

INSTITUTI I STUDIMIT TË KRIMEVE DHE PASOJAVE TË KOMUNIZMIT

**FJALOR ENCIKLOPEDIK
I VIKTIMAVE TË TERRORIT
KOMUNIST**

I
A-Ç

TIRANË, 2012

Fjalor enciklopedik i viktimave të terrorit komunist

Redaktor përgjegjës:
Azem Qazimi

Redaksia:
Agron Tufa, Davjola Ndoja, Çelo Hoxha,
Daniela Runa, Brunilda Doçi, Ada Sinani, Juliana Kurti

Bordi konsultativ:
Kolec Topalli
Alfred Luka
Uran Butka
Gëzim Peshkëpia
Pjetër Pepa
Romeo Gurakuqi
Nebil Çika
Agim Musta
Valjeta Kaftalli
Visar Zhiti
Virion Graçi
Kolec Çefa
Dhurata Shehri
Gjovalin Çuni

© ISKK, 2012



Ky botim u mundësua nga Fondacioni “Konrad Adenauer”

Design & Layout: Grafika Elzana
Shtypur në shtypshkronjën:
West Print

978-9928-168-01-6

ISBN: 978-9928-168-02-03

Ky botim shpërndahet falas

NË MUNGESË TË NJË TRIBUNALI

*“Kam me ju kallë mnerën në një grusht pluhun¹”
(T.S. Eliot)*

Një inventar për viktimat e terrorit komunist

“Fjalori Enciklopedik i Viktimave të Terrorit Komunist” është një projekt i Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri (ISKK). Fill pas botimit të këtij vëllimi të parë, Instituti ynë do të vijojë punën evidentuese për realizimin e plotë të projektit, i cili, në përputhje me rendin alfabetik, mendohet ta “shterojë” lëndën e tij në 8 vëllime. Në faqet e këtij Fjalori, ne synojmë t’i bëjmë me dije gjithkujt që interesohet për përmasat e krimit, dhunës, terrorit, shtypjes, sikundërse dhe format e përndjekjes që shteti komunist njëpartiak (ose Partia-Shtet), ka ushtruar mbi qytetarët shqiptarë gjatë gjithë ekzistencës së tij, para dhe gjatë ushtrimit të pushtetit. Përveç përmbushjes së kësaj detyre të dëshmisë dhe kujtesës, si detyrim moral ndaj të vdekurve, sidomos kur ata janë viktimat të pafajshme e të pambrojtura, Instituti ynë synon, njëkohësisht, krijimin e një *database kombëtare* me të dhënat më të plota për numrin e përgjithshëm të qytetarëve shqiptarë të persekutuar politikisht nga regjimi komunist i Enver Hoxhës dhe Ramiz Alisë.

Në të gjitha traditat e lashta dhe të reja të njerëzimit, puna e parë që është bërë fill pas një lufte apo beteje, ka qenë hartimi i listave të sakta zyrtare të humbjeve në njerëz. Të gjithë e dimë se kohëzgjatja gjysmëshekullore e diktaturës komuniste në Shqipëri, e kalon disa herë përmasën e thjeshtë të një lufte a beteje; për popullin shqiptar, kohëzgjatja e diktaturës komuniste ishte një ployë rrënuese, shkatërrimtare, që e cfiliti dhe e shfytyroi shoqërinë tonë deri në mosnjohje. Një pjesë e pakthyeshme, e pazëvendësueshme dhe e pandreqshme e kësaj “lufte të gjatë” drobitëse ishin qytetarët shqiptarë, viktimat të përshkallëzimit të dhunës, të cilët, siç do të paraqiten në “Fjalor...”, janë mijëra të pushkatuar, dhjetëra mijëra të dënuar politikë dhe mbi njëqind mijë të tjerë të internuar në kampet shfarosëse të punës së detyruar. Deri më sot nuk është bërë një përpjekje gjithëpërfshirëse e sistematizuese e numrit të plotë të viktimave, prandaj, edhe rezultatet që kanë dhënë disa statistika të vitit 1993 e në vijim, janë të pjesshme, duke u bazuar në dokumentacionin zyrtar të shtetit komunist. Mbledhja dhe hartimi i të dhënave të sakta të numrit të qytetarëve të persekutuar politikisht, i tejkalon ndjeshëm shifrat e deritanishme, duke përfshirë, si ndërmjetësim konfirmues për çdo zë në aktet ligjore të dënimit, edhe dëshmitë e penalitetit.

¹ T.S.Eliot. Varg i poemës “Toka e shkretë”, sipas përkthimit tim (A.T).

Nazizmi *versus* Komunizmi

Alen Bezanson, një ndër filozofët e politologët më të shquar bashkëkohorë francezë, në librin e tij "Fatkeqësitë e shekullit", nazizmin hitlerian dhe komunizmin i quan në një masë të barabartë - *sisteme kriminale*. Që të dy, në të njëjtën masë, lejuan krimet masive dhe gjenocidin. Që të dy sistemet vranë miliona njerëz. Megjithatë, kujtesa historike i percepton këto dy sisteme jo njëllor. Nëse krimet e nazizmit gjithmonë kujtohen, për habi, për krimet e komunizmit në pjesën më të madhe të vendeve ish-komuniste, heshtet, ndërsa për ndëshkimin e përgjegjësve për vrasjet, burgosjet, rrënimin dhe trulllosjen e tre a katër brezave - as që bie fjala. Prej nga e ka zanafillën kjo asimetri në sjelljen ndaj nazizmit dhe komunizmit, - pyet Bezansoni? Ai parashton shtatë shkaqe.

Së pari, nazizmi është shumë më i njohur, për shkak se aleatët hapën kanatësh "dollarët me kufoma", ndërkohë që shoqëritë perëndimore i kishin provuar në lëkurë të vet egërsitë e hitlerianëve. Por GULAG-u sovjetik dhe kampet e përqendrimit kinez "Laogaj" - ishin për europianët diç e përlargët dhe mjegulllore.

Së dyti, detyrën për të ndërmendur krimet e nazizmit e mori përsipër populli hebre. Njerëzimi duhet t'u jetë mirënjohës hebrenjve që gjenocidi nazist i kryer mbi ta, nuk iu la harresës, - shkruan Bezansoni.

Së treti, nazizmi dhe komunizmi qenë përzier në polet e përkundërta të fushës magnetike - në të djathtë dhe të majtën. Shumë intelektualë e klasifikonin komunizmin tek forcat e majta, duke e marrë aparençën dhe dinakërinë e parullave të ideologëve komunistë si të vërteta të padiskutueshme. Ndërsa rrënjët e nazizmit i shihnin të lidhura me ideologjinë e djathtë. Por në të vërtetë, fashizmi italian dhe nazizmi gjerman i kanë rrënjët pikërisht në demagogjinë e majtë - ja paradoksi!

Së katërti, aleanca ushtarake e shteteve demokratike me Bashkimin Sovjetik në kohën e luftës kundër Gjermanisë hitleriane e dobësoi mbrojtjen e Perëndimit nga komunizmi dhe lindi në një farë lloji bllokadën intelektuale. Vendet demokratike u sakrifikuuan rëndë në emër të fitores mbi Hitlerin. Mandej, në përfundim të kësaj lufte, perëndimorët nuk kishin më fuqi që të mund të ndalnin edhe regjimin sovjetik, e, së mbrami, duke u përpjekur të ruajnë ekuilibrin, ata e ndihmuan atë të mbahej.

Së pesti, një arritje e madhe e ideologëve sovjetë ka qenë dhe ajo që ata përhapën dhe diktuan sistemin e tyre të klasifikimit të regjimeve politike: socializmin ia kundërvinin kapitalizmit, madje socializmin e identifikonin plotësisht me rendin sovjet!

Së gjashti, dobësia e një grupi njerëzish, të aftë për të ruajtur kujtesën mbi komunizmin. Nazizmi sundoi përgjatë 12 vjetëve, ndërkohë që komunizmi evropian pati një ekzistencë midis 50-70 vjetësh. Gjatë kësaj kohëzgjatjeje, shoqëria që rrënuar, elitat dalëngadalë u shfarosën, duke iu nënshtruar dhunshëm riedukimit. Mbretëroi mashtrimi, pabesia, perversioni moral. Shumica e njerëzve të pavarur, të aftë për reflektim, u privuan nga mundësia e njohjes së historisë dhe e humbën aftësinë e analizës. Pas rënies së sistemit totalitar, gjëja më e vështirë është të ringresh parimet morale dhe

aftësitë intelektuale. Gjermania ishte në një gjendje më të volitshme se Rusia postsovjetike: Hitleri nuk pati kohë të plotë që të shfaroste shoqërinë qytetare.

Së shtati, amnezia, me të cilën kemi punë në rastin e komunizmit, na shpie në përfundimin se kujtesa për nazizmin vazhdoi të mbetet e të ushqehet fort, ndërsa nuk ndodhi e njëjta gjë me komunizmin.

Mitologjia komuniste mbi Kohën dhe Historinë

Terrori i konceptuar politikisht dhe ideologjikisht sipas doktrinës komuniste ose *terrorologjika*, nuk kurseu as mjet e as qëllim, duke mbjellë një psikozë të rëndë ankthi e pasigurie nga kryeqyteti deri në fshatrat e provincat më të skajshme të atdheut, si në rastet kur u drejtua ndaj kundërshtarëve të regjimit, ashtu edhe ndaj bashkëpunëtorëve të tij. Dhuna e kombinuar me propagandë, me gjyqe masive, me luftën e klasave, me pushkatime, linçime publike dhe sistemin e dubluar të survejimit, alibisë së fajit dhe spiunimeve, e shpuri terrorin shtetëror në një rang okult, duke e nënshtruar skllavërisht popullatën shqiptare të pranonte, e paralizuar, vullnetin e pushtetit diktatorial.

Sistemi totalitar i pushtetit komunist e tëhuajësoi popullin shqiptar prej çdo kujtese e tradite të mëparshme, duke i imponuar regjimin e vet të edukimit, nëpërmjet shantazhit, varfërimit, terrorit, pushkatimeve, burgimeve e internimeve dhe propagandës nëpër shkolla, kooperativa e qendra pune. Çdo përfytyrim i mëparshëm për historinë, marrëdhëniet shpirtërore me fenë dhe traditën, artin e letërsinë u fshi, u çrrënjës, duke eksperimentuar ndër breza tipin e njeriut të ri, pa të shkuar, një tabula rasa, si hap i parë i manipulimit të ndërgjegjes, përshtat me trajektoren e shndërrimit të tij në një zombie të komanduar. Sipas komunistëve, historia fillon në atë moment kur ata erdhën në pushtet. Atëherë nis dhe “shenjtërimi” i historisë dhe e drejta për ta parë atë sipas doktrinës ideologjike. Kjo duket qartë në manipulimin e traditave, bastardimin e folklorit dhe arteve dhe sidomos, me kalendarin e festave të ngjyer lyrshëm me të kuqe. Është një mitologji e tërë që flet për zëvendësimin e festave tradicionale me festat komuniste, siç është zëvendësimi i 28 Nëntorit me datën 29 si datë e “Çlirimit” të Shqipërisë, duke e njehsuar atë me festën kombëtare të Jugosllavisë. Le të ndalemi pak në origjinën intencionale mitologjike të festimeve komuniste, e cila synonte ta rrethonte njeriun me suazën kohore të doktrinës.

Baza mitologjike e festimeve, qysh në kohërat parakristiane, ka qenë kremtimi i çdo “zanafille të re”, një dëshirë e fortë për një *përtëritje* të re të botës; dëshira për të hyrë në historinë e *përtëritjes* së botës, domethënë *të krijuar për së pari*. Nuk është vështirë të sillen shembuj të shumtë për ta ilustruar. Ndër shumë mite, ndër më tipikët janë miti *mbi parajsën e humbur* që ruhet deri më sot në imazhet e ishullit parajsor apo tokës së pamëkatë, tokës së çliruar, Eldorados utopike ku ligjet janë anuluar, ndërsa koha qëndron në vend. E rëndësishme është të depërtojmë matanë maskës së sjelljes mitologjike të realitetit bashkëkohor, duke analizuar, para së gjithash, pozicionin e tij ndaj kohës. Nuk duhet të harrojmë që njëri nga funksionet thelbësore të mitit është

të mundësojë hyrjen në *kohën zanafillore*. Kjo duket qartë në tendencën për të injoruar kohën e tashme apo atë që quhet “moment historik”.

Reminishencat e këtij qëndrimi mitik ndaj kohës mund t'i kundrojmë në kalendarët e kremtimeve festive, të cilat rrëfejnë për të vërtetat absolute, për *historinë e shenjtë*, të ndryshme nga ajo *profane*, nëse operojmë me këto dy nocione të Mirçea Eliades. Me fjalë të tjera, miti shfaqet si *histori e vërtetë* e asaj që ka ngjarë në burimet e kohës dhe paraqet një model sjelljeje për njeriun dhe shoqërinë. Duke kopjuar akte tipike të zotave apo heronjve mitikë, apo thjesht duke i shkruar bëmat e veta, njeriu i shoqërive arkaike e ndan veten nga koha *profane* për t'u gjetur në një mënyrë magjike në kohën e Madhe të *shenjtë*.

Por reminishenca mitike e *zanafillës së re*, e *krijimit të ri* dhe *kronologjisë së re*, ndeshet përgjatë gjithë historisë së civilizimeve, si në themelimin e religjioneve të mëdha, ashtu dhe në kthesa, përmbysje historike apo revolucione, sidomos me ardhjen e diktaturave në pushtet dhe modelimin mitik të realitetit gjoja sipas konsequencës së doktrinave. Në të gjitha këto raste kemi një gjë tepër të thjeshtë, që thuhetse “bërtet”: “Koha fillon numërimin nga momenti që erdhëm ne në pushtet!”

Por ne na intereson në këtë kumtesë statusi politik i mitit dhe mitologjizmit të realitetit.

Le t'i lëmë mënjanë të gjitha çështjet e përligjjes filozofike të komunizmit të Marksit dhe fatin e tij historik dhe le të shqyrtojmë vetëm modelin mitologjik të komunizmit dhe domethënien eskatologjike të popullaritetit dhe suksesit të tij. Çfarëdo të jetë thënë për pretendimet shkencore të Marksit, një gjë është e qartë, që autori i *Manifestit të komunizmit* merr dhe shtjellon një nga mitet më madhështore eskatologjike të Mesdheut dhe të Lindjes (“i zgjedhuri”, “i shenjuari”, “i papërlyemi”, “misionari”, “Mesia” - ndërsa në shekullin XX – këto attribute i vishen proletariatit), përvujtnia dhe cfilia e të cilit janë thirrur të ndryshojnë statusin ontologjik të botës. Në fakt, shoqëria pa klasa e Marksit dhe zhdukja e mëpasme e të gjitha tensioneve historike e gjen plotësisht precedentin e vet në mitin mbi Shekullin e Artë, i cili, sipas një shumice doktrinash, gjendet në zanafillë dhe në fund të historisë. Marksi e begatoi këtë mit të lashtë me ideologjinë e vërtetë mesianike *judeo-kristiane*: nga njëra anë - me rolin profetik e shpëtimtar që i atribuohet *proletariatit* dhe nga ana tjetër - me betejën vendimtare mbi të Mirën dhe të Keqen, e cila mbaron me fitoren vendimtare të së Mirës, gjë që mund ta krahasojmë me luftën apokaliptike ndërmjet Krishtit dhe Antikrishtit. Është menjëmend e rëndësishme që Marksi adopton në dobi të vet besimin eskatologjik judeo-kristian për *qëllimin absolut të historisë*; dhe pikërisht këtu ai ndahet me filozofët e tjerë të historisë (për shembull me B. Kroçen, Ortega y Gasetin), të cilët shpallin se tendosjet apo tensionet historike janë karakteristikë e natyrës njerëzore dhe prandaj prej tyre kurrë dhe asnjëherë nuk ka shpëtim përfundimtar.

Kalendarët e festave që në dukje janë thjesht profanë, në thelb ruajnë strukturë dhe funksion mitologjik. Kështu, Enver Hoxha dhe komunistët kanë ndërjerë një nevojë të turbullt për një *zanafillë krejt të re* (*incipt vita nova*)

kur kanë shpërngulur datën e çlirimit të Shqipërisë nga 28 në 29 nëntor 1944. Duke e ndarë qartë nga data e kthimit të Gjergj Kastriotit në atdhe dhe festa e Pavarësisë, - data e kremtimit të Çlirimit, e shpërngulur më 29 nëntor, është njëmend data e ripërtëritjes së historisë shqiptare, por nga pikëpamja e mitikës komuniste. Kujdesi i pushtetit të ri për ta strukturuar simbolikën komuniste jashtë dhe për ta lënë të papërzier me dy 28-at e kalendarit patriotik, nxjerr në pah frikën se mos kjo datë do ta eklipsonte monopolin e çlirimit, i cili duhej të ishte veçse atribut dhe meritë e komunistëve. Në këtë mënyrë, komunistët shqiptarë do të përfitonin në maksimum prej nëntorit, duke nxjerrë prej këtij muaji një zinxhir të kuq festash kalendarike, si 7 nëntori - data e revolucionit bolshevik rus të Leninit, 8 nëntori (dita e themelimit të PKSH), 17 nëntori (dita e çlirimit të kryeqytetit), 23 nëntori - festa e Rinisë Komuniste (ditëlindja e Qemal Stafës) dhe 29 nëntori – data e çlirimit të atdheut. Një zinxhir i tillë do ta sfumonte datën e *partit* 28. Jo më kot në zhargonin komunist ky muaj u quajt “Nëntori i kuq”, ndërsa të vetmes revistë letrare në Shqipëri, organ i Lidhjes së Shkrimtarëve dhe artistëve, iu vu emri “Nëntori”, krejt në analogji me revistën letrare të shkrimtarëve rusë “Oktjabër” (“Tetori”). Gjithë zhurma këmbëngulëse që bën e majta me angazhimin e veteranëve, familjet e dëshmorëve, OJQ-ve dhe forumeve të çunakëve dhe çupëlinave, rrjetin mediatik me historianë që e kanë shkruar po vetë historinë e Shqipërisë, sipas lenteve të kuqe ideologjike – gjithë kjo zallamahi për sensibilizimin e shoqërisë – është hiç më pak se përfitim i përllogaritur i asaj pjese të elektoratit të implikuar me mitin dhe nostalgjinë komuniste.

Por nëse i pranojmë si të mirëqena pretendimet e veteranëve për vërtetësi historike, atëherë njëkohësisht me nderimin për Luftën e tyre antifashiste, kemi të drejtën t’i fajësojmë ata si bashkëfajtorë në instalimin e diktaturës staliniste në Shqipëri, t’i fajësojmë njëkohësisht për shkallën e egër të persekutimit dhe gjenocidit komunist mbi dhjetëra mijëra familje shqiptare; kemi të drejtë njëkohësisht t’i fajësojmë ata që bënë luftën, se qenë pjesëmarrësit dhe ushtruesit e pushtetit më përçarës e më antikombëtar, qysh me aspektet e luftës civile (1943-1945), kur në fakt kishin për detyrë të luftonin okupatorët dhe jo bashkatdhetarët që nuk ndanin të njëjtin vizion ideologjik me ta. Pa llogaritur mandej që pjesa dërrmuese e tyre ishin ministra, drejtues institucionesh, oficeë, hetues, policë, etj. Ishin pushteti ekzekutues i përditshmërisë shqiptare në të gjitha nivelet administrative dhe publike.

Nevoja për dekonstruktimin e miteve komuniste në përditshmërinë e sotme plot tension konjunktural politik është detyrë e inteligjencies së re, sidomos kur këto mite në momente të caktuara pretendojnë të bëhen jo vetëm argumenti i ditës, por edhe instanca politike e publike shantazhi, kuraje, revansh për të fituar sërish status sakral. Ringritja e nostalgjisë komuniste për “parajsën e humbur” duhet kundruar si një energji e trashëguar e monopolit komunist mbi festat kalendarike, të cilat lidhen me data të tjera, të shumta, me energjinë e idoleve komuniste në trajtën e emrave të heronjve dhe dëshmorëve, që mbushin institucionet, shkollat, rrugët dhe sheshet tona

publike. E kemi parë angazhimin luftarak në studiot dhe shtypin e shkruar se me çfarë fanatizmi u kundërshtua ideja e heqjes së mozaikut socrealist nga fasada e Muzeut Kombëtar.

Pesë vjet më parë nxitoja të kapja autobusin në stacionin e kreut të rrugës “Komuna e Parisit”. E lashë të kalojë autobusin ngase vura re disa punëtorë të Bashkisë, që po hiqnin pllakën që i jepte emrin asaj rruge. U ndala të shoh e të shuaj kureshtjen se çfarë emri të ri do t’i vinin rrugës. Dhe ja, pasi hoqën pllakën me mbishkrimin “Komuna e Parisit”, punëtorët vunë pllakën e re, që e zëvendësonte emrin e mëparshëm me emrin që mban tash zyrtarisht. Pllaka e re tregon: Rruga “Medar Shtylla”. Emri i ri konfirmon simbolikën brenda të njëjtit sistem vlerash ideologjike.

Të majtët shqiptarë, ndër shumë ekuivoqe në lidhje me trashëgiminë e tyre ideologjike, kapen pas mitit të 29 nëntorit si kryesimboli i festës së tyre kalendarike, kësaj stërgjysheje ilegjitime që ka pjellë të gjitha simbolet e tjera më të vogla. Nëse do të binte ky kryesimbol, do të çahet gjithë piramida e simboleve të tjera. Rëndësi ka simboli, miti, rituali, inicimi që diktojnë sjelljen dhe orientojnë energjitë. Pak rëndësi ka cila është e vërteta. Zaten në politikë dhe ideologji e vërtetë është vetëm ajo që i shërben kauzës. Është pikërisht ky thelb simbolik që modelon ndjeshmërinë dhe tipin e ligjëritimit në komunikimin politiko-ideologjik.

Krimet kundër njerëzimit: a ka ushtruar gjenocid komunizmi?

Gjenocidi (greq vj. - racë + lat. caedere - me vra) - është shfarosja e grupeve të veçanta të popullsisë nisur nga motive racore, nacionale, religjioze apo sociale. Nocioni “krim kundër njerëzimit” përfshin në vetvete një radhë krimesh të shenjuara. Më karakteristiku prej këtyre krimeve është gjenocidi. Këtij nocioni i është dhënë përkufizimi gjegjës: “një akt i kryer me qëllim shfarosjen e plotë apo të pjesshme të ndonjë kombi, etnie, race ose grupi religjioz, si dhe çdo grupi tjetër në përgjithësi, të veçuar sipas kritereve arbitrare” (artikulli 6c, në konvencën e OKB-së të datës 09.12. 1948). “Ne do të vazhdojmë luftën jo kundër personave të veçantë, - shkruan Laci, shef i ÇK, (më vonë KGB) më 01.11.1918. - Ne do ta zhbijmë borgjezinë si klasë”. Pyetja e parë, së cilës duhet t’i përgjigjej i pandehuri në hetim ishte: çfarë prejardhjeje ka ai, edukim-arsimimi, profesioni. Këto pyetje duhet të përcaktonin fatin e tij të mëtejshëm.

Ka plagë të cilat kurrë nuk do të mbyllen. Si ka mundësi të ndodhë, që miliona njerëz pa asnjë faj të jenë shfarosur me ardhjen në pushtet të një grupi të vogël kriminelësh? E prapë miliona të tjerë u bënë viktima të makinës së terrorit shtetëror - të anatemuar të shoqërisë, që iu nënshtruan vuajtjeve të pafundme. Tragjedi e të vdekurve dhe e të gjallëve. Mjafton një guidë e shpejtë që të mbërrish në përfundimin se shekulli XX është qindvjetëshi i katastrofave më të mëdha humanitare: dy luftërat botërore me në mes Revolucionin bolshevik të Tetorit, nazizmi dhe kasaphanat raciste nga Europa në Ruandë. Gjermania e Hitlerit - mbi hebrejtë dhe ciganët; Italia e Musolinit - me vrasjen e etiopianëve; Serbia jugosllave e postjugosllave - mbi shqiptarët e Kosovës dhe boshnjakët muslimanë.

Midis tmerreve që tronditën botën e shekullit XX, komunizmi është fenomeni më i frikshëm, i cili ra i fundit në Rusi dhe Shqipëri më 1991. Dokumentat dhe dëshmitë arkivore s'të lënë dyshim se terrori ka qenë që në fillim baza përbërëse e komunizmit. Pushkatimet, varjet, mbytjet, rrahja deri në vdekje, uria e programuar dhe e imponuar, vdekja nga puna rraskapitëse në kampe, nga deportimi; etapë pas etape ne përftojme veçse një ide të zbehtë listash e katalogjesh të krimeve të komunizmit kundër njeriut. A nuk është gjenocid zhdukja e asgjësimi sipas një axhende politike spastrimi i klerit, që përbën një klasë? Po zhdukja e borgjezisë dhe tregtarëve, grabitja e floririt dhe shpronësimi i tyre? Po zhdukja e intelektualëve apo shpronësimi nga toka i fshatarit? Këto krime nuk rroken në kornizat e ligjeve humane dhe mendjes së shëndoshë të njeriut normal as nga pikëpamja historike, as nga pikëpamja morale. Ky është komunizmi real, që ka ekzistuar në tokë në një kohë të caktuar, në vende të caktuara me praktikatat e udhëheqësve të rinj - Leninit, Stalinit, Mao Ce Dunit, Ho Shi Minit, Kim Ir Senit, Pol Potit, Çausheskut, Enver Hoxhës, etj.

Numri i përgjithshëm i të vrarëve nga regjimet komuniste përafrohet tek 100 milionë njerëz (sipas të dhënave nga libri i Stefan Kurtua dhe Nikola Vert - *"Libri i zi i komunizmit"*). Krimet e komunizmit janë të paevidentuara: para së gjithash, ato janë krime kundër shpirtit/frymës, kundër kulturës dhe krimi më i madh janë vrasjet masive të njerëzve.

Komunizmi - çarja më e madhe në historinë tonë kombëtare

Komunizmi, që krijoi çarjen më të madhe në historinë e shqiptarëve, tashmë, nën dritën e arkivave, dokumentave e studimeve të reja, nuk ka pikë dyshimi se u krijua, themelua dhe u organizua sipas një plani të detajuar të Partisë Komuniste Jugosllave nëpërmjet emisarëve të saj, para së gjithash, të Miladin Popoviçit dhe Dushan Mugoshës. Nën urdhrat, miratimet dhe tutelën e komunistëve jugosllavë, u formua e ashtuquajtura Parti Komuniste Shqiptare (PKSH), e cila vuri në jetë, deri në mishërim të plotë, planin e aneksimit të Kosovës pas Luftës së Dytë Botërore dhe kontrollin e pushtetit politik dhe ekonomik mbi Shqipërinë, përmes të zgjedhurit dhe të nënshtruarit të tyre, Enver Hoxhës. Kontrolli i pushtetit të komunistëve jugosllavë mbi luftën, Miladinit dhe Dushanit, nëpërmjet Enver Hoxhës dhe ultraekstremistëve të majtë me sens antikombëtar (H. Kapo, M. Shehu, R. Çitaku, K. Xoxe e L. Gega), i dha kthesë tragjike dy përpjekjeve serioze të nacionalistëve shqiptarë dhe krahut të moderuar me sens kombëtar (M. Gjinishi, S. Malëshova, K. Tashko, Y. Dishnica) për krijimin e një fronti të përbashkët të çlirimit nga pushtuesi fashist dhe prosperitetin e Shqipërisë. Megjithëse, siç dihet gjerësisht, luftën kundër pushtuesve e nisën nacionalistët, të cilët organizuan demonstratat e para kundër tyre, rezistencën e parë antifashiste dhe çetat e para, që luftuan armikun me armë, si ato të Abaz Kupit, Muharrem Bajraktarit, Mestan Ujanikut, Ismail Petrelës, Safet Butkës, Shyqyri Pezës, Hysni Lepenicës, Skënder Muços, Abaz Ermenjit, Baba Fajës etj., në të dyja konferencat për organizimin e Frontit të përbashkët kundër pushtuesit (Pezë, 16 shtator 1942 dhe Mukje, 8 gusht 1943), krahu komunist

i kontrolluar prej Miladinit dhe Dushanit tentoi deri në fund t'u impononte marrëveshjeve format dhe kushtet e saj. Pas arritjes së "Marrëveshjes së Mukjes" dhe proklamatës patriotike të Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë, vijon menjëherë raporti i Miladin Popoviçit drejtuar Komitetit Qendror të PKJ:

"Kemi biseduar me KQ të PPSH dhe studiuam çështjen e situatën atje dhe atëherë vendosëm, që të nxjerrim një traktat, që të mos njihet mënyra e organizimit të Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë dhe as funksionet e tij si instanca më e lartë në Luftën NÇL"². Ja si e përshkruan një dëshmitar çastin kur Proklamata e Mukjes u bë e njohur për shqiptarët, por edhe për serbin Miladin Popoviç: a e dini pse u prish Bashkimi i kongresit të Mukjes, shkruan ai, ja pse: "Në atë kongres është shënuar fjala 'Shqipëri Etnike', domosdo, për Kosovën. Mirëpo Dushani e Miladini nuk duronin që Kosova t'i hiqej Jugosllavisë. Për këtë o shokë u prish bashkimi i Mukjes. Jam ndodhur vetë me shumë shokë të Qendrorit, në krye të të cilit ishte Druzha Miladini, kur me postë të jashtëzakonshme arriti Proklamata e Bashkimit të Mukjes. E hapëm Proklamatën, e kënduam, në fytyrën e lexuesit shëndriti rrezja e siahiriqit të bashkimit e të gjithë u gëzuam. Më vonë e mora atë Proklamatë dhe duke ia spjeguar gjysmë shqip e gjysma serbisht, Miladini e kuptoi menjëherë dhe në fytyrën e tij hipi një cergë e zezë dhe filloi të thotë: "Nuk pranohet ky bashkim. Neve tashti që po forcohem, do të fillojmë nga spata dhe jo të bëjmë lidhje me qentë; pastaj kjo Skipëri Etniçka - jeben ti majka (është për t'i q... nënën)"³. Që nga mesi ose fundi i gushtit në horizontin e përgjakur shqiptar u ngrit si një re ogurzezë vëllavrasja, lufta civile, sinonimi i fjalës komunizëm; lufta civile që bëri pre jo vetëm individë e fise, por edhe fshatra të tërë të cilësuar komunistë ose ballistë.

Me 1 tetor 1943 Enver Hoxha ngriti siparin e përgjakur të Luftës Civile. Enver Hoxha, në një letër që i dërgon Liri Gegës, urdhëron luftën frontale kundër Ballit sipas logjikës leniniste "Pushteti del nga gryka e pushkës", se nuk duhet të këtë pretendent tjetër për pushtet në Shqipëri. Në atë letër ai shprehet tekstualisht: "Për këtë nuk duhet të ketë dy kuptime, por vetëm pushteti i këshilleve duhet të ekzistojë dhe asnjë pushtet tjetër. Nuk ka kompromis dhe dualitet në këtë gjë"⁴. Letra të tilla drejtuar drejtuesve të partizanëve komunistë janë të shumta. Ato shprehin qartazi luftën e shpallur ndaj çdo alternative që do të pretendojnë për pushtetin e ardhshëm. Prishja e Marrëveshjes së Mukjes shënon shpalljen e luftës në radhë të parë ndaj Ballit dhe Legalitetit, siç thekson Enver Hoxha në një letër drejtuar Gogo Nushit: "S'duhet humbur kohë, po zjarr për zjarr t'u vëmë zjarrin Ballit dhe zogistëve". Në një letër të pabotuar të Shtabit të Përgjithshëm NÇL, ekziston dhe një radiogram që udhëzon: "Të mos luftohen ashpër pushtuesit gjermanë, por Bazi të zhduket. Kjo do të ishte fitore. No comment"⁵.

Vëllavrasja dhe vallja e përzishme e vdekjes përfshin të gjitha krahinat e Shqipërisë nga Jugu në Veri. Ajo i ngjet një "spastrimi etnik", ku axhendën

2 Butka Uran, "Mukja, shansi i bashkimit peng i tradhëtisë", Tiranë, 1998, f.56

3 po aty, f. 143

4 Hoxha Enver, Letër Muzhikut, Liri Gegës, 1.10.1943

5 Butka Uran, "Mukja, shansi i bashkimit - peng i tradhëtisë", Tiranë 1998, f.133

e spastrimit e drejtojnë emisarët serbë të PKJ. Për të perceptuar tablonë e terrorit të luftës civile, ia vlen të rendisim disa fakte kronologjike⁶:

- Në Libohovë, gusht 1943, u vranë 11 vetë; në nëntor 1943 u vranë 17 vetë, derisa në luftën vëllavrasëse shifra e viktimave midis partizanëve dhe Ballit shkoi në 104 vetë.
- Në Devoll, Ziçisht, ku ishte lënë një takim, komunistët u bënë pritë përfaqësuesve të Ballit dhe zogistëve dhe vranë 6 nacionalistë, midis të cilëve edhe Dr. Kasimatin, të cilin e therën me thikë në fyt, pastaj i thanë: "Hë tani, na fol edhe njëherë për Shqipërinë tënde".
- Me 14 shtator 1943 forcat nacionaliste të Hysni Lepenicës e Skënder Muços u kërkuan forcave italiane të divizionit "Peruxhia" të dorëzoheshin. Krerët komunistë Bedri Spahiu, Shefqet Peçi, Shemsi Totozani që ishin në zyrat e komandës së divizionit italian organizuan vrasjen e tyre. Ndërsa nacionalistët ishin në portën e divizionit e kërkonin takim me komandantin e tij, dikush qëllloi me armë nga jashtë dhe italianët hapën zjarr kundër nacionalistëve. Pas tre-katër orëve luftë, u vra H. Lepenica me 35 nacionalistë.
- Me 21 tetor 1943 në fshatrat e Lushnjës forcat partizane të Brigadës I Sulmuese, të udhëhequra nga Mehmet Shehu dhe serbi Dushan Mugosha, vranë e therën me thika 65 fshatarë të pafajshëm, me pretekstin se ishin simpatizues të Ballit.
- Mehmet Shehu, që më vonë u bë kryeministër i Shqipërisë, i njohur për vrasjet e tij në Vlorë, Peqin e Dumre, në tetor 1943 pushkatoi në Priskë të Tiranës 13 xhandarë e fshatarë që iu dorëzuan në besë.
- Në Çermenikë - i shkruan E. Hoxha N. Spirit: "Brigada kapi robër ballistë dhe më tepër se 70 prej tyre u pushkatuan. Siç shihet, Brigada I po lufton për mrekulli"⁷.
- Në Kuçovë u konfrontuan me armë partizanët dhe nacionalistët. Lufta zgjati gjithë natën, u vranë 7 partizanë, 2 nacionalistë dhe shumë të plagosur nga të dy anët.
- Në zonën e Pogradecit nga luftimet vëllavrasëse që zgjatën nga 13-18 tetor 1943, përveç viktimave, u vranë edhe 8 civilë.
- Në Libofshë mbetën të vrarë në luftime 21 partizanë dhe 8 ballistë.
- Në Melçan të Korçës, çeta e kryesuar nga A. Gjeorgjevica kapi dy nacionalistë. Këta u masakruan barbarisht: iu prenë hundët, veshët, iu nxorën sytë, iu prenë nofullat e krahët...
- Me 23 tetor 1943 në mes të Kavajës dhe Pezës u masakruan barbarisht Besnik Çano dhe Qeramudin Sulo, dy të rinj nacionalistë. Ekzekutimi i tyre u bë nga Dushan Mugosha me anë të maqedonasve Papa Hasani dhe Leon Katërvasi.
- Në një raport që komanda e Shtabit të Korçës i dërgon Shtabit të Përgjithshëm, mësohet se në përpjekje midis partizanëve u vra komisar i batalionit Gorë-Opar Skënder Çaçi. Humbjet e Ballit janë 5 të vrarë, disa të plagosur dhe 4 robër. U plagos dhe komandanti i Ballit Demir

6 Citimet janë marrë nga historiani Luan Xhafa "Libri i zi i Komunizmit" (shtojca), Besa, Tiranë 2000.

7 Butka Uran, "Mukja, shans i bashkimit - peng i tradhëtisë", Tiranë 1998, f.123

Staravecka, që vdiq të nesërmen. “Goditja doli me sukses dhe përfitimi politik ishte i mjaftë”...

- Në nëntor 1943 Brigadat I dhe V, të komanduara nga Mehmet Shehu dhe Hysni Kapo, të orientuar nga D. Mugosha, u konfrontuan me nacionalistët dhe bazat e tyre në fshatrat e Sevasterit e të Velçës, ku u vranë dy pleq; në Gjorm, pas 26 orë luftimesh, u vranë 24 partizanë, viktimat e luftës civile.
- Në luftën e Dukatit, me 30 nëntor 1943, që zgjati 13 orë, u vranë 14 partizanë e 10 nacionalistë dhe u plagosën shumë të tjerë, midis tyre 3 gra.
- Përpjekjet me armë midis formacioneve politike kundërshtare ishin më të përgjakshme në Jug të Shqipërisë, ku ndikimi i nacionalizmit ishte më i madh. Në Gjirokastër u vranë qindra njerëz. Në Tepelenë, në teqen e Turanit, u vra babai i teqesë dhe të tjerë. Vrasje masive pati në Voskopojë, ku u gjetën 150 viktimat e varrosura në një gropë. Vatrata e vrasjeve përfshinë Mallakstrën dhe Kolonjën, ku lufta civile ishte ashpërsuar shumë. I gjithë ky peisazh i përgjakur vëllavrasës i përket vetëm periudhës shtator-nëntor 1943.

Për të parë efektet shkatërruese e gjakësore të luftës civile, le të ndalemi në fshatin Lepenicë të Mesaplikut të Vlorës. Pas 18 orë luftimesh midis shqiptarësh (të huaj nuk kishte), u dogjën 11 shtëpi nga 61 që kishte fshati dhe fshatarët u strehuan në male e pyje. Por lufta nuk mbaroi me kaq, nga 50-60 burra që mbetën, 14 u dënuan me burg politik, 2 vdiqën nga torturat, 5 u pushkatuan, 6 u arratisën dhe të tjerët u cilësuan “kulakë”.

- Në Dishnicë, thuhet në një dokument, komunistët dogjën fshatin bashkë me njerëzit e pafajshëm; plakun Riza e poqën në zjarr. Rakipin e varën në degë të një peme...
- Në Devoll partizanët zunë rob 14 ballistë, 13 i pushkatuan, ndërsa të fundit e masakroi serbi Dushan Mugosha. Devolliun Ali Lumi, djalosh i pafajshëm, me urdhër të Dushanit, e qëlluan 12 herë në dru. Pastaj vetë xhelati Dushan, i theu këmbët, ia rregulloi, ia theu edhe më lart.

E torturoi në organet seksuale derisa humbi ndjenjat dhe më vonë, me majën e thikës i çau kërcin e majtë dhe ia kroi kockën derisa i doli gjak. I shoi cigaren në beben e syve dhe më në fund, trupin e pajetë e qëlloi dy herë në kokë... I gjithë ky ritual kriminal u krye në prani të Tahir Kadaresë e të partizanëve. Dhe kur një i pranishëm e pyeti Dushanin se ç’kishte bërë djaloshi, ai u përgjigj: “Besa kurrëgj. Po këtyre devollinjtë kështu duhet t’ua bësh, se të gjithë janë nacionalistë”⁸.

Shifra e përgjithshme e viktimave të luftës civile në Shqipëri ende nuk është nxjerrë përfundimisht, por statistikat paraprake të trondisin: rreth 3/4 janë viktimat e luftës civile të shkaktuara nga dy klasat ndërluftuese, partizanët e nacionalistët. Partizanët e rënë u shpallën dëshmorë dhe u nderuan, kurse nacionalistët e rënë, edhe varret ua prishën. Ndërsa emrat e tyre u nxorën në listat e kriminelëve, pushteti komunist, me familjet e tyre, vazhdoi luftën e përbindshme të klasave, me burgime, pushkatime, internime, që s’është gjë tjetër veçse vazhdim i luftës civile me mjete më të sigurta⁹.

⁸ Po aty, f. 121

⁹ Po aty, f. 132-133

Më në fund, me 28 nëntor vendi u çlirua; njerëzit shëtitnin rrugëve të gëzuar dhe komunistët përgatisnin gjuetinë e tyre të shtrigave ndaj nacionalistëve që nuk ishin bashkuar me ta, që nuk kishin pranuar t'i njihnin për zotër, ndaj intelektualëve, ndaj klerikëve, e më shumë, ndaj atyre katolikë. Dhe terrori filloi në pikun e vet më të egër, që në ditët e para të Çlirimit, me të gjithë, anipse kishte më shumë se një vit që ishte vënë në zbatim, jo vetëm për të zhdukur kundërshtarët, por edhe për të mbjellë panik. I këtellë është rasti i pushkatimit të mbi 100 qytetarëve në Hotel Bristol e nëpër rrugët e Tiranës. Ja se ç'thotë Gogo Nushi, sekretar i PKSHE për Tiranën. "Shpirtin e terrorit e kemi parë ditët e fundit në Tiranë. Me hyrjen e forcave tona janë vrarë 60 vetë. Listën e kemi. Unë mendoj që asnjë nga ata nuk e meritonte këtë dënim. Jemi të sigurtë se do të ketë edhe të tjerë. Numri do të ketë kaluar mbi 100... Kështu ne kemi menduar, se me këto masa do t'ia mbërrijmë fitores"¹⁰.

Gjatë gjithë vitit 1944, brigada të ndryshme të ushtrisë partizane mësynë nëpër krahinat e Veriut. Në qarkoren e Enver Hoxhës për kapërcimin e Shkumbinit, thuhej tekstualisht "Kujdes! Po hyni në një territor armik". Dhe në përputhje me logjikën e ndeshjes me "armikun", udhëzimet jepeshin jo për ndjekjen e okupatorit, por të spastrimit të krahinave nga kundërshtari. Veriu antikomunist përbënte problem, pasi në krahina që kthyer para vendase. Urdhurat e Enver Hoxhës janë të qarta për konfrontim dhe ushtrim terrori: "...të përshkohen disa herë, të kontrollohen pyje të dyshimta dhe të mitralohen. Krerët e Dibrës të goditen me ashpërsi sikurse dhe Bazi i Canes" (*Dokumente të Shtabit të Përgjithshëm, 6 korrik 1944, V.I f 468*). Për t'iu kundërvënë ekspeditave ndëshkimore të partizanëve komunistë, me 8 korrik 1944, paria nacionaliste e Fushë-Çidhnës mban Besëlidhjen Antikomuniste. Të nesërmen, duke gdhirë 9 korriku, çetat partizane të Haxhi Lleshit, Esat Ndreut, Faik Shehut, Ferik Radovickës dhe batalioni i dytë i Brigadës I me komandant Myslym Shyrin, me një fuqi prej 750 vetësh, të armatosur me 125 mitraloza, 12 mortaja e 75 mushka me municion, ia behën para kullave të Halil Alisë, pasi qenë betuar në drapër e çekan ta nënshtonin krejt zonën "reaksionare" të Çidhnës. Konfrontimi që i rreptë, por beteja zgjati jo më shumë se dy orë. Komunistët u tërhoqën, duke lënë 180 të vrarë dhe 30 robër, të cilët u falën. Me 27 korrik 1944, brigadat e IV dhe V Sulmuese, me përforcimin e çetave maqedonase, të udhëhequr nga Hysni Kapo, Shefqet Peçi, Kadri Hazbiu, Manush Myftiu, zv/komisar Josif Pashko, Hito Çako, përgjegjësja e rinisë Vera Pojani (Ngjela), sulmuan në mesnatë fshatrat e Çidhnës, Sinën e Epërme, Fushë-Alien, Bllaçen, etj, si hakmarrje për 8 korrikun, duke djegur kullat e shtëpitë e fshatarëve me gjithë pleq e fëmijë dhe duke vrarë 64 fshatarë.

Ndërkohë, kryeqendra e Veriut, Shkodra, "bastioni i reaksionit", e priste ditën e çlirimit njësoj si pushtimin më poshtëruës. Ja se si e kujton këtë ditë në memoret e tij Atë Zef Pllumi në librin "Rrno vetëm për me tregue": "28 Nandori 1944 që një ditë e ftohtë, e zyrtë, ndoshta ma e zyrtë që prej shpalljes së pamvarsisë. Qysh në fëmijni këtë ditë e kishim festue me dritë, ngjyra, kangë, brohori e flamuj. Flamujtë ishin naltue në kumbonaret e kishave,

¹⁰ Po aty, f. 128

por ishin si të vetmuem dhe atë ditë nuk i kqyrte kurrkush. Gjermanët ishin largue të gjithë prej kazermave, zyrave dhe vend-rojeve të tyne në drejtim të Malit të Zi. Shkodra priste hymjen e partizanëve, të cilët ndër kodra të Bardhajve, në Postripë e përtej Urës së Bahçallëkut pritshin largimin e plotë të gjermanëve.

Atë natë u ndie zhurma e disa shpërthimeve të mëdha, aq sa u thyen xhamat e shumë shpijave. Nji motocikël gjermane ishte kthye prej Hanit të Hotit për me i ndezë minat e vendosuna ndër urat që lidhshin qytetin me fushat. Mbas tyne bumbullimave që shpallën largimin përfundimtar të gjermanëve, nuk fjeti ma kurrkush n'atë natë të gjatë. Në Kuvendin Françeskan, ku jetojshem, zotnonte parandjenja se me atë çast Oksidenti po largohej prej nesh me nji hap shumëshekullor, se kundra katolicizmit në Shqipni do të fillonte nji luftë, e cila, me gjasë, do të vente në rrezik vetë ekzistencën e elementit katolik në Shqipni. Për klerin katolik nuk qe gja e papritun, madje mund thomi se ishte e parapame. Shumë vjet përpara kishin fillue përgatitjet e të rijve me leksione e konferenca për të përballue nji salvim aq mizor sa mund të na kushtonte edhe jetën... N'orarin e lutjeve të mëngjesit, që prej orës 5 deri 6, u mblodh i gjithë komuniteti françeskan me eprorin, At Mati Prendushin, dhe me lutje të veçanta kërkue mbrojtjen e të Madhit Zot. Kisha Katolike në Shqipni gjindej në Kopsht të Gethsemanit:

“O Zot, në kjoftë e mundun, largoje kët kelk prej meje!” Lutja ishte kjo, por u ba vullnesa e Zotit. 29 nandori gdhini ditë e zyrtë dhe e ftohtë. Në orën 10³⁰-11 nëpër rrugët kryesore të qytetit hyni brigada partizane e prime prej Major Gjin Markut: flamurit kombëtar, që valavitnin përpara, i kishin shtue nji hyll të kuq. Na këqyrshim mbas grilave të dritareve. Për hir të së vërtetës, duhet dishmue se popullsia katolike e qytetit nuk merrte pjesë n'atë manifestim, përveç ndonji personi të rrallë, që njihej si prokomunist, ndërsa nji pjesë e madhe e popullsisë myslimane, veshë në tesha festet, jepte dukjen e nji pritje të gëzueshme. Ushtria partizane e veshun me gjithnduer uniformash të hueja, paraqitej si nji ushtri e parregullt, leckamane, me opinga dhe e untë. Çka bante ma shumë përshtypje ishin partizanet. Çfarë nanash mund ishin ato femna me pushkë në krah? Ndër kazerma nuk kishin çka me ba, mbasi nuk kishin as rroba fjetje, as ushqime, prandej i shpërndanë nëpër familje: dikund 3, dikund 6-7. Populli i strehoi, i ushqe u mbush me parazitë. Por nuk ishin rob Zotit: këqyrshin me tinzi nëpër shpija nëse mund gjejshin ndonji gjerman ose “reaksonar” të mshehun. E para punë që banë qe vumja në funksionim e burgjeve, të cilat u mbushën plot e përmajë me njerëz të pafajshëm. Nuk kishin bukë me u dhanë, prandej duhej t'ua çojshin familjet, përndryshe vdisshin. Ushqimet që u dërgojshin familjet ishin ma shumë për partizanët e unshëm, se për ata të mjerët e torturuem. Menjihërë filluen të shpërndahen fjalë: kanë ora X-in ose Y-in; ose për tjerë që ishin zhdukë pa shenj, pa nishan. Kush ishte kryetar i kësaj qeverije? Filloi me u përmendë emni i Enver Hoxhës, deri atëherë krejt i panjoftun për popullin e Shqipnisë së Veriut.

Gjatë muejit dhjetor u vendos pushteti i ri i Shqipnisë, që nuk kuptohej mirë nëse ishte ushtarak apo civil: të gjithë ishin të mëdhaj e kurrkush nuk kishte gja në dorë, përveç komandantëve partizanë, nga ma të ndryshmit, të cilët ishin vendosë kush në nji shtëpi, kush në nji tjetër.

Brigadat në Shkodër banë nji riorganizim, dhe kështu Major Gjin Marku me ata të parët që erdhën kaluen kufinin e Shqipnisë për t'u dhanë “ndihmë vëllazërore” popujve të Jugosllavisë. Shkodra u mbush me brigada partizane dhe çuditej se nga erdhën aq shumë ushtarë sa nuk i kishin pasë as ushtritë e hueja!

Partizanët thojshin se kishin ardhë për të ndjekë gjermanin deri në Berlin, por ishin pa këpucë ndër kambë. Në përgjithësi ishin njerëz me të cilët nuk mund të flitej, me sjellje të këqija: hajshin bukën e përmbysshin kupën. Shumë ushtri të hueja kishte pa Shkodra, por si këtë kurrnji jo.

Menjherë mbas asaj dite të 29 nandorit 1944 në rrugën Shkodër-Podgoricë filloi qarkullimi si kurrë ma parë, në një kohë që komunikacioni me Tiranën ishte tepër i vështirë për shkak të prishjes së urave, ndër të cilat filluen me u vendosë trapa lundruese e roje partizane. Kështu malazezë e shqiptarë qarkullojshin mes vedit pa kufi. Kush ishte sundimtari i vërtetë i Shqipnisë? Përgjegjen e jepte "trobojnica". Flamujt e shumë tringjyrësh jugosllavë valaviteshin në çdo rrugë, në çdo ndërtesë shtetnore e në çdo shpi. Ku u gjetën aq shpejt e aq shumë ata flamuj që populli i kqyrte me inat, sepse shenjojshin një robni të re të kombit shqiptar!

Posa u hapën shkollat, ndër të gjitha, pa përjashtim, erdhën me mësue që të këndohej Hymni i atij flamurit të huej: "Ei sllovenski joshte zhivi", "ço bajrak ne vije", "zhivi, zhivi jugoslavenski" si edhe "Ide druzhe Tito preko Albanie... preko Albanie..." (Un nuk di as kuptimin e tyre, as se si shkruhen, por kshtu m'kan mbetun në vesh qysh n'atë kohë me gjithë meloditë e tyre).

Hymnet tona të flamurit nuk i ndigjojshin ma. Kaluen disa ditë. Vetëm në kumbonaren e kishës françeskane, e cila zotnonte qendrën e qytetit, ende nuk ishte vu "trobojnica". Flamuri i Shqipnisë, ai i vërteti pa spata e pa hyll, dridhej, përpëlitej i zyrtë e i vetmuem: nuk shifte asnjë si vedin. Përpiquej me u qindrue stuhive t'atij dimni komunist: ashtu i shkyem e i leckosun valavitej pa pushim. Nji ditë të dhetorit dy partizanë trokitën në derën e Kuvendit Françeskan: "Duam të hipim në këmbanare".

Portieri më thirri mue, sepse un ditë për ditë u ngjitshem atje nalt për me kurdisë sahatin, të cilin e shifte gjithë Shkodra. Në të vërtetë, për këtë detyrë ishte i ngarkuem At Filip Mazreku: ai kishte vendosë të fundit flamurin e vërtetë të shqiptarëve me 27 nandor 1944, por tue qenë se un ishem e ri e i gatshëm, m'i besoi çilsat e kumbonares. Shkova me vrap e gjeta At Filipin e i thashë se te porta kishin ardhë partizanët e dojshin çilsin e kumbonares.

"Ndigjo, - më tha – un nuk mund i shof me sy; ti e din se këta ma kanë zhdukë vllanë tem në Tiranë, pa shej, pa nishan. Ne nuk ia dim as vorrin, që të thomi një uratë e t'i dërgojmë një lule. Të lutem, shko ti me ta, çilsat i ke. Por ndigjo këtu: mos i len vetëm as për një ças. Zoti e din se çfarë kurthesh mund të vejnë!"

"Jemi të dërguem nga komanda për ta hequr atë rreckë që valavitet atje lart. Është turp – thanë ata – që mu mbi sheshin kryesor të qytetit të valavitet ajo leckë që nuk e ka as yllin partizan!"

"Eh, po nuk kemi tjetër."

"I kemi prurë neve, të rinj fringo. Ja flamuri i Jugosllavisë motër, dhe ky me yllin partizan."

"Dy flamuj? – pyeta unë. – Po ne kemi një shtizë të vetme; nuk janë vendosë kurrë dy flamuj!¹¹"

11 Pllumi, Zef At: "Rrno vetëm për me tregue", sh.b "55", Tiranë 2006, f. 20-21

Masakra komuniste e Tivarit - një krim i përbashkët i PKSH dhe PKJ

Historia është shkalla tokë-qiell, që iu shtir në ëndërr Jakovit. Çdo shkallare është një përpjekje për t'u ngritur në një nivel më të lartë përparimi. Popullin shqiptar e kanë flakur shpesh nga këto shkallare të historisë në nivelet më të ulëta. Po nëse këtë e kanë bërë të huajt, fuqitë e mëdha në rrethana aspak të favorshme historike, kësaj here, gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore, qenë vetë komunistët që i dhanë popullit të tyre shqelmin më të dhunshëm e më të hidhur. Ne përmendëm më lart vetëm disa aspekte vëllavrasëse të luftës civile, që imponuan komunistët internacionalistë të rekrutuar në planet e Partisë Komuniste Jugosllave, pa pretenduar të shpalojmë valën e terrorit dhe raprezaljeve sistematike nëpër të gjitha trevat e Shqipërisë. Ideologjia, etja për pushtet, servilizmi, nënshtrimi dhe mungesa e dinjitetit të krerëve udhëheqës të PKSH, shpunë në përmbysjen e asaj situatë të krijuar gjatë luftës, situatë e cila me qetësi e zgjuarsi mund të çonte në përfitime të mëdha kombëtare, pa derdhur gjakun shqiptar, po përkundrazi, më një shtet të bashkuar të të gjithave tokave shqiptare në Ballkan, siç ka qenë brenga dhe amaneti i patriotëve të mëdhenj që nga Rilindja jonë Kombëtare e deri tek përpjekjet e mëvonshme të nacionalistëve, sikundërse e gjejmë të shprehur në Dekalogun e Mit'hat Frashërit.

Por Enver Hoxha, Ramiz Alia dhe udhëheqës të zellshëm të PKSH e kishin shitur me kohë të ardhmen dhe fatet e kombit tek udhëheqja komuniste serbe e jugosllave. Udhëheqësit komunistë të ushtrisë NAÇL jo vetëm me fjalë, por me vepra iu bashkangjitën projektit spastrues, gjenocidal serbo-jugosllav, për të bërë "banja gjaku" në Kosovë.

Pamjen më të plotë të kasaphanës së komunistëve serbo-malazezë mbi rreth 4000 partizanë kosovarë e jep libri historiko-studimor i Uran Butkës "Masakra e Tivarit", qysh në zanafillë të planit të kobshëm të dy udhëheqjeve që e projektuan atë: Partia Komuniste jugosllave dhe Partia Komuniste shqiptare. Janë ditarët, epistolarët, procesverbalet, raportet, urdhrat zyrtare dhe relacionet respektive pranë komandave të shtabeve të ushtrive shqiptare dhe armatës jugosllave lënda që përbën argumentin dhe kthjellon shkallë-shkallshëm e ditë pas dite të vërtetën e tmerrshme të kasaphanës së Tivarit. Dokumentacioni i pasur arkival dhe dëshmitë e të mbijetuarve nga masakra veçse mbështesin udhën e vërtetë të plojes së paramenduar për asgjësimin e mbi 4000 shqiptarëve të Kosovës në mënyrën më të pabesë e më të shëmtuar në Ballkan, që nga lufta e Trojës e deri më sot. Çdo projekt spastrimi duhet ta ketë një arsye, një elaborat paraprak që përcakton objektivin. Këtë platformë gjenocidi, që i paraprin veprimit ushtarak, e gjejmë të artikuluar nga akademiku famëkeq Vasa Çubrilloviç të 7 marsit 1938 dhe 3 nëntorit 1943 e që fatalisht u bë dhe platforma e Lëvizjes Nacional-Çlirimtare jugosllave. Sipas idesë ultranacionaliste të Çubrilloviçit, "dy janë mënyrat për spastrimin etnik të shqiptarëve: *t'i zhdukim ose t'i shpërngulim*". Më tej, platforma e Çubrilloviçit mbi zhbimjen e shqiptarëve të Kosovës, thotë: "*Luftrat janë momenti më i përshtatshëm për zgjidhjen e këtyre problemeve <...> Ajo që në kohë paqeje kërkon dekada dhe shekuj, gjatë kohës së luftës kryhet brenda*

muajsh e vitesh <...> Tani për tani, vetëm theksoj, se duhet të spastrohen pa kushte nga shqiptarët Metohia me Kosovën dhe Pollogu" (Vasa Çubrilloviç, "Problemi i pakicave në Jugosllavi", 3. 11. 1943).

E vërteta (ose të vërtetat) mbi luftën, të ashtuquajtur Nacional-Çlirimtare, kanë qenë e kanë vazhduar deri vonë të jenë monopol vetëm i propagandës komuniste, të shumëfishuara në libra shkollorë, vëllime historike të Institutit të Studimeve M-L apo Akademisë së Shkencave të PPSH-së, pa përmendur perceptimet e ndërtuara nga mikserët gjigandë e trushpëlarës si letërsia dhe kinemaja. Të vërtetat e luftës janë varrosur në një varr gjigand agjit-propri, andaj njohja e këtyre të vërtetave të varrosura përbën aktin tonë të parë të çlirimit nga gënjeshtria dhe hapin e parë të çlirimit të vetëdijes së manipuluar masive. Nëpërmjet korrespondencës, presionit dhe urdhrave nga instancat më të larta të ushtrisë jugosllave, Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë NAÇL shqiptare dërgoi në Kosovë nga gushti në nëntor 1944 divizionin V që përfshinte Brigadat III, V dhe XXV. Roli i partizanëve shqiptarë të inkuadruara në këto brigada ka qenë, në fillim, ndeshja me çetat nacionaliste shqiptare, të cilat, siç dëshmohet në libër, tërhiqen, që të mos shkaktojnë vëllavrasje midis shqiptarësh. Kosova është shtënë në një rreth të hekurt rrethimi: në jug me njësitë e partizanëve maqedonas, në lindje e verilindje nga divizionet serbe, ndërsa në veriperëndim dhe perëndim nga njësitë malazeze të armatës jugosllave. Nga Gjakova në Mitrovicë pjesën e rrethimit të hekurt e mbajnë brigadat e partizanëve shqiptarë. Kontributi i tyre është i zi: njësoj si serbët, malazezët dhe maqedonët, ata spastrojnë çetat e nacionalistëve shqiptarë që bëjnë qëndresë. Kosovarët e dorëzuar në besë ata ua kthejnë brigadave serbe, ku i pret pushkatimi. Në këtë histori të egër spastrimi të Kosovës nuk kursehen as 6000 partizanët e çetës së Shaban Polluzhës, të cilët, pas vrasjes së prijësit të tyre, shpërbëhen duke rënë viktimat të spastrimit të organizuar etnik. Faza e fundit është rekrutimi i dhunshëm i pjesës më vitale të të rinjve kosovarë, të cilët, sipas skenarit, duhet të mbushin 6 eshalonet e mars-prillit 1945 në Prizren, duke lënë prapa tokën e shkretuar të Kosovës, ashtu siç ishte parashikuar qysh në elaboratin e Vasa Çubrilloviçit. Episodet e masakrave masive mbi shqiptarët dhe qytetarët e Kosovës janë bërë në prani të Divizionit V të ushtrisë shqiptare. Libri na i përejell me anë të korrespondencës bëmat e partizanëve shqiptarë, të eilët në mungesë të okupatorit me të eilin duhej të luftonin, nuk bëjnë tjetër, përpos se i ndihmojnë armatës jugosllave në spastrimin e Kosovës prej shqiptarëve. Të tillë përmbajtje kanë raportet që i dërgojnë Shtabit të Përgjithshëm të UNÇL-së shqiptare komisar Ramiz Alia dhe komandantët Rrahman Parllaku e më vonë Gjini Marku. Të njëjtat kablllograme për nga përmbajtja (dezertimin e partizanëve kosovarë dhe dorëzimin e tyre shtabit operativ të Kosmetit) çon edhe komandanti tjetër Gafur Çuçi. Meqenëse libri i përcjell në mënyrë sistematike e të shumta këto korrespondenca, ndalemi në një prej komunikimeve që përfaqëson tipologjinë e përgjithshme të tyre:

KOMANDËS SË PËRGJITHSHME

Gjegje e tel. nr. 51 res, datë 30.05.1945

Numri i të arratisurve që janë dorëzuar në repartet tona, arrin 155

aproximativisht, me përjashtim të disa kriminelëve që ia kemi dorëzuar M.P. simbas kërkesës së tyre. Numri i kosovarëve që janë mobilizuar është 1398.

Gafur Çuçi

Ja edhe përgjigja e Enver Hoxhës:

Radiogramë

Divizionit V. Shifër

Gjegje telit tuaj nr. 135 Res datë 1.06.1945.

T'arratisurit e dorëzuar në Divizionin tuaj, dërgojani Divizionit 52 (d.mth. Divizionit serb, - shën. im. A.T.).

Enver

Gjatë gjithë veprimtarisë së tyre, radiogramet e partizanëve shqiptarë lajmërojnë së koordinohen në një plan të përbashkët veprimi më ushtrinë jugosllave për spastrimin e Kosovës nga shqiptarët, siç lajmëron rregullisht n/kolonel Ramiz Alia: "Brigadat janë duke bërë ndjekje dhe rrethime bandave, gjithnjë me sukses". Bie poshtë katërcipërisht pretendimi i Ramiz Alisë, se gjoja ai nuk kishte dijeni për Masakrën e Tivarit. Partizanët shqiptarë nën udhëheqjen e Ramiz Alisë janë sjellë me të njëjtën egërsi, njëlloj si çetat e çetnikëve në radhët e partizanëve serbë e malazezë. E padurueshme është se për herë të parë në histori shqiptarët i çonin vëllezërit e tyre në thertore, tek armiku ynë shekullor, kur kujtesa e gjakut të masakrave nuk kalonte një pesëvjeçar harresë. Pabesia e partizanëve shqiptarë është e neveritshme, sepse ajo bëhet, sipas tyre, në emër të gjoja "Vëllazërim-bashkimit". Bashkim me kë? Bashkim për çfarë? Kosova u zbraz, siç na dëshmohet në libër, me rekrutimin e 50.000 mijë shqiptarëve që mbushën eshalonet në frontin dalmat të Adriatikut, ku nuk u kthyen më në vatrën amtare. Ai ishte kurban i llogaritur për epshin shekullor të nacionalizmit serbo-malazes. Dita e parashikuar për Çubrilloviçin kishte mbërritur. Prandaj, duke e ditur faktin se Ramiz Alia asnjëherë nuk "dëshmoi" drejt "për historinë", zhvishet thjesht e shëmtueshëm nën dritën e relacioneve të shumta të arkivit, çka e hedh poshtë pretendimin e tij se gjoja "nuk ka pasur dijeni për Masakrën e Tivarit". Ish-shifranti i KQ të PKSH, Islam Kadashi, deklaroi: "Atë ditë erdhi një telegram shifër nga komisar i divizionit V, Ramiz Alia, i cili njoftonte se sot herët në mëngjes, një turmë e madhe disa mijëra shqiptarësh të Kosovës, pasi u grumbulluan në mes të dy kodrave, në një luginë, u pushkatuan dhe u likuiduan të gjithë. Në momentin që unë e dorëzoja këtë telegram, në zyrë gjeta Koçi Xoxen dhe Enver Hoxhën dhe ua dhashë telegramin me shifër të përkthyer". Studiuesi Uran Butka e zbardh me këmbëngulje situatën deri në mars të vitit 1945, kur nisën 3 kolonat e para sipas itinerarit Prizren-Kukës-Pukë-Shkodër-Tivar. Me procesverbale dhe numër të saktë ushtarësh në nisje deri në procesverbalet e mbërritjes. Si para, ashtu edhe gjatë nisjes së kolonave të marsit dhe prillit, Butka ka shfrytëzuar një material të pasur e sistematik dokumentash, listash, raportimesh, dëshmish, duke kombinuar planet dhe materialet arkivore të palës shqiptare e jugosllave, ashtu edhe me rrëfimet ngjethëse të dhjetëra të mbijetuarve nga kasaphana. Mijëra shqiptarë

të grumbulluar në Prizrenin e pushtuar e të terrorizuar nga çetat nacionaliste serbe e malazeze, nisen në kalvarin e pakthim, të luftojnë për liri. Në Prizren urdhërohen të mos marrin armatim me vete për të qenë të lehtë në marshim, pasi armët do t'ua jepnin në front. Ajo që përshkruhet gjatë udhëtimit nëpër veriun e Shqipërisë është jashtë përfytyrimit më mizor: partizanët shqiptarë fyhen, rrihen, torturohen, pushkatohen në grupe të mëdha; atyre u ndalohej të mbushin një pagure ujë, nën kërcënimin e oficerëve të armatosur serbë. Skenat janë të llahtarshme: shohim partizanin kosovar që pi shurrën e kalit të naçallnikut; vriten partizanë të veshur me rroba kombëtare shqiptare; në një episod shohim partizanët shqiptarë që duartrokasin bashkë me serbët pushkatimin e vëllezërve të tyre të Kosovës. Në një rast tjetër, me një gjuhë të njëjtë fyese e kërcënuese, u flet në Shkodër Ministri i Brendshëm i Shqipërisë, Koçi Xoxe. Bilanci është makabër: mbi 4000 shqiptarë të maskuar në Tivar. Mbi 1000 të pushkatuar e të hedhur greminave në territorin shqiptar. Historiani Uran Butka na sjell gjithë tablonë e përmortshme të luftës, të një lufte për liri, që u shndërrua në krimin e përmasave më tragjike ndaj pjesës më të pafajshme të kësaj lufte. Për Masakrën e Tivarit kurrë më parë nuk është folur me kaq bindje e siguri, pa ndërmjetësi hipotezash, por me fakte, të pranuar, ndonëse në mënyrë të reduktuar, edhe nga pala tjetër. Bashkëfajësia e udhëheqjes komuniste në këtë gjakderdhje të pabesë të gjakut shqiptar, sado që është maskuar e fshehur gjatë, nuk mund t'i fshihet më historisë nëpër konjuktura e arkiva. E vërteta e tmerrshme duhet të çlirohet e të dëshmohet bashkë me përgjegjësitë historike të krimit. Zbardhja e Masakrës së Tivarit, sado ngjethëse, le të shërbejë për ata breza që do ta mësojnë abc-në e atdhedashurisë e patriotizmit, jo me gënjeshtër, shpifje e mashtrime, por ashtu siç është kjo e vërtetë, reale, konkrete, mizore, e shëmtuar, ashtu siç ishte fytyra e vërtetë e komunizmit, që bazonte idealin e vëllazërim-bashkimit në banjat e gjakut të pafajshëm shqiptar.

Hekatombat e para të masakrës komuniste

Në këtë periudhë të errët, të mbushur me shqetësime, padituri, frikë, akuza që ndillnin vdekjen ose burgosjen, por edhe me shtëpi rinie, mbrëmje vallzimi dhe rrahje gjoksesh se do ta luftonin armikun deri në strofullën e fundit - në Berlin, u hap gjyqi i parë politik, spektakël, me një trup gjykues të kryesuar nga teneqexhiu Koçi Xoxe dhe me anëtarë Halim Budo, Gaqo Floqi, Hysni Kapo, Beqir Balluku, Medar Shtylla, Faik Shehu, Bilbil Klosi dhe me prokuror Bedri Spahiun (sipas ligjit të diktaturave, nga shokët e tyre: Koçi Xoxe, Beqir Balluku e Faik Shehu u dënuan me vdekje, Bedri Spahiun me burg e internim¹². Ky gjyq, që u quajt Gjyqi special, dha 17 dënime me vdekje: Fejzi Alizoti, Terenc Toçi, Aqif Përmeti, Gustav Mirdashi, Kostandin Kote, Hilmi Leka, Reshit Merlika, Beqir Valteri, Javer Hurshiti, Dik Cami, Ismail Golemi,

12 Në këtë syth, kemi shfrytëzuar të dhënat që sjell historiani Luan Xhafa në shtojcën "Shqipëria" të "Libri i zi i Komunizmit", një sistematizim lakonik i të dhënave dhe përmasave të krimit dhe terrorit komunist, bazuar në librat studimorë e dokumntalë të Uran Butkës "Mukja, shans i bashkimit - peng i tadhëtisë" dhe Pjetër Pepës "Dosja e dikaturës". Këtij kontributi të vyer sintetik të L. Xhafës mbi diagramën e terrorit komunist, sidomos në fazën e parë të egërsisë së pushtetit komunist, i jemi referuar vazhdimisht në tekstin tonë.

Zef Kadareja, Tahsim Bishqemi, Shyqyri Borshi, Daut Cercani, Kol Tromara, Bahri Omari. Me burgim të përjetshëm: Koço Kota, Xhavit Leskoviku, Koço Tasi, Ibrahim Biçaku, Xhevat Korça, Refat Begolli, Bajram Pustina, Shuk Gurakuqi. Me 30 vjet burg: Qamil Vrioni, Tofik Mborja, Sokrat Dodbiba, Mihal Zallari, Ethem Cara, Ndue Naraçi, Anton Kosmaçi, Lazër Radi, Sami Koka, Sulejman Vuçiterni.

- Me 20 vjet burg: Mihal Sherko, Akile Tase, Fiqiri Llagami.

- Me 15 vjet burg. Gjerb Bubani, Rrok Kolaj, Bilal Niciva, Ismet Kryeziu, Jakov Milaj.

- Me 10 vjet burg: Rrok Gera, Nedin Kokona, Rifat Tartari, Ihsan Libohova, Vangjel Goxhomani.

- Me 5 vjet burg: Emin Toro, Zef Benusi, Manush Peshkëpia.

- Me 3 vjet burg: Zenel Prodani, Sami Nisokaj.

- Me 2 vjet burg. Zef Shiroka - i liruar me kusht, Dedë Jakova- liruar me kusht; Abedin Xhiku.

- Morën pafajësinë: Luigj Filja, Abdurrahman Telqini.

Pra gjithsej 60 vetë, por duhet të shtojmë se gjyqe të tillë, të mëdhenj a të vegjël në numër të fatkëqinjve u zhvilluan në të gjithë Shqipërinë, ata që u dënuan ishin me qindra dhe akuzat standarde për të gjithë, akuza të tilla edhe për Bahri Omarin, burri i motrës së diktatorit E. Hoxha, që e shkolloi, e dërgoi në Francë, në Monpelje, të ndiqte studimet universitare ku ai, njëmend nuk mori asnjë provim, por ama u “njoh me marksizmin”. Krahas luftës ndaj klerit, në veçanti atij katolik dhe sektit bektashi, nisi beteja e tatimeve të jashtëzakonshme të luftës, ashtu si thoshnin, që t’i hiqnin borgjezisë fuqinë ekonomike, për të mos rikthyer në pushtet klasat e përmbysura; nisi dhe sekuestrimi me forcë i arit nga qytetarët, fushata të cilat u shoqëruan me burgosje, me vetëvrasje, me dëbimet e sekuestrimet e banesave të “borgjezëve e të çifligarëve”, që na e shjegovan aq ‘bukur’ filmi “Kur hidheshin themelet”. Duke pasë informacione se në Tiranë e kudo dhunës i përgjigjeshin me veprime që shprehnin protesta, në Shkodër nisën gjyqet me dyer të mbyllura mbi klerin katolik. Kështu nisën arrestimet e një grupi të madh priftërinjsh, studentësh të seminarit jezuit, fshatarësh, ushtarakësh të akuzuar se kishin formuar organizatën “Bashkimi kombëtar” (pseudonim që disa studentë e përdornin për traktet e tyre me përmbajtje antikomuniste), njërin prej të cilëve ia kishin dërguar hierarkut komunist Tuk Jakova në shtëpi. Ata që akuzoheshin ishin: At Gjon Fausti nga Breshia (Itali), rektor i Seminarit Papnor, i cili dënohet me pushkatim.

-At Danil Dajani, nga Blinishti i Zadrimes, profesor e më vonë rektor i Seminarit Papnor të jezuitëve. Drejtonte revistën “Lajmëtari”. Dënohet me pushkatim.

-At Gjon Shllaku, profesor në Seminarin Papnor dhe drejtues i revistës “Hylli i dritës”. Dënohet me pushkatim.

-Mark Çuni, 26 vjeç. Ndër seminaristët e parë të kolegjit saverian. Në moshën 18 vjeç regjistrohet në kolegjin Papnor jezuit. Antifashist, gris portretin e diktatorit fashist. Pas “çlirimit” aktiv kundër diktaturës komuniste. Dënohet me pushkatim.

- Qazim Sadiku, 27 vjeç, nga Gucia, (Kosovë). Dënohet me pushkatim.
- Gjelosh Lulashi, 30 vjeç, ish-oficer. Dënohet me pushkatim.
- Frano Miraj, bujk e tregtar, nga Puka. Dënohet me pushkatim.
- Shtatë vetë me burgim të përjetshëm, nga këta 4 seminaristë, një profesor dhe një student 19-vjeçar nga Shkodra.
- Dënuar me 30 vjet: Gjovalin Zezaj, 17 vjeç, nga Shkodra, student dhe 6 të tjerë.
- Me 20 vjet: 2 vetë
- Me 15 vjet 3 vetë, ndër ata dhe Luigj Kçira, 20 vjeç dhe një student 18 vjeç.
- Me 5 vjet: E. Dema 16 vjeç, student dhe dy të tjerë dhe me dy vjet, pesë vetë.

5. Kryengritjet e para antikomuniste në Shqipëri - të parat në Europë

Kryengritja e parë e armatosur kundër diktaturës komuniste në Shqipëri u zhvillua në Malësinë e Madhe. Beteja midis forcave ndëshkuese të Brigadës së Parë dhe fshatarëve kryengritës të udhëhequr nga Preng Cali, nisi në 1 janar të vitit 1945 dhe vazhdoi 1 muaj. Kelmendi qëndroi sa mundi. Por së fundi, për t'iu shmangë gjakderdhjes vlla me vlla, Preng Cali urdhëroi malësorët të mos qëllonin dhe ata u tërhoqën nga pozicionet, ndërsa Prenga me 15 shokë e 1 murgeshë u ngujuan në një shpellë. Ja raporti i Zoi Themelit: "Humbjet e armikut janë 44 të vrarë (armiq Zoi Themeli quante fshatarët) e 21 të plagosur. Prej të vrarëve, 13 rezultojnë gjatë përlëshjeve me forcat tona, po ashtu dhe të plagosurit... Veç këtyre, në mënyrë konspirative janë pushkatuar edhe tre vetë të tjerë, sepse kanë qenë bashkëpunëtorë të Preng Calit." U dogjën mbi 50 shtëpi fshatarësh edhe një shtëpi në Vukël, e djegur tre herë nga turqit, malazezët dhe në 10 shkurt 1945 nga komunistat. Luc e Zef Rapuka ishin në shpellë me Preng Calin dhe pas daljes prej saj i pushkatuan, pas tyre, pushkatuan edhe Rrokun, ma të voglin e familjes.

Të ngjuarit e pësuan të gjithë: Smajlin e pushkatuan sa doli nga shpella, një tjetër e pushkatuan pasi ia kishin prerë mishin më sëpatë; një tjetri ia nxorën sytë dhe e varrosën së gjalli. Luc Bajraktarin e therën në qafë me bajonetë dhe e hodhën në greminë; Fran Zef Bajraktarin e groposën së gjalli pasi i dogjën kullën; Marash Vat Lumajn e pushkatuan si agjikator. Gjithashtu u pushkatuan edhe: Dedë Prek Nika, Uk Marash Biku, Nik Mark Rezaj, Gjelosh Fran Pëllumbi. Pas gjykimit në Shkodër, Kreshniku i Vermoshit, plaku 70-vjeçar Preng Cali u dënua me vdekje dhe 4 me burgim të përjetshëm, të tjerët me 30 vjet burg, pra u dënuan plot 25 vetë. Më 18 janar 1945 u organizua Kuvendi i Pojcës, që u quajt Kuvendi i Maleve dhe u tubuan burrat nga Hoti, Kastrati, Shkreli, Dedaj e Zagora. Ata vendosën që kryengritja të fillonte më 28 janar 1945, në bashkëpunim me forcat e Shkodrës e të Postribës, atyre u printe Llesh Marashi.

Forcat e batalionit të ndjekjes dhe me forcat e postkomandës së Bajzës, që ishin informuar për kryengritjen në 23 janar vendosën të arrestonin udhëheqësit. Në malësi u dha alarmi e malësorët më 24 janar pushtuan

Bajzën. Nën drejtimin e Llesh Marashit kryengritësit sulmuan Koplikun dhe e morën atë dhe partizanët e ndaluar, pasi dorëzuan armët, u liruan. Pasojat e kryengritjes ishin të ashpra. Përveç viktima të rëna gjatë luftimit, viktima të reja pati edhe pas humbjes. Me qindra kryengritës të arrestuar, midis të cilëve M. Shehu dënoi me vdekje 27 dhe nga ata përzgjedhi 12 vetë të cilët i ekzekutoi. Për ekzekutimin e vendimeve, M. Shehu kërkoi aprovimin e E. Hoxhës, i cili pëgjigjet:

*“Radiogram urgjent
Korpusit të III*

Gjegje radiogramit Nr. Extra datë 9 fruer 1945. Aprovohen ndëshkimet me vdekje të 12 vetëve dhe ndëshkimi i të tjerëve me dënime propozue me të sipërmin. Na njoftoni datën e ekzekutimit.

Enver Hoxha”

Kryengritja e Postribës

Postriba me 10 katundet e saj shtrihet në verilindje të Shkodrës. Më 7 korrik 1946, në Shkodër u bë një mbledhje e të gjithë opozitarëve, e cila vendosi që shpërthimi i kryengritjes kundër regjimit komunist të bëhej brenda datës 16 shtator 1946. Në datën 8 shtator filluan të grumbullohen në zonën e Postribës 200 forca, nga të cilët 60 të armatosur, Guri i Zi 170 vetë dhe Oblika 70 vetë. Në orën 2 të mëngjesit të datës 9 shtator filloi sulmi, ndërsa ndërlidhja telefonike ishte prerë më parë. Kryengritësit do të sulmonin në tre drejtime: nga Postriba në drejtim të kazermave ku ishte edhe Komanda e Korpusit të III. Nga Guri i Zi në drejtim të postës të Urës së Kirit dhe mësymja drejt Kodrave të Tepes. Revolta u shtyp me forcë dhe u shoqërua me raprezalje. Po atë ditë, më 9 shtator, forcat e diktaturës të komanduara nga shefi i sigurimit për Shkodrën, pushkatuan publikisht grupin e parë prej 12 kryengritësish. Ashtu të lidhur këmbë e duar me hekura e me litarë, pasi i rrahën e i torturuan mizorisht, i grinë me automatik përbri një grope të përbashkët, me apo pa faj, të përfshirë e të papërfshirë.

Të nesërmen më 10 shtator dhe çdo ditë, çdo javë, çdo muaj të atij viti tragjik, por edhe në vitin 1947, nuk pushuan terrori, vrasjet, internimet, në krahinën e Postribës. Kështu, u pushkatuan edhe 7 vetë të tjerë para syve të familjes dhe shtëpive që përfshiheshin nga flakët. Nga të gjithë fshatarët që morën pjesë në kryengritje, në arkiv gjendet një listë me 69 vetë, si dhe një listë me 68 fshatarë të dorëzuar nën kërcënimet e djegies së shtëpive, të vrasjeve, të burgimeve dhe të premtimeve për falje në rast të dorëzimit të armëve, premtime që nuk u mbajtën kurrë, pasi të gjithë ata që u besuan premtimeve u torturuan çnjerëzisht dhe u dënuan me vdekje apo me burgim. Në rrethanat e shtypjes e të persekutimeve, të dyfaqësisë, në ballë të shqiptarëve do të dilnin ata që u dhimbej Shqipëria, u dhimbej e ardhmja e saj, dhe filluan kështu aktet e heshtura, opozitare, bisedat, grupimet e me vonë edhe partitë që kishin si ideal të tyre lirinë. Fitoren ata e kërkonin nga veprimtaria e tyre, por edhe nga aleatët, anglezët e amerikanët, që deklarorin se pa pluralizëm nuk ka demokraci dhe pa demokraci nuk ka pluralizëm.

Postriba, harta memece e historisë sonë

Dëshmimi i të vërtetës së 9 shtatorit 1946, ashtu sikundërse dhe e kryengritjeve të tjera antikomuniste, duhej të kishte qenë detyrë parësore e historiografisë sonë zyrtare në liri. Por me gjithë arkivat e pasura, për fat të keq, ngjarje të tilla që, përveç të vërtetës, i ngrenë dinjitetin shqiptarit në histori, janë lënë, përkundrazi, në harresë të plotë. Dhe Postriba, një ndër kryengritjet e para antikomuniste jo vetëm në Shqipëri, por në krejt Europën Lindore, është shembulli flagrant, në kuptimin e saj më të drejtpërdrejtë, i "hartës memece" të historisë sonë zyrtare, i teksteve të arsimit tonë shtetëror.

Megjithë kujtimet, shënimet dhe përshkrimet që na vijnë nga ajo kohë e kobshme për Shqipërinë dhe në veçanti për Shkodrën, prapë është e vështirë t'i bësh sot vend në përfytyrim asaj shkalle mizorie, mllefi e urrejtjeje plebeje, që solli vëllazëria komuniste e sektit shqiptaro-sllav. Postribasit, ashtu si qytetarët e vjetër të Shkodrës, u bënë dëshmitarë të shtangur nga tmerrri të pamjeve të lemerishme të masakrave ditën për diell, të ekzekutimeve publike, pa gjyq, pa proces, pa mbrojtje ligjore, pa të drejtë apeli. Çdo ditë përgatitej një "shfaqje" publike për diskreditimin e "armiqve të popullit". Çdo ditë përgatiteshin mesha të zeza sataniste që shoqëroheshin me kryqëzimin e flisë së radhës nën ritualet, vallet rreth të pushkatuarve me këngën e padëgjuar asoane "Lule Sofo, lule djalë...". Grupe malësorësh, intelektualësh e klerikësh parakalojnë të lidhur me pranga e litarë, krah për krah, ndërsa rreth e rrotull tyre, grupe të rinjsh e gra hysterike - aktivistë të rinisë komuniste përsëritin në kor: "Plumbin ballit! Vdekje tradhtarëve!". Të arrestuarit, burra shtatnaltë, përfaqësues të denjë të racës ilire që u ruajt për shekuj në naltësitë e Alpeve të veriut dhe ajka e inteligjencies dhe klerit, shikojshin me çudi këtë komedi të zezë funebre. Turma të topitura në të dy anët e bulevardit heshtin të habitura e të frikësuar. Frika e ushtrueme nga partizanët, po jepte frytet e saj të para: një popullsi e tërë zhvishej nga guximi qytetar tradicional. Mandej vijnë gjyqet ushtarake dhe sheshet e Shkodrës shndërrohen në poligonet e qitjes ushtarake të ekzekutimit. Kudo të sheh syri kufoma, të mbuluara e të pambuluara, në sytë e qytetarëve. Në përgjithësi kjo ishte tabloja, kjo ishte shija e parë e shoqërisë së re...

Malësorët e Postribës guxuan, provuan ta ndalin dhe t'i përzënë me armë komunistët njëloj si çdo pushtues tjetër, duke shpresuar për një përkrahje dhe zgjerim të aksionit, duke depërtuar në qytet, duke u ndeshur me kazermat dhe ushtrinë e madhe e të armatosur mirë. Edhe pse kryengritja u shtyp, ajo është rasti më i vetëdijshëm i kundërshtimit të organizuar të diktaturës gjakësore; ajo kishte një objektiv të qartë politik, një strategji dhe një mesazh për të gjithë shqiptarët e nënshtruar, me një plan përhapjeje në të gjithë Shqipërinë e Veriut dhe lidhjen e mundshme me aleatët perëndimorë. E rëndësishme është nuhatja politike e postribasve: ata i parandjenë reformat e dhunshme që do ndiqte politika e pas zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945, lidhja me vendet e lindjes si Jugosllavia e Bashkimi Sovjetik. Postribasit e kishin të vështirë, madje të pamundur, t'i besonin komunizmit, që vinte nga Jugosllavia. Postriba dhe Shkodra i kishin të freskëta djegiet dhe masakrat e serbo-malazezeve të 20-30 viteve më parë. Për ta ishte e pamundur të

bashkëjetoje me shkjaun që për postribasit ishte një i pabesë historik. Të gjitha këto ndikuan te postribakët dhe sollën atë që i bëri të njohur kudo, kryengritjen e armatosur të 9 shtatorit 1946, e para kryengritje antikomuniste në të gjithë Evropën Lindore. Ndonëse lëvizja e Postribës, e kombinuar edhe me qytetin e Shkodrës, vinte pas disa kryengritjeve të një viti më parë, siç ishte ajo e Kelmendit, Koplikut, Bërdicës dhe Anës së Malit, ajo ka meritën se guxoi të sfidonte me një aksion tashmë jo mbrojtës, por sulmues, pushtetin e instaluar komunist në pikun e revanshit të tij. Madje, një pushtet që nuk fillonte vetëm në Shqipëri, por që ishte rrjedhojë e zgjatimit kontinental të gjithë kampit komunist deri në epiqendrën e tij në Kremlin.

Rrjedhimisht, siç është theksuar shpesh, Kryengritja e Postribës është e para përplasje me krejt "Perandorinë e së Keqes", plot dhjetë vjet para se të shpërthejë "Revolucioni hungarez", gjithashtu i mbytur në gjak.

Rrjedhimet e këtij akti vetmohues, siç shkruan prof. Sami Repishti, rezultuan katastrofale: "Lëvizja e Postribës nuk la shumë viktime në fushën e betejës, por bani shumë viktime në ditët që vazhduen. Në një fushë afër qytetit, u ekzekutuen 28 katundarë. Me dyzina shtëpi u dogjën, e tymi i tyne dukej qartë nga qyteti. Arrestimet u banë në masë dhe jashtë çdo kontrolli. Lëvizja u ba shkak "të pastrohej" gjithë qyteti i Shkodrës me rrethe, nga elementët "armiq të popullit". Brenda një mueji, qyteti kishte 11 burgje të përkohshme, e ma shumë se njëmijë e dyqind të arrestuem". Sipas përlllogaritjeve tona, numri i të vrarëve dhe të pushkatuarve të lidhur me Postribën, para dhe pas Kryengritjes, mbërrin në 64 dhe disa qindra të tjerë me dënime të rënda me burg. "Hija e randë e ekzekutimeve ishte kudo! Por natën, kur filloi pushka nëpër rrugët e qytetit, Shkodra u elektrifikue. Ideja e rrëzimit të "pushtetit komunist", ndezi fantazinë e të gjithëve. Monstra e kuqe mishngranëse ishte plagosë!"

Kanë kaluar 65 vjet nga Lëvizja antikomuniste e Postribës, por ajo qëndron gjithmonë në zgrip të historisë tonë, e shmangur, e mënjanuar, ende e parehabilituar siç e meriton. Ajo kërkon llogari prej nesh; kërkon një të kuptuar më të thellë; kërkon bilancin tonë për atë ployë gjysmëshekullore prej së cilës dolëm të gjymtë, të tjetërsuar, të shfytyruar dhe me një hendek të pakapërcyeshëm midis traditave, brezave, krahinave, mentaliteteve dhe trashëgimive e përvojave tona. Postriba lyp prej nesh një tjetër dialektikë thellimi e reflektimi mbi vlerën dhe çmimin e lirisë dhe raporteve tona morale, individuale e shoqërore me të vërtetën. Sa të forta janë sot raportet tona me të vërtetën? Me historinë tonë të largët e të afërt? Ku është sot pozicioni dhe vendi ynë në atë çarje të thellë që hapi komunizmi në shoqërinë tonë? Kulti gjysmëshekullor i mashtrimit, gënjeshtërisë dhe falsifikimit, të vetmet parime që i kanë paraprirë për gjysmë shekulli sundimit komunist, kalendarit dhe ritualeve të tij festive, pedagogjikës së pandërprerë të mashtrimit dhe alibisë, vazhdon të ushqehet e të shpërthejë me frenetizëm e histeri në mbrojtje të trashëgimisë së vet!

Por Postriba ishte një fakt i përgjakur; ishte çarja e thellë dhe e pariparueshme në historinë tonë; ajo është tortura dhe ndëshkimi i asaj ndërgjegjeje kriminale që kurrë nuk mund t'i blejë me harresë gjakun e lotët e derdhur të

qindra familjeve dhe brezave të tyre për dekada persekutimi; për itinerarët cfilitës të familjeve pas bijve të tyre nëpër burgje e kampe shfarosëse internimi. Postriba si kujtesë është bilanci i të gjithëve, është një llogari e hapur në historinë tonë të mbuluar me dhe!

Forcat e djathta të politikës shqiptare janë të vetmet që janë munduar ta nderojnë kujtimin e kësaj lëvizjeje dhe të martirëve të saj, e megjithatë, ne e dimë se jemi ende larg. Jo gjithçka është zbuluar, jo gjithçka ka dalë në dritë nga hiri i të vdekurve! Në këtë vend të verbuar nga shtjellat e urrejtjes, në këtë vend ku kanë ndodhur ligësitë dhe poshtërsitë më tronditëse me jetën e njeriut; në këtë vend dhimbjeje e zhgënjimesh, qenka vështirë të zbulosh fytyrën e plotë të së vërtetës, për të cilën kemi nevojë të gjithë! Dhe e vërteta nuk mund të flasë e shqyer në copa, në fragmente, e segmentuar në artikuj shtypi e as në një kërkim të përciptë dokumentash, që na shmang nga zanafilla e thelbi i krimit. Në çdo përvjetor diçka harrohet: njerëz të gjallë, pasardhës të familjeve të pushkatuara, të shpërndarë anë e mbanë Shqipërisë e nëpër botë, ndoshta habiten e ndoshta preken prej kësaj "harrese". Prandaj është e nevojshme të përvijohet një gjeografi e krimit dhe e plagëve.

Postriba kërkon prej nesh një ballafaqim të hapët, diskret, të gjithanshëm, ashtu si shumë ngjarje të kyçura në kasafortat e arkivave, për t'u shpalosur fizionomia e shëmtuar e krimit në krejt pamjen e vet të përbindshme, pavarësisht se edhe kjo është e pamjaftueshme. Ju të gjithë e dini se jo çdo gjë e gjen në arkiva. Nuk i gjen të arkivuara torturat çnjerëzore, fyerjet e poshtërimet, shantazhet e përndjekjet. Nuk i gjen të arkivuara dot vetëmohimin dhe thyerjen e njeriut nëpër qelitë dhe hetuesitë e xhelatëve. Por ne ua kemi borxh atyre burrave dhe familjeve, ua kemi borxh brezave të tyre ndër dekada, që u rritën me tmerret, privimet dhe tragjeditë njerëzore si të mallkuar. Dhe ne duhet patjetër të na interesojnë këto histori njerëzore, të mos harrojmë as fatin e një njeriu të vetëm, që nga dita kur "në emër të popullit" xhelatët e Sigurimit i vunë prangat në zyrë, në auditor, në rrugë, në kishë, mes familjes. Ç'u bë me këta njerëz nga ky moment? Ç'u bë me njeriun në përgjithësi? Atë babën e familjes, axhën a vllaun derisa e kthyen, në rastin më të mirë, të plakur, të sëmurë, të thyer, e në rastin më të keq në një trastë najloni me kocka? Po për ato familje që nuk kanë ku të vënë një qiri, një tufë me lule, një përlule në gjunj? Si janë rritur vallë ata fëmijë të vegjël kur me çantën e librave në krah kthejnë në shtëpi dhe e gjejnë oborrin plot me statuja familjare të ngrira?

Ne rrezikojmë si popull, si vetëdije e krejt sociumit, me indiferencë e harresë, nën moralin cinik e nihilist të parullës "Të shohim përpara". Ashtu shikonin edhe postribasit, edhe shkodranët, edhe gjithë shqiptarët në vjetin 1945, por prapa, në shpatulla, u kujtuan, ajme, me vonesë, se kishin tytën e automatikut të komunistëve, ndërsa përpara - nxinte gremina. Postribën dhe rezistencën antikomuniste të Shkodrës dhe shqiptarëve janë përpjekur ta bëjnë memece, të pagojë; ta shmangin nga librat, nga tekstet e historisë shkollore e të të gjitha niveleve, nga tekstet e Akademisë për 40 vjet me radhë; trashëgimtarët e komunizmit shqiptar janë përpjekur e deri më sot ia kanë dalë t'i privojnë brezat shkollorë nga e vetmja kujtesë e denjë midis turpit të ngrefosur të izolacionit komunist. Në volume

të tëra, pambarim, kemi parë të tirret saga e mërzitshme dhe e pafund e Udhëheqësit dhe apostujve komunistë me gjithë zhganin e tyre, të dëshmojnë truprojat, rrobaqepësit, gjelltorët e berberët, por kurrë nuk kemi parë të flitet për kryengritjet antikomuniste. Dhe në ato pak raste koprace kur është përmendur, historiografia zyrtare komuniste e regjur në manipulime, e cila ka ndot prej së vërtetës, e përmend rastin e Kryengritje së Postribës për t'i thurur lavde vetvetes. Ja si është karikaturuar kryengritja e parë antikomuniste në Evropë mbas Luftës së Dytë Botërore në tekstin "Historia e Partisë së Punës të Shqipërisë", Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste, pranë K. Q. të PPSH, Tiranë 1968, f. 232:

"Në shtator 1946 bandat kundër-revolucionare kryen një goditje të armatosur në qytetin e Shkodrës. Kjo goditje ishte llogaritur të shërbente si pikënisje për ndërhyrjen ushtarake të jashtme. Mirëpo llogaria nuk u doli armiqve, sepse bandat reaksionare u asgjësuan brenda ditës".

Në këtë kuptim, le të shtojmë që "bandat" ishin banorët vendas, ndërsa forcat e "sigurisë" kishin zbritur nga mali dhe pjesa dërrmuese e tyre nuk kishte asnjë lidhje me Shkodrën. Nëse rishkrimi e rishikimi i historisë ka akoma kundërshtarë, atëherë, me siguri, ata janë trashëgimtarët e drejtpërdrejtë të atyre që bënë masakrën në Postribë, në Shkodër e në tërë Shqipërinë.

Tragedia e opozitës socialdemokrate

Së pari, në skenën shqiptare të opozitës shfaqet Fronti i Rezistencës, Legalistët dhe të fundit shfaqen intelektualët e Grupit Social-Demokrat, por dhe emra të rinj si Sami Qeribashi, Qenan Dibra e Musine Kokalari. Me ata bashkohen edhe demokratë, patriotë e intelektualë, si Av. Suat Asllani, av. Baltasar Benusi e shumë të tjerë. Por me ata bashkohet edhe burri e patrioti i ndershëm Gjergj Kokoshi, që deri atëherë ishte në Front, i cili, i tronditur për fatin e Shqipërisë e të demokracisë, u ngrit në Këshillin Antifashist e tha: "atje ku nuk ka pluralizëm nuk ka demokraci". Kështu, në vjeshtë, në shtëpinë e Ali Kavajës, të tre grupet formojnë organizatën antikomuniste: "Bashkimi Demokratik Shqiptar", i cili kishte degë në shumë rrethe. Në jetën politike shqiptare dilte ky grupim, që Partia Social-Demokrate kryesohej nga Musine Kokalari, Partia e Legalitetit nga Qenan Dibra dhe Fronti i Rezistencës nga Sami Qeribashi. Këto Sigurimi dhe Enver Hoxha i dinin, pasi brenda Bashkimit Demokratik kishin njerëzit e tyre, por si duket ata vendosën të veprojnë pas zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945. Në janar 1946 filluan arrestimet e reprezaljet, bastisjet pasi u arrestuan 37 anëtarë të Bashkimit Demokrat me Sami Qeribashin në krye. Cilët ishin të akuzuarit?

1. Sami Qeribashi, tregtar, nga Gjirokastra, banues në Tiranë. Dënohet me vdekje.

2. Xhahit Koka, diplomat, doktor i shkencave politiko-ekonomike. Dënohet me vdekje.

3. Hivzi Gole, tregtar nga Dibra. Dënohet me vdekje.

4. Qenan Dibra, banues në Tiranë. Shkollën e mesme në liceun francez, Korçë. Studimet e larta jurisprudencë, Paris; fliste anglisht, frëngjisht dhe turqisht. Dënohet me pushkatim. Më vonë i falet jeta.

5. Tut Miniku, nga Tirana, tregtar, me pesë fëmijë. Dënohet me vdekje, me pushkatim.

6. Telat Drini, nëpunës, banues në Tiranë. Dënohet me vdekje.

7. Mehmet Ali Beshiri, nga Tirana, kryer shkollën tregtare në Austri. Dënohet me vdekje.

8. Ali Kavaja, banues në Tiranë, ka kryer shkollën teknike të Fullcit. Dënohet me vdekje.

9. Shaban Balla, lindur në Krujë, banues në Tiranë.

Gjeometër, ka kryer shkollën e Fullcit. Dënohet me vdekje.

- Më poshtë:

-Me 101 — Prof Jorgji Çoka

-Me burgim të përjetshëm; Lluca Bibi, Anton Dukagjini, Enver Hasa, Abdulla Muça.

-Me 30 vjet: Gjergj Kokoshi. Nefail Shikuli, Qemal Biçaku, Reiz Hasho, 22 vjeç, student.

-Me 20 vjet: Musine Kokalari, kryetare e Partisë Social-Demokrate Shqiptare, doktore në shkencat letrare, 28 vjeç, dhe Hasan Kalaja, Stefan Bumçi. Vahid Verdalli, Haki Gjinishi. Të tjerë me 25 vjet burg, me 15 vjet, me 5 dhe 1 vjet burg. Gjithsej 37 vetë.

Musine Kokalari, ndërsa iu përgjigjej pyetjeve të prokurorit, dikush nga ata që ndiqnin gjyqet me ftesa me histeri thirri: “Me vdekje në litar!” - I krekosur se e mposhti të pandehurën, kryetari i trupit gjykues, Frederik Nosi, i tha Musines: “E dëgjon e pandehur se ç’thotë populli për ty?” Dhe ajo me guxim e largpamësi iu përgjigj: “Një ditë do të thonë edhe për ju, zoti gjykatës”. Dhe mbas vendimit të trupit gjykues e pas ekzekutimit të fatzinjve, 37 familje do të nisin rrugën e tmerreve të kampeve të përqendrimit.

Të gjitha këto masakra, gjyqe e spastrime bëheshin në një sfond nënshtrimi e servilizmi poshtëruar të Partisë Komuniste Shqiptare ndaj udhëheqjes jugosllave, e cila hapte solemnisht Kongresin e saj të Dytë të Frontit Popullor të Jugosllavisë, nën përshëndetjen e mareshallit Tito. Në Shqipëri rapsodët palaço, që e politizuan dhe folklorin, këndonin me çifteli që përhapen në gjithë Shqipërinë:

*“Enver - Koçi ka pa andërr
Shqipnën nuse e Titon dhandërr,
N’nji shpi t’bukur n’nji shpi t’gjanë,
Beograd e deri n’Tiranë”.*

Terrori komunist mbi klerin katolik

Në këtë atmosferë feste shpallen me histeri dënimet me vdekje të klerit katolik, të inxhinierëve të Kënetës së Maliqit ose “grupit sabotator”, nën thirrjet e rinisë së rekrutuar: “Tradhtarët në litar!”.

Kështu, komunistët hartuan provokacionin e radhës, siç ishte gjyqi kundër klerit katolik të Shkodrës, me pretekstin e fshehjes së armëve në altarët e kishave, me shpresë se do ta diskreditonte klerin në sy të popullit. Ata që do të burgoseshin ishin vërtet shumë, por edhe burgjet ishin të shumta. Në Shkodër numëroheshin 10 burgje (ndërsa po t’i besojë karrocierit

që i fumizonte me bukë ishin 17). Ishin kthyer në burgje edhe vetë Kuvendi i Françeskanëve dhe ndërtesa e Jezuitëve. Por ishin kthyer në burgje edhe shtëpitë e tregtarëve, burgu i Prelës, Pogut, i Ulqinakut, përveç burgjeve tashmë të njohur, si Burgu i Madh, burgu i Gestapos, Burgu i Prefekturës, shtëpia e Çurçisë etj. "Trokitjet" fillonin më 13 tetor 1946 te Dom Nikoll Deda, Dom Tom Lacaj, Pater Çeprian Nika, Pal Doda, P. Donat Kurti e Gjon Karma. Me 15 nëntor - tek Monsinjor Gjini e Mati Prendushi e me 20 nëntor tek deputeti Zef Haxhia me shokë e deri në qershor 1947 me Dom Anton Muzaj, Dom Ndoc Sahatçiu e shumë të tjerë.

-Në qelinë e vogël një frat i heshtur rrinte në gjunjë kokulur sa mezi i dallohej lëvizja e buzëve, kujton Ilir Bali (pseudonim i Sami Rrepishtit). Edhe ai si të tjerët priste fundin në atë mënyrën e vet... Një shkelm i fuqishëm i një çizmeje ushtarake dhe një sharje e ndytë e sjellin në vete. E marrin e diku e çojnë e pas një ore e përplasnin si një trup pa jetë në qelinë tonë. Ishte P. Çeprian Nika, që kur filloi t'i vinte shpirti dhe diçka e pyeta nisi të më tregojë: "Donin të më provokonin edhe për çështje fetare, por unë i përmenda Shën Tom Aquinin dhe u dhashë një mësim aq të mirë sa njëri prej tyre u nexh e më tha: "zoti im asht Enver Hoxha". Mandej nuk di ma sa ç'më banë.

- Pse more Padër, e qortova unë, shton "Iliri", - ata janë maskarenj e të mbysin!
-Ke të drejtë biri im - m'u përgjigj, - ashtu asht. Por në këtë mes unë kamedhe një mision më shumë se të tjerët, më duhet të nder dritën kur ajo ka rrezik të shuhet, vuajtja sigurisht nuk asht e lehtë, por ajo e fisnikëron më shumë fitoren e arritur.

"Ishim 25 vetë të dënuar me vdekje në një dhomë, dëshmon Rakip Meta, e sa herë që hapej dera, çoheshin të gjithë njëherësh, kush të arrinte i pari që të shkante në pushkatim: kaq na ishte mërzitur jeta...¹³". Në odën nr.5, e gjatë afër 5 m dhe e gjanë 2.20, ishin të vendosur kështu:

- | | |
|--|-----------------------------|
| 1.Hafiz Dërguti (që më vonë e pushkatuan); | 18.D. Jak Zekaj; |
| 2.D. Engjëll Deda; | 19.D. Lekë Dredhaj; |
| 3.At Rrok Mirashi; | 20.At Ciril Cani; |
| 4.At Mikel Koliqi; | 21.D.Mëhill Cani; |
| 5.D. Mark Hasi; | 22.At Bona Gjeçaj; |
| 6.D. Ndoc Suma; | 23.D. Tomë Laca; |
| 7.At Mark Harapi; | 24.D. Nikoll Shelqeti; |
| 8.At Karlo Serreqi; | 25.At Gjon Karma; |
| 9.At Agostin Ashiku; | 26.At Mëhill Miraj; |
| 10.At Marjan Prelaj; | 27.At Donat Kurti |
| 11.At Alek Baqli; | 28.At Leon Kabashi; |
| 12.Fr. Zef Pllumi; | 29.At Pjetër Gruda; |
| 13.At Filip Mazrekaj; | 30.At Pal Dedaj; |
| 14.At Frano Kiri; | Ky i fundit erdhi kur hoqën |
| 15.D. Anton Luli; | Hafiz Dërgutin... |
| 16.At Gaspër Suma; | |
| 17. At Injac Gjoka; | |

13 Pepa, Pjetër "Dosjet e diktaturës", Tiranë 1995, f. 191

Tue pyetë njani-tjetrin na thanë se në atë burg ishte edhe një dhomë tjetër, e cila kishte edhe 16 meshtarë të tjerë katolikë. Ata ishin dënue mjaft kohë para nesh¹⁴. Skenari i fshehjes së armëve në kishë kishte motivet e tij.

-Imzot Frano Gjini me vdekje dhe At Mati Prendushi 66 vjeç e At Çeprian Nika, të dy me vdekje.

Gjyqi mbi inxhinierët “sabotatorë” të Kënetës së Maliqit

Më 22 nëntor 1946, e ashtuquajtura “drejtësi e shtetit komunist”, nëpërmjet propagandës, shpifjeve, montimit e falsifikimit të së vërtetës, pasi inskenoi diavoliadën e procesit gjyqësor kundër “inxhinierëve sabotatorë amerikanë”, ekzekutoi me dënime me varje, pushkatime e burgime të gjata kastën e intelektualëve me përgatitjen më të shquar teknike e profesionale, nën akuzën e sabotazhit dhe agjenturës së huaj. Inxhinierët e ekzekutuar dhe të dënuar akuzoheshin si agjentë të të ashtuquajturit “imperializëm amerikan”.

Sigurisht, pushteti komunist në bashkëveprim metodash e analogjish me praktikën e shtetit të Stalinit apo komunizmit Jugosllav u përpoq të ishte më i zellshmi në larjen e hesapeve me kundërshtarin potencial, ndaj dhe fabrikimi i procesit dhe propaganda partiake në likuidimin e kundërshtarëve të drejtpërdrejtë apo potencialë, që kishte grumbulluar tashmë një përvojë të përgjakshme rreth 2 vjeçare, u ushtrua në nivelet më të egra agjitative. Sipas të dhënave, tharja e kënetës së Maliqit na paskësh shërbyer si pretekst për mbylljen e veprimtarisë së shkollës teknike amerikane “Harry Fullz” për t’i paraprirë këputjes së të gjitha lidhjeve me “imperializmin amerikan”! Sipas shkrimeve të botuara në lidhje me këtë ngjarje, mësojmë atë që nuk e kemi ditur, se nga 156 nxënës të kësaj shkolle, 18 janë pushkatuar, dy janë varur, 80 janë burgosur dhe dënuar me 800 vjet burg!

Ndër arsyet e dënimit të inxhinierëve për “aktivitetin e tyre antipopullor”, të pandehurit Abdyl Sharra, Kujtim Beqiri e Zyrika Mano, bashkë dhe me elementë të tjerë, janë vënë në kontakt herë pas here me agjentët e reaksionit të huaj, të maskuar me funksione legale dhe për t’iu shërbyer qëllimeve të tyre imperialiste, bëhen spiunë dhe vegla të verbëta në shërbim të tyre.

Kush ishin në fakt arsyet e vërteta? Ato duhet t’i kërkojmë në prejardhjen e tyre, ose siç quhej ndryshe në kohën e komunizmit, në biografinë e tyre: Abdyl Sharra, sipas akuzës së komunistëve, është një ish-oficer i fashizmit, i rrethuar nga një ambient familjar që u vu në dispozicion të Ballit e të okupatorëve. Kujtim Beqiri - anëtar i Komitetit Qarkor të Ballit në Vlorë në kohën e okupacionit. Kujtim Beqiri, sipas alibisë së komunistëve, që i emëruar inxhinier drejtues i aksionit të rinisë në rrugën Kukës-Peshkopi, ku sabotoi një pjesë të rrugës në sektorin “B”, kurse Abdyl Sharra, i emëruar drejtor i punimeve për tharjen e liqenit të Maliqit, para se të nisej për në krye të detyrës, merr udhëzime nga agjentët e huaj në Tiranë, duke u shpërblyer me një rrogë të përmuajshme prej 50 stërlinash. Atij iu dhanë premtime se në të njëjtën mënyrë do të shpërbleheshin gjithë elementët e tjerë që do të bashkëpunonin me të. Qysh prej mbërritjes së tij e deri më 27 korrik të 1946, kur u largua nga përgjegjësia si drejtues i kantierit të Maliqit, ai e shtriu aktivitetin antipopullor

¹⁴ Pllumi, Zef At “Rrno vetëm për me tregue”, Tiranë 1995, f.205

të gjerë duke rekrutuar Aleks Vasilin, Vasil Manon, Zyrika Manon, Pandeli Zografin, Mihal Stratobërdën dhe dy italianët që gjendeshin në Maliq.

Kanë kaluar 65 vjet nga dita e këtij krimi shtetëror. Në tekstet shkollore të Historisë së Shqipërisë të të gjitha niveleve nuk shkruhet asnjë fjalë, së paku për të dëshmuar falsifikimin dhe manipulimin e shtetit komunist nëpërmjet këtij modeli aq të përfolur e të propaganduar për gjysmë shekulli me të gjitha format e agjitacionit komunist. Të mos harrojmë se forma më e sofistikuar e ruajtjes, fshehjes dhe mbrojtjes së krimit, është *mospërmendja e tij*.

Kujtim Beqiri pati mbaruar në Vjenë dhe ishte drejtor; ai u akuzua dhe u var në litar; të tjerë u pushkatuan. Kujtim Beqirit i thanë të qëndronte pedagog në Vjenë; ai nuk pranoi, me idenë që të rikthehej në vend e t'i shërbente popullit të tij. Edhe sot fotografia e tij gjendet në Universitetin e Inxhinierisë së Vjenës, si nxënës i shkëlqyer i të gjitha kohërave. Fjala e fundit e të riut para se të vdiste ishte: "Fajin tonë do ta tregojë historia. Të rrojë Shqipëria!". Mënyra se si u veprua me elitën e intelektualëve shqiptarë, në veçanti me rastin e të ashtuquajturve "grupi sabotues i inxhinierëve amerikanë" dhe qëndrimet që vazhdojnë të mbahen ende sot, na vënë përpara një piste morale e meditative mbi qëndrimin e dykuptimtë të historianëve shqiptarë, të cilët, duke mos e zbardhur krimin, lejojnë të vazhdojë po ai perceptim, me të cilin i pati damkosur propaganda komuniste. E ritheksoj edhe njëherë se forma më e kamufluar e mbrojtjes së trashëgimisë komuniste, është mbijetesja e saj nëpërmjet *heshtjes*. Dekomunistizimi, para së gjithash, i teksteve shkollore, jo nëpërmjet mospërmendjes, por të zbardhjes, analizave, dokumentimit dhe krahasimeve, do të shënonte hapin e parë të rehabilitimit të këtyre martirëve, si hap i parë i kapërcimit të gënjeshtërs, intrigës e shpifjes, në kushtet kur familjarët e viktimave ende nuk kanë gjetur eshtrat e të ekzekutuarve. Për kampin shfarosës të Maliqit kanë shkruar kujtime personalitete të rëndësishme të letrave shqipe, njerëz të rëndësishëm e njerëz të thjeshtë, të cilëve iu ra për short të përjetonin atë rreth të përzishëm të Ferrit komunist. Mbresëlënëse e ngjethëse mbi punën në këtë kënetë janë memualet e At Zef Pllumit, Ejëll Çobës dhe Sulejman Xhixhës.

Nuk ishin ushtri të huajsh ata që varnin të shkolluarit në Perëndim, por ishin dora vetë komunistët shqiptarë, që ngritën trekëmbëshat në vjeshtën e fundvitit '46. Partia Komuniste Shqiptare me levat e saj të propagandës e përdori gjerësisht si referencë dhe edukim për brezat gënjeshtërs e madhe të "inxhinierëve sabotatorë". Mjafton të kujtojmë demarshin e kësaj propagande në artin socrealist. Ka një roman të Fatmir Gjatës me titullin "Kënetë", që e shndërron të vërtetën e kësaj ngjarjeje në një afresk të manipuluar epike sipas kanoneve të realizmit stalinist në letërsi. Nëpërmjet këtij romani që njih mbi tetë ribotime me tirazh llahtarisht të madh, të përfshirë në të gjitha tekstet shkollore-universitare, të përfshirë në kolanën "seria e romanit të zgjedhur (srz)", të përcaktuar si lexim të detyrueshëm në shkollat tetëvjeçare, të mesme dhe universitare, të përfshirë në të gjitha antologjitë shkollore, - u ndërtuan deri në vitin 1990 perceptime të rrejshme mbi të vërtetën. Thelbi i romanit "Kënetë" të shkrimtarit komunist Fatmir Gjata, nisët nga një e vërtetë, por shkrimtari i partisë këtë të vërtetë e shndërron tërësisht të përmbysur,

të falsifikuar dhe në fakt, falsifikimi i kësaj të vërtete është një rivrasje e shëmtuar e viktimave dhe martirëve që u dënuan. Personazhet e veprës - Abdi Sharra, Kujtim Shaqiri, Vasil Minga, Zyraka, Euxhenio Skutarini, Harri Fullci, në roman paraqiten si sabotatorë, armiq të popullit e të Partisë dhe agjentë të ndryshëm e sidomos të imperializmit amerikan. Prandaj si të tillë duhej të dënohen dhe vërtet janë dënuar. Përballë tyre del ndonjë personazh letrar me ideale të reja socialiste, me një zgjuarsiri të veçantë për "zbulimin e armiqve të popullit" dhe me besnikëri të plotë ndaj idealeve të Partisë.

Tema e romanit është tharja e Kënetës së Maliqit në vitin 1946, sapo ka zënë rrënjë regjimi komunist. Brezat shkollorë që e kanë lexuar kanë krijuar një përshtypje të veçantë nga vepra, kanë ndjerë kënaqësi dhe i kanë urreyer "armiqtë e popullit"! Mirëpo me kalimin e kohës, me ndryshimin e rrethanave politike, me të dhënat e bazuara në të vërtetën e kësaj ngjarjeje, na del një realitet tjetër, të cilin shkrimtari Fatmir Gjata nuk kishte guxuar ta paraqiste si të tillë.

T'i japim disa të dhëna në përballje me romanin "Kënetë": - Avdi Sharra, si personazh letrar, është Avdyl Sharra i vërtetë, 35 vjeç, inxhinier i ndërtimitarisë i diplomuar në Romë, i caktuar si kryeinxhinier në tharjen e Kënetës së Maliqit. Më vonë i dënuar me varje!

Kujtim Shaqiri, personazh letrar, është Kujtim Beqiri i vërtetë, 30 vjeçar, inxhinier, fitues i medaljes së artë në Universitetin e Vjenës.

I caktuar si drejtor i punimeve në kënetë. I dënuar me varje !

- Vasil Minga, personazh letrar, me emër të vërtetë Vasil Mano dhe bashkëshortja e tij Zyraka Mano (kroate) që del me po atë emër letrar, dënohen me pushkatim për sabotim dhe "tradhti" ndaj popullit dhe atdheut! Po ashtu, dënohen me pushkatim drejtori i shkollës, Fullci, dhe inxhinieri italian, Euxhenio Skaturra, në roman Skutarini.

Dhe gjithnjë duke gjurmuar shkrimet rreth kësaj ngjarjeje mësojmë se në tharjen e Kënetës së Maliqit nuk ka marrë pjesë populli, as punëtorë vullnetarë të Partisë, por të burgosurit e burgut të Tiranës nën masa të rrepta sigurie e në kushte e masa ndëshkuese mesjetare. Kënetë e Maliqit ishte shëndërruar në një kamp të tmerrshëm ku bëhej shfarosja e "armiqve të popullit e të Partisë"! Prandaj është e qartë se ngjarjet rreth Kënetës së Maliqit janë shtrembëruar dhe janë hartuar ashtu siç i ka pëlqyer regjimit komunist. A do ta shkruante ndryshe shkrimtari Fatmir Gjata po të ishte gjallë?!

Përveç romanit, ka edhe një film të Kinostudios "Shqipëria e Re" për ta kanonizuar masivisht versionin zyrtar komunist, po ashtu edhe dokumentarë mbi këtë diavoliadë. Në Kënetën e Maliqit, sipas versionit të propagandës komuniste, punonte "populli, rinia jonë heroike", ndërsa e vërteta është krejt ndryshe: kontingjenti që realizoi në kushte naziskine këtë vepër ishin të burgosurit politikë. Disa nga shifrat që afrohen janë se rreth tre mijë të burgosur kanë punuar atje. 63 vetë kanë vdekur në punët e vështira, janë pushkatuar, janë varur në kohë të tharjes së kësaj kënete. Masat represive që u ushtruan në kënetën e Maliqit u përkasin metodave të nazistëve. Mushkonjat, kushtet e vështira të punës, ushqimi i pakët, rrahja, ndëshkimet poshtëruese deri te groposja në kanal, mungesa e mjeteve të punës (mjetet

përbëheshin prej lopatës, kazmës, tokmakut, dekovil dinamiti dhe pako gjë - këto ishin kushtet e këtij kampi shfarosjeje. Tharja e kënetës kërkoi shfrytëzimin mizor të energjive të mijëra vetëve, ndërkaq shteti refuzonte kredi dhe makineritë moderne që përdorte bota në tharjet e kënetave.

Vetëm pas rënies së komunizmit për horrorin e vërtetë të kësaj kënete shkruhet një roman tjetër - "Këneta e vdekjes" e Makensen Bungos. Sipas shkrimtarit Visar Zhiti, shkrimtari Makensen Bungo që punoi atje si i dënuar, përshkruan Ilahtarin, ujërat e turbullta të kënetës, që iknin duke marrë me vete kufoma dhe skelete njerëzish. Policia vriste këdo, si të donte. Prandaj dhe në titull është shtuar ndajshtimi përfundues "e vdekjes". Nisur nga kjo, shemra e tij "Këneta", mbase lë të nënkuptohet kënetën e Partisë. Në atë kënetë kanë punuar si të burgosur dhe dy kolegë të shkrimtarit, prijëtari i rrëfimit shqip, Mitrush Kuteli, me poetin e studiuesin, profesorin në universitetet amerikane, Arshi Pipa, i cili arriti të nxjerrë nga ai burg "Sonetet e Kanalit", të cilat i botoi në Romë, më 1959 në vëllimin "Libri i burgut". Ndryshe nga Fatmir Gjata, në sonetet e Pipës ne ndeshemi me atmosferën e kobshme danteske, në rrathët më drithërues të "Ferrit", ku punonin të dënuarit politikë, sikundër na e jep këtë afresk të maktshëm soneti hyrës i poemës së tij "Kanali":

*Nga Korça bumbullon. Currila shiu
Rrjedhin prej mushamas mbi krena e shtroje.
Pështillen, struken gjindja ndër mbuloje:
Nji lamsh ku qelben rrecka e mish njeriu.*

*Mbramje. Dikush përmbri qet gjak për goje.
Këndon letas mbatanë nji fmi arixhiu.
Ky grindet për pak ujë qi shoku i piu;
Ai shan se i vodhën bukën. Hin një roje.
Shkopinj e shqelma. Britma. Frin bilbili.*

*Pushim. E dergjet lodhja, pran secili,
E flen kush mundet për atë natë me fjetë.
Si lazaret rënkon e fshan baraka.
Nesër të gjithë i pret kanali, brraka,
Veç atyne qi i pret nji vorr i shkretë.*

Pasi të kujtohet thënia e Danillo Kishit se "shkrimtarët nuk janë ndërgjegjja e kombit, sepse në mesin e tyre ka shumë qelbanikë", në çast të dalin përpara personazhet e Fatmir Gjatës nga romani "Këneta". Në këtë rast nuk ke si të mos shtrosh dilemën se, po të ishin gjallë ata personazhe, si do të silleshin vallë me autorin e tyre? Çfarë do të bënin gjithë ata inxhinierë shqiptarë, që autori i librit i shpalli sabotatorë, dezertorë dhe armiq të atdheut!? Dhe së fundi do të ishte me vend të ngremë një pyetje kuaziretorike, së cilës na takon t'i përgjigjemi njëherë e mirë: Si do t'ia bëjmë ne, si shoqëri, me botën e librave të mbushur me shtresa të trasha gënjeshtresh?

Festë vdekjeje në mesnatë për nder të Stalinit

Me 15 shkurt 1951 në oborrin e Ambasadës Sovjetike u hodh një bombë artizanale me dinamit, që nuk bëri asnjë dëm. U mbloodh Byroja Politike më 20 shkurt 1951. Mehmet Shehu, Ministër i Brendshëm, thotë: “Është një ngjarje politike e kalibrit të madh, bile edhe më e madhe se një atentat që mund t’i bëhej ndonjërit nga ne”. Ai kërkoi masa represive të jashtëzakonshme, pa marrë parasysh ligjet në fuqi, meqenëse edhe herë tjetër “kemi pushkatuar, jashtë ligjeve në fuqi. Ju kujtohet si kemi vepruar kur u vra Bardhok Biba?”. Të gjithë anëtarët e Byrosë Politike ishin dakord për masa të menjëhershme represive (AQSH - Procesverbali i Byrosë Politike, 20 shkurt 1951). Menjëherë pas kësaj u hartuan “listat e zeza” dhe nga të gjitha krahinat e Shqipërisë u arrestuan qindra të pafajshëm me biografi “perëndimore”. 22 intelektualë nga këto lista u dënuan pa gjyq, me vdekje, pasi i kaloi për nëpër duar për herë të fundit vetë Enver Hoxha.

Karakteri i hapur kriminal në zbatimin e gjenocidit dhe formave të terrorit masiv mbi intelektualët dhe kundërshtarët politikë, ka qenë një praktikë e importuar e udhëheqjes komuniste shqiptare, duke u mbështetur mbi modelet staliniste të “spastrimeve” dhe “listave të zeza”. Sloganet se në Shqipëri po zbatohet në mënyrë krijuese modeli socialist, kanë, në thelb, vetëm një të vërtetë: Enver Hoxha dhe Byroja Politike në çdo hap janë mbështetur tek praktika e Stalinit dhe Politbyrosë sovjetike me ligjet e hartuara enkas, që i paraprinin të drejtës së pakufizuar të ushtrimit të terrorit, sa mbi kundërshtarët, aq dhe të luftës brenda llojit. I vetmi aspekt krijues i komunistëve shqiptarë konsiston në larjen e hesapeve me kundërshtarët, pa qenë nevoja as e procedurave dhe as e dokumentacionit elementar.

Përvoja e vyer e “Terrorit të madh stalinist”

Komisariati Popullor i Punëve të Brendshme (NKVD) të BRSS ishte thjesht zbatuesi i ligjeve të hartuara nga Stalini dhe Politbyroja mbi arrestimet sipas listave të zeza dhe dënimit kapital me pushkatim. Përvoja e Udhëheqjes komuniste shqiptare e zbatoi me fanatizëm këtë skemë duke e pasuruar atë me elementë emocionalë të luftës së klasave, edhe pse modeli i importuar nga përvojat staliniste i referohej një kohe e shtateve aspak analoge, 15 vjet pas, pa atmosferën e rënduar psikologjike në prag të Luftës së Dytë Botërore. Me gjetjen e një sadisti të zellshëm si Nikolaj Jezhov, në krye të NKVD-së nis periudha më kriminale në historinë e dhunës, që ka hyrë në histori me emrin “Koha e Terrorit të Madh” ose “jezhovçina”. Në gjyqin kundër tij, më 1940, para se ta pushkatonin, Jezhov thotë të vetmet fjalë keqardhëse për veten: “Kam fshirë nga kjo jetë 14 000 çekistë, por faji im më i madh është se nuk kam mundur të vras dyfishin”.

Figura të tilla frymëzuese si Stalini dhe Jezhovi kanë gjetur paralelet e tyre në udhëheqjen komuniste shqiptare, deri tek funksionarët më të vegjël, si Aranit Çela, Siri Çarçani apo Nevzat Haznedari, duke e aplikuar logjikën e “terrorit të madh” përgjatë gjithë segmentit të sundimit komunist në Shqipëri. E gjithë masakra e 26-27 shkurtit 1951 e ushtruar mbi intelektualët

shqiptarë, me shkas hedhjen e eksplozivit në ambasadën sovjetike, flet për një orientim të Byrosë politike dhe Enver Hoxhës në përvojën e modelit stalinist të “kohës së terrorit të madh” dhe “listave të zeza të spastrimit”, duke e kopjuar atë në frymë dhe në procedurë, e shpesh duke e tejkuluar për nga zelli dhe përsheptimi. Në të vetmen monografi studimore “Bombë në Ambasadën Sovjetike”, që hedh dritë me fakte, dokumenta e procedura lidhur me pushkatimin e 22 intelektualëve të shquar properëndimorë të kohës, historiani Uran Butka na njeh gjerësisht me ideimin dhe praktikën që u ndoq nga Byroja Politike e KQ nën drejtimin e Enver Hoxhës. Ka madje një përkujdesje që harta e gjenocidit t’i përmbahet edhe kriterit gjeografik të trevave shqiptare, duke i dhënë domethënie simbolike edhe gjeografisë së terrorit. Në kapitullin “Dekreti i Zi”, të librit të tij, Butka na sjell dokumentin origjinal që legjitimon pushkatimin e 22 intelektualëve, duke na njohur me absurditetin dhe kontradikSIONIN flagrant të zbatimit të tij. Ekzekutimi i 22 viktimave, konform dekretit të lëshuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, me datë 26.02.1951 mbetet i paligjshëm, sepse të gjitha veprimet juridike janë kryer pa dalë dekreti, pra i kanë paraprirë dekretit, i cili ka dalë një ditë më vonë. Butka nuk është larg të vërtetës kur thotë se “ky projekt-dekret u përpilua në zyrat e Ministrisë së Brendshme, të cilat, si çdo Ministri, kanë qenë asokohe të tejnngopura me specialistë e këshilltarë sovjetikë, të cilët kishin një përvojë të pasur nga historia e BRSS, së kohës së “Terrorit të madh”. Pushkatimi i kundërshtarëve të komunizmit, në një shkallë të tillë masive nuk përbën ndonjë risi në praktikën terroriste të udhëheqjes shqiptare.

Në mbledhjen e Byrosë Politike, duket se përvetësimi i kësaj përvoje të importuar nga praktika staliniste, është zbatuar edhe më parë. Kjo del nga fjalët e Mehmet Shehut në mbledhjen Byrosë Politike të po asaj dite kur u hodh eksplozivi në Ambasadën Sovjetike: “Një masë të tillë ne e kemi marrë edhe kur u vra Bardhok Biba, d.m.th., kemi pushkatuar edhe jashtë ligjeve në fuqi¹⁵”. Uran Butka konstaton pesë kontradiktat kundravajtëse me ligjin: *Së pari*, hetimet për këtë ngjarje u bënë të përsheptuara e pa procesverbale të rregullta dhe zgjatën 5-6 ditë, ashtu siç do ta përcaktonte dekreti i ri, në nenin 1 të tij: “Hetimet në lidhje me veprimtaritë e organizatave terroriste dhe akteve terroriste kundër punonjësve të pushtetit popullor dhe organizatave politike e shoqërore të Republikës Popullore të Shqipërisë duhet të përfundohen brenda një kohe jo më të gjatë se 10 ditë. Siç do ta shohim më poshtë, ky nen duket se është marrë *copy/paste* prej ligjit të hartuar nga Komiteti Qendror Ekzekutiv (CIK) dhe Këshilli Popullor i Komisarëve (SNK) të BRSS me 01.12.1934. *Së dyti*, akuza iu dorëzua të pandehurve një ditë përpara shikimit të çështjes në gjyq, ashtu siç e përcakton neni 2 i dekretit.

Së treti, sipas procesverbalit të vendimit, gjyqi u bë në letër, pa pjesëmarrjen e palëve, të prokurorit dhe avokatëve mbrojtës, dëshmitarëve, etj., pra u veprua në bazë të nenit 3 të dekretit.

Së katërti, nuk u lejua rekursi kundër vendimit përfundimtar, si dhe paraqitja e kërkesave për falje.

15 Proces-verbali i mbledhjes së Byrosë Politike, 20 shkurt 1951.

Së pesti, pushkatimi i tyre u bë menjëherë, ashtu siç e përcaktonte neni 5 i dekretit.

Mospërputhjen në kohë e datë të dekretit mbi pushkatimin e 22 intelektualëve, Mehmet Shehu e ka përligjur edhe më parë në logjikën terroriste e të vetëdijshme të komunistëve shqiptarë: “Vetëm duke vrarë njerëz, ne do ta mbajmë pushtetin¹⁶”.

Vetë teksti i dekretit është ky: “Dekret me datë 26 shkurt 1951 mbi ndjekjen dhe shikimin e veprimtarisë t’organizatave terroriste dhe t’akteve terroriste kundër punonjësve të pushtetit popullor dhe të organizatave politike e shoqërore të Republikës Popullore të Shqipërisë”. Ashtu si në praktikën sovjetë të kohës së “Terrorit të madh”, edhe në Shqipëri, ngjarjeve të tilla, si e pushkatimit të 22 intelektualëve, u bëhej jehonë në shtypin qendror dhe lokal. Pas pushkatimit, vetë Mehmet Shehu shkruan në “Zëri i Popullit” të 1 marsit 1951 artikullin “Të jemi vigjilentë dhe të pamëshirshëm ndaj armikut”, në të cilin shprehet: “Dekreti i 26 shkurtit 1951 është një armë shumë e fortë në duart e organeve të pushtetit tonë për të goditur pa mëshirë armiqtë e brendshëm¹⁷”.

Le të shohim modelin e importuar sovjet nga është marrë përvoja shqiptare për të shfarosur inteligjencien me pikëpamje të përkundra me ta dhe të formuar në Perëndim. Koha e “terrorit të madh” dhe “listave të zeza” është projektuar në BRSS në fund të vitit 1934 dhe është venë në zbatim, siç thamë, me ardhjen në krye të NKVD-së të Nikolaj Jezhovit.

Listat e vdekjes - e vetmja kronikë e pushtetit komunist

Burimet më të afërta të “Listave të vdekjes”, duhen kërkuar tek procedurat e shkurtuara të procesit gjyqësor, të cilat qenë postuluar nga dekreti famëkeq i Komitetit Qendror Ekzekutiv (CIK) dhe Këshillit Popullor të Komisarëve (SNK) të BRSS me 01.12.1934. Ky dekret u shpall menjëherë pas vrasjes së anëtarit më popullor të Politbyrosë, Sergej Kirovit (vrasje, e cila, sipas një versioni të studiuesve rusë, ishte urdhëruar nga vetë Stalini, për shkak të reputacionit popullor të të Kirovit). Sipas këtij dekreti, që u hartua po mbrëmjen e vrasjes së Kirovit, hetimi për veprimtaritë dhe aktet e organizatave terroriste duhet kryer në mënyrë të përsheptuar¹⁸ (deri në 10 ditë), gjyqi duhet të bëhet pa pjesëmarrjen e palëve dhe pa thirrjen e dëshmitarëve. Ligji që do të veprojë pas datës 01.12.1934 nuk lejonte as ankimin e dënimit në Gjykatën e Kasacionit, as paraqitjen e kërkesave për falje. Dënimet me vdekje për vepra të tilla duhen ekzekutuar menjëherë. Edhe pse 15 vjet me vonesë, në një kohë e kulturë tjetër, kur ende nuk ishte shuar entuziazmi i fitores së popujve mbi fashizmin, ky ligj u kopjua e u zbatua. Mënyra krijuese e imituesve konsiston në atë se procedura e komunistëve shqiptarë shkurtohet dyfish, krahasuar me ligjin sovjet, përkatësisht nga 10 ditë në 5.

Normat e reja procesuale, pas ligjit që i parapriu “terrorit të madh” në BRSS, të lejonin të jepje dënime me vdekje për çështje politike pa zgjatje e

¹⁶ Nga fjala e M. Shehut lidhur me Promemorien e Bilbil Klosit, 1949.

¹⁷ Gazeta “Zëri i Popullit”, 1 mars 1951.

¹⁸ <http://www.memo.ru/s/319.html>

burokraci të tepërt, duke ruajtur ndërkaq iluzionin e procedurës gjyqësore. Është e rëndësishme të vërejmë se rregullatori real (megjithëse i fshehur) i mekanizmit të ri të gjyqimit ishte Politbyroja e Komitetit Qendror të Partisë Komuniste të BRSS-së: shqyrtimi i çështjeve “në procedurë të përsheptuar” kërkonte sanksionin e saj domosdo paraparak, të hartuar me një vendim special.

Zbatimi praktik i Ligjit të datës 01.12.1934 pati në fillim një karakter episodik dhe lidhej kryesisht me çështje të mëdha e të veçanta. Kështu, për shembull, u veprua me sanksionin e Politbyrosë në çështjen e Leonid Nikollajevit (vrasësit të S. Kirovit) në dhjetor 1934. Përpyekjet e para për të zbatuar “metodën e reduktuar” në përmasa të mëdha filluan në vjeshtën e vitit 1936, fiks disa ditë pas emërimit të Jezhovit në postin e drejtuesit të NKVD të BS.

Edhe në këtë rast, vendimi paraparak formal u mor nga instanca më e lartë e partisë (megjithëse në mungesë të Stalinit, i cili atë kohë po pushonte në Soçi): më 4 tetor 1936 Politbyroja shqyrtoi propozimin e Jezhovit dhe Vishinskit për sanksionimin e dënimit me vdekje të 585 njerëzve sipas listës së marrë në “hetim” dhe vendosi: “Jemi dakord me propozimin e tovarish Jezhovit dhe Vishinskit mbi masat e ndëshkimit gjyqësor ndaj pjesëmarrësve aktivë të organizatave terroristo-kundrerevolucionare trockisto-zinovjeviane, sipas listës, në sasinë 585 njerëz”. (Në origjinal vendimin e pushkatimit të tyre e firmosën me shkrim: “Pro: Kaganoviç, Molotov, Postishjev, Andrejev, Voroshilov).

Këtu duhen parë me vëmendje dy detaje:

- së pari, një vendim i tillë për herë të parë nuk qe hartuar si formulim nga protokollin i mbledhjes së Politbyrosë me rekuizitat që parashikojnë këtë protokolle (№ protokollit / № pika e rendit të ditës, etj);

- së dyti, fjala në vendim nuk ishte për sanksionet e “procedurave të shkurtuara” të shqyrtimit gjyqësor, por direkt për “masat e masakrës gjyqësore”, d.m.th., të pushkatimit. Kësisoj, duke nisur nga kjo përvojë e parë e Jezhovit, u shpall tendenca e mosndërlikimit të procedurës në shqyrtimit e listave me formalitete të tepërta¹⁹ dhe, si të thuash, e “thjeshton” atë duke

19 Fakti, se këto çështje shqyrtoheshin me një procedurë të shkurtuar, konfirmohet, për shembull, me letrën e ministrit të Drejtësisë të BRSS, M.I. Pankratjev dhe Presidentit të Gjykatës së Lartë të BRSS I.T. Goljakovit drejtuar Stalinit dhe Molotovit më 3 dhjetor 1939, në të cilën shtrohet çështja e metodës së shqyrtimit të disa dënimeve. Ata shkruajnë: «Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë të BRSS, veçanërisht përgjatë viteve 1937 dhe 1938, është shqyrtuar në cilësinë e gjykatës së instancës së parë një sasi të madhe çështjesh gjyqësore mbi krimet kundër-revolucionare. Këto çështje janë shqyrtuar në formë të shkurtuar dhe, si regull, pa thirrur dëshmitarët” (APRF. F.Z. Vol.57. D.38. L.179). Problemi i rishikimit kishte të bënte me faktin, se sipas ligjit këtë kishte tagër ta bënte vetëm Pleniumi i Gjykatës së Lartë të BRSS, që përbëhej prej 30 antërësh, çka, sipas autorëve të letrës, është e padëshirueshme, nga se mund të shpjerë në mos pajtim karshi materialeve të propozuara për këto çështje. «Çështjet e kësaj kategorie, - shkruajnë më tej autorët - janë rreptësisht sekrete, dhe materiali, lidhur me këto çështje, përbën një sekret të një rëndësie të madhe shtetërore». Prandaj propozoj për shqyrtimin e këtyre çështjeve një “grup i ngushtë” i Gjykatës së Lartë prej 3 personash me pjesëmarrjen personale të Prokurorit të BRSS (Po aty. L.180–181). Me 7 dhjetor 1939 Beria, duke iu përgjigjur kësaj letrë, vëren: «...çështjet e përmendura janë shqyrtuar nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë të BRSS në periudhën midis viteve 1937–38 bazuar në ligjin e datës 1.XII-1934, në të cilin parashikohet shqyrtimi i çështjeve pa dëshmitarë», dhe bënte konkluzionin, se shkelja e ligjit ekzistues është jo i qëllimshëm dhe shqyrtimi i çështjeve të tilla duhet të mbetet prerogativë

e zhvendosur qendrën e përgjegjësisë për vendimet gjyqësore nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë - në Politbyro. Bëhet e qartë tani dhe se çfarë dënimesh më të përdorshme do të ketë paskëtaj me realizimin e drejtësisë partiake. Gjykuar sipas rezultateve, të vetmen masë të drejtë të ndëshkimit që njihnin anëtarët e Politbyrosë, ishte pushkatimi.

Nga shkurti i vitit 1937 nisi tashmë konfirmimi i regullt në Politbyro i listave të personave, dënimin e të cilëve pastaj duhet ta ligjëronte Këshilli Ushtarak i Gjykatës së Lartë. Ndërkaq procedura u bë edhe më ngushtë se sa në vitin 1936. Listat e dërguara i shihte dhe i miratonte vetë Stalini, para se t'ia dërgonte formalisht për vendim Politbyrosë. Roli i Politbyrosë u reduktua vetëm me votimin "pro" dhe nënshkrimin e listave të vdekjes. Kështu qe krijuar skema e gatshme: listat i hartonte dhe paraqiste NKVD (Jezhovi), i konfirmonin anëtarët e Politbyrosë dhe i jepte formën e prerë Këshilli Ushtarak i Gjykatës së Lartë (V.V. Ulrih). Listat që sillte NKVD bazoheshin sa në materialet e seksioneve të aparatit qendror, aq edhe mbi materialet e dërguara në qendër prej regjioneve.

Procedura gjyqësore qe reduktuar në maksimum; mbeteshin vetëm formalitetet. Kontrolli i dokumentacionit protokollar dëshmon, se e gjithë procedura dokumentale parapërgatitej para se të merrej në pyetje i arrestuari, ndërsa vetë dëgjimi i akuzës së një të arrestuari nuk duhet të hante më shumë se 5-10 minuta kohë. Gjatë kësaj kohe tre gjyqtarë gjoja ia dilnin "t'i shpjegojnë të pandehurit të drejtat e tij, të mbrohen nga akuza, t'i shpjegojnë të pandehurit thelbin e fajit të tij për "krimin e kryer", të dëgjojnë dëshminë e tij dhe të thonë fjalën e fundit. Mandej treshja tërhiqej në dhomën e gjykimit, shkruante vendimin e dënimit, të cilin nuk ia komunikonin të pandehurit. Këtë vendim të arrestuarit e merrnin vesh direkt në vendin e pushkatimit. Vetë vendi i pushkatimit konsiderohej sekret shtetëror dhe nuk mësohej asnjëherë, metodë të cilën e kopjuan përpikmërisht komunistët shqiptarë. Me urdhër të vetë Stalinit, pushkatimet masive të inteligjencies duhet të pasqyroheshin gjerësisht në shtypin lokal e qendror, për ta shndërruar ekzekutimin e armiqve në një spektakël politik e propagandistik. Përvoja shqiptare, siç e dimë, e përvetësoi plotësisht edhe këtë metodë.

Në listat e para, kryesisht, përfshiheshin emrat e kundërshtarëve të njohur, të cilit ose kishin qenë më parë në burg, ose ishin në internim. Të tillë ishin demokratët, liberal-demokratët, të majtë e të djathtë, eserët, shkrimtarët, shkencëtarët, intelektualët, gjithë përfaqësuesit e inteligjencies, që nuk kishin treguar ndonjë zell në përkrahjen e pushtetit leninist. Por më vonë këtyre listave e këtij mekanizmi iu shtuan edhe intelektualët e nomenklaturës, edhe udhëheqësit e partisë, të organeve të pushtetit, komsomolit dhe bashkimeve profesionale. Të preferuar në listat e zeza janë udhëheqësit e kulturës, arteve dhe shkencës, prej të cilëve nuk shpëtoi gjallë asnjëri. Vetëm nga listat e zeza të pushkatimeve që janë gjetur, pa përfshirë listat e

e Plenumit të Gjykatës së Lartë të BRSS (Po aty. L.182). Madje edhe pas vdekjes së Stalinit trashëgimtarët e tij nuk u nxituan të hiqnin dorë nga proceset e reduktuara gjyqësore dhe e shfrytëzuar këtë regull, për shembull, në dhjetor 1953 gjatë gjykimit të Berjas, megjithëse ky është veçse një shembull. Ligji i datës 01.12.1934 u anulua me Urdhër të Presidiumit të Gjykatës së Lartë vetëm me 19 prill 1956.

provincave ku pushkatimet bëheshin pas një gjyqi edhe më të shkurtuar, të kryesuar nga “trojkat” lokale - Prokurorë, shefa të NKVD dhe drejtues të policisë, - shifra e të pushkatuarve përgjatë viteve 1936-1938 shkon në 44 mijë e 500 njerëz të pafajshëm.

Enver Hoxha dhe Byroja Politike, e kishin praktikuar dhe më parë modelin e terrorit të importuar, kur pushkatuan më 22 shkurt 1951, 22 intelektualë pro-perëndimorë, duke u mbështetur mbi modelin e importuar të një ligji terrorist nga koha më gjakatare e Stalinit, pa shkak, pa gjyq, pa dëshmitarë dhe pa prova. Këta 22 intelektualë, vdekjen e të cilëve e firmosi vetë E. Hoxha ishin nga lista e tretë, e përpiluar nga Edip Çuçi, kryetar i degës II ka shumë emra, por me kryqin blu janë shënuar 15 emra. Pra gjithsej për t’u flijuar 22 vetë dhe këta janë: Sabiha Kasimati, Pjerin Guraziu, Anton Delhysa, Zyhdi Herri, Gafur Jegeni, Jonuz Kaceli, Manush Peshkëpia, Mehmet Shkupi, Niko Laze, Lluka Rashkoviç, Haki Kodra, Raiz Selfo, Myftar Jegeni, Thoma Katundi, Hekuran Troka, Qemal Kasaruho, Tefik Shehu, Gjon Temali, Fadil Dizdari, Petro Konomi, Pandeli Nova, Ali Qorralliu. Mbi gjakun e pafajshëm të njerëzve më të emancipuar të elitës sonë kombëtare u forcua kursi, besnikëria dhe servilizmi politik ndaj stalinizmit, duke përhapur frymën e terrorit okult mbi mbarë inteligjencien. Kjo krijoi me kohë një tipologji të intelektualit të nënshtruar, skllavit pro pushtetit, të terrorizuar psikikisht nga frika. Shkalla e thellë e degradimit dhe tëhuajësimit të ndërgjegjes, u bë baza e përpunimit mendor të brezave të tërë, të zombizuar tërësisht, çka çoi në fund të procesit përfitim të një qenijeje të deformuar e mutante, e cila i kishte humbur përfundimisht lidhjet me të Vërtetën. Intelektuali i këtij tipi, lindej e rritej me një besnikëri qeni, duke u shpërfytyruar përmes krimeve të quajtura “luftë klasash” e që në fakt nuk qe tjetër pos se përçarja më e madhe që ka ndodhur ndonjëherë në historinë e këtij kombi.

“Listat e zeza të vdekjes” qenë praktika që e shoqëroi pushtetin komunist të Enver Hoxhës dhe Ramiz Alisë deri në ditët e fundit të ekzistencës së diktaturës. Ato hartoheshin paskëtaj, për lehtësi studimi e manovrimi, nga Komitetet e Partive nëpër rrethe, krejt në analogji me KQ të PPSH. E kemi parë të funksionojë kjo masoneri në mbledhjet e mbyllura të Komiteteve, njëlloj si në seancat e sekteve satanike kur kryqëzojnë flinë e radhës. Kështu kanë vepruar me të ashtuquajturat “grupime armiqësore” jashtë “radhëve” të Partisë, si në rastin e pushkatimeve e varjeve të poetëve Trifon Xhagjika, Genc Leka, Vilson Blloshmi e deri në gusht të vitit 1988 me varjen e poetit Havzi Nela. Për grupimet “armiqësore” brenda KQ të PPSH merrej personalisht Enver Hoxha. Por një gjë është e padiskutueshme, siç na e ofrojnë sot arkivat: atë dënim që vendoste mbledhja sataniste e KP të partive nëpër rrethe, atë zbatonte përpikmërisht drejtësia e Degëve të Punëve të Brendshme, hetuesia, gjykatat dhe prokuroria. Ndërsa firmosja e këtyre listave me pushkatime, firmosej nga kryesatanai Hoxha dhe Alia, deri në vitin 1990, siç na bëjnë me dije dhjetëra të rinj të vrarë në kufi, në vitin e fundit të diktaturës.

“Kolonja ndëshkimore” e kampeve të internimit

“Partia - theksoi Kongresi - mendon se lufta e klasave, edhe pas likuidimit të klasave shfrytëzuese, mbetet një nga forcat kryesore lëvizëse të shoqërisë... Kjo luftë në socializëm, siç tregon dhe eksperiencia e vendit tonë, është një fenomen objektiv dhe i pashmangshëm. Lufta e klasave brenda vendit jo vetëm nuk ndërpritet e nuk shuhet, por bëhet edhe më e ashpër, valë-valë; ajo gërshetohet me luftën e klasave në frontin e jashtëm. Ajo përfshin të gjitha fushat e jetës”. Dhe “delikatja” Nexhmije Hoxha, shtonte: “Në përshtatje me shkallën e fajit, diktatura e proletariatit njërin e lë jashtë dhe e mban nën kontroll, tjetrin e fut në burg, njërin e dënon dy-tre vjet, një tjetër 10-20 vjet, tjetrin e pushkaton”. Pra “Shqipëria, Fanari ndriçues në brigjet e Adriatikut”, bija besnike e Stalinit, ende vazhdonte ta mbante pushkën ngrehur kundër qytetarëve të saj. Në luftë për të përjetësuar sundimin e saj dhe pasi kishte eliminuar të gjithë kundërshtarët potencialë, të mundshëm për ta kundërshtuar me forcë shakanë e hidhur të saj, Partia Komuniste e Shqipërisë vendosi të shpallë Shqipërinë, vendin e vetëm ateist në botë. Ashtu si të tjerat, edhe kjo ishte vepër e Enver Hoxhës, me të cilën ai imitonte Robespjerin (për fat të keq ai dinte frëngjisht), jakobinët, paraardhësit e komunizmit²⁰.

Ja ç’thotë teoria komuniste: “Zhdukja e kishave dhe xhamijave nuk e kishte zhdukur fenë si botëkuptim. Feja i zuri rrënjët shumë më të thella... krahas punës edukuese, qëllimit të zhdukjes së paragjyqimeve fetare. . . i shërbejnë të gjitha kushteve përkatëse materiale e morale nën procesin revolucionar të ndërtimit të plotë të shoqërisë socialiste... Me prishjen e vatrave fetare u shkatërruan baza të rëndësishme që helmonin jetën e njerëzve, që shërbenin edhe si vatra armiqësore”. Lufta e hapur dhe e fshehtë e diktaturës kundër fesë i kushtoi klerit musliman 60 myftinj e hoxhallarë të vrarë e të burgosur dhe nga 1650 xhami u ruajtën si monumente kulturore vetëm pesë, ndërsa të tjerat u rrafshuan ose u përdhuan; klerit katolik 100 klerikë të vrarë e të plagosur, të gjitha objektet e kultit të shembura ose të përdhunuara; gjithashtu me të njëjtën masë është prekur edhe kleri ortodoks²¹.

Burgjet pas pushtimit komunist mbinë si kërpudhat: në Shkodër 10, në Tiranë 5, në Durrës 3, në Vlorë 2, në Gjirokastrë 2, në Korçë 2 dhe kështu në të gjitha qytetet e Shqipërisë. Ndër ta më vrashtarët mund të përmendim burgun e Burrelit, për të cilin ekzistonte shprehja: “Burrel, hyn e nuk del”, që përveç regjimit të egër, torturave, infermieri i burgut, shpesh të “pabindurve”, me urdhër të drejtorisë, u injektonte në vena ajër dhe ata vdisnin nga hembolia; burgun e Gjirokastrës, burgun e Tiranës dhe burgun e Madh në Shkodër. Gjatë diktaturës, Shqipëria u mbush edhe me kampe përqendrimi, të përhershme ose provizore, sipas objekteve të bonifikimit ose industriale që u ngritën në Shqipëri.

Ndër to mund të përmendim: kampet e përqendrimit në Jubë (Durrës) Beden (Kavajë), Vloçisht e Orman-Pojan (Korçë), Bulqizë (Peshkopi), Batër Martanesh e Thekër (Burrel), Laçit (Laç), Qafë-Bari dhe Spaç (Mirditë),

²⁰ Xhafa Luan “Libri i zi i Komunizmit”, shtojca “Shqipëria”, Botimet Besa, Tiranë 2000.

²¹ Po aty

Kosovë (Lushnjë), Belsh (Elbasan), Ballsh, Sarandë, Tërbuf e të tjera e të tjera. Për të mësuar diçka për këto kampe famëkëqij le të shohim pjesë nga kujtimet e Atë Zef Pllumit në librin e tij memuaristik "Rrno vetëm për me tregue", për hapjen e kanalit kullues të Bedenit, që ishte 60 metra i gjerë e me dy bankina me nga 20 m secila²².

"Mbas atij burrit vinte Shyqyri Rrjodhi dhe drejtori i burgut të Shkodrës. Drejtor ishte Haxhi Pela, i cili u mbajti të burgosurve një fjalim "magistral". Ai u tha se puna e bëri majmunin njeri dhe autori vazhdon: "Puna asht lavdi. Si përfundim, delte se nuk ishim njerëz, por majmuna që me punë do të mrrishim me u ba njerëz... Megjithatë, Haxhi Pela në fjalimin e tij të gjatë teorik, leninist-stalinist mbërrijti në përfundimin praktik se duhet të përballojmë mjaft vështirësi të shkaktuara nga kapitalizmi botnor... Racioni ditor ishte 2 gr. vaj, 4 gr. makarona ose oriz dhe 10 gram sheqer... Na ndanë në 5 brigada, ndërsa ne priftërinjve katolikë na veçuan të gjithëve në një kompani. ...Na ishim 29 priftën...Dheu gërmohej me kazma e lopata, transportohej me karroca druni, dore, me rrota drunit, peshonte ma shumë karroca se dheu. Policët aty me shkop, sa herë që pengohej trafiku, sillshin mbi shpina njerzish të kthyem në kafshë pune. Vetëm në atë moment e kuptova kjartë si ishin ndërtue piramidat e Egjiptit... Ndërsa ishin disa të tjerë të burgosun skutha, që vetë punojshin pak, por që rrahshin të burgosunit e tjerë gjatë punës dhe mandej me ndërhyrje të brigadierit merrshin dy lugë te kazani i asaj gjelle të shplame: për ne ata ishin edhe ma tmerr se polici... Ishin ata pasi kryente orari 8 orësh i punës, bërtitshin me të madhe: "Për nder të shokut Stalin të bajm edhe një gjys ore sulm punë... "Për nder të shokut Tito një gjys ore sulm vullnetar!"... "Për shokun Enver... sulm vullnetar" ...Aty ngjat (kuzhinës) kishin ngulë në tokë dy shtylla me transversal pak më të shkurtë dhe në të lidhnin me pranga, tel ose konop, herë me kry naltë e ndonji herë me krye poshtë, ata të burgosun të cilët akuzoheshin se nuk kishin punue ose kishin thye disiplinën... E randë e padurueshme ishte ajo punë skllavësh që bajshim në kanal, por shumë ma i keq ishte ai terror kur merrnin atë gjellë të helmueme. Ka pasë raste që n'atë lloj kryqi, disa kanë dhanë shpirtin... Aty në atë kënetë kam pa me syt e mi At Geg Sumën që e kishin zhyt në ujë në mjedis të kënetës dhe dy të burgosun i hidhshin sipri llucë. Po të njajtën skenë me At Mark Harapin. Ka pasë raste që njerzit po njashtu i kanë mbulue me llucë e aty i kan lanë, sepse nuk mujshin me punue ma. Fuqitë tona tashma shkojshin me vrull drejt shterrjes... Nuk kishim ma asnji dyshim se të gjithë ishim dënue me vdekje mizore "me punë të detyruar". Pothuej ishte hapur një ndjenjë e përgjithshme ndër të burgosun që kjo të vinte sa ma parë, megjithëqë instinkti i vetëmbrojtjes jepte çfaqjet e veta. .. E si mund ta bante normën Atë Ciril Cani, që kishte kalue moshën 75-vjeçare? Kështu ishin dhe shumë priftën të vjetër ose shëndetpakë... Megjithkta, puna e kompanisë sonë ishte gjithmonë në shënjestër. Shyqyri Rrjodhi, zhdukjen tonë ia kishte ngarkue brigadierit... Osman... Në frontin e punës nuk kishim asnji pikë ujë. Atë sadopak ujë që na dajshin kur ktheheshim prej pune, ishte racioni për 24 orë: ndërsa ne vetëm djersë gjatë punës nxirrshim ma shumë se ai sapllak...

22 po aty

Tashmë ishim tepër të lodhun.

Trupat tona tue punue pa pushim kishin shterrue çdo rezervë të mbrendshme trupore. E shumta kishin mbetë të zhdedhun e të zbathun. Ne ishim shëndrrue të gjithë në një turmë leckamanësh të uritun: thirrshim të lum, ata që mund të kishin me përcjellë bukën. . .Njerzit filluen me ra e mos me u çue ma kurrë prej krevatit deri të jepshin shpirt. Kështu i ndodhi edhe Dom Nikollë Laskës. Ndërsa po ktheheshim prej pune në kamp ai ra përtokë... Dom Nikolli nuk vonoi me dekë. Ne nuk dijtëm se ku e varrosën. Kjo mënyrë vdekje u ba e zakonshme. Pat edhe asi rastesh, kur nuk lajmuen për vdekjen e vllaut ose të shokut të vet, ata që ishin afër, por e mbulojshin me batanije dhe e lejshin aty për me marrë një ditë racionin e bukës së tij e me shty vetë një ditë ma tepër jetë... Zija e bukës ishte shëndrrue në psikopati. Nji ditë po bisedojshin gjatë punës dy priftën: “A do të ketë në botë ndonji njeri që të nginjet me bukë”? Tjetri përgjigjej: “Sigurisht do të ketë. Unë nuk kam dyshim as për Papën as për Stalinin, se për të tjerët asht punë ndryshej...”. Në kamp filluan sëmundje pothuaj epidemike, të cilat nuk kursejshin jetën. Nuk kalonte ditë pa ndigjue se vdiq filani. Edhe Dom Nikollë Shelqeti kështu mbaroi... Në gjysë të tetorit kampi kishte pamjen e një grumbulli plehnash, i cili meritonte t’i vihej zjarrmi, për mos me përlye botën me mikrobe. Kërkush nuk ishte i zoti me ba normën që kërkujshin. Ata herojt e punës o kishin vdekë, o ishin në atë çadrën e vdekjes (Spitali, mjeku i të cilit për t’i mjekue kishte vetëm aspirina.). Njerzit ishin kthye në kafshë që tashma nuk muejshin me punue, rrijsim tue andrrue me gjetë një copë buke të mykun për me jetue edhe një ditë ma tepër. Kur vdiste ndokush, e para punë ishte me kqyrë a e ka kund racjonin e bukës... Prej makinash të lidhun ashtu si ishim, i lëshuem nji sy Bedenit atje përtej fushe. Atje mbetën eshtnat e shokëve tanë.

Na gjallë gjithnji. E (mbasi u kthyen nga kampi dhe i dërguen në burgun e Madh të Shkodrës... Ajo dita e takimit të parë kje nji tmerr për gjithë qytetin e Shkodrës: familjarët nuk i njifshin njerzit e vet dhe thërritshin: “Unë due filanin”, ndërsa këndej hekurash (të burgut) epej përgjegja: “Unë jam”. Kjo “unë jam” ishte e afërt, por mos me thanë e barabartë me “ecce homo”. Atëherë fillonte nji kujë e nji vaj. Dy minutshi fillonte e mbaronte me tmerr: njerz e skelete njerzish takoheshin përtej dy hekurash, mbrenda të cilve ruante polici “roje vigjilente” e demokracisë proletare.

Dhe në pranverën e vitit tjetër ata që i shpëtuan vdekjes i dërguan të punonin (të vdesin) në kampin e Kënetës së Maliqit. Por ndër kampe e burgje rezistenca ishte prezente dhe ridënimet ishin përgjigja e ashpër e diktaturës ndaj përpjekjeve për dinjitet dhe humanizëm”.

Kampet e internimeve - kampe të shfarosjes

E kemi të pamundur të përmendim hartën e gjenocidit komunist të kampeve të internimit me punë të detyruar, të shpërndarë si metastazat e kancerit në trupin e atdheut. Në këto kampe, që u ngjanin si dy pika uji kampeve naziste të shfarosjes, vdiqën fëmijë, gra e pleq nga mungesa e ushqimit, puna e rëndë dhe sëmundjet. Nga disa dhjetra dëshmi të jetuara dhe disa qindra që po mbledh Instituti ynë i Studimeve për Krimet dhe

Pasojat e Komunizmit, le të prezantojmë vetëm një, për të parë me sytë e një plake, që u mbijetoi tmerreve të pafundme të Kampeve të Internimit²³. Kjo është dëshmia e Asie Habilit (Elezi), vajza e Ramazan Habilit:²⁴

“Jemi internuar në momentin që e kanë marrë komunistët pushtetin e duhet të ketë qenë fillimi i vitit 1945. Kemi qenë Nanë Vathja (gruaja e Ramës - shën. ynë), unë, Xhevati, Qefserja, Mukadesi dhe Nexhmija (familja e ngushtë e Ramës - shën. ynë); pastaj ishin Pashja ose Nana e Tushes, (njerka e Ramës); Hallë Laja (motra e Ramës, e ve, e martuar me Beqir Gjocin - shën. ynë) bashkë me djalin e saj Osmanin; gjithashtu kishim Nafijen (e reja e Ramës, nusja e djalit, Hamidit), shtatzanë, si edhe xha Dalipi (vëllai i Ramës). Bashkë si grup kemi pasë edhe një grua me dy vajza nga Luzi i Kavajës, Dije Hoxha, e cila ishte e internuar për shkak se djali i tyre Mal Hoxha, ishte në arrati bashkë me Babë Ramën.

Në Berat kemi qëndruar rreth 4 vjet. Në fillim na futën në “Shtëpinë e Pashait” në lagjen Mangalem, pastaj më vonë në Kala të Beratit. Verës na çonin në Kuçovë të punonim në bujqësi ose punë që na caktonin, pa kurrfarë pagese, pra punë e detyruar, kurse dimrit na mbyllnin në Kala. Këtu na kanë vdekur dy fëmijë.

Kur ishim në Mangalem, vdiqën Nexhmija, motra e vogël tre vjeçe dhe Fatmira, vajza e vëllait tim Hamidit e Nafijes. Ne thonim të dëshpëruara, por dhe nga naiviteti i moshës, se ç’është ky emër Fatmira, kur kjo e paska pasë këtë fat kaq të zi! Por ajo vdiq shpejt, as 6 muajshe, për shkak të mungesës së ushqimit, qumështit, kushteve primitive ku jetonim.

Nexhi, mbaj mend që ka vdekur duke vjellë gjak nga goja për shumë kohë. Se çfarë sëmundjeje ka qenë, nuk mund ta them, s’e kam idenë. Këtu sëmuret edhe Mukadesi, që shkurt i thërrisnim Desi. Ajo kërkonte trajtim mjekësor dhe kushte spitali e jetese të mira, të cilat, ne që ishim në zgrip të ekzistencës, as që mund t’i përfytyronim. Desi enjtet në të gjithë trupin, me sa mbaj mend ishte problem i veshkave. Ndërkohë na komunikohet se do të na transferojnë në Tepelenë.

Kishim dëgjuar që ishte rrugë e keqe dhe e zorshme, prandaj Nanë Vathja i lutet doktorit që e mjekonte, ta mbante e ta shtronte Desin në spital, duke i

23 Dëshminë e ka marrë për Institutin tonë, nipi i Asije Habilit (Elezi), z. Neritan Kolgjini.

Këto fragmente të kësaj bisede të regjistruar botohen për herë të parë.

24 Ramazan Habili, nga Habilajt e Kavajës, i biri i Abaz Habilit, oficer kreshnik i Monarkisë së Mbretit Zog, familje e pasur dhe me emër në gjithë krahinën e vet, bajraktar, pjesëmarrës në mbrojtjen e organizuar në 7 prill 1939, i paangazhuar me ndonjë krah politik, deri në shtator 1943. Pas kësaj kohe, është bashkuar për 2 muaj në çetën e Myslym Pezës, ku konfrontohet me Kajo Karafilin dhe largohet përgjithmonë. I djegin shtëpinë çetat partizane të Sali Verdhtës dhe hakmerret brenda 24 orësh. Kjo shënon angazhimin e tij në politikë. Emërohet komandant i forcave ushatarake të Ballit Kombëtar për zonën e Kavajës. Njihet si burri që i vuri frë terrorit të komunistëve, pas vrasjes së Kajo Karafilin në Helmës të Kavajës. Kjo i dha famë, por njëkohësisht i krijoi armiq të shumtë nga të gjitha anët. Pas përfundimit të luftës, në 1944, ai shpallet armik, prandaj qëndron në arrati me një grup nacionalistësh, me shpresën se regjimi komunist do të rrëzohej. Ndiqet pa sukses për 7 vjet nga forcat e ndjekjes dhe për shkak se ishte shumë i përgatitur, për të thuheshin legjenda, si p.sh. “nuk e kap plumbi!” Në fakt ai vdiq prej helmimit që i kurdisi Sigurimi i Shtetit, nëpërmjet njerëzve të rrethit të tij miqësor. Në qershor 1951 gjendet i vdekur dhe kufomën e tij e marrin dhe e ekspozojnë për dy ditë në pazarin e Kavajës. Vendvarrimi edhe sot nuk i dihet.

qarë hallin si nënë dhe duke i rrëfyer vdekjen e fëmijëve të tjerë. Ai i përgjigjet se: “nuk mund ta dimë jetën e kësaj. Merreni me vete!” Ne e dimë se ishte e guximshme të bëje diçka të tillë, pasi Seksioni (i Degës së Brendshme - shën. ynë) nuk të lejonte, kur bëhej fjalë për familjen e një të internuari. Pas dy javësh, në Tepelenë, Desi dha shpirt në një gjendje të parrëfyeshme.

Doktori na kishte porositur që të mos e ushqenim me thartira, kripëra, djegësira etj., por ushqimi ynë ishte vetëm me të tilla, pra bukë me kripë, me shëllirë, ose bukë me presh. Mbaj mend që një ditë e gjeta Desin pas derës duke mbledhur e gëlltitur mbeturinat e “vaktit”, që ishin disa thërrime buke e bishta preshi të zverdhura, të cilat i kishim fshirë e bërë gati për t’i hedhur në plehra. E qortoj disi rëndë, madje duke i kujtuar edhe porosinë e doktorit! Por ah, si mund ta kuptoja unë adoleshente në atë kohë, se ajo ishte aq e uritur sa mblidhte edhe thërrimet bukës e bishtat e preshit të pangrënshme, që ne i kishim hedhur!

Mbaj mend se kur ishim në Berat, ajo shkonte përditë te Magia, zonja e shtëpisë, që kishte një tufë të vogël delesh. Ne i flisnim ashpër duke i kërkuar hesap pse?! Ajo na përgjigjej, – “më jep një lugë qumësht!” Desi e ndihmonte të nxirrte dhentë jashtë e t’i fuste përsëri në kasolle dhe Magia e shpërblente me një lugë qumësht.

Këtu sëmuret edhe Osmani, djali i hallë Lajes, i cili enjtet gjithashtu në të gjithë trupin. Ka qenë në moshë me vëllain tim Ragipin. Halla bën lutje për ta liruar, që për fat iu aprovua. Osmani vdes pas pak kohësh në shtëpi. Edhe djali tjetër, Sula i kishte vdekur dha ajo ngeli vetëm me vajzën, Filen. Por hallë Lajen do ta takonim në Tepelenë pak kohë më vonë, kur e internojnë për së dyti, bashkë me xha Dalipin, për shkak të takimeve që kishin pasur me Babë Ramën.

Neve na ngarkuan në një kamion, që shoqërohej me nga 3 policë secila, dhe kemi qenë nga 2 ose 3 familje në një makinë, në karroceri lart, zbuluar. Ishte verë të paktën. Kemi udhëtuar për shumë kohë e dikur mbërritëm të rraskapitur në Turan të Tepelenës, te kazermat e ushtrisë italiane.

Gjatë udhëtimit pati një aksident, një makinë u përmbys afër Roskovecit, nëse e mbaj mend, dhe vdesin dy prindërit, por shpëtojnë 4 fëmijët, të cilët “fluturuan” nëpër ferra. Më kujtohet babai i tyre që i ishte ngulur në trup një nga spondet e makinës, si ta kishin kryqëzuar! Tmerr ta shihje me sy atë skenë.

Në Tepelenë nuk e dinim ç’na priste, dhe as që e përfytyronim dot gjithsesi. Por, çfarë vuajtëm e hoqëm ishte jashtë çdo imagjinate. Na lanë 8 ditë rresh pa bukë dhe asnjë mundësi për t’u ushqyer. Njerëzit filluan të vdesin nga uria. Ndërkohë drurët e shkurret rrotull kampit u “pastruan” nga gjethet, që filluam t’i mbledhim e t’i ziejmë në formë lakrash, me një dorë oriz, sa për të shuar urinë. Filloi dizanteria në masë dhe kufiri që dallonte njeriun nga shtaza ishte shumë afër. Njerëzit u bënë si të çmendur e flisnin me vete.

Në këto kushte ne duhej të mendonim edhe për sëmundjen e Desit të vogël, 8 vjeçe. Ajo ishte e uritur dhe nuk kishim asgjë ç’t’i jepnim. Mbaj mend që i thoshte Nanë Dijes (Dije Hoxha, nga Luzi i Madh, e internuar me dy

vajzat, Bakushen dhe Dritën - shën.ynë), – “pse, nanë Dijs, kto laknat tueja zijnë mô shpejt?!...”

- “Ashtu!? Hajt Desi, se të jap nana ty lakna, tashi, menjherë!” I jepte nga pjesa e vajzave të veta, të sëmures Desi. Ne ishim gjashtë fëmijë, “laknat”, një përzjerje gjethesh rrushi të egër, ferrash e barishtesh, i vinim në sasi më të madhe çka kërkonte më shumë kohë të zienin, por Desi nuk priste dot.

Pas 8 ditësh urie të skajshme, filluan të na sjellin bukë misri nga Berati. Bukë kishte emrin, sepse në fakt ishte diçka si punë brumi, i mykur, gati jeshil, i papjekur fare dhe në sasi krejt të vogël për nevojat e njerëzve. Filluam ta racionojmë dhe ta ndajmë. I takonte pa ekzagjerim, një copë e barabartë me një kuti shkrepëse të sotme që mban 50 fije. A mund të rronte njeriu me këtë sasi ushqimi?!... Por vdekjet e shumta, në fakt sikur e lehtësuan disi këtë uri. Vdisnin mbi 8 ose 10 vetë në ditë. Kur vdisnin 3 ose 4, quhej ditë me pak të vdekur. Aty ishin 8 kazerma dhe për 2 muaj vdiqën, kush i mban mend sa njerëz, gjysma ndoshta.

Njëherë e shoh Desin që hëngri një racion tepër dhe si më e madhe, i them: - pse e hëngre edhe racionin tim? Ajo më sheh e trembur dhe si e habitur, ndërsa ndërhyr Nanë Vathja që thotë: –s’ka gjë, se unë nuk dua, le ta hajë Desi copën time!

Deri sa të vdes nuk më harrohen ato pamje kur ne s’kishim si ta ushqenim apo kuronim motrën tonë të vogël, e cila vdiq më shumë nga uria sesa nga sëmundja. Kushtet higjienike ishin të tmerrshme. Na jepnin mundësi vetëm një herë në javë të lanim rrobat në përrua, thjesht me ujë mali, pa sapun, detergjentë, etj.. Na shoqëronin e ruanin me policë, të cilët ishin ca ish-partizanë, që s’kishin asgjë të përbashkët me njeriun. Të internuarit i ndanë në 2 grupe, të aftët për punë dhe të pamundshmit, për shkak të moshës, etj. Neve që quheshim të rinj, unë dhe Ragipi, na dërguan në Memaliaj, ku punonim me kazmë për hapjen e rrugës automobilistike. Jetonim në çadra të ushtrisë.

Një mëngjez vjen një roje dhe më njofton se më kërkonte vëllai. Dal te rrethimi dhe takoj tim vëlla, Ragipin, i cili më thotë të bëhem gati e të shkoj në kamp, sepse kishte ardhur Dajë Hekri (Hekuran Saraçi - shën. ynë) që kishte porosi nga Babë Rama të mos kthehej pa i parë të gjithë fëmijët. Unë e kundërshtoj dhe i them: “po ti, pse nuk vjen?!” Ai më shpjegon se nuk e linin të ikte nga puna.

Nisem për në kazerma bashkë me një plak që na sillte ushqimin me kalë, i cili ishte nga Malësia e Shkodrës. Rrugës ai më pyeste se sa motra apo vëllezër kisha, sa vjeç ishin etj. etj.. Unë nuk po u jepja dum fjalëve të tij, megjithatë i thashë se jemi 3 motra e 3 vëllezër! Ai më pyeste për emrat e për moshën dhe gati më bezdisi me ato pyetje që unë i quaja trashanike! Kur afrohem afër kampit në Turan, aty dëgjoj zëra grash që pëshpërisnin: “Ja kësaj i ka vdekur motra!”

Nuk po e kuptoja dhe më dukej e pabesueshme që ato fjalë të ishin për mua! Kur mbërrij në kazermën nr.2 ku ishte familja ime, mësoj se Desi ishte varrosur! Filloj e ulërij dhe sot e kësaj dite nuk më del hidhërimi për humbjen e motrës. Doja të shkoja ta shihja edhe njëherë e këmbëngula të

hapnim varrin, sa për ta puthur për herë të fundit. Më sqaruan se e kishin futur direkt në tokë, pa arkivol apo "shulse", ose dërrasa varri që të mund të mbronin kufomën. Ma bënë të qartë se gjithë ato gurë e dhé e kishin prishur tashmë fytyrën e saj të njomë! Qaj aty deri sa s'më dilnin më lotë e kthehem me shpirtin copë në kazermë, ku vazhdonte jeta e internimit! Edhe sot, më thotë mendja, e di vendin ku është varrosur, në atë shpat kodre në Turan... Nanë Vathja kishte kërkuar t'i sillnin djalin, Ragipin, që të varroste të motrën, por nuk i dhanë leje. Desin e varrosën disa pleq që ishin ende gjallë. Vdekja e Desit në moshën 8 vjeçe na e rëndoi gjendjen shpirtërore dhe mbaj mend që shumicën e kohës unë e kaloja në vaj e lotë.

Nga Turani, në krye të vitit na hoqën e na çuan në kampin e Tepelenës, i përbërë nga 9 kazerma. Këtu ishim pak më mirë, sepse kishim krevate 2 katësh, kurse në Turan rrinim përtokë, pa kurrfarë shtrese apo izolimi. Ishim të rrethuar me tela, por mund të mblidhnim ndonjë dru apo rrënjë rrotull kampit sa për të gatuar diçka apo për të ngrënë "lakra". Kishim edhe njëfarë gjelle kazani që shpërndahej me racione për secilën familje. "Kazani" i gatimit ishte një vozë (fuçi) e prerë në mes dhe pjesa e poshtme shërbente për të gatuar. Ushqimi që na jepnin ishte një lëng i përfutur nga zierja e tre katër kg makarona tip babole (kërmill) që notonin në mbi 50 litra ujë. Nëse në racion të binte ndonjë "kërmill", ishte me fat, por zakonisht ishte thjesht ujë me kripë. Nganjëherë na e ndërronin menunë e na gatisnin presh të zier, zakonisht të palarë e me gjithë rrënjë e gjethe të kalbura.

Edhe këtu na shfrytëzonin në punë të detyrueshme duke na ngarkuar me dru zjarri që i zbrisnim nga mali i Bënçës, në kamp ose në rrugë të makinës, sipas kualitetit të druve. Në Bënçë na përdornin sikur të ishim kafshë pune dhe pa asnjë pikë respekti njerëzor e duke na fyer pa shkak. Një ditë, një dru më ra në këmbë dhe u plagosa keq për shumë kohë. Me zor ngjisja malin e kthehesha me barrën ngakuar me tërkuzë lidhur, si kafshë. Por këmba e vrarë me mundonte edhe më tepër. Dëgjoja rreth e rrotull të thonin: "Këta janë të sëmurë si familje! Po vdesin të gjithë! Edhe kjo s'e ka të gjatë!"

Mbay mend njëherë që ngarkova një barrë drush kazani, të holla dhe të lehta. Polici më pikas dhe më flet rëndë në një gjuhë që mezi e merrja vesh, ma ul barrën dhe e ngjesh mirë e mirë me këmbë për t'ia ulur volumin, por jo peshën. Pastaj ia merr barrën një gruajë tjetër, e bashkon me timen e m'i ngarkon të dyja në kurriz. Mbay mend që mezi e kam sjellë këtë barrë në kamp. Më rrinin pranë vajzat e Abaz Kupit, Hyrija dhe sidomos Bukurija e Lajde Miraka, të cilat më jepnin dorën e më ndihmonin! Edhe ato ishin të ngakuara si unë, por nuk më linin mbrapa. Kishte një rregull: kush nuk plotësonte normën, nuk lirohej nga puna, edhe sikur të errej e bëhej natë. Ndërsa kush plotësonte shpejt një metër-kub, kishte të drejtë të pushonte për pak kohë. Ky ishte shpërblimi!

Ju keni pasur edhe një vëlla që ju ka vdekur në Tepelenë...

Po, Xhevatini... Ju betohem që çastet e fundit të jetës së tij janë të pabesueshme, po të mos i kesh parë me sy. Unë qëllova fatkeqë që i kam parë e po jua rrëfej. Ishte muaji gusht, një vit pas vdekjes së Desit. Xhevatini e zu dizanteria, por nuk na tha. Për 2 ditë rresht shkante e vinte pa pushim në

banjot që ishin 40 m larg kazermës ku rrinim. Pastaj u dorëzua e i tha Nanë Vathes: “Jam keq, më dhemb barku, jam sëmurë!” Ajo e vizitoi te mjeku, në fakt një infermiere e kampit. Ajo konstaton se kishte dizanteri dhe thotë se do t’i bëjë inxheksione. Fillon kura, çdo ditë nga një gjilpërë, por asnjë efekt. Gjendja rëndohet. Vetëm 5 ditë munda të shkojë në banjo. Pastaj nuk çohet dot më nga krevati. Filloi të nxjerrë veç gjak nga zorrët, sepse nuk hante gjë. Nuk i treguam njeriu, sepse kishim frikë mos na nxirrnin nga kampi, pasi dizanteria është ngjitëse. Dy-tri ditët e fundit gjaku nuk pushonte. Nana ia lante lecat që ia vinim poshtë dyshekut, në çezme dhe na thoshte që kullonin shumë gjak, sikur të ishte ndonjë kafshë e therur, aq gjak rridhte. Ditën e fundit, kur po jep shpirt, vjen infermierja për të bërë adetin. Xhevati i thotë: “Kot vjen, nuk po më bôjnë gjô gjylponat e tuja! Nesër mos hajde mô!”

Pak kohë pasi ikën infermierja, ai kërkon një gotë ujë. Nana më thërret e thotë: “Hyr në krevat, merre e ngreje ndenjurr, që të pijë ujë më lehtë. Ulem në krevat, e sistemoj mes këmbëve të mia dhe ia fus krahët rreth trupit për ta mbajtur drejt, duke ia mbështetur kokën në gjoks. Afrohet nana dhe i zgjat filxhanin me ujë. Ai përcjell gllënjken e parë, ndërsa të dytën nuk e kalon dot, duke e derdhur buzëve anash. Nana në këtë çast e sheh mirë se çfarë ndodhi, por me të lehtë më thotë:

- Mbaje mirë, se po e zë gjumi! Shtrije me kujdes në shtrat!”

I bindem dhe kthehem duke e parë në fytyrë. M’u duk se ishte pakëz i ndryshuar dhe sikur i kishte rënë një hije e veçantë.

Në atë moment shoh nanën që t’ia mbyllte sytë e t’i thotë:

- Të keqen nona, shpejt më le! Kaq tesalallik (jetë të përbashkët - shën. ynë) paske pasë ti me mu!?

Në atë moment kuptova që vëllai kishte dhënë shpirt dhe ia dhashë kujës, sa besoj më kanë ndier në të gjitha kazermat. Xhevati u sëmur të premtën e dha shpirt të shtunën pas 8 ditësh! Ishte vetëm 13 vjeç. Nana nisat për në Drejtorinë e Kampit. Takohet me nëndrejtorin, i cili mbaj mend që quhej Syrja. E njofton se i ka vdekur djali dhe i lutet t’i thotë një polici të shkojë në Tepelenë sa për t’i blerë pak metra kambrik, për qefin.

Të internuarit nuk i linin të dilnin jashtë kampit. I drejtohet me fjalët:

- Zotni, më ka vdekur djali!

- Mirë e ka bërë! - i përgjigjet ai.

- Mirë, thua ti, por unë kam hall ta varros, e s’kam qefin! - i thotë nana e shkretë.

- Ka sa të duash fier, gur e dhé! – ia kthen zyrtari me emrin Syrja.

Nana kthehet në kazermë, gris disa rroba e sajton me to një qefin. Ndërkohë kishim lajmëruar një hoxhë, të internuar kuptohet, i cili i bën adetet xhenazes, sipas rregullit musliman duke e larë e pastruar. Ndërsa një plak tjetër na ndihmon të rregullojmë një arkivol, i cili u sajua prej një arke dërrase që kishim me vete. Kishim nijetin që t’ia merrnim eshtrat Xhevatit prej aty, e t’ia varrosnim në Kavajë. Një grup pleqsh, njësoj si në rastin e vdekjes së Desit, e morën dhe e çuan vëllain e vogël në varreza te këmbët e urës së Tepelenës, rreth 400 metra nga kampi. Varret ishin gati, s’kishte nevojë me i hapë. Edhe këtë xhenaze e fusin në tokë jashtë rregullit, duke

mos i vënë shulse apo dërrasa vorri, ndërsa arka që luante rolin e arkivolit është copëtuar me të rënë gurët e parë, duke ia shtrydhur trupin e copëtuar. Ne si muslimanë besojmë se trupi duhet ruajtur, pasi vetëm në krye të 40 ditëve ai fillon prishjen e dekompozimin.

Nana na urdhëron përsëri:

- Ecni të hajmë darkë! Ju kôm juve tash që ka ikë Xhevati! Ai ka shku në vend të vet! Nuk ôsht mir' të mos hajmë sonte, se i bôhet keq atij! Kishte varrosë 4 fëmijë të vetët e kishte frikë e shkreta se do t'i vdisnim edhe ne dy motrat që kishim ngelë! Nana e Tushes, njerka e Bab Ramës, s'levizte dot nga shtrati. Mallkonte veten që po rronte e po shihte vdekjen e fëmijëve.

Pas 6 muajsh vdiq edhe ajo dhe e varrosëm po te varreza e të internuarve. *Vëllai tjetër, ku ishte ndërkohë?*

Ragipi ishte në Vlorë, ku i kishin shpërndarë të internuarit dhe të rinjtë që kishin fizikun të fortë për punë. Ishin tre kampe, në Vlorë, në Fier e Lushnje. Ragipit i takoi të punonte në Vlorë. Prej andej na niste telegrame ku pyeste rreth shkaqeve të vdekjes së Xhevatit. Dyshonte se mund ta kishin vrrarë ose diçka e tillë. Por në fakt ai vdiq nga dizanteria dhe kushtet çnjerëzore që ishin në kampin e Tepelenës. Edhe Desi, edhe Xhevati, edhe Babë Rama kanë vdekur gjatë muajit të Ramazanit dhe Nanë Vathja, megjithëse ishin kushte të tmerrshme, ishte me agjënim. Ku e gjente atë besim e atë forcë shpirti ajo!? E habitshme... *Si shkoi fati i pjesëtarëve të tjerë të fisit që ishin me ju?*

Khaxhai, Dalipi, siç ju thashë, u internua bashkë me ne në Tepelenë, por pas torturash çnjerëzore në hetuesi, ku i kërkonin të tregonte se ku ishte Rama, ai ishte transformuar si njeri dhe nuk kuptonte se çfarë ndodhte përreth. Mund të them se e kishte humbur aftësinë e të gjykuarit kthjelltas dhe sidomos kishte një tmerr nga rroba e policit, apo thjesht t'i përmendje policinë, d.m.th. rrobën ushtarake. Ka shumë episode që mund të rrëfej, por më kujtohet që herë pas here ai rrinte kruspull e dridhej, duke thënë:

- Po vijnë të na marrin e të na pushkatojnë!

- Jo, - i thonim ne, - nuk do të marrin ty, por Ragipin, se ai është djali i Ramës. Mos u tremb...

- Jo, do na pushkatojnë të gjithëve, - e dridhej fort, kurse sytë i kishte të skuqur natë e ditë e nuk e zinte gjumi kurrë!

Atë e zhvendosën pastaj nga Tepelena në Porto Palermo, bashkë me hallë Lajen.

Kurse pas vrasjes së vëllait të madh që ishte në arrati, Hamidit, e shoqja e tij, Nafija, kërkon të lirohet, me arsyetimin që ajo tashmë nuk e ka më burrin e duhej të shkonte te prindët, por megjithatë nuk e lirojnë. Ajo u lirua bashkë me ne në fund të vitit 1951, pas helmimit që i kurdisën Bab Ramës, nëpërmjet njerëzve të Sigurimit. Nga gjithë familja ime shpëtuam gjallë vetëm nana, unë, motra dhe një vëlla, kurse 2 motra dhe 1 vëlla tjetër vdiqën në internim, ndërsa vëllai i madh dhe baba u vranë në mal. Po ashtu në internim vdiqën edhe disa kushërinj, siç ishte Osmani i hallë Lajes, si edhe vajza e vogël e vëllait, Fatmira, që ju tregova në fillim. Gjithsej, për shkak të Ramës, jemi internuar 15 vetë, prej të cilëve 5 vdiqën siç ju thashë..."

Kur Themida ka vetëm njërin sy të mbyllur... si piratët

Nuk kishim për qëllim të shpalonim në këtë introduktë gjithë gjatësinë, gjerësinë dhe thellësinë e tablosë së përzishme të terrorit komunist mbi qytetarët shqiptarë. Vetë viktimat e kësaj dhune mizore, që janë personazhet e këtij Fjalori, që nga ky vëllim i parë e deri në të tetin, do të na bindin se çfarë kilometrazhi të llahtartë vdekjeje e pengjesh të pangushëllimta njerëzore ka lënë prapa diktatura komuniste. Ne jemi munduar të sistemojmë disa nga tablotë e fiksuar tashmë nga studiues të ndryshëm²⁵, por më besoni: është ende shumë herët të flasim për bilancin tragjik të plojes komuniste mbi popullin shqiptar. "Historia është pëllhurë e endur nga duar të pafajshme - thoshte lordi Acton. - Nuk do të çlirohemi kurrë nga gjirizi, pasioni dhe çmenduria, ndjeshmëritë e tejkaluara dhe fanatizmi kanë për të na shoqëruar gjithmonë". Sot tekstet shkollore e universitare të historisë, letërsisë dhe shkencave humane në përgjithësi, nuk u janë larguar trajtimeve në frymën komuniste. Asnjë fjalë nuk thuhet mbi periudhën e komunizmit.

Taktika e historianëve zyrtarë, të cilët trashëguan monopolin mbi institucionet, katedrat dhe programimin dhe shkrimin e teksteve është e njohur, siç e kam shpjeguar dhe gjetkë: ata mjaftohen me *heshtje* me *mospërmendje* dhe në këtë mënyrë kujtojnë se do ta kapërcejnë e do të harrohet ajo çfarë ka ngjarë përgjatë diktaturës.

Nga ana tjetër nuk është amnezia që i ka zënë shqiptarët, por është qëndrimi djallëzor, ambivalent, mungesa e kurajos për t'u përballur me të vërtetat. Dhe kjo ka çuar në një situatë absurde: në Shqipëri nuk u dënua askush, përkundrazi, xhelatët u lanë të lirë të rifitojnë monopolet e dikurshme, të kenë sukses, të nderohen e t'u hapet rruga për karrierë... deri në Parlament. Të kryesojnë universitetet e katedrat; të udhëheqin institucionet e larta të shtetit. Askush askujt nuk i shqiptoi kurrë deri më sot një "më fal" të thjeshtë. Drejtësia dështoi. Viktimat janë braktisur mes mizerjes së vet, të fyer, të poshtëruar, të tradhëtuar, por qytetarë e njerëzor, që kurrë nuk e ngritën dorën të kërkojnë shpagë. Tashmë as reagim nuk ndesh kur ditën për diell mediat përcjellin zërin e viktimës që njohu kriminelin, torturuesin e tij, në majat e karrierës, si në rastin e mëposhtëm:

Në mediat tona të shkruara, opinioni ynë u ndesh këtë vit (2012) me dy gjeste reagimesh publike të natyrës paditëse-akuzuese. Shkrimi i parë - "*Titulli, dy profesorë padi Ministrisë*", me autorë dy pedagogë të Katedrës Juridike në shkollën e Ministrisë së Punëve të Brendshme akuzojnë Ministrinë e Arsimit se nuk u jepet titulli "Profesor". Njëri nga këta pedagogë është Kosta Gazeli, një njeri me karrierë kriminale gjatë komunizmit, njëherë si kryehetues, mandej si zëvendëskryetar i degës III dhe I në Drejtorinë e Hetuesisë dhe së mbrami, duke shënuar kulmin e kësaj karriere në organet e diktaturës komuniste, si zëvendësdrejtor dhe Drejtor i Drejtorisë së Hetuesisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Një trajektore konseguente që portretizon karrierën flagrante

²⁵ Jemi mbështetur kryesisht në literaturën e ofruar nga historiani Luan Xhafa, në kapitullin "Shqipëria", fashikull që përmbyll botimin në shqip të "Libri i zi i Komunizmit", Besa, Tiranë 2000. Gjithashtu jemi mbështetur në studimet e dokumentuara të historianit U. Butka, P. Pepa, A. Musta, etj.

të një kriminelit tribunalesh! Megjithatë, edukatori Kosta Gazeli, që përhap dijen, moralin dhe përvojën e tij bash në auditorët e asaj Ministrie ku dikur ka kryer torturat e krimet më çnjerëzore, edhe pas rënies së komunizmit, jo vetëm që nuk iu dorëzua asnjë tribunali, por paskësh pasur një karrierë të re në hapësirat e lirive demokratike - anëtar i KQZ-së në vitin e "paqtë" 1997 dhe fill më pas, zëvendës ambasador në Athinë!

Shkrimi i dytë akuzues me titullin "*Profesori kriminel*", është shkruar nga Gëzim Peshkëpia, ish i dënuar politik, biri i shkrimtarit Manush Peshkëpia, të pushkatuar pa gjyq me urdhër të KQ të PPSH më 26 shkurt 1951. Thelbi i shkrimit të z. Gëzim Peshkëpia është habia, tronditja dhe fyerja e thellë, se si ka mundësi që një gjakësor i tillë, torturuesi i tij personal në hetuesi, jo vetëm gjendet në elitën e kësaj ministrie si edukator i auditorëve me studentë, por padit Ministrinë e Arsimit për mosdhënien e titullit shkencor "*Profesor*". Sigurisht, sentenca latine "*O tempora, o mores*" është e pafuqishmë për çfarëdo habie në këtë rast dhe kujtesa e njerëzve të torturuar nga Kosta Gazelët nuk është kujtesë peshku. Kështu duhet kuptuar përvoja personale që sjell z. Gëzim Peshkëpia në këtë pasazh të shkrimit të tij, i cili, para se t'i drejtohet ish-persekutorit të tij, i drejtohet haptazi ndërgjegjes sonë:

"Ju pata pagëzuar dhe me nofkën Kasius Klei (ishte viti 1975). Kur ju quajta njëherë në sy të Nashos me këtë nofkë, ju u prishët në fytyrë se nuk ju pëlqeu, kurse kolegu juaj gjithashtu greqishtfolës më tha: E more, ky Kasius Klei, ti Xho Frezer, bëj njëherë dhjetëshen që të kemi taksur e po qe se del gjallë këtej kërkoni revanshin. Të pata rezistuar shumë raunde, por dy herë më hodhe nokaut. Herën e parë mbulova fytyrën, ndërsa ti me një haperkut më hodhe në dysheme, ku nxora dhe copat e lakrës e preshit, o zoti shkencëtaro-kriminel. Nashoja, ironik kur duhej, shtoi: me gjuhë do t'i lëpish pllakat, ta dish! Sidoqoftë ma kini borxh atë drekë të pasur që më shkoi kot. Nokauti i dytë pati për pasojë thyerjen e dhëmbit të qenit e çarjen e buzës. Gjaku më rodhi mbi xhaketë e përshkoi kanavacën e jakës që ishte e shqyer nga ju. Mendova ta shqep në sallën e gjyqit për t'u treguar të gjithëve se si isha trajtuar. Por më kot; gjyqi u zhvillua me dyer të mbyllura. Ju kam parasysh, ndërsa fshinit me gazetë dorën e gjakosur nga goja time shfrynit: Armik i poshtë! Ju thashë: Ah mor qen, a do ta mbante të më qëllonte sikur të isha i lirë? Të qëllonte që çke me të, - ju doli zot Nashoja, se ka atë të shkretën këtu dhe vuri dorën tek vendi i revoles. Ku i kishit mësuar ato perversitete? Nashoja qëllonte me majat e këpucës tek kërcinjtë e këmbëve, ndërsa ju më shkullnit qimet e gjoksit. Si ia bënit me ata që nuk ishin leshatorë? Me siguri, kreativiteti juaj kishte larmi. Estref Kërciku që kishte eksperiencë hetuesie ju kapi duart kur e qëlluat. Nuk e ngatë më. Ishit frikacakë. Në koncertin e Katja Riçarelit në Tiranë ju pashë poshtë në holl. Zbrita shkallët me shpejtësi për t'ju dalë para, por u zhdokët sikur ju përpiu dheu. Mos vallë u kujtuat për revanshin?"

Kështu duhet kuptuar akuza e një ish të burgosuri, që sheh xhelatin e tij, jo vetëm të bëjë karrierë, por të ketë luksin e arrogancës t'i bëjë shantazh Ministrisë së Arsimit, në emër të ligjeve të shtetit demokratik! Për fat të keq, e kemi prekur tabanin e ftohtë të indiferencës dhe ndjeshmëria jonë, jo se nuk është e jo se nuk ka qenë në nivelin moral të neverisë ndaj kriminelëve të tillë. Por ka zënë rrënjë një skepsis i thellë, e me sa shohim dhe nga ky rast i fundit, kuptojmë një të vërtetë të trishtuar: ish-kriminelët, përpos se nuk

dënohen, atyre, përkundrazi, iu ofrohet një perspektivë e begatë karriere dhe mbulohen me dafina zyrtare, për t'u shndërruar mandej, pashmangshëm, në simbole të vetëdijes qytetare për brezat që vijnë. Një makth antiutopik! Çfarë erë na pret vallë? Apo më mirë: çfarë presim ne prej gjithë kësaj historie të turpshme? Të mbyllim sytë? Të shtupojmë veshët? Të qepim gojën? Të ulim kokën e t'i justifikojmë duke tredhur në vetvete çdo nerv qytetar? Mos vallë kemi kaluar një proces vetëhipnotizimi dhe ndryshe nga përvojat e kulturave të tjera demokratike i kemi sajuar vetes rolin e një rasti *sui generis*-i shqiptar? Hynasha e Drejtësisë, Themida, e cila në imazhet antike paraqitet duke vendosur drejtësi me një peshore në pëllëmbë, ku thikat e saj janë në barabar, në ekuilibër të plotë, sytë i ka të lidhur me një shirit të zi. Ndërsa Themida jonë kur gjykon, si në rastin e krimeve të komunizmit, ka vetëm njërin sy të lidhur... si piratët.

Kontrata jonë me Djallin

As progresi teknik, as revolucioni postindustrial me bumin e teknologjisë së mjeteve të informimit, as situata morale postmoderniste me moskokëçarjen liberale si stil jetese – nuk e bëri njerëzimin aspak më të përgjegjshëm në raport me historinë, e madje – me historinë e tij më të afërt. Përkundër predikimit se “po jetojmë në kohën e rënies së ideologjive dhe kundërvënieve polare”, gjithë e më tepër po vërtetohet e kundërta: pema e ideologjive mbetet gjithëherë e blertë. Këtë e shohim nga lëvizjet naziskine në Perëndim dhe nga gjallërimi i mitit dhe idoleve të komunizmit në Lindjen ish-komuniste. Nazizmi dhe komunizmi si dy versione manipuluese me idenë e së Mirës, synojnë të rikthehen. Megjithatë, sot kujtesa historike nuk i kundron të njëjlojta këto dy forca të së Keqes. Nazizmi, pa marrë parasysh se është shpartalluar krejtësisht para gjysmë shekulli, vazhdon të ngjallë neverinë e merituar njësoj si më parë, pa u dobësuar me kalimin e kohës. Përkundrazi, komunizmi, edhe pse më i afërt dhe i freskët në kohë e në plagë, i përmbysur vetëm afro dy dhjetëvjeçarë më parë, gëzon të drejtën e amnezisë dhe amnistisë, të miratuar njëzëri. Madje miratimin e tij e shfaqin jo vetëm idhtarët e tij, që ekzistojnë ende, por edhe armiqtë e tij më të përбетuar, e ndonjëherë edhe viktimat. As njëra palë, as tjetra nuk e quajnë me vend ta trazojnë komunizmin nga harresa. Nganjëherë, menjëmend, arkivoli i Drakulës hapet. Kështu, në fund të vitit 1997, autorët e një vepre (“Libri i zi i Komunizmit”) guxuan të bëjnë bilancin e vdekjeve të shkaktuara nga komunizmi. Ata numëruan një shifër që luhatej midis 80-100 milionë njerëzve të vrarë. Skandali nuk vazhdoi gjatë dhe arkivoli u mbyll prapë, megjithëse shifrat nuk iu nënshtruan ndonjë përgënjeshtimi serioz. Siç shihet, kemi të bëjmë me një kontrast ndërmjet *pakujtesës* mbi komunizmin dhe *mbikujtesës* mbi nazizmin. Por siç e shprehëm më sipër, arkivoli i Drakulës hapet herë pas here, sado që ta nxjerrim jashtë vëmendjes komunizmin, sado që ne, të frymëzuar nga ëndrra për paqen sociale, të mos ua njohim krimet dhe përgjegjësitë komunistëve si shkaktarë të njëvlershëm me nazistët për nga shkalla e katastrofës njerëzore. Me 14 dhjetor 2010, gjashtë ministra të jashtëm të vendeve ish-komuniste

të BE, i kërkuan përmes një letre zyrtare komisioneres europianë për Çështje të Drejtësisë, Vivianë Reding, të dënojë “miratimin publik, mohimin dhe trivializimin e krimeve totalitare.” Matthew Newman, zëdhënës i Komisioneres së BE-së, thotë: “Ne e marrim shumë seriozisht këtë kërkesë. Krimet e regjimeve totalitare janë pjesë e kujtesës kolektive të Evropës”. Por për krimin duhet të vlejnjë të njëjtat norma, në të gjitha vendet me një të shkuar diktatoriale naziste dhe komuniste. Shqipëria për një gjysmë shekulli qe ndër vendet më të masakruara, e cila nuk mori asnjëherë asnjë iniciativë, qoftë edhe të brendshme. Edhe idetë e ardhura nga Europa me mesazh të qartë, herë-herë edhe sanksionues, paraqesin në praktikën tonë diskursive veçse trajtën e degjenerimit të tyre. Duke mos e patur as vullnetin, as ndjeshmërinë, e si rrjedhim as të kuptuarit adekuat, diskutimet për apel të ndërgjegjes përballë krimit historik nxjerrin në pah një gaz satanik, që nga foltoret e Kuvendit deri në mediumet vasale të politikës. Shqipëria mbetet vendi i blasfemisë morale ku shndërrohen në absurditet kategori e nocione të tilla si “katharsis”, “lustracion”, “ndërgjegje morale e historike”, “rishikim e rishkrim i historisë, letërsisë”, etj., etj., duke shpresuar se koha këtu ka një peshë të papërbalueshme plakjeje e harrimi. Këtu ngadhënjën gjithmonë profania mbi çdo aspekt të shenjtë. Përgjithësisht, nocionet e së shenjtës dhe raportet me të vërtetën dhe të drejtën janë relativizuar tashmë pakthyesëm në një mishmash llapaqenësh e demagogësh.

Letra e 14 dhjetorit 2010 e vendeve ish-komuniste të BE-së, e ka nismën tek iniciativa e Ministrit të Jashtëm lituanëz, Audronius Azubalis. Gjashtë ministrat e bazojnë këtë tek mohimi i Holokaustit, i cili është i dënueshëm si në Gjermani, ashtu edhe në shumë vende të tjera. “Mohimi i çdo krimi ndërkombëtar duhet t’u nënshtrohet të njëjtave norma, për të shmangur rehabilitimin dhe ringjalljen e ideologjive totalitare”, shkruan Azubalis. Ai është i bindur se shqetësimet e shteteve të reja anëtare të BE-së, por edhe e atyre që e mëtojnë këtë status në politikën e veta, duhet të merren seriozisht nga Brukseli. “Të gjithë i dinë krimet e nacional-socializmit, por vetëm një pjesë e Europës është e vetëdijshme për krimet e komunizmit”, thotë Azubalis. Një pozicionim i ngjashëm vjen edhe nga Ministri i Jashtëm çek, Karel Schwarzenberg. Ai është i mendimit se “të dy sistemet totalitare duhet të maten me të njëjtin kut. Për të, si Hitleri, ashtu edhe Stalini, kanë qenë vrasës dhe ata që u kanë shërbyer atyre janë bashkëfajtorë”.

Megjithatë, Komisioni European në Bruksel angazhohet për një reflektim dhe diskutim të gjerë, që në janar të këtij viti, për një shqyrtim e hetim të imtësishtëm për çështjen e ngritur në letrën e 14 dhjetorit prej 6 Ministrave të Jashtëm të vendeve rishtarë në BE.

Historiani dhe shkrimtari rumun Marius Oprea, ish-president i Institutit Shtetëror për Hetimin e Krimeve Komuniste në Rumani, drejton tani një organizatë joqeveritare me këtë objektiv dhe ka inicuar që në shkurt të 2010-ës të ashtuquajturën “Deklarata e Pragës” për këtë temë: “Ne kërkojmë që krimet komuniste të trajtohen njësoj si Holokausti, që do të thotë se krimet nga koha e regjimit komunist duhet të trajtohen para drejtësisë në të njëjtën mënyrë. Veprat e tyre nuk duhet të deklarohen se u ka kaluar koha; me këtë

problem konfrontohemi të gjithë në ish-vendet komuniste. Ne kërkojmë drejtësinë ligjore, jo vetëm dëmshpërblim moral. Ata që kanë kryer vrasje në emër të komunizmit, duhet të dënohen. Është e papranueshme që ne të jetojmë bashkë me vrasësit dhe kriminelët. Ata janë kriminelë që kanë kryer vrasje dhe tortura në emër të një ideologjie. Çfarë i dallon ata nga nazistët? Asgjë!”. Tani me këtë temë merret Komisioni në Bruksel. Ende nuk dihet nëse do të arrihet të shpallet ndalimi i mohimit të krimeve komuniste. Matthew Newman shprehet me kujdes: “Që kur kemi marrë kërkesën, jemi duke punuar në përpilimin e një raporti që do të përfundojë qysh këtë vit. Në këtë raport do të përcaktohet nëse jemi në gjendje të dënojmë njerëz që mohojnë krimet e regjimeve totalitare”.

Heshtja e errët e Lustracionit

Dështimi i Ligjit të Lustracionit është dëshmia më e qartë se në Shqipëri mungon vullneti elementar për të dënuar Krimet e Komunizmit. Pas dështimit të këtij ligji, askush nuk ka më as më të voglin dyshim se vetë përpjekja për shtrimin e kësaj çështjeje tejet të ndjeshme për moralin e shoqërisë sonë, për të shkuarën, të sotmen dhe të ardhmen e saj, ka qenë qysh në zanafillë dhe që në thelb të saj - një bllof, një lojë, një truk. Ashtu siç trukohen ndeshjet e futbollit, për shembull, ku spektakli në fushë është mashtrimtar, pasi “rezultati” është paravendosur ende pa filluar loja. Që nga rrëzimi i Ligjit nga Gjykata Kushtetuese (i shoqëruar deri në atë çast me kundërshtime të vazhdueshme nga opozita socialiste) e deri më sot kanë kaluar rreth tre vjet që nuk është bërë absolutisht asgjë. Të krijohet përshtypja se dy krahët e politikës shqiptare e shtruan çështjen “në parim” dhe, meqë ajo nuk gjeti zgjidhje, ia lëshuan mëkatet e “cjamin biblik” Gjykatës Kushtetuese. Ndërkaq, nuk pati më, për habinë e thellë, asnjë përpjekje të dytë për t’iu rikthyer kësaj çështjeje, megjithë udhëzimet e vazhdueshme nga politikat e BE, megjithë kërkesat e vazhdueshme nga shoqata, grupime dhe personalitete të së djathtës. E habitshme, sepse kishte bazë, arsye dhe motiv për ta rikthyer çështjen në Parlament, për shkakun e thjeshtë, se Gjykata Kushtetuese kishte ngritur disa pretendime, të cilat mund të ishin përmbushur, madje edhe ligjërisht, nëse do të kishte ekzistuar vullneti i mirë. Por harresa ra si një perde e errët, a thua se politika jonë aktive në Kuvend priste veçse një pretekst për ta mbyllur çështjen. Në këtë pikë, gjithçka përputhet me një tendencë bizarre, që ka formuar një traditë solide: çështjet e nxehta nuk mënjanojnë; përkundrazi, ato shtrohen, sa për të mos e akuzuar politikën tonë si të pandjeshme, indiferente. Por ama çështjet shtrohen me të vetmin qëllim: për t’i çaktivizuar! Këtë mënyrë sjelljeje e kemi parë jo vetëm në sallën e Parlamentit, por edhe në studiot tona televizive, të cilat konfigurohen në debatin e radhës me skenarë të gatshëm e me porosi nga “lart”. Për mua vazhdon të mbetet e habitshme, së paku, pozicioni i të djathtës, tek e cila shpresoj kryesisht për t’i dhënë një përgjigje apo zgjidhje kësaj heshtjeje anormalisht të gjatë në lidhje me Ligjin e Lustracionit. Madje mendoj se po heshtet me një nëntekst të tillë, të fuqishëm... Krejt çka na brengos është mungesa e çdo iniciative për t’i paraprirë këtij bllokimi me

një platformë të re; mungesa e interesimit me grupimet aleate të shoqërisë civile apo shoqatave antikomuniste, si aleatë natyralë e botëkuptimorë të së djathtës. Ose edhe më keq: shurdhëria dhe indiferenca e plotë e së djathtës, kur këtë platformë ia ofrojnë të gatshme, të ripunuar e të korrigjuar vetë këto shoqata e institute, siç ka ndodhur konkretisht. Përse vallë kjo mungesë dëshire për t'u përballur? Disa mendojnë se gjithë spektakli i dosjeve tre vjet më parë është bërë për të krijuar alibinë e një aksioni karshi BE-së dhe, mandej "larja e duarve" për rezultatin dështak.

Ndërsa rezolutat e Këshillit të Europës dhe udhëzimet e BE, përfshi dhe senatorët amerikanë, këmbëngulin në transparencën e shoqërisë përmes hapjes së dosjeve, në axhendën e Parlamentit shqiptar as që ndjehet pipëtimë. Utopia e re e "ëndrrës europiane" vazhdon prapë në kulmin e entuziazmit, duke u harlisur me retorika të kujdesshme. Presidentët radhazi japin kontributin e tyre simbolik, duke i bërë "refresh" vetëdijes sonë qytetare me dekorimet e radhës, kryesisht me persona që kanë qenë aktorë të diktaturës, sa duket tashmë qartë tendenca: Europës do të shkojmë t'i mbetemi në derë, jo vetëm me martirët tanë të lirisë, po domosdo edhe me vrasësit dhe xhelatët e tyre! Ja pra se çfarë epifanie! Të gjithë së bashku, xhelatë e viktima, të gjithë të nderuar, të gjithë pjesë përbërëse të vetëdijes dhe nderit tonë qytetar! Po, Shqipëria sot është kredhur në një heshtje të thellë, sikletosëse për të shkuarën e saj. Dhe heshtet, siç e thashë, me një nëntekst të tillë të fuqishëm... Drama morale e së djeshmes nuk çënon vetëm të djeshmen: ajo reflektohet në cilësinë e së sotmes, dhe akoma më shumë, do të mbajë peng të nesërmen. Diktatura kështu, paraqitet e restauruar, e revizionuar dhe padëmtuar: të njëjtët persona, të njëjtët aktorë, dolën kompaktësisht të shpëtuar dhe vijojnë rrugëtimin e tyre në hapësirën e molepsur të lirisë sonë, duke bërë të qetë biznesin e tyre, duke drejtuar katedrat e universiteteve apo departamentet e ministrive, duke udhëhequr misionet diplomatike, secili i nxitur të arrijë majën e triumfit të karrierës së tij.

Asnjë fjalë për çfarë ka ngjarë! Asnjë gjest! Asnjë kujdes për të pushkatuarit përroskave në mesnatë, asnjë lehtësim moral për të "mallkuarit" me burgim e internim: ata nuk i ka më kush në hesap, edhe pse njohin në rrugë, në zyrë, në ambasada, në ekran apo në foltoren e Parlamentit persekutorin e tyre! Drejtësia jonë ka ose të njëjtat fytyra të xhelatëve të tyre, ose fytyrat e bijve që kanë zëvendësuar etërit.

Në Shqipërinë e sotme, të lirë e me aspirata europiane, shumë më e vështirë qenka të gëlltitësh fyerjen dhe poshtërimin në heshtje. E nëse kjo (siç mundohet ndonjëri ta përligjë) u bëka për hir të paqes së përbashkët, atëherë a është e drejtë të pyesim: paqe për kë? Dhe cila do të jetë cilësia e kësaj "paqeje"? Kush janë ata që menjëmend duhet të falin në emër të paqes dhe, kryesorja, në cilat kondita? Po, heshtja ka me na kaplue të gjithëve, herët a vonë. Heshtja ka me e kaplue, herëdokur, krejt planetin, nëse llogaritë bëhen me Përjetësinë. Por brengosëse është se në mjedisin e një shoqërie që ëndërrojmë të ngremë, tani në Kohën tonë njerëzore, ata që kanë paguar më shtrenjtë për Lirinë, i kemi ishulluar me një heshtje vrastare e fyese, pikërisht Ata, viktimat dhe martirët që u munduan në ditët më të vështira të ekzistencës sonë të mbrojnë

sadopak me jetët e tyre dinjitetin tonë si popull, dinjitetin tonë kombëtar. Shqipëria dhe Maqedonia qenë të fundit shtete, shoqëritë e të cilëve nuk iu nënshtruan pastrimit nga e kaluara. Që prej muajit qershor 2012 edhe Maqedonia e hodhi hapin vendimtar dhe filloi jo vetëm hapjen e Dosjeve, por po i bën ato publike. Me sa duket, vendi i fundit që nuk pranon ta hedhë këtë hap, mbetet Shqipëria, e tëra e kredhur në heshtje. E me sa duket, shtrenjtë kemi për ta paguar faturën e kësaj heshtjeje, djallëzisht nënkuptuese.

Kuja e Mnemozinës

Kujtesa si organ psikologjik i përjetimit të kohës mbetet e vetmja ndërmjetëse që na garanton unitetin e thelbit të qenies, të projektuar në një shkallë vetënjohjeje individuale dhe kolektive. Fjala më konkretisht është për kujtesën historike apo kolektive, që deri më tash ekziston kryesisht në po ato forma, që e mendonin grekët e lashtë, në trajtën e *anamnezisit* dhe *mnemozinës*. “Nga perceptimet ndjesore lind, siç themi ne, aftësia e kujtesës, - thotë Arsitoteli. Ndërsa nga ndërmendjet e shpeshta për të njëjtën gjë lind përvoja, sepse një numër i madh kujtimesh përbëjnë së bashku njëfarë përvoje. Nga përvoja pra, nga tërësia e përvojës që ruhet në shpirt, nga përvoja e vetme, e ndryshme prej shumicës, nga përvoja vetjake, që paraqitet si identike në gjithë këtë shumësi, e ka zanafillën arti dhe shkenca: arti, nëse kemi të bëjmë me krijimin e diçkaje, dhe shkenca, nëse kemi të bëjmë me thelbin dhe esencën”²⁶. Në kulturën europiane *anamnezisi* ka hyrë kryesisht në atë kuptim të saj, siç e pati themeluar dhe përdorur Platoni: “Kur shpirti, që ka humbur kujtesën mbi ndjesitë apo dijet, e thërret sërish atë dhe përpiket ta përtërijë në vetvete, atëherë këtë ne e quajmë ndërmendje”²⁷.

Para pak kohësh me ra të kuvendoja me V.D, një piktor i mbijetuar nga burgjet dhe kamp-burgjet e komunizmit. Duke hamendësuar trysninë e përvojave të tij, e pyeta: “Si ballafaqohesh me kujtesën tënde në jetë dhe në krijimtari personale?”. Ai m’u përgjigj jo menjëherë, por në një mënyrë lakonike e kuptimplote: “Po bëhen 20 vjet që unë fle në dy krevate”. “Në ç’kuptim, - i thashë, - a mund të ma sqaroni?”. “E thjeshtë fare”, tha.

“Përfytyro: bie të fle në krevatin tim, në apartamentin tim, por gjithë natën endem në krevatet e qelive dhe kapanoneve të burgjeve. Habitem fort kur gjumi më del dhe e shoh veten prapë në krevatin e apartamentit tim”.

Ky dyshtresim paralel përvojash e sqaronte vetvetiu marrëdhënien e tij me kryemuzën e vet dhe pak a shumë, mund t’i merrja me mend çfarë frymëzimesh i sillte atij Mnemozina.

Doza e hidhur e fatkeqësive që i ra për short psikikës sonë kombëtare, në mënyrë të veçantë përgjatë shekullit XX, i ka pjekur frytet e helmëta në kujtesën individuale dhe kolektive. Me shembjen epokale të “perandorisë së të keqes”, doli në pah krijesa eksperimentale e saj, njeriu me kujtesë të shkalfitur në të tre përbërësit – të mnemesë, *anamnezisit* dhe *mnemozinës*.

²⁶ *Arsistoteli*. “Analitika e dytë” (Vtoraja analitika), kap. 19 100a// nga *Arsistotel*.

Vepra e plotë.

Vëll 2. Moskë.: Mendimi (Mysl), 1978. fq. 345.

²⁷ *Platon*. Thilebi, 34 c. // nga *Platon*. Vepra e plotë në 3 vëllime. Vëll 1. Moskë. Mendimi (Mysl), 1971. fq. 41.

Mnemozina jonë, pa arritur dot të krijojë mirëkuptim në përfitim e tërësisë së identitetit të origjinës me të tashmen, pa arritur të krijojë një lidhje ndërmjet vedi, një logjikë, qoftë të përftuar prej fragmenteve, endet e verbuar dhe e tromaksur nga drita e përvojës që përjetoi. Është pikërisht kjo dritë e përvojës së mënxyrshme ajo pjesa e Hadit me të cilën është mësuar, ngase nuk do t'i nxjerrë në sipërfaqe të Letës imazhet mëkatore të terrinës. Mnemozina jonë heterogjene shfaqet e çoroditur e kontradiktore në përditshmërinë tonë, duke e pllakosur atë herë me kujën e thellë dhe mallkimet, e herë me skërmitjen e marrë dhe me absurditetin frenetik, ashtu si figura e kërlëshur e mbretit Lir në shtrengatën e stepës. Një pjesë të poetëve të saj ajo u vjen si muzë e përvojës dhe ne përftojme një përmasë të saj si kujë, duke rindërtuar sipas plagëve kujtesën e të mbijetuarit për ta e për të vdekurit e tyre (at Zef Pllumi, Petro Marko, Uran Kalakulla, Fatos Lubonja, Pjetër Pepa, Ahmet Bushati, Arshi Pipa, Visar Zhiti, Uran Butka, Pjetër Arbnori, Agim Musta, etj.), ndërsa një pjesë tjetër ajo u vjen si ngërdheshje saturnale, për vete e për të gjithë të mbijetuarit e tyre (Ramiz Alia, Nexhmije Hoxha si dhe gjithë veglat e diktaturës, sahanlëpirësit e tyre, ish-ministrat me gjithë rekuizitën, me bëmat dhe nostalgjitë).

Kujtesën e ringjall përvoja e të mbijetuarve. Nga njëra anë, përrenj të flligësht narrative që përbëjnë epike më vete, derdhen dhe ushqejnë mediat e përditshme. Nga ana tjetër – kujtesa e marginalizuar dhe e sfumuar e breshërive të pushkatimit, e torturave të qelive, e privimit nga ekzistenca, e dhunës dhe e internimit. Një kujtesë lufton dhe eklipson kujtesën tjetër. Cilën kujtesë të pranojmë të na flasë? Çfarë kumti presim prej tyre? Cili është reflektimi ynë? Shpërngulet përballja e kujtesave nga sfera e përditës, duke e vetëprojektuar ekzistencën në vazhdimësi, tek e ardhmja: ajo lyp kohësimin e saj në historiografi, në art, në shkencë, në sistemin shkollor. Duket se sinoret e veta do t'i zgjerojë ajo kujtesë, që është më e ushtruar në sprint, në spektakël, në klip. Sprinti na magjeps me shkathtësinë, zhdërvjelltësinë, duke mos na lënë asnjë çast të kridhemi në meditim, por të shkasim në sipërfaqe të gazetës, të ekranit, për të ndjekur, të molepsur e pasivë, ritmin e këtij galopi marramendës. Kështu, narracioni e përshpejton kohën. Spektakli dhe klipi i studiove televizive na mbërthen në pritje ku endet dhe rrotullohet kinse njëfarë enigme e premtuar, që na lidh me deshifrimin e saj dhe na lë të zbrazët, këtë herë, duke e ndaluar kohën. Kjo është kujtesa mbizotëruese, që i rrok të dyja dinamikat e kohës: përshpejtimin, zgjatjen dhe pezullimin e saj. Është kujtesa e xhelatëve të mbijetuar, ngërdheshja satanike në karnavalin patësosur të përditshmërisë: ajo shumëfishon dhe klonon vetveten duke shpikur forma fetishizuese mbijetese e vazhdimësie, për të mos u kapur asnjëherë gafil. Ajo ndihet mirë në kushtet e shpërqendrimin që i japin mundësi të korruptojë agjentët teknologjikë, të krijojë aleanca më të fortifikuara në institucionet e kulturës, shkencës, politikës, ekonomisë - në instalimin dhe riprodhimin e imazhit të përgjithshëm publik, të bashkëpunimit, bashkëshoqërimit, ndërkalljes së idesë, se jemi një kujtesë me fat e përvojë të përbashkët, me ideal të përbashkët. Ja se si flet narrativa e kujtesës së xhelatit: "Boll u zhgënjem! Lavdi Zotit, utopia e re është prapë

përpara. Qëllimi i mirë, ëndërrimi i mirë, meqë nuk na shpuri në parajsën e komunizmit, tani do të shpjerë në parajsën europiane. Kush është armiku, pengesa, përçarja?

Ata pra... ATA, që po na e helmojnë të sotmen dhe po na e sterrosin të nesërmen. ATA me kokën prapa... që nuk duan ta shijojnë jetën. Tek e fundit, jo më kot janë pikërisht ATA, obskurantët, të paaftët, vulëhumburit, që nuk përfitojnë. Janë ATA që nuk ndahen nga fantazmat e tyre, që na hedhin hije në optimizmin tonë të përbashkët, duke na kujtuar plagët e moçme, fyerjet e parëndësishme, që kërkojnë të na mbajnë peng duke bubrruar të djeshmen pa kthim, të cilën ne së bashku e shembëm... se ku ishin ATA? Në burgje, në internime, të shtypur, sa as pika e gjakut s'u bëhej e gjallë. Të ishte për ATA, as një grimë nuk do të shembej "perandoria e së keqes", sepse as gishtin e vogël nuk mund ta lëviznin. Ashtu, të gërbulur në lotët e qurret e veta, ATA, të leckosurit, brengaxhinjtë, ankuesit e përjetshëm, të pagdhundur e të pashkolluar, nuk do ta nxirrnin kurrë qimen prej qullit. Dhe së fundi, çfarë duan KËTA mosmirënjohës? A nuk ua dhuruam NE lirinë? Le ta provojnë sa u vlen lëkura TANI në LIRI, po qe se vlejnë një grosh. ATA nuk e njohin ç'është liria. Nuk e dinë ç'do të thotë të gëzosh, të shijosh jetën e të përpiqesh t'ua përcjellësh atë brezave të tjerë, pa u qurravitur për skërkat e paemra ku prehen të parët e TYRE. Ç'faj paskemi ne? Mos duhet të vëmë thesin në kokë e të qajmë bashkë me TA me kuje e logori? Ne krijojmë pulsën e gjallë të kësaj jete. E ATA? Qajnë, rënkojnë, ankohen dhe duan para, para, para, kompensim, rehabilitim, vëmendje për të dëgjuar historitë e tyre me fantazma. Kujt i hyn në punë kujtesa e TYRE, dëshmime të TYRE, veprave të TYRE? Mos do të ndryshonte gjë vallë? Ne u japim mundësinë të rreshtohen krah nesh. U ofrojmë punë sipas aftësisë që kanë, e po u bindën, pse jo, edhe pushtet!"

Po kujtesa e viktimave të mbijetuara? Narrativa e saj bën dy jetë paralele: një të tashme, për inerci, dhe një jetë tjetër, të vegimit, traumës, hapësirës së pamatë të gjumit, e cila, me t'u mbyllur qerpikët, zbret shkallët me shpirtra e hije që kërkojnë të çlirohen nga harresa, duke u zhvendosur në hapësirat e pikëlluara të përvojave ku plasën farëra hidhërimesh pa ngushëllim. Duar, gjeste, fjalë, rënkime, pengje të një kohe tjetër, që lypin shpjegim, që pyesin, pyesin, pyesin... që kërkojnë të zbardhet e vërteta e tyre e netëve të zeza, kur drejtësia, mëshira dhe shpresa tek Zoti u reduktuan në një frazë të anktshme amaneti para plumbave, torturave mizore, kalbjes e plakjes nëpër qeli, shfytyrimit nëpër kampet e punës, poshtërimit, terrorit, dhunimit, degdisjes – gjithçka mbeti e tkurrur në një formulë amaneti – "Rrno vetëm për me tregue!". E narrativa e tyre është veçse monologu i shpërndarë, i përjashtuar, i shpërfillur, i fyer e i përbuzur, i dënuar të vdesë në heshtje bashkë me TA dhe të vërtetat e tyre. Narrativa e TYRE është një tekst pa vlerë për veshët tanë, që uturijnë e shungullojnë nga zhurma e marrë e galopit dhe spektaklit, sepse veshët tanë janë të pushtuar nga muzika e delirit dhe s'bën ta ndërpresim, s'bën ta ndërrojmë "stacionin".

Muzika e përzishme e funebre e funeralit na shpërqendron, na bën të biem nga ritmi galopant, na kthen në qenie mendore, ndërkaq që ne s'duhet të mendojmë: mendon Partia! A mund të na kthehet vallë, herëdokur në

veshë, kjo muzikë e ndaluar, e mohuar, e përjashtuar nga kujtesa jonë e tredhur? Me çfarë do t'i mbyllim vallë veshët, kur të na kthehet, tashmë me aht hakmarrës, si ndëshkim i sërishëm, i pamëshirshëm, me tërë piskamat e përvojave çnjerëzore të Hadit? A do të jemi në gjendje të përballemi vallë me kujën e mbledhur në grykë të Mnemozinës? Mjeshtëria e harrimit veçse do ta deformatë përvojën të marrë forma të përçudshme, derisa ta hedhë në erë depon e eksplozivit të pengjeve tona. Në Shtëpinë e Harrimit nuk mund të bujë ndërgjegjja. Bujtësi do të përballet me të shkuarën e krimit, sepse kujtesa e krimit nuk mund të shlyhet me asnjë spektakël narrativ. Krimi i shpërfillur dhe shpërfillja e krimit asgjësojnë çdo formacion moral të vetëdijes. Prej një vetëdijeje të tillë mbahet gjallë vetëmashtrimi kolektiv. Mnemozina jonë na frymëzon të përjetojmë dhe të përballim dy kujtesa të ndryshme: kujtesa e viktimës është e detyruar të riprodhojë kujën e saj, duke krijuar një narrativë ishullore, të papranuar në publik, ndërsa kujtesa e restauruar e xhelatëve, krijon narrativën dominuese me pedagogjikën e vet të mashtrimit dhe alibisë, duke likuiduar të parën.

Vend të tretë për marrëdhëniet tona me të vërtetën, nuk ka. Kjo të vjen ndërmend sa herë vijmë festat e nëntorit, kur demagogët e politikës së manipulimit danjë demonstrativisht kujtesat tona në një palë që duhen festuar dhe në një palë tjetër, që s' meritojnë të festohen. Paradoksi ynë i Mnemozinës! Kështu zbresin vertikalisht kujtesat tona, duke përshkuar të gjitha porët e hierarkisë së realiteteve kulturore, sidomos në shkencat letrare e historike.

Kush tha që kultura s' është politikë? Që strofilla me e sigurtë e demagogjisë politike nuk është kultura? Që në kohën e "rënies së ideologjive", këtë rol nuk e luan kultura? Teksti i saj mbërrin tek ne si kujtesë dhe si pakujtesë. Mnemozina na dikton kujën e saj: dikush dëgjon, dikush mbyll veshët, pavarësisht, se një ditë të gjithë e dëgjojmë, me të vetmin ndryshim: dikush më herët, dikush më vonë...

Çdo viktimë e terrorit komunist akuzon

Duke i mbyllur këto shënime hyrëse për të parin prej 8 vëllimeve të "Fjalorit Enciklopedik të Viktimave të Terrorit Komunist", dëshiroj që çdokush që merr në dorë këtë vëllim dhe të tjerët që do të vijojnë të lexojnë radhë radhë e kursyer që prezantojnë jetëshkrimin dhe të dhënat e viktimave (si të atyre që s'janë më në këtë jetë dhe që as varri nuk u dihet, si të atyre pak vetave që u kanë mbijetuar tmerreve të komunizmit), të ndalet pak dhe të meditojë, jo mbi personin e njohur apo të panjohur, por mbi fatin e njeriut në përgjithësi. Po më së pari le të ndalet e të meditojë mbi frakturën e këputur të njeriut në veçanti, njeriut në vetë të parë, sikur të ishte, në rastin më diskret, ati, nëna, vëllai, gjyshi mjekërbardhë a gjyshja zemërebëmbël apo së paku, miku i fëmijërisë, me të cilin ka ndarë lotët e humbjes a gëzimit. Sepse realisht, fati i tyre thyhet këtu; sytë e mbushur me dhé, jetët e tyre të pambrojtura e të këputura dhunshëm, po aq sa dhe sytë e gjallë, të venitur e të zbrazur nga zhgënjimi e çmeritja, që shpresuan, por nuk e ndeshën kund mirëkuptimin tonë, kërkojnë një përgjigje prej nesh. Sepse prej tyre, të gjallë e të vdekur, vendin që lanë bosh, e gjejnë sot edhe më të zbrazët. Prej kësaj

zbrazëtire të akullt fryn indiferenca jonë, mungesa e ndjeshmërisë, mungesa e dëshirës për të kuvenduar me idenë që përfaqësuan ata para, gjatë dhe pas tehut të gijotinës. Ky Fjalor mëton me modesti të mbushë sadopak, pikërisht atë vend të zbrazët që la mes nesh secili prej tyre veç e veç në zgafellën e dhimbjes, trishtimit dhe pikëllimit popullor të të gjithë martirëve së bashku. Për kujtimin e tyre sot ende nuk e kemi një përmendore, ende nuk e kemi një muze... dhe i pamundur do të ishte, sepse, nese imagjinojmë një muze të tillë, muret e tij rrotullare do të mbështillnin krejt trupin e drobitur të atdheut tonë, që e lanë, ashtu siç thotë një poet i pushkatuar, *të drobitur e lakuriq*.

A kemi vallë përgjegjësi ndaj tyre? A dimë t'u përgjigjemi? Dhe nëse nuk kemi përgjigje, a dimë vallë së paku të shtrojmë një pyetje për ta, për kujtimin e tyre, të vetmin shembull të dinjitetit njerëzor e kombëtar që na lanë si pajë, duke lënë peng jetët e tyre, shpresat dhe të ardhmen e tyre? Dhe pyetja që duhet të shtrojmë drejt e të na shqetësojë gjetja e përgjigjes së saj është kjo: Çfarë u bë me individin, - jo me atë të rrethuarin me kult, por me atë individ, me gjithkënd, përtej të cilit mbeti veçse një vërtetim mbi rehabilitimin pas vdekjes? Ku shkoi, ç'u bë, ku është varrosur kjo vetësi, ky individ? Çfarë u bë me njeriun, çfarë përjetoj ai, duke filluar nga minuti kur e nxorën dhe e morën nga shtëpia e duke mbaruar në minutin kur ai iu kthye familjes dhe të afërmve në trajtën e një dëshmie, një vërtetimi, një qeske najloni me kocka? Çfarë u bë me njeriun, atë që nuk u kthye fare e s'dihet ku i prehen eshtrat? Çfarë u bë me babain, vëllanë tonë, motrën tonë, që nga dita kur u hodhën prangat, duke i marrë me vete në mesnatë, për të mos u kthyer më kurrë? Po me atë tjetrin, që i hodhën prangat ditën për diell dhe me një zë skërmitës, në mes të klasës me nxënës, i thanë: "Në emër të popullit, je i arrestuar"? Po me atë që prangat ia hodhën në vendin e punës, në kafene apo në shëtitore? Dhe nëse ktheu i gjallë mes nesh, atëherë sa, sa i gjallë është kthyer? A mund të ngjitet më jeta e tij, fati i tij?

Këto dhjetëra mijëra, qindra mijëra jetë, që do t'i ndeshni nëpër faqet e Fjalorit nuk janë hije, ndonëse deshën t'i kthejnë hije për së gjalli. Na kanë mbetur vetëm emrat dhe *dëshmitë e penalitetit* për "mëkatin" e lirisë dhe mosnënshtrimin. Shumë prej tyre nuk kanë as dëshmi, as varre, vetëm vendet bosh në zemrat e të afërmve të tyre, zbrazëtire që nuk e mbushin as lotët e derdhur të të afërve, as mendimet e as shpresat që vyshken, për ndonjë grusht hi prej trupit të tyre.

Për shumë prej tyre shteti komunist nuk u kujdes as me një pusullë shënimi kur qëlloi mbi ta në mesnatë. Për shumë të tjerë nuk gjenden as dëshmitë e penalitetit. Dosjet dhe dokumentacioni mbi ta në arkiva nuk dëshmojnë asnjë informacion. Shpesh gjykatat ushtarake të rretheve merreshin me procesin e dënimit dhe kjo na e ka vështirësuar mjaft punën gjatë këtij vëllimi të Fjalorit. Ne jemi të bindur se jo të gjithë zërat e të dënuarve sipas alfabetit janë gjetur. Në vëllimin e tetë përmbyllës, do t'i japim kohë vetes për të gjitha përplotësimet. Ndërkaq, në formulimin e aktakuzës së të dënuarve, e cila nga viti 1945 deri në vitin 1955 shoqërohej gjithnjë me konfiskimin e pasurisë, kemi formulime ambivalente. Shpesh përzierja e neneve tek të dënuarit politikë shoqërohej kastile me poshtërime të përllogaritura. Për ta

ulur figurën e kundërshtarit, drejtësia komuniste bashkë me nenet politike sajonte djallëzisht fajësi të sajua turpëruese për vjedhje ose imoralizma. Kuptohet, bashkangjitja e këtyre neneve ordinere synonte të ulte në sytë e shoqërisë profilin e kundërshtarit të sistemit.

Gjatë leximit të jetëshkrimeve të shkurtra të viktimave, ju do të ndeshni absurditete, mospërkime, alogjizma. Ato kanë për qëllim diskreditimin dhe propagandimin e kundërshtarit si karakter, përveçse armiqësor, po aq edhe të rrezikshëm moralisht, një përbindësh dhe strehë e të gjitha veseve. Për të internuarit, që si rregull ishin familjarët e një prej të burgosurve apo të arratisurve, ka të dhëna të kufizuara për numrin. Kjo sepse pushteti llogariste vetëm kryefamiljarin. Kësodore, numri i të internuarve del nga dokumentacioni rreth katër herë më i madh nga ç'është regjistruar. Të tre kategoritë e viktimave që merren në shqyrtim në Fjalor (të pushkatuar, të burgosur, të internuar) shkon rreth 250-300 mijë zëra; nëse do t'i numëronim edhe pjesëtarët e tjerë të familjes dhe jo vetëm kryefamiljarin, atëherë kjo shifër do të kërcente shumë lart. Duke patur parasysh popullsinë e Shqipërisë, rreth 800 mijë banorë në fund të luftës dhe 3 milionë në vitin 1990, atëherë na përftohet një hartë e llahtarshme e persekutimit, po të kemi parasysh që çdo i dënuar ka një familje me rreth 3-4 anëtarë. Dhe pikërisht këta vëllezër e motra nuk do ta ngrinin më kokën për të ecur në jetë e për të ndjekur dëshirat e tyre, përderisa do të ishin përjetësisht të damkosur me biografi të keqe. Pra, na përftohet një mesatare e tillë, ku mbi gjysma e popullsisë shqiptare është me biografi të keqe dhe luftohet si klasë: nuk u jepet e drejta e studimeve të larta, nuk zënë vende pune, përveçse në hierarkitë më të ulëta, deri në mospranimin dhe refuzimin e martesave për shkaqe biografie.

Duke i nxjerrë nga harresa këto emra viktimash e matirësh, ne i parashtrijmë lexuesit të njihet shkurtimisht me secilin prej tyre. Emrat e tyre nuk janë enë të zbrazëta, nuk janë vargan hijesh e fantazmash, porse secila viktimitë është një akuzë. "Muza e historisë është e butë, e përkorë dhe pa pretendime, shkruante Leshek Kollakovski, ama kur ndjehet e braktisur dhe pa kujdes, kërkon hakmarrje dhe i verbon të gjithë ata që e përçmojnë".

Tiranë me 23 nëntor 2012

Doc. Dr. Agron TUFA,

*Drejtor ekzekutiv i Institutit të Studimeve
për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit.*

FALENDERIMET E VEÇANTA TË "INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT" (ISKK) I TAKOJNË:

1. Bordit Drejtues dhe Këshillit Shkencor të Institutit për konsultën e vazhdueshme gjatë hartimit të Fjalorit.
2. Znj. Nevila Nika, titullare e Arkivit Qëndror të Shtetit, për dashamirësinë dhe ndihmën e pakursyer në shfytëzimin e arkivit.
3. Z. Kastriot Dervishi për ndihmën e pakursyer me shfrytëzimin e arkivave të Ministrisë së Punëve të Brendshme.
4. Z. Simon Miraka dhe Institutit të Integritit të ish-të Përndjekurve Politikë, për ndihmën me materiale arkivore.
5. Z. Gazmend Dibra në emër të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të Shqipërisë për mundësimin e "Dëshmime penale".
6. Një falenderim personal të veçantë për z. Uran Butka dhe z. Agim Musta për kontributin e tyre personal gjatë punës së hartimit të Fjalorit.

KRITERET E HARTIMIT

Hartim i këtij Fjalori enciklopedik nisët nga një ide e thjeshtë: në mbarim të çdo lufte, veprimi i parë që kryhet, është numërimi i viktimave, hartimi i një liste zyrtare të viktimave. Nën një rregjim terrori, i cili zgjati për afër 50 vjet, përmasat e plogjës tejkalojnë çdo betejë të thjeshtë. Prandaj, duke patur parasysh se nuk ekziston një detabazë e plotë e viktimave që shkaktoi persekutimi komunist (përveç të dhënave të vitit 1993) që nga prishja e marrëveshjes së Mukjes, ISKK vendosi të fillojë projektin e këtij Fjalori në shtatë vëllime plus një vëllim me shtojca e plotësime. Më këtë projekt të Fjalorit, ne synojmë, përveç një evidentimi të viktimave që iu nënshtruan represionit ideologjik dhe luftës së klasave, edhe nevojën për krijimin e një detabaze të të dhënave të plota mbi qytetarët e persekutuar politikisht nga regjimi.

Ky Fjalor Enciklopedik merr në shqyrtim të imtësishëm pa përjashtim çdo qytetar që iu nënshtrua përndjekjes direkte, pavarësisht nga funksionet apo përkatësia social-politike që ka patur para dhe gjatë regjimit komunist.

Fjalori do t'u përmbahet rigorozisht kriterëve të mëposhtme metodologjike:

1. Neutraliteti në trajtimin e thukët të informacionit për çdo njësi (zë) të Fjalorit, duke respektuar stilistikën adekuate të Fjalorëve enciklopedikë të këtyre llojeve dhe duke shmangur subjektivitetin në trajtimin e informacionit. Për këtë qëllim janë konsultuar disa modele të Fjalorëve kombëtarë dhe ndërkombëtarë, duke patur parasysh specifikat e rasteve shqiptare .

2. Pasqyrimin sipas niveleve të rëndësisë së çdonjërit zë (njësi). Rëndësia si koncept në trajtimin e zërave rrjedh vetvetiu nga shkalla e aktivitetit dhe informacion biografik të secilit të persekutuar. Kësisoj paraqitja e zërave në Fjalor, është realizuar në tre shkallë: a) ish-funksionarë politikë (ministra, zv/ministra, deputetë, ambasadorë të shtetit shqiptar para dhe pas vitit 1944); b) klerikë, intelektualë – kundërshtarë të regjimit; c) qytetarë të thjeshtë, që në një mënyrë a në një tjetër iu nënshtruan persekutimit komunist.

3. Paanësia dhe rezervimi në etiketime apo dhënie konsideratash subjektive në raport me personalitetin apo domethënien e secilit prej personave të përfshirë në të.

4. Ndërmjetësia e detyrueshme e «Dëshmime të penalitetit» për çdo zë (përveç rasteve kur ajo mungon ose ka qenë e pamundur të gjendet në arkiva), si provë e konfirmuar juridike e dënimit zyrtar nga shteti komunist. Për rastet kur këto dëshmi mungojnë (pushkatimet pa gjyq), kemi shfrytëzuar burime të tjera dokumentare dhe memuaristike të dëshmitarëve dhe familjarëve të viktimave («Gazeta zyrtare», gazetatat e kohës pa përjashtim, Listat e të

Pushkatuarve të hartuara në Ministria e Punëve të Brendshme dhe gjithë format e tjera të dëshmime memuaristike).

5. Seleksionimi nga dosjet gjyësore i atyre rasteve që përbëjnë krim shtetëror për standardet politike të asaj kohe (tradhëti ndaj atdheut me gjithë larminë e akuzave, që përbënin bazën ligjore të këtij «krimi», agitacion propagandë, sabotim dhe dëmtim i pronës socialiste plus përvetësim pasurie, dekadentizëm, degradim moral, shfaqje të huaja dhe ndikim nga bota borgjezo-revizioniste, përmbysje me dhunë e pushtetit popullor, diversion, tentativat për atentate, revizionizëm, oportunitizëm, liberalizëm brenda PPSH, etj., etj.).

6. Respektimi, kriticizmi dhe përqasja e çdo burimi të informacionit për çdo zë.

Redaksia

A

ABATI Kel

Nëpunës i Bankës së Shtetit në Shkodër. U pushkatua më 18 korrik të vitit 1946 për «difiçit», bashkë me Don Alfons Trackin [shih], Kolë Ashikun [shih] dhe Nikollë Prengë Dedajn [shih].

Fritz Radovani – de Angeliis, *Një monument nën dhé*, Melbourne, 2004, II, f. 100; IV, f. 265.

ABAZAJ Zeman

Lindi më 12 mars të vitit 1908, në fshatin Psar të Përmetit. Më 16 korrik të vitit 1956, Gjykata e Rrethit të Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor», dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar). Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 20 gusht të po atij viti. U lirua më 3 nëntor 1960.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 450.

ABAZI Abdulla

Lindi më 3 prill të vitit 1907, në Durrës. Më 1 nëntor të vitit 1945, Komisioni i Hetimeve të Krimeve të Luftës e deklaroi fajtor «se ka bashkëpunuar me okupatorin, ka penguar forcimin e Këshillit Nacionalçlirimtar» dhe e dënoi me dy vjet heqje lirie. Katër vjet më vonë, më 27 shtator 1949, Gjykata e Lartë Speciale e deklaroi fajtor për të njëjtat akuza, dhe «se nuk ka kryer detyrimin si bashkëpunëtor i Sigurimit të Shtetit, ka tradhëtuar këto organe dhe dekonspiruar sekretin me elementë të tjerë, ka organizuar arratisjen e tij në Jugosllavi» dhe e dënoi me vdekje, pushkatim.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 451.

ABAZI Alush

Lindi më 14 gusht të vitit 1903 në Elbasan. U vra pa gjyq për arsye politike, më 11 nëntor 1944 në Elbasan.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 171, 172.

ABAZI Bahri

Lindi më 20 prill të vitit 1928, në fshatin Tatzat të Delvinës. Më 3 shkurt të vitit 1977, Gjykata e Rrethit të Sarandës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundë pushtetit popullor» dhe e dënoi me 14 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 452.

ABAZI Demir

Lindi më 20 janar të vitit 1948, në qytetin e Tiranës. Më 7 prill 1967, Gjykata e Qarkut të Tiranës e deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje jashtë shtetit», dhe e dënoi me dhjetë vjet heqje lirie. Vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

ABAZI Haxhi

Lindi më 13 shkurt të vitit 1908, në fshatin Janjar të Sarandës. Më 23 maj të vitit 1964, Gjykata e Beratit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 453.

ABAZI Mehmet

Lindi më 19 maj të vitit 1891, në fshatin Tatzat të Delvinës. U arrestua më 1945, dhe më 21 shtator të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Delvinës e deklaroi fajtor «si kriminel luftime: Është hedhur vullnetarisht në organizatën tradhëtare të Ballit Kombëtar, ka marrë pjesë me armë në të gjitha operacionet e kryera prej gjermano-ballistëve etj.» Dhe për këto arsye, e dënoi «me vdekje, me humbjen e të drejtave qytetare e politike dhe me konfiskimin e pasurisë së tij të luajtshme dhe të paluajtshme». Dënimi me vdekje u aprovua edhe nga Gjykata e Lartë Ushtarake me vendimin nr. 291, datë 25. 9. 1945. U ekzekutua më 16 prill 1947.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 58, 59.

ABAZI Mezan

Lindi më 29 prill të vitit 1954, në Elbasan. Më 14 dhjetor të vitit 1978, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë. U lirua më 28 tetor 1982. U arrestua sërish një vit më vonë, dhe më 3 gusht 1983, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «tradhti ndaj atdheut mbetur në tentativë» dhe e dënoi me 22 vjet heqje lirie, 5 vjet internim dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 454.

ABAZI Nazif

Lindi më 2 shkurt të vitit 1918, në fshatin Vleshë të Peshkopisë. Më 12 korrik 1958, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie. Vendimi mori formë të prerë më 18 korrik 1958.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 455.

ABAZI Osman

Lindi më 2 gusht të vitit 1893, në fshatin Tatzat të Delvinës. U arrestua më 17

shkurt të vitit 1948. Më 23 korrik të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Gjirokastrës e deklaroi fajtor «se ka furnizuar dhe strehuar të arratisurit dhe s'ka shkuar për të denoncuar», dhe e dënoi me një vit heqje lirie me punë të detyruar.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 456.

ABAZI Rifat

Lindi në fshatin Moglicë të Korçës. Më 12 nëntor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit N.Ç. të Nënprefekturës së Gorë-Oparit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 82, 3 shtator 1946, f. 4.

ABAZI Smail

Lindi në fshatin Greshicë të Mallakastrës. U shpall «kriminell luftime dhe armik i popullit». Më 30 korrik të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Mallakastrës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta zyrtare, nr. 96, 31 tetor 1947, fq. 2.

ABAZI Shaban Abaz

Lindi në vitin 1930 në ish-Jugosllavi. Më 10 shtator të vitit 1951, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «krime kundër shtetit, bërë në 1950 në Llakatund të rrethit të Vlorës», dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 458.

ABAZI (ABAZAJ) Shaban Çaus

Lindi në vitin 1931, në Çamëri. Më 21 gusht të vitit 1946, Gjykata Ushtarake e Vlorës e deklaroi fajtor si «sabotator të pushtetit» dhe e dënoi me një vit heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 457.

ABAZI Shkëlqim

Lindi më 23 dhjetor të viti 1951, në qytetin e Beratit. Më 23 tetor 1968, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut me anë të arratisje së mbetur në tentativë», dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.



Burgu i Burrelit, 1993

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 459.

ABAZI Shyqyri

Lindi më 14 prill të vitit 1914, në Tiranë. Më 29 dhjetor të vitit 1971, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës», dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 15 janar 1972.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 460.

ABAZI Zylyftar

Lindi më 9 nëntor të vitit 1911, në fshatin Dhëmban të Tepelenës. Më 9 shtator të vitit 1980, Gjykata e Rrethit të Tepelenës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit kundër pushtetit popullor», dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie dhe me humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Vendimi mori formë të prerë pa ankimuar, me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor nr. 6656, më 28 tetor 1982.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 461.

ABDIA Ahmet

Lindi më 14 qershor të vitit 1940, në fshatin Sohodoll të Peshkopisë. Më 10 prill 1963, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 15 vjet e 4 muaj heqje lirie, konfiskim të pasurie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 462.

ABDIAJ Idriz

Lindi më 1 janar të vitit 1916, në fshatin Trebisht të Peshkopisë. U arrestua më 8 prill 1946. Më 20 maj 1947, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor se «ka bashkëpunuar me një grup armiqësor kundër pushtetit», dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie dhe 3 vjet punë të detyruar. U arrestua sërish më 25 tetor 1957, dhe më 30 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Qarkut të Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «krimin e

agitacionit dhe propagandës» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie. U lirua më 3 nëntor 1962 për plotësim kohe.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 463.

ABDIA Osman

Lindi më 18 nëntor të vitit 1942, në fshatin Sohodoll të Peshkopisë. Më 10 prill 1963, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe privimin nga e drejta elektorale për 2 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 464.

ABDIJA (DANI) Ilmie

Lindi më 10 prill të vitit 1944, në fshatin Brest të Peshkopisë. U arrestua më 10 nëntor 1962. Më 18 prill 1963, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor se «ka tentuar të arratiset jashtë shtetit», dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale. Por, meqenëse në bazë të dekretit nr. 3603, datë 23 nëntor 1962, iu falej dënimi të gjithë atyre që qenë dënuar me 5 vjet burg e poshtë, u lirua në sallë të gjyqit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 418.

ABDULLA (TEME) Qazim

Lindi më 7 janar të vitit 1908, në fshatin Starje të Ersekës. Më 2 gusht të vitit 1945, Gjykata Ushtarake e Kolonjës e deklaroi fajtor si «kriminel lufte dhe armik të popullit» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe me humbjen e të drejtave politike për aq kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë. Më 24 dhjetor 1946 iu ul dënimi në 10 vjet privim lirie me punë të detyruar.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 469.

ABDULLAI Ethem

Lindi në qytezën e Tuzit, në Malin e Zi. U vra pa gjyq për motive politike, bashkë me të vëllain, Selman Abdullain [*shih*], më 18 shtator 1944.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 204, 205-206, 207.

ABDULLAI Selman

Lindi në qytezën e Tuzit, në Malin e Zi. U vra pa gjyq për motive politike, bashkë me të vëllain, Ethem Abdullain [*shih*], më 18 shtator 1944.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 204, 205-206.

ABDULLAHU Shaban

Lindi më 1893, në fshatin Gur i Zi të Shkodrës. Mori pjesë në kryengritjen e Postribës, ndaj më 27 nëntor 1947, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krime kundër popullit e shtetit» dhe e dënoi me burgim të përjetshëm.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 468.

ABDURRAHMANI (SHPUZA) Asim

Përfaqësues i shoqërisë farmaceutike gjermane «Bayer», kryetar i shoqatës së miqësisë Shqipëri-Kroaci, kryetar i Klubit Mbretnor Shqiptar dhe Konsull Nderi i Austrisë.

Lindi në Shkodër, më 22 dhjetor të vitit 1905. Që në moshë të vogël, i ati, Mehmet Kokotli Shpuza, e dërgoi për studime në Austri. Pas diplomimit u kthye në Shqipëri dhe hapi në Tiranë, te pallati i Kacelit, një farmaci. Mes viteve 1935-1938 shërbeu si Konsull Nderi i Austrisë. Në vitin 1939, si nacionalist legalist, mori pjesë në demonstratat antifashiste, ndaj dhe u internua familjarisht në Leno të Breshias në Itali. Pas dy vitesh i kthyen në Shqipëri. Më 13 shtator 1943, pesë ditë pas kapitullimit të Italisë, kur trupat gjermane po i afroreshin Tiranës dhe Durrësit, së bashku me Xhaferr Devën vajtën në Durrës dhe morën pjesë në hapjen e burgut të Porto-Romanos, duke liruar dhe marrë me vete Rexhep Mitrovicën dhe Bedri Pejanin, vjehrrin e Asimit. Në vitet 1944-1946, sipas këshillave të Sejfulla Malëshovës [*shih*], dr. Ymer Dishnicës [*shih*] etj., u fsheh në shtëpinë e Hajdar Rusit në Shkodër, sa të kalonte furtuna e parë. U arrestua në fillim të vitit 1947 dhe u pushkatua më 8 qershor të po atij viti.

Petro Marko, *Intervistë me vetveten (Retë dhe*



Asim Adurrahmani (Shpuza)

gurët), Tiranë, 2000, II, f. 469-470; *Kurthet e Hoxhës për arrestimin e Asim Adurrahmanit, njeriu që i pari solli ilaçe cilësore në Shkodër, në «Metropol»*, 10 qershor 2012.

ABDURRAHMANI (DURO) Shefqet

Lindi më 1 janar të vitit 1922, në qytetin Bengazi të Libisë. Më 26 gusht 1964, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut dhe agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie dhe me konfiskim të pasurisë. Vendimi mori formë të prerë më 6 nëntor 1964.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 470.

ABEDINI Sherif

Lindi në fshatin Dunckë të Skraparit. U shpall «armik i popullit». Më 15 korrik 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Skraparit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta zyrtare, nr. 99, 15 nëntor 1948, fq. 6.

ABEDINI Tefik

Lindi në fshatin Vërdovë të Pogradecit. U dënua si «kriminel lufte». Më 4 qershor 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Pogradecit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta zyrtare, nr. 69, 30 qershor 1948, fq.3.

ABRASHI Hysen

Lindi më 3 qershor 1924, në Korçë. U vra pa gjyq nga forcat partizane, më 20 shtator 1944.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 234, 235.

ACCOGLIT Augusto

Shtetas italian. U dënua si «kriminel lufte». Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Vlorë më 5 shkurt 1946 vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 51, 12 qeshor 1946, fq. 2.

ADAMI Loni

Sekretar i Legatës Amerikane në Tiranë.

Lindi në vitin 1911, në fshatin Progër të Devollit. Më 1927 kreu shkollën teknike amerikane «Harry Fultz» në Tiranë. Mes viteve 1929-1939 shërbeu si sekretar në Legatën Amerikane në Tiranë. Shoqëroi misionin anglez gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në tetor të vitit 1946 u arrestua bashkë me të shoqen, të akuzuar se «qysh para v. 1939, duke qenë të punësuar në Legatën Amerikane, janë rekrutuar si agjentë të spiunazhit të SH.B.A. pasi kanë kryer një kurs special për këtë qëllim». Si pasojë e trajtimit barbar, vdiq në qelitë e hetuesisë më 6 qershor të vitit 1947.

H. Gonxhja, I. Gogaj, Sh. Bumçi, *Ndihmesa e ish nxënësve dhe mësuesve të Shkollës Teknike të Tiranës për zhvillimin e vendit dhe luftën për çlirim e demokraci*, Tiranë, 2006, VII, f. 245-246; Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, Tiranë, 2007, XXIV, f. 312.

ADEMAJ Llukman

Lindi më 28 maj të vitit 1950, në fshatin Bardhoc të Kukësit. Më 21 qershor 1965, Gjykata e Rrethit të Kukësit e deklaroi fajtor për «krimin e tradhtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie. Më 29 tetor 1968 iu fal me dekret pjesa e mbetur e dënimit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 473.

ADEMI (NURMA) Bajram

Lindi më 10 tetor të vitit 1927, në fshatin Starje të Ersekës. U arrestua më 18 maj 1946 dhe me 24 qershor të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e pjesëmarrjes në grup të organizuar anti-pushtet», dhe dënoi me 2 vjet heqje lirie, punë të detyruar dhe humbjen e të drejtave civile gjatë periudhës së ndëshkimit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 474.

ADEMI Bexhet

Lindi në fshatin Baban të Korçës. Më 10 shtator të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit të Nënprefekturës së Devollit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 117, 27 dhjetor 1946, f. 6.

ADEMI Dane

Lindi më 5 prill të vitit 1922, në Kukës. Më 17 mars 1977, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 9 prill të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 428.

ADEMI Mustafa

Lindi në fshatin Rruzhdije të Mallakastrës. U ekzekutua me vdekje si «kriminel luftë». Më 30 korrik të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Mallakastrës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta zyrtare, nr. 96, 31 tetor 1947, fq. 3.

ADEMI Ramadan

Lindi në vitin 1925, në fshatin Reç të Dibrës. U arrestua më 23 janar 1945 dhe më 24 gusht të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Kukësit e deklaroi fajtor se «ka strehuar dhe furnizuar Muharrem Bajraktarin», ndaj dhe e dënoi me 10 vjet burg. Më 21 dhjetor 1945, konform Dekretit të Faljes,

dënimi iu zbrit në 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 475.

ADEMI Rexh

Lindi më 11 shtator të vitit 1942, në Gjakovë. Më 29 shtator 1964, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e kalimit të paligjshëm të kufirit, mbetur në tentativë» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1969, dhe më 3 shkurt të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Mirditës e deklaroi fajtor për «krimin e kalimit të paligjshëm të kufirit, mbetur në tentativë, dhe kryer në bashkëpunim» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 476.

ADEMI Selman

Lindi në vitin 1900, në fshatin në Gurë-Reç të Peshkopisë. Më 24 gusht 1945, Gjykata e Rrethit të Kukësit e deklaroi fajtor për «strehim të arratisurish, Muharrem Bajraktarit» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie. Po atë vit, me ligjin 167, datë 26. 11. 1945, dënimi iu zbrit në 5 vjet burgim.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 645.

ADEMI Shaban

Lindi në fshatin Koskë të Filatit, në Çamëri. U arrestua më 28 korrik të vitit 1960, si një prej eksponentëve të të ashtuquajturit «Grupi i Teme Sejkos». U ekzekutua pa gjyq më 14 shtator të vitit 1961.

Hyqmet Zane, *50 vjet nga ekzekutimi i grupit të Teme Sejkos dhe Tahir Demit*, në «Dielli», 31 maj 2011; *Lista e personave të ekzekutuar për vitin 1961-1962*, hartuar nga Dega e Hetuesisë së Drejtorisë së Policisë, Tiranë.

ADEMI Ymer

Lindi në vitin 1900, në Kopluk të Malësisë së Madhe. Më 25 shtator 1945, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krime kundër shtetit» dhe e dënoi me 2 vjet burgim të rëndë. Por më 13 dhjetor 1945 iu fal dënimi.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 477.



Shaban Ademi

ADEMI Zek

Lindi në fshatin Kishaj të Kukësit. Më 14 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Kukës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 55, 20 qeshor 1946, fq. 5.

ADILAJ Adil

Lindi më 28 maj të vitit 1968, në fshatin Lladomericë të Dibrës. Më datë 21 janar të vitit 1988, Gjykata e Dibrës e dënoi me 15 vjet heqje lirie për «tradhëti ndaj atdheut në formën e arratisjes».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, FL. 159.

ADILI Aliko

Lindi në fshatin Alarup të Korçës. Më 19 gusht 1946, Gjykata Ushtarake e Korçës e dënoi si «kriminel luftime». Për këtë arsye, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Rrethit të Pogradecit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 69, 30 qershor 1948, fq. 5.

ADRANJI Dhimitri (Hysni)

Lindi më 23 prill të vitit 1959, në Korçë. U arrestua më 14 tetor 1975 dhe më 1 nëntor të po atij viti, Gjykata e Rrethit të

Korçës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe dënoi me 4 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 2 dhjetor 1975.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 440.

ADRI (HADRI) Feti

Lindi më 3 qeshor të vitit 1915, në fshatin Podgorje të Korçës. Më 20 shtator 1963, Gjykata e Qarkut të Korçës e deklaroi fajtor për «faje kundër popullit e shtetit», dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie dhe me humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë. Në bazë të Pikës 11 të Dekretit 3603, datë 23/11/1962 «Mbi amnistinë», iu ul 1/6 e dënimit, dhe i mbetën për të vuajtur 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 480.

ADRI (HADRI) Florenc

Lindi më 3 maj të vitit 1964, në Korçë. Më 1 dhjetor 1982, Gjykata e Rrethit të Korçës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit», dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, më 15 mars 1983.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 415.

ADRI (HADRI) Ismail

Lindi më 2 prill të vitit 1913, në fshatin Potgorie të Korçës. Më 17 qershor 1958, Gjykata ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimet: tradhëti ndaj atdheut dhe agjitacion e propagandë», ndaj e dënoi me 18 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 643.

ADRI (HADRI) Xhevat

Lindi më 18 shkurt të vitit 1937, në fshatin Alarup të Pogradecit. Më 13 maj 1978, Gjykata e Rrethit të Pogradecit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie dhe humbjen

e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 482.

ADRI Zini

Lindi më 21 janar të vitit 1938, në fshatin Podgorje të Korçës. U arrestua më 13 gusht 1962. Më 17 qershor 1963, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë» dhe «moskallzim të një krimi kundër pushtetit», dhe e dënoi me 13 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 4 vjet kohë. U lirua më 25 maj 1974.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 483.

ADHAMI Ollga

Lindi më 1 dhjetor të vitit 1902, në fshatin Qytezë të Korçës. Më 12 shtator 1950, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtorë për «tentativë arratisjeje dhe agjitacion e propagandë, në bashkëpunim» dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie dhe humbjen e të drejtave elektorale për 3 vjet kohë. Dënimin e vuajti në burgun e Korçës.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 484.

ADHAMIDHI Llukan

Lindi më 20 prill të vitit 1925, në Përmet. U arrestua më 21 janar 1950 dhe më 11 shtator të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër Republikës Popullore të Shqipërisë, Bashkimit Sovjetik dhe Demokracisë Popullore dhe se ka hedhur parrulla të ndryshme në provokimet e gushtit 1949 kundër vendit tonë», dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie e punë të detyruar.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 485.

ADHAMIDHI Petraq

Lindi më 7 qeshor të vitit 1954, në Përmet. Më 8 tetor 1969, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës» dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 353.

AFESLLARI Halit

Lindi më 10 shkurt të vitit 1908, në fshatin Vërdovë të Pogradecit. U dënua si kriminel lufte dhe armik i popullit. Më 14 janar 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Pogradecit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta zyrtare, nr. 102, 9 dhjetor 1948, fq. 6.

AGA Destan

Lindi në vitin 1903, në fshatin Liqe i Kuq të Kukësit. Më 17 dhjetor 1958, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e ndihmës në kryerjen e krimit të tradhtisë ndaj atdheut, me bashkëveprim» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e të drejtave elektorale për 2 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 487.

AGA Nebi

Lindi më 1 nëntor të vitit 1929, në fshatin Liqe i Kuq të Kukësit. Më 17 dhjetor 1958, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «ndihmë në kryerje të krimit të tradhtisë ndaj atdheut», dhe e dënoi me dhjetë vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe humbje të së drejtës elektorale për dy vjet kohë. Me dekret nr. 4058, datë 27 shtator 1965, iu fal një vit nga dënimi.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

AGA Halil

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1884. U vra nga forcat partizane, më 4 shkurt 1944, për motive politike.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 37.

AGA Haxhi

Lindi më 1 maj të vitit 1900, në Tiranë. Më 11 gusht 1945, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «se ka penguar e tradhëtuar luftën e popullit, se me cilësinë e tij si komandant çete i Legalitetit, ka rek-



Trup gjykues

rutuar njerëz të tjerë» dhe e dënoi me 30 vjet heqje lirie dhe konfiskim të pasurisë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 488.

AGA Ibrahim

Lindi në vitin 1911, në fshatin Farkë të Tiranës. Më 25 qershor 1945, Gjykata e Lartë Ushtarake e deklaroi «kriminel luftime dhe armik të popullit» dhe e dënoi me vdekje dhe me konfiskimin e pasurisë së tundshme e të patundshme.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 490.

AGA Shemsedin

Lindi më 8 gusht të vitit 1913, në fshatin Grazhdan të Dibrës. U pushkatua pa gjyq për motive politike, më 1 qershor 1946.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 102-103, 104.

AGAÇI Asim

Lindi në vitin 1908 në fshatin Suk të Fier. Më 1947, Gjykata e Beratit e dënoi

me 10 vjet heqje lirie si «pjesmarrës në organizatë tradhëtare» dhe «eksponent i Ballit në krahinën e Roskovecit». Më 24 tetor të po atij viti, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës Qendër të Beratit vendosi sekuestrimin e pasurisë së luajtshme të tij.

A. SH. Berat, Nr. Prot. 72, më 21.12.1993; *Gazeta Zyrtare*, nr. 1, 2 janar 1948, f. 2

AGAÇI Izet

Lindi më 11 shkurt të vitit 1898, në fshatin Suk të Fierit. U shpall armik i popullit. Më 24 tetor 1947, Komiteti Ekzekutiv K.P. të Nënprefekturës Qendër të Beratit, vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij të luajtshme. Disa muaj më vonë, më 18 maj 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Fierit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 1, 2 janar 1948, f. 2; *Gazeta Zyrtare*, nr. 61, 26 maj 1948, fq. 5.

AGAJ Ali

Më 16 mars të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit N. Ç. të Nënprefekturës së Durrësit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të pa-tundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 79, 29 gusht 1946, f. 13.

AGAJ Bekim

Lindi më 8 mars të vitit 1927, në fshatin Ramic të Vlorës. Më 17 qershor 1946, Gjykata Ushtarake e Vlorës e deklaroi fajtor si «armik i popullit e sabotator i pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 489.

AGAJ Daut

Lindi më 15 janar të vitit 1916, në fshatin Hekal të Mallakastrës. Më 20 korrik 1945, Gjykata Ushtarake e Fierit e deklaroi fajtor se «ka dezertuar nga radhët e Frontit dhe ka marrë pjesë në organizatën e Ballit Kombëtar; ka sabotuar luftën e popullit dhe ka marrë pjesë në operacione kundër UNÇL» dhe e dënoi me vdekje dhe me konfiskimin e pasurisë së luajshme e të paluajshme. Më 23 korrik të po atij viti, Gjykata e Lartë Ushtarake ia ndryshoi dënimin në privim lirie për jetë me punë të detyruar.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 491.

AGAJ Kadri

Lindi në vitin 1906, në fshatin Kuç të Vlorës. U vra pa gjyq, në qershor 1944, si antikomunist.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 51, 52.

AGAJ Mithat

Lindi më 6 prill të vitit 1941, në fshatin Hekal të Mallakastrës. Më 26 nëntor 1975, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 492.

AGAJ Qamil

Lindi në fshatin Rresës të Fierit. U deklarua «armik i popullit». Për këtë arsye, më 19 shkurt të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Fierit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij, të luajshme e të paluajshme.

Gazeta Zyrtare, nr.25, 18 mars 1947, f. 4.

AGAJ Reshat

Kontabilist, veprimtar politik.

Lindi në mars të vitit 1914, në fshatin Ramic të Vlorës. Pasi kreu mësimet fillore në fshatin e lindjes, studioi në Shkollën Tregtare të Vlorës. Më 1932 filloi në Bari Institutin e Kontabilitetit. U diplomua më 1936. Sapo u kthye nga Bari u emërua nëpunës tatimesh në Korçë. Më pas filloi punë në Bankën e Shtetit. Gjatë kohës së luftës u rreshtua në radhët e Ballit Kombëtar. Pas largimit të gjermanëve, mori një letër nga Hysni Kapoja, ku ai e siguronte se nuk do të kishte pasoja. Ndaj dhe nuk u arratis. Pas pak kohësh e mobilizuan në radhët e Brigadës 23 në Veri. Më vonë nisi punë si stenograf në gazetën «Bashkimi», por pas pak kohësh u arrestua pa asnjë shkak. Pasi u torturua për muaj me radhë në birucat e Ministrisë së Brendshme, u dënua me dhjetë vjet heqje lirie për agjitacion e propagandë. Pas lirimimit më 1949, me ndihmën e miqve nisi sërish punë si stenograf, po këtë herë në gazetën «Zëri i popullit». Nuk kaloi shumë kohë dhe Kadri Hazbiu i përgatiti kurthin: «Vëllai i Reshatit, Pertefi është arrestuar si armik që kërkonte të përmbyste pushtetin dhe gjyqi i ka dhënë dënim me vdekje.» Pas torturave çnjerëzore dhe pas vendimit të gjyqit, Kadri Hazbiu realizoi takimin e Reshatit me të vëllanë e katandisur kockë e lëkurë, dhe e vuri para alternativës: «Ose na shërbe, ose vëllanë e pret plumbi». Një pjesë e të gjykuarve në të njëjtin grup me vëllanë ishin vvarë. Kështu, ai u detyrua të «arratiset» në perëndim, për të spiunuar të arratisurit, disa syresh të afërm të tij. Reshat Agaj pranoi, por sapo e nxorën

jashtë, u dorëzua tek misioni amerikan dhe u tregoi për detyrën që i kishin ngarkuar. Vdiq më 15 tetor të vitit 1981 në Kinoshë të shtetit Wisconsin në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe u varros në Detroit.

Vepra: «Vëllai i pengut: ditar i mbajtur në Amerikë» ("Europrint", Vlorë, 2009). Përthime: Ismail Qemal Vlorë, «Kujtimet» ("Harmoni Printing Limited", Toronto, 1968).

Reshat Agaj, *Vëllai i pengut: ditar i mbajtur në Amerikë*, Vlorë, 2009; Petro Marko, *Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)*, Tiranë, 2000, II, f. 448.

AGALLI Bajram

Lindi më 15 janar të vitit 1890, në fshatin Taç Lartë të Ersekës. Më 16 dhjetor 1961, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimet: tradhëti ndaj atdheut, bashkëpunim me diversantët në favor të zbulimit grek» dhe «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor», ndaj e dënoi me 25 vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 493.

AGALLI Ferit

Lindi më 7 prill të vitit 1929, në Ersekë. Më 24 maj 1951, Gjykata Ushtarake Territoriale e Gjirokastrës e deklaroi fajtor se «ka pasur dijeni për arratisjen e dy personave», dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 494.

AGALLIJA Ali

Lindi në vitin 1885, në fshatin Taç Lartë të Ersekës. Më 18 korrik 1945, Gjykata Ushtarake e Kolonjës e deklaroi fajtor se ka «agjituuar kundër lëvizjes popullore», dhe e dënoi me 101 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. Më 5 dhjetor 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kolonjës urdhëroi konfiskimin e gjithë pasurisë së tij.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 495; *Gazeta Zyrtare*, nr. 57, 27 qeshor 1946, fq. 2.

AGALLIU Avni

Lindi më 15 janar të vitit 1900, në fshatin Çorogjaf të Beratit. Më 15 shtator 1947, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor se ka «strehuar dhe furnizuar kriminelin e luftës të ikur nga burgu, Dilaver Çorogjafin» dhe e dënoi me 2 vjet privim lirie me punë të detyruar.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 496.

AGALLIU Dajlan

Lindi më 1 janar të vitit 1943, në fshatin Terpan të Beratit. Më 26 gusht 1966, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut, në bashkëpunim», dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 497.

AGALLIU Fitim

Lindi më 14 qershor të vitit 1944, në fshatin Velçan të Beratit. U arrestua më 12 dhjetor 1974 për «tradhëti ndaj atdheut mbetur në fazën e tentativës» dhe u ekzekutua më 2 korrik 1975.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 25, 26, 27.

AGALLIU Hair

Lindi më 4 prill të vitit 1943, në fshatin Kraps të Fierit. Më 8 nëntor 1977, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor», «përtvetësim të pasurisë socialiste» dhe «rrahje të thjeshtë» dhe, përfundimisht e dënoi me dhjetë vjet heqje lirie.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

AGALLIU Haki

Lindi më 18 mars të vitit 1939, në Fier. Më 29 dhjetor 1964, Gjykata e Vlorës e dënoi me 12 vjet heqje lirie për «tradhëti ndaj atdheut».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 216.

AGALLIU Haxhi

Lindi më 3 mars të vitit 1940, në fshatin Çorogjaf të Beratit. Më 12 korrik 1958,

Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 8 vjet heqje lirie dhe konfiskim të pasurisë së luajtshme e të paluajtshme për «tentativë arratisje jashtë shtetit». Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë, më 2 shtator të po atij viti. U lirua më 27 qershor 1963 për plotësim afati.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 392.

AGALLIU Myqerem

Lindi më 21 maj të vitit 1935, në fshatin Çorrogjaf të Beratit. Më 23 tetor 1952, Gjykata Ushtarake e Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë. Por më 2 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Lartë ia zbriti dënimin në 5 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1954, dhe më 2 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Qarkut të Beratit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë. U arrestua për të tretën herë më 1974, dhe më 24 shtator të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Lushnjës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës në dëm të pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 404.

AGALLIU Nesim

Lindi në vitin 1915, në fshatin Çorrogjaf të Beratit. Më 27 nëntor 1957, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor», dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie dhe me humbjen e të drejtave për 2 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 500.

AGALLIU Velo

Lindi më 28 korrik të vitit 1897, në Vlorë. Më 28 dhjetor 1947, Gjykata Ushtarake e Vlorës e deklaroi fajtor «për spiunazh» dhe se «në bashkëpunim me ko-

mponentët e Ballit Kombëtar në Tiranë, ka pasur për qëllim kryesor rrëzimin e pushtetit popullor me forcë». Për këto arsye e dënoi me 20 vjet privim lirie me punë të detyruar (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 501.

AGARAJ Xhaferr

Lindi më 10 qeshor të vitit 1931, në fshatin Arrëz të Tepelenës. Më 5 dhjetor 1976, Gjykata e Tepelenës e dënoi me 10 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë» (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 140.

AGARAJ Xhevahir

Lindi në vitin 1910, në fshatin Vergo të Sarandës. Gjatë luftës u rrjeshtua në radhët e forcave nacionaliste. U vra më 31 tetor 1943 nga guerrillasit komunistë në zonën e Rrëzomës.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 134, 138.

AGASI Ahmet

Ushtarak.

Lindi më 10 shkurt të vitit 1925, në fshatin Ishëm të Durrësit. Më 6 nëntor 1951, Gjykata Ushtarake e Durrësit e dënoi me 18 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë për «agjitacion e propagandë», «sabotim», «pjesëmarrje në milicinë fashiste» dhe dhënie «ndihme të arratisurve».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 180; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 237.

AGASTRA Velisha

Lindi më 11 mars të vitit 1927, në fshatin Baban të Bilishtit. Më 29 shtator 1951, Gjykata Ushtarake Territoriale e Korçës e deklaroi fajtor për «krimet e agjitacionit e propagandës dhe të moskallëzimit të krimit», dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për një vit kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 502.

AGIMGOSTIVARI Ibrahim

Mësues.

Lindi më 21 shkurt të vitit 1934, në Tiranë. Pas mbarimit të gjimnazit, për shumë vjet punoi si mësues në fshatrat e Kukësit. U dënua me pesë vjet heqje lirie. Më 1990 emigroi në Gjermani. Jeton në Bochum.

Vepra: «Pas shpine» (*dramë*), «Dhimbja e mallit» (*poezi*), «Në tretjen e muzgut» (*poezi*, "Dardania", Tiranë, 2001), «Fjala flet si zemra» (*poezi*) etj.

AGO Hasan

Lindi më 8 prill të vitit 1920, në fshatin Uznovë të Beratit. Më 19 prill 1950, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor «për pjesëmarrje në grup të organizuar kundër pushtetit... dhe propagandë kundra pushtetit dhe ushtrisë», dhe e dënoi me 10 vjet privim lirie me punë të detyruar dhe humbjen e së drejtës elektorale për një vit kohë. Por më 21 nëntor 1950, Gjykata e Lartë Ushtarake ia uli dënimin në 8 vjetë privim lirie me punë të detyruar.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 503.

AGO Ilija (Ilo)

Lindi më 1 maj të vitit 1938, në fshatin Liqenas të Korçës. Më 1 prill 1976, Gjykata e Korçës e dënoi me 6 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor».

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 83.

AGO Istref

Lindi në vitin 1911, në Korçë. Më 14 shtator 1946, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi «armik i popullit dhe sabotator pushteti» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë, humbjen e të drejtës civile dhe punë të detyruar baraz me kohën e dënimit. Vendimi mori formë të prerë më 15 tetor 1960.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 644.

AGO Kadri

Lindi më 6 maj të vitit 1921, në fshatin

Cangonj të Bilishtit. Më 28 mars 1947, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor për «krime kundër shtetit» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 504.

AGO Lumturi

Lindi në vitin 1959, në Përmet. Më 28 shkurt 1979, Gjykata e Rrethit të Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjetacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 553.

AGO Mehdi

Lindi më 22 shkurt të vitit 1953, në fshatin Grabockë të Korçës. Më 28 shkurt 1979, Gjykata e Qarkut të Korçës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me dhjetë vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për pesë vjet kohë.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

AGO Mehdi Islam

Lindi në vitin 1907, në fshatin Topojan të Elbasanit. Më 13 dhjetor 1947, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor «për tradhëti ndaj atdheut» e «agjitacion e propagandë», dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 513.

AGO Reshat

Lindi në vitin 1914, në fshatin Ramic të Vlorës. Më 29 mars 1947, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi «armik i popullit», dhe e dënoi me 8 vjet privim lirie dhe humbjen e të drejtave civile e politike për 2 vjet kohë.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 505.

AGO Reshat Ramadan

Mësues.

Lindi më 15 maj të vitit 1912, në Berat. Më 28 gusht 1961, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e tentativës së arratisjes nga vendndalimi», dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 4 vjet kohë. U vra më 1967, në kampin e punës së detyruar në Elbasan.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 506.

AGOHITAJ Piro

Lindi më 3 shkurt të vitit 1934, në fshatin Dukat të Vlorës. Më 14 qershor 1979, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor «për krimin e agjitacionit dhe propagandës armiqësore» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 507.

AGOLLI Abedin

Lindi më 4 qeshor të vitit 1930, në fshatin Bulgarec të Korçës. Më 28 prill 1950, Gjykata Ushtarake e Korçës e dënoi me 2 vjet punë korrektuese për «moskallzim të grupit kundër shtetit».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 236.

AGOLLI Adriatik

Lindi më 20 shtator të vitit 1932, në fshatin Nishavec të Pogradecit. Më 10 janar 1963, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi për «tentativë arratisjeje» me 13 vjet e 4 muaj burg, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. U lirua më 18 shtator 1974.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 281.

AGOLLI Agim

Lindi më 4 korrik të vitit 1938, në fshatin Kërçisht të Peshkopisë. Më 4 tetor 1956, Gjykata e Lartë Ushtarake e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin

e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë. U lirua më 30 nëntor 1962 për plotësim afati.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 379.

AGOLLI Ahmet

Lindi më 27 mars të vitit 1929, në fshatin Bulgarec të Korçës. Më 21 nëntor 1945, Gjykata Ushtarake e Pogradecit e dënoi me 10 vjet heqje lirie si «armik i popullit». Për këtë arsye, më 29 janar 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës Qendër Korçë, vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 255; *Gazeta Zyrtare*, nr. 30, 26 prill 1946, f. 3.

AGOLLI Ali Ahmet

Lindi më 10 mars të vitit 1910, në fshatin Damjanec të Korçës. Më 29 gusht 1947, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor «për krimin e mosdenoncimit të një baze municioni (fishekë)», dhe e dënoi me 1 vit privim lirie me punë të detyruar. U arrestua sërish më 1950, dhe më 23 gusht të po atij viti, Gjykata e rrethit të Korçës e deklaroi fajtor për «sabotim ekonomik» dhe e dënoi me 9 vjet privim lirie me punë të detyruar.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 509.

AGOLLI Ali Maliq

Lindi më 14 mars të vitit 1908, në Dibër. Udhëhoqi çetat nacionaliste në vitin 1943-1944. Në vitin 1946, Gjykata Ushtarake e dënoi me vdekje, me pushkatim, dënim që iu kthye në 25 vjet heqje lirie. U vra në krye të 22 viteve burg, në kampin e punës së detyruar në Elbasan në vitin 1967.

AGOLLI Avni

Djali i patriotit Ali Maliqi (Agolli).

Lindi më 20 janar të vitit 1931, në fshatin Këshishtë të Qarkut të Dibrës. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, ndërsa uniken dhe pedagogjiken në Peshkopi më 1949. U arrestua më 7 maj të po këtij viti



Avni Agolli

me akuzën e pjesëmarrjes në një grup që donte të përmbyste Pushtetin Popullor. Pas rreth pesë muajsh hetuesie, meqë nuk pranoi asnjë nga akuzat, u internua familjarisht në Tepelenë, Porto Palermo e kampe të tjera pune. U lirua në qershor të vitit 1956. Dy muaj më vonë u arratis në Maqedoni, së bashku me të vëllezërit dhe motrat. Pas 10 ditësh qëndrimi në Shkup, qeveria jugosllave i riadhesoi. Në pikën kufitare të Bllatës, pjesëtarët e familjes Agolli i priti vetë Kadri Hazbiu. Më 4 tetor të vitit 1956, Avni Agolloi doli në gjyq dhe u dënua me 15 vjet heqje lirie. Dënimin e vuajti në kampet e punës në Bulqizë, Tiranë, Krujë etj. Përfitoi nga një amnisti dhe pas tetetë vitesh u lirua. U kthye në Peshkopi, ku punoi si punëtor në ndërmarrjen e ndërtimit deri në vitin 1990.

AGOLLI Baftjar

Lindi më 6 shkurt të vitit 1920, në fshatin Trestenik të Devollit. Më 26 prill 1961, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor «për moskallëzim të një krimi kundër shtetit», dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 510.

AGOLLI Çelnik

U vra pa gjyq për motive politike, më 3 prill 1946, në Tiranë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 183.

AGOLLI Dylber

Lindi më 13 shkurt të vitit 1919, në fshatin Moçan të Korçës. U arrestua më 3 korrik 1945 dhe më 22 gusht të po atij viti Gjykata Ushtarake e Qarkut të Tiranës e dënoi me 1 vit heqje lirie për dezertim nga ushtria. U arrestua sërish më 8 shtator 1946 dhe më 2 tetor të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor «se "Si armik i popullit" ka ... qenë organizator dhe drejtues i grupit në ushtri, i cili së bashku me tre të tjerë ka qenë i lidhur me reaksionin e jashtëm dhe të mbrendshëm...» etj., dhe e dënoi me vdekje. U ekzekutua më 9 tetor 1946.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 18, 19.

AGOLLI Enver

Lindi më 15 shkurt të vitit 1922, në fshatin Dolan të Korçës. Më 12 shtator 1945, Gjykata Ushtarake e Korçës e dënoi me vdekje dhe konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, «për bashkëpunim me Ballin Kombëtar». U ekzekutua më 25 tetor 1945. Më 29 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës Qendër Korçë, vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 202, 203; *Gazeta Zyrtare*, nr. 30, 26 prill 1946, f. 3.

AGOLLI Eqrem

Lindi më 21 shkurt të vitit 1935, në fshatin Moçan të Korçës. Më 9 prill 1955, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «moskallëzim krimi kundër shtetit» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 114.

AGOLLI Fetah

Lindi më 15 tetor të vitit 1935, në fshatin Taç Lartë të Kolonjës. U vra pa gjyq

për motive politike, më 22 janar 1945, në burgun e Korçës.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 23, 24.

AGOLLI Hasan

Lindi më 5 korrik të vitit 1904, në fshatin Velçan të Korçës. Më 2 tetor 1945, Gjykata Ushtarake e Pogradecit e deklaroi fajtor si «eksponent të Ballit Kombëtar», që «ka sabotuar luftën Nacional-Çlirimtare» dhe që «ka bërë propagandë në popull për t'i futur në radhët e Ballit Kombëtar», dhe e dënoi me 20 vjet privim lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 20 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 511.

AGOLLI Mehdi

Lindi në vitin 1900, në fshatin Zvarisht të Gorës. Më 8 shtator 1950, Gjykata Ushtarake Territoriale e Korçës e deklaroi fajtor për «pjesëmarrjen në grup të organizuar» dhe «agjitacion e propagandë, në bashkëpunim», dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për një vit kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 512.

AGOLLI Mersin

Lindi më 9 nëntor të vitit 1914, në fshatin Bulgarec të Korçës. Më 28 gusht 1950, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor «për pjesëmarrjen në grup të oraganizuar» dhe për «agjitacion e propagandë me bashkëpunim», dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 514.

AGOLLI Muhamet

Lindi më 10 mars të vitit 1917, në Korçë. Më 14 shtator 1946, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor si «armik i popullit» dhe «sabotator i pushtetit», dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie me punë të detyruar, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e të drejtave civile baraz me kohën e dënimit.

Më 27 prill 1949, dënimi iu ul në 4 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 515.

AGOLLI Mustafa

Lindi më 8 korrik të vitit 1928, në Korçë. Më 22 gusht 1951, Gjykata Ushtarake Territoriale e Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacion e propagandës, në bashkëpunim» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, si dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 516.

AGOLLI Nijas

Lindi më 14 qershor të vitit 1930, në Korçë. Më 11 shtator 1958, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «përgatitje për arratisje jashtë shtetit» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, si dhe me humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 425.

AGOLLI Qazim

Lindi më 10 nëntor të vitit 1905, në fshatin Bulgarec të Korçës. Më 2 nëntor 1945, Gjykata Ushtarake e Pogradecit e deklaroi «armik i popullit» dhe «kriminel luftime» dhe e dënoi me vdekje me pushkatim dhe konfiskimin e pasurisë. Pesë ditë më vonë, më 7 nëntor të po atij viti, Gjykata Ushtarake ia uli dënimin në burgim të përjetshëm. Vdiq në burgun e Pogradecit, më 18 nëntor 1945.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 518.

AGOLLI Qerim

Lindi më 17 gusht të vitit 1922, në fshatin Moçan të Korçës. Më 19 prill 1954, Gjykata Ushtarake Territoriale e Korçës e deklaroi fajtor për «kryerjen e detyrave të agjenturës së huaj», dhe e dënoi me vdekje me pushkatim, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Por më 7 qershor të po atij



Gjyqi kundër deputetëve, 1947

viti, Presidiumi i Kuvendit Popullor ia uli dënimin në 25 vjet burg (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 519.

AGOLLI Rexhai

Lindi më 20 maj të vitit 1921, në fshatin Moçan të Korçës. Më 15 mars 1954, Gjykata Ushtarake Territoriale e Korçës e deklaroi fajtor «për dhënien ndihmë bandave të armatosura», dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1958, dhe më 11 shtator të po atij viti Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë

dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 520.

AGOLLI Sadik

Lindi më 14 shkurt të vitit 1905, në Korçë. Më 29 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës Qendër Korçë, vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 30, 26 prill 1946, f. 3.

AGOLLI Seladin

Lindi më 23 nëntor të vitit 1929, në fshatin Moçan të Korçës. Më 11 mars 1954, Gjykata Ushtarake Territoriale e Korçës

e deklaroi fajtor për «dhënie ndihme të gjithanshme diversantëve», dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë, humbjen e të drejtës elektorale si dhe heqjen e medaljes.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 521.

AGOLLI Selami

Lindi më 18 mars të vitit 1914, në fshatin Velçan të Korçës. Më 21 qershor 1946, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor «për krime kundër popullit e shtetit», dhe e dënoi me burgim të përjetshëm, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. U arrestua sërish më 1977, dhe më 10 shkurt të po atij viti, Gjykata e Elbasanit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër shtetit», dhe e dënoi 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 525.

AGOLLI Selim

Lindi në vitin 1907, në fshatin Nishavec të Korçës. U internua më 1949, fillimisht në Tiranë, pastaj në Tepelenë e Porto Palermo. Pas lirimt më 1951, u dëbua familjarisht në Cakran të Mallakastrës e, më vonë, në Gorishovë e Shtyllas, ku qëndroi deri më 1966. Vdiq në vitin 1985 në Nishavec.

AGOLLI Shëfqet

Lindi më 3 maj të vitit 1922, në fshatin Bilisht të Devollit. Më 22 gusht 1977, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Korçës e deklaroi fajtor për «krimet e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor dhe fyerjes së përfaqësuesit të pushtetit», dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 523.

AGOLLI Shyqyri

Lindi më 19 dhjetor të vitit 1930, në fshatin Dolan të Korçës. Më 13 mars 1968, Gjykata e Rrethit të Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës»,

dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 524.

AGOLLI Tahir

Lindi më 5 prill të vitit 1932, në fshatin Starovë të Pogradecit. Më 13 dhjetor 1967, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me njëzetë vjet heqje lirie, me konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për pesë vjet kohë. U arrestua sërish, dhe më 29 janar 1987, Gjykata e Rrethit të Lushnjës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me dymbëdhjetë vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 397.

AGOLLI Telat

Krijues i cirkut shqiptar (1952), kampion në ngritje peshe për peshat e rënda, «Artist i Popullit», «Mjeshtër i merituar i sportit».

Lindi më 15 nëntor të vitit 1932, në Tiranë. Kreu IKF «Vojo Kushi» dhe një kurs kualifikimi njëvjeçar për cirk në Kinë. Si peshëngritës, në 22 vjet ka vendosur 99 rekorde kombëtare. Në qershor të vitit 1976 e lidhën këmbë e duar në Sarandë, ku ishte në turne me trupën e cirkut, dhe e sollën në burgun e Tiranës. U akuzua si agjent dhe si tradhtar i vënë në shërbim të UDB-së. Më 18 maj 1977, Gjykata e Tiranës e dënoi me 10 vjet burg, konfiskim të pasurisë, heqjen e medaljes së punës si dhe të titujve «Artist i Popullit» e «Artist i Merituar» për «agjitacion e propagandë». Dënimin e e kreu pjesërisht në kampin e Spaçit. U lirua më 28 tetor 1982.

Josif Papagjoni, *AGOLLI Telat*, në «Fjalor Enciklopedik Shqiptar», 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 18-19; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 219.

AGOLLI Xhelal

Lindi më 11 prill të vitit 1910, në fshatin Nishavec të Korçës. Bëri tre vjet hetuesi si «armik i popullit».

AGOLLI Xhevat

Lindi në vitin 1924, në fshatin Nishavec të Korçës. Gjatë luftës u rrjestua në radhët e Ballit Kombëtar. U arrestua më 1945 dhe këbi 27 vjet burg.

AGOLLI Xhevdet

Lindi më 14 mars të vitit 1908, në fshatin Bulgarec të Korçës. U vra pa gjyq për motive politike më 18 shtator 1943 në Teqenë e Melçanit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 146, 147, 148.

AGOLLI Zenel

Lindi më 7 prill të vitit 1930, në fshatin Dohoshisht të Peshkopisë. Më 19 gusht 1958, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut», dhe dënoi me 25 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 525.

AGOLLI Zini (Zeni)

Lindi më 13 prill të vitit 1939, në fshatin Moçan të Korçës. Më 17 gusht 1962, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandë, me bashkëveprim» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë, më 17 shtator të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 424.

AGOVË Halit

Lindi më 6 mars të vitit 1926, në Shkodër. Më 18 tetor 1973, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës», dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie. U ridënua më 1977: më 4 mars të atij viti, Gjykata e Rrethit të Mirditës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës», dhe e dënoi me 13 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 528.

AGRI (KRUJA) Man

Lindi më 20 prill të vitit 1895, në fshatin Kullaj të Postribës. Më 22 dhjetor 1949, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi «armik i popullit», dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 529.

AGUSHI Ramiz

Lindi më 20 tetor të vitit 1938, në qytetin e Resnjës, në Maqedoni. Më 15 prill 1988, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut në formën e tentativës për t'u arratisur jashtë shtetit», dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 530.

AHMATA Hasan

Lindi më 7 qershor 1922. U vra pa gjyq për motive politike, më 17 shtator 1944, në Korçë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 230, 232.

AHMATAJ Dede Ahmet Myftar

Klerik i lartë bektashian, Kryegjysh Botëror i Bektashinjve (1948-1958).

Lindi më 22 shkurt të vitit 1916, në fshatin Brataj të Vlorës. Kreu Shkollën Qytetëse më 1924-1929. Pasi mbaroi shërbimin ushtarak, u vesh dervish në teqenë bektashiane të Bllacës (Dibër) tek Baba Zeneli, ku qëndroi deri më 1939. Që nga kjo kohë e deri më 1942 shërbeu në disa teqe të vendit, si në atë të Baba Hamidit në Elbasan (u emërua më 16 janar 1941), në Turan të Tepelenës dhe në Vlorë. Më 22 korrik të vitit 1942 u hodh në luftë, në radhët e Brigadës XVIII Sulmuese, në batalionet partizane të Martaneshit, Elbasanit dhe të Pezës. Më 1943 u internua nga italianët në Porto Romano. Pas internimit kaloi në çetën partizane të Shijakut, ku u plagos rëndë. Në qershor të vitit 1944 u gradua «Baba» dhe u dërgua në Vlorë, ku themeloi teqenë e Kuzum Babait. Aty shërbeu deri më 1948, kur u zgjodh Kryegjysh Botëror i Bektashinjve. Dhjetë vjet më vonë, më 1958, shteti komunist e largoi nga Kryesia e Kryegjyshit Botërorë Bektashiane.



Dede Ahmet Myftar Ahmataj

U internua së bashku me dervishin e tij, Reshat Bardhin [*shih*], në Drizar të Mallakastrës, ku qëndroi nëntë vjet, deri më 1967, kur në Shqipëri u ndalua ushtrimi i fesë. Që nga kjo kohë e deri sa vdiq, më 10 korrik 1980, jetoi në familjen e të vëllait në Tiranë. Është dekoruar me medaljen «Pishtar i Demokracisë».

Kujtim Ahmataj, *Shenjt i këmbëzbathur: Dede Ahmet Myftar Ahmataj (22 shkurt 1916-10 korrik 1980)*, Tiranë, pa datë; Kujtim Ahmataj, *Loti i vvarë*, Tiranë, 2012, f. 86; Gjysh Qazim Dedej, *Fillimet e Bektashizmit në Shqipëri dhe në Elbasan*, Elbasan, 1997, f. 107; Kujtim Ahmataj, *AHMATAJ Dede Ahmet Myftar*, në «Fjalor Enciklopedik Shqiptar», 1, Tiranë, 2008, f. 26-27.

AHMATAJ (GJINI) Dodë

Lindi më 25 maj të vitit 1922, në fshatin Rragam të Shkodrës. Më 18 nëntor 1952, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor se «ka strehuar diversantët dhe u ka shërbyer atyre», ndaj e dënoi me 7 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 531.

AHMATAJ (GJINI) Shuk

Lindi më 1 janar të vitit 1913, në Shkodër. Sipas Regjistrimit të Gjendjes Gjyqësore të Ministrisë së Drejtësisë (vendimi nr. 501), më 1947 u dënua me shtatë vjet heqje lirie.

Ministria e Drejtësisë, Regjistri i Gjendjes Gjyqësore, vendimi nr. 501, viti 1947.

AHMATI Ibrahim

Lindi më 15 qeshor të vitit 1910, në fshatin Radomirë të Peshkopisë. Më 20 korrik 1954, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «fajin e dhënies ndihmë për t'u arratisur» dhe për «agjitacion e propagandë», dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 534.

AHMATI Musë

Lindi në vitin 1916, në Kukës. Më 31 mars 1980, Gjykata e Rrethit të Kukësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor», dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 29 prill 1980.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 535.

AHMATI Sali

Lindi në vitin 1916, në Kukës. Më 31 mars 1980, Gjykata e Rrethit të Kukësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës», dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 535.

AHMATI Ymer

Lindi më 11 korrik të vitit 1962, në fshatin Radomirë të Peshkopisë. Më 14 tetor 1986, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit», dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 536.

AHMETAGA Shyqyri

Lindi më 13 mars të vitit 1925, në Shkodër. Më 14 janar 1956, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës», dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 537.

AHMETAJ Ahmet

Lindi në vitin 1917, në fshatin Gri të Tropojës. Më 18 shtator 1951, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor «për bashkëpunim me diversantët» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie dhe humbjen e të drejtave qytetare për 2 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 674.

AHMETAJ Isuf

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1890, në fshatin Gurrazez të Skraparit. U vra pa gjyq, më 31 tetor 1943, për motive politike.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 44, 49.

AHMETAJ Musë

Lindi më 10 shtator të vitit 1920, në fshatin Kepenek të Tropojës. U pushkatua pa gjyq më 10 janar 1945, për motive politike.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 70-71, 72.

AHMETAJ Seit Rexhep

Lindi në vitin 1911, në fshatin Polis të rrethit të Librazhdit. Më 16 dhjetor 1946, Gjykata ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor për «sabotim të pushtetit popullor» dhe e dënoi me 1 vit heqje lirie. U arrestua sërish më 1972, dhe më 23 nëntor në po atij viti, Gjykata e Librazhdit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1 V. 2012, D. 1, Fl. 636.

AHMETAJ Seit Ethem

Lindi më 29 maj të vitit 1966, në fshatin Zerec të Korçës. Më 13 shtator 1988, Gjykata e Rrethit të Korçës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut në formën e arratisjes mbetur në fazën e përgatitjes»

dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar). Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 4 tetor të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 423.

AHMETAJ Xheladin (Zadin)

Lindi në vitin 1890, në fshatin Mashkullorë të Gjirokastrës. Më 25 korrik 1945, Gjykata e Rrethit të Gjirokastrës e cilësoi «kriminel lufte e armik i popullit», dhe e dënoi me 101 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 550.

AHMETAJ Xhemë

Lindi më 15 mars të vitit 1906, në fshatin Gri të Tropojës. Më 21 janar 1953, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «bashkëpunim me diversantët», dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e të drejtave për 3 vjet kohë (dënim i kombinuar). Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 4 prill 1953.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 541.

AHMETAJ Xhemo

Lindi më 15 mars të vitit 1905, në fshatin Mashkullorë të Gjirokastrës. Më 25 korrik 1945, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor si «kriminele lufte», dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie. Më 27 prill 1949, me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor iu zbrit dënimi në 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 543.

AHMETI Adem

Lindi në fshatin Krej-Reç. Më 25 tetor të vitit 1946, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e dënoi si armik të popullit, sepse «ka strehë kriminelat e luftës, ka sabotue punët e pushtetit dhe asht mundue të ngjalli pa kënaqësira e urrejtje karshi Pushtetit». Për këtë arsye, më 18 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Shumbatit



Drita Ahmeti

urdhëroi konfiskimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

AHMETI Avni

Lindi më 7 qershor 1890, në fshatin Mashkullorë të Gjirokastrës. U vra pa gjyq për motive politike, më 3 shkurt 1944.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 8, 9.

AHMETI Bektash

Lindi më 12 mars të vitit 1880, në fshatin Rabije të Tepelenës. Më 11 korrik 1949, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor si «antar në grupin e organizuar kundër pushtetit» dhe për «fajin e agjitacionit e propagandës», dhe e dënoi me 3 vjet privim lirie me punë të detyruar dhe humbjen e së drejtës elektorale për një vit kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 6 gusht 1949.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 545.

AHMETI Beqir

Lindi më 7 nëntor të vitit 1935, në fshatin Barbullush të Shkodrës. Më 14 mars 1964, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut», dhe e dënoi me 14 vjet

heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 21 prill 1964.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 546.

AHMETI Daut

Lindi në vitin 1900, në fshatin Podgorie të Korçës. Më 18 mars 1947, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor «për strehim kriminelësh lufte», dhe e dënoi me paraburgim nga 24 shkurti 1946 deri më 18 mars 1947.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 547.

AHMETI Drita

Lindi më 13 mars të vitit 1936, në Shijak të Durrësit. Më 5 mars 1979, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtorë për «agjitacion dhe propagandë kundër shtetit» dhe e dënoi me pesë vjet heqje lirie.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

AHMETI Haxhi

Lindi më 2 qeshor të vitit 1934, në fshatin Bërdicë të Shkodrës. U arrestua në vitin 1945. Por një ditë të shkurtit të po atij viti, kur bashkë me shtatë të burgosur të tjerë po i dërgonin me makinë nga burgu i madh i Shkodrës për në Zall të Kirit, ai u hodh dhe arriti t'u shpëtojë ndjekësve. U fsheh në fshatrat përreth Shkodrës deri më 18 maj 1946, kur forcat e ndjekjes e rrethuan në një arë me grurë në fshatin e tij të lindjes. Thirrjes së tyre për t'u dorëzuar iu përgjigj me të shtëna. Pas dy-tri orësh luftimi, kur iu mbaruan fishekët, për të mos rënë në duart e forcave të ndjekjes, vuri revolën në kokë dhe vrau veten.

Ahmet Bushati, *Në gjurmët e një ditari: Shkodra në vitet e para nën komunizëm*, «Camaj-Pipa», Shkodër, 2007, f. 132-133.

AHMETI (OSMËNI) Iljaz

Ushtarak i lartë.

Lindi më 10 janar të vitit 1915, në fshatin Tatzat të Delvinës. Studimete



Iljaz Ahmeti (Osmëni)

e larta ekonomike i kreu në Kozencë të Italisë. Gjatë luftës ishte një nga udhëheqësit ushtarakë kryesorë për rrethin e Gjirokastrës. Më 1942 u zgjodh anëtar i Partisë Komuniste Shqiptare. Pas debateve që zhvilloi me Enver Hoxhën në Konferencën e Tiranës (14-19 prillit 1956), u përjashtua nga Partia si armik. U arrestua më 15 qershor të vitit 1973. Dy muaj më vonë, më 17 gusht të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Lushnjës e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë së luajtshme për «agjitacion e propagandë kundra pushtetit popullor, duke përhapur disa ide kundërrevolucionare në persona të veçantë». Pas lirimit, u internua në Lushnjë. Vdiq më 21 maj të vitit 1996.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Sektori i Arkivit Shtetëror të Sistemit, Vërtetim, Nr. 1510/8 Prot.; Skifter Këlliçi, *Radio Tirana dhe Konferenca e Tiranës*; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 548.

AHMETI Ismail


Më 4 maj të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Burrelit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 67, 22 korrik 1946, fq. 7.

AHMETI Sadri

Poet, piktor.

Lindi më 23 mars të vitit 1939, në Vuthaj të Plavës (Mali i Zi). Shkollën e mesme të përgjithshme e kreu në Pejë. Më 23 tetor 1957 u arratis në Shqipëri, ku nis dhe kalvari i tij. Sapo mbërriti, u internua në Fermën e Llakatundit për një vit. Më 1958 u dërgua në shkollën e mesme bujqësore në Kavajë, ku filloi vitin e tretë. Më 1959, meqë kishte vizatuar plakun e vitit të ri me arna në gjunjë dhe të ndenjura, u transferuan nga shkolla e Kavajës në shkollën e mesme bujqësore të Fierit. Aty u akuzua se kishte skicuar karikaturën e Hrushovit dhe u internua për 3 muaj në Çermë të Lushnjës. Në vitin 1960 u emërua agronom në Kutalli të Beratit. Nga viti 1962 deri më 1966 punoi në administratën e një ferme në Krujë. Mes viteve 1966-1970 u transferua si dizenjator i rrethit në shërbimet komunale. Në shtator të vitit 1970 fitoi konkursin në Institutin e Lartë të Arteve (sot Akademia e Arteve të Bukura), dega Pikturë, por dy muaj më vonë u arrestuan për agjitacion e propogandë kundër pushtetit popullor. U dënua nga Gjykata Ushtarake e rrethit Tiranë me 4 vjet heqje lirie. Dënimin e vuajti në kampin e Spaçit. U lirua më 1974, dhe u internua në fshatin Balëz të Elbasanit, ku punoi si puntor krahu deri



Sadri Ahmeti

në vitet '90-të. Pas rënies së komunizmit, përfundoi studimet e lëna përgjysmë në Akademinë e Arteve. Vdiq më 24 qershor të vitit 2010 në Tiranë.

Vepra: «Dielli për në Ballkan nuk kalon nëpër Goli Otok» (poezi, 1991), «Një e qeshur harbon nëpër errësirë» (poezi, 1993), «Masakra e Tivarit» (poemë, 1996), «33 vjet në mitrën e ferrit të fjalës» (poezi, 1999), «Vallja e katrahurave» (poezi; Tiranë, 2000), «Loz era me gjethet e vjeshtës sime» (poemë; Tiranë, 2000), «Kalëroj rreth botës mbi re» (poezi; Tiranë, 2001) dhe «Tek lahem në argjendin e hënës» (poezi, 2001) etj.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 194.

AHMETI Safet

Lindi në vitin 1915, në Sarandë. U pushkatua si antikomunist, më 5 shtator 1943.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 128, 129.

AHMETI Serjan

Lindi më 14 dhjetor të vitit 1900, në fshatin Lazarat të Gjirokastrës. U arrestua më 22 maj 1959, dhe më 23 korrik të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «krimin tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës së elektorale për 4 vjet kohë. U lirua më 25 korrik 1967 për plotësim afati.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 549.

AHMETI (AHMETAJ) Siri

Lindi më 22 maj të vitit 1934, në fshatin Mashkullorë të Gjirokastrës. Më 27 dhjetor 1951, Gjykata e Gjirokastrës e dënoi me 8 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës së elektorale për 3 vjet kohë për «agjitacion e propagandë».

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 235.

AHMETI Zylfo

Lindi më 5 mars të vitit 1910, në fshatin Vergo të Sarandës. U arrestua më 30 shtator 1947 dhe më 6 nëntor të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës

e deklaroi «kriminel lufte» dhe e dënoi me vdekje. Më 19 dhjetor 1947, Gjykata e Lartë e ktheu çështën në ngarkim të tij për rigjykim. Dhe kështu, më 9 qeshor 1948, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «pjesëmarrje në organizata antipushtet», dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, punë të detyrueshme si dhe me humbjen e të drejtave civile për 3 vjet kohë.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 551.

AHMETLLARI Baki

Lindi në Skrapar. U dënua dy herë: herën e parë me 20 dhe të dytën me 10 vjet heqje lirie. Gjatë hetuesisë ia shkulën dhëmbët me darë.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 79.

AHMETLLIU Selami

Lindi më 5 dhjetor të vitit 1924, në Korçë. Më 28 prill 1950, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe «moskallzim grupi të organizuar», ndaj e dënoi me 3 vjet burgim e punë të detyruar.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 552.

AJASLLARI (QIMJA) Aqif

Lindi më 15 shkurt të vitit 1919, në fshatin Grevë të Skraparit. Më 3 shkurt 1948, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi «kriminel lufte» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie. Dënimin e vuajti në burgun e Korçës.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 561.

AJAZAJ Azbi

Lindi në fshatin Vranishtë të Vlorës. U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Për këtë arsye, më 21 tetor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Vlorë urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 15, 22 shkurt 1947, f.6.



Beqir Ajazi

AJAZI Beqir

Veprimtar politik, gazetar, përkthyes.

Sado që familja Ajazi është nga fshati Prezë i Tiranës, Beqiri lindi më 20 korrik 1920 në Dibër të Madhe, ku ndodhej atë vit familja e tij. Kreu Liceun e Korçës. Në tetor të vitit 1943 filloi punë si sekretar i tretë në Ministrinë e Kulturës Popullore, redaktor në ATSH dhe, që prej majit 1944, edhe redaktor në «Bashkimi i Kombit». Mori pjesë në Kongresin e Legalitetit të zhvilluar në Herr të Tiranës, më 1943. Është një prej të burgosurve të parë politikë në Shqipërinë komuniste. U arrestua më 21 nëntor të vitit 1944. Më 29 maj 1945, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me vdekje, si dhe konfiskim të pasurisë për «krime lufte». Më vonë dënimi iu ul në 15 vjet heqje lirie, të cilat i vuajti nëpër kampe e burgje të ndryshme. Dhjet vjet të tjera i kaloi në internim. Më 10 maj 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Shijakut urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme. Në vitin 2002, Shteti Francez e dekoroi me titullin e lartë «Kalorës i Urdhrit të Meritës».

Vepra: «Nga Shkaba me kurorë tek Dripi me çekan» (*kujtime, 2000, 2007*), «Nuk

m'u nda burgu i Burrelit» (*kujtime, 2002*), «Sure Ajazi, ky kreshnik i kohës sonë» (*kujtime, 2005*), «Kush ishte Enver Hoxha» (2007) etj. *Përkthime:* «Tristani dhe Izolta», «Spastrimi etnik», «Henrieta», «Lufta e pashenjhtë» etj.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 268; *Gazeta Zyrtare*, nr. 73, 6 gusht 1946, f. 5.

AJAZI Bexhet

Lindi më 19 janar të vitit 1922, në Vlorë. U arrestua më 18 maj 1946 dhe më 24 qershor të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për tentativë për «përmbysjen dhe sabotimin e Pushtetit me vjolencë». Për këtë arsye e dënoi me vdekje dhe me konfiskimin e pasurisë së tij të luajtshme e të paluajtshme. U ekzekutua më 11 korrik 1946. Disa muaj më vonë, më 4 dhjetor të po atij viti, u zbatua edhe vendimi i Komitetit Ekzekutiv të Nënprefekturës Qendër Vlorë për sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 181, 182; *Gazeta Zyrtare*, nr. 16, 24 shkurt 1947, f. 4.

AJAZI Galjana (Ana)

Lindi më 4 prill të vitit 1958, në Korçë. Më 9 gusht 1984, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtoreshë për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor», dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 555.

AJAZI Haxhi

Lindi në vitin 1923, në Kolonjë. Më 19 shtator 1949, Gjykata Ushtarake e Kolonjës e deklaroi «kriminel lufte» dhe «armik i popullit» për «pjesëmarrje në organizatën e Ballit Kombëtar» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie dhe humbjen e të drejtave qytetare.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 556.

AJAZI Mersin

Lindi më 15 shtator të vitit 1923, në Kolonjë. Më 19 shtator 1945, Gjykata



Burgu i Burrelit, 1993

Ushtarake e Kolonjës e deklaroi «kriminel lufte, armik i popullit si pjesëmarrës në organizatën e Ballit Kombëtar», dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie dhe humbjen e të drejtave qytetare baraz me kohën e dënimit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 556.

AJAZI Osman Xhetan

Oficer.

Lindi më 25 prill të vitit 1904, në fshatin Armollë të Lurës. U pushkatua pa gjyq për motive politike, më 25 dhjetor 1943.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 91, 92.

AJAZI Osman Murat

Lindi në vitin 1923, në Shkodër. Më 14 tetor 1973, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «krimet e tradhëtisë ndaj atdheut mbetur në fazën e përgatitjes... dhe agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 557.

AJAZI Selami

Lindi më 3 shkurt të vitit 1908, në Leskovik. Më 23 dhjetor 1947, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor «për bashkëpunim me organet tradhtare të Ballit dhe të Legalitetit» dhe se «pas Çlirimit ka vazhduar aktivitetin e tij antipushtetar dhe popullor», ndaj e dënoi me 2 vjet burgim me punë të detyruar, humbjen e të drejtave elektorale dhe konfiskimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 558.

AJAZI Sul

Lindi në vitin 1903, në Lurë. Më 13 gusht 1946, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi «armik i popullit», dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 559.

AJAZI Sure

Ushtarak.

Lindi në fshatin Prezë të Tiranës. Shër-

beu si oficer në ushtrinë franceze. U shpall «kriminel lufte dhe armik i popullit». Për këtë arsye, më 10 maj 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Shijakut urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme. Një vit e gjysmë më vonë, më 11 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Tiranës përsëriti urdhërin për sekuestrimin e pasurisë së tij të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 73, 6 gusht 1946, f. 5; *Gazeta Zyrtare*, nr. 7, 31 kallnor 1947, f. 2.

AJDINI (CENKA) Rexhep

Lindi më 17 maj të vitit 1890, në fshatin Hingë të Beratit. Më 9 tetor 1945, Gjykata Ushtarake e Fierit e shpalli fajtor si «armik të popullit dhe kriminel lufte» dhe e dënoi me vdekje e konfiskimin e pasurisë së tij të luajtshme e të paluajtshme.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 106, 107, 108.

AJDHONI Dhimitër

Lindi më 15 prill të vitit 1911, në fshatin Çatistë të Pogonit, Gjirokastrë. U arrestua më 17 janar 1949 dhe më 23 shtator të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «kriminelin e agjitacionit e propagandës», dhe e dënoi me 6 vjet burgim dhe punë të detyruar.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 564.

AJDHONI Niko

Lindi më 23 maj të vitit 1939, në Gjirokastrë. Më 30 qershor 1979, Gjykata e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «kriminelin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe dënoi me 10 vjet heqje lirie, 5 vjet internim dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 239.

AJUPI Ismail

Lindi në fshatin Grebllesh të Tiranës. U deklarua «armik i popullit». Për këtë arsye, më 31 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së

Shijakut vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 46, 19 maj 1947, f.6.

AKCANI (HAKCANI) Agim

Lindi më 30 shtator të vitit 1953, në Tiranë. U arrestua më 10 nëntor 1975. Më 31 janar 1977, Gjykata e Tiranës e deklaroi fajtor «për kriminelin e pjesëmarrjes në organizatë kriminale kundër pushtetit popullor, agjitacion dhe propagandë me qëllim minimin e pushtetit dhe diversion», dhe u dënua me 21 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e të drejtës elektorale për 4 vjet kohë. U lirua në vitin 1989.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Zyra e Gjendjes Gjyqësore, Vërtetim Gjyqësor, nr. 4218 i Prot.

AKULLI Dilaver

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1923, në fshatin Allambrez të Beratit. Gjatë luftës u rrjeshtua në radhët e Ballit Kombëtar. Mori pjesë në luftime me çetën e Ali Zenelit nga Aranitasi i rrethit të Fierit. U vra në fshatin e lindjes, më 30 nëntor të vitit 1943, në përpjekje me «forcat partizane të komanduara nga Neshat Hysi», komandant i çetës partizane të Skraparit.

Republika e Shqipërisë, Gjykata e Rrethit Berat, Vendim nr. 1391; Republika e Shqipërisë, Qarku Berat, Rrethi Berat, Zyra e Gjendjes Civile, Çertifikatë vdekjeje, nr. 001 010066.

ALANAJ (KELO) Valentina

Lindi më 1940, në Rusi. Më 30 qershor 1979, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «kriminelin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me nëntë vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 566.

ALARUPI Meropi

Lindi më 29 maj të vitit 1923, në Korçë. Më 12 dhjetor 1947, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «kriminelin e agjitacionit e propagandës kundër formave të pushtetit» dhe e dënoi me dy vjet heqje lirie.



FILLON SEANCA E IRË DHE ME TE FILLONJË TË DALIN NË SHESH KRIMET E ARMIQVE TË POPULLIT.-

Gjyqi kundër anëtarëve të «Bashkimit Demokrat Shqiptar», 1946

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 567.

ALBRAHIMI Besim

Lindi më 4 mars të vitit 1952, në fshatin Lunik të Librazhdit. Më 6 mars 1978, Gjykata e Rrethit të Librazhdit e deklaroi fajtor për «sabotim të kryer në bashkëpunim» dhe e dënoi me pesëmbëdhjetë vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për pesë vjet kohë. Vendimi mori formën e prerë pasi u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë më 31 mars 1979.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

ALBRAHIMI Hamit

Lindi më 1 tetor të vitit 1900, në fshatin Lunik të Librazhdit. Më 28 dhjetor 1946, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor si «armik të popullit» dhe «sabotator

të pushtetit» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 568.

ALBRAHIMI (KODRALIU) Ismail

Lindi më 9 nëntor të vitit 1928, në fshatin Lunik të Librazhdit. Më 18 tetor 1977, Gjykata e Rrethit të Librazhdit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 569.

ALBRAHIMI Muharrem

Lindi më 29 korrik të vitit 1944, në fshatin Lunik të Librazhdit. Më 2 tetor 1978, Gjykata e Rrethit të Librazhdit e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me shtatë vjet heqje lirie. Vendimi mori formën e

prerë pasi u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 21 tetor 1978. U lirua me dekret nr. 6656, më 28 tetor të vitit 1982.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

ALBRAHIMI (SELMANI) Riza

Lindi më 1920, në Elbasan. Më 31 tetor 1946, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krime kundër shtetit» dhe e dënoi me tridhjetë vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale. Më 1958, dënimi iu kthye në njëzet vjet heqje lirie.

AIKSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 570.

ALBRAHIMI Seit

Lindi më 12 shkurt të vitit 1916, në fshatin Lunik të Librazhdit. Më 25 mars 1947, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor për «krime kundër shtetit» dhe e dënoi me dy vjet burg. U arrestua sërish më 1977, dhe më 6 mars të po atij viti, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Librazhdit e deklaroi fajtor për «krimet e sabotimit dhe agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AIKSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 571.

ALCANI Isak

Lindi në vitin 1886, në fshatin Neshtë të Librazhdit. Më 20 qershor 1945, Gjykata ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor për «krime të kryera gjatë luftës» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie. Por më 28 dhjetor 1946, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor si «armik të popullit dhe sabotator» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AIKSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 572.

ALEBOKU Ymer

Lindi më 10 prill të vitit 1915, në Kavajë. Më 1943 u rrjeshtua në radhët e forcave nacionaliste të Ballit Kombëtar. Në

qershor të vitit 1944 u pushkatua pa gjyq në shtëpinë tij nga forcat komuniste.

AIKSK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 143-144, 145.

ALEKSI Vasil

Lindi më 14 korrik të vitit 1920, në fshatin Jergucat të Gjirokastrës. Më 14 maj të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Qendrës Korçë vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 53, 3 qershor 1947, f. 7.

ALEMI Alajdin

Lindi më 20 qershor të vitit 1934, në fshatin Tragjas të Vlorës. U arrestua më 1950 dhe më 21 shtator të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor «se në bashkëpunim me të tjerë ka formuar grupin e të rinjve në gjimnazin "Ali Demi", grup i cili vepronte kundra pushtetit, duke bërë mbledhje në të cilat ka qenë vendosur që të shkruheshin parulla kundra pushtetit dhe udhëheqjes së tij», dhe e dënoi me 15 vjet privim lirie me punë të detyruar, me humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë dhe me konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të palu-



Alajdin Alemi

ajtshme. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë Ushtarake, më 16 shkurt 1951. I ati, Mehmet Alemi, qe dënuar me vdekje (në mungesë). U lirua në vitin 1962, pastaj u internua familjarisht.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 358.

ALETI Zeqir

Lindi më 3 maj të vitit 1928, në fshatin Bërdicë të Shkodrës. Më 9 shtator 1970, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut dhe agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 575.

ALHASA Hysen

Lindi më 7 gusht të vitit 1921, në Martanesh. Më 11 shtator 1948, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi «armik të popullit dhe kriminel lufte» dhe e dënoi me shtatë vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 576.

ALI Gani

Lindi më 16 shkurt të vitit 1951, në Tiranë. Më 29 mars 1979, Gjykata e Tiranës e dënoi e dënoi me 12 vjet heqje lirie dhe 3 vjet internim për «tradhëti ndaj atdheut» (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 299.

ALI Përparim

Lindi më 7 korrik të vitit 1957, në fshatin Kamenicë të Korçës. Më 14 korrik 1977, Kolegji Ushtarak i Gjykatës Korçë e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «agjitacion e propagandë» (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 193.

ALI (LIÇO) Riza

Lindi në vitin 1880, në fshatin Bazhanj të Kolonjës. Më 12 shtator 1950, Gjykata Ushtarake Territoriale e Korçës e deklaroi fajtor për «strehim dhe furnizim të diversantëve» dhe e dënoi me 5 vjet

heqje lirie, konfiskimin e florinjve dhënë nga diversantët dhe heqjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 577.

ALI Qazim

Lindi më 6 maj të vitit 1947, në Berat. Më 17 tetor 1975, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 214.

ALI (TOSKA) Ymer

Lindi më 24 qeshor të vitit 1936, në Rrogozhinë. Më 14 gusht 1976, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 578.

ALIA Ali

Lindi më 10 tetor të vitit 1888, në Shkodër. Më 1 dhjetor 1947, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «strehim dhe furnizim të të arratisurve» dhe e dënoi me vdekje. Por pas amnistisë së dekretuar nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, dënimi iu kthye në burgim të përjetshëm dhe konfiskim të pasurisë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 579.

ALIA Demir

Lindi më 20 tetor të vitit 1937, në Kukës. Më 11 tetor 1977, Gjykata e Rrethit të Tepelenës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 581.

ALIA Halil

Ushtarak.

Lindi më 15 korrik të vitit 1910, në fshatin Fushë-Alie të Peshkopisë. Mbaroi «Mejtepin» në Kalis tek sheh Rrema. Pastaj ndoqi shkollën konviktore 6 vjeçare «Internat Dibra» në Kastriot, të cilën e

mbaroi në vitin 1929. Më 1933 kreu Shkollën Mbretnore Ushtarake, Dega Fonderi-Artileri, në Tiranë. Fill pas mbarimit të shkollës, mori gradën nëntoger artillerie. Por pikërisht në këtë kohë, më 8 tetor të vitit 1933 vrau shokun e tij të shkollës, Mehmet Murat Kaloshin. U dënua nga gjykata e Tiranës në mungesë me dënimin maksimal që përmbante Kodi Penal i Mbretërisë; më 24 tetor 1933 iu hoq dhe gradua ushtarake. Për më tepër, familja Alia u internua për tre vjet në Mallakastër. Përfitoi nga amnistia e shpallur më 22 qershor 1939 me dekret mbretëror dhe, pas një muaji, më 20 korrik të të njëjtit vit u kthye në Fushë-Alie, pasi kishte qëndruar në arrati në Kosovë nga 10 dhjetori i vitit 1936 kur u largua nga Dibra. Pas pushtimit italian të Shqipërisë, Halil Alia u kthye në punë me gradën e mëparshme si komandant i Baterisë 75/13 dhe u caktua nënpunës shërbimi në Shkodër. Që këtu u thirr në Tiranë, ku mori detyrën për formimin e reparteve të milicisë në Dibër. Më 11 maj 1942 u zgjodh deputet i Tokave të Lirue. Më 8 korrik 1944 u zgjodh unanimitisht kryetar i Besëlidhjes Antikomuniste, që u mbajt në Fushë-Alie me pjesëmarrjen e më shumë se 5000 burrave të ardhura nga e gjithë treva. Më 22 dhjetor të vitit 1944, u rrethua nga forcat partizane të brigadave 17 dhe 18 të kompanisë së shtabit të Divizionit të dytë në shtëpinë e Arif Muratit (Ratës), në fshatin Kolosjan të Lumës dhe, pas shumë orësh luftimi, u vra tek po përpiquej të çante rrethimin. Më 29 dhjetor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Shumbatit, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Asllan Loka, *Shqipëria, Dibra, Aliajt dhe Hali Alia*, Tiranë, 2008, f. 50-54, 86, 144, 227, 272-275; *Fletorja Zyrtare e Mbretërisë Shqiptare*, nr. 38, 24 qershor 1939; AQSh, F. 165, viti 1941, D. 11, fl. 118; *Gazeta Zyrtare*, nr. 7, 24 kallnor 1946, f. 5-6.

ALIA Hamdi

Lindi në fshatin Hoxhare të Fierit. U dënua si «kriminel lufte». Më 14

shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Fierit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 51, 12 qeshor 1946, fq. 4.

ALIA Hazis

Lindi më 5 mars të vitit 1914, në Fushë Alie të Dibrës. U vra pa gjyq, më 10 tetor 1943, për motive politike.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 40, 41.

ALIA Maliq

Lindi më 1 dhjetor të vitit 1890, në fshatin Fushë Alie të Dibrës. U vra pa gjyq, më 1 qershor 1944, në Merah të Kukësit, për motive politike.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 54, 56.

ALIA Mark

Lindi më 13 qeshor të vitit 1895, në fshatin Kryezi të Pukës. Më 17 janar 1978, Gjykata e Rrethit të Pukës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 582.

ALIA Metush

Lindi në fshatin Kullaj të Postribës. Mori pjesë në kryengritjen që u bë e njohur me emrin e kësaj krahine. U arrestua po atë ditë, pas shtypjes së kryengritjes, dhe të nesërmen, më 10 shtator të vitit 1946, u pushkatua në fushë të Shtojit, bashkë me njëmbëdhjetë kryengritës të tjerë.

Uran Butka, *Kryengritja e Postribës*, në «Almanak 1», Tiranë, 2011, f. 69; «Shekulli», qershor 2007.

ALIA Qemal

Lindi në vitin 1928, në fshatin Kuç të Vlorës. U arrestua më 1950 dhe u dënua me 10 vjet burg për «tentativë arratisje». U lirua në vitin 1956.

ALIA Zenun

Lindi në fshatin Bujan të Tropojës. U vra si «kriminel lufte dhe armik i popullit».

Për këtë arsye, më 6 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Tropojës urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 34, 18 prill 1947, f. 4.

ALIA Shaban

Lindi më 10 shkurt të vitit 1920, në fshatin Mustafe të Dibrës. U pushkatua pa gjyq për motive politike, më 7 korrik 1944.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 97, 98.

ALIA Xhelal

Lindi më 25 shkurt të vitit 1948, në fshatin Brekije të Kukësit. Më 14 mars 1977, Gjykata e Rrethit të Kukësit e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 616.

ALIAGAJ Karafil

Lindi më 10 mars të vitit 1899, në fshatin Zhepovë të Përmetit. Më 22 shtator 1945, Gjykata Ushtarake e Beratit e deklaroi «armik i popullit» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie, punë të detyruar, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e të drejtave civile e politike. Konform dekretit të faljes, dënimi iu zbrit në 15 vjet burg.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 610.

ALIAJ Avni

Lindi më 30 mars të vitit 1930, në fshatin Çorrush të Fierit. Më 19 shtator 1952, Gjykata Ushtarake e Durrësit e deklaroi fajtor «se ka strehuar dhe furnizuar kriminelët me bashkëveprim», dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie, por u la i lirë me vendim të Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë. U arrestua sërish më 1981, dhe më 5 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor «për agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 399.

ALIAJ Bajram

Lindi më 10 gusht të vitit 1908, në fshatin Babinë të Tropojës. Më 17 korrik 1953 Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krim në bashkëpunim me diversantët» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 584.

ALIAJ Dedë

Lindi më 18 tetor të vitit 1920, në fshatin Lekbibaj të Tropojës. U vra pa gjyq në fshatin e lindjes më 24 shtator 1948 për motive politike.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 15, 16.

ALIAJ (AGAJ) Hate

Lindi në vitin 5 mars të vitit 1892, në Vlorë. Më 27 janar 1947, Gjykata Ushtarake e Vlorës e deklaroi fajtor për «strehim të të arratisurve dhe kriminelëve të luftës» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 10 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 586.

ALIAJ Hysni

Lindi më 18 qershor të vitit 1944, në Kukës. Më 27 korrik 1975, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «krimin e sabotimit» dhe e dënoi me 22 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 587.

ALIAJ Ibrahim

Lindi më 22 shkurt të vitit 1937, në fshatin Kërnajë të Tropojës. Më 17 korrik 1959, Gjykata e Tropojës e dënoi me 10 vjet heqje lirie për «tentativë arratisjeje jashtë shtetit».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 120.

ALIAJ Përparim

Lindi më 25 shkurt të vitit 1949, në fshatin Shkozë të Vlorës. Më 4 tetor 1975, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor

për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 589.

ALIAJ (NIKPRENDAJ, PRENDAJ) Pjetër

Lindi më 12 tetor të vitit 1920, në Lekbibaj të Tropojës. Më 13 tetor 1950, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë e deklaroi fajtor për «dezertim nga ushtria dhe qëndrim me banda të armatosura» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 590.

ALIAJ (META) Ramë

Lindi më 4 shkurt të vitit 1927, në fshatin Zgjeç të Kukësit. Më 17 dhjetor 1958, Gjykata ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 641.

ALIAJ Ramazan

Lindi më 9 maj të vitit 1955, në qytetin e Tiranës. Më 24 dhjetor 1984, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut në formën e arratisjes» dhe e dënoi me shtatë vjet heqje lirie dhe pesë vjet internim. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë më 16 janar 1985.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

ALIAJ Rustem Ali

Lindi më 10 korrik të vitit 1956, në qytetin e Tiranës. Më 24 dhjetor 1972, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut në formën e arratisjes» dhe e dënoi me tetë vjet heqje lirie.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

ALIAJ Rustem Shaip

Lindi më 27 gusht të vitit 1905, në fshatin Çorrush të Fierit. Më 9 tetor 1945, Gjykata Ushtarake e Fierit e deklaroi fajtor si «kriminel luftime dhe armik i popullit» dhe e dënoi me burgim të përjetshëm, humbjen e së drejtës elektorale baraz me kohën e ndëshkimit, si dhe me konfiskimin e pasurisë. Me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor iu zbrit dënimi në 7 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 591.

ALIAJ Sabri

Lindi më 2 prill të vitit 1953, në Tiranë. Më 24 shkurt 1972, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «përgatitje për arratisje» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë. Gjatë kohës së vuajtjes së dënimit tentoi të arratisesh nga burgu, ndaj dhe më 26 qershor 1972, Gjykata e Elbasanit e ridënoi me një vit burg për «krimin e arratisjes nga vendi i vuajtjes së dënimit të mbetur në tentativë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 593.

ALIAJ Sadik

Lindi më 1 maj të vitit 1889, në fshatin Zgjeç të Hasit. Më 28 maj 1951, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «strehim të të arratisurve dhe furnizim të kriminelave» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 592.

ALIAJ Skënder

Lindi në vitin 1930, në Pogradec. Më 13 janar 1959, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e përgatitjes për t'u arratisur jashtë shtetit» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 594.

ALIAJ Tahir

Lindi më 15 korrik të vitit 1916, në

fshatin Babinë të Tropojës. Më 20 shtator 1952, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «strehim dhe furnizim të kriminelave» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për një vit kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 598.

ALIAJ Ukë

Lindi më 10 qeshor të vitit 1916, në fshatin Babinë të Tropojës. Më 18 qershor 1953, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «bashkëpunim me diversantët» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 597.

ALIAJ Xhevit Avni

Lindi më 28 nëntor të vitit 1957, në Fier. Më 10 nëntor 1989, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 373.

ALIAJ Xhevit Shaip

Lindi më 18 korrik të vitit 1917, në fshatin Çorrush të Mallakastrës. Gjatë luftës udhëhoqi çetën nacionaliste të fshatit të tij. U vra më 31 dhjetor të vitit 1943, në Kras të Tepelenës, në përpjekje me forcat komuniste.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 160, 161.

ALIAJ Ylli

Lindi më 29 shkurt të vitit 1950 në Tiranë. Më 20 janar 1969, Gjykata e Tiranës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë» dhe «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 306.

ALIBALI Ylli

Lindi më 1 shtator të vitit 1936, në Gjirokastrë. Më 23 gusht 1975, Gjykata

Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 107.

ALIBALI Xhevat

Lindi më 12 nëntor të vitit 1932, në Shkodër. Më 23 gusht 1975, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 601.

ALIBEAJ Avni

Lindi më 18 gusht të vitit 1928, në fshatin Varibop të Fierit. U vra pa gjyq për motive politike, më 16 dhjetor të vitit 1943.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 179, 180.

ALIBEAJ Ferik

Lindi më 22 shkurt të vitit 1925, në Fier. Më 3 shtator 1959, Gjykata e Vlorës e dënoi me 5 vjet heqje lirie për «agjitacion dhe propagandë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 105.

ALIBEAJ Ferman

Lindi më 16 maj të vitit 1911, në fshatin Varibop të Fierit. Më 29 gusht 1947, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «përgatitje arratisjeje» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë. Më dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor, dënimi iu zbrit në tre vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 604.

ALIBEAJ (HOXHA) Iljaz

Lindi më 6 prill të vitit 1912, në fshatin Varibop të Fierit. Më 15 qershor 1949, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut, stre-

him diversantësh dhe agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për dy vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 606.

ALIBRAHA Braho

Lindi në vitin 1865, në fshatin Shipshan të Tropojës. U arrestua më 15 mars 1945, dhe më 15 maj të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e dënoi me 6 vjet burg si «kriminel lufte».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 642.

ALIÇKA Avni

Lindi më 1 qeshor të vitit 1912, në fshatin Orgockë të Korçës. Më 14 shtator 1946, Gjykata Ushtarake e Korçës deklaroi fajtor si «armik të popullit, sabotator të pushteti dhe pjesëmarrës në organizatën e Ballit Kombëtar» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale baraz me kohën e dënimit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 607.

ALIÇKA Gazi

Lindi më 22 janar të vitit 1910, në fshatin Orgockë të Kolonjës. Më 10 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kolonjës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 120, 31 dhjetor 1946, f. 4.

ALIÇKA Hajredin

Lindi më 20 maj të vitit 1895, në fshatin Orgockë të Kolonjës. Gjatë luftës u inkuadrua në forcat e Ballit Kombëtar për Kolonjën dhe luftoi në çetën e Safet Butkës [*shih*]. U vra në përpjekje me forcat partizane, më 17 nëntor 1943, në fshatin Kurtës, dhe u varros në Orgockë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 31, 32.

ALIÇKOLLI Gëzim

Lindi më 25 janar të vitit 1946, në fshatin Kapshticë të Devollit. Më 28 korrik 1987, Gjykata e Lushnjës e dënoi me 18 vjet heqje

lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «tradhëti ndaj atdheut».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 298.

ALIÇO Xhelo

Lindi më 16 mars të vitit 1910, në Konispol. U akuzua për krime lufte. Më 12 prill 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. së Nënprefekturës së Konispolit urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 67, 22 korrik 1946, fq. 2.

ALIDINAJ (SALI) Bahri

Lindi më 2 mars të vitit 1926 në fshatin Dersnik të Korçës. Më 21 nëntor 1945, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi «kriminel lufte dhe armik i popullit» dhe e dënoi me 15 vjet burg me punë të detyruar, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale baraz me kohën e dënimit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 608.

ALIHoxHAJ (HOXHAJ) Nase (Nastradin)

Lindi më 3 nëntor të vitit 1931, në Tepelenë. Më 19 korrik 1956, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «tetativë arratisjeje në një shtet të huaj dhe për tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë dhe heqjen e dekoratës. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë, më 30 korrik 1956.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 407.

ALIJA Abdullah

Lindi më 1 shkurt të vitit 1886, në fshatin Fushë Alije të Dibrës. U vra më 1 qershor 1944 për motive politike.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 2.

ALIJA Beqir

Inxhinier gjeolog, drejtor i Institutit Gjeologjik të Naftës e Gazit (janar 1971-mars 1975).

Lindi më 7 prill të vitit 1927 në Shkodër.



Burgu i Ballshit

Kreu studimet për inxhinieri gjeologjie në Bashikimin Sovjetik. Nga janari i vitit 1971 deri në mars 1975 ishte drejtor i Institutit Gjeologjik të Naftës e Gazit. U arrestua në 25 mars të po atij viti. Një vit më vonë, më 17 qershor 1976, Gjykata e Lartë e dënoi me 25 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë, humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë dhe heqjen e të gjitha dekoratave, si sabotator në «grupin e naftës». U riarrestua më 21 shkurt të vitit 1979, si anëtar i një organizate të paqenë, që u pagëzua «Revizioniste e majtë», e cila, sipas akuzës, ishte krijuar «për të kryer krime kundër shtetit...». Gjyqi ndaj tij dhe nëntë të dënuarve të tjerë, Fadil Kokomanit [shih], Vangjel Lezhos [shih], Xhaferr Xhomos [shih], Muho Balës [shih], Fatos Lubonjës [shih], Nuredin Skraparit [shih], Robert Vullkanit [shih] dhe Petrit

Orietit [shih], filloi më 9 maj të vitit 1979. Dhe nëntë ditë më vonë, më 18 maj 1979, Gjykata e Lartë e dënoi me 23 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 371; Fatos Lubonja, *Ridënimi*, Tiranë, 2007, II, XIX, f. 120; III, XXVI, f. 176-177; III, XXXIII, f. 235; III, XXXV, f. 264-265; Shpëtim Koli, *Grupi i «sabotorëve» të naftës*, në «Mapo», E mërkurë, 31 gusht 2011, f. 18-19.

ALIJA Brah

Lindi në fshatin Busaj të Tropojës. U dënua si kriminel lufte dhe armik i popullit. Për këtë arsye, më 6 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Tropojës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 34, 18 prill 1947, f. 3.

ALIJA Besnik

Lindi më 22 prill të vitit 1970, në Shkodër. Më 8 prill 1986, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 611.

ALIJA Ibrahim

Lindi në vitin 1913, në Shkodër. Më 19 qershor 1957, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë» e «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1 V. 2012, D. 1, Fl. 640.

ALIJA Isa

Lindi më 2 dhjetor të vitit 1924, në fshatin Rragam të Shkodrës. Më 18 dhjetor 1947, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krime kundër popullit dhe shtetit» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 612.

ALIJA Jonuz

Lindi më 6 janar të vitit 1909, në fshatin Rragam të Shkodrës. Më 18 dhjetor 1947, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krime kundër popullit dhe shtetit» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 613.

ALIJA Mark

Lindi më 3 shkurt të viti 1939, në Mamurras të Kurbinit. U arrestua më 24 prill të vitit 1958. Më 11 qershor 1958 Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë e dënoi «për tradhti ndaj atdheut mbetur në fazën e përgatitjes për t'u arratisur jashtë shtetit me 6 (gjashtë) vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme dhe me humbjen e së drejtës elektorale për dy vjet kohë». U lirua më 2 qershor 1963. Që pas daljes nga burgu, e deri në vitin 1990 punoi si specialist ndërtimi në Ndërma-

rrjen NSHN Banesa të Laçit. Në vitin 1992 u emërua drejtor i Ndërmarrjes Komonale të Laçit. Në vitin 1995 u emërua shef i administratës në Drejtorinë e Personelit të Ministrisë së Jashtme. Më 1997, me kërkesën e tij u largua nga ai dikaster dhe u emërua shef i shërbimeve dhe marrëdhënieve me jashtë, si dhe nënkryetar në Bashkinë e Mamurrasit. Më 2006 filloi punë në drejtorinë e Shërbimit Diplomatik. Është autor i librave: «Saipi» (*tregime*), «Kodra e Kovaçit» (*roman*), «Dasëm në vjeshtë» (*roman*; *Enti Botues «Gjergj Fishta»*).

Republika Popullore e Shqipërisë, Gjykata e Lartë, «Kolegji Ushtarak», Nr. 71 i Radhorit themeltar, Nr. 2 i Vendimit; Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Zyra e Gjendjes Gjyqësore, Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore Nr. 4218 i Prot.; Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Sektori i Arkivit Shtetëror të Sistemit, Vërtetim, Nr. 1717/1 i Prot.

ALIJA Shaban

Lindi më 10 shkurt të vitit 1897, në fshatin Gur i Zi të Shkodrës. Më 27 nëntor 1947, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krime gjatë luftës N.ÇI» dhe e dënoi me burgim të përjetshëm, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e përhershme të së drejtës elektorale.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 596.

ALIJA Tahir

Lindi më 26 shtator të vitit 1939, në Shkodër. Më 24 gusht 1962, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «tentativë për të kryer krimin e tradhëtisë ndaj atdheut me anë të arratisjes jashtë» dhe dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë (dënim i kombinuar). Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë, më 23 tetor të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 439.

ALIJA Zef

Lindi në vitin 1900, në Peraj të Njakaj. Më 25 tetor 1946, Gjykata Ushtarake



Pamje nga Gjyqi Special, prill 1945

e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krime kundër shtetit» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale baraz me kohën e dënimit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 618.

ALIKAJ Bilal

Lindi më 7 qershor 1890, në fshatin Mashkullorë të Gjirokastrës. Fill pas luftës u arrestua si pjesëmarrës aktiv i Ballit Kombëtar. U arratis nga burgu i Gjirokastrës dhe, teksa po përpiqej të kalonte kufirin me Greqinë, më 16 gusht 1948 u vra nga forcat e Sigurimit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 10, 11.

ALIKAJ Jazo

Lindi më 2 gusht të viti 1916 në fshatin Bolenë të Vlorës. Më 13 shtator 1945, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e dënoi me vdekje, humbjen e të drejtave qytetare dhe politike, si dhe konfiskimin e pasurisë

së luajtshme e të paluajtshme, si «kriminel luftime dhe armik të popullit». Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 5 tetor 1945. U ekzekutua më 9 nëntor të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 245, 246.

ALIKO Aliko

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1920, në fshatin Golëm të Gjirokastrës. Gjatë luftës u rrjeshtua në radhët e forcave të Ballit Kombëtar. Më 26 korrik të vitit 1944 u kap, bashkë me të vëllanë, Avdul Alikon [shih], nga forcat partizane të Brigadës VI dhe u pushkatua në fshatin Kodër të Tepelenës.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 176, 177.

ALIKO Avdul

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1918, në fshatin Golëm të Gjirokastrës. Gjatë luftës u rrjeshtua në radhët e forcave të Ballit

Kombëtar. Më 26 korrik të vitit 1944 u kap, bashkë me të vëllanë, Aliko Alikon [*shih*], nga forcat partizane të Brigadës VI dhe u pushkatua në fshatin Kodër të Tepelenës.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 176, 177, 178.

ALIKO Avni

Lindi më 11 mars të vitit 1949, në Korçë. Më 27 tetor 1973, Gjykata e Rrethit të Fierit e dënoi me 25 vjet heqje lirie për «tradhëti ndaj atdheut mbetur në fazën e përgatitjes» (dënim i kombinuar).

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 342.

ALIKO Hetem

Lindi në fshatin Lazarat të Gjirokastrës. Studimet e larta i kreu në Universitetin e Barit, në Itali. U shpall «armik i popullit». Komiteti Ekzekutiv i K.P. të qytetit të Gjirokastrës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta *Lazarati*, dhjetor 2008; *Gazeta Zyrtare*, nr. 61, 26 maj 1948, fq. 6.

ALIKO Jazo

Lindi në fshatin Bolenë të Kurveleshit. U dënua si kriminel luftime dhe armik i popullit. Për këtë arsye, më 7 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Kurveleshit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij, të luajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 36, 23 prill 1947, f. 8.

ALIKO Mustafa

Lindi në vitin 1919, në fshatin Kuç të Vlorës. U arrestua më 23 mars 1945, dhe më 19 shtator të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi «kriminel luftime dhe armik i popullit» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie, punë të detyrueshme dhe humbjen e të drejtave qytetare për 2 vjet kohë. U lirua me amnisti, më 28 nëntor 1945.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 649.

ALIKO Tomorr

Lindi më 10 korrik të vitit 1925, në Libohovë. Në moshën 17-vjeçare aderoi

në Ballin Kombëtar. Në vitin 1945 u arratis në Greqi, ku u inkuadrua në forcat Aleate. Pas gjashtë muajsh, u kap në kufi. Më 9 dhjetor 1947, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 20 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për «dhënie informacioni të huajve kundër shtetit». Pas kryerjes së dënimit, u internua për 29 vjet në Mamurras. U lirua në vitin 1991.

Vepra: «Fundi i udhës së gjatë» (1999), «Gjysmë shekull në kthetrat e djallit» (*Tiranë*, 2003), «Genocidi mbi eliten intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist/Genocide on the intellectual elite of the albanian nation under the communist terror» (*Tiranë*, 2007), «Genocidi gjysëmshkullor në Shqipëri/The half century genocide in Albania» (*Emal*, *Tiranë*, 2010). Tomorr Alikoja është dhe autor i skenarit të filmit dokumentar «Zhdukja e inteligjencës shqiptare gjatë vitëve 1944-1951 », prodhim i Televizionit Publik Shqiptar (2008).

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 139.

ALIKOLLARI Muharrem

Lindi në vitin 1939, në fshatin Fratar të Përmetit. Më 6 dhjetor 1957, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «kriminel e arratisjes nga vendi i internimit» dhe dënoi me 5 vjet burg.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 619.

ALIMADHI Fadil

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1927, në fshatin Kuç të Skraparit. Më 1 qershor 1945, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë e deklaroi fajtor «për hapjen e parullave disfatiste në ushtri» dhe për tentativë arratisjeje dhe e dënoi me vdekje. U ekzekutua më 30 qershor të po atij viti.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 209, 210, 211.

ALIMADHI Nexhip

Lindi më 30 shtator të vitit 1915, në fshatin Kuç të Skraparit. Më 19 maj 1971, Gjykata e Rrethit të Skraparit e deklaroi fajtor për «kriminel e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor»

dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 630.

ALIMADHI Sadik

Lindi më 20 maj të vitit 1919, në fshatin Kuç të Skraparit. Më 19 maj 1971, Gjykata e Rrethit të Skraparit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 631.

ALIMANI Flamur (Osman)

Lindi më 18 mars të vitit 1949 në Tiranë. U arrestua më 22 maj 1974, dhe më 8 korrik të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1984, dhe më datë 12 janar 1945, Gjykata e Rrethit të Fieritit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet burg.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 632.

ALIMANI Rexhep

Lindi në vitin 1920 në fshatin Marglliç të Çamërisë. Më 15 korrik 1970, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 5 vjet burg.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 633.

ALIMEHMETI Bedri

Gazetar sportiv.

Lindi në vitin 1945 në Tiranë. Ka botuar librin «Tirana e përgjakur», për ekzekutimet pa gjyq që u bënë në Tiranë në muajt tetor-nëntor të vitit 1944.

Vepra: «Tirana e përgjakur: poemë dhimbjeje për ata që nuk duhet të ishin vrarë. Masakra e terrorit komunist në Tiranë, 28 tetor 1944–16 nëntor 1944» (*Tiranë, 2001*); «Skënder Halili: vezullimi i një ylli» (*Tiranë, 2008*), «Shyqyri Rreli: një jetë për futbollin shqiptar» (*Tiranë, 2010*),

ALIMEHMETI Xhemal

Lindi në Tiranë, në vitin 1923. Kreu gjimnazin e Tiranës më 1943. Që në bankat e shkollës mori pjesë aktive me rininë e Ballit Kombëtar, duke u inkuadruar në batalionin e rinisë «Besnik Çano», në përbërje të të cilit, në verën e vitit 1944, luftoi deri në Kosovë. U arrestua në dhjetor të vitit 1944 dhe më 12 maj 1945, Komisioni i Hetimeve të Krimeve të Luftës e deklaroi fajtor «si pjesëtar të organizatës tradhëtare të Ballit Kombëtar», dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie dhe humbjen e të drejtave civile e politike për 3 vjet kohë. U lirua në vitin 1947.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 542.

ALIMERKAJ Ahmet

Lindi më 18 shkurt të vitit 1885, në fshatin Hekal të Mallaksatrës. U arrestua më 1945, dhe më 12 shtator të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Fierit e deklaroi fajtor se «gjatë okupacionit fashist ka qenë ... pjesëtar i organizatës tradhëtare të Ballit Kombëtar, ... ka udhëhequr fuqitë balliste në operacione» etj. Për këto arsye, u dënua me vdekje dhe me konfiskimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. U ekzekutua më 29 shtator 1945.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 166, 167, 168.

ALIMERKO Hysni

Lindi më 19 janar të vitit 1919, në fshatin Tragjas të Vlorës. Më 21 nëntor 1947, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor për «krime kundër shtetit, me bashkëveprim» dhe e dënoi me vdekje dhe humbjen e të drejtave për 5 vjet kohë. Më vonë, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë ia ktheu dënimin në burgim të përjetshëm. U lirua më 25 qershor 1963.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 634.

ALIRAJ Istref

Lindi në vitin 1896, në fshatin Kërkovë të Vlorës. U vra pa gjyq për motive politike, më 4 korrik të vitit 1946.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 241, 243.

ALITE Bektash

Lindi më 10 maj të vitit 1891, në Gjiro-kastër. Më 19 shkurt 1953, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» e «tentativë arratisje», dhe e dënnoi me 5 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 1 vit kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 637.

ALITE Izudin

Lindi më 5 dhjetor të vitit 1910, në Gjirokastrë. U arrestua më 19 dhjetor 1946. Më 18 korrik 1947, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi «armik i popullit» dhe e dënnoi me 10 vjet heqje lirie, punë të detyruar dhe humbjen e së drejtës politike për 5 vjet kohë. Më 27 prill 1949 dënimi iu ul, me dekret, në 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 638.

ALITE Metali

Lindi më 3 mars të vitit 1920, në Vlorë. Më 4 mars 1950, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënnoi me 8 vjet heqje lirie, punë të detyruar dhe humbjen e të drejtave civile për 2 vjet kohë. U lirua me kusht, më 30 dhjetor të vitit 1953.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 639.

ALIU Afis

Lindi në fshatin Gjergjevicë të Korçës. U dënua si «kriminel lufte». Më 5 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Vlorës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 48, 30 maj 1946, fq. 6.

ALIU Emin

Lindi në fshatin Gjergjevicë të Korçës. U dënua si «kriminel lufte». Më 5 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Vlorës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 48, 30 maj 1946, fq. 6.

ALIU Maliq

Lindi në fshatin Kapshticë të Devollit.

U akuzua si «sabotator i Pushtetit dhe si armik i popullit». Për këtë arsye, më 13 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Devollit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 42, 8 maj 1947, f. 3.

ALIU (KAMENICA) Mehmet

Lindi më 4 shkurt të vitit 1890 në fshatin Kamenicë të Korçës. Më 31 korrik 1945, Gjykata Ushtarake e Korçës e dënnoi me 20 heqje lirie, por më 25 nëntor 1949 iu fal dënimi. U arrestua sërish më 1954, dhe më 19 tetor të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e moskallëzimit të një bande diversantësh» dhe e dënnoi me 5 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për një vit kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 648.

ALIU Mustafa

Lindi më 15 gusht të vitit 1958 në Tiranë. Më 8 janar 1986, Gjykata e Tiranës e dënnoi me 9 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 164.

ALIU Sulejman

Lindi më 1962, në fshatin Lubishtë të Vitisë, Kosovë. Më 1 nëntor 1983, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës e deklaroi fajtor për «spiunazh dhe kalim të paligjshëm të kufirit» dhe e dënnoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 595.

ALIU Hafiz Xhaferr

Klerik i lartë musliman, Kryemyfti i zonës së Korçës. U arrestua në vitin 1947. Vdiq më 2 maj 1950.

Ali M. Basha, *Rrugëtimi i fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë, 2011.

ALIU Xheladin

Ushtarak.

Lindi në fshatin Gur-Lurë të Dibrës. U dënua me akuzën se «ka qenë Oficer i Milicisë, Oficer në Ballin Kombëtar, ka

marrë pjesë aktive në luftimet kundra partizanve, ka sabotue punët e pushtetit, ka mbrojtur rrymat reaksionare, asht mundue të lehtësojë punët e tyne dhe si i tillë cilësohet si armik i popullit (kriminel luftime)». Për këtë arsyë, më 9 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Shumbatit urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 18, 26 shkurt 1947, f. 5.

ALIU Xhemal

Lindi në fshatin Golëm të rrethit të Gjirokastrës. Më 14 janar të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. së Nënprefekturës së Kurveleshit urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 67, 22 korrik 1946, fq. 3.

ALIU Zenjel

Lindi në fshatin Buzmath të Nënprefekturës së Mallakastrës. U burgos si «kriminel luftime». Më 15 shtator të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Mallakastrës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 96, 31 tetor 1947, fq. 6.

ALIZOTI (METALI) Fatbardha

Lindi më 5 maj të vitit 1931, në Tiranë. Më 7 dhjetor 1956, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtorë për «moskallzim të kimit dhe tradhëti ndaj atdheut, me bashkëveprim» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 25 dhjetor 1956.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 651.

ALIZOTI Fejzi

Veprimtar politik, Ministër i Punëve të Brendshme në Qeverinë Vlorë, Ministër i Financave (1927-1940), Ministër Shteti (1940), Guvernator i Kosovës (1940-1942), deputet.

Lindi në qytetin e Gjirokastrës, më 22 shtator të vitit 1876. U diplomua në shkollën «Mykije» në Stamboll për diplomaci,



Fejzi Alizoti

financë dhe administratë. Shërbeu në administratën e Perandorisë Osmane, si zv. Guvernator në Liban, kajmekam në Libi, Anadoll dhe në Prizren, si prefekt i Prishtinës gjatë Luftërave Ballkanike dhe si vali në Shkup. Me kërkesë të Ismail Qemalit u kthye në Shqipëri, ku u emërua prefekt i Beratit dhe më vonë sekretar i përgjithshëm i Qeverisë Vlorë. Pak më vonë u emërua Ministër i Punëve të Brendshme të saj. Në vitet 1916-1918 qe drejtor i financave për territorin nën administrimin e Austro-Hungarisë. Më 1927 u zgjodh Ministër i Financave dhe deputet i Gjirokastrës. Këtë post e mbajti edhe në kohën e qeverisë së Shefqet Vërlacit. Paraqiti dorëheqjen më 5 prill 1940. Po këtë ditë, me propozimin e kryeministrit Vërlaci dhe me dekret Mëkambësues, u emërua Ministër Shteti. Në vitet 1940-1942 kreu funksionin e Komisionarit të Lartë apo të Guvernatorit të Kosovës. Me dekret Mëkambësues të Alberto Parianit, më datë 1 qershor 1943, u emërua anëtar i Këshillit Qendror të Ekonomisë Korporative dhe Kryetar i Këshillit të Epërm Fashist Korporativ. U arrestua në nëntor të vitit 1944, bashkë me 16 persona të tjerë, që akuzoheshin «për veprat e tyre armiqësore dhe antipopullore». Në akt-akuzën nominale, thuhej se: «1. Ka qenë në marrëveshje me

autoritetet fashiste italiane për okupimin italian të Shqipërisë...; 2. Ka bashkëpunue me okupatorët fashistë italianë edhe mbas zaptimit të vendit; 3. Si anëtarë i qeverisë së parë kuislinge të Shefqet Vërlacit, në dikasterin e financave, ka ndihmue okupatorin për të shtypur popullin...; 4. Ka bashkëpunue me okupatorin në plaçkitjen e pasurisë shtetnore e të popullit...; 5. Asht emnue komisionar i naltë i Kosovës; 6. Në saje të bashkëpunimit politik dhe ekonomik me okupatorin asht pasurue...; 7. Nën okupacionin nazist gjerman ka provokue mbledhje në Parlament për të shpallur independencën e Shqipërisë nën hijen e bajonetave gjermane; 8. Ka sabotue dhe tradhtue luftën e popullit nën okupacionin gjerman...». Për të gjitha këto akuza, më 14 prill 1945, Gjykata e Lartë e dënoi me vdekje, pushkatim. Një vit më vonë, më 20 shkurt 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tiranës, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Hilë Lushaku, *Ministrat e Brendshëm 1912-2007*, vol. 1, Tiranë, 2009, vol. 1, 4, f. 104-115; *Gazeta Zyrtare*, nr. 21, 29 mars 1946, f. 5-6; *Fletorja Zyrtare e Mbretnisë Shqiptare*, nr. 61, 17 prill 1940; Kastriot Dervishi, *ALIZOTI Fejzi*, në «Fjalor Enciklopedik Shqiptar», 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 57.

ALIZOTI Fejzi Riza

I biri i Riza Alizotit [shih]. Lindi më 17 shtator të vitit 1946, në qytetin e Tiranës. Më 16 korrik 1970, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi fajtor për «agjitacion dhe propagandë kundër shtetit» dhe e dënoi me dhjetë vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për pesë vjet kohë.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e BURGJEVE, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

ALIZOTI Hasan

Diplomat.

Lindi më 2 shtator të vitit 1902, në Turqi. Studimet e larta i kreu në Greqi.

Në vitet 1927-1928 shërbeu si diplomat i shtetit shqiptar. U arrestua në vitin 1946 dhe u dënua me 5 vjet heqje lirie. Vdiq në internim, më 1985.

ALIZOTI Riza

Inxhinier, i biri i Fejzi Alizotit [shih], plakut.

Lindi më 10 tetor të vitit 1910, në Stamboll, ku i ati kryente detyra me rëndësi në Qeverinë Turke. Pasi kreu në Stamboll «Robert College», u kthye në Tiranë për të vazhduar mësimet në Shkollën Teknike «Harry Fultz». Paskëtaj, me bursë të Shtetit Shqiptar, në vitin 1929 filloi studimet e larta për inxhinieri miniere në Cambridge, Angli. Pas diplomimit më 1933, u specializua për shfrytëzimin e minierave në Strasburg. Me t'u kthyer në Shqipëri, u emërua me punë në pushtet vajguore të



Riza Alizoti

Kuçovës. Në vitin 1943 u internua prej italianëve në Porto Romano, si pjesëmarrës në demonstratën e punëtorëve të Kuçovës. Me vendim të Këshillit të Ministrave, më 22 dhjetor 1945 u dekorua me Urdhërin e Punës, por pa kaluar as dy vjet, më 11 qershor 1947, u arrestua si sabotator. Një ditë përpara se të fillonte gjyqi, më 3 shtator 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Qendrës së Beratit vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij. Më 27

shtator të po atij viti, Gjykata e Lartë Ushtarake e deklarua fajtor si «armik i popullit dhe sabotator i pushtetit» dhe e dënoi me varje në litar, konfiskim të pasurisë së luajtshme e të paluajtshme dhe humbjen e të drejtave civile e politike. U ekzekutua më 10 tetor 1947: u var në degët e një vidhi në sheshin e Kuçovës.

Gazeta Zyrtare, nr. 3, 5 janar 1948, f. 5; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 113, 114.

ALIZOTI Zybejte

Lindi në vitin 1929, në Tiranë. U arrestua në vitin 1960 dhe u dënua me 10 vjet heqje lirie për agjitacion dhe propagandë. U lirua më 1968.

Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, «Naim Frashëri», Tiranë, 2007, XXIII, Dh, f. 306.

ALKU Riza

Lindi më 7 tetor të vitit 1919, në fshatin Dohoshisht të Peshkopisë. Më 26 prill 1948, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «pjesmarrje në grup spiunazhi dhe grupe kundër pushtetit, në bashkëpunim» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, punë të detyrueshme. U lirua me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor, më 27 prill 1949.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 647.

ALOLLI Safet

Lindi më 19 prill të vitit 1925, në fshatin Gollobordë të Korçës. Më 22 gusht 1951, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e arratisjes në një shtet armik, me bashkëpunëtorë», «pjesëmarrje në grupazh» dhe «agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e të drejtave për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1 V. 2012, D.1, Fl. 653.

ALOLLI Sulejman

Lindi më 18 shkurt të vitit 1920, në fshatin Gollobordë të Korçës. Më 22 gusht 1951, Gjykata Ushtarake e Korçës e dekla-

roi fajtor për «krimet: drejtim të grupit për arratisje dhe strehim diversantësh» dhe e dënoi me vdekje me pushkatim, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e të drejtave për 5 vjet kohë. Më 3 janar 1952, me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor dënimi me vdekje iu kthye në 25 vjet heqje lirie. U lirua më 30 tetor 1963.

AISKK, F. 1 V. 2012, D.1, Fl. 654.

ALOLLI Shaban

Lindi më 13 maj të vitit 1921, në fshatin Gollobërdë të Korçës. Më 22 gusht 1951, Gjykata e Korçës e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «tentativë arratisjeje» dhe si «pjesëmarrës në grupazh». Më 1 shtator 1956 dënimi iu zbrit në 15 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 270.

ALUSHI Demir

Lindi më 1 janar të vitit 1906, në fshatin Rodenj të Përmetit. U vra pa gjyq nga forcat komuniste, më 30 qershor 1944.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 187, 189.

ALUSHI Etëhem

Lindi në lagjen Zguraj të Kavajës. Më 3 shtator të vitit 1946, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi si «kriminel lufte dhe armik të popullit». Për këtë arsye, më 18 tetor 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Kavajës, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 11, 13 shkurt 1947, f. 4-5.

ALUSHI Belul

Lindi më 4 tetor të vitit 1939, në fshatin Radat të Ersekës. Më 14 shkurt 1961, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 15 vjet heqje lirie, humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë dhe konfiskimin e pasurisë për «agjitacion e propagandë» dhe «tradhëti ndaj atdheut». U lirua me kusht, më 19 gusht të vitit 1971.



Fejzi Alizoti në gjyq

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 227.

ALUSHI Fitim (Faik)

Lindi më 1 janar të vitit 1949, në fshatin Kuç të Vlorës. U arrestua më 3 nëntor 1976. Më 7 prill 1976, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me tetë vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për pesë vjet kohë. Ky vendim i Gjykatës së Fierit u la në fuqi edhe nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë më 10 maj 1976.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

ALUSHI Mitat

Lindi në vitit 1944, në fshatin Dukat të Vlorës. U arrestua më 7 gusht 1966. Më 21 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Qarkut të vlorës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut dhe tentativë arratisjeje» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e plotë të pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme. U ekzekutua më 25 prill 1967.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 64, 65.

ALUSHI Petrit

Lindi më 29 shkurt të vitit 1956, në Tiranë. Më 8 shkurt 1977, Gjykata e Rrethit të Tiranës e për «krimin e agjitacionit e

propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 95.

ALUSHI Qazim

Lindi në fshatin Selenicë. Më 22 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kolonjës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 120, 31 dhjetor 1946, f. 6.

ALUSHI Ragip

Lindi në lagjen Zguraj të Kavajës. U dënua si «kriminel dhe armik i popullit». Më 19 prill të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i rrethit të Kavajës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 51, 8 maj 1948, fq. 7.

ALUSHI Sejdullah

Lindi më 21 qeshor të vitit 1925, në fshatin Radat të Ersekës. Më 24 tetor 1959, Kolegji Usharak i Gjykatës së Lartë e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut, tentativë akti diversioni dhe agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1 V. 2012, D.1, Fl. 655.

ALUSHI Shako

Lindi në fshatin Sevaster të Vlorës. Më 23 qershor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kotës, vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 30, 26 prill 1946, f. 5.

ALUSHI Teme

Lindi në fshatin Kaninë të Vlorës. U ekzekutua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 12 korrik të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Vlorë, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 72, 5 gusht 1946, f. 6.

ALUSHI Ymer

Lindi më 10 janar të vitit 1957, në qyte-tin e Durrësit. Më 1 tetor 1977, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me pesë vjet heqje lirie.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

ALUSHI Zyhdi

Lindi në lagjen Zguraj të Kavajës. U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit» nga Gjykata Usharake e Tiranës më 3 shtator të vitit 1946. Për këtë arsye, më 18 tetor 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Kavajës, vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 11, 13 shkurt 1947, f. 4-5.

ALVORA Ardian

Lindi më 23 tetor të vitit 1969, në Tiranë. Më 20 maj 1987, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e përgatitjes për t'u arratisur» dhe dënoi me 1 vit heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 252.

ALLA Abas

Lindi në vitin 1927, në fshatin Babunjë të Lushnjës. Më 30 tetor 1945, Gjykata Usharake e Beratit e deklaroi fajtor si «pjesmarrës në organizatën e Ballit Kombëtar» dhe për «pjesmarrje në luftime kundër fuqive të U.N.Çl» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie me punë të detyruar, humbjen e së drejtës elektorale dhe konfiskimin e pasurisë. Në vitin 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Lushnjës vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij të paluajtshme.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 657; *Gazeta Zyrtare*, nr. 54, 20 qeshor 1946, fq. 6.

ALLA (ALA) Abedin

Lindi më 12 maj të vitit 1956 në fshtatin

Vërri të Pogradecit. Më 31 maj 1975, Gjykata e Rrethit të Librazhdit e deklaroi fajtor «për tradhëti ndaj atdheut në formën e arratisjes së mbetur në fazën e tentativës» dhe e dënoi me dhjetë vjet heqje lirie.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

ALLA Ali

Lindi më 4 tetor të vitit 1929 në fshatin Mollagjesh të Elbasanit. Më 9 korrik 1952, Gjykata Speciale e Sigurimit e deklaroi fajtor «për faje kundër shtetit e popullit», dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1973, dhe më 16 qershor të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor «për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 17 korrik të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 400.

ALLA Dalip

Lindi më 18 maj të vitit 1937 në fshatin Mollagjesh të Elbasanit. Më 17 dhjetor 1978, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor», dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 19 janar të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 414.

ALLA Hajredin

Lindi në vitin 1910, në Elbasan. U vra pa gjyq për motive politike, më 28 mars 1945.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 223, 224.

ALLA Halil

Lindi më 5 maj të vitit 1917, në fshatin Zgosht të Librazhdit. U vra pa gjyq për motive politike, më 1 tetor 1947.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 225, 226.

ALLA Hamit

Lindi më 7 gusht të vitit 1911, në fshatin Zgosht të Librazhdit. Më 8 prill 1946, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor si «strehues e furnizues kriminelësh» dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale baraz me kohën e dënimit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 660.

ALLA Haxhi Sali

Lindi më 10 shkurt të vitit 1909, në fshatin Nuoj të Krujës. Më 7 shtator 1946, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krime gjatë luftës» dhe e dënoi me 30 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale baraz me kohën e dënimit. Më vonë dënimi iu ul në 20 vjet heqje lirie. U lirua më 26 nëntor 1950.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 662.

ALLA Haxhi Mersin

Lindi më 21 prill të vitit 1922, në fshatin Shegas të Lushnjës. Më 11 tetor 1946, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 3 vjet heqje lirie për «krime antipushtet».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 91.

ALLA Ibrahim

Lindi më 12 gusht të vitit 1875, në fshatin Zhamë të Lushnjës. Më 24 gusht 1950, Gjykata e Elbasanit e deklaroi fajtor për «sabotim» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie me punë të detyruar.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 663.

ALLA Isuf

Lindi më 1924, në Tiranë. U arrestua në vitin 1950 dhe u dënua me 15 vjet heqje lirie për tentativë arratisjeje. U lirua më 1963.

ALLA Muharrem

Lindi më 5 korrik të vitit 1894, në fshatin Mollagjesh të Elbasanit. U pushkatua pa gjyq më 1949, për motive politike.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 67, 68.

ALLA Seit

Lindi më 1 gusht të vitit 1912, në fshatin Vërri të Pogradecit. Më 26 nëntor 1956, Gjykata e Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 664.

ALLA Xheladin

Lindi më 4 maj të vitit 1909, në fshatin Zgosht të Librazhdit. Më 17 nëntor 1945, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor për «krime lufte» dhe e dënoi me burgim të përjetshëm, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 666.

ALLA Xhevahir

Lindi më 15 maj të vitit 1949, në Peshkopi. U arrestua më 4 prill 1964 dhe më 2 qershor të po atij viti, Gjykata e Qarkut të Dibrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut», dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie. Një vit më vonë, më 15 shkurt 1965, iu fal me dekret pjesa e mbetur e dënimit. U lirua më 24 shkurt 1965.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 156, 157, 158.

ALLA Zeqir

Antikomunist i betuar. Gjatë luftës aderoi në organizatën e Ballit Kombëtar. U pushkatua pa gjyq nga forcat e ndjekjes, në gusht 1946, pranë shtëpisë së tij në fshatin Zgosht të rrethit të Librazhdit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 227-228, 229.

ALLAJBEU Ali

Lindi më 26 qeshor të vitit 1943, në fshatin Peshtan të Beratit. Më 30 gusht 1977, Gjykata e Rrethit të Beratit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacion e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës



Asllan Allamani

elektorale për 5 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, më 23 shtator të po atij viti.

AISKK, F. 1 V. 2012, D.1, Fl. 667.

ALLAJBEU Tomorr

Lindi më 4 prill të vitit 1941, në fshatin Peshtan të Beratit. Më 14 tetor 1969, Gjykata e Rrethit të Beratit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacion e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie. Gjatë kohës që vuante dënimin, më 30 qershor 1973, Gjykata e Rrethit të Mirditës e ridënoi me 15 vjet heqje lirie, humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë dhe konfiskimin e pasurisë për «krimin e sabotimit duke qenë pjesëmarrës në një organizatë kundër pushtetit popullor dhe për agjitacion e propagandë që ka sjellë pasoja veçanërisht të rënda». Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 15 gusht të po atij viti.

AISKK, F. 1 V. 2012, D.1, Fl. 668.

ALLAMANI Asllan

Lindi më 15 gusht të vitit 1931, në fshatin Kurdari të Matit. Më 25 maj 1954, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë.

Vendimi mori formë të prerë me vendim të Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë, më 8 korrik 1954. U lirua më 1962. Në vitin 1979 u arrestua sërish, dhe më 15 korrik të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Matit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundra pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie. U lirua më 1989.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 347; Xhevahir Gradica, *Si i dogjën e i vranë Allamanët e Matit*, në «Metropol», E martë, 29 dhjetor, 2009.

ALLAMANI Dylejman

Lindi më 25 maj të vitit 1885, në fshatin Kurdari të Matit. Gjatë luftës përkrahu forcat e Abaz Kupit dhe për disa ditë mbajti në shtëpi të tij misionin anglez. Në gusht të vitit 1944 udhëhoqi forcat nacionaliste kundër partizanëve të udhëhequr nga Mehmet Shehu, kur këta sulmuan Kurdarin dhe në shenjë hakmarrjeje dogjën të gjitha kullat e Allamanëve. U dorëzua për të shpëtuar nga plumbi burrat dhe nipërit e fisit të tij. U dënua me pushkatim dhe u ekzekutua pranverën e vitit 1945 në Breg Lum të Tiranës. Më 12 nëntor 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Burrelit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta «Atdheu», 26 mars-2 prill 2006; *Gazeta Zyrtare*, nr. 14, 20 shkurt 1947, f. 4; *Gazeta Zyrtare*, nr. 44, 14 maj 1947, f. 3; Xhevahir Gradica, *Si i dogjën e i vranë Allamanët e Matit*, në «Metropol», E martë, 29 dhjetor, 2009; «55», E enjte, 30 dhjetor 2010, f. 4.

ALLAMANI Isuf

Veteriner.

Lindi në vitin 1907, në fshatin Kurdari të Matit. Studimet e larta veterinare i kreu në Universitetin e Firences. Pas kthimit në Shqipëri, themeloi fermën e Xhafzotajt. Aty u arrestua, ndonëse nuk ishte përzier fare në çështje politike. U dërgua në Pezë dhe prej këtu në fshatin Sharrë të Tiranës, ku dhe, më 3 nëntor të vitit 1944, u pushkatua bashkë me Kapllan Deliallisin

[*shih*], deputet i Shijakut në Parlamentin shqiptar, të vëllain, Jakup Deliallisin [*shih*], ish-kryetar i komunës së Shënavlashit dhe të Luzit, dhe Shefqet Deliallisin [*shih*], të birin e atdhetarit të njohur Ymer Deliallisit, sekretarit personal të Ismail Qemalit, një oficer i ri, i diplomuar në Akademinë Ushtarake në Romë. Ka lënë në dorëshkrim një sërë studimesh zooveterinare.

Në dhjetor të vitit 2009, Presidenti i Republikës e dekoroi me Urdhërin «Nderi i Kombit», bashkë me 36 intelektualë të tjerë të Tiranës të vranë nga komunistët në periudhën 28 tetor-16 nëntor 1944, me motivacionin: «Të martirizuar nga terrori komunist për shkak të besimit në idetë demokratike perëndimore të zhvillimit të Shqipërisë pas Luftës II Botërore».

Xhevahir Gradica, *Si i dogjën e i vranë Allamanët e Matit*, në gazetën «Metropol», E martë, 29 dhjetor, 2009.

ALLAMANI Petrit

Lindi më 3 maj të vitit 1937, në fshatin Kurdari të Matit. Më 18 tetor 1970, Gjykata e Rrethit të Matit e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut dhe agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie.

AISKK, F.1, V. 2012, D. 1, Fl. 670; *Gazeta Atdheu*, 26 mars-2 prill 2006.

ALLAMANI Shefki

Lindi më 25 gusht të vitit 1927, në fshatin Kurdari të Matit. Më 1 tetor 1980, Gjykata e Rrethit të Matit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 433.

ALLAMANI Sherif

Lindi më 8 prill të vitit 1926, në fshatin Kurdari të Matit. Më 18 tetor 1970, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Matit e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor», «moskallzim të kri-

mit» dhe «përhapje të sekretit shtetëror» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie. Mori pjesë në revoltën e Spaçit të 21-23 majit të vitit 1973, ndaj dhe, më 13 korrik të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Mirditës e deklaroi fajtor për «sabotim duke qenë pjesëmarrës në një organizatë kundra pushtetit popullor dhe për agjitacion e propagandë që ka sjellë pasoja veçanërisht të rënda», dhe e dënoi me 18 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 8 shtator 1973.

Dokumenti i Sigurimit: Si e shtypëm revoltën e Qafëbarit, në Gazetën «Panorama», 5 tetor 2009; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 434.

ALLAMANI Selman

Lindi më 1900, në fshatin Kurdari të Matit. U arrestua më 27 korrik 1945, pak kohë pas pushkatimit të të vëllezërve, Isuf [shih] dhe Dylejman Allamanit [shih]. Më 1 nëntor 1945, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me dy vjet heqje lirie dhe humbjen e të drejtave civile baraz me kohën e dënimit. U lirua më 16 shtator 1946.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 671.

ALLASUFI Sadi

Lindi më 15 maj të vitit 1927, në fshatin Seferaj të Kavajës. Më 17 mars 1949, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «takime me të arratisurit» dhe e dënoi me një vit burg dhe punë të detyruar (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, v. 2012, D. 1, Fl. 676.

ALLÇI Adem

Lindi më 6 mars të vitit 1942, në fshatin Viçidol të Tropojës. Më 1961, kur ishte në vit të dytë të gjimnazit në Shkodër, i hoqën të drejtën për të vazhduar shkollën. Kështu, një vit më vonë, në fund të vitit 1962, u arratis bashkë me të vëllanë, Elezin [shih], në Kosovë. Aty i arrestuan dhe i burgosën në kampin e Gjirakovcit në Pejë. Gjashtë muaj më vonë, më 29 maj të vitit 1963, i kthyen në pikën kufitare të Morinës,



Adem Allçi

ku i priste Sigurimi i Shtetit dhe vetë Kadri Hazbiu. Pas dhjetë muajsh hetuesie në birucat e Bajram Currit, më 7 shkurt 1964, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për katër vjet kohë. Vuajtjen e dënimit e nisi në burgun e Burrelit. Këtu, tre vjet më vonë, më 2 gusht 1967, bashkë me Theodhor Gërnjotin [shih] dhe Sazan Hadërin [shih], thyen burgun. Gjatë arratisjes, Sazan Hadëri u vra nga ushtari i trupprojës, Thodhor Gërnjoti u plagos në këmbë, kurse Adem Allçi në shpatull. Gjykata e Qarkut të Tiranës, dega e Peshkopisë, me akuzën se «kanë kryer vepra terroriste kundër përfaqësuesve të pushtetit popullor dhe kanë tentuar të arratisen jashtë shtetit», i dënoi të dy me vdekje me pushkatim dhe konfiskimin e plotë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme. Përveç një viti në kampin e Ballshit (1973-1974) dhe tre viteve në kampin e Spaçit (1983-1985), tërë pjesën tjetër të burgut e kreu në Burrel. U lirua më 30 prill të vitit 1990.

Më 21 shkurt 2011, Presidenti i Republikës i akordoi Urdhërin «Nënë Tereza» me motivacionin: «Në shenjë nderimi dhe vlerësimi për qëndresën mbinjerëzore dhe rezistencën e papajtuashme ndaj diktaturës komuniste».

Republika Popullore e Shqipërisë, Gjykata e Lartë, «Kolegji Penal», nr. 160 Regj. Themeltar, nr. 150 i vendimit; Republika e Shqipërisë, Ministria e Rendit Publik, Dega e Arkivit, nr. 1161/1 i Prot.; Republika e Shqipërisë, Ministria e Rendit Publik, Drejtoria e Administratës së Burgjeve, Vërtetim nr. 2265; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 363; Ndue Ukcama, *Zgjimi i dragojve*, Tiranë, 2005.

ALLÇI Elez

Lindi më 6 janar të vitit 1936, në fshatin Viçidol të Tropojës. Në fund të vitit 1962 u arratis, bashkë me të vëllanë, Ademin [shih], në Kosovë. Aty i arrestuan dhe i burgosën në kampin e Gjikavocit në Pejë. Gjashtë muaj më vonë, më 29 maj të vitit 1963, i kthyen në pikën kufitare të Morinës, ku i priste Sigurimi i Shtetit dhe vetë Kadri Hazbiu. Pas dhjetë muajsh hetuesie në birucat e Bajram Currit, më 7 shkurt 1964, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 25 vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për pesë vjet kohë. Dënimin e vuajti në burgje e kampe të ndryshme të vendit, si në Laç, Elbasan, Burrel, Spaç, Ballsh dhe në Zejmen të Lezhës. Në vitin 1999 u vendos në Baballeq të Kosovës, ku dhe vdiq më 20 shtator të vitit 2002.

Ndue Ukcama, *Zgjimi i dragojve*, Tiranë, 2005, f. 87, 92, 263.

ALLÇI Halil

Lindi më 8 maj të vitit 1932, në fshatin Viçidol të Tropojës. Pas arrestimit të të vëllezërve, Ademit [shih] dhe Elezit [shih], u internua me pjesën tjetër të familjes Allçi në Lekbibaj. U arrestua më 18 korrik të vitit 1977, bashkë me të vëllanë, Ismailin [shih], për agjitacion e propagandë, sepse atë ditë që vdiq Mao Ce Duni kishte thënë: «Ishalla vdes edhe Enveri mbas Mao Ce Dunit». U dënua me gjashtë vjet heqje lirie. Dënimin e vuajti në kampin e Spaçit. Me t'u liruar, filloi punë në minierën e Manzës, në Durrës, ku ndodhej e internuar familja e tij. Vdiq më 2 maj të vitit 1998.

Ndue Ukcama, *Zgjimi i dragojve*, Tiranë, 2005, f. 181-182.

ALLÇI Ismail

Lindi në fshatin Viçidol të Tropojës. Pas arrestimit të të vëllezërve, Ademit [shih] dhe Elezit [shih], u internua, me gjithë pjesën tjetër të familjes Allçi, në Lekbibaj. U arrestua më 18 korrik të vitit 1977, bashkë me të vëllanë, Halilin [shih], dhe u dënua me një vit e gjysëm burg.

Ndue Ukcama, *Zgjimi i dragojve*, Tiranë, 2005, f. 181-182.

ALLÇI Ymer

Lindi më 3 korrik të vitit 1939, në fshatin Viçidol të Tropojës. Më 1 tetor 1965, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Kukësit e dënoi me 10 vjet burg. Një muaj pas lirim, u arrestua sërish dhe më 30 gusht 1975, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tropojës e dënoi me 18 vjet heqje lirie «për krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes së ngelur në tentativë». U lirua në vitin 1987.

Ndue Ukcama, *Zgjimi i dragojve*, Tiranë, 2005, f. 83-85, 92; AISKK, F. 1, V. 2012, D.1, Fl. 10.

ALLIRAJ Dushan

Lindi më 13 maj të vitit 1916, në fshatin Panaja të Vlorës. Më 25 tetor 1945, Gjykata Ushtarake e Vlorës e deklaroi «kriminel luftime dhe armik i popullit», sepse, sipas vendimi të saj, ka qenë «pjesëtar i organizatës së B. Kombëtar dhe më vonë pjesëtar në çetën e Topalltisë dhe anëtar i Këshillit Krahinor; ka marrë pjesë në xhandarmërinë kuislinge e në kontrollime në qytetin e Vlorës», ndaj dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie me punë të detyruar dhe humbjen e të drejtave qytetare e ploitike baraz me kohën e dënimit. U arrestua sërish më 1949, dhe më 25 nëntor të po atij viti, Gjykata e Lartë e deklaroi «fajtor për pjesëmarrje në grup kundër pushtetit» dhe e dënoi me burgim të përjetshëm, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e përjetshme të së drejtës elektorale. Më 18 janar 1965 iu falën 3 vjet nga dënimi. U lirua më 26 gusht 1966.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 677.

ALLIU Hysen

Lindi më 4 gusht të vitit 1929, në Librazhd. Më 15 tetor 1976, Gjykata e Rrethit të Librazhdit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër shtetit popullor» dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar). Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 10 nëntor të po atij viti.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 678.

ALLIU Islam

Lindi më 8 maj të vitit 1890, në fshatin Strikçan të Bulqizës. U dënua si «kriminel luftime dhe armik i popullit». Për këtë arsye, më 25 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Zerqanit vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 16, 24 shkurt 1947, f. 1-2.

ALLIU Kaso

Lindi më 15 mars të vitit 1946, në fshatin Bubës të Përmetit. Më 1 tetor 1964, Gjykata e Qarkut të Gjirokastrës e dënoi me 10 vjet heqje lirie për «tradhëti ndaj atdheut». U arrestua sërish më 1979, dhe më 8 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Qarkut të Gjirokastrës e shpalli fajtor për «agjitacion e propagandë kundër shtetit» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 11.

ALLIU Muharrem

Lindi më 1 maj të vitit 1934, në Krujë. Më 22 nëntor 1958, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe konfiskim të pasurisë për «tradhëti ndaj atdheut». U lirua më 18 janar 1965.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 224.

ALLKAJ Bezat

Lindi më 20 mars të vitit 1917, në fshatin Godoleshtë të Elbasanit. U arrestua më 30 korrik 1956, dhe më 25 tetor të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë,

moskallëzim krimi kundër shtetit dhe tradhëti ndaj atdheut», dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë, humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë dhe heqjen e dekoratës. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 27 nëntor 1956. U lirua më 7 mars 1963 për plotësim afati.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 679.

ALLKAJ Demo

Lindi më 15 tetor të vitit 1904, në fshatin Dukaj të Tepelenës. Më 14 maj 1949, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor «për krimin e pjesëmarrjes në baza kriminale si dhe për mosdenoncimin e tyre» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 680.

ALLKU (ALLCIU) Ashim

Lindi më 19 korrik të vitit 1946, në fshatin Kllobçishtë të Peshkopisë. Më 18 korrik 1963, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut (arratisje në Jugosllavi)» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 681.

ALLKUSHAJ Demir

Lindi më 1 janar të vitit 1911, në fshatin Gllavë të Tepelenës. Më 6 gusht 1949, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor «për krime kundër shtetit» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie. U lirua më 30 mars 1961.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 682.

ALLMUÇA Bashkim

Lindi më 15 korrik të vitit 1950, në fshatin Mumajes të Tiranës. Më 31 janar 1977, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «diversion në bashkëpunim» dhe e dënoi me 16 vjet heqje lirie, konfiskimin e plotë të pasurisë dhe humbjen e të drejtës elektorale për 4 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 19 shkurt 1977.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 683.

ALLMUÇA Enver

Lindi më 25 shkurt të vitit 1945, në Tiranë. Më 16 shkurt 1977, Gjykata e Tiranës e dënoi me 5 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 208.

ALLMUÇA Nuri

Lindi më 5 shkurt të vitit 1938, në fshatin Mumajes të Tiranës. Më 31 janar 1977, Gjykata e Rrethit të Tiranës e shpalli fajtor për «krimin e diversionit, agjitacionit dhe të propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me vdekje, pushkatim, konfiskimin e plotë të pasurisë dhe humbjen e të drejtave elektorale për 5 vjet kohë. U pushkatua më 22 mars 1977.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 88, 89.

ALLMUÇA Sali

Lindi më 1 nëntor të vitit 1901, në fshatin Mumajes të Tiranës. U pushkatua pa gjyq nga forcat e ndjekjes, më 31 dhjetor 1944.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 121, 122.

ALLUSHAJ (MYFTARI) Mete

Lindi më 10 prill të vitit 1918, në fshatin Dukat të Vlorës. Më 23 dhjetor 1949, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor si «pjesëmarrës në një grup të organizuar dhe për tentativë arratisjeje» dhe e dënoi me vdekje me pushkatim, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e përherëshme të të drejtave civile. Më 18 shkurt 1950, Gjykata e Lartë ia ktheu dënimin me vdekje në 20 vjet heqje lirie me punë të detyruar dhe humbjen e të drejtave civile për 5 vjet kohë. U lirua me kusht, më 16 dhjetor 1962.

AISKK, F. 1, V.2012, D. 1, Fl. 685.

AMETI Nasip

Lindi në fshatin Kaninë të Vlorës. U ekzekutua si kriminel lufte dhe armik i popullit. Më 12 korrik të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Vlorë, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 72, 5 gusht 1946, f. 6.

AMULI (MULI) Adem

Lindi më 12 maj të vitit 1918, në fshatin Flakë të Koplikut. Më 26 shtator 1951, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor «për dhënie informatash duke u vënë në shërbim të U.D.B., me bashkëveprim» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie dhe humbjen e të drejtave për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V.2012, D. 1, Fl. 688.

AMULI (OMURI) Arif

Lindi më 16 gusht të vitit 1895, në fshatin Flakë të Koplikut. Më 26 shtator 1951, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor «se është vënë në shërbim të U.D.B., në bashkëpunim» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e të drejtave për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V.2012, D. 1, Fl. 689.

ANAMALI Syrri

Lindi në vitin 1922, në Shkodër. Më 27 nëntor 1947, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi «armik i popullit» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie dhe punë të detyruar, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e të drejtave civile dhe politike për 5 vjet kohë. U fal me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor, më 26 nëntor 1951.

AISKK, F. 1, V.2012, D. 1, Fl. 690.

ANASTASI Lazër

Lindi në vitin 1922, në Shkodër. Më 6 gusht 1945, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor «për krime kundra shtetit, me bashkëveprim» dhe e dënoi me 30 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e të drejtave qytetare e politika baraz me kohën e dënimit. Në mbështetje të ligjit nr. 382, dënimi iu zbrit në 20 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V.2012, D. 1, Fl. 691.

ANDONI Boris

Lindi më 18 qeshor të vitit 1912, në Korçë. U arrestua më 19 mars 1949, dhe më

3 shtator të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit kundra shtetit» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie dhe humbjen e të drejtave elektorale për 5 vjet kohë. Dënimin e vuajti në burgun e Korçës.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 693.

ANDONI Gjergj

Lindi në vitin 1951, në Qytetin Stalin (Kuçovë). Që në moshë të re ra në sy për sjelljet e tij «liberale». Sipas të atit, kjo qe arsyeja që u vu në shënjestër dhe u thirr në ushtri pa mbushur ende moshën. Shërbimin ushtarak u caktua të kryente në një repart afër Ardenicës. Pak kohë më vonë, e morën dhe e torturuan në Degën e Punëve të Brendshme në Lushnjë. Pas kësaj, sipas të atit, Gjergj Andoni filloi të shfaqte shenja të tronditjes psikike. Më 31 gusht të vitit 1970 u arrestua nga Dega e Punëve të Brendshme e Fierit. Po atë ditë u shtrua forcërisht në spitalin e burgut në Tiranë. E gjithë ngjarja u zhvillua në kushte misterioze: ndaj tij nuk u hap asnjë proces gjyqësor apo mjekësor. Sipas fletëdaljes së spitalit të burgut, aty u mbajt deri më 5 dhjetor 1970 për skizofreni. Po atë ditë u transferua në Spitalin Psikiatrik të Elbasanit. Me këmbënguljen e të atit në insitucionet shtetërore, Gjergj Andoni doli nga spitali. Më vonë, më 19 shkurt 1971, u mbyll në pavionin 15 të Spitalit Psikiatrik të Tiranës. Doli përfundimisht si «invalid i përjetshëm», i shkatërruar fizikisht dhe psikikisht, e duke iu mohuar e drejta e punës deri në fund të jetës.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Administratës së Burgjeve, Vërtetim nr. 65/4991; Republika e Shqipërisë, Spitali Psikiatrik «Dr. Filip Papajani», Elbasan, Vërtetim nr. 1113 regj.

ANDONI Jorgji

Lindi më 14 janar të vitit 1915, në fshatin Borovë të Ersekës. Më 8 shkurt 1949, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e arratisjes në Greqi dhe largim nga ushtria» dhe e dënoi me kohën e paraburgimit.



Gjergj Andoni

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 692.

ANDONI Kristaq

Lindi më 31 janar të vitit 1935, në fshatin Nartë të Vlorës. Më 5 qershor 1978, gjykata e rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 694.

ANDONI (DAKO) Sotir

Lindi më 5 qeshor të vitit 1925, në fshatin Ziçisht të Devollit. Më 20 korrik 1949, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «krime kundra popullit e shtetit» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie, punë të detyruar dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 695.

ANDONI Sotiraq

Lindi më 6 mars të vitit 1962, në fshatin Nartë të Vlorës. Më 4 dhjetor 1981, Gjykata e Vlorës e dënoi me 5 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 212.

ANDONI Vasil

Lindi në Elbasan. Më 11 mars të vitit

1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit N.Ç. të Nënprefekturës së Elbasanit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 79, 29 gusht 1946, f. 14.

ANDONI Vasillaq

Lindi më 29 dhjetor të vitit 1965, në Himarë. Më 22 qershor 1984, Gjykata e Qarkut të Fierit e dënoi për «tradhëti ndaj atdheut» me 10 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar), 5 vjet internim dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 12

ANDONI Viron

Lindi më 15 maj të vitit 1950, në fshatin Vuno të Vlorës. Më 5 korrik 1973, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisje» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 696.

ANDONI Thimi

Lindi më 8 janar të vitit 1933, në fshatin Mërtish të Lushnjës. Më 18 shkurt 1975, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 6 mars 1975.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 697.

ANDONI Thoma

Lindi më 12 prill të vitit 1891, në Bilisht të Devollit. Më 14 dhjetor 1948, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «krime kundra popullit: ka ndihmuar... dhe ka patur dijeni për arratisjen e Sotir Dakës» dhe e dënoi me 1 vit burg.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 698.

ANDRAKIO Gjyliane

Lindi më 22 maj të vitit 1924, në Shkodër. Më 27 dhjetor 1975, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimet

tradhëti ndaj atdheut dhe agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 699.

ANDRAKIO Tonin

Lindi më 17 mars të vitit 1948, në Shkodër. Më 26 nëntor 1975, Gjykata e Qarkut të Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 356.

ANDREA Jani

Lindi më 1 janar të vitit 1876, në fshatin Nartë të Vlorës. Më 20 korrik 1946, Gjykata Ushtarake e Vlorës e deklaroi fajtor se «ka sabotuar shkëmbimin e monedhës» dhe e dënoi me 30 vjet heqje lirie, punë të detyruar, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e të drejtave qytetare dhe politike baraz me kohën e dënimit. Më von dënimi iu kthye në 20 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 701.

ANDREA Sotir

Lindi në fshatin Biovizhdë të Përmetit. U dënua si «sabotator i Pushtetit dhe armik i Popullit». Më 23 gusht 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Përmetit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 15, 22 shkurt 1947, f. 3.

ANDREA Thanas

U shpall kriminel lufte. Më 26 tetor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës Qendër Korçë vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 15, 22 shkurt 1947, f. 5.

ANDRIKU Andrea

Lindi më 3 shkurt të vitit 1914, në fshatin Goranxi të Dropullit. U arrestua

më 20 shkurt 1961 dhe më 26 prill të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor «për krimin e tradhëtisë ndaj atdheut». Për këtë arsye e dënoi me vdekje, konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme dhe humbjen e të drejtave elektorale për 5 vjet kohë. U ekzekutua më 20 qershor të vitit 1961.

Lista e personave të ekzekutuar për vitin 1961-1962, hartuar nga Dega e Hetuesisë së Drejtorisë së Policisë, Tiranë; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 173, 174, 175.

ANDRUÇI Dhimitër

Lindi më 20 mars të vitit 1908, në Himarë. Më 8 maj 1946, Gjykata Ushtarake e Vlorës e deklaroi fajtor për «krime kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me burgim të përjetshëm dhe konfiskimin e të gjithë pasurisë, të luajtshme e të paluajtshme. Më 28 qeshor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit të Nënprefekturës së Himarës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 703; *Gazeta Zyrtare*, nr. 112, 14 dhjetor 1946, f. 6.

ANDRUÇI Koço

Lindi më 2 mars të vitit 1954, në Himarë. Më 30 maj 1985, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «krijimin e një organizate antisocialiste, për diversion, agjitacion e propagandë kundër shtetit dhe për moskallzim krimi kundër shtetit», ndaj e dënoi me 25 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 705.

ANDRUÇI Kristo

Lindi në vitin 1910, në Himarë. Më 19 gusht 1946, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi «armik i popullit, në bashkëveprim» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 704.

ANGONI Faredin

Lindi më 18 janar të vitit 1907, në Gjirokastrë. Më 5 qershor 1945, Gjykata e

Gjirokastrës e deklaroi fajtor se «së bashku me të tjerë ka organizuar dezertime nga radhët e ushtrisë dhe ka përhapur parulla disfatiste». Për këtë arsye e dënoi me vdekje. U ekzekutua më 17 qershor të po atij viti. Më 30 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës Qendër Korçë, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij të luajtshme.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 213, 214; *Gazeta Zyrtare*, nr. 14, 25 shkurt 1946, f. 8.

ANGJELI Agron

Lindi më 23 tetor të vitit 1938, në Tiranë. U arrestua më 5 mars 1974, dhe më 20 korrik të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 706.

ANGJELI Ilia

Lindi më 12 prill të vitit 1909, në Përmet. U dënua si «sabotator i Pushtetit e armik i Popullit». Më 23 gusht të 1946-s, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Përmetit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 15, 22 shkurt 1947, f. 3.

ANGJELI Ziso

Lindi më 9 janar të vitit 1958, në Sarandë. Më 28 mars 1974, Gjykata e Rrethit të Sarandës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë në formën e arratisjes jashtë shtetit mbetur në tentativë» dhe e dënoi me 6 vjet heqje liri (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 707.

ANKOLLARI Ahmet

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1905, në fshatin Strelcë të Gorës. Gjatë luftës u rrjeshtua në radhët e forcave të Ballit Kombëtar. Më 12 dhjetor të vitit 1944 u kap nga forcat partizane dhe u pushkatua në malet e Strelcës.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 169, 170.



Agime Araniti (Pipa)

ANXHARA (HANXHARA) Nuli

Lindi më 30 qeshor të vitit 1912, në fshatin Leshnicë të Pogradecit. Më 26 dhjetor 1952, Gjykata e Rrethit të Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «krimin e pasjes dijeni mbi ardhjen e diversantëve dhe për mosdenoncim» dhe e dënoi me 1 vit punë korrektuese.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 708.

APOSTOLI Aleks

Lindi më 23 mars të vitit 1914, në Përmet. Më 10 maj 1951, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë e deklaroi fajtor për «krime kundër shtetit» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 710.

APOSTOLI Panajot

Lindi më 8 korrik të vitit 1915, në fshatin Kostar të Delvinës. Më 4 dhjetor 1979, Gjykata e Rrethit të Sarandës e deklaroi fajtor për «krimin e tadhëtisë ndaj atdheut dhe agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 19 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 709.

ARANITI (PIPA) Agime

Lindi më 9 shtator të vitit 1924, në Shkodër. U arrestua në vitin 1946 dhe u

dënuar me 10 vjet heqje lirie për «agjitacion dhe propagandë». U lirua më 1951.

Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar, «Naim Frashëri»*, Tiranë, 2007, XXIII, Dh, f. 306-307.

ARANITI Mithat

Jurist, shkrimtar, publicist, përkthyes, nismëtar i letërsisë dialektore.

Lindi më 15 mars të vitit 1912, në Selanik, ku i ati shërbente si ushtarak i lartë. Studimet e larta i filloi në Austri e Itali. Pas një pushimi dyvjeçar pranë familjes, i rinisi studimet për jurisprudencë në Zagreb. Në shtypin e kohës («Illyria», «Bota e Re», «Revista Letrare», «Bashkimi i Kombit» etj.) u bë i njohur me pseudonimet Rrem Vogli, Jago Blini, Ja Që Hë dhe Sufi Asmon Sufës. Në vitin 1940 u emërua gjyqtar paqi në Gjirokastrë. Pas një viti u transferua në Prizren. Mori pjesë që në fillim në organizatën «Balli Kombëtar». U kthye në Ministrinë e Drejtësisë, u riemërua në Prizren dhe që andej në Elbasan, deri më 1943, kur doli në mal në radhët e çetave nacionaliste të zonës së Mallakastrës. Në gusht 1943 u zgjodh në përfaqësinë që Balli Kombëtar dërgoi në Mukje. Në fund të vitit 1943 u emërua shef personeli në Ministrinë e Dre-



Mithat Araniti

jtësisë, ku qëndroi deri ditën e arrestimit, më 21 nëntor 1944. Dënimin e vuajti në burgun e Tiranës, ku bashkë me të dënuar të tjerë, përktheu të gjithë legjislacionin dhe bazat teorike të funksionimit të shtetit. U lirua në prill të vitit 1954, por fill pas lirim-it u internua (maj 1954-1960). Vdiq më 29 nëntor të vitit 1992.

Vepra: «Qyfyre të Rrem Voglit, katunar pri Rrashbulle: Skica humoristike dhe publicistike» («Phoenix», Tiranë, 1996). *Përkthime:* Hans Krahe, «Gjuha e ilirëve» (1955); C. de Simone, «Gjuha mesapishte» (1962); Hans Krahe, «Fjalor i emrave personalë ilirë të vjetër» (1929); Aleksandar Stipčević, «Ilirët, historia, jeta, kultura» (1974); Antun Mayer, «Gjuha e ilirëve të vjetër: fjalor i relikteve gjuhësore ilire» (vëll. I, II, 1957); Ludwig von Thalloczy, «Kërkime iliro-shqiptare» (vëll. I, 1916); Aleksandar Stipčević, «Bibliografia ilire» (1974); Fanula Papazoglu, «Onomastika dardane» (1964); Duje Rendić Miočević, «Lashtësia e gjallë: studime onomastike ilire» (1971); D. Garašanin, «Miscellanea Illyrica: kontribut për dokumentimin arkaik të dyndjes egjeane» (1970); Radoslav Katičić, «Illyricus Fluvius» (1970); C. Prashniker, A Schober, «Fjalor etimologjik i indogjermanishtes» (vëll. 2) etj.

Agron Tufa, *ADN-ja kulturore e atdhedashurisë së Mitat Aranitit*, në «Start», 14 prill 2012.

ARANITI Qemal

Lindi në vitin 1917, në Mallakastër. U arrestua më 3 nëntor 1944, dhe më 22 shtator 1945, Këshilli Gjyqësor i Gjykatës së Durrësit e deklaroi «armik i popullit» dhe e dënoi me 20 vjet burg, punë të detyruar, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e të drejtave qytetare e politike. Me dekret të Presidiumit të Kuvendit popullor, më 27 prill 1949 dënimi iu kthye në 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 711.

ARAPI Abdullah

Lindi në vitin 1900, në fshatin Bilisht të Korçës. Ende sa pa u shpalluar vendimi i

gjyqit, më 10 shtator të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit të Nënprefekturës së Devollit urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij të patundshme. Dhe më 24 nëntor 1945, Gjykata Ushtarake e Korçës e dënoi me burgim të përjetshëm si «armik të popullit».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 294; *Gazeta Zyrtare*, nr. 117, 27 dhjetor 1946, f. 6.

ARAPI Ali

Lindi në vitin 1922, në Konispol. Më 15 maj 1961, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «krimet e tradhëtisë ndaj atdheut, organizator dhe pjesëmarrës në banda të armatosura dhe agjitacion e propagandë» dhe u dënua me vdekje me pushkatim, konfiskimin e pasurisë dhe humbje e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. U ekzekutua më 20 qershor të vitit 1961, bashkë me Teme Sejkoon [*shih*], Tahir Demin [*shih*], Avdul Resulin [*shih*], Hajri Manen [*shih*], Shaban Refatin [*shih*], Taho Sejkon [*shih*], Ilia Gjyzelin [*shih*] e të tjerë.

Lista e personave të ekzekutuar për vitin 1961-1962, hartuar nga Dega e Hetuesisë së Drejtorisë së Policisë, Tiranë; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 725.

ARAPI Avni

Lindi më 12 mars të vitit 1932, në fshatin Konispol të Sarandës. Më 16 dhjetor 1958, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e dënoi me 11 vjet burg, konfiskim të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, humbjen e të drejtave elektorale për 3 vjet kohë dhe heqjen e medaljes së dhjetëvjetorit të ushtrisë për «veprime përgatitore për arratisje». U lirua më 5 qershor 1965 për plotësim afati.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 99.

ARAPI Fatmir

Lindi në Vlorë, në vitin 1953. Më 16 korrik 1976, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 712.

ARAPI Gjysh

Lindi në vitin 1924, në fshatin Martiraj të Vlorës. U vra në korrik 1944 në fshatin Rexhepaj, në përpjekje me forcat partizane.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 28-29, 30.

ARAPI Ismail

Lindi në vitin 1907. Më 23 nëntor 1946, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor se ka «strehuar kriminelë dhe është hedhur totalisht me Ballin Kombëtar dhe ka marrë pjesë në luftën kundra partizanëve» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 726.

ARAPI Mustafa

Lindi më 26 janar të vitit 1949, në fshatin Koxhas të Durrësit. Më 15 korrik 1987, Gjykata e Durrësit e dënoi me 4 vjet heqje lirie për «krimin e agjitacionit e propagandës».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 128.

ARAPI Mynyr

Lindi më 3 tetor të vitit 1933, në Vlorë. Më 10 janar 1987, Gjykata e Lartë e dënoi me 22 vjet heqje lirie, humbjen e së drejtës së zgjedhjes për 3 vjet kohë dhe heqjen e dekoratave, për «tradhëti ndaj atdheut» dhe «sabotim».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 124.

ARAPI Ndue

Lindi më 5 maj të vitit 1931, në fshatin Zajs të Mirditës. U arrestua më 20 korrik 1949 dhe u ekzekutua me varje në litar më 29 korrik të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 79, 80.

ARAPI Pjetër

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1907, në fshatin Zajs të Mirditës. Më 20 korrik 1960, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 16 gusht 1960. U lirua me amnistë, më 29 shtator 1962.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 713.

ARAPI Preng

Lindi më 5 gusht të vitit 1890, në fshatin Zajs të Mirditës. U arrestua më 9 gusht 1949, dhe më 2 janar 1950, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë e deklaroi fajtor për «strehim dhe furnizim të arratisurish» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 714.

ARAPI Skënder

Lindi në vitin 1890, në fshtatin Çermë të Lushnjës. Gjatë luftës u rrjeshtua në radhët e nacionalistëve. U kap nga forcat partizane më 23 tetor të vitit 1943 në Shegas të Lushnjës dhe u vra pa gjyq, bashkë me disa fshatarë të tjerë nga Çërma, me urdhër të Mehmet Shehut.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 150-151, 152.

ARAPI Shyqyri

Lindi më 7 janar të vitit 1912, në Fier. Më 12 tetor 1949, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «dhënie ndihme kriminelëve të arratisur (ushqim, strehim)» dhe e dënoi me 5 vjet privim lirie me punë të detyruar. U lirua më 3 dhjetor 1953.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 715.

ARAPI Urim

Lindi më 7 mars të vitit 1949, në Kohnispol. Më 29 prill 1967, në bazë të neneve 64, 46/II E 43 të Kodit Penal, Gjykata e Gjirokastrës e dënoi me 7 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 109.

ARAPI Vllas (Vangjo)

Lindi në Vlorë më 1922. U vra më 6 maj 1946 në përpjekje me forcat e Sigurimit.

ARAPI Zyhdi

Lindi më 1 janar të vitit 1941, në fshatin Blerimaj të Kavajës. Më 10 janar 1977, Gjykata e Rrethit të Kavajës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë» dhe e

dënoi me katër vjet heqje lirie.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

ARBNORI Pjetër

Shkrimtar, përkthyes, veprimtar politik, Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë (6 prilli 1992-24 korrik 1997).

Lindi në Durrës, më 18 janar të vitit 1935. Mbaroi në dy vjet e gjysëm studimet në Fakultetin e Filologjisë. U arrestua më 27 maj të vitit 1961 përpara Degës së Sigurimit në Durrës. Gjyqi kundër grupit social-demokrat, ku bënte pjesë dhe Arbnori, filloi më 8 gusht të vitit 1962, në ndërtesën e Gjykatës së Rrethit të Tiranës. Në ditën e katërt të gjyqit, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me vdekje me pushkatim. Vendimin e Gjykatës Ushtarake të Tiranës e la në fuqi edhe Gjykata e Lartë. Pas 64 ditësh në «dhomën e vdekjes», siç quhej qelia ku mbaheshin të dënuarit me vdekje, më 13 tetor 1962, iu komunikua falja e jetës nga Presidiumi i Kuvendit Popullor, dhe dënimi përfundimtar me 25 vjet heqje lirie. Si pasojë e aktivitetit të tij në burg, iu shtua dënimi edhe me dhjetë vjet të tjerë për agjitacion e propagandë. U lirua në gusht të vitit 1989, pas më shumë se 28 vjetësh burg. Pesë muaj pas lirit, më 14 janar 1990, mori pjesë në demonstratën antikomuniste të Shkodrës që rrëzoi shtatoren e Stalinit. Fill pas kësaj, u zgjodh kryetar i Partisë Demokratike për Shkodrën. Në zgjedhjet e para pluraliste u zgjodh deputet. Kreu për dy mandate detyrën e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë (6 prilli 1992-24 korrik 1997). Ishte «Oficer i Madh i Urdhërit të Plejadës» të Asamblesë së vendeve frëngjishtfolëse. Është përfshirë në fjalorin «Who's Who» të intelektualëve, të hartuar nga Insituti Biografik i Kembrixhit, dhe në Fjalorin Biografik Ndërkombëtar. Vdiq më 8 korrik të vitit 2006 në Napoli. Pak pas vdekjes, emri i tij iu vu njërit prej institucioneve kryesore kulturore shqiptare, Qendrës Ndërkombëtare të Kulturës, e cila që prej 25 majit të vitit 2007 jep çmimin letrar



Pjetër Arbnori

«Pjetër Arbnori». Më 28 tetor 2011, Presidenti i Republikës e dekoroi me Urdhërin «Nderi i Kombit» (Pas vdekjes) me motivacionin: «Personalitetit të shquar të Shkodrës dhe të gjithë Shqipërisë, simbolit të sakrificave mbinjerëzore nën persekutimin komunist, politikanit paqësor dhe shkrimtarit të talentuar, intelektualit vizionar e qytetarit fisnik, që gjithë jetën dhe veprimtarinë e tij ia kushtoi idealeve të mëdha të demokracisë, shtetit të së drejtës dhe të përparimit kombëtar».

Vepra: «Kur dynden vikingët» (novelë; Tiranë, 1993), «Mugujt e mesjetës» (roman i shkruar më 1982 në burgun e Burrelit, Tiranë, 1993), «Bukuroshja me hijen» (romancë, Tiranë, 1994), «E bardha dhe e zeza» (roman, Tiranë, 1996), «Brajtoni, një vetëtimë e largët» (roman, Tiranë, 2000), «Lufta për të mbetur njeri: intervista, artikuj, fjalime për demokracinë në Shqipëri dhe lirinë në Kosovë» (intervista: 1990-2000, Tiranë, 2000), «Pse do të rrëzohet komunizmi» (Tiranë, 2000), «Martirët e rinj në Shqipëri: 10300 ditë e net në burgjet komuniste» (2004) etj. *Përkthime:* Andre Morua, «Historia e Anglisë» (Tiranë, 1996).

Kolec Topalli, *ARBNORI Pjetër*, në «Fjalor Enciklopedik Shqiptar», 1, Tiranë, 2008; Uran Kalakulla, *21 vjet burg komunist*, Tiranë, 2008, f. 50, 138, 146, 151, 163, 165.

AREZA Xhemal

Më 8 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendrës Korçë, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 40, 20 maj 1946, f. 7.

ARGJENDARI Riko (Dhori)

Lindi më 30 tetor të vitit 1914, në Korçë. Më 22 tetor 1946, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «krimet: reaktionar, sabotator i pushtetit» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie, humbjen e të drejtave civile dhe punë të detyruar. U lirua me dekret, më 27 prill 1949.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 716.

ARGJENDI Ilo

Lindi më 28 maj të vitit 1890, në Korçë. Më 25 nëntor 1955, Gjykata e Rrethit të Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitationit e propagandës» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 13 dhjetor 1955.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 717.

ARIFAJ Ali

Lindi në vitin 1919, në Pejë, Kosovë. Më 30 dhjetor 1956, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «përgatitje për t'u arratisur jashtë shtetit me bashkëveprim» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 28 janar 1957. U lirua me kusht, më 21 nëntor 1961.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 718.

ARIFAJ Alush

U vra pa gjyq për motive politike më 20 shtator 1946.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 6.

ARIFI Abedin

Lindi më 15 maj të vitit 1943, në Korçë. Më 31 janar 1967, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «përgatitje për t'u

arratisur jashtë shtetit në bashkëpunim» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 719.

ARIFI Ahmet

Lindi në vitin 1904, në fshatin Rjoll të Shkodrës. Më 6 shtator 1945, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor «për krime kundër shtetit, sabotator lufte dhe armik i popullit» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë së tundshme dhe të patundshme dhe humbjen e të drejtave elektorale e politike baraz me kohën e ndëshkimit. Më vonë, dënimi iu zbrit në 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 675.

ARIFI Eqerem

Lindi më 8 janar të vitit 1946, në Durrës. Më 16 nëntor 1970, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e tentativës për arratisje jashtë shtetit» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie. U arrestua sërisht më 1984, dhe më 22 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi fajtor «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisje mbetur në tentativë» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 720.

ARIFI Ibish

Lindi më 6 korrik të vitit 1903, në fshatin Ostrec të Manastirit, në Maqedoni. U arrestua më 1952 dhe u vra në organet e torturës pa gjyq. Varri i tij nuk është gjenur as sot e kësaj dite.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 237-238, 239.

ARIFI Man

Lindi në Tropojë. U dënua si kriminel lufte dhe armik i popullit. Më 6 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Tropojës urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 34, 18 prill 1947, f. 4.

ARIKU Riza

Lindi në vitin 1907, në fshatin Gurrë e Vogël të Matit. Më 10 qershor 1946, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor për «krimin e sabotimit të pushtetit» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie dhe humbje e të drejtave qytetare dhe politike baraz me kohën e dënimit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 721.

ARKAXHIA (ARKAXHIU) Rokat

Lindi më 12 janar të vitit 1968, në Tiranë. Më 13 dhjetor 1988, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Korçës e dënoi me 12 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «tradhëti ndaj atdheut në formën e arratisjes» (dënimi i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 192.

ARKAXHIU Muhamet

Lindi më 1 janar të vitit 1915, në Kavajë. Më 1 mars 1947, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krime kundra popullit e shtetit, në kohën e okupacionit ka shërbyer në sektorë të ndryshëm (agjitacion e propagandë, ka sabotuar reformën agrare)» dhe e dënoi me kohën e paraburgimit (një vit e 19 ditë).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 723.

ARKAXHIU Petrit

Lindi më 6 janar të vitit 1936, në Kavajë. Më 24 qershor 1981, Gjykata e rrethit të Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundra shtetit» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 722.

ARKAXHIU Xhevit

Lindi më 7 gusht të vitit 1928, në Kavajë. Më 28 tetor 1976, Gjykata e Rrethit të Kavajës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe urdhëroi mbylljen e tij të detyruar në një institucion mjekësor.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 724.

ARTA Dom Marjan

Klerik katolik.

Lindi në vitin 1905, në fshatin Nartë të Vlorës. Të mesmen e kreu në Seminarin Papnor të Shkodrës, ndërsa studimet e larta në Xhenova të Italisë. U shuguroi më 1938 dhe u kthye në atdhe, ku u emërua famullitar i Rrëshenit (1938-1945). Pas vitit 1945 shërbeu si famullitar i Selitës së Madhe, si administrator i Perlatit dhe Lurës dhe më vonë sërish si famullitar në Durrës e Vlorë. U arrestua më 26 mars të vitit 1951, për «veprimtari kundra Pushtetit Popullor; agjitacion e propagandë». Tetë muaj më vonë, më 26 nëntor të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Durrësit e dënoi me 15 vjet heqje lirie. Në burg pësoi trauma të rënda psikike, që i lanë pasoja për të gjithë jetën. Pas lirimit, gjatë gjithë vitit 1967 u nxorr vazhdimisht në «gjqet demaskuese të popullit». Jetoj në një kasolle të shkatërruar. Në pleqëri të thellë e strehoi në shtëpinë e tij një vlonjat musliman. Vdiq në vitin 1986 dhe u varros në Vlorë.

Dr. Pjetër Pepa, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri, "55"*, Tiranë, 2007, Vol. II, f. 254-258.

ARUSHA Cubel

Lindi më 4 prill të vitit 1900, në fshatin Bradoshnicë të Tropojës. U pushkatua pa gjyq nga forcat komuniste, më 18 mars 1945, në Tropojë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 184-185, 186.

ASIMAQI Çaçul

Lindi në fshatin Buhal të Përmetit. U akuzua si kriminel lufte dhe armik i popullit. Më 24 nëntor të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Përmetit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 36, 3 prill 1948, f. 2.

ASIMAQI Llukan

Lindi në fshatin Buhal të Përmetit. U akuzua si kriminel lufte dhe armik i popullit. Më 24 nëntor të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Përmetit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 36, 3 prill 1948, f. 2.

ASIMETAJ Kujtim

Lindi më 12 prill të vitit 1934, në fshatin Hekal të Fierit. Më 11 dhjetor 1974, Gjykata e Fierit e deklaroi fajtor për krimin e «agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 728.

ASIMETAJ Sefedin

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1893, në fshatin Hekal të Mallakastrës. U vra pa gjyq më 30 maj 1944 për motive politike.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 140, 141.

ASKA Hamdi

Lindi më 5 mars të vitit 1930, në fshatin Kamenicë të Korçës. Më 15 maj 1965, Gjykata e Rrethit të Durrësit e dënoi me vdekje, konfiskimin pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale. Më më 7 qershor 1965, me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor iu fal jeta dhe dënimi iu kthye në 25 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 730.

ASLLANAJ Behar

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1953, në fshatin Poro të Vlorës. Më 21 korrik 1971, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 4 vjet e 6 muaj heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 153.

ASLLANAJ Bejo

Lindi më 7 shkurt të vitit 1944, në fshatin Luftinjë të Tepelenës. Më 6 shkurt 1984, Gjykata e Rrethit të Lushnjës e dënoi me dy vjet burg për «largim pa leje nga vendi i internimit».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 732.

ASLLANAJ Petrit

Lindi më 9 qershor të vitit 1949 në fshatin Poro të Vlorës. Më 5 korrik 1977, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe

e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 733.

ASLLANI Ali

Lindi në vitin 1905, në fshatin Selenicë të Kolonjës. Më 14 shtator 1946, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor si «armik të popullit dhe sabotator të pushetit» dhe e dënoi me burgim të përjetshëm, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtave elektorale e civile.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 734.

ASLLANI Fuat

Gazetar, diplomat (1929-1939), Ministër i Punëve të Jashtme (21 tetor 1935-7 nëntor 1936).

Lindi në vitit 1897, në Bejrut të Libanit, në një familje shqiptare që kish nxjerrë disa funksionarë të lartë të Perandorisë Osmane. U diplomua për Jurisprudencë në Universitetin e Vjenës. Është një nga themeluesit dhe kryetari i parë i shoqërisë studentore «Albania», që u themelua në Vjenë, më 10 mars të vitit 1918, dhe redaktor përgjegjës i organit të shoqërisë, revistës «Dialëria» (për katër numra të vitit 1922). Bashkëpunoi dhe me gazetën «Liria kombëtare». Në vitin 1929 hyri në shërbimin diplomatik shqiptar. Përfaqësoi vendin në Sofje, Londër (1934-1935) dhe në Lidhjen e Kombeve. Nga 21 tetori i vitit 1935 deri më 7 nëntor 1936 ushtroi funksionin e Ministrisë të Punëve të Jashtme në Qeverinë e kryesuar nga Mehdi Frashëri. Më 1946 u dëbua familjarisht nga Tirana dhe u vendos në qytetin e Elbasanit. Më 5 janar 1952, Gjykata e Lartë Ushtarake e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e të drejtës elektorale për 3 vjet kohë. Vdiq në vitin 1981, në Elbasan.

Skënder Luarasi, *Shoqëria «Albania» dhe organi i saj «Dialëria»*; Enver Memisha, *Masakra komuniste: arrestime, burgime, ekzekutime e internime mbi inteligjencien shqiptare*, në «55», 25 shkurt 2009, f. 17; Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit*

shqiptar, Tiranë, 2007, XXV, f. 318; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 735.

ASLLANI Fuat Rifat

Lindi në fshatin Ostren të Peshkopisë, më 20 shkurt të vitit 1930. Më 21 korrik 1988, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 736.

ASLLANI Hamit

Lindi më 15 maj të vitit 1926, në Mitrovicë të Kosovës. Më 2 nëntor 1970, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje jashtë shtetit» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 737.

ASLLANI Kadri

Lindi më 2 mars të vitit 1946, në Ferizaj të Kosovës. Që i ri u arratis në Shqipëri. Më 1971 u arrestua, dhe më 30 qershor 1971, Gjykata e Lushnjës e dënoi me 9 vjet heqje lirie për «agjitacion dhe propagandë» (dënim i kombinuar).

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, «UEGEN», Berat, 1995, f. 103; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 156.

ASLLANI Lato

Lindi në fshatin Beçisht të Tepelenës. Më 8 dhjetor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tepelenës, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 40, 20 maj 1946, f. 4.

ASLLANI Reis

Lindi në Pogradec. U dënua si kriminel luftime. Më 30 prill të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Pogradecit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 54, 15 maj 1948, fq. 8.

ASLLANI Reshat

Diplomat, mësues.



Suat Asllani

Lindi më 24 prill të vitit 1897, në Adrianopojë (Edrene) të Turqisë. Kolegjin e kreu në Stamboll, kurse studimet e larta në Itali. Në vitet 1923-1924 shërbeu si konsull në Itali, ndërsa më 1938-1939 si konsull në Manastir, Jugosllavi. Në mars 1951 u dënua 10 vjet burg, të cilat i vuajti në burgun e Burrelit. Vdiq në vitin 1978.

Enver Memisha, *Masakra komuniste: arrestime, burgime, ekzekutime e internime mbi inteligjencien shqiptare*, në «55», E mërkurë, 25 shkurt 2009, f. 17; Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, Tiranë, 2007, XXV, f. 318-319.

ASLLANI Sinan


Lindi më 7 shkurt të vitit 1903, në fshatin Poro të Vlorës. Më 18 maj 1965, Gjykata e Qarkut të Vlorës e dënoi me dymbëdhjetë vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 739.

ASLLANI Suat

Jurist, një nga figurat kryesore të «Bashkimit Demokrat Shqiptar».

Lindi më 21 mars të vitit 1903, në fshatin Nepravishtë e Sipërme të Libohovës. Studimet e mesme i kreu në Kolegjin e Shën Adrianit në Shën Mitër Koronë në Kalabri, kurse të lartat në Fakultetin e Drejtësisë në Napoli. Mori pjesë në Luftën e Vlorës më 1920. Më 1942 u internua për pikëpamjet e tij antifashiste. Pas mbarimit të luftës,



Qeli në burgun e Burrelit, 1993

është një nga avokatët mbrojtës në të parin Gjyqin Special të 1945-ës. U arrestua në janar të vitit 1946, së bashku me Gjergj Kokoshin [shih] dhe Musine Kokalarin [shih]. U dënua me pesëmbëdhjetë vjet heqje lirie. Më 31 korrik të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Libohovës, vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij private. U lirua në vitin 1960. Pas lirimit nga burgu u internua, ku dhe vdiq në mjerim të plotë.

Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë, 2009, I, III, f. 83; *Gazeta Zyrtare*, nr. 14, 20 shkurt 1947, f. 3.

ASLLANI Xhaferr

Lindi në vitin 1909, në fshatin Bërzhitë të Tiranës. Më 26 shtator 1951, Gjykata Ushtarake Territoriale e Tiranës e deklaroi fajtor për «strehimin dhe furnizimin e kriminelëve» dhe e dënoi me një vit burg.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 650.

ASLLANI Ylli

Lindi më 22 korrik të vitit 1962, në fshatin Burim të Dibrës. Më 19 dhjetor të vitit

1983, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër shtetit» dhe «vjedhje të pasurisë së tjetrit në përmasa të mëdha» dhe, pas bashkimit të neneve nenet, e dënoi përfundimisht me pesëmbëdhjetë vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për pesë vjet kohë.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

ASHIKJA Salih

Lindi më 3 shtator të vitit 1948, në Shkodër. Më 19 shkurt 1980, Gjykata e Shkodrës e dënoi me 4 vjet heqje lirie për «moskallëzim të krimit kundër shtetit».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 82.

ASHIKU O.F.M. At Agustin

Klerik katolik, definitor i Provincës Françeskane Shqiptare (21 qershor 1952-20 qershor 1955), Provincial i Françeskanëve (21 qershor 1958-1967).

Lindi më 16 shtator të vitit 1905, në



Alfred Ashiku

fshatin Kir të Pultit. Mësimet e para dhe të mesme i kreu në shkollën françeskane në Shkodër, kurse të lartat në Milano e Sergjeno të Arecos (1928). U shugurua më 12 korrik 1931. Pas kthimit në atdhe, u emërua profesor në Liceun «Illyricum». Më 1932 u kthye në Itali, në Frirence, ku kreu studimet për literaturë klasike. Në vitin 1940 u zgjodh drejtor i Shoqërisë Antoniane, kurse një vit më vonë drejtor i Liceut «Illyricum», detyrë të cilën e ushtroi deri në vitin 1944. U arrestua më 2 janar 1948 dhe u akuzua «se ka marrë pjesë në pritjen e Italisë Fashiste, se ka propaganduar me të rinjtë etj., si drejtor i Shoqërisë Antoniane etj.». Më 4 janar 1948, Këshilli i Gjykatës Ushtarake të Shkodrës e dënoi me «5 vjet privim lirie si dhe humbjen e të drejtave civile për 5 vjet..., me konfiskim të pasurisë së luajtshme e të paluajtshme». Më 21 qershor 1952 u zgjodh definitor i Provincës Françeskane Shqiptare, post në të cilin qëndroi deri më 20 qershor 1955, kur u bënë zgjedhjet e reja të Provincës. Tre vjet më vonë, më

21 qershor 1958, u zgjodh Provincial i Françeskanëve. U rizgjodh në të njëjtin post më 22 qershor 1961. Me mbylljen e Kuvendit, u strehua tek të kushërinjtë, ku jetoi deri sa vdiq, më 16 shtator të vitit 1986. U varros në Stom Golem.

P. Donat Kurti, *Provinca Françeskane Shqiptare (E ripërtrime në vj. 1906)*, I, XXVIII, XXIX, XXX, XXXI, f. 38, 39, 42; II, XXXV, XXXVI, f. 98, 99; Dr. Pjetër Pepa, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri, "55"*, Tiranë, 2007, Vol. II, f. 14-15, 27, 30, 39; *Bashkimi Shqiptar!*, në «Nji Seminar Papnor në vorbull të përndjekjes komuniste: Shkodër 1945-1946», Shkodër, 2008, f. 87.

ASHIKU Alfred

Farmacist, kundërshtar i vendosur i komunizmit.

Lindi në Shkodër, më 1917. Studimet e larta për Farmaci i kreu në Itali. U arrestua në vitin 1947 dhe u dënua me dhjetë vjet heqje lirie për agjitacion e propagandë. U lirua në vitin 1952.

ASHIKU Bedrije

Lindi në vitin 1931, në Shkodër. Më 2 mars 1971, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtorë për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e përgatitjes për t'u arratisur jashtë shtetit» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 740.

ASHIKU Bernard

Lindi më 12 korrik të vitit 1914, në Shkodër. Më 25 tetor 1968, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 741.

ASHIKU Filip

Lindi në vitin 1910, në Shkodër. Më 13 janar 1954, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie. Më vonë dënimi iu zbrit në tre vjet dhe, përfundimisht, në dy vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 742.

ASHIKU Kolë

Lindi në Shkodër, më 1885. Më 17 korrik të vitit 1946 u dënua me vdekje, pushkatim. U ekzekutua një ditë më vonë, bashkë me Don Alfons Trackin [shih], Nikollë Prengë Dedajn [shih] dhe Kel Abatin [shih].

Fritz Radovani – de Angeliis, *Një monument nën dhé*, Melbourne, 2004, II, f. 99-100.

ASHTA Gjergj

Lindi më 2 prill të vitit 1908, në Shkodër. Më 30 mars 1948, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Më 13 gusht 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Tiranës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 743; *Gazeta Zyrtare*, nr. 89, 15 shtator 1948, fq. 3.

ASHTA Zef

Ushtarak.

Lindi në vitin 1913, në Shkodër. Kreu Akademinë Ushtarake në Itali. Më 23 qershor 1947, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor si «oficer të okupatorëve italo-gjermanë» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për një vit kohë. U arrestua sërish më 1953, dhe më 26 gusht të po atij viti, Gjykata e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit», «propagandë lufte» dhe «moskallëzim krimi», dhe e dënoi me 14 vjet heqje lirie. Vdiq në burg.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 744.

ATJANI Sali

Lindi në vitin 1938, në Mamurras. Më 1 qershor 1957, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut», dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë. Ky ven-

dim mori formë të prerë më 10 qershor 1957. Më 27 nëntor të po atij viti iu fal, me dekret, ¼ e dënimit. U lirua më 25 prill 1962.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 412.

AVALEJA (HASA) Anika

Lindi më 15 qeshor të vitit 1939, në fshatin Hoçisht të Korçës. Më 17 tetor 1961, Gjykata Ushtarake e Tiranës, e deklaroi fajtorë për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie, me humbjen e të drejtës elektorale për 2 vjet kohë dhe me konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë, më 30 nëntor 1961. U amnistua me dekretin nr. 3603, datë 23 nëntor 1962.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 747.

AVDIA Astrit

Lindi më 6 shtator të vitit 1953, në qytetin e Tiranës. Më 10 maj 1979, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut duke u përgatitur për t'u arratisur jashtë shtetit», «agjitacion e propagandë» e «largim pa leje nga reparti», dhe e dënoi me trembëdhjetë vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë, më 2 qershor 1979.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

AVDIA Kipe

Lindi më 26 qershor të vitit 1934, në Sarandë. Më 1 shtator 1977, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1988, dhe më 5 mars të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit mbetur në fazën e tentativës» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 646.

AVDIA Qemal

Lindi më 14 maj të vitit 1923, në Tiranë. Më 21 mars 1979, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacion e propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 749.

AVDIA Sulo

Lindi më 6 shkurt të vitit 1924, në Fier. U pushkatua pa gjyq për motive politike, më 31 janar 1944.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 117, 118, 119.

AVDIJA Ukë

Lindi më 14 qeshor të vitit 1907, në Berishë të Tropojës. Më 24 prill 1959, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «veprën penale të tradhtisë ndaj atdheut dhe agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 15 qershor 1959.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 746.

AVDIJA Ahmet

Lindi më 1 janar të vitit 1940, në fshatin Sohodoll të Peshkopisë. Më 10 prill 1963, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me pesëmbëdhjetë vjet e katër muaj heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe heqjen e së drejtës elektorale për pesë vjet kohë.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

AVDIJA, OSMAN

Lindi më 1 janar të vitit 1942, në fshatin Sohodoll të Peshkopisë. Më 10 prill 1963, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me dhjetë vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për dy vjet kohë.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë,

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

AVDIQ (AVDIJA) Nazim

Lindi më 12 shtator të vitit 1961, në fshatin Sukobinë të Ulqinit. Më 19 nëntor 1986, Gjykata e Shkodrës e dënoi me 7 vjet heqje lirie për «kalim të paligjshëm të kufirit».

AISKK, F. 1, V. 2012, D.1, FL. 157.

AVDIQ (AVDIJA) Zenel

Lindi më 9 mars të vitit 1957, në Mal të Zi. Më 8 maj 1979, Gjykata e Shkodrës e dënoi me 7 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 162.

AVDULI Bilbil

Lindi në fshatin Velçë të Vlorës. Më 25 qershor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kotës, vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 30, 26 prill 1946, f. 7-8.

AVDULI Hasan

Lindi më 4 dhjetor të vitit 1890, në Sarandë. Më 13 shtator 1947, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor se «ka bërë pjesë në organizatën tradhtarë të Ballit dhe ka kryer akte terroriste» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie dhe punë të detyrueshme, humbjen e së drejtës politike për 1 vit kohë dhe konfiskimin e pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. Por më 3 tetor të po atij viti, Gjykata e Lartë Ushtarake modifikoi vendimin e mësipërm, duke e zbritur në 2 vjet privim lirie dhe punë të detyrueshme, humbjen e të drejtës politike për 1 vit kohe, pa konfiskim të pasurisë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 750.

AVDULI Zeqir

Lindi më 3 maj të vitit 1937, në fshatin Shalës të Delvinës. Më 24 qershor 1957,

Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «tentativë arratisje jashtë shtetit» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1989, dhe më 11 maj të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 757.

AVDULLARI Ferit

Lindi në vitin 1925, në Pogradec. Më 17 dhjetor 1980, Gjykata e Rrethit të Mirditës e deklaroi fajtor për «krimet e kundërshtimit me dhunë ndaj përfaqësuesit të shtetit ... për shkak të veprimtarisë shtetërore të kryer botërisht» dhe e dënoi me 8 vjet e 7 muaj heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 751.

AVDULLARI Sadush

Lindi në 5 tetor të vitit 1908, në fshatin Lin të Pogradecit. U arrestua më 16 gusht 1949. Më 20 mars 1950, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «dhënie informatash një shteti të huaj» dhe e dënoi me 10 vjet burgim dhe humbjen e të drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 752.

AVDULLARI Kadri

Lindi më 22 prill të vitit 1918, në fshatin Lin të Pogradecit. Më 19 Gusht 1946, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi «kriminel lufte se ka marrë pjesë në Ballin Kombëtar dhe ka bashkëpunuar me gjermanin në luftime kundra partizanëve, ka dashur të sabotojë Luftën» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme dhe humbjen e të drejtave baraz me kohën e ndëshkimit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 753.

AVDURRAHMANI Mehmet

Lindi në fshatin Drashovicë të Vlorës. Më 23 qershor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kotës, vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të lu-

ajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 30, 26 prill 1946, f. 4.

AVDYLAJ Ali

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1906, në fshatin Molisht të Beratit. U vra pa gjyq për motive politike më 17 shtator 1944.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 3, 5.

AVDYLAJ Adem

Lindi më 7 mars të vitit 1911, në fshatin Mbolan të Beratit. Gjatë luftës u anëtarësua në organizatën nacionaliste Balli Kombëtar dhe luftoi në radhët e çetës «Abdyl Frashëri». U vra më 31 tetor 1943, në fshatin e tij të lindjes, në përpjekje të armatosur me forcat komuniste.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 163, 164, 165.

AVDYLI Belul

Lindi më 15 korrik të vitit 1927, në fshatin Kurtesh të Çamërisë. Më 31 maj 1978, Gjykata e Rrethit të Beratit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 754.

AVDYLI Fejzo

Lindi në vitin 1923, në Çamëri. Më 27 shkurt 1950, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «fajin e pjesëmarrjes me armikun kundër L.N.ÇI.» dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë. Dënimin e vuajti në Burgun e Elbasanit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 755.

AVDYLI Nijazi

Lindi në fshatin Gracë të Devollit. U dënua si kriminel lufte. Për këtë arsye, më 10 shtator të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Devollit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 10, 11 shkurt 1947, f. 3.

AVDYLI Nusret

Lindi më 22 prill të vitit 1938, në fshatin Draganj të Çamërisë. Më 7 korrik 1962, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhtisë ndaj atdheut me anë arratisje» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme të pjesës së tij dhe me humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë. Më 31 korrik të po atij viti, Gjykata e Lartë vendosi ndryshimin e këtij vendimi në 15 vjet heqje lirie dhe me konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme të pjesës së tij.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 756.

AVDYLI Zog

Lindi në fshatin Babinë të Tropojës. U dënua si kriminel lufte dhe armik i popullit. Më 6 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Tropojës urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 34, 18 prill 1947, f. 4.


AVERIKU Aqif

Ushtrak.

Lindi në Kavajë, më 1910. Akademinë Ushtarake e kreu në Itali. Meqenëse ishte nacionalist dhe atdhetar i vendosur, nuk pranoi të vinte yllin e kuq në kasketë: «Jam shqiptar, – thoshte, – e jo Serb e Rus». Në vitet 1944-’46 ra në kontakt me Organizatën Nacionaliste Fronti i Rezistencës, drejtuar nga Hamdi Frashëri. Shumica e veprimtarëve të Frontit të Rezistencës u arrestuan në vitin 1946 nga Sigurimi i Shtetit dhe, ose u pushkatuan, ose u burgosën. Këtë fat tragjik pati edhe Aqif Averiku, që u arrestua. Në burgun e Tiranës provoi tortura nga më çnjerëzoret. U dënua me pushkatim si «armik i popullit, që kërkoi të përmbyste me forcë pushtetin popullor», dhe u ekzekutua më 1947.

AVORICANI (MASAREJA) Nuri

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1918, në Kolonjë. Shkollën e lartë ushtarake e kreu



Aqif Averiku

në Itali. U kthye në Shqipëri më 1942. Dezertoi nga ushtria italiane dhe doli partizan. U pushkatua më 5 gusht të vitit 1943 në Selenicë të Pishës, në Ersekë, nga vetë njësia partizane ku bënte pjesë, me urdhër të Komitetit Qarkor të Korçës.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 83, 84-85, 86.

AXHA Llazar

Lindi më 6 janar të vitit 1939, në Kavajë. Më 15 shtator 1977, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 11 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar). Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 15 tetor të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 758.

AZEMI Myslim

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1874, në fshatin Velçan të Pogradecit. U vra në përpjekje me forcat partizane, më 15 qershor 1944.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 2, Fl. 74-75, 76.

AZGANI Ibrahim

Lindi në Gjakovë. U arratis në Shqipëri. Pas dy vjetësh e ndoqi pas edhe i biri,

Zeneli [*shih*], dhe që të dy përfunduan në një fermë të Beratit. Sigurimi ua mbushi mendjen që të arratisen dhe pas 15 kilometrash i arrestoi si spiunë jugosllavë.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, «UEGEN», Berat, 1995, f. 70.

AZGANI Zenel

Lindi në Gjakovë. Dy vjet pas arratisjes së të atit, Ibrahimit [*shih*], kaloi kufirin dhe u fut në Shqipëri. Që të dy përfunduan në një fermë të Beratit. Sigurimi ua mbushi mendjen të arratisen dhe pas 15 kilometrash i arrestoi si spiunë jugosllavë.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, «UEGEN», Berat, 1995, f. 70.

AZISLLARI (HAZISLLARI) Ramadan

Lindi në vitin 1900, në fshatin Dolan të Korçës. Më 4 mars 1949, Gjakata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor se «ka ndihmuar të burgosurit për t'u arratisur nga burgu, armiqtë e popullit: Rakip Kosovën, Ali Starovën, Jakë Kolecin e Kofo Vosha», dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale baraz me kohën e dënimit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 759.

AZIZAJ Bajram

Lindi më 12 prill të vitit 1933, në fshatin Verbas të Fierit. U arrestua më 8 gusht 1975. Më 10 korrik të po atij viti, Gjakata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me katër vjet heqje lirie.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

AZIZAJ (HAZISAJ) Bego

Lindi më 8 shkurt të vitit 1925, në fshatin Vezhdanisht të Vlorës. Më 29 mars 1957, Gjakata Ushtarake e Rrethit të Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «bashkëpunim

me banda të armatosura» dhe e dënoi me trembëdhjetë vjet heqje lirie. Më 27 nëntor 1957, me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor, dënimi iu zbrit në 9 vjet e 27 ditë heqje lirie, si dhe me konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë. U lirua më 1 prill 1964.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 760.

AZIZAJ (HAZIZI) Pelivan

Lindi më 1 korrik të vitit 1923, në fshatin Vezhdanisht të Vlorës. Më 19 shkurt 1954, Gjakata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimet: pjesëmarrje ne grup antipushtet; agjitacion e propagandë dhe tentativë për arratisje» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie, humbjen e të drejtave elektorale për 5 vjet kohë dhe konfiskimin e pasurisë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 761.

AZIZI Ahmet

Lindi më 20 dhjetor të vitit 1920, në fshatin Polizhan të Beratit. Më 15 mars 1978, Gjakata e Rrethit të Beratit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës në bashkëpunim kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Mbi ankimimin e të gjykuarit, vendimi i mësipërm u la në fuqi edhe nga Gjakata e Lartë, më 8 prill 1978.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 762.

AZIZI (HAZIZI) Avni

Lindi më 9 prill të vitit 1967, në Tiranë. Më 21 nëntor 1986, Gjakata e Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut në formën e arratisjes të mbetur në tentativë dhe të kryer në bashkëpunim me persona të tjerë», dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjakata e Lartë, më 22 dhjetor të po atij viti. U lirua më 5 korrik 1989 me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 413.



Kisha e Kuvendit Françeskan

AZIZI Halim

Lindi më 5 gusht të vitit 1890, në fshatin Strum të Fierit. U dënua si kriminel lufte dhe armik i popullit. Më 26 shkurt të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshil-

lit Popullor të Nënprefekturës së Qendres Berat urdhëroi, si masë sigurie, sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 28, 29 mars 1947, f. 1.

B

BABA Panajot

Lindi më 23 tetor të vitit 1930, në fshatin Vllapslloterë të Përmetit. Më 4 nëntor 1957, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e dënoi me 7 vjet e 6 muaj burg, konfiskim të pasurisë, heqjen e gradës ushtarake dhe humbjen së drejtës elektorale për 2 vjet kohë për «tradhëti ndaj atdheut».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 419.

BABAMETO Hajro

Lindi më 13 nëntor të vitit 1925, në Gjirokastrë. U arrestua në vitin 1946 dhe më 7 janar 1947, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 7 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale baraz me dënimin për «krime kundër shtetit» (si pjesëtar i grupit të studentëve antikomunistë të organizatës «Balli Kombëtar»). U lirua në vitin 1949.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 301.

BABAMETO Mërkur

Lindi më 21 gusht të vitit 1930, në Gjirokastrë. U arrestua më 1967, dhe më 23 janar të po atij viti, Gjykata e Tiranës e dënoi me 8 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë për «agjitacion dhe propagandë». U riarrestua pas revoltës në Repartin e riedukimit 303 Spaç (21-23 maj 1973), por çështja kundër tij dhe të pandehurve të tjerë Zef Ashta [*shih*], Gramoz Spaho [*shih*] dhe Muho Curro [*shih*], u pushua për mungesë provash. Në vitin 1981 u internua bashkë me të shoqen, Zyrha Mustën [*shih*], në fshatin Përcëllesh të Tiranës. Në vitin 1990 u largua nga Shqipëria dhe sot jeton në Itali.

Kastriot Dervishi, *Revolta e Spaçit 21-23 maj 1973: Si u ngrit flamuri në kamp*, në «55», Nr. 140 (4205), E hënë, 24 maj 2010, f. 16; AISKK, F.1, V.2012, D.1, Fl. 119.

BABAMETO Petrit

Llogaritar.

Lindi më 15 mars të vitit 1920, në Gjirokastrë. U dënua me 6 vjet heqje lirie për mos denoncim, nga të cilat vuajti vetëm tre.

BABANI Mehmet

Lindi në Korçë, më 1887. Studimet e larta për drejtësi i kreu në Stamboll. Për një kohë të gjatë punoi si noter në Korçë. U arrestua në prill të vitit 1947, në kuadrin e raprezaljeve të kryera pas gjyqit të «Grupit të Deputetëve». U dënua me vdekje dhe u pushkatua në shkurt të vitit 1948.

BABANI Nazif

Lindi në vitin 1910, në fshatin Baban të Korçës. U diplomu në Akademinë Ushtarake të Modenas në Itali. U arrestua në vitin 1947 dhe mbas një viti hetuesi u dënua me vdekje. U pushkatua më 4 shkurt 1948.

BABANI Tefik

U vra si «tradhëtar». Më 10 shtator të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nën-prefekturës së Devollit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 117, 27 dhjetor 1946, f. 5.

BABAZIQI Ahmet

Lindur në Jugosllavi dhe banues në Durrës. U deklarua «armik i popullit». Më

17 mars të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Durrësit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 45, 29 prill 1948, f. 6.

BABI Kristaq

Lindi më 2 shtator të vitit 1950, në Durrës. Më 16 dhjetor 1982, Gjykata e Durrësit e dënoi me 13 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «tradhëti ndaj atdheut».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 152.

BABLUSHA Ahmet

Lindi më 15 janar të vitit 1928, në Koçë. U arrestua më 1952 dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie për veprimtari antikomuniste. U lirua më 1966.

BABOÇI Myrteza

Lindi më 5 dhjetor të vitit 1936, në Gjirokastrë. Më 11 dhjetor 1951, Gjykata Territoriale e Durrësit e deklaroi fajtor për «krimet: agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor dhe pjesëmarrje në grup antipushtet» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie dhe me konfiskimin e pasurisë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 17.

BACANI Shefqet

Lindi më 15 qershor të vitit 1956, në Dibër. Më 1977, Gjykata Ushtarake e Dibërës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe «moszbatim urdhëri e shkelje të dispozitave të shërbimit». Por më 1 tetor të po atij viti, çështja ndaj tij u pushua dhe u urdhërua që i pandehuri të mbyllej në spitalin neuropsikiatrik të Elbasanit për mjekim të detyrueshëm.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 445.

BACI Xheladin

Lindi më 16 mars të vitit 1909, në qytetin e Shkodrës. Kreu shkollën teknike «Harry Fultz» në Tiranë. U arrestua në fund të vitit 1945.



Ahmet Bablusha

BACKA Adem

Lindi në fshatin Lubonjë të Kolonjës. Më 25 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Vithkuqit vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 64, 16 korrik 1946, fq. 5.

BACKA Hasan

Lindi në fshatin Lubonjë të Kolonjës. Më 25 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Vithkuqit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 64, 16 korrik 1946, fq. 5.

BACKA Kamber

Polic me detyrë. Më 31 dhjetor të vitit 1947, Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake e dënoi me pesëmbëdhjetë vjet heqje lirie. Fitoi pafajsinë më 15 tetor 1949.

BACKA Qazim

Lindi në fshatin Lubonjë të Kolonjës. Më 25 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Vithkuqit vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 64, 16 korrik 1946, fq. 5.

BACKA Selim

Lindi në fshatin Lubonjë të Kolonjës. Më 25 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Vithkuqit vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 64, 16 korrik 1946, fq. 5.

BACKA Shyqri

Lindi më 7 mars të vitit 1927, në fshatin Bilisht të Korçës. Më 2 tetor 1961, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 17 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë për «tradhëti ndaj atdheut, duke kryer detyrat e agjenturës së huaj». Më 11 maj 1971 iu fall një vit nga dënimi.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 380.

BACKA Xhemal

Lindi në fshatin Lubonjë të Kolonjës. Më 25 prill të vitit 1946, Këshilli Ekzekutiv i Nënprefekturës së Vithkuqit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 64, 16 korrik 1946, fq. 5.

BAÇAJ Jahja

Lindi më 25 tetor të vitit 1910, në Përmet. U arrestua më 1945 dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie. Pas 15 vjetësh burg, u internua në Mamurras, ku dhe vdiq.

BAÇE Irfan

Më 12 shtator të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Fierit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 75, 8 gusht 1946, f. 8.

BAÇI Ramiz

Lindi në Shijak. U deklarua «armik i popullit». Më 31 mars të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Shijakut vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 57, 19 maj 1948, fq. 2.

BAÇINOZI Haxhi

Lindi më 2 korrik të vitit 1957, në fshatin Radostinë të Fierit. Më 30 janar 1982, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «agjitacion e propagandë». U dënua sërish më 3 qershor 1984, kësaj radhe me 21 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «veprën e terrorit në bashkëpunim» (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 223.

BAÇOVA Metush

Lindi në fshatin Baçovë të Nënprefekturës së Fierit. U burgos si «kriminel lufte». Më 7 qershor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Fierit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 47, 29 shtator 1945, f. 7.

BADA Hafiz Mehmet

Klerik musliman, drejtor i Medresesë së Filatit, veprimtar për çlirimin kombëtar.

Lindi më 31 mars të vitit 1860, në fshatin Lopës të rrethit të Filatit, në Çamëri. Pasi mbaroi shkollën 5-vjeçare në fshatin e lindjes, u regjistrua në medresenë e Filatit. Me të mbaruar medresenë, u regjistrua në Universitetin e Stambollit, ku kreu Fakultetin e Teologjisë dhe të Drejtësisë (1893-1899). Studimet pasuniversitare i përfundoi në Universitetin «El Ez'her» të Kajros. Më 1904 u kthye në vendlindje, ku për tre vjet punoi si drejtor i medresesë së Filatit dhe më vonë si kryetar i Bashkësisë Islame të Çamërisë. Më 27 nëntor 1912 ngriti flamurin shqiptar në Filat. Mes viteve 1920-1927 punoi në ambasadën turke në Athinë, nga ku i dërgoi një letër të hapur mbretit Jorgo të Greqisë, ku mbronte të drejtat e popullsisë shqiptare nga terrori grek. Më 1929 u arrestua nga autoritetet greke dhe u dënua me 15 vjet burg si «kundërshtar i hapur i regjimit grek». Nga viti 1941 deri më 1943 u internua në ishullin e Medelinit. Më 1945 u dëbua së bashku me familjen në Shqipëri: fillimisht u vendos

në Kavajë, pastaj për tre vjet në Elbasan e më vonë në Shijak. U arrestua në vitin 1948 «për krime ndaj popullit grek». U lirua më 1951. Vdiq një vit më vonë, më 14 prill të vitit 1952, në moshën 92 vjeçare.

100 personalitete shqiptare të kulturës islame: shekulli XIX-XX, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë, 2012, f. 134-135.

BAGANAÇI Sulë

Lindi në fshatin Sukth të Durrësit. U dënua nga Gjykata Ushtarake e Tiranës më 23 nëntor të vitit 1946. Në bazë të këtij vendimi, më 20 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nën-prefekturës së Durrësit, urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij të tundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 21, 4 mars 1947, f. 6-7.

BAGUCA Panajot

Lindi më 15 mars të vitit 1935, në fshatin Kakodhiq të Delvinës. Më 1 tetor 1966, Gjykata e Qarkut të Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor», dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 386.

BAHOLLI Ferit

Lindi në Elbasan. U deklarua «armik i popullit». Më 30 mars të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Elbasanit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 43, 26 prill 1948, f. 7.

BAHOLLI Shefqet

Lindi më 22 korrik të vitit 1893, në Elbasan. U dënua si armik i popullit dhe kriminel lufte. Më 15 shkurt të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nën-prefekturës së Qendres Elbasan urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 28, 29 mars 1947, f. 7.

BAHRIU Skënder

Lindi më 29 janar të vitit 1921, fshatin

Rrezaj të Gumenicës. U arrestua në vitin 1960 me «grupin e Teme Sejkos» dhe u dënua me 25 vjet heqje lirie.

BAJA Ruzhdi

Lindi më 10 mars të vitit 1907, në qytetin e Shkodrës. Kreu shkollën teknike «Harry Fultz» në Tiranë. U arrestua aty nga fundi i vitit 1945 për «spiunazh në shërbim të CIA-s».

Ahmet Bushati, *Në gjurmët e një ditari: Shkodra në vitet e para nën komunizëm*, Shkodër, 2007, I, f. 188; II, f. 254.

BAJAJ Ali

Lindi në fshatin Kuç të Kurveleshit. U dënua si «armik i popullit dhe kriminel lufte». Për këtë arsye, më 6 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nën-prefekturës së Kurveleshit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 36, 23 prill 1947, f. 5.

BAJAJ Fejzo

Lindi më 18 maj të vitit 1923, në fshatin Kuç të Kurveleshit. U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 6 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nën-prefekturës së Kurveleshit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 36, 23 prill 1947, f. 4.

BAJAJ Syrja

Lindi më 8 prill të vitit 1931 në Vlorë.

BAJÇINOFSKI Halit

Lindur në Kosovë dhe banues në Urën e Gurit, në Fier. U burgos si «kriminel lufte». Më 7 qershor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nën-prefekturës së Fierit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 52, 21 shtator 1945, f. 4.

BAJRAKTARI Bajram

Lindi më 30 shtator të vitit 1919.

Shkollën e mesme e kreu në Romë. Ndërpriu Fakultetin e Jurisprudencës pas tri vjetësh dhe u kthye në Shqipëri, për të luftuar italianët përkrah të vëllait, Muharrem Bajraktarit. U arrestua më 1949 dhe u dënua me vdekje. U pushkatua më 30 shtator të vitit 1949, pikërisht ditën kur do të mbushte të tridhjetat.

BAJRAKTARI Dedë Gjon

Luftëtar antikomunist.

Vëlla i Lucë Gjon Bajraktarit [shih]. I plagosur rëndë në luftën e Brojës, në shkurt të vitit 1945, partizanët e rrethuan brenda shtëpisë së tij në Vukël dhe e dogjën për së gjalli, bashkë me Lucë Tomën [shih].

Mërgim Korça, *Histori të pashkruara*, Tiranë, 2005, f. 51.

BAJRAKTARI Fran Zef

Luftëtar antikomunist.

U arrestua në shkurt të vitit 1945, bashkë me Rrok Gjo' Rapuken [shih] në Grizhaj. E mbështetën pas një muri dhe, si ia nxorren sytë, shembën murin mbi të. Ashtu dhe vdiq. U gjet nga bashkëfshatarët e tij dhe u varros në varrezën e Vuklit, ku prehet edhe sot.

Dr. Luigj Martini, *Prek Cali, Kelmendi dhe kelmendasit*, Shkodër, 2005, f. 259.



Mustafa Bajraktari

BAJRAKTARI Gjelo

Lindi në vitin 1926, në fshatin Ndreaj-Shosh të Dukagjinit. U arrestua si anëtar i organizatës antikomuniste «Bashkimi Shqiptar», gjyqi kundër anëtarëve të së cilës filloi më 28 janar të vitit 1946. Më 22 shkurt të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Qarkut të Shkodrës e dënoi me vdekje. U ekzekutua më 4 mars 1946, bashkë me At Danjel Dajanin [shih], At Giovanni Faustin [shih], At Gjon Shllakun [shih], Mark Çunin [shih] dhe Qerim Sadikun [shih].

Fritz Radovani – de Angeliis, *Një monument nën dhé*, Melbourne, 2004, II, f. 76-77.

BAJRAKTARI Lucë Gjon

Luftëtar antikomunist.

Vëlla i Dedë Gjon Bajraktarit [shih]. Udhëhoqi malësorët e Vuklit në Betejën e Brojës kundër forcave partizane të udhëhequra nga Mehmet Shehu, më 7 shkurt 1945. U pushkatua po atë ditë, në vendin e quajtur Buçë, një pyll pranë Vuklit, së bashku me bashkëfshatarin e tij, Lucë Gjo' Rapuken [shih].

Dr. Luigj Martini, *Prek Cali, Kelmendi dhe kelmendasit*, Shkodër, 2005, f. 247, f. 259.

BAJRAKTARI Mustafa

Lindi në Tropojë. Kreu shkollën bujqësore në Fier. Një ditë disa njerëz e dëgjuan duke biseduar me ca turistë që flisnin anglisht. U arrestua menjëherë dhe u dënua me 10 vjet burg për tentativë arratisje. Një vit përpara se të lirohej, u ridënua për agjitacion e propagandë. Ato ditë, nga hidhërimi i vdiq e ëma. Mbetur vetëm, një mëngjes qershori të vitit 1975, ndërkohë që bashkëvuajtësit kishin dalë në ajrosje, ai u vetëvar në hekurat e dritares së dhomës ku banonte në burgun e Burrelit. Poshtë jastëkut kishte lënë edhe një letër në anglisht, të cilën e morën hetuesit.

Uran Kalakulla, *21 vjet burg komunist*, Tiranë, 2008, f. 103.

BAJRAKTARI Myrteza

Veprimtar politik, mësues.

Lindi më 15 prill të vitit 1933, në qyte-

tin e Gostivarit, në Maqedoni. Arsimin e mesëm e kreu në Tetovë e Shkup. Më 1952 filloi studimet për filozofi në Universitetin e Shkupit, ku krijoi organizatën nacionale «Shkëndija». U arrestua më 12 janar të vitit 1953 dhe, pas torturash çnjerëzore në hetuesi, u dënua me 7 vjet heqje lirie. Dënimin e vuajti në burgun e Idrizovës, në Shkup. Pas lirimit, më 1962 kaloi në Shqipëri. Pas muajsh hetuesie, u internua në Kampin e Semanit për më tepër se katër vjet. Në vitin 1966 iu dha e drejta e studimit: mbaroi Fakultetin e Gjuhës dhe Letërsisë në Universitetin e Tiranës (1970). U emërua në Institutin e Historisë dhe Gjuhësisë, por me ndërhyrjen e Sigurimit u transferua në rrethin e Beratit, gjë që nuk e pranoi. U arrestua më 12 nëntor të vitit 1970 dhe më 28 qershor 1971, Gjykata e Rrethit të Tiranës e dënoi me 3 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë kundër R.P.SH.». Pas lirimit iu mohua e drejta e ushtrimit të profesionit të mësuesit dhe u detyrua të bënte punë nga më të rëndat. Në korrik të vitit 1990 krijoi grupin ilegal «Fronti Antikomunist Tanshqiptar». Në janar të vitit 1993 u emërua konsull i Shqipërisë në Konfederatën Zvicerane. Pesë vjet më vonë, më 1998, emigroi në Belgjikë, ku jeton dhe sot.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 374; Myrteza Bajraktari, *Një vështrim tjetër i historisë*, Tiranë, 2011.

BAJRAKTARI Ndue

Lindi më 30 janar të vitit 1928, në fshatin Manati të Lezhës. U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më më 18 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nën-prefekturës së Lezhës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr.16, 24 shkurt 1947, f. 7.

BAJRAKTARI Nikë Lucë

Luftëtar antikomunist.

I biri i Lucë Gjon Bajraktarit [*shih*]. U arrestua nga partizanët në shkurt të vitit

1945 në Rapshë të Hotit; ata e dërguan te varri i komandantit të tyre Fejzi Micolli dhe aty e ekzekutuan duke e prerë në fyt.

Dr. Luigj Martini, *Prek Cali, Kelmendi dhe kelmendasit*, Shkodër, 2005, f. 259.

BAJRAKTARI Nikollë Bardhok

Lindi në Rrëshen të Mirditës. U pushkatua më 17 gusht të vitit 1949, si i dyshuar për vrasjen e sekretarit politik të Komitetit të Partisë për rrethin e Mirditës dhe deputetit të Kuvendit Popullor, Bardhok Bibës.

BAJRAKTARI Nikollë Llesh

Lindi në fshatin Orosh të Mirditës. U pushkatua më 17 gusht të vitit 1949, si i dyshuar për vrasjen e sekretarit politik të Komitetit të Partisë për rrethin e Mirditës dhe deputetit të Kuvendit Popullor, Bardhok Bibës.

BAJRAKTARI Sulejman

Lindi më 1 janar të vitit 1940, në fshatin Arras të Dibrës. Më 14 prill 1979, Gjykata e Rrethit të Dibrës e dënoi për «agjitacion dhe propagandë» me 10 vjet burg dhe humbje të së drejtës së zgjedhjes për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 16

BAJRAKTARI Zenel

Gjeometër.

Lindi më 10 prill të vitit 1942, në Kukës. U dënua me 15 vjet heqje lirie, sepse kundërshtoi prishjen me Bashkimin Sovjetik.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 62.

BAJRAMI Ajvaz

Lindi në fshatin Dumosh të Llapit në Kosovë. Dënimin e vuajti në burgun e Gjirokastrës.

BAJRAMI Arben

Lindi më 19 korrik të vitit 1961, në Elbasan. Më 25 qeshor 1980, Gjykata e El-

basanit e dënoi me 25 vjet burg e 5 internim për «agjitacion dhe propagandë» (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 112.

BAJRAMI Ismail

Lindi në fshatin Protopapë të Korçës. U dënua me 15 vjet heqje lirie. Më 12 nëntor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit N.Ç. të Nënprefekturës së Gorë-Oparit urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 77, 24 gusht 1946, f. 7.

BARJAMI Ismet

Lindi më 1925, në fshatin Linec të Tetovës. Më 15 dhjetor 1979, mbështetur në nenet 64 dhe 55/1 të Kodit Penal, Gjykata e Rrethit të Vlorës e dënoi me 25 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 52.

BAJRAMI Liq

U ekzekutua më 24 dhjetor të vitit 1962.

Lista e personave të ekzekutuar për vitin 1961-1962, hartuar nga Dega e Hetuesisë së Drejtorisë së Policisë, Tiranë.

BAJRAMI Nehim

Lindi në fshatin Vishocicë të Devollit. Më 5 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Devollit, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 35, 9 maj 1946, f. 4.

BAJRAMI Tosum

Lindi më 25 gusht të vitit 1937, në fshatin Tucep të Peshkopisë. Më 2 mars 1962, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 10 vjet e 6 muaj burg, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë për «tradhëti ndaj atdheut». Më 27 shtator 1965 iu fal pjesa e mbetur e dënimit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 297.



Emin Bakalli

BAJRAMI Ymer

Lindi në fshatin Vishocicë të Devollit. U ekzekutua si «armik i popullit». Më 10 shtator të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Devollit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 10, 11 shkurt 1947, f. 4.

BAKALLI Emin

Lindi më 11 shtator të vitit 1912, në Tiranë. Kreu shkollën teknike «Harry Fultz» në Tiranë. U arrestua më 1946 për sabotazh dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie. Mori pjesë në hapjen e tunelit në kampin nr. 4 në Tiranë. U ridënua dhe u dërgua në burgun e Burrelit. U lirua në vitin 1962.

BAKALLI Ethem

Lindi më 18 mars të vitit 1931, në Shkodër. Anëtar i organizatës studentore antikomuniste «Përplekja Shqiptare», që u krijua në Gjimnazin e Shkodrës në tetor të 1947-s. Ishte një prej bashkëpunëtorëve më të ngushtë të kreut të kësaj organizate, Bardhosh Danit [*shih*]. Ai hartonte traktet e organizatës që pastaj shpërndaheshin në Shkodër, Kelmend, Mirditë e Tiranë.

BAKALLI Hasan

Lindi më 13 shkurt të vitit 1938, në fshatin Goskovë të Korçës. Më 20 mars 1962, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 18.

BAKALLI Isuf

Lindi më 22 nëntor të vitit 1921 në Elbasan. Vujati 12 vjet burg.

BAKALLI Hafiz Ymer

Klerik i lartë musliman, mësues.

Lindi më 10 maj të vitit 1870, në një familje të madhe në lagjen «Rus i Vogël» të qytetit të Shkodrës. Ishte njëri prej gjashtë fëmijëve të familjes së Ethem Bakallit. Arsimin fillor e kreu në shkollën Ruzhdije në Fushë Çelë. Të mesmen fetare e filloi në Stamboll më 1889. Pas mbarimit të saj, u regjistrua në fakultetin e teologjisë, të cilin e mbaroi në vitin 1903. Aty mori dhe titullin «Hafiz». Pas kësaj, po në Universitetin e Stambollit, kreu edhe Fakultetin e Filozofisë, Logjikës dhe të Psikologjisë. U punësua në Stamboll, ku shtypi e cilësonte si një prej interpretuesve më të shkëlqyer të legjislacionit islam. Pas mbarimit të shkollës së lartë ushtarake, shërbeu si Allajmyfti i një regjimenti ushtarak me gradën major. Pasi u plagos në luftime, rrugës për në spital, u zu rob nga forcat angleze. U internua në Pakistan dhe në Java të Indonezisë. Pas shumë mundimesh, më 1918 arriti të kthehet në Shkodër. Pas kthimit, u aktivizua në jetën qytetare dhe politike. Ky aktivitet arriti kulmin me pjesëmarrjen në radhët e forcave për mbrojtjen e Shkodrës nga malazezët dhe në mobilizimin e qytetarëve në luftën e Koplikut. Pas dështimit të kësaj lëvizjeje u arrestua dhe u dënua me burgim të përjetshëm, por me ndërhyrjen e autoriteteve fetare dhe qytetare pranë qeverisë së Ahmet Zogut, u la i lirë. Aktiv si gjithnjë, deri në vitin 1929 iu përkushtua tërësisht thirrjes islame, si

mësues i Medresesë në Shkodër. Më vonë u emërua vaiz (predikues) në xhamin e Rusit të vogël dhe Imam në xhaminë e Fushë Çelës. Gjatë viteve të Luftës së Dytë Botërore porosiste besimtarët dhe bashkëqytetarët e tij që të ruheshin nga Komunisti, i cili do të shkatërronte fenë, moralin dhe jetën. Dhe këtë komunistët nuk ia falën. Pas shumë përpjekjesh e gjetën dhe shkakun: arratisjen e të birit. Në vitin 1951 e arrestuan dhe e internua në Tepelenë. Por meqenëse ishte 81 vjeç, i sëmurë dhe fare i parrezikshëm, pas pak kohësh u la i lirë. Vdiq më 2 maj të vitit 1953.

100 personalitete shqiptare të kulturës islame: shekulli XIX-XX, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë, 2012, f. 292-293.

BAKIU Abdulla

Lindi në fshatin Pretushë të Pogradecit. Më 27 korrik të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Pogradecit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 49, 31 maj 1946, fq. 6.

BAKIU Ali

Lindi më 20 tetor të vitit 1911, në Tiranë. Më 30 mars 1948, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor se së bashkë me Haki Karapicin [shih], Irfan Pustinën [shih] dhe Imer Keçin [shih] ka «formuar grup me tendencë kundër Pushtetit dhe për ta rëzuar këtë me dhunë» dhe e dënoi me vdekje, humbjen e të drejtave civile e politike për 5 vjet kohë, si dhe me konfiskimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. Por një muaj më vonë, më 21 prill të po atij viti, Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake ia ktheu dënimin në 7 vjet privim lirie dhe konfiskim të pasurisë, të luajtshme e të paluajtshme.

Republika Popullore e Shqipërisë, Gjykata e Lartë Ushtarake, Nr. 127 i Regj. Them.

BAKO Adem

Lindi në fshatin Gostivisht të Dangëllisë. Më 29 prill të vitit 1946, Komiteti



Dhimitër Bala

Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nën-prefekturës së Kolonjës urdhëroi konfiskimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 63, 15 korrik 1946, fq. 3.

BAKO Ali

Lindi në Libohovë. U shpall «armik i popullit». Më 15 korrik të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P.të rrethit të Gjirokastrës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 81, 3 gusht 1948, fq. 2.

BAKO Bajram

Lindi në fshatin Gostivisht të Dangëllisë. Më 29 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kolonjës urdhëroi konfiskimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 63, 15 korrik 1946, fq. 4.

BAKO Jakup (Jaup)

Lindi më 25 maj të vitit 1928, në fshatin Gostivisht të Dangëllisë. Më 5 shtator 1945, Gjykata Ushtarake e Kolonjës e dënoi për «bashkëpunim me Ballin Kombëtar» me vdekje, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale. Por më vonë, mbështetur në nenin 51 të ligjit nr. 382, datës 24 dhjetor 1946, dënimi iu kthye në burgim të përjetshëm.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, FL. 160.

BALA Dhimitër

Pas dështimit të Revolucionit të Qershorit dhe kthimit të Ahmet Zogut në dhjetor të vitit 1924, emigroi jashtë shtetit. Si shumë shokë të tij, u kthye më 1939. Më 1943 u caktua kuestor (shëf policie) i prefekturës së Durrësit. U ekzekutua në vitin 1945, në moshën 65 vjeçare «për fajë politike». Më 11 shtator të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Himarës, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, Tiranë, 2007, XXII, 2, f. 226-228; *Gazeta Zyrtare*, nr. 9, 31 kallnor 1946, f. 8.

BALA Foto

Profesor i filozofisë dhe i letërsisë.

Lindi më 14 shkurt të vitit 1910, në fshatin Vuno të Himarës. Kreu gjysmë-gjimnazin e Gjirokastrës, Liceun e Korçës dhe studimet e larta në Montpellier të Francës, gjithnjë së bashku me Enver Hoxhën. Më 1945 u caktua profesor në Gjimnazin e Gjirokastrës. Po këtë vit i ekzekutuan të atin, Dhimitër Balën [*shih*]. U arrestua një



Foto Bala



Viti 1946: populli ndjek seancën gjyqësore në sheshin para kinemasë

vit më vonë (1946), me akuzën se kishte krijuar grupin e Neoballistëve dhe se ishte agjent anglo-amerikan-francez. Në vitin 1947, u dënua me burgim të përjetshëm. Më 14 maj të po atij viti, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Qendrës Korçë vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. U lirua në vitin 1964. Vdiq më 1991.

Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, Tiranë, 2007, XXII, 2, f. 226-231; *Gazeta Zyrtare*, nr. 53, 3 qershor 1947, f. 6.

BALA Muho

Lindi më 3 qeshor të vitit 1932, në fshatin Golem të rrethit të Shkodrës. Me arsim të mesëm të pambaruar. Më 1960 u dënua me vdekje për tradhti të lartë me akuzën bashkëpunim me diversantët. Por diversanti nuk ishte veçse vëllai i nënës së tij, Haxhi Hajdari [shih], deputet i Kuvendit Popullor, i cili pasi u prish me komunistët, doli në mal, i shoqëruar nga i nipi, Muhoja. Kur i

rrethuan në një shpellë, Haxhi Hajdari vrau veten, kurse Muho Bala u arrestua dhe u dënua me vdekje. Por Presidiumi i Kuvendit Popullor i fali jetën. Një pjesë të dënimit e vuajti në kampin e Spaçit. Në krye të 18 viteve burg, më 21 shkurt të vitit 1979 (në dosjen hetimore 20, në dosjen gjyqësore 23 shkurt) u riarrestua bashkë me Fatos Lubonjën [shih], Thoma Bejon [shih], Dhimitër Stefën [shih] dhe Eduard Vatën [shih], në kohën që ende po vuante dënim në kampin e Spaçit, si anëtar i një organizate të paqenë, që u pagëzua «Revizioniste e majtë». U akuzua se ka «marrë pjesë në një organizatë kundërrevolucionare, antisocialiste të krijuar nga të arrestuarit Fadil Kokomani dhe Vangjel Lezho për të kryer krime kundër shtetit, si dhe kanë agjiturar e propaganduar kundër shtetit...». Më 19 prill 1979, Gjykata e Lartë e dënoi me 22 vjet heqje lirie.

Fatos Lubonja, *Ridënimi*, Tiranë, 2007, I, VII, f. 33, 38-39; II, IX, f. 50; II, XVI, f. 97-99; II, XIX, f. 120; III, XXVI, f. 173-174; III, XXXIII, f. 235; III, XXXV, f. 265.

BALA Sulejman

Lindi në fshatin Bodinak të Shijakut. U deklarua «armik i popullit». Për këtë arsye, më 31 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nën-prefekturës së Shijakut, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 34, 18 prill 1947, f. 2.

BALA Zef

U deklarua «armik i popullit». Për këtë arsye, më 20 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Shijakut vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 16, 24 shkurt 1947, f. 8.

BALANI Pëllumb

Lindi më 8 prill të vitit 1939, në fshatin Vërvë të Sarandës. Më 12 mars 1962, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Tiranës e dënoi për «tradhëti ndaj atdheut» me 11 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 57.

BALI Izet

Lindi më 10 shtator të vitit 1927, në fshatin Balaj të Lushnjës. Më 7 shtator 1977, Gjykata e Lushnjës e dënoi me 5 vjet heqje lirie për «agjitacion dhe propagandë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 117.

BALI Xhaferr

Lindi në fshatin Belesh. U deklarua «kriminel lufte». Për këtë arsye, më 24 dhjetor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Gostimës, urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 11, 13 shkurt 1947, f. 2.

BALI Xhemal

Lindi më 26 mars të vitit 1936, në fshatin Vërvë të Sarandës. Më 8 korrik 1961, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e dekla-

roi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 17 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë. U dënua edhe dy herë të tjera: kështu, më 27 tetor 1967, Gjykata e Elbasanit e dënoi me 17 vjet e 6 muaj burg për «agjitacion dhe propagandë», kurse më 25 korrik 1973, Gjykata e Mirditës me 16 vjet heqje lirie për «sabotim».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 273.

BALILAJ Petrit

Lindi më 12 maj të vitit 1942, në fshatin Kuç të Vlorës. Më 13 maj 1975, Gjykata e Vlorës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 150.

BALILI Qemal

Lindi më 15 mars të vitit 1889, në fshatin Borsh të Sarandës. Më 19 nëntor të vitit 1945, Gjykata Ushtarake e Prefekturës së Beratit, e dënoi me 8 vjet heqje lirie. Mbështetur mbi këtë vendim, tre muaj më vonë, më 12 mars 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Sarandës, urdhëroi konfiskimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 60, 6 korrik 1946, fq. 4.

BALLA Hajdar

Lindi në vitin 1871, në fshatin Babje të Librazhdit. U arrestua më 26 gusht 1946. Më 28 dhjetor të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi «armik i popullit dhe sabotator i pushtetit» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie. Për këtë arsye, më 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Librazhdit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. Vdiq në burgun e Gjirokastrës, më 24 shkurt të vitit 1952.

Dëshmi, Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, Gjykata e Lartë, Regjistri i Gjendjes Gjyqësore, Tiranë, 2. 4. 1992; Vërtetim i gjendjes gjyqësore, Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë,

Drejtoria e Administratës së Burgjeve, 19. 01. 1993; *Gazeta Zyrtare*, nr. 58, 25 qershor 1947, f. 5.

BALLA Rushit

Lindi më 15 maj të vitit 1935, në Delvinë. Më 31 korrik 1956, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 185; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 210.

BALLA Selman

Lindi më 18 shtator të vitit 1944, në fshatin Baldushk të Tiranës. Më 31 janar 1977, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës e dënoi për «krim të diversionit të kryer në bashkëpunim» me 22 vjet burg, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 4 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 36.

BALLA Shaban

Gjeometër, gazetar, korrespondent i gazetës amerikane «Times» (1925).

Lindi në vitin 1904, në qytetin e Krujës. Më 1929 kreu shkollën teknike «Harry Fultz» në Tiranë dhe dy kurse në «Robert Kolegj» të Stambollit. Në vitin 1925 punoi si korrespondent i gazetës «Times» të Amerikës, pastaj si gjeometër pranë zyrës Teknike të Ministrisë së Punëve Botore. I zhgënjyer nga terrori i ushtruar nga regjimi i ri, në verën e vitit 1945 u anëtarësua në organizatën e rezistencës «Bashkimi Demokrat Shqiptar». U arrestua më 18 janar të vitit 1946 për «spiunazh» dhe «tentativë për rrëzimin e Pushtetit Popullor» dhe u dënua me vdekje-pushkatim. U ekzekutua më 3 korrik 1946, bashkë me Xhahit Kokën [shih], Qenan Dibrën [shih], Telat Drinin [shih], Mahmut Menikun [shih], Sami Qeribashin [shih], Mehmet Beshirin dhe Ali Kavajën [shih]. Më 25 gusht 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Prefekturës së qytetit të Tiranës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë, 2009, I, III, f. 81-82; V, f. 101; *Gazeta Zyrtare*, nr. 3, 5 janar 1948, f. 6; H. Gonxhja, I. Gogaj, Sh. Bumçi, *Ndihmesa e ish nxënësve dhe mësuesve të Shkollës Teknike të Tiranës për zhvillimin e vendit dhe luftën për çlirim e demokraci*, Tiranë, 2006, VII, f. 246-247.

BALLAURI Angjeli

Tregtar i madh.

Lindi më 4 mars të vitit 1896, në Korçë. Në fillim të vitit 1945 u dënua si armik i popullit. Dënimin e vuajti në kampin e Maliqit. Më 14 maj të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Qendrës Korçë vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Qyteti im, Botim i Bashkisë Korçë, nr. 4, maj 2008; *Gazeta Zyrtare*, nr. 53, 3 qershor 1947, f. 7.

BALLAURI Josif

Lindi në Korçë. Më 14 maj të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Qendrës Korçë vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 53, 3 qershor 1947, f. 7.

BALLHYSA Vildan

Lindi më 23 nëntor të vitit 1956, në Tiranë. Më 5 korrik 1972, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës e deklaroi fajtor «për krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes së mbetur në tentativë», dhe e dënoi me 1 vit heqje lirie. Vendimi u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 27 korrik 1972.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 390.

BALLIU Aziz

Lindi në fshatin Funares të Çermenikës. U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Për këtë arsye, më 22 maj të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Librazhdit urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 52, 3 qershor 1947, f. 5.

BALLIU Bari

Lindi më 10 shkurt të vitit 1935, në fshatin Vokopolë të Berat. U arrestua më 23 maj 1981 dhe po këtë vit Gjykata e Rrethit të Beratit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër shtetit», dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë dhe 5 vjet internim.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 370.

BALLIU Bexhet

Lindi më 5 qeshor të vitit 1948, në fshatin Gurras të Pogradecit. Më 28 gusht 1973, Gjykata e Korçës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 264.

BALLIU Çaush

Lindi më 5 dhjetor të vitit 1930, në fshatin Senisht të Pogradecit. Më 5 prill 1977, Gjykata e Pogradecit e dënoi me 7 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë» (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 261.

BALLIU Demir

Lindi më 10 qeshor të vitit 1943, në fshatin Çekin të Gramshit. Më 15 shtator 1977, Gjykata e Rrethit të Gramshit e dënoi përfundimisht me 10 vjet heqje lirie për «agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit popullor» (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 35.

BALLIU Haxhi

Lindi më 4 shtator të vitit 1931, në fshatin Funares të Çermenikës. Më 19 shkurt 1977, Gjykata e Elbasanit e dënoi me 7 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 94.

BALLIU Ismail

Lindi në fshatin Funares të Çermenikës. Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor

të Nënprefekturës së Librazhdit urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 51, 29 maj 1947, f. 6.

BALLIU Jakup

Lindi më 7 gusht të vitit 1892, në fshatin Funares të Çermenikës. Më 3 mars 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Librazhdit urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 60, 6 korrik 1946, fq. 8; nr. 64, 16 korrik 1946, fq. 6.

BALLIU Shyqyri

Lindi në fshatin Pjeçë të Peshkopisë. U dënua si «sabotator i Pushtetit». Për këtë arsye, më 27 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Peshkopi urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 17, 25 shkurt 1947, f. 6.

BALLIU Tomorr

Lindi më 7 maj të vitit 1941, në fshatin Çekin të Gramshit. Më datë 23 prill 1968, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 197.

BALLKA Nexhmi

Mësues.

Lindi më 4 maj të vitit 1913, në Delvinë. Më 31 dhjetor 1947, Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake e dënoi me burgim të përjetshëm. Më 3 mars 1948, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Tiranës vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij të tundshme. Fitoi pafajësinë dhe u lirua më 15 tetor 1949, për t'u burgosur sërish më vonë.

Gazeta Zyrtare, nr. 37, 7 prill 1948, f. 2.

BALLKAMENI Mihal

Luftëtar i çetës së Spiro Ballkamenit, mësues, publicist.

Lindi më 9 mars të vitit 1891, në fshatin Ballkamen pranë Follorinës, në Vilajetin e

Manastirit. Hapi shkollën e parë shqipe në Pogradec. Për shumë vite shërbeu si drejtor i arsimit në këtë qytet. Në vitet '30-të ishte përfaqësues i gazetës «Shqipëria e re». U arrestua në nëntor të vitit 1944. Më 10 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit N.Ç. të Nënprefekturës Qendër Korçë vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme. Vdiq nën tortura më 1948 në burgun e Burrelit dhe varri nuk i dihet as sot e kësaj dite.

Gazeta Zyrtare, nr. 42, 22 maj 1946, fq. 1.

BALLUKU Beqir

Ushtarak i lartë, Ministër i Mbrojtjes, zv. kryetar i Këshillit të Ministrave, deputet.

Lindi në Tiranë, më 14 shkurt të vitit 1917. Pasi kreu shkollën fillore, filloi shkollën teknike, por i shtrënguar nga gjendja e vështirë ekonomike e familjes, e la atë dhe, deri më 1939, ushtroi profesionin e hidraulikut e më pas atë të hekurpunuesit. Në vitin 1940, thirret nën armë në repartet e fanterisë dhe aty shërbeu deri në vitin 1942, kur u lirua nga ushtria. Në prill të vitit 1942 u pranua në Partinë Komuniste, kurse në mars 1943 u zgjodh anëtar i Komitetit Qarkor të Partisë Komuniste për Tiranën. Më 28 janar 1948, me urdhër të Enver Hoxhës, u emërua Kryetar i Shtatmadhërisë së Ushtrisë Kombëtare. Në Kongresin I-rë të PKSH-së u zgjodh anëtar i KQ të PKSH-së dhe i Byrosë Politike. Beqir Balluku është i dyti ushtarak i lartë shqiptar, që do të qëndronte më gjatë në krye të Ministrisë së Mbrojtjes. U zgjodh deputet në thujse në të gjitha legjislaturat. U arrestua në vitin 1974 dhe u ekzekutua një vit më vonë, si pjesëmarrës në të ashtuquajturin «Puç ushtarak», bashkë me Petrit Dumen [shih] e Hito Çakon [shih].

Dr. Gjergj P. Titani, Prof. dr. Proletar Hasani, *Personalitete ushtarake shqiptare në vite: 1912-dhjetor 1997*, Vëll. I, f. 165-173.

BALLUKU Vladimir

I biri i Beqir Ballukut [shih], futbollist.



Beqir Balluku

Lindi më 15 shkurt të vitit 1949 në Tiranë. Më 1 tetor 1979, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënnoi me 8 vjet heqje lirie. U ridënua dy vjet më vonë, më 5 shkurt 1981, nga Gjykata e Mirditës, me 10 vjet burg për «agjitacion e propagandë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 295.

BAMI Islam

Lindi më 15 gusht të vitit 1922 në Martanesh. Më 11 Shtator 1948, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «krime kundër shtetit» dhe e dënnoi me 20 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 231.

BAMI Rrape

Lindi në fshatin Tërbaç të Vlorës. U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Për këtë arsye, më 20 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Zerqanit vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 17, 25 shkurt 1947, f. 8.

BAMLLARI Avni

Lindi më 6 tetor të vitit 1949, në fshatin Pojan të Korçës. Më 7 shkurt 1980, Gjykata e Elbasanit e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe si «pjesëmarrës në organizata tradhëtare antisocialiste» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 220.

BANA Abdyl

Mori pjesë në Lëvizjen Nacionalçlirimtare që në vitin 1943. U arrestua pa asnjë provë, me sa duket për t'i nxjerrë ndonjë informacion mbi Islam Radovickën [shih]. Vdiq nga torturat në hetuesi, më 1947.

BANA Vesel

Lindi më 15 prill të vitit 1934, në fshatin Vidohovë të Devollit. Më 20 mars 1980, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 334.

BANAJ Maliq

Lindi më 1924, në fshatin Vranishtë të Vlorës. Më 27 shtator 1946, Gjykata Ushtarake e Vlorës e deklaroi fajtor për «strehimin e të arratisurve» dhe e dënoi me 30 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale. Më vonë dënimi iu ul në 20 vjet burg.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 88.

BANE (BANAJ) Piro

Lindi më 2 korrik të vitit 1950, në fshatin Zagori të Gjirokastrës. Më 24 gusht 1974, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «përgatitje për t'u arratisur» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 58.

BANO (BANOLLARI) Ilmi (Hilmi)

Lindi më 20 prill të vitit 1931 në fshatin Ballaban të Përmetit. Më 10 dhjetor 1950, Gjykata e Përmetit e deklaroi fajtor

për «sabotim ekonomik» dhe e dënoi me 5 vjet heqja lirie dhe punë të detyruar.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 276.

BANUSHI Besim

Lindi në fshatin Menkulas të Devollit. U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 13 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Devollit urdhëron sekuestrimin e pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 42, 8 maj 1947, f. 3.

BANUSHI Ibrahim

Lindi në fshatin Bozhigrad të Korçës. U deklarua «armik i popullit». Më 10 qershor të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit të Nënprefekturës së Devollit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 62, 8 korrik 1947, fq. 2.

BANUSHI Imzot Irine

Klerik i lartë ortodoks, peshkop i Strugës-Prespës dhe Caredvorit, ndihmës-peshkop i Apollonisë, peshkop i Gjirokastrës, pedagog.

Ilia Kolë Banushi lindi në Shkodër, më 18 gusht të vitin 1906. Shkollën e mesme e filloi në liceun «Illyricum» (1925) dhe



Imzot Irine Banushi

e përfundoi në Seminarin Ortodoks të Cetinjës (1931). Ndoqi Fakultetin e Teologjisë pranë Universitetit të Beogradit, ku u diplomua në qershor 1938. Pas kthimit në atdhe, Kryesia e Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë e emëroi profesor në Seminarin Kombëtar «Apostull Pavli», kurse Ministria e Arsimit profesor të gjuhës latine dhe të historisë në Gjimnazin e Shtetit në Tiranë (tetor 1941). Më 30 janar 1942 u hirotonis hierodhjakon, një ditë më vonë hieromonah e arkimandrit me emrin Irine, dhe më 1 shkurt peshkop. Me vendim të Sinodit të Shenjtë iu caktua froni i peshkopit të Strugës-Prespës dhe Caredvorit. Më vonë u emërua ndihmës-peshkop i Apollonisë. Deri më 12 korrik 1945 qëndroi si ndihmës peshkop i Kryesisë, e që prej asaj dite, derisa u arrestua, ushtroi funksionet e peshkopit për dioqezën e Gjirokastrës, por si titullar. U arrestua më 28 tetor 1946. Pas hetimesh të stërzgjatura, më 17 prill iu komunikua dënimi me 5 vjet heqje lirie, dënim të cilin e kreu në burgun e Tiranës. Përfitoi nga amnistia e 28 prillit 1949, dhe sapo doli nga burgu u shtrua në senatoriumin e Tiranës, sepse gjatë viteve të burgut ishte sëmurur me tuberkuloz. Një muaj e gjysmë pas daljes nga spitali, u izolua në manastirin e Shën Vlashit në Durrës. Më 1 shkurt 1950 u thirr si specialist për çështjet kankonike dhe dogmatike në komisionin për hartimin e Statutit të ri të Kishës Ortodokse Autoqefale të Shqipërisë. Por ai nuk pranoi dhe kundërshtoi hapur shkeljet dogmatike dhe kanonike që bëheshin në atë kohë në Kishë. Ai nuk pranoi të merrte pjesë as në Kongresin III të KOASH-it dhe as në dorëzimin e peshkopëve të rinj, të cilët më parë kishin qenë priftërinj të martuar. Për këtë arsye, pa kaluar shumë kohë, më 22 gusht 1952, një ditë përpara kremtimit të emrit të tij, u arrestua sërish. Pas hetimeve, më 9 prill 1953 u dënua përsëri me 5 vjet heqje lirie me akuzën se «Ka zhvilluar aktivitet kundër KOASH-it dhe ka nxitur elementë të tjerë për të shpifur kundër Kryesisë së Kishës me qëllim për të diskredituar udhëheqjen e

saj dhe më në fund për t'i hequr nga posti dhe për ta kthyer KOASH-in kundra vijës që ndjek sot dhe për të zhvilluar në të aktivitet kundra pushtetit.». U lirua pas kryerjes së kohës së plotë të dënimit, më 25 gusht 1957. Fill pas lirimit, u internua në Manastirin e Ardenicës në Lushnjë, ku qëndroi deri më 1967. Pas ndalimit të fesë, u zhvesh nga çdo detyrë kishtarë dhe filloi punë në ndërmarrjen e ndërtimit të hekurudhës (1967-1969) e, më vonë si kryellogaritar në Parkun e Automjeteve, po në Lushnjë. Pas keqësimit të shëndetit, më 18 nëntor 1973 u dërgua urgjentisht në spitalin e Tiranës. Vdiq në shtëpinë e së mbesës në Tiranë, më 25 nëntor të vitit 1973.

Hirësia e Tij Irineu është autor i librave shkollorë *Mësime fetare orthodhokse* (1943) për klasën e parë, të dytë, të tretë, të katërt dhe të pestë të fillores, të cilat u ndaluan me vendim të Gjykatës së Rrethit të Tiranës, datë 2 mars 1948. Ka përkthyer librin e Stavrofor Dr. D. Stefanoviçit, *Hymje në Testamentin e Ri: Pjesa e parë, Veprat e Apostujvet – Jeta e Veprat e Ap. Pavlit – Letrat e Ap. Paolit – Letrat e Përgjithëshme – Zbulesa (Apokalipsis)*, që u botua në Tiranë, më 1944, nga Kryepiskopata Orthodhokse e Shqipërisë.

Dhimitër Beduli, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944, në Kishë dhe Kulturë*, Tiranë, 2006, f. 37-59; Kristofor Beduli, *Episkop Irine Banushi martir i Kishës Orthodhokse autoqefale të Shqipërisë*, Botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë, Tiranë, 2000; *Jeta Kristiane*, nr. 12, shkurt 1942; *Gazeta Zyrtare*, 10 prill 1948, f. 6-8; Andrea Llukani, *Kisha në diktaturë*, Tiranë, 2012, f. 15-17; *70 vjet të kishës ortodokse autoqefale shqiptare*, Tiranë, 1993.

BAQLI O.F.M. At Aleks

Klerik katolik, drejtues i Shoqnisë Antoniane, sekretar i Provincës Françeskane Shqiptare.

Lindi në Shkodër, më 26 korrik të vitit 1918. Kreu Gjimnazin «Illyricum» më 1939. Studimet e larta për teologji dhe filozofi i kreu në Siena të Italisë. U shugurua më 28 qershor 1942. Qe drejtues i Shoqnisë Anto-

niane, profesor i stilistikës dhe i historisë së Mesjetës e asaj Moderne në Liceun «Illyricum» etj. Jepte dhe lëndën e dogmës dhe të moralit në shkollën e lartë të teologjisë ndër fretër. Shkroi dramën «Skanderbeu», që u luajt disa herë në Shkodër përpara vendosjes së Komunizmit. Shërbeu për shumë vite në kishën e Gjuhadolit e më pas në atë të Arrës së Madhe. Ishte dëshmitar i vendosjes së armëve në kishë nga Sigurimi, në nëntor 1946. Për këtë arsye u arrestua më 11 nëntor të vitit 1946 dhe u akuzua për «agjitacion e propagandë dhe përpjekje për rrëzimin e pushtetit popullor me armë». U lirua më 1956. Më 21 qershor 1958 u zgjodh sekretar i Provincës Françeskane Shqiptare. Tre vjet më vonë, më 22 qershor 1961, definitor dhe sekretar i saj. U arrestua sërish më 1976 dhe u dënua me dhjetë vjet heqje lirie. U lirua më 1987. Pas rihapjes së kishave, rifilloi shërbimin në kapelën e varrezave në Shkodër. Më pas shërbeu edhe në disa kisha të ndryshme të qytetit e të disa fshatrave përreth. Vdiq më 16 gusht 1993 në një spital të Romës. U varros në varrezat e Rrmajit në Shkodër.

P. Donat Kurti, *Provinca Françeskane Shqiptare (E ripërtrime në vj. 1906)*, I, XXX, XXXI, f. 39, 40; II, XXXIV, f. 96; Dr. Pjetër Pepa, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik shqiptar*, Tiranë, 2007, vol. I, II, f. 705-706.

BAQLI Injac

Ekonomist, nëpunës në Bankën e Shtetit në Shkodër.

Lindi më 30 tetor të vitit 1915, në Shkodër. U arrestua nga Sigurimi i Shtetit, më 22 dhjetor të vitit 1952. I kontrolluan shtëpinë dhe në arkën e së ëmës gjetën një revolver. Katër ditë më vonë, më 26 dhjetor, filluan hetimet, fillimisht për armëmbajtje pa leje. Më vonë u akuzua për agjitacion e propagandë kundër Pushtetit. Thuajse pas një viti torturash, në fund të vitit 1953 ia ndryshuan sërish akuzën dhe e fajësuan se ishte orvatur të arratisë, se kish qenë spiun i fashizmit dhe se kish folur kundër Pushtetit Popullor. Gjykata Ushtarake e Shkodrës e dënoi me 6 vjet

heqje lirie, por Gjykata e Lartë vendosi përsëritjen e gjyqit, sepse «proçesverbalet nuk janë firmuar nga i pandehuri». Gjyqi u përsërit më 18 korrik të vitit 1953: «...për krimin e armëmbajtjes (revolver gold amerikan, me 5 fishekë) deklarohet i pafajshëm. Akuzat tjera mbesin.» Më 29 janar 1954 ai kërkoi «prishje vendimi dhe rikthim aktesh për rishqyrtim dhe rigjykim». Në gjithë këtë kohë, nga përdorimi i shpeshhtë i elektrohokut, iu keqësua rëndë shëndeti. Vdiq në bodrumin e spitalit civil të Shkodrës. Trupi i tij u dërgua në morgun e Tiranës e prej këtu në morgun e Fakultetit të Mjeksisë për praktikant studentore.

Fritz Radovani – de Angeliis, *Një monument nën dhé*, Melbourne, 2004, IV, f. 264-267.

BARBULLUSHI Hysen

Lindi më 5 dhjetor të vitit 1943 në Shkodër. Më 13 prill 1961, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 3 vjet heqje lirie dhe konfiskim të pasurisë, për «tradhëti ndaj atdheut në formën e arratisjes». U arrestua sërish më 1969 dhe më 2 prill të po atij viti, Gjykata e Qarkut të Shkodrës e dënoi me 4 vjet burg për «veprën përgatitore për arratisje».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, FL. 161.

BARBULLUSHI Lec

Ish-nxënës i shkollës «Harry Fultz» në Tiranë. U arrestua aty nga fundi i vitit 1945.

BARÇI Qani

Më 10 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit N.Ç. të Nënprefekturës Qendër Korçë vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 42, 22 maj 1946, fq. 8.

BARÇI Skënder

Lindi më 1 tetor të vitit 1941, në Korçë. Më 25 shkurt 1967, Gjykata e Rrethit të Durrësit, mbështetur në nenet 64 dhe 27 të Kodit Penal, e dënoi me 15 vjet heqje li-



Koçi Xoxe, Siri Çarçani dhe në të majtë Beqir Balluku

rie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Më 24 janar 1970 iu falën 3 vjet nga dënimi.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 56.

BARÇI Vejsel

Më 10 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit N.Ç. të Nënprefekturës Qendër Korçë vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 42, 22 maj 1946, fq. 8.

BARDELI Kolec

Lindi më 30 maj të vitit 1932, në Shkodër. Më 28 dhjetor 1950, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 165.

BARDHA Namik

Inxhinier, gjeometër.

Lindi më 3 maj të vitit 1912, në Prevezë të Çamërisë. Më 1933 kreu Shkollën Teknike amerikane «Harry Fultz», dega

inxhinieri, në Tiranë. Mes viteve 1934-1936 punoi si gjeometër pranë seksionit të punimeve botore në Bashkinë e Peshkopisë, ndërsa në vitet 1937-1944 si gjeometër privat në qytetin e Tiranës. Pas mbarimit të luftës u emërua gjeometër në Degën Rruga-Ura, pranë Ministrisë së Punëve Botore, ndërsa më 1946 u transferua si kryetar i N.SH.N.-së së Elbasanit. Po këtë vit drejtoi punimet për ndërtimin e spitalit të Gjirokastrës. U arrestua më 27 maj të vitit 1947 si agjent i zbulimit amerikan dhe si pjesëtar i grupit «sabotator» të Kantierit të Maliqit, të «kryesuar» nga inxh. Abdyl Sharra. U pushkatua në nëntor të vitit 1947.

H. Gonxhja, I. Gogaj, Sh. Bumçi, *Ndihmesa e ish nxënësve dhe mësuesve të Shkollës Teknike të Tiranës për zhvillimin e vendit dhe luftën për çlirim e demokraci*, Tiranë, 2006, VII, f. 246; Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, Tiranë, 2007, XXIV, f. 314.

BARDHI Sami

Lindi në Konicë, më 1925. Gjatë luftës u rrjeshtua në radhët e organizatës së Ballit Kombëtar. Më vonë u inkuadrua në

Komitetin «Shqipëria e Lirë». Në vitin 1950 u kthye me mision në Shqipëri, por u kap me tradhëti. Pas dy vitesh tortura në hetuesi, u pushkatua më 1953.

BARDHI Kadri

Lindi më 10 korrik të vitit 1943 në Peqin. Më 5 dhjetor 1970, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «përgatitje për arratisje jashtë shtetit» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1977. Më 18 korrik 1978 Gjykata e Rrethit të Matit e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor», dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie. Gjatë kohës që po vuante dënimin, u arrestua sërish për «agjitacion e propagandë» dhe më 11 shtator 1980, Gjykata e Rrethit të Mirditës, duke i shtuar 10 vjet dënimit të mëparshëm, e ridënoi përfundimisht me 25 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 420.

BARDHI Kastriot

Lindi më 17 maj të vitit 1960 në Gramsh. Më 9 janar 1987, Gjykata e Rrethit të Gramshit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundra shtetit të kryer në bashkëpunim» dhe e dënoi me 13 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 361.

BARDHI Kolë

Lindi më 16 prill të vitit 1905 në fshatin Kaluer të Mirditës. U shpall «kriminel lufte dhe armik i popullit» dhe u ekzekutua më 19 maj 1946. Më 20 shtator 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Mirditës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 105, 18 dhjetor 1947, fq. 6.

BARDHI Qazim


Lindi më 13 shtator të vitit 1946, në Vlorë. Më 7 prill 1964, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 55.

BARDHI Haxhi Dede Reshat

Klerik i lartë bektashian, Kryegjysh Botëror i Bektashinjve (1993-2011).

Lindi më 4 mars të vitit 1935, në fshatin Lusën të Kukësit. Më 1954 u dorëzua dervish tek Dede Ahmet Myftar Ahmataj [shih]. Pas largimit të Dede Ahmetit nga Kryesia e Kryegjyshit Botëror Bektashian, pranoi të internohej bashkë me të në fshatin Drizar të Mallakastrës, ku qëndroi deri më 1967, kur në Shqipëri u ndalua ushtrimi i fesë. Pas kësaj, për 22 vjet, punoi si punëtor i thjeshtë në fermën «Gjergj Dimitrov» në Tiranë. Më 1991, bashkë me një grup besimtarësh, hapi Selinë e Shenjtë të Kryegjyshit Botëror Bektashian, dhe iu vu punës për riorganizimin e jetës fetare të komunitetit bektashian, duke ringritur objektet e kultit dhe duke përgatitur një brez të ri klerikësh. Po këtë vit bëri peligrinazhin tradicional islam në qytetin e shenjtë të Mekës dhe mori titullin Haxhi. Më 20 korrik 1993 organizoi dhe drejtoi Kongresin e Gjashtë Bektashian, ku u shpall Kryegjysh Botëror i Bektashinjve. Vdiq në moshën 76 vjeçare, më 2 prill të vitit 2011 në Tiranë. Me dekret nr. 1218, datë 26. 09. 1995 të Kuvendit të Shqipërisë,



Haxhi Dede Reshat Bardhi

Haxhi Dede Reshat Bardhi u nderua me titullin «Pishtar i Demokracisë», me motivacionin: «I pa përkulur dhe me besim ndaj Zotit, duroi burgjet e torturat e diktaturës për një Shqipëri të lirë, fetare e demokratike.» Është dekoruar dhe me Urdhrin «Naim Frashëri i artë».

Kujtim Ahmataj, *Loti i vvarë*, Tiranë, 2012, f. 86; Kujtim Ahmataj, *BARDHI Haxhi Dede Reshat*, në «Fjalor Enciklopedik Shqiptar», 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 180-181.

BARDHI Shaqir

Lindi më 31 korrik të vitit 1937, në Krujë. U dënua nga Gjykata Ushtarake e Rrethit të Tiranës për «tradhëti ndaj atdheut» me 10 vjet burg, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë. Më 27 nëntor 1957 iu fal dënimi i mbetur.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 48.

BARDHI Xhemal

Lindi në fshatin Selishtë të Burrelit. U shpall «kriminel lufte dhe armik i popullit». Për këtë arsye, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Burrelit urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 19, 27 shkurt 1947, f. 5.

BARDHOKU Luigj

Lindi në Rrëshen të Mirditës. U shpall «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 20 shtator të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Mirditës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 104, 16 dhjetor 1947, fq. 8.

BARDHOLLARI Kajmak

Lindi më 14 janar të vitit 1933, në fshatin Gjonomadh të Korçës. Më 11 nëntor 1957, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «përgatitje arratisjeje» dhe e dënoi me 13 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 54.

BARE Tunj

Lindi më 3 shkurt të vitit 1935, në Tiranë. Më 14 mars 1957, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie, konfiskimin e pjesshëm të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 53.

BARIU Skënder

Punëtor pasticerie nga qyteti i Durresit. U akuzua si bashkëpunëtor i Teme Sejkos [*shih*] dhe Tahir Demit [*shih*], dhe se në shtëpinë e tij ishte vendosur radiomarrësi, me anë të të cilit ata lidheshin me Flotën e Gjashtë Amerikane në Mesdhe. Fillimisht u dënua me vdekje, pastaj me 25 vjet heqje lirie.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 52.

BARKA KOÇO

Lindi më 13 korrik të vitit 1913, në fshatin Bodrishtë të Gjirokastrës. U dënua si «armik i popullit». Më 7 maj të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Libohovës urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 54, 6 qershor 1947, f. 6.


BARO Spiro

Lindi më 5 dhjetor të vitit 1958, në fshatin Borsh të Sarandës. Më 27 nëntor 1986, Gjykata e Sarandës e deklaroi fajtor për «krimiet: agjitacion e propagandë dhe arratisje të organizuar» dhe e dënoi me 11 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 191.

BAROLLI Fiqri

Lindi më 13 tetor të vitit 1943, në Korçë. Më 8 dhjetor 1962, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut me anë arratisjeje», dhe e dënoi me



Akil Basha

15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 419.

BAROLLI (BARDHI) Tomorr

Lindi më 2 prill të vitit 1961, në Lushnjë. Më 17 janar 1989, Gjykata e Lushnjes e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 18 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 137.

BARUTI Ismail

I biri i kolonel Ali Riza Kosovës, anëtar i organizatës studentore antikomuniste «Përppjekja Shqiptare», që u krijua në Gjimnazin e Shkodrës në tetor të vitit 1947.

Lindi më 1 tetor të vitit 1930, në Stamboll. U arrestua së bashku me të motrën, Olimbinë [shih], në tetor të vitit 1949, tek po përpiqeshin të kalonin kufirin. U dënua me vdekje, por më vonë dënimi iu kthye në burgim të përjetshëm. Përfundimisht vuajti tetëmbëdhjetë vjet burg.

Ahmet Bushati, *Në gjurmët e një ditari: Shkodra në vitet e para nën komunizëm*, Shkodër, 2007, III, f. 421-426.

BARUTI Olimbi

E bija e kolonel Ali Riza Kosovës. U arrestua së bashku me të vëllanë, Ismailin

[shih], në tetor të vitit 1949, ku po përpiqeshin të kalonin kufirin. U dënua me tri vjet heqje lirie.

Ahmet Bushati, *Në gjurmët e një ditari: Shkodra në vitet e para nën komunizëm*, Shkodër, 2007, III, f. 421-426.

BASRIU Lirie

Lindi më 18 shtator të vitit 1944, në Tiranë. Më 26 nëntor 1976, Gjykata e Rrethit të Tropojës e deklaroi fajtorë për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 18 dhjetor të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 422.

BASHA Akil

Lindi më 3 prill të vitit 1930, në Elbasan. U arrestua më 1946, dhe më 24 korrik të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krime kundra shtetit në bashkëpunim» dhe e dënoi me 1 vit heqje lirie dhe me humbjen e së drejtës elektorale baraz me kohën e dënimit. Ai, bashkë me Abdulla Berberin [shih], Parid Deranin [shih] dhe Petrit Berishën [shih] kishin hedhur traktet e hartuar prej krerëve të organizatës «Bashkimi-Demokrat», ku bëhej thirrje për bojkotimin e zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945. U arrestua sërish më 1950, dhe më 1 tetor të po atij viti, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë e deklaroi fajtor «se ka qenë anëtar i një grupi kundërshtar» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 349.

BASHA Lorenc

Lindi në Shkodër, në vitin 1900. Kreu shkollën françeskane në qytetin e lindjes, kurse studimet e larta për gjuhësi në Austri. Shërbeu për shumë vjet si nëndrejtor i gjimnazit të shtetit në Tiranë. U pushkatua më 12 nëntor të vitit 1944 me urdhër të Mehmet Shehut.

Agim Musta, Enver Lepenica, *Antologjia e krim-it komunist*, Tiranë, 2006, f. 35.

BASHA Mehmetali

Lindi më 6 dhjetor të vitit 1942, në Durrës. Më 1 gusht 1977, Gjykata e Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e agitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 189.

BASHA Murat

Ushtarak, drejtor i Shkollën së Xhandarmërisë, anëtar i Shtabit të Forcave të Legalitetit.

Lindi në vitin 1900, në fshatin Plani i Bardhë të Matit. Shkollën fillore (mejtëpin) (1907-1912), të mesmen (ruzhdijen, 1912-1915) dhe shkollën e aspirantëve për xhandarmëri (1918-1919) i kreu në Tiranë, kurse Akademinë Ushtarake në Itali. U emërua komandant batalioni rezervë në Gardën Kombëtare me gradën kapiten II. Në vitin 1936 u emërua drejtor i Shkollën së Xhandarmërisë në Burrel. Pas pushtimit italian të vendit, u largua në Jugosllavi. U kthye në prill të vitit 1941 dhe u caktua në Komisionin e kujdesit dhe ndihmës për emigrantët. Që nga tetori i vitit 1941 e deri në mbarim të luftës, u inkuadrua në Shtabin e Forcave të Legalitetit. Në vitin 1945 u arrestua për veprimtari antikomuniste gjatë luftës dhe, në qershor 1945, u dënua me vdekje me pushkatim. U ekzekutua më 7 qershor 1945. Ndonja një vit më vonë, më 8 prill 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tiranës, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Asllan Zemani, *BASHA Murat*, në «Fjalor Enciklopedik Shqiptar», 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 187; *Gazeta Zrytare*, nr. 35, 9 maj 1946, f. 2.

BASHA Shaban

Ushtarak.

Lindi në Pejë. Që fëmijë u largua në Shqipëri. Kreu Akademinë Ushtarake në Modena të Italisë. Më vonë u fut në Grupin Komunist të Shkodrës. Mori pjesë në Luftën e Spanjës, ku u gradua kapiten. Pas pushtimit italian të Shqipërisë, mori pjesë

aktive në luftë. Me mbarimin e luftës u arratis në Greqi, po atje ra në dorë të komunistëve grekë, të cilët e kthyen në Shqipëri, ku u arrestua menjëherë. Dënimin e vuajti pjesërisht në burgun e Burrelit. U lirua me amnistinë e vitit 1964. Pas liritimit u kthye në Kosovë. Pak kohë më vonë u emërua profesor i matematikës dhe fizikës në gjimnazin e Prishtinës.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 57-58; Uran Kalakulla, *21 vjet burg komunist*, Tiranë, 2008, f. 2.

BASHA Shaqir

Lindi më 20 shkurt të vitit 1948, në Tiranë. Më 19 nëntor 1976, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 14 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 246.

BASHA Shkëlqim

Lindi më 22 gusht të vitit 1962, në Tiranë. Më 12 tetor 1988, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 23 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 229.

BASHA Shyqyri Sulejman

Mjek dermatovenerolog, doktor i shkencave mjeksore, pedagog që me krijimin e Fakultetit të Mjeksisë.

Lindi më 19 maj të vitit 1911, në qytetin e Tiranës. Shkollën e mesme e kreu në Montemario të Padovës, kurse të lartën në Universitetin e Romës (1931-1936). Në vitin 1939, së bashku me dr. Sinan Imamin, hapën një spital në Sukth për mjekimin e të plagosurve. Në vitet 1940-1942 kreu specializimin për dermatovenerologji në Bolonjë dhe nga viti 1942 deri më 1945 shërbeu si dermatolog në Spitalin e Përgjithëshëm Civil në Tiranë. U arrestua më 1945 dhe u dënua me dy vjet heqje lirie. Me t'u liruar, shërbeu si dermatolog në spitalin e Beratit (1948-1950) dhe në Poliklinikën

Qendrore të Tiranës (1950-1989). Prej vitit 1960 drejtoi kurse specializimi për mjekët e rretheve. Vdiq në vitin 1995.

Mantho Nakuçi, *BASHA Shyqri*, në «Fjalor Enciklopedik Shqiptar», 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 187; Lista nr. 1 e të Dënuarve Politikë me dënim me burgim (vkm 1699, datë 29.12.2008).

BASHI Kozma

Lindi më 3 mars të vitit 1929, në fshatin Dhërmi të Vlorës. Më 27 korrik 1962, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut në formën e tentativës së arratisjes në Greqinë monarko-fashiste» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 4 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë, më 6 shtator të po atij viti.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 432.

BASHO Dhionis

Lindi më 20 dhjetor të vitit 1936, në Delvinë. Më 25 tetor 1976, Gjykata e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 176.

BASHO Llambi

Lindi më 12 shkurt të vitit 1897, në Pogradec. U dënua si «kriminel luftë». Më 30 prill 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Pogradecit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 54, 15 maj 1948, fq. 7.

BASHO Nikolla

U ekzekutua më 14 nëntor të vitit 1962.

Lista e personave të ekzekutuar për vitin 1961-1962, hartuar nga Dega e Hetuesisë së Drejtorisë së Policisë, Tiranë.

BATKINA (PISHA) Taisa

Hebreje ruse, kimiste.

Lindi më 2 shtator të vitit 1932, në qytetin Tula, në Rusi. Kreu studimet në Universitetin e Moskës. Aty u njoh dhe u martua me studentin shqiptar Gaqo Pisha, që në vitet '50-të studionte për filozofi në Universitetin e Moskës, dhe në vitin 1957 erdhën në Shqipëri. Po atë vit filloi punë në Universitetin Shtetëror të Tiranës, në katedrën e kimisë organike. Në vitin 1966, kur filloi fushata «e qarkullimit të kuadrove», bashkëshortët Pisha i transferuan në Berat, ku ajo filloi punë në kombinatin e tekstileve. Për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore të të shoqit, më 1971 i kthyen në Tiranë. U arrestua më 1977, dhe më 16 korrik të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Tiranës e dënoi me 16 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë së luajtshme, për «tradhti ndaj atdheut në formën e spiunazhit dhe agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor». Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 5 gusht 1977. U lirua me dekret, më 13 janar 1986. Më 1990 u largua familjarisht në B.S., e prej këtu në Izrael.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 372.

BATUSHA Fadil

Lindi më 30 shtator të vitit 1936, në fshatin Batushë të Malësisë së Gjakovës. Më 4 prill 1967, Gjykata e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V.2012, D. 1, Fl. 205.

BAZELLI Petrit

Lindi më 16 shkurt të vitit 1949, në fshatin Maliq të Korçës. Më 17 mars 1981, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 343.

BAZELLIU Hasim

Lindi në fshatin Kolanec të Korçës. Më

6 mars të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Korçë urdhëron sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 57, 27 qeshor 1946, fq. 6.

BAZI Elez

Lindi në fshatin Kullaj të Postribës. Mori pjesë në kryengritjen e Postribës. U vra në përpjekje me forcat qeveritare në afërsi të spitalit të Shkodrës, më 9 shtator të vitit 1946.

BAZHDARI Adem

Profesor i matematikës në Gjymnazin e Shtetit në Shkodër. U arrestua në vitin 1946 dhe vuajti 3 vjet burg.

BAZHDARI Ndrekë

Lindi më 10 dhjetor të vitit 1939, në Shkodër. Më 6 gusht 1957, Gjykata Ushtrake e Tiranës e deklaroi fajtor «për përgatitje për t'u arratisur në një shtet të huaj» e «për agjitacion e propagandë» dhe dënoi me 14 vjet heqje lirie dhe me konfiskim të pasurisë. U lirua me kusht më 28 gusht të vitit 1964.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 335.

BEBEZIQI Izet

Lindi në Shkodër, më 11 tetor të vitit 1905. Studimet e mesme e të larta i kreu në Austri, ku kish profesor Norbert Joklin. Mori pjesë në demonstratën antifashiste, që u zhvillua në Vlorë më 7 prillit 1939. Mes viteve 1940-1943 u inetrnua në Itali. U arrestua aty nga fundi i vitit 1945 në Tiranë dhe u dënua me 7 vjet heqje lirie.

Ahmet Bushati, *Në gjurmët e një ditari: Shkodra në vitet e para nën komunizëm*, Shkodër, 2007, I, f. 187.

BECI Bibë

Lindi në fshatin Zajs të Mirditës. U shpall «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 20 shtator të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Mirditës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 104, 16 dhjetor 1947, fq. 5.

BECI Gjetë

Lindi në vitin 1878, në fshatin Zajs të Mirditës. Më 29 korrik 1949, Gjykata Ushtrake e Tiranës e deklaroi fajtor si «bashkëpunëtor me kriminelat e arratisur» dhe «pjesëmarrës në grupet kundër shtetit» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 225.

BECI, MARK

Lindi në fshatin Zajs të Mirditës. U shpall «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 20 shtator të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Mirditës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 105, 18 dhjetor 1947, fq. 4.

BEÇA Nikollë

Lindi në Elbasan. U dënua si «armik i popullit». Më 10 tetor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Qendrës Elbasan urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 28, 29 mars 1947, f. 7.

BEÇO Nikolla

Lindi në Elbasan. U shpall «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 13 tetor të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Prefekturës së Tiranës vendosi sekuestrimin e pasurisë së tundshme te tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 102, 9 dhjetor 1947, fq. 5.

BEDA Flora

Lindi më 18 gusht të vitit 1942, në fshatin Kamçishtë (Bubullimë) të Lushnjës. Më 27 qeshor 1984, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 14 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 138.

BEDOLLI Ferdinand

Lindi më 10 gusht të vitit 1952, në Vlorë. Më 6 dhjetor 1984, Gjykata e Rrethit

të Elbasanit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 87.

BABA BEDRIU I BRERIMËS

U ekzekutua në vitin 1947.

BEGA BORO

Lindi më 20 maj të vitit 1932, në fshatin Nivicë të Tepelenës. Më 5 tetor 1951, Gjykata Ushtarake e Gjirakastrës e deklaroi fajtor për «strehim të diversantëve» dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për një vit kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 133.

BEGA Gëzim

Lindi më 7 shkurt të vitit 1948, në fshatin Samaticë të Beratit. Më 13 tetor 1983, Gjykata e Rrethit të Beratit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 51.

BEGA Zenel

Lindi në Pogradec. U deklarua «tradhtar». Për këtë arsye, më 14 maj të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Qendrës Korçë vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 53, 3 qershor 1947, f. 7.

BEGAJ Musa

Lindi më 16 gusht të vitit 1943, në fshatin Çorush të Mallakastrës. Më 27 shtator 1982, Gjykata e Fierit e dënoi me 9 vjet heqje lirie, 5 vjet internim dhe humbje të së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «agjitacion e propagandë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 202.

BEGAJ Mustafa

Lindi në Mallakastër. Më 26 tetor të vitit 1949, Gjykata e Prefekturës së Tiranës

(vendim nr. 50) e dënoi me vdekje. Por më 7 shkurt 1947, Kryesia e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë, dekretoi faljen e këtij dënimi dhe kthimin e tij në privim lirie për jetë dhe punë të detyruar.

Gazeta Zyrtare, nr. 1, 18 janar 1950, f. 2.

BEGOLLI Rifat

Ekonomist, pjesëtar i Lidhjes së Dytë të Prizrenit, Ministër i Ekonomisë (18 korrik 1944-28 gusht 1944; 7 shtator 1944-25 tetor 1944).

Lindi në Pejë. Ushtri funksionin e Ministrit të Ekonomisë në dy kabinete qeveritare, në qeverinë e kryesuar prej Fiqiri Dines (18 korrik 1944-28 gusht 1944) dhe në atë të Ibrahim Biçakut (7 shtator 1944-25 tetor 1944) [*shih*]. U dënua me burg nga Gjyqi Special i zhvilluar në muajt mars-prill të vitit 1945. Për këtë arsye, më 6 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tiranës, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 20, 23 mars 1946, f. 7.

BEGOLLI Sahmi

Lindi në fshatin Menkulas të Devollit. Më 3 shtator të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv të Nënprefekturës së Devollit, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 35, 9 maj 1946, f. 7.

BEGTESHI Refat

Lindi në Shkodër. U deklarua «armik i popullit». Më 17 mars të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Durrësit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 45, 29 prill 1948, f. 6.

BEJA Shefqet

Veprimtar politik, nënkryetar i Frontit Nacionalçlirimtar, deputet i legjislaturës së parë (1945).

Lindi në vitin 1914, në Durrës. Studimet e larta për ekonomi i kreu në Itali.



Shefqet Beja në gjyq

Mori pjesë aktive në Frontin Nacionalçlirimtar. Është një nga nismëtarët për nxjerrjen e gazetës «Bashkimi», organ i Frontit Nacionalçlirimtar dhe nënkryetar i këtij fronti. Në legjislaturën e parë pas luftës (1945) u zgjodh deputet i qytetit të Durrësit. Kundërshtoi hapur vendosjen e diktaturës komuniste. Më 7 gusht 1947, në mbledhjen XI të Kuvendit Popullor, iu hoq mandati, njëherësh me atë të shtatë deputetëve të tjerë, si kryetar i «grupit të deputetëve» (opozita e dytë). U akuzua se kishte «formuar një organizatë klandestine në bashkëpunim me «armiqtë e popullit» Sami Qeribashi [shih], Suat Asllani [shih], Gjergj Kokoshi [shih], Riza Dani [shih] etj.». Me vendim të Gjykatës së Lartë nr. 187, datë 27 shtator 1947, u dënua me vdekje në litar. Vendimi u ekzekutua më 3 tetor 1947. Një muaj para ekzekutimit, më 29 shtator të po atij viti, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Prefekturës së Tiranës vendosi sekuestrimin e pasurisë së tundshme të tij.

Arkivi i Kuvendit Popullor, f. 466; *Gazeta Zyrtare*, nr. 102, 9 dhjetor 1947, fq. 2.

BEJDO Nebi

Lindi në fshatin Gostivisht të Kolonjës. U deklarua «kriminel lufte». Më 11 dhjetor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Prefekturës së Qendres Korçë, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë

së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 1, 2 kallnor 1947, f. 6.

BEJKO Çajup

Lindi më 17 mars të vitit 1954, në fshatin Lazarat të Gjirokastrës. Më 11 prill 1980, Kolegji Ushtarak i Gjirokastrës e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «tradhëti ndaj atdheut» (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 262.

BEJKO Dervish

Lindi në vitin 1946, në Pogradec. U dënua më 1971 nga Gjykata e Elbasanit për «përgatitje arratisjeje». Është një nga të dënuarit me vdekje të revoltës së Spaçit, që shpërtheu më 21 maj të vitit 1973. Më 24 maj, ende sa pa përfunduar përlëshja midis të dënuarve dhe forcave të policisë, Gjykata e Lartë, që shprehte verdiktin e Këshillit Gjyqësor të Kolegjit Penal, bëri të ditur se Skënder Daja [shih], Dervish Bejko, Naim Pashaj [shih] e Pal Zefi [shih], shpallen fajtorë për pjesëmarrjen në një organizatë kundër pushtetit popullor me qëllim kriminel e sabotimit ekonomik, ndaj dhe i dënoi me vdekje me pushkatim. Edhe pse të dënuarit kërkuan mëshirë, Presidiumi i Kuvendi Popullor refuzoi kërkesën e tyre dhe ata u pushkatuan po atë ditë. Për të tmerruar të burgosurit, pushkatimi u krye në kamp. Pastaj trupat u sollën në Tiranë për kadavër, por meqë nuk kishte nevojë, i varrosën në rrugën Elbasan-Tiranë, në afërsi të vendit ku ka filluar tuneli i rrugës në fjalë.

Gazeta «Panorama», 2 maj 2011; Bedri Blloshmi, *Rrëfime nga ferri komunist*, Tiranë, 2011, f. 494.

BEJKO Enver

Lindi më 13 shkurt të vitit 1914 në Starovë.

BEJKO Jemin

Lindi më 18 maj të vitit 1928, në fshatin Taç i Poshtëm të Kolonjës. Më 7 dhjetor 1966, mbështetur në nenet 73/2, 273/1 dhe 271/20

të Kodit Penal, Gjykata e Rrethit të Korçës e dënoi me 7 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 47.

BEJKO Kamber

Lindi më 18 shkurt të vitit 1923, në fshatin Dobrush të Skraparit. Më 30 tetor 1945, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Beratit e deklaroi fajtor si «armik të popullit» dhe e dënoi me 30 vjet heqje lirie, konfiskimin e të gjithë pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale. Më 24 dhjetor të të njëjtit vit, dënimi iu kthye në 20 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 49.

BEJKO Lirak

Lindi më 13 tetor të vitit 1965, në Tiranë. U arrestua më 13 nëntor 1985. Më 1 shtator 1986, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Sarandës deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie. U lirua më 10 janar 1991. Vdiq më 2 nëntor të vitit 2012 në një spital të Barit, në Itali.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 46; Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Problemeve Shqoqërore, Vërtetim, nr. Extra i Prot.

BEJKOSALAJ Laze

Lindi në Vlorë. Më 7 korrik të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Vlorë, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 41, 21 maj 1946, f. 3.

BEJKOVA Medo

Lindi në fshatin Bejkovë të Kolonjës. U dënua me vdekje nga Gjykata Usharake «për faje kriminale të kryera në rradhët e organizatës tradhëtare të Ballit Kombëtar». Më 16 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit N.Ç. të Nënprefekturës së Kolonjës urdhëroi konfiskimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 64, 16 korrik 1946, fq. 3.



Medo Bejkova

BEJLERI Dervish

Mësues.

Lindi më 9 tetor të vitit 1909, në Gjirokastrë. U arratis jashtë shtetit më 5 mars 1953. U kthye në Shqipëri më 1961 dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie.

BEJLERI Isa

Financier.

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1921, në Gjirokastrë. Më 1960 u dënua me 20 vjet heqje lirie për «tentativë arratisjeje».

BEJLERI Muharrem

Lindi në vitin 1919, në Libohovë. U arrestua në shtator 1945 dhe u dërgua në birucat e Burgut të Ri të Tiranës. Në korrik të vitit 1946, në çastin që të burgosurit kishin dalë në oborr, goditi për vdekje policin gardian. Doli në oborr duke thirrur: «Poshtë komunizmi!». U përpoq të kalonte murin e lartë rrethues, por më kotë. Pastaj u fut në një dhomë policie dhe u armatos. Ra alarmi. Thirrjes për dorëzim iu përgjigj me të shtëna nëpërmjet dritares. Askush nuk guxoi të afrohej. Kjo gjendje vazhdoi më se një orë, derisa mbërriti zv. Prokurori i Përgjithshëm, kolonel Bilbil Klosi, që kërkoi me çdo kusht kokën e tij. Më në fund, një nën-oficer hipi mbi çatinë e gazermës, hoqi një tjegull dhe hodhi brenda

një granatë. Në vitin 1995, Presidenti i Republikës e dekoroi me medaljen «Martir i Demokracisë».

BEJLERI Nevruz

Ish major i Sigurimit të Shtetit.

Lindi në Libohovë, më 25 mars të vitit 1922. U ekzekutua më 17 nëntor të vitit 1961 si anëtar i «Grupit të Teme Sejkos».

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 01. 07. 2009: Për miratimin e dëmshtëpërblimit financiar për ish-të përndjekurit politikë të regjimit komunist; *Lista e personave të ekzekutuar për vitin 1961-1962*, hartuar nga Dega e Hetuesisë së Drejtorisë së Policisë, Tiranë.

BEJLERI Zija

Ekonomist, politolog.

Lindi në Tassos (Maqedoni), më 1896, në familjen e gjykatësit libohovit Haki Bejleri. Shkollën fillore e kreu në Stamboll dhe të mesëm në Liceun franko-turk të Gallata Sarajit po në Stamboll (1918). Me mbarimin e Luftës I Botërore, u dërgua në Francë për studime universitare, pranë shkollës së lartë të shkencave politike në Paris. Vitin e fundit e mbaroi në Romë, ku mbrojti dhe doktoratën për shkencë politike-ekonomike. Më 1925 u emërua pranë Ministrisë së Financave, ku punoi deri në shtator të vitit 1930. Me vendim qeverie, Zija Bejleri u dërgua nga shteti në Paris, ku për një vit akademik u specializua për problemet e Bankës Bujqësore. Në qershor të vitit 1931 rifilloi punën në Ministri dhe në tetor u zgjodh në përbërje të delegacionit, që përfaqësoi Shqipërinë në Konferencën Ballkanike të Athinës. Në dhjetor 1936 u emërua Drejtor i të Ardhurave Kombëtare pranë Ministrisë së Financave. Këtë funksion e ushtroi deri në gusht 1937, kur u caktua drejtor i Bankës Bujqësore Shqiptare. U arrestua më 1 mars 1945, dhe u dënua me 5 vjet burg nga Gjyqi Special i zhvilluar në muajt mars-prill të vitit 1945, me akuzën: «I. Ka qenë eksponent i organizatës tradhëtare e mercenare të Ballit Kombëtar. II. Si nëpunës i lartë i qeverive Kuislinge i ka shërbyer okupatorit». U



Zija e Idajete Bejleri

lirua tre vjet më vonë me amnisti. Pas burgut u mor me përkthime nga frëngjishtja, turqishtja etj. Vdiq në qershor të vitit 1963, në moshën 67 vjeçare. Është përfshirë në fjalorin «Who's Who in East and Central Europe», të botuar në Zyrin, më 1937.

Gazeta «Besa», 6 prill 1932 dhe 2 gusht 1937; Stephen Taylor, *Who's Who in East and Central Europe*, «Central European Times Pub. Co.», Zurich, 1937, f. 168.

BEJO Shamet

Lindi në fshatin Dhëmban të Tepele-nës. Më 2 nëntor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tepelenës, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 40, 20 maj 1946, f. 3.

BEJO Thoma

Më 21 shkurt të vitit 1979 (në dosjen hetimore 20, në dosjen gjyqësore 23 shkurt) u riarrestua bashkë me Fatos Lubonjën [shih], Muho Balën [shih], Dhimitër Stefën [shih] dhe Eduard Vatën [shih], në kohën që ende po vuante dënim në kampin e Spaçit.

Fatos Lubonja, *Ridënimi*, Tiranë, 2007, I, VII, f. 33, 38-39; II, IX, f. 50.

BEJTAGA Isuf

Lindi më 28 nëntor të vitit 1945, në Durrës. Më 20 shtator 1977, Gjykata e Kavajës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitationit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 271.

BEJTJA Ramadan

U ekzekutua më 17 nëntor të vitit 1962.

Lista e personave të ekzekutuar për vitin 1961-1962, hartuar nga Dega e Hetuesisë së Drejtorisë së Policisë, Tiranë.

BEJTJAJ Arif

Lindi në fshatin Mavrovë të Vlorës. Më 15 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv të Nënprefekturës së Kotës, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 34, 4 maj 1946, f. 4; *Gazeta Zyrtare*, nr. 41, 21 maj 1946, f. 6.

BEKTASHI Mehdi

Lindi në Mbreshtan të Leskovikut. U shpall «kriminel luftime». Më 21 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Leskovikut vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 42, 8 maj 1947, f. 7.

BEKTESHI Latif

Lindi më 17 dhjetor të vitit 1941, në fshatin Kllobusht të Dibrës. Më 10 gusht 1965, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e të gjithë pasurisë, të luajtshme e të paluajtshme.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 50.

BEKTESHI Mexhit

Lindi në Shijak. Më 10 maj të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Shijakut urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 73, 6 gusht 1946, f. 5.

BEKTESHI Haxhi Hafiz Muhamet

Klerik i lartë musliman, pedagog, prijës i tarikatit Tixhani për Shkodrën.

Lindi në Shkodër, më 1883. Kreu shkollën qytetëse dhe të mesmen administrative. Studimet teologjike i bëri me myderrizë të njohur shkodranë, si Haxhi Hysen ef. Vuthi etj. Në Kongresin II Musliman të Shqipërisë (1926) mori pjesë si delegat i Shkodrës. Më 1929 u emërua *vaiz* (predikues) në prefekturën e Shkodrës e më vonë edhe myderriz e profesor në medrese. U arrestua në vitin 1947 për agjitation e propagandë dhe u dënua me 10 vjet heqje lirie. U lirua më 1954 dhe vdiq katër vjet më vonë, më 1958, në Shkodër.

100 personalitete shqiptare të kulturës islame: shekulli XIX-XX, Komiteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë, 2012, f. 136-139.

BEKTESHI Sadik

Pjesëmarrës i Luftës ANÇ, komandant i formacioneve partizane, drejtor i Institutit të Kërkimeve Ushtarake.

Lindi më 10 janar të vitit 1920, në Shkodër. Kreu gjimnazin e qytetit. Më 1937 u anëtarësua në Grupin Komunist



Haxhi Hafiz Muhamet Bektishi

të Shkodrës. Në shtator të vitit 1943 u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm NÇ të Shqipërisë. Pas mbarimit të luftës, në shkurt 1945, u emërua për pak kohë shef i Kabinetit Ushtarak të Komandës së Përgjithshme. Kreu Akademinë Ushtarake «Frunze» (1945-1950) dhe më pas Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm «Voroshilov» (1954-1957) në Moskë. Më 1969-1974 u emërua drejtor i Institutit të Kërkimeve Ushtarake. Në dhjetor të vitit 1974 u përjashtua nga radhët e Ushtrisë dhe nga PPSH dhe më 1975 u internua bashkë me familjen në fshatrat e Beratit. U arrestua më 1982 dhe u dënua me 25 vjet heqje lirie. U lirua më 1990.

Gjergj Titani, *BEKTESHI, Sadik*, në «Fjalor Enciklopedik Shqiptar», 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 204.

BEKTESHI Sakip

Lindi më 6 shkurt të vitit 1937, në fshatin Kllloboçishtë të Dibrës. Më 10 gusht 1965, Gjykata e Dibrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 253.

BEKTESHI Shuaip

Lindi në fshatin Zerqan të rrethit të Bulqizës. U dënua si «kriminel luftime dhe armik i popullit». Për këtë arsye, më 22 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Zerqanit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 46, 19 maj 1947, f. 4.

BELE Nikollaq

Lindi më 1 janar të vitit 1922, në Fier. Më 17 korrik 1945, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e dënoi me vdekje si «disfatist në ushtri». Më vonë, dënimi iu kthye në burgim të përjetshëm e pataj në 30 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1950, dhe më 1 shtator të po atij viti, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie. U arres-

tua për të tretën herë më 1956, dhe më 21 dhjetor të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor «për krimin e tentativës së arratisjes për në një shtet të huaj armik» dhe e dënoi me 18 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 340.

BELEGU Bajram

Lindi më 15 korrik të vitit 1921, në fshatin Laktesh të Pogradecit. Më 14 shkurt 1957, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut», dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë, humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë dhe heqjen e gradës ushtarake.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 410.

BELEGU Xhafer

Historian e diplomat.

Lindi më 11 janar të vitit 1904, në Elbasan. Kreu shkollën e mesme «Naim Frashëri» në qytetin e lindjes. Mes viteve 1920-1928 kreu Akademinë Tregtare në Linz të Austrisë. Pas përfundimit të studimeve u kthye në Shqipëri. Më 1938 u emërua kryekonsull në Bari, Itali, detyrë të cilën e kreu deri më 1939, kur u transferua si konsull në qytetin e Manastirit në Maqedoni. Pas pushtimit të Jugosllavisë nga nazistët, u kthye në atdhe. U arrestua më 1945 si autor i veprës antijugosllave «Lidhja e Prizrenit e veprimet e sajë, 1878-1881». U lirua tre vjet më vonë, më 1948. Vdiq më 1 janar të vitit 1962 në Elbasan.

Vepra: «Lidhja e Prizrenit e veprimet e sajë 1878-1881» (Tiranë, 1939). *Përkthime*: Ivan Turgenjev, «Dashuni e parë», Shtyp. Kartoleria «Peppo et Marko», Korçë, 1933.

Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, Tiranë, 2007, XXV, f. 319; Maks Gjinaj, Margarita Mele, Myrvete Elmazi, *Bibliografi e librit shqip në fondet e Bibliotekës Kombëtare (1913-1944)*, Biblioteka Kombëtare, Tiranë, 2010, f. 574.

BELEGU Xhemal

Lindi në Krujë, më 1881. Studimet e larta për pedagogji i kreu në Stamboll. U

arrestua në vitin 1946 dhe u dënua me 5 vjet burg «për agjitacion e propagandë». U lirua në vitin 1948.

Në vitin 1994, Presidenti i Republikës i akordoi urdhërin «Mësues i Popullit», pas vdekjes.

Vepra: «Hygjenie per ke do qi dishiron me jetue me shëndet» (*bashkëautor, Shkodër, 1920*).

Maks Gjinaj, Margarita Mele, Myrvete Elmazi, *Bibliografi e librit shqip në fondet e Bibliotekës Kombëtare (1913-1944)*, Biblioteka Kombëtare, Tiranë, 2010, f. 239.

BELESKI Boris

Ushtarak i lartë, instruktor i Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, një nga treqind rusët e bardhë që erdhën me mbretin Zog në Shqipëri.

Lindi në vitin 1898. U diplomua në Akademinë Ushtarake të Moskës. Shërbeu si instruktor në Ushtrinë Kombëtare Shqiptare. U arrestua më 12 nëntor të vitit 1944 dhe u pushkatua për spiunazh nga një skuadër partizane.

Në dhjetor të vitit 2009, Presidenti i Republikës e dekoroi me Urdhërin «Nderi i Kombit», bashkë me 36 intelektualë të tjerë të Tiranës të vrarë nga komunistët në periudhën 28 tetor-16 nëntor 1944, me motivacionin: «Të martirizuar nga terrori komunist për shkak të besimit në idetë demokratike perëndimore të zhvillimit të Shqipërisë pas Luftës II Botërore».

Agim Musta, Enver Lepenica, *Antologjia e krim-it komunist*, Tiranë, 2006, f. 33.

BELESHI Gjergj

Lindi në fshatin Kthellë Epër të Mirditës. U pushkatua më 17 gusht të vitit 1949, si i dyshuar për vrasjen e Bardhok Bibës.

BELI Adem

Agronom.

Lindi më 3 qeshor të vitit 1909 në Korçë. Studimet universitare për agronomi i kreu në Tuluzë të Francës. U kthye në Shqipëri më 1939. Mori pjesë në luftën e Gjormit. U



Adem Beli

arrestua në fund të 1946-s. Më 31 dhjetor të vitit 1947, Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake e dënoi me 20 vjet heqje lirie. Më 26 shkurt 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të qytetit të Beratit vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. U lirua në vitin 1954. Nga torturat çnjerëzore kaloi në gangrenë të këmbëve dhe, ashtu i gjymtuar, jetoi deri sa vdiq.

Gazeta Zyrtare, nr. 32, 25 mars 1948, f. 6.

BELI Myrteza

Lindi në Korçë. U arrestua në fillim të vitit 1946 si anëtar i Grupit të Rezistencës. U dënua me 25 vjet heqje lirie. Më 17 shkurt 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Qendres Korçë vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 25, 18 mars 1947, f. 3.

BELISHOVA Agron

Mjek.

Lindi më 20 prill të vitit 1938, në fshatin Belishovë të Mallakastrës. Pas 6 muajsh sflitës në qelitë e hetuesisë, më 14 shtator 1977, Gjykata e Rrethit të Lezhës e dënoi me 10 vjet heqje lirie për «agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit popullor».



Liri Belishova

Pas burgut u internua pa familjen në zonat më të thella të vendit.

Agim Musta, Visar Zhiti, Enver Lepenica, Tanush Mulleti, *Antologjia e plagëve nën terrorin komunist*, Tiranë, 2004, f. 113; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 45.

BELISHOVA Bardhyl

Inxhinier elektrik.

Lindi më 4 shtator të vitit 1932, në fshatin Belishovë të Mallakastrës. U arrestua më 1964. Dënimin e vuajti në burgun e Burrelit. U lirua më 1990. Është një nga themeluesit e Shoqatës Kombëtare të të Persekutuarve Politikë të Shqipërisë (1991).

BELISHOVA Liri

Një nga drejtueset kryesore të PKSH-së, anëtare e Byrosë Politike dhe e Komitetit Qendror të PPSH-së.


Lindi më 1923, në fshatin Belishovë të Mallakastrës. Pas themelimit të PPSH-së, u caktua në detyra të rëndësishme drejtuese. Më 1948 u zgjodh anëtare e Komitetit Qendror të PPSH-së, si dhe anëtare e Byrosë Politike të saj. Nga qershori i vitit 1954 deri më 1960 pasoi Josif Pashkon në postin e sekretarit të Komitetit Qendror. Në gjithë këtë kohë ushtroi dhe funksionet e sekretarit të Presidiumit të Kuvendit Popullor (1958-1961). Më 9 shtator 1960, pas një de-

noncimi të Hysni Kapos, u përjashtua nga partia si përfaqësuese «e krahut prosovjetik dhe revizionist në PPSH». U internua, fillimisht në Gjirokastër dhe më pas në Cërrik, ku qëndroi për gati 21 vjet.

BELTOJA (GJERGJI) Dom Mikel

Klerik katolik.

Lindi në fshatin Beltojë të Shkodrës, më 17 prill të vitit 1935 (sipas gjendje civile, më 9 maj 1936). Shkollën fillore e kreu në fshatin e tij të lindjes (1948-1951) dhe, vitin e fundit, në Bërdicë. Në Shkollën Pedagogjike të Tiranës bëri shtatë muaj për mësuesi. Më vonë u përgatit privatisht nga ana filozofike e teologjike prej Ipeshkvit të Shkodrës, Imzot Ernest Çobës [shih]. U shugurua më 8 dhjetor 1961. Po atë muaj u emërua meshtar në Dajç të Bregut të Bunës, ndërsa në nëntor 1964 famullitar në Barbullush. Aty qëndroi deri më 22 shkurt 1967. Pas mbylljes së kishave në mars 1967, u kthye në shtëpi të prindërve dhe filloi punë në kooperativën bujqësore, deri ditën që u arrestua në Beltojë, më 19 prill 1973. U torturua në mënyrë shtazarake. Gjatë hetuesisë dhe gjyqit nuk i kurseu fjalët kundër regjimit dhe diktatorit Enver Hoxha: «Është provuar plotësisht se i lartpërmenduri, vazhdimisht ka zhvilluar



Dom Mikel Beltoja (Gjergji)

agjitacion e propagandë kundër Pushtetit Popullor dhe është shprehur kundër udhëheqjes së Partisë dhe të Pushtetit, kundër komunistëve, “të cilët kanë mbyllur kishat dhe kanë persekutuar fetarët e pafajshëm”./I Gjykuari, edhe gjatë gjykimit në sallën e gjyqit, është shprehur me urrejtje të madhe kundër Partisë e Pushtetit. Ai, gjatë qëndrimit në dhomat e izolimit, ka shkruar fjalë armiqësore për minimin e dobësimit të Pushtetit Popullor e fjalët i ka shkruar edhe në muret e burgut./Klerikët armiq, ai është munduar t’i quajë viktimat të ateizmit. “Do të vijë një ditë, ka deklaruar ai, që komunistët do të japin llogari për krimet që kanë kryer në popull, duke e çuar atë në errësirë dhe duke e privuar nga të gjitha të drejtat!”» Për këto arsye, më 4 shtator 1973, Gjykata e Rrethit të Shkodrës, e dënoi «me vdekje – pushkatim, konfiskim të pasurisë së luajtshme e të paluajtshme dhe heqjen e të drjtës së zgjedhjeve për pesë vjet». Më 10 shkurt 1974 e tërhoqën për gjymtyrësh deri sa e shqyen dhe, ashtu të vdekur, në fund e pushkatuan. Trupi i tij u dërgua në morgun e studentëve të Fakultetit të Mjeksisë në Tiranë.

Dr. Pjetër Pepa, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri*, Tiranë, 2007, Vol. II, f. 478-490; Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë, 2009, *Përmbyllje*, f. 478, 480-481.

BELTRAM Helmuth

Nënshtetas gjerman, përkthyes me banim në Shkodër.

Në «Raportin Informativ të agjentëve të Komisionit të Administrimit të Pasurive të kriminelëve të luftës, thuhet se i lartpërmenduri ka qenë bashkëpuntor me okupatorët Fashistë dhe Nazistë në dam të atdheut e t’Ushtrisë N.Çl. të Shqipërisë, bile ka qenë në luftim me ushtritë N.Çl. e ka mbetun i vramë vdekun». Për këto arsye, më 27 korrik 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit të Prefekturës së Shkodër urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 87-bis, 17 shtator 1946, f. 4.

BELULI Haredin

Banues në fshatin Vajzë të Vlorës. U burgos si «kriminel lufte». Më 23 qershor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Kotës vendosi konfiskimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 70, nëntor 1945, f. 7.

BELLO Nevrus

Lindi në fshatin Fushë-Bardhë të Gjirokastrës. Më 16 mars 1945, Gjykata Ushtarake e Korpusit II për krahinën e Gjirokastrës e dënoi me vdekje dhe u ekzekutua. Një vit më vonë, më 8 janar 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës Qendër Gjirokastrë, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 26, 13 prill 1946, f. 5-6.

BELLOSHI Ismail

Lindi më 1932, në Stamboll, Turqi. Më 9 shtator 1966, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 143.

BENA Haxhi

Lindi më 27 tetor të vitit 1938, në Filat të Çamërisë. Më 7 korrik 1962, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1973 dhe më 30 qershor të po atij viti, Gjykata e Mirditës e dënoi me 18 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «sabotim» dhe «agjitacion e propagandë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 155.

BENESHI Sadik

Lindi në Kavajë. Më 14 maj të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Durrësit urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 54, 20 qeshor 1946, fq. 5.

BENGAZI Isa

Lindi në fshatin Starovë të Pogradecit. U dënua si «kriminel luftime dhe armik i popullit». Më 14 janar të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Rrethit të Pogradecit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 102, 9 dhjetor 1948, fq. 7.

BENUSI Baltazar

Jurist, një nga hartuesit e legjislacionit shqiptar të periudhës së Monarkisë, avokat.

Lindi më 6 janar të vitit 1897, në qytetin e Shkodrës. Filloi mësimet në Kolegjin Saverian të qytetit, por i ndërpreu ato për t'i vazhduar katër vitet e fundit në Kolegjin Jezuit të Peshtit në Hungari. Pas mbarimit të shkollës, më 1916 u kthye në vendlindje. Më 1920 iu aprovua e drejta për të ndjekur studimet në degën e Jurisprudencës pranë Universitetit të Romës në Itali. U diplomua në vitin 1924. Më vonë mbrojti dhe gradën shkencore Doktor në Jurisprudencë. Është një nga hartuesit e Legjislacionit modern shqiptar të periudhës së Monarkisë shqiptare. Pas mbarimit të Luftës punoi si avokat. Në vitin 1947 u arrestua në qytetin e Beratit, i akuzuar për agjitacion e propagandë dhe si pjesëmarrës në organizatën «Bashkimi Demokrat». Më 30 mars 1948, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor se ka «marrë pjesë në mbledhje të ndryshme, dhe ka hapur parulla me qëllim që të ulin prestigjin e Shtetit dhe të ngjallin pabesim ndaj masës së popullit» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, humbjen e të drejtave civile e politike për 5 vjet kohë, si dhe me konfiskimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. Por një muaj më vonë, më 21 prill të po atij viti, Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake ia ktheu dënimin në 5 vjet privim lirie dhe konfiskim të gjysmës së pasurisë. Kështu, më 20 gusht të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Tiranës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij. Si pasojë e këtij vendimi iu sekuestruan tre vila luksoze në Tira-



Baltazar Benusi

në, kurse familja e tij u nxorr me përdhunë nga shtëpia vetëm me petkat e trupit dhe u dëbua nga Tirana për në Shkodër. Dënimin e plotë e vuajti në burgun e Burrelit. Pas lirimt, më 1956 u internua për katër vjet në Kuç të Kurveleshit. Dymbëdhjetë vitet e fundit, për të siguruar bukën e gojës, u lejua të shiste cigare në një kinkaleri të qytetit të Shkodrës. Vdiq në vitin 1982 në Shkodër. Një nga tre veprat kryesore që la në fushën e Drejtësisë është shtjellimi i Kodit Civil «Sendet, zotnimi dhe modifikimet e tij», i cili u ribotua në vitin 1995.

Republika Popullore e Shqipërisë, Gjykata e Lartë Ushtarake, Nr. 127 i Regj. Them.; *Gazeta Shqiptare*, 7-8 shtator 2002; *Gazeta Zyrtare*, nr. 89, 15 shtator 1948, fq. 6.

BENUSI Zef

Gjyqtar, prokuror, Ministër i Arsimit dhe i Kulturës (korrik-shtator 1943).

Lindi më 2 shkurt të vitit 1898, në Shkodër. Studimet e mesme i kreu në Kolegjin Saverian të qytetit, kurse të lartat në Universitetin e Romës, në Fakultetin e Jurisprudencës. Pas diplomimit, më 1932 u kthye në Shqipëri dhe Ministria e Drejtësisë e emëroi anëtar të Gjykatës së Shkallës së Parë në qytetin e Korçës. Pasi disa vitesh u transferua në qytetet e Tiranës dhe të

Shkodrës. Në korrik të vitit 1943 u emërua Ministër i Arsimit dhe i Kulturës. Dha dorëheqje dy muaj më vonë; paskëtaj, deri në mbarim të luftës, u mor me avokati. U arrestua në fillim të vitit 1945, me akuzën: «ka marrë pjesë në qeverin Kuislinge të Eqrem Libohovës në Dikasterin e Arësimit, tue u cilësue kështu si armik i popullit. Ka qenë edhe në Kom. e internimeve». Në Gjyqin Special, të zhvilluar në muajt mars-prill të vitit 1945, meqenëse nuk ishte implikuar me asnjë lloj veprimtarie të cilësuar nga komunistët si armiqësore, u dënua vetëm me pesë vjet burg. Pas dënimit, iu sekuestrua pasuria që kishte në Tiranë (tokë dhe shtëpi). Të mbetur në mes të katër rrugëve, e shoqja me të birin, Antonin, u shtrënguan të strehoheshin tek të afërmit e tyre në Shkodër. Bëri vetëm dy vjet burg dhe kur doli në vitin 1947 punoi si punëtor krahu. Më vonë u internua edhe katër vjet të tjera (1954-1958) në Shtyllas të Fierit dhe në Kuç të Kurveleshit. Pasi mbaroi të gjithë internimin, u kthye në qytetin e Shkodrës dhe aty nga viti 1962, kur regjimi komunist bëri disa lëshime të vogla ndaj atyre që i konsideronte armiq të klasës dhe reaksionarë, u lejua të ushtronte për tri-katër vjet profesionin e avokatit në Lezhë. Vdiq në moshën 65-vjeçare.

Vepra: «E drejta zakonore shqiptare».

Gazeta Shqiptare, 7-8 shtator 2002.

BEQA Niko

Tregtar nga Tirana. U arrestua në fillim të vitit 1946 si anëtar i Grupit të Rezistencës. U dënua me 10 vjet heqje lirie.

BEQARI Alfons

Lindi më 3 korrik të vitit 1929, në Berat. Më 9 shtator 1950, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe «agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 44.

BEQARI Ilir

Lindi më 3 prill të vitit 1969, në fshatin Bejar të Mallakastrës. Më 9 dhjetor 1988, Gjykata e Fierit e deklaroi fajtor për «krimet: agjitacion e propagandë kunër pushtetit popullor dhe tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 190.

BEQIRAJ Hysen

Lindi më 5 prill të vitit 1944, në fshatin Osmane të Kukësit. Më 14 mars 1977, Gjykata e Kukësit e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes» dhe e dënoi me 17 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 200.

BEQIRAJ Reshit

Lindi në fshatin Çorrush të Mallakastrës. U burgos si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 18 shtator të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Mallakastrës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 96, 31 tetor 1947, fq. 6.

BEQIRAJ Shefqet

Lindi në Fier. U dënua me vdekje si «kriminel lufte». Më 14 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Fierit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 51, 12 qeshor 1946, fq. 4.

BEQIRI Arben

Lindi më 19 mars të vitit 1968, në Elbasan. Më 26 tetor 1988, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie dhe me humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 203.

BEQIRI Arsim

Lindi më 1965, në Kukës. Më 15 gusht

1985, Gjykata e Kukësit e dënoi me 11 vjet heqje lirie për «tentativë arratisjeje jashtë shtetit». U arrestua sërish më 1990, dhe më 14 shkurt te po atij viti, Gjykata e Kukësit e deklaroi fajtor «për fyerje të përfaqësuesve të partisë» dhe e dënoi me 3 muaj burg.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 111.

BEQIRI Bexhet

Lindi në fshatin Kallarar të Kurveleshit. U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 8 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Kurveleshit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij, të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 40, 5 maj 1947, f. 4.

BEQIRI Demir

Lindi në fshatin Trestenik të Devollit. Më 5 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv të Nënprefekturës së Devollit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. Gjashtë muaj më vonë, më 19 nëntor 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Devollit, përsëri edhe një herë urdhërin, po kësaj here për sekuestrimin e pasurisë së tij të tundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 35, 9 maj 1946, f. 5; *Gazeta Zyrtare*, nr. 117, 27 dhjetor 1946, f. 4.

BEQIRI Esat

Lindi në fshatin Fravesh të Malësisë së Tiranës. U deklarua «kriminel lufte». Për Këtë arsye, më 16 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Malësisë (Qafmollë) vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 48, 26 maj 1947, f. 4.

BEQIRI (ABDIJA) Isa

Lindi më 12 prill të vitit 1929, në Shkodër. Më 29 korrik 1949, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për pjesëmarrje në «organizatë kundërshtarë me bashkëveprim» dhe për «tentativë arratisje

me bashkëveprim» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie e punë të detyruar, dhe me privimin nga të drejtat civile për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 466.

BEQIRI Kujtim

Inxhinier.

Lindi në fshatin Velçë të Vlorës, më 23 shkurt të vitit 1916, në familjen e patriotit të shquar Ali Beqiri. Filloren e mbaroi në vendlindje, kurse të mesmen në Teknikën e Tiranës (1927-1932). Pas mbylljes së shkollave të huaja në Shqipëri (1932), studimet e mesme i vazhdoi në Vjenë. Në vitet 1936-1940 është student në Universitetin Teknik të Vjenës, të cilin e mbaron me Yll të Artë: studimet që zgjasnin 5 vjet, ai i kreu me rezultate të shkëlqyera për 4 vjet. Iu bë ftesë të qëndronte si asistent pedagog në Universitet, apo të punonte në një firmë austriake me seli në Venecie, por ai i refuzoi të dyja ofertat dhe në verë të vitit 1940 u kthye në atdhe. U emërua kryetar i Zyrës së Punëve Botore në Vlorë e, më vonë, në Prizren. Gjatë gjithë periudhës së luftës ndërtoi dhe meremetoi, për aq sa i lejonin rrethanat, rrugë, ura e ndërtesa të tjera publike. Mori pjesë në organizatën e «Ballit Kombëtar», duke shpresuar se idealet e tyre properëndimore do të fitonin, por doli i zhgënjyer nga lufta. E, megjithatë, nuk pranoi të largohej nga Shqipëria, edhe pse iu bë i qartë rreziku që i kanosej atij dhe familjes së tij. Pas luftës u emërua kryeinxhinier në ndërtimin e Urës së Rrogozhinës. Është autor dhe bashkëautor i ndërtimit dhe i meremetimit të të gjithë veprave të mëdha mes viteve 1944 e 1946. Në korrik 1946 u emërua drejtor i Kantierit të tharjes së Kënetës së Maliqit. Projektit të inxhinierit italian Omodeo, inxhinierit hidrologjik më të madh të shekullit XX, i bëri modifikimet e nevojshme dhe mbi bazën e këtij projekti kënetë u tha, pa çka se ideatori i projektit u quajt sabotator e armik dhe e pagoi me jetën e tij. Më 22 nëntor 1946 u dënua me varje në litar, dhe kur litari u këput, prokurori Nevzat Haznedari nxitoi dhe e vari sërish.

H. Gonxhja, I. Gogaj, Sh. Bumçi, *Ndihmesa e ish nxënësve dhe mësuesve të Shkollës Teknike të Tiranës për zhvillimin e vendit dhe luftën për çlirim e demokraci*, Tiranë, 2006, VII, f. 240-243.

BEQIRI Lulëzim

Lindi më 7 prill të vitit 1949, në Tiranë. Më 29 gusht 1977, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitationit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie.

AISKK, F.1, V. 2012, D. 1, Fl. 207.

BEQIRI Myrteza

Lindi më 6 shkurt të vitit 1963, në Elbasan. Më 4 prill 1981, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor «për veprën penale të tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes mbetur në përgatitje» dhe e dënoi me 12 vjet e 6 muaj heqje lirie, 5 vjet internim dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. U arrestua sërish më 1989, dhe më 9 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor «për krimin e arratisjes jashtë shtetit mbetur në fazën e përgatitjes» dhe e dënoi me 18 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 332.

BEQIRI Nevruz

Lindi në Libohovë. Më 10 dhjetor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Libohovës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 19, 27 shkurt 1947, d. 3.

BEQIRI Reshat

Lindi në vitin 1918, në Mallakstër. U diplomua në Akademinë Ushtarake në Itali. U arrestua më 1946 dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie për veprimtari antikomuniste gjatë luftës. U lirua në vitin 1959.

BEQIRI Reshit

Mori pjesë në kryengritjen e Postribës. U arrestua po atë ditë, pas shtypjes së kry-

engritjes, dhe të nesërmen, më 10 shtator të vitit 1946, u pushkatua në fushë të Shtojit, bashkë me njëmbëdhjetë kryengritës të tjerë.

Uran Butka, *Kryengritja e Postribës*, në «Almanak 1», botim i ISKK, Tiranë, 2011, f. 69; *Gazeta «Shekulli»*, qershor 2007.

BEQIRI Rustem

Lindi më 16 shtator të vitit 1938, në qytetin e Preshevës, në Kosovën Lindore. Më 11 nëntor 1986, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 409.

BEQIRI Sadik

Burgu i Tiranës.

BEQIRI Tefik

Lindi në fshatin Starovë të Pogradecit. Më 27 korrik të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i N.Ç. të Nënprefekturës së Pogradecit vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 50, 4 qeshor 1946, fq. 6.

BEQIRI Ymer

Një ndër prijësit e kryengritjes së Postribës. Pas shtypjes së saj, u arrestua në Kodër Boks dhe 9 shtator 1946 u pushkatua në sy të të birit dhe të bashkëfshatarëve, në sheshin përpara xhamisë së fshatit.

Uran Butka, *Kryengritja e Postribës*, në «Almanak 1», botim i ISKK, Tiranë, 2011, f. 69; *Gazeta «Shekulli»*, qershor 2007.

BEQIRI Zihni

Lindi në fshatin Ecmenik të Devollit. Më 10 shtator të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Devollit urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 117, 27 dhjetor 1946, f. 5.

BEQO Ahmet

Lindi në vitin 1923, në fshatin Nivicë



Beatrice Berati

të Kurveleshit. Më 10 nëntor të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Kurveleshit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij. Më 21 mars 1967, Gjykata e Qarkut të Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie. Por më 19 mars të vitit 1968, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë i uli dënimin në 6 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1982, dhe më 16 mars të po atij viti, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Fierit e dënoi me 10 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandës kundër shtetit».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 354; *Gazeta Zyrtare*, nr. 12, 20 janar 1948, f. 4.

BEQO (SULAJ) Lavdosh

Lindi më 31 tetor të vitit 1932, në Vlorë. U arrestua më 1950 për «tentativë arratisjeje» dhe u dënua me 15 vjet burg. U lirua më 1962. U burgos sërish në vitin 1981 dhe u lirua më 1988.

BEQO Refik

U arratis në Francë, por më vonë u kthye vullnetarisht. Për këtë arsye, u dënua me dymbëdhjetë vjet heqje lirie si agjent francez. U lirua në krye të dymbëdhjetë viteve, por pas pak kohësh, meqë me sa

duket ia kishin frikën se mos arratisesh, e arrestuan sërish. Një largim pa leje nga internimi ia kishin konsidruar tentativë arratisjeje dhe e dënuan njëzet vjet të tjera. Disa ditë pas shfaqjes në kampin e Spaçit të dokumentarit të punimeve të Kongresit VII të PPSH-së, ai u dëshpërua aq shumë, sa u hodh në telat e rrethimit dhe u vra nga ushtari i rojës.

Fatos Lubonja, *Ridënimi*, Tiranë, 2007, III, XXX, f. 208-209.


BERATI Beatrice

Lindi në Tiranë, në vitin 1943. U arrestua në vitin 1980 dhe u dënua me 4 vjet burg për «agjitacion e propagandë». U lirua më 1982.

BERBERI Abdulla

Inxhinier ndërtimi.

Lindi më 9 mars të vitit 1924, në Kallanë e Krujës. Kur filloi lufta, ai vazhdonte shkollën e mesme në Institutin «Leonardo da Vinci» në Romë. Më 1942, si shumë studentë të tjerë, u kthye në Shqipëri. Bashkë me Parid Deranin [*shih*], Petrit Berishën [*shih*] e Akil Bashën [*shih*] kishin hedhur traktet e hartuar prej krerëve të organizatës «Bashkimi Demokrat», ku bëhej thirrje për bojkotimin e zgjedhjeve të 2 dhjetorit



Abdulla Berberi

1945. U arrestua në shkurt të vitit 1946 dhe më 24 korrik të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale si «anëtar të Legalitetit dhe për propagandë kundër lëvizjes NAÇL» dhe si «sabotator të pushtetit». U lirua në vitin 1955, dhe dy vjet më vonë arriti të marrë maturën. Mbaroi Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit, por më 1967, si i «prekur» që ishte, iu lejua të punonte vetëm si murator në Ndërmarrjen e Ndërtimit. Në vitet '70-'80 vazhdoi punën si teknik në zbatim.

Vepra: «Tregime, kujtime, mendime, vjersha, përkthime e parodi» («*Alte-Mon-tecchio Maggiore*», 1993).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 148.

BERBERI Angela (Angjelina)

Lindi më 7 nëntor të vitit 1937, në Brasov të Rumanisë. Më 20 dhjetor 1976, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Pogradecit e deklaroi fajtorë për «krimin e agjitacionit dhe propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 43.

BERBERI Daver

Lindi më 3 mars të vitit 1914, në Gjirokastrë. U dënua si «sabotator». Më 9 qershor 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Qendrës Gjirokastrë vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij, të luajshme e të paluajshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 57 bis., 21 qershor 1947, f. 3.

BERBERI Vasfi

Lindi më 13 shtator të vitit 1930, në Pogradec. Më 20 shtator 1957, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje jashtë shtetit» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë, humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë dhe heqjen e dekoratave të çlirimit, të trimërisë dhe dy dekoratave të punës. Më 27 nëntor 1957, Presidiumi

i Kuvendit Popullor i fali ¼ e dënimit të mbetur.

AISKK, F.1, V.2012, D.1, Fl. 100.

BERHAMI Ali

Lindi në Shijak. U shpall «armik i popullit». Për këtë arsye më 14 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Shijakut vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajshme e të paluajshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 43, 10 maj 1947, f. 6.

BERISHA Alfred

Lindi më 25 shtator të vitit 1957, në Tiranë. Më 11 tetor 1988, Gjykata e Tiranës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë» dhe «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 289.

BERISHA S.J. At Florian

Klerik katolik, një prej firmëtarëve të Statutit të Kishës Katolike të Shqipërisë (1951).

Lindi më 6 prill të vitit 1897, në Janjevë të Kosovës. Studimet e mesme i kreu në



At Florian Berisha S. J.

Seminarin Jezuit të Shkodrës. Më 13 janar 1917 u pranua në Shoqërinë e Jezuit në Cividale të Friulit. Atje përfundoi dy vite të shkollës dhe, më 1919, kaloi në Fakultetin Filozofik të Padovës. Pas një viti, për arësye shëndetësore, u kthet në Shkodër, ku iu ngarkuan përgjegjësi të vogla në mësimdhënie dhe asistencë. Në vitin 1923 kreu filozofinë në Romë. Një vit më vonë përfundoi vitin e katërt të magjisterit në Shkodër dhe rifilloi teologjinë në Chieri të Torinos. U kthye në Shqipëri dhe më 1929 u shugurua meshtar nga Delegati Apostolik, Imzot Giovanbattista della Pietra. Në vitin 1930 shkoi në Shtëpinë e Jezuit në Romë për të kryer «vitin e provës së tretë». Pas kthimit në Shkodër, më 2 shkurt 1932, bëri kushtet e fundit në Shoqërinë «Jezus». U arrestua në vitin 1947. U mbajt 13 muaj në qelitë e Sigurimit, duke provuar mbi vete tortura nga më çnjerëzoret, derisa gati u çmend. U arrestua sërish më 1958, por nuk u mbajt shumë, nga frika se mos u mbetej në dorë. Vitet e fundit shërbeu si famullitar ndihmës me Dom Ernest Çobën [shih] në Katedralen e Shkodrës. Vdiq më 17 tetor të vitit 1970.

Dr. Pjetër Pepa, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri*, Tiranë, 2007, Vol. II, f. 311-316.

BERISHA Gani

Lindi më 5 shkurt të vitit 1943 në Elbasan. Më 21 tetor 1980, Gjykata e Elbasanit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 136.

BERISHA Hil

I biri i Rrok Berishës, mësues.

Lindi më 9 qeshor të vitit 1901, në Shkup. Më 1926 kreu Shkollën Teknikë të Tiranës dhe u emërua mësues në po këtë shkollë, ku shërbeu pa ndërprerje deri në vitin 1943. Pas lufte, u prangos si agjent i Fultzit. U torturua mizorisht në qelitë e

Sigurimit për afër një vit. Pas shtatë vitesh burgu dhe pune të rëndë, më 1954 u lirua. Vdiq dhjetë ditë më vonë.

H. Gonxhja, I. Gogaj, Sh. Bumçi, *Ndihmesa e ish nxënësve dhe mësuesve të Shkollës Teknikë të Tiranës për zhvillimin e vendit dhe luftën për çlirim e demokraci*, Tiranë, 2006, VII. 2, f. 252.

BERISHA Kolë

U pushkatua në breg të lumit, në Tiranë, më 1947, bashkë me Hasan Reçin [shih], Uan Filipin [shih], Spiro Ruçon [shih], Sinan Gjonin [shih] dhe Islam Radovickën [shih].

Petro Marko, *Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)*, Tiranë, 2000, II, f. 484.

BERISHA Mark

Lindi në Shkodër. Më 20 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nën-prefekturës së Tiranës, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 21, 29 mars 1946, f. 6.

BERISHA (DYZI) Nazmi

Lindi më 20 dhjetor të vitit 1938, në fshatin Dyz të Llapit, Komuna e Podujevës. Më 1960 u arratis në Shqipëri nga ana e Ulqinit. Iu dorëzua ushtarëve të kufirit, të cilët e dërguan në Degën e Shkodrës e, pas dy ditësh biruce, në Shtëpinë e Pritjes në Shijak. Dy muaj më vonë, u transferua në Kampin e Çermës në Lushnjë. Më 1961 përfundoi në Shtëpinë e Pritjes në Sarisalltek të Krujës. Aty e akuzuan si agjent të UDB-së, që kishte kapërcyer kufirin për t'u lidhur me «Grupin e Teme Sejkos», me monarkofashistët grekë dhe me revizionistët jugosllavë, e të gjithë bashkë me Flotën e Gjashtë Amerikane në Mesdhe. Pas një muaji hetuesie u transferua në Burgun e Vjetër të Tiranës. Në gjyqin që u zhvillua pas pak kohësh u akuzua «si tradhëtar i popullit, për veprën penale të spiunazhit në dobi të Jugosllavisë dhe në dëm të Shqipërisë» dhe u dënua me 12 vjet heqje lirie. Pas kryerjes së dënimit u lirua. U internua sërish në kampin e Çermës. Që

këtu i shkroi Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ambasadës jugosllave në Tiranë për t'iu lejuar kthimi në Jugosllavi. Por meqenë se përgjigjja po vononte, vendosi të arratiset. Pas shtatë ditësh arratie, më 3 qershor 1975, u arrestua në afërsi të urës së Bunës në Shkodër. Më 16 korrik të po atij viti u dënua me 5 vjet burg. Pas liritimit më 3 qershor të vitit 1980, kërkoi të kthehet në Jugosllavi, dhe në fund të shtatorit të po atij viti, Ministria e Punëve të Brendshme ia aprovoi kërkesën. Dhe kështu më 9 tetor 1980 u kthye në Kosovë. Më 1987 kërkoi strehim politik në Norvegji, ku jeton edhe sot. Është autor i librit «20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980», (*kujttime, Berat, 1995*).

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980, Berat, 1995; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 280.*

BERISHA Petrit

Veprimtar politik.

Lindi në Tiranë, në vitin 1930. U arrestua në vitin 1946 si anëtar i organizatës «Bashkimi Demokrat», të kryesuar nga Sami Qeribashi [*shih*]. Bashkë me Abdulla Berberin [*shih*], Parid Deranin [*shih*] dhe Akil Bashën [*shih*] kishin hedhur traktet e hartuar prej krerëve të kësaj organizate, ku bëhej thirrje për bojkotimin e zgjedhjeve të 2 dhjetorit 1945. U dënua me 10 vjet heqje lirie. Ishte më i riu në burgun e Tiranës. U lirua në vitin 1951. U arrestua sërish më 1955 dhe u lirua më 1968.

BERISHA Rustem

Lindi më 30 mars të vitit 1939, në Mamurras. Më 11 qershor 1958, Gjykata e Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe me humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë. Vendimi u la në fuqi edhe nga Kolegji Usharak i Gjykatës së Lartë, më 11 korrik 1958. U lirua më 29 qershor 1963.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 348.

BERISHA Ymer

Lindi në Pejë, në vitin 1912. U pushkatua në Tiranë më 4 nëntor 1946.

BESIMI Ali

Lindi në fshatin Bozhigrad të Korçës. U deklarua «kriminel luftime dhe armik i popullit». Më 10 qershor të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Devollit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 62, 8 korrik 1947, fq. 2.

BESHAJ Remo (Remzi)

Lindi më 27 shkurt të vitit 1947, në Vlorë. Më 20 nëntor 1973, Gjykata e Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 196.

BESHIRI Kame

Lindi në Zvërnaskë. U burgos për arsye politike. Më 27 korrik të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit të N.Ç. të Nënprefekturës së Pogradecit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 52, 15 qershor 1946, fq. 3.

BESHIRI Mehmet

Nacionalist i njohur, anëtar i organizatës antikomuniste «Bashkimi Demokrat Shqiptar».

Lindi në Tiranë, më 1911. Kreu shkollën tregtare në Austri. Mori pjesë aktive në organizatën Bashkimi Demokrat. U dënua me vdekje, pushkatim. U ekzekutua më 3 korrik të vitit 1946, bashkë me Xhahit Kokën [*shih*], Qenan Dibrën [*shih*], Telat Drinin [*shih*], Mahmut Menikun [*shih*], Sami Qeribashin [*shih*], Shaban Ballën [*shih*] dhe Ali Kavajën [*shih*]. Më 11 nëntor të po atij viti, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Tiranës, urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme.

Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë, 2009, I, V, f. 101; *Gazeta Zyrtare*, nr. 7, 31 kallnor 1947, f. 3.

BESHIRI Tahir

Tregëtar i madh, pronar i fabrikës së makaronave «Gjeli», një nga firmëtarët e Statutit të Komunitetit Musliman Shqiptar të vitit 1945, si delegat i Durrësit. U dënua nga Gjykata Ushtarake. Për këtë arsye, më 16 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Durrësit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 41, 7 maj 1947, f. 1.

BESHIRI Xhevahir

Lindi në Berat. U deklarua «kriminel luftime dhe armik i popullit». Për këtë arsye, më 3 janar të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të qytetit të Beratit vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 18, 4 shkurt 1948, f. 1.

BEU Arif

Lindi më 23 mars të vitit 1957, në fshatin Bago të Kavajës. Më 13 gusht 1975, Gjykata e Rrethit të Kavajës e deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 42.

BEU Hysni

Lindi në fshatin Luar të Beratit. U dënua si «kriminel luftime» nga Gjykata Ushtarake e Fierit. Në bazë të vendimit të kësaj gjykate, më 28 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor N.Çl. të Nënprefekturës së Qendrës Berat vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 28, 29 mars 1947, f. 3.

BEZHANI Papa Jorgji Kosta

Klerik ortodoks.

Lindi më 10 korrik të vitit 1897, në fshatin Bezhan të Kolonjës. Mësimet fillore i mori në vendlindje. Që në moshë të re shërbeu si psallt në kishën e fshatit. Në vitet 1933-1934 kreu Seminarin njëvjeçar

të Tiranës, që qe hapur për përgatitjen e klerikëve. Fillimisht u emërua prift në fshatrat Çarshovë e Radovë e më vonë edhe në Bezhan, Shtikë, Skorovot, Kreshovë etj. Në prag të Luftës Italo-Greke u internua në Itali, fillimisht në Bari dhe më pas në Ankona. U lirua pas përfundimit të luftës. Pas kthimit në Shqipëri, shërbeu në fshatin Drenovë të Korçës (1941-1942). Më 6 janar të vitit 1946, ditën e Ujit të Bekuar, u arrestua në mes të meshës dhe u dënua nga Gjykata Ushtarake si «armik i popullit dhe i pushtetit popullor» dhe si «bashkëpunëtor i ngushtë me reaksionin e jashtëm e të brendshëm». Dënimin e kreu në kampin e Vloçishtit. Mbas lirimit, reforma agrare i sekuestroi gjysmën e tokës bujqësore, rreth 1000 krerë bagëti të imta, dy kafshë pune, dy mullinj bloje dhe, për pasojë, në vitin 1950 u shpall «kulak». Në këto rrethana u shtrëngua të largohet bashkë me familjen në Korçë. U emërua famullitar i fshatrave Drenovë dhe Mborje, ku shërbeu deri më 1954. Që nga kjo kohë e deri në vitin 1967 shërbeu pranë Mitropolisë së Shenjtë të Korçës. Vdiq më 17 gusht të vitit 1983.

Atë Vasil Kordileva, *Papa Jorgji Kosta Bezhani*, në gazetën «Ngjallja», nr. 12 (179), Tiranë, dhjetor 2007, f. 9-10.

BËRXOLLI Dalip

Lindi në fshatin Koxhasë të Shijakut. U deklarua «armik i popullit». Më 31 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Shijakut, vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 28, 29 mars 1947, f. 5.

BIANKU Tonin

Anëtar i organizatës antikomuniste «Bashkimi Shqiptar». U arrestua mbrëmjen e 27 nëntorit të vitit 1945 bashkë me Çesk Gjelucin [shih] dhe Lazër Kodhelin [shih].

Bashkimi Shqiptar!, në «Nji Seminar Papnor në vorbull të përndjekjes komuniste: Shkodër 1945-1946», Shkodër, 2008, f. 100-101.

BIBA Bibë

Lindi në Rrëshen të Mirditës. U deklarua «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 20 shtator të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Mirditës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 105, 18 dhjetor 1947, fq. 7.

BIBA Dodë

Lindi në fshatin Kthellë Epër të Mirditës. U var në litar më 17 gusht të vitit 1949, si i dyshuar për vrasjen e sekretarit politik të Komitetit të Partisë për rrethin e Mirditës dhe deputetit të Kuvendit Popullor, Bardhok Bibës.

BIBA Imedi

Mësues.

Lindi më 11 nëntor të vitit 1938, në qytetin e Ohrit në Maqedoni. Më 26 dhjetor 1962, Gjykata e Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 4 vjet e 6 muaj heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 147.

BIBA Llesh

Lindi në fshatin Rras i Butë të Mirditës. U deklarua «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 20 shtator të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Mirditës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 106, 19 dhjetor 1947, fq. 3.

BIBA Vladimir

Lindi më 16 maj të vitit 1951, në Elbasan. Më 3 tetor 1986, Gjykata e Elbasanit e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 296.

BIBERAJ Niman

Lindi në vitin 1918, në fshatin Shoshan të Tropojës. U arrestua në vitin 1946 dhe u dënua me 10 vjet heqje lirie për veprimtari

anti-komuniste. Fill pas liritimit më 1956, u arratis jashtë shtetit.

BIBI Lluka

Jurist.

Lindi në Përmet. U arrestua në fillim të vitit 1946 si anëtar i Grupit të Rezitencës. U dënua me burgim të përjetshëm. Më 20 shkurt 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Korçë urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij të luajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 73, 6 gusht mars 1946, f. 3.

BICAJ Dom Mark

Klerik katolik.

Lindi në vitin 1911, në Kashnjet të Mirditës. Kreu studimet e mesme në Seminarin Papnor në Shkodër dhe studimet e larta për teologji në Padova të Italisë. Pas kthimit në Shqipëri, më 1939, u zgjodh kapelan i Abacisë së Shën Aleksandrit në Orosh. U shugurua meshtar në vitin 1936. U arrestua më 10 tetor të vitit 1946, në moshën 35-vjeçare, në Kaçinar të Spaçit, dhe u akuzua se «gjatë okupacionit fashist ka qenë në shërbim të SIM-it... Ka shkue shpeshherë në Tiranë, tek Jakomoni dhe për shërbimet që i ka krye Fashizmit, është shpërblyer edhe me shuma të majme. Ka propaganduar e predikuar në popull kundër Lëvizjes N-Çl. (...) Ka propaganduar në popull që të mos shkojnë ushtarë... Përveç këtyre, i pandehuri ka pasë lidhje edhe me organizatën Fashiste Terroriste «Bashkimi Shqiptar». I pandehuri ka pasë lidhje edhe me reaksionarët legalë. I pandehuri ka marrë pjesë edhe në përpjekjet me armë kundra forcave tona që operonin n'atë zonë...». Për të gjitha këto akuza, prokurori i Gjykatës Ushtarake të Shkodrës, kapiten Aranit Çela, kërkoi dënimin e tij me pesëmbëdhjetë vjet heqje lirie, dënim që u zbrit në pesë vjet punë të rëndë, si dhe me humbjen e të drejtave qytetare e politike për aq vjet sa do të zgjaste dënimi. Por, në fund të hetimit, Dom Mark Bicaj vdiq prej torturave në burgun e Shkodrës.

Dr. Pjetër Pepa, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri*, Tiranë, 2007, vol. I, II, f. 620-622.

BICAJ Nazmi

Lindi më 11 prill të vitit 1928, në Peqin. Më 15 prill 1949, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje dhe agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me burgim të përjetshëm. Vendimi mori formë të prerë më 11 maj të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 344.

BICI Bardha

E bija e bajraktarit Gjon Marka Gjoni.

Lindi më 11 mars të vitit 1925, në Rrëshen të Mirditës. U arrestua më 1945 dhe u dënua me dhjet vjet heqje lirie si «armike e popullit». U lirua më 1951 dhe u internua familjarisht deri në vitin 1990.

Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, Tiranë, 2007, XXIII, Dh, f. 306.

BICI Gjergj Vatë

Lindi në vitin 1920, në fshatin Gurzi të Milotit. U arrestua mbrëmjen e 11 dhjetorit 1945 si anëtar i organizatës antikomuniste «Bashkimi Shqiptar», gjyqi kundër anëtarëve të së cilës filloi më 28 janar të vitit 1946. Më 2 shkurt të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Qarkut të Shkodrës e dënoi me vdekje. Katër ditë më vonë, më 26 shkurt, dënimi iu kthye në burgim të përjetshëm. U arrestua sërish më 1975, dhe më 13 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Krujës e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë për «agjitacion e propagandë».

Gjak në Shqipëri dhe në Kuqe, në «Nji Seminar Papnor në vorbull të përndjekjes komuniste: Shkodër 1945-1946», Shkodër, 2008, f. 148, shënimi 8; Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë, 2009, I, VI, f. 62-63; Fritz Radovani – de Angelis, *Një monument nën dhé*, Melbourne, 2004, II, f. 75-77; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 182.

BICI Dom Zef

Klerik katolik, vikar kapitullar i Arkidieqzës së Durrësit.

Lindi në Breg të Matës, më 19 maj të

vitit 1919. Shkollën fillore e kreu në fshatin Gurëz (1927-1932). Dy vjet më vonë, më 1934, filloi Seminarin e Papnor të Shkodrës, ku vazhdoi dhe teologjinë. Më 2 shkurt 1946 u shugurua meshtar në Katedralen e Shkodrës, prej Imzot Gaspër Thaçit, dhe të nesërmen tha, po në Katedrale, meshën e tij të parë. Nga 6 nëntori i vitit 1946 e deri në mars 1952, shërbeu si ndihmësfamullitar në Tiranë, së bashku me Dom Mark Dushin [shih]. Gjatë kësaj kohe thujse drejtoi mbledhjet dhe përpjekjet për pranimin e Statutit të ri të Kishës Katolike, sepse sipas marrëveshjes verbale Tuk Jakova-At Marin Sirdani, ai ishte ngarkuara të përfaqësonte mendimin e qeverisë. Në mars 1952 u emërua shef administrate, shef personeli e shef kulture pranë Kryesisë së Kishës Katolike në Shkodër. Më 1955 u shkarkua nga detyrat pranë Kryesisë së Kishës dhe, që nga 1 janari 1956, u la në dispozicion. Shërbeu për pak kohë si ndihmësfamullitar në Shirokë. U vu në dispozicion të ordinarit të Arkidieqzës së Shkodrës, Dom Luigj Gashit, i cili e dërgoi në Zhejë. Me propozim të ordinarit, më 28 prill 1957, u kthye sërish në Tiranë, në vend të Dom Mark Dushit. Më 12 shtator të po atij viti u zgjodh vikar kapitullar i Arkidieqzës së Durrësit. Qëndroi në famullinë e Tiranës deri në nëntor të vitit 1964, kur dhe u arrestua me akuzën se kishte blerë kontrabandë letër nga një hajdut i ndërrmarjes shtetërore «Mihal Duri». Pas tetë muajsh hetuesie u nxorr në gjyq, ku ai paraqiti një kasetë në të cilën kishte regjistruar të gjithë bisedën e kontratës së blerjes së letrës. Për këtë arsye, pas tri ditësh u lirua, jo me pafajësi, por me një vendim gjyqi që e dënonte aq ditë burg sa kishte bërë. Meqë ndërkohë vendi i tij në Tiranë ishte zënë nga Dom Ndoc Sahatçia [shih], iu la vetëm 24 orë kohë që të bartej si famullitar në Mërq të dieqzës së Lezhës, ku qëndroi deri në marsin e vitit 1967. U arrestua sërish më 4 korrik 1967, i akuzuar se kishte mbajtur lidhje «me spiunazhin italian dhe pikërisht me kryeagjentin Bartolini, funksionar i Ambasadës Italiane në Tiranë». Më 25 prill 1968, në gjyqin e

zhvilluar në kishën e Motrave Stigmatine, tashmë të kthyer në klub rinie, u dënua me vdekje, me pushkatim, për «tradhëti të lartë ndaj atdheut» e si «agjent i Vatikanit». Dhe, megjithëse, vuante nga kanceri në gjendrrën e qafës e për këtë arsye ishte operuar dy herë në spitalin e Tiranës, u ekzekutua me 10 maj të vitit 1968. Eshtrat e tij, bashkë me ato të Dom Mark Dushit, u gjetën 25 vjet më vonë, më 12 shtator të vitit 1993, në një fushë të Dobraçit, dhe u varrosën në Kishën e Zembrës së Krishtit në Tiranë. Është dekoruar «Martir i Demokracisë» bashkë me Dom Mark Dushin dhe Dom Shtjefën Kurtin, eshtrat e të cilit nuk janë gjetur ende.

At Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, I, Tiranë, 1995, f. 353; At Zef Pllumi, *Vep. cit.*, II, f. 16, 228-230; At Zef Pllumi, *Vep. cit.*, III, f. 46, 89; Dr. Pjetër Pepa, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri*, Tiranë, 2007, Vol. II, f. 429-431; Markus W. E. Peters, *Përballjet e historisë së Kishës Katolike në Shqipëri 1919-1996*, Shkodër, 2010, 5, f. 280-281.

BICKA Nezir

Më 11 tetor 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit N.Ç. të Nënprefekturës Qendër Korçë urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 62, 12 korrik 1946, fq. 2-3.

BICOLLI Gaqo

Lindi më 13 maj të vitit 1929, në fshatin Terovë të Korçës. Më 7 korrik 1961, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 4 vjet kohë. Me dekret nr. 4323 iu falën 2 vjet nga dënimi.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 41.

BICUKU Ndre

Lindi më 18 qershor të vitit 1956, në fshatin Qelëz të Pukës. Më 7 tetor 1986, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj

atdheut» dhe e dënoi me 11 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 274.

BIÇAKU Bilal

Lindi në fshatin Qarrishtë të Librazhdit. U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 18 maj të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Librazhdit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 56, 20 qershor 1947, f. 6.

BIÇAKU (BIÇAKÇIU) Ibrahim bej

Vepimtar politik, djali i vetëm i Aqif Pashë Elbasanit (Biçakut), deputet, kryetar i Partisë Nacionaliste, Kryeministër i Shqipërisë (5 shtator 1944-25 tetor 1944).

Lindi më 10 shtator të vitit 1905, në Elbasan. Arsimin fillor e kreu në qytetin e lindjes. Mbaroi Akademinë Tregtare në Vjenë për agronomi. Në vitin 1937 u zgjodh deputet i Elbasanit. Me kapitullimin e Italisë bën pjesë në grupin e politikanëve që nisën procesin e pavarësimit të Shqipërisë. Emri i tij është ndër 22 patriotët që nënshkruan deklaratën e 14 shtatorit të vitit 1943, e cila e rishpalli Shqipërinë të pavarur. Në zgjedhjet e 1 tetorit 1943 për Kuvendin Kombëtar, u



Ibrahim bej Biçaku (Biçakçiu)

zgjodh sërish deputet i Elbasanit. Gjatë kësaj kohe, bashkë me Rexhep Mitrovicën, Xhaferr Devën, Lef Nosin [shih] etj., u angazhua fuqishëm për shuarjen e lëvizjes komuniste në Shqipëri. Në shtator të vitit 1944 u zgjodh Kryeministër dhe krijoi kabinetin qeveritar, që u betua më 5 shtator të po atij viti. Qeveria Biçaku dha dorëheqjen më 25 tetor 1944, dy ditë pasi komunistët kishin shpallur qeverinë e tyre në Berat. Pas dorëheqjes, Ibrahim Biçaku, së bashku me një grup patriotësh, u largua nga Tirana dhe vajti në Shkodër, ku ishte planifikuar të organizohej një mbledhje me elementët antikomunistë. Dhe kur miqtë e tij kapërcyen kufinj të Shqipërisë, ai nuk pranoi të largohet. U arrestua në Shkodër më 6 dhjetor të vitit 1944. Më 13 prill 1945, Gjyqi Special e dënoi me burgim të përjetshëm, por më 13 dhjetor 1945 dënimi iu ul në 30 vjet heqje lirie. Më 15 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Tiranës vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme, ndër to edhe fabrikën e tij të cigareve «Flora». Pjesën më të madhe të dënimit e vuajti në burgun e Burrelit. U lirua pas shtatëmbëdhjetë vjetësh, më 5 maj 1962. Vdiq në Elbasan, më 4 janar të vitit 1977.

Hilë Lushaku, *Ministrat e Brendshëm 1912-2007*, vol. 1, Tiranë, 2009, vol. 1, 31, f. 515-527; *Gazeta Zyrtare*, nr. 5, 22 kallnor 1947, f. 7; *Gazeta Zyrtare*, nr. 43, 10 maj 1947, f. 6.

BIÇAKU Kapllan

Lindi më 24 prill të vitit 1899, në fshatin Qarrisht të Librazhdit. U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Për këtë arsye, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Librazhdit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 58, 25 qershor 1947, f. 6.

BIÇAKU Mefail

Lindi më 4 maj të vitit 1898 në Librazhd. U akuzua se kish strehuar diversantë. Gjatë hetuesisë u çmend.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 50.

BIÇAKU Mehdi

Lindi më 10 shtator të vitit 1935, në fshatin Qarrishtë të Librazhdit. Më 1 mars 1977, Gjykata e Rrethit të Librazhdit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 215.

BIÇAKU (Hoxhë Kajo Biçaku) Imam Muhamed

Klerik musliman.

Lindi në vitin 1929, në fshatin Qerret të zonës së Shmilit në Elbasan. Në vitin 1945 filloi Medresenë e qytetit, të cilën e përfundoi gjashtë vjet më vonë. Më 1952 Myftinia e Elbasanit e caktoi mësues të osmanishtes dhe të arabishtes në fshatrat e Librazhdit. Shtatë vjet më vonë u caktua sekretar i Myftinisë së Elbasanit, kurse më 1964 imam i xhamisë së Rrapit të Bezistanit. Me mbylljen e institucioneve fetare më 1967, i dërgoi një letër proteste Hysni Kapos. Për këtë arsye u arrestua dhe u dënua me 20 vjet burg «për agjitacion e propagandë». U lirua më 1974 dhe u shtrëngua të punonte si punëtor krahu. U arrestua për të dytën herë më 1981, me akuzën se kishte marrë pjesë në një synetllëk, dhe u dënua me 4 vjet heqje lirie, të cilat i vuajti në Qafëbar. U arrestua sërish në prag të rënies së komunizmit dhe u dënua me 25 vjet burg, nga të cilat bëri vetëm 3 muaj në kampin e Spaçit. Që pas lirimit shërbeu si imam në xhaminë e Pashës në Elbasan. Vdiq në fund të vitit 1991. Më 1994, Presidenti i Republikës e nderoi me medaljen «Naim Frashëri» i klasit të parë me motivacionin: «Martir e pishtar i demokracisë shqiptare, antikomunist i vendosur, udhëheqës shpirtëror me moral të lartë që gjithë jetën e vet e shkriu në dobi të atdheut, fesë islame, lirive dhe të drejtave të njeriut dhe çështjes kombëtare».

100 personalitete shqiptare të kulturës islame:

shekulli XIX-XX, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë, 2012, f. 139-140.

BIÇAKU Qemal

Lindi në Elbasan. U arrestua në fillim të vitit 1946 si anëtar i Grupit të Rezistencës dhe u dënua me 30 vjet heqje lirie. Më 22 gusht të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Elbasanit, urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. Të njëjtin urdhër e përsëriti më 13 tetor 1947 edhe Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Prefekturës së Tiranës.

Gazeta Zyrtare, nr. 28, 29 mars 1947, f. 7; Gazeta Zyrtare, nr. 102, 9 dhjetor 1947, fq. 5.

BIÇAKU Sabr

Lindi në fshatin Qarrishtë të Librazhdit. U deklarua «armik i popullit». Më 18 qershor 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Librazhdit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij të tundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 69, 30 qershor 1948, fq. 6.

BIÇAKU Xhavit


Lindi më 13 nëntor të vitit 1895 në Elbasan. U deklarua «armik i popullit». Më 17 prill 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të qytetit të Elbasanit vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 54, 8 maj 1948, fq. 6.

BIÇOKU Ibrahim

Lindi më 20 gusht të vitit 1954, në Elbasan. U arrestua më 16 dhjetor 1990. Dy javë më vonë, më 30 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «kundërshtim me dhunë të përfaqësuesve të shtetit» dhe «shkelje të ligjit "Për mbledhjet, grumbullimet dhe manifestimet"» dhe e dënoi me 1 vit e 6 muaj heqje lirie. Por më 8 shkurt 1991, Gjykata e Zonës së Durrësit vendosi për prishjen e këtij vendimi dhe pushimin e çështjes në ngarkim të tij.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 448.



Teki Biçoku

BIÇOKU Teki

Inxhinier gjeofizik, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë (25 shtator 2008-25 shkurt 2009).

Lindi më 6 maj të vitit 1926, në Elbasan. Pesë klasët e fillores (1932-1937) dhe shkollën qytetëse i kreu në Elbasan. Arsimimin e mesëm e vazhdoi në Shkollën Teknike të Korçës (1942-43) dhe atë të Tiranës (që aso kohe quhej Instituti Teknik «Sadik Stavaleci»). Studimet universitare i kreu në Institutin e Naftës «Gubkin» në Moskë në vitet 1948-1953. Sapo u kthye në atdhe, filloi punë si inxhinier gjeofizik në ekspeditën sizmike të Fierit (06. 04. 1953-31. 12. 1954). Më 1 janar 1955 u emërua kryetar i degës gjeologjike në Drejtorinë e Përgjithshme të Gjeologjisë në Tiranë (SHGJSH), kurse më 1 qershor 1957 Zv. kryetar dhe kryegjeolog i Komitetit Shtetëror të Gjeologjisë. Në këtë detyrë qëndroi deri më 1 janar 1960, kur u emërua Kryegjeolog i Drejtorisë së Përgjithshme të Gjeologjisë në Ministrinë e Minerave dhe Gjeologjisë. Nga 1 shtatori 1965 deri në 31 mars 1966 kreu detyrën e Drejtorit të Institutit të Studimeve dhe Projektmeve Gjeologjike e Minerare në Tiranë. Më 1 prill 1966 u emërua sërish Drejtor i Përgjithshëm i Gjeologjisë në Ministrinë e Industrisë dhe Minerave. Nga 1 gushti i vitit 1975 deri më 14 maj 1977 u dërgua si

inxhinier gjeofizik në ekspeditën sizmike të Ndërmarrjes Sizmo-Gravimetrike të Fierit, ku dhe u arrestua për «Sabotim, agjitacion e propagandë» dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie dhe me humbje të së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Me dekret nr. 7263, dt. 12. 12. 1988, iu fal pjesa e mbetur e dënimit. U lirua katër ditë më vonë (16 dhjetor 1988). Më 25 shtator 1991, Pleniumi dhe Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë të Shqipërisë, e shpalli të pafajshëm. Nga 25 shtatori i vitit 2008 deri më 25 shkurt 2009 mbajti postin e Kryetarit të Akademisë së Shkencave të Shqipërisë.

Vepra: «Analiza dhe përgjithësimi i rezultateve të punimeve sizmometrike në Ultësirën pranëadriatike dhe zgjedhja e metodës sizmike më racionale për të» (1964), «Harta gjeologjike e Shqipërisë në shakllë 1:200 000» (*drejtues dhe bashkëautor, 1967*), «Harta e mineraleve të dobishme të Shqipërisë në shakllë 1:200 000» (*drejtues dhe bashkëautor, 1971*), «Gjeologjia e Shqipërisë: Tekst i hartës» (1970), «La Geologie de l'Albanie» (1974), «Geological Mapping of Albania» (*në bashkëpunim me G. Baldassarre e F. Arkaxhiu, Pjesa 1, Universita degli Studi, Bari, 2003 dhe Pjesa 2. Universita degli Studi, Bari, 2004*), «Historiku i kërkimeve dhe studimeve gjeologjike të Shqipërisë» (2004) etj.

H. Gonxhja, I. Gogaj, Sh. Bumçi, *Ndihmesa e ish nxënësve dhe mësuesve të Shkollës Teknike të Tiranës për zhvillimin e vendit dhe luftën për çlirim e demokraci*, Tiranë, 2006, v.1, f. 170-172; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 40.

BIFSHA Dhimitër

Lindi më 17 nëntor të vitit 1941, në fshatin Dhërmi të Vlorës. Më 2 nëntor 1959, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «tentativë të kalimit të kufirit në mënyrë të paligjshme» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë. Por më 30 nëntor 1959 të po atij viti, Gjykata e Lartë vendosi pushimin e çështjes. U arrestua sërish më 11 shtator 1960, dhe më 30 dhjetor të po atij viti, Gjykata Ushtarake e shpalli faj-

tor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 4 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë, më 6 shkurt 1961. U lirua para kohe, më 13 mars 1972.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 393.

BIKU Ukë Mark

Luftëtar antikomunist.

U pushkatua nga Forcat e Ndjekjes në mes të fshatit Brojë të Kelmendit, bashkë me dy vëllezërit e tij, Marash Mark Bikun dhe Ndue Mark Bikun, në shkurt të vitit 1945, pas shtypjes së Kryengritjes së Kelmendit.

Dr. Luigi Martini, *Prek Cali, Kelmendi dhe kelmendasit*, Shkodër, 2005, f. 259; Mërgim Korça, *Histori të pashkruara*, Tiranë, 2005, f. 51.

BILAÇI Nikollë Ndue

Lindi më 1 tetor të vitit 1939, në fshatin Manati të Lezhës. Më 30 dhjetor 1953, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «bashkëpunim me kriminelë për terror» dhe «bashkëpunim me banda duke i strehuar dhe furnizuar» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 38.


BILBIJA (BILBILOVIQ) Vojin (Vojo)

Me origjinë serb nga Sarajeva. Lindi më 4 nëntor të vitit 1912, në Shkodër. Partizan, mjek dhe, në fund, punonjës i Komitetit Qendror. U arrestua si «agent i UDB-së jugosllave» dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie. Familja e tij u internua në rrethin e Fierit.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 72; At Zef Pllumi, *Arno vetëm për me tregue: Robnia e gjatë*, Pjesa e tretë: 1967-1989, Tiranë, 2000, f. 102.

BILI Arsitulla

Lindi në fshatin Sotirë të Gjirokastrës. U deklarua «armik i popullit». Më 15 ko-



Lekë Previzi, Kampi i Tepelenës (skicë)

rrik të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Gjirokastrës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 81, 3 gusht 1948, fq. 2.

BILI Dhimitër

Lindi më 20 korrik të vitit 1937, në fshatin Cerckë të Leskovikut. Më 21 nëntor 1980, Gjykata e Rrethit të Kolonjës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, internim dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 39.

BILI Loni

Lindi në fshatin Seran të Leskovikut. U deklarua «armik i popullit». Më 16 dhjetor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Leskovikut vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 42, 8 maj 1947, f. 7.

BILIBASHI Flamur

Lindi në Libohovë, në vitin 1943. Më 1944 iu pushkatua i ati. U arrestua në vitin 1963 dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie për «tentativë arratisjeje». Në vitin 1967 u torturua egërsisht në kampin e punës së Elbasanit, deri sa përfundoi në psikiatrinë e qytetit.

BILISHTI Evdal (Ebdal)

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1917, në Selanik. U arratis, por u kthye sërish. U arrestua dhe u dënua me 14 vjet heqje lirie. Në burg u sëmur nga sytë dhe kërkoi ndihmë mjeksore. Dhe, meqenëse e lanë në duart e studentëve praktikantë, u verbua fare.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 41.

BILIMANI Raman

Lindi më 28 qershor të vitit 1939, në qytetin e Korçës. Më 29 janar 1979, Gjykata e Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e

agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 243.

BILO (BIKE) Skëndo

Lindi në Mallakastër. U ekzekutua si «kriminel luftime». Më 30 gusht të vitit 1947, Komiteti i Ekzekutiv i Nënprefekturës së Mallakastrës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 96, 31 tetor 1947, fq. 5.

BIMBLI Llambi

Më 9 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit N. Ç. të Nënprefekturës Qendër Korçë vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 42, 22 maj 1946, fq. 1.

BINERI Arben

Lindi më 7 gusht të vitit 1957, në Tiranë. Më 18 prill 1974, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar). Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 9 maj të vitit 1977.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 330.

BINO Agim

Lindi më 15 prill të vitit 1933, në Vlorë. Më 17 maj 1952, Gjykata Ushtarake e Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe «tentativë për arratisje» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 4 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 240.

BINOSHAJ Miruk

Lindi më 19 shtator të vitit 1968, në fshatin Gegaj të Shkodrës. Më 14 prill 1988, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e

dënoi me 10 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 144.

BIRJA Hiqmet

Lindi në Elbasan. U dënua si «kriminel luftime». Për këtë arsye Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Qendrës Elbasan, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 43, 10 maj 1947, f. 6.

BISARI Adem

Lindi në fshatin Marqinet të Tiranës. U deklarua «armik i popullit». Për këtë arsye, më 14 mars të vitit të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Shijakut vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 43, 10 maj 1947, f. 7.

BISHA Shpëtim

Lindi më 7 prill të vitit 1939, në Vlorë. Më 28 shtator 1960, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Më 10 dhjetor 1960, me vendim të Kolegjit Ushtarak të Gjykatës së Lartë dënimi iu kthye në 15 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 34.

BISHQEMI Osman

Gazetar, shkrimtar, autor i disa librave në dorëshkrim.

Lindi më 17 tetor të vitit 1922, në Elbasan. Kreu studimet e larta për filozofi në Romë. Në vitin 1943 u kthye në Tiranë. Më 1945 filloi punë si reporter i «Bashkimit». Po këtë vit i pushkatuan të atin, Tahsin Bishqemin [*shih*]. U arrestua në vitin 1947 dhe u dënua me 5 vjet heqje lirie. U lirua më 1950. U arrestua sërish më 1962. Pas lirimit më 1967, u internua.

Petro Marko, *Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)*, Tiranë, 2000, II, f. 448.

BISHQEMI Robert

Lindi më 26 dhjetor të vitit 1939, në Tiranë. Më 7 gusht 1965, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor «për krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 11 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 15 shtator 1965.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 333.

BISHQEMI Shefqet

Lindi më 21 tetor të vitit 1908, në Elbasan. U dënua si «armik i popullit». Për këtë arsye, më 14 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Qendrës Elbasan vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij të luajtshme. Tre muaj më vonë, më 13 prill 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Elbasan urdhëroi edhe sekuestrimin e pasurisë së tij të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 37, 26 prill 1947, f. 7; *Gazeta Zyrtare*, nr. 54, 20 qeshor 1946, fq. 8.

BISHQEMI Tahsin

Ushtarak i lartë, Zëvendëskomandant i Përgjithshëm i Xhandarmërisë Shqiptare (1943-1944).

Lindi në vitin 1897, në Elbasan. Kreu studimet në Akademinë Ushtarake të Napolit. Në vitin 1920 mori pjesë në luftën kundër serbëve. Shërbeu si qark-komandant në shumë rrethe të Shqipërisë, si Kryetar i Departamentit të Xhandarmërisë dhe, së fundmi, si Zëvendëskomandant i Përgjithshëm i Xhandarmërisë Shqiptare (1943-1944). Më 14 prill 1945 Gjykata e Lartë e dënoi me vdekje, pushkatim. Për këtë arsye, më 27 dhjetor 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tiranës, vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij të luajtshme. Një vit pas ekzekutimit, më 13 prill 1946, u mor edhe një tjetër vendim, kësaj radhe nga Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër të Elbasanit, për

sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 59, 5 korrik 1946, fq. 5; *Gazeta Zyrtare*, nr. 7, 24 kallnor 1946, f. 5.

BITRI Rustem Ali

Lindi në vitin 1882, në fshatin Blliçe të Dibrës. U pushkatua më 16 qershor të vitit 1946 në Fushë Alie.

BITRI Rustem Sinan

Lindi më 7 shkurt të vitit 1964, në fshatin Blliçe të Dibrës. Më 2 prill 1980, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje jashtë shtetit» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 113.

BITRUKU Afrim

Lindi më 7 gusht të vitit 1966, në Kavajë. Më 2 tetor 1986, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 195.

BITURKU Arjan

Lindi më 20 janar të vitit 1964, në Kavajë. Më 2 tetor 1986, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Durrësit e deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje» dhe e dënoi me 13 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 81.

BJANKU Kolë (Kolec)

Lindi më 3 dhjetor të vitit 1934, në Shkodër. Më 6 gusht 1966, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 305.

BLACERI Henrik

Lindi më 14 tetor të vitit 1964, në Tiranë. Më 18 janar 1988, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e

tradhëtisë ndaj atdheut në formën e tentativës për t'u arratisur» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 116.

BLAKÇORI Jonuz

Mësues, përkthyes.

Lindi në Istog të Kosovës. Familja e tij u vendos që herët në Shqipëri. Kreu Shkollën Normale të Elbasanit dhe Akademinë Ushtarake në Romë. Gjatë periudhës së Mbretërisë punoi në administratë në Tiranë. Pas pushtimit italian u emërua mësues në Kuçovë. Me mbarimin e luftës u burgos si bashkëpunëtor i fashizmit. Gjatë tërë jetës u mor me përkthime nga italishtja, por emri i tij s'u bë i njohur kurrë. Më vonë u lejua që t'u jepte mësimë italishteje fëmijëve të udhëheqjes. Një ditë e ndaluan në mes të Tiranës dy të rinj italianë dhe e pyetën se ku ndodhej hotel Dajti. Kaq u desh që Sigurimi t'i vinte prangat, duke e akuzuar për bashkëpunim me të huajt. Me urdhër të Mehmet Shehut u internua në kampin e Çermës në Lushnjë.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 90-91.

BLETA Rexhep

Lindi më 20 nëntor të vitit 1947, në në fshatin Kërçukje të Tiranës. Më 7 prill 1976, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 265.

BLINISHTI Dr. Benedikt

Diplomat.

Lindi në vitin 1895, në Stamboll. U diplomua për jurisprudencë në Turqi; doktoratën e mbrojti në Universitetin e Vjenës. Mes viteve 1920-1936 shërbeu si diplomat i shtetit shqiptar. U arrestua më 1945 dhe u dënua me 7 vjet heqje lirie. Vdiq në vitin 1966.

Enver Memisha, *Masakra komuniste: arrestime,*

burgime, ekzekutime e internime mbi inteligjencien shqiptare, në «55», E mërkurë, 25 shkurt 2009, f. 17; Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, Tiranë, 2007, XXV, f. 319.

BLUSHI Ali

Lindi në fshatin Blush të Kolonjës. U dënua me vdekje nga Gjykata Ushtarake e Kolonjës «për faje kriminale bërë kundër popullit dhe LNÇL si dhe ka qenë pjesë e rradhëve të Ballit Kombëtar». Më 18 gusht 1946, Komiteti Ekzekutiv N.Ç. i Nën-prefekturës së Kolonjës, vendosi sekuestri-min e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 64, 16 korrik 1946, fq. 3.

BLUSHI Edmond

Lindi më 7 korrik të vitit 1962, në Krujë. Më 26 tetor 1988, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 11 vjet e 6 muaj burg (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 291.

BLUSHI Myrteza

Lindi më 6 shtator të vitit 1936, në Krujë. Më 5 qeshor 1979, Gjykata e Rrethit të Krujës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 7 vjet burg dhe heqjen e medaljes «për punë të shquar në ekonomi bujqësore».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 104.

BLUSHI Skënder

Lindi në fshatin Blush të Kolonjës. U dënua me 10 vjet heqje lirie nga Gjykata Ushtarake e Kolonjës. Më 18 gusht të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv N.Ç. i Nën-prefekturës së Kolonjës, vendosi sekuestri-min e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 64, 16 korrik 1946, fq. 3.

BLLACA Qazim

Një nga tre nënsekretarët e qeverisë së kryesuar nga Rexhep Mitrovica (5 nëntor 1943-17 qeshor 1944).

Lindi më 12 dhjetor të vitit 1915, në fshatin Bllacë të Suharekës, në Kosovë. Kreu studimet e larta për Drejtësi. U arrestua në vitin 1945 dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie si «armik i popullit». U lirua në vitin 1960.

BLLACI Jorgo

Poet, përkthyes, «Mjeshtër i Madh».

Lindi në vitin 1938, në qytetin e Gjirokastrës. Kreu fakultetin e Gjuhë-Letërsisë. Për disa kohë punoi si mësues. Në vitet '50 u dënua me dhjetë vjet burg, për shkak të bindjeve të tij politike. Pas daljes nga burgu në vitet 1964-1967 punoi si punëtor krahu në ndërtim. Më 1990 u kthye në shtëpinë botuese «Naim Frashëri». Pas vdekjes u nderua me titullin «Mjeshtër i Madh». Për përkthimet e tij nga letërsia ruse, Bllaci është dekoruar nga ish-presidenti rus Boris Jelcin me dekoratën e lartë të «Urdhërit të miqësisë».

Vepra: «Ligjërimet e Pyllit» (lirika; «Naim Frashëri», Tiranë, 1964), «Epika e trëndafilave» (poezi; «Naim Frashëri», Tiranë, 1990), «Zërat e natës» (poezi; Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1933), «Kuja e violinës» (poezi të zgjedhura; Tiranë, 2007) etj. *Përkthime:* Sergej A. Esenin, «Vjersha dhe poema të zgjedhura» (poezi; «Monroe», Tiranë, 1994; ribot. «Bllaci», Tiranë, 1996), Ivan S. Turgenjev, «Ujrat pranverore: Rudini» (romane; Shtëpia Botuese «Naim Frashëri», Tiranë, 1996), A. S. Pushkin, «Vjersha e poema» (Shtëpia Botuese «Naim Frashëri», Tiranë, 1997), Hajnrih Hajne, «U hodha – dhe u zgjova shpejt», Lermontovi, Gëtja, Kitsi etj.

BLOSHMI Azis

Ushtarak.

Lindi në vitin 1903, në fshatin Bërzeshtë të rrethit të Librazhdit. Shkollën fillore e kreu në fshat, kurse të mesmen në Manastir. Më 1917 u dërgua në Grac të Austrisë, ku kreu Akademinë Ushtarake. Pas mbarimit të akademisë u kthye në atdhe. U caktoi instruktor në shkollën e plotësimit për oficer në Tiranë. Më vonë u transferua në



Jorgo Bllaci

këmbësori dhe shërbeu në rrethet Kukës, Burrel, Durrës dhe, së fundi, në Tiranë. Më 26 tetor të vitit 1944 u thirr për një sqarim së bashku me 35 intelektualë të tjerë, dhe që nga ajo ditë nuk u kthye më kurrë në familje. U ekzekutua pa gjyq më 28 tetor 1944.

Në dhjetor të vitit 2009, Presidenti i Republikës e dekoroi me Urdhërin «Nderi i Kombit», bashkë me 36 intelektualë të tjerë të Tiranës të vrarë nga komunistët në periudhën 28 tetor-16 nëntor 1944, me motivacionin: «Të martirizuar nga terrori komunist për shkak të besimit në idetë demokratike perëndimore të zhvillimit të Shqipërisë pas Luftës II Botërore».

Bedri Blloshmi, *Rrëfime nga ferri komunist*, Tiranë, 2011, f. 55-57.

BLOSHMI Bedri

Lindi më 2 qeshor të vitit 1950, në fshatin Bërzeshtë të rrethit të Librazhdit. Që i vogël punoi në Ndërmarrjen e Shfrytëzimit të Pyjeve në Stravaj. Qysh pas mbarimit të shërbimit ushtarak, më 1971, e deri më 1976, punoi në kooperativë. Më 1 prill të po këtij viti u thirr në Degën Ushtarake të Librazhdit me pretekstin se nuk e kishte kryer zborin dhe se kish falsifikuar fletëzborin. Për këtë arsye u dërgua në Degën e Punëve të Brendshme për verifikim. Meqe-

nëse aty u mbajt deri natën vonë, i thanë se nuk do të kthehej në shtëpi, por atë natë do të flinte në Hotel Turizmin e qytezës. Dhe aty, në mesnatë, vajti policia dhe e shpuri sërish në Degën e Punëve të Brendshme, ku i vunë prangat. Gjyqi kundër tij dhe të ashtuquajturit «grupi i Bërzeshtës» filloi më 6 qershor të vitit 1977. U akuzua «për krimet e sabotimit të ekonomis kooperativiste në bashkëpunim dhe të agjitacionit e propagandës kundra pushtetit popullor». Një javë më vonë, më 13 qershor, Gjykata Popullore e Rrethit të Librazhdit e dënoi «me 25 vjet heqje të lirisë, me konfiskim të pasurisë dhe humbjen e të drejtave elektorale për 5 vjet kohë». Pjesën me të madhe të dënimit e vuajti në Burrel, Qafë Bari e Spaç. U lirua më 29 mars 1991. Në vitin 1997 u diplomua si jurist dhe oficer policie.

Vepra: «Fabrikimi i vdekjes: Dosjet e Sigurimit të Genc Lekës dhe Vilson Blloshmit», «Rrëfime nga ferri komunist» (2011).

Bedri Blloshmi, *Rrëfime nga ferri komunist*, Tiranë, 2011, f. 159, 169, 392, 395-396; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 37.

BLLOSHMI Bukurosh

Lindi në vitin 1933, në fshatin Bërzeshtë të rrethit të Librazhdit. Arsimin fillor e kreu në fshat. Punoi në Ndërmarrjen e Shfrytëzimit të Pyjeve në Stravaj. Pas burgosjes së të vëllezërve, Hasanit [shih] më 1952, dhe Samiut [shih] më 1963, atij dhe Eshrefit [shih], vëllait më të vogël të familjes Blloshmi, u ra barra e mbajtjes edhe të familjeve të tyre. Kurse pas burgosjes së nipërve të tij, Bedri [shih] dhe Vilson Blloshmit [shih], familja e tij, bashkë me pjesën tjetër të familjes Blloshmi, u internua në Polis të Librazhdit. Familja e Bukurosh Blloshmit u lirua nga internimi dhe u kthye në fshatin e lindjes, në Bërzeshtë, në vitin 1987.

Bedri Blloshmi, *Rrëfime nga ferri komunist*, Tiranë, 2011, f. 157-158.

BLLOSHMI Demir

Lindi më 12 tetor 1943, në fshatin

Bërzeshtë të Librazhdit. Më 13 qershor të vitit 1977, Gjykata Popullore e Rrethit të Librazhdit e dënoi me 20 vjet heqje lirie, me konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet, për sabotim dhe «agjitacion e propagandë kundër Pushtetit Popullor». Me dekret nr. 7147 datë 9. 09. 1987 të Presidiumit të Kuvendit Popullor iu fal dënimi i mbetur dhe u lirua.

Bedri Blloshmi, *Rrëfime nga ferri komunist*, Tiranë, 2011, f. 378, 396; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 277.

BLLOSHMI Eshref

Lindi në vitin 1937, në fshatin Bërzeshtë të rrethit të Librazhdit. Shkollë fillore e kreu në fshat. Si i vëllai, Bukuroshi [shih], Punoi në Ndërmarrjen e Shfrytëzimit të Pyjeve në Stravaj. Më 1977 u internua së bashku me pjesën tjetër të familjes Blloshmi në Polis të Librazhdit. U lirua më parë se të tjerët dhe u vendos në Elbasan, ku jeton edhe sot.

Bedri Blloshmi, *Rrëfime nga ferri komunist*, Tiranë, 2011, f. 158.

BLLOSHMI Haki

Diplomat.

Lindi në vitin 1904, në fshatin Bërzeshtë



Haki Blloshmi

të rrethit të Librazhdit. Mësimet e para i mori në shkollat shqipe në fshatin e lindjes dhe në Korçë. Në moshën gjashtëmbëdhjetë vjeçare u dërgua për të vazhduar shkollën e mesme dhe të lartë në Shtetet e Bashkuara. Kreu Universitetin e Harvardit për Ekonomi politike. Nga viti 1925 deri më 1929 shërbeu si konsull në Boston. U kthye në Shqipëri, dhe më vonë kreu studimet pasuniversitare në Francë. Pushtimi fashist e gjeti në vendlindje, ku organizoi rezistencën antifashiste dhe u vu në krye të çetës nacionaliste të zonës. Më 7 mars të vitit 1944, në fshatin Dunicë të Mokrës, komunistët i sulmuan befas forcat nacionaliste të Ballit Kombëtar, të komanduara prej tij. Partizanët u bënë thirrje të dorëzoheshin, duke iu premtuar se do t'i linin të lirë të ktheheshin në shtëpi. Haki Blloshmi pranoi, me kusht që luftëtarët e tij të lireshin të lirë. Pas kapjes së tij, komunistët i pushkatuan të gjithë të dorëzuarit. Aty atë ditë u vranë Haki Blloshmi, Shefqet Blloshmi [shih], Skënder Blloshmi [shih], Sabri Blloshmi [shih], Bajram Blloshmi [shih] etj.

Bedri Blloshmi, *Rrëfime nga ferri komunist*, Tiranë, 2011, f. 18-19, 27.

BLOSHMI Hasan

Lindi më 11 dhjetor 1926, në fshatin Bërzeshtë të rrethit të Librazhdit. Pesë klasë të fillores i kreu në fshat. U arrestua nga Sigurimi i Shtetit më 10 qershor të vitit 1952 dhe, më 21 tetor të po atij viti, Gjykata Ushtarake Territoriale e Korçës e dënoi me 20 vjet heqje lirie, humbjen e të drejtave elektorale për 5 vjet, si dhe me konfiskimin e gjithë pasurisë, «për krimin e bashkëpunimit me bandat e armatosura», «për krimin e agjitacionit dhe të propagandës» dhe «për krimin e mbajtjes së armës pa leje». U lirua më 19 korrik të vitit 1965. Pas arrestimit të dy nipërve të tij, Vilson [shih] dhe Bedri Blloshmit [shih], më 27 korrik 1977 familja e Hasanit, së bashku me të gjithë vëllezërit e tjerë, u internua në Polis të Librazhdit. Por po atë ditë, me të mbërritur në vendin e internimit, u thirr në zyrën e këshillit dhe u arrestua sërish.

Dhe më 2 nëntor 1977, Gjykata Popullore e Rrethit të Librazhdit e dënoi me 10 vjet burg «për krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit popullor». Në fillim të korrikut të vitit 1982 u sëmur rëndë në kampin e Spaçit dhe vdiq më 7 korrik 1982. Pas vitit 1982, familja Blloshmi i gjeti eshtrat e tij në varrezën e fshatit Shishtufinë dhe i rivarrosi në varrezën e fshatit Bërzeshtë, pranë babait dhe nënës së tij.

Bedri Blloshmi, *Rrëfime nga ferri komunist*, Tiranë, 2011, f. 59, 82-84, 95, 125-128.

BLOSHMI Sami


Lindi më 4 tetor të vitit 1930, në fshatin Bërzeshtë të rrethit të Librazhdit. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes. Punoi në bujqësi dhe në Ndërmarrjen e Shfrytëzimit të Pyjeve si druvar. U arrestua më 25 mars të vitit 1963. Më 25 korrik të po atij viti, Gjykata e Qarkut Durrës, Dega Elbasan, e dënoi me 7 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë «për krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër Pushtetit Popullor». U intrenua familjarisht më 27 korrik 1977 në Polis të Librazhdit, për shkak të dënimit të djemve të tij, Vilsonit [shih] dhe Bedriut [shih]. U lirua në gusht të vitit 1987.

Bedri Blloshmi, *Rrëfime nga ferri komunist*, Tiranë, 2011, f. 133, 137, 147-151; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 188.

BLOSHMI Vilson

Poet, përkthyes, «Mësues i Popullit».

Lindi më 18 mars 1948, në fshatin Bërzeshtë të rrethit të Librazhdit. Shkollën fillore e kreu në fshatin e lindjes, kurse pedagogjiken në Normalen e Elbasanit (1966). Megjithë kërkesat e shumta bërë në Drejtorinë Arsimore të rrethit të Librazhdit, nuk u lejua të fillonte punë si mësues. Ndaj dhe u shtrëngua të punonte në Ndërmarrjen e Shfrytëzimit të Pyjeve në Stravaj. Pas kryerjes së shërbimit ushtarak, më 1970 filloi punë në kooperativë. U arrestua më 5 gusht të vitit 1976 në Librazhd. Që këtu u dërgua menjëherë në Tiranë. Pas një viti torturash në hetuesitë e Tiranës dhe të Librazhdit, më



Vilson Blloshmi

6 qershor 1977 u nxorr përpara Gjykatës Popullore të Rrethit të Librazhdit, «akuzuar për krimin e agjitacionit e propagandës kundra pushtetit popullor». Një javë më vonë, më 13 qershor, gjykata e deklaroi fajtor dhe, së bashku me Genc Lekën [shih], e dënoi «me vdekje pushkatim, me konfiskimin e pasurisë dhe me humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë». Ky vendim u la në fuqi, si nga Gjykata e Lartë, ashtu dhe nga Presidiumi i Kuvendit Popullor. Dhe, më 17 korrik 1977 u zbatua urdhëri i Ministrisë të Brendshme për ekzekutimin e tij në orën 00.

Në vitin 1994, ditën e rivarrimit, Presidenti i Republikës i akordoi medaljen «Martir i Demokracisë». Një vit më vonë, njëerës prej shkollave 8 vjeçare në Librazhd iu vu emri «Vilson Blloshmi», dhe po këtë vit u dekorua «Mësues i Popullit». Më 30 qershor 2006, nën kujdesin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe në prani të Presidentit të Republikës, në Librazhd u përvurua memoriali i dy poetëve martirë të demokracisë, Genc Lekës e Vilson Blloshmit. Po këtë ditë ata u shpallën «Qytetarë Nderi» të Bashkisë së Librazhdit. Në janar 2009 iu dha çmimi «Lasgush Poradeci» për librin më të mirë poetik të vitit (postum). Në maj të vitit

2010, Presidenti i Republikës i akordoi urdhërin «Nderi i Kombit».

Bedri Blloshmi, *Rrëfime nga ferri komunist*, Tiranë, 2011, f. 169, 173-175, 395-397.

BOBI Fotaq (Foto)

Lindi më 5 shkurt të vitit 1950, në Gjirokastrë. Më 3 shkurt 1973, Gjykata e Rrethit të Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 279 .

BOBI Hysen

Lindi në fshatin Lazarat të Gjirokastrës. U deklarua «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 7 maj të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të qytetit të Gjirokastrës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 57, 19 maj 1948, fq. 4.

BOBI Teki

Lindi në fshatin Lazarat të Gjirokastrës. U deklarua «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 7 maj 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Gjirokastrës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 57, 19 maj 1948, fq. 4.

BOCA Kalam

Lindi në fshatin Sasaj të Sarandës. U ekzekutua nga partizanët para përfundimit të luftës si «kriminel lufte e armik i popullit». Më 9 shkurt 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Sarandës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 47, 29 maj 1946, fq. 5.

BOCAJ (BOCI) Muço

Lindi më 4 shtator të vitit 1941 në fshatin Ranicë të Vlorës. Më 24 shkurt 1976, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AIKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 33.

BOÇE Hysen

Lindi në fshatin Sasaj të Sarandës. Më 11 shtator të vitit 1946, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi «armik i popullit dhe kriminel lufte» dhe e dënoi me vdekje dhe «me konfiksimin tanësor të pasurisë së tij të luftëshme e të pa luftëshme». Më 13 dhjetor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Sarandës urdhëroi sekuestrimin e plotë të pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 19, 27 shkurt 1947, f. 8.

BOÇI Leonard

Lindi më 7 prill të vitit 1943 në Shkodër. Më 16 tetor 1979, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie.

AIKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 304.

BOÇI Xhelaludin (Xheladin)

Lindi më 21 prill të vitit 1959, në fshatin Lazarat të Gjirokastrës. Më 11 prill 1980, Gjykata e Rrethit të Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AIKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 125.

BOÇI Asrit

Lindi më 2 nëntor të vitit 1933, në Sarandë. Kreu Liceun Artistik. U dënua me 15 vjet heqje lirie për tentativë arratisjeje. Vdiq në vitin 1979.

BOÇI Dhimo

Lindi më 19 korrik të vitit 1920, në fshatin Pilur të Vlorës. Më 25 korrik 1957, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe për «strehim dhe furnizim të diversantëve» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiksimin e pasurisë dhe humbjen

e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. U arrestua sërish më 1979, dhe më 20 mars të po atij viti, Gjykata e Vlorës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AIKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 179; AIKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 267.

BOÇI Sifi

Lindi më 20 korrik të vitit 1937, në fshatin Bujaras të Elbasanit. Më 2 qershor 1966, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «veprime përgatitore për arratisje» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AIKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 258.

BODE Zaim

Lindi më 16 prill të vitit 1923, në fshatin Rakickë të Devollit. Më 1 dhjetor 1980, Gjykata e Rrethit të Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie.

AIKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 199.

BODINAKU Yllbardh

Lindi më 20 tetor të vitit 1953, në Tiranë. Më 12 maj 1981, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar). U lirua me aminsti, më 15 nëntor 1982.

AIKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 336.

BOGDANI Sheh Ali

Klerik i lartë musliman, nënmyfti i Lumës.

Lindi më 15 gusht të vitit 1880, në fshatin Lanaj të Kukësit. Studimet teologjike i kreu në Stamboll. U arrestua më 7 shtator të vitit 1947. Një vit më vonë, më 18 qershor 1948, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 12 vjet heqje lirie, punë të detyruar dhe konfiskim të pasurisë së luajtshme e të paluajtshme, sepse, sipas vendimit, «ka strehuar kriminelët e arratisur dhe ka pro-

poganduar në popull kundër reformave të pushtetit». Pas burgimit të tij, Kryesia e Këshillit të Përhershëm të Komunitetit Musliman Shqiptar e pezulloi nga të gjitha detyrat.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 382; AQSh, *Komuniteti Mysliman*, F. 482, D. 3, viti 1947.

BOGDANI Iljaz

U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 20 maj të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Librazhdit urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 52, 3 qershor 1947, f. 5.

BOGDANI Kodhel

Lindi më 18 dhjetor të vitit 1966, në fshatin Rrajcë të Librazhdit. Më 8 dhjetor 1987, Gjykata e Rrethit të Librazhdit e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit, mbetur në tentativë» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 32.

BOJANI Anton

Lindi më 8 shkurt të vitit 1944, në Shkodër. Më 12 prill 1961, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tentativës për arratisje në bashkëpunim» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie. Por më 15 maj të po atij viti, Gjykata e Lartë e ndryshoi vendimin e Gjykatës Ushtarake dhe, përfundimisht, e dënoi me 2 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 357.

BOJAXHI Stavro

Lindi më 6 shtator të vitit 1907, në Vlorë. Mbeti jetim që fëmijë. Me ndihmën e Bashkisë së qytetit u dërgua për studime në shkollën teknike «Harry Fultz» të Tiranës. Pas përfundimit të shkollës, punoi si teknik në centralin elektrik të Beratit, të Vlorës dhe të Kavajës. U arrestua më 1947 si «agjent në shërbim të imperializmit anglo-amerikan dhe armik i Pushtetit Po-

pullor». Fillimisht u dënua me vdekje, por përfundimisht bëri shumë vite burg.

H. Gonxhja, I. Gogaj, Sh. Bumçi, *Ndihmesa e ish nxënësve dhe mësuesve të Shkollës Teknike të Tiranës për zhvillimin e vendit dhe luftën për çlirim e demokraci*, Tiranë, 2006, VII, 2, f. 253.

BOJKU Remzi

Lindi më 3 janar të vitit 1927, në Pejë. Më 12 gusht 1958, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «tentativë për kalim kufiri» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie. U lirua me aminsti më 1959.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 341.

BOKSI Rasim

U diplomua në Greqi për Jurisprudencë. Kur italianët hynë në Shqipëri, ai u largua bashkë me mbretin Zog në Greqi. U kthye në vitin 1943 dhe luftoi në çetat e legalistëve. Në janar të vitit 1945 ndodhet në Postribë për të organizuar rezistencën antikomuniste. U vra nga partizanët në gjysmën e dytë të qershorit të vitit 1945 në bjeshkët e Domnit.

BOLENA Qamil

Lindi në fshatin Bolenë të Vlorës. U dënua si «kriminel lufte». Për këtë arsye, më 4 dhjetor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Qendrës Vlorë urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij të luajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 16, 24 shkurt 1947, f. 5.

BOLETINI (BEKTESHI) Adile

E motra e Teofik Bekteshit [*shih*] dhe e veja e Adem Isa Boletinit. Lindi më 5 prill të vitit 1907, në Shkodër. U arrestua në vitin 1946 dhe u dënua me gjashtë vjet heqje lirie «për agjitacion e propagandë». U lirua më 1950.

Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, Tiranë, 2007, XXIII, Dh, f. 306.

BOLETINI Ismet

Nipi i Isa Boletinit. Luftëtar i Regjimentit «Kosova». Pas vitit 1944 doli në mal

bashkë me Isuf e Faik Boletin. Në vitin 1945 u zu dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie, 7 prej të cilave i vuajti në burgun e Mitrovicës së Sremit. Pas lirimit u arratis në Shqipëri, ku më vonë u arrestua dhe vuajti rreth 17 vjet në burgje e internime, sepse kishte folur kundër lidhjeve te shtetit shqiptar me Kinën, kundër nderimit të figurës së Stalinin etj. Për më tepër, gjatë një mitingu kundër bombardimeve amerikane në Vietnam, tha do të kishte qenë më mirë të protestohej ndaj dhunës dhe terrorit që po ushtrohej ndaj popullit shqiptar në Kosovë. Pas lirimit u kthye në Kosovë, ku dhe vdiq.

Prof. Dr. Muhamet Shatri, *Përpyjekjet e Lidhjes së Dytë të Prizrenit për jetësimin e aspiratave jetike të kombit shqiptar*.

BOLLANO Angjello

Lindi më 25 dhjetor të vitit 1934, në Himarë. Më 17 janar 1961, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes në një shtet të huaj», dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme dhe me humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 394.

BOLLANO Jorgji

Lindi në Himarë të Vlorës. Si njeri me autoritet në vendin e tij, pengoi ngritjen e keshillave nacional-çlirimtarë në Himarë. Për këtë arsye, pas luftës u vra me snajper tek po pinte kafe në ballkonin e shtëpisë së tij. Më 28 qeshor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Himarës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Edvin Q., *Himara kristjane e Himarës dhe himarjotëve*, në gazetën «Kritika», 20 tetor 2006; *Gazeta Zyrtare*, nr. 112, 14 dhjetor 1946, f. 7.

BOLLANO Petro

Lindi më 13 prill të vitit 1934, në Himarë të Vlorës. Më 1 shtator 1958, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor

për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 89.

BOLLANO Roland

Lindi më 23 tetor të vitit 1958, në Tiranë. Më 28 dhjetor 1987, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Sarandës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes mbetur në tentativë, kryer në bashkëpunim me të tjerë» dhe dënoi me 10 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 444.

BOLLANO Theodhori

Lindi më 2 nëntor të vitit 1924, në Himarë të Vlorës. Më 31 janar të 1979, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 6 vjet burg dhe heqjen e medaljes.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 178.

BOLLO Dhimitër

Lindi më 27 tetor të vitit 1947, në fshatin Goricë të Gjirokastrës. Më 12 qeshor 1973, Gjykata e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 110.

BOME Qerime

Lindi në vitin 1938, në Ersekë të Kolonjës. Nga 1 gushti 1945 deri më 10 shkurt 1950 u internua në rrethin e Krullës. U arrestua në maternitet, teksa po lindte. Më 6 tetor të vitit 1972, me vendim të Kolegjit Ushtarak të Tiranës u dënua me pesëmbëdhjetë vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë «për tradhti ndaj atdheut mbetur në përgatitje, agjitacion e propogandë kundër pushtetit popullor». U lirua në vitin 1983.

Vërtetim i gjendjes gjyqësore, Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Regjistri i Gjendjes Gjyqësore, Tiranë, 8. 10. 1992; Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1529/1, Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Sektori i Arkivit Shtetëror të Sistemit.


BONATI Imzot Jul

Klerik i lartë katolik, Vikar i Përgjithshëm i Durrësit dhe i Vlorës.

Lindi në Shkodër, më 4 maj të vitit 1874. Kreu arsimin e lartë për filozofi dhe letërsi në Austri dhe në Padova të Italisë. U shugurua meshtar në Goricia (Itali), më 8 prill 1906. Shërbeu si prift në Padovë, për pesëmbëdhjetë vjet në Stamboll, dhjetë vjet në Durrës dhe tre vjet në Vlorë. U arrestua në Durrës më 6 dhjetor të vitit 1946, me akuzën se «nën maskën e fesë ka lozur rolin e propagandës kundër Lëvizjes N-ÇI; se ka urryer në kulm komunistat dhe ka qenë i lidhur ngushtë me spiunat e famshme...», se gjatë vitit 1944 ka udhëtuar në Itali, është krahu i djathtë për italianët dhe ka marrë udhëzime nga mjeshtri i madh, Papa; ka ndenjur në Shkodër lart nga tre javë dhe ka marrë udhëzime prej shokëve të tij priftin të Shkodrës, për veprim kundër Pushtetit Popullor dhe sidomos, kundra komunistave mbasandaj, është kthyer në Berat, ku ka ndenjur një javë e është takuar me një shok si veten e tij, mbaroi punë dhe u kthye në Vlorë, ku filloi avazin e parë dhe kërkoi të përgatisë një rrjet tjetër për agjitacion e propagandë kundër Pushtetit Popullor. Prandaj Bonati me shokë kanë qenë spiunat ma të rrezikshëm të Pushtetit Popullor, që propagandonin para ardhjes së Italisë dhe thonin «Po ja mbërrijnë pëllumbat e Krishit» për ushtarët italianë; i kanë dashur varrin Shqipërisë...». U torturua çnjerëzisht. Për ta torturuar edhe më shumë, u mbyll në çmendenin e Durrësit, ku më 5 maj 1951 u masakrua nga të çmendurit.

Imzot Jul Bonati është përkthyesi i «Lahutës së Malcisë» në gjuhën italiane.

Dr. Pjetër Pepa, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri*, Tiranë, 2007, vol. I, II, f. 697-704.



Imzot Jul Bonati

BONJAKO Lluka

Lindi më 7 mars të vitit 1925, në fshatin Dhërmi të Vlorës. Më 21 dhjetor 1962, Gjykata Ushtarake e Tiranës deklaroi fajtor për «krimet: tradhëti ndaj atdheut dhe pjesëmarrje në banda të armatosura» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie, humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë, si dhe konfiskimin e pasurisë. U arrestua sërish më 1981 dhe më 15 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Mirditës e deklaroi fajtor për «agjitacion dhe propagandë» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 134.

BONJAKU Sabri

Lindi në fshatin Kaninë të Vlorës. Më 20 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Vlorë urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 72, 5 gusht 1946, f. 7.

BONJAKU Tasim

Lindi në Kaninë të Vlorës. U deklarua «kriminel luftë» dhe u ekzekutua. Më 5 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Qendrës Vlorë vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 48, 30 maj 1946, fq. 8.

BORA Sadik

Veprimtar i lëvizjes kombëtare shiptare.

Lindi më 16 dhjetor të vitin 1900, në fshatin Vajzë të Vlorës. Arsimin fillor e kreu në shkollën e fshatit. Më vonë, gjyshi i tij e dërgoi për të vazhduar studimet në Vlorë e pastaj në Labovë të Gjirokastrës. Detyrën si mësues e filloi më 1919 në disa fshatra të Vlorës: Gorisht, Kaninë, Vajzë, Ramicë, Sevaster, Mavrovë, Velçë etj. Mori pjesë aktive në krijimin e klubit patriotik «Mbrotja Kombëtare», që organizoi luftën e Vlorës. Në vitin 1924 i ofroi shërbimet e tij qeverisë Noli. Gjatë periudhës së Mbretërisë, mori pjesë në tre përbetimet e viteve 1932, '35 dhe '37. Pushtimi fashist e gjeti tek të 40-at, me përvojë dhe kontribut të madh në lëvizjen kombëtare. U fut në radhët e organizatës nacionaliste «Balli Kombëtar». U arrestua që më 1944 dhe u dënua me pushkatim, por mbrotja që i bënë në gjyq bashkëfshatarët dhe qytetarët e Vlorës, të cilët ngulnin këmbë në pafajësinë e tij, i detyruan autoritetet t'ia ulnin dënimin në 10 vjet heqje lirie. Më 5 shkurt 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Vlorë vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij. Pas lirimit nga burgu, si pasojë e dhunës dhe terrorit që u ushtrua ndaj tij, familjes dhe rrethit të tij familjar, u çmend. Vdiq në javën e parë të korrikut të vitit 1976.

Pas rënies së Komunizmit, me Dekret të Presidentit të Republikës, u dekorua me urdhërin «Naim Frashëri» i klasit të parë, për kontributin e dhënë në shtrirjen e arsimit dhe për edukimin e rinisë me ndjenja patriotike, liridashëse dhe demokratike.

Gazeta Zyrtare, nr. 48, 30 maj 1946, fq. 7.

BORDI Mahmud

Lindi në Elbasan. U deklarua «armik i popullit». Për këtë arsye, më 29 mars 1948, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Elbasanit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 43, 26 prill 1948, f. 7.

BORIÇI Nexhat

Lindi më 1 maj të vitit 1918, në Shkodër. Në vitet 1944-1946 qëndroi në mal, u dënua me burgim dhe pas përfundimit të burgut u arratis jashtë vendit. Punoi si mësues në Kosovë, ku kishte luftuar në vitin 1943 si vullnetar në Batalionin e Rinisë së Ballit Kombëtar «Besnik Çano».

Anila Dushi, *Daut Boriçi - Historia e një familjeje mësuesish e patriotësh*, në «Shekulli», 30 korrik 2007.

BORIÇI Nuredin

Mësues.

Lindi në Fier, më 1945. Kreu Institutin e Lartë Pedagogjik, Fakultetin Gjuhë-Letërsi, në Tiranë. Punoi për shumë vjet si mësues në qytetin e Fierit. U arrestua në vitin 1977 dhe u dënua me gjashtë vjet heqje lirie «për agjitacion e propagandë».

Vepra: «Pleqtë e burgut», «Është koha për të vdekur», «Mall për dheun e pastër», «Ullinj të Hekalit» etj.

Agim Musta, Visar Zhiti, Enver Lepenica, Tanush Mulleti, *Antologjia e plagëve nën terrorin komunist*, 2004, f. 466.

BORIÇI Xhevahir

Lindi më 1 janar të vitit 1948, në fshatin Hamil të Fierit. Më 14 shtator të vitit 1985, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Fierit e deklaroi fajtor për «agjitacion dhe propagandë kundër shtetit» dhe «përvetësim të pasurisë qytetare», dhe e dënoi me shtatë vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 31.

BORSHI Shyqyri

Ushtarak.

Lindi në vitin 1893, në fshatin Borsh të Sarandës. Kreu Shkollën Tregtare të Vlorës dhe Akademinë Ushtarake të Torinos. Gjatë kohës së Mbretërisë shërbeu në degën e garnizonit të Tiranës. Gjatë pushtimit italian u përfshi në forcat ushtarake të Ministrisë së Mbrotjes. Në vitin 1942 është oficer i kuesturës dhe karabinerisë. Më 14 prill të vitit 1945, Gjykata e Lartë e

dënoi me vdekje, pushkatim. Një vit më vonë, më 4 prill 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tiranës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë, 2009, I, f. 30; *Gazeta zyrtare*, nr. 102, 9 dhjetor 1947, fq. 1.

BOSHENJI Abdyl

Lindi në fshatin Boshanj të Kolonjës. U dënua me vdekje si pjestar i Ballit Kombëtar. Më 5 dhjetor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Ersekës urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 57, 27 qeshor 1946, fq. 5.

BOSHNJAKU Hasan

Lindi më 1 shkurt të vitit 1955, në fshatin Buçaj të Tropojës. Më 11 mars 1989, Gjykata e Rrethit të Tropojës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 22 vjet heqje lirie.

AISKK, F.1, V.2012, D.1, Fl. 97.

BOSHNJAKU Kostandin

Veprimtar politik, deputet i legjislaturës së parë, Drejtor i Përgjithshëm i Bankës së Shtetit (17 janar 1945-2 prill 1946), bankier, diplomat.

Lindi në vitin 1888 në fshatin Gjatë të Lunxhërisë. U diplomua në Institutin Tregtar të Pireut, në Greqi. Nga 1908 deri më 1914 punoi si bankier në Odesë dhe Shën Petërburg, kurse nga 7 marsi deri më 3 shtator 1914 shërbeu si drejtor i Thesarit dhe Borxhit të Shtetit në qeverinë e princ Vidit. Po këtë vit u kthye në Shën Petërburg si drejtor banke. Në janar 1922 shkoi në Moskë, duke vënë kështu kontaktet e para shqiptare me Rusinë Sovjetike. Po këtë vit u caktua përfaqësues i Shqipërisë në Hagë dhe i ngarkuar me punë në Stamboll. Më 1923 u kthye në Shqipëri. Pas dështimit të Revolucionit të Qershorit emigroi në Austri, Zvicër etj. Bënte pjesë në delegacionin shqiptar të kryesuar nga Fan Noli në Konferencën e Miqve të Bashkimit Sovjetik (1927). Po këtë vit, qeveria shqiptare



Kostandin Boshnjaku

e dënoi me vdekje në mungesë. Në vitet 1925-1939 ishte një nga përfaqësuesit e Kominternit për Ballkanin. Më 1939 u kthye në atdhe. Punoi në Këshillin Kontrollues të Bankës së Shtetit deri në shtator 1943, kur u bashkua me Lëvizjen Nacional-Çlirimtare. Nga 17 janari 1945 deri më 2 prill 1946 ushtroi funksionet e Drejtorit të Përgjithshëm të Bankës së Shtetit. Në legjislaturën e parë u zgjodh deputet i qytetit të Shkodrës. U arrestua më 15 maj të vitit 1947, si pjestar i grupit të deputetëve. Disa muaj më vonë, më 31 dhjetor të vitit 1947, Këshilli i Gjykatës së Lartë Ushtarake e dënoi me burgim të përjetshëm. Ndaj dhe më 3 mars të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Tiranës vendosi sekuestrimin e pasurisë së luajtshme të tij. U lirua më 27 prill 1949 si viktimë e Koçi Xoxes. Vdiq në Durrës, më 1953.

Vladimir Misja, Ana Lalaj, *BOSHNJAKU Kostandin*, në «Fjalor Enciklopedik Shqiptar», 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 284; *Gazeta Zyrtare*, nr. 37, 7 prill 1948, f. 1.

BOZDO At Kostandin

Klerik ortodoks.

Lindi në vitin 1902, në fshatin Koshovicë të Dropullit të Sipërm (Gjirokastrë) në një familje klerikësh ortodoksë. U hirotonis prift nga Mitropoliti i Gjiro-

kastrës dhe shërbeu në fshatrat Koshovicë, Sofratikë, Selo e Klishar. Më vonë u gradua Stavrofor dhe u caktua përgjegjës i Manasatirit të Trinisë së Shenjtë të Pepelit. Më 30 shtator të vitit 1946 u dënua me vdekje për tradhëti ndaj atdheut dhe u ekzekutua.

BOZDO Luçi

Lindi më 21 korrik të vitit 1898, në fshatin Kolonjë të Lushnjës. U deklarua «armik i popullit». Më 21 korrik 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Lushnjës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 76, 23 gusht 1947, fq. 8.

BOZO Bani

Lindi më 15 shkurt të vitit 1915, në fshatin Kolonjë të Lushnjës. Më 23 gusht 1946 u dënua nga Gjykata Ushtarake e Prefekturës së Beratit «si armik i popullit dhe i Pushtetit dhe kriminel i luftës për veprat e tij trathtije i bashkuar me të njëjtin kriminel Hamit Matjanin, i cili u ekzekutua me vdekje me konfiksimin e pasurisë së tundëshme e të patundëshme». Për këtë arsye, më 8 janar të vitit 1947 Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Lushnjës vendosi konfiksimin e pasurisë private të tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 14, 20 shkurt 1947, f.6-7.

BRACI Llosh

Vëlla i Dedë Fran Bracit [*shih*]. U ther nga partizanët në shkurt të vitit 1945, në Rapshë të Hotit.

BRAÇELLARI Ilmi

Lindi më 17 janar të vitit 1926, në fshatin Lozhan të Korçës. Më 17 dhjetor 1965, Gjykata e Rrethit të Korçës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe «agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskim e 2940 obligacioneve dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 256.

BRAHIMAJ Mano

Lindi në fshatin Buzmath të Nënprefekturës së Mallakastrës. U deklarua «kriminel luftime». Më 15 gusht të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Mallakastrës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 96, 31 tetor 1947, fq. 6.

BRAHIMAJ Pashko

Inxhinier mekanik, mësues.

Lindi më 6 tetor të vitit 1901, në Shkodër. Më 1926 kreu Shkollën Teknike të Tiranës dhe u emërua mësues në po këtë shkollë. Në vitet 1930-1932 ndoqi studimet universitare në Angli, në degën e inxhinierisë mekanike, të cilat i ndërpreu për arsye ekonomike. Pas kthimit në Shqipëri, punoi si mësues i lëndës teorike të mekanikës dhe, njëkohësisht, si drejtor i Oficinës së Shkollës Teknike nga viti 1933 deri në fund të vitit 1952. U arrestua më 13 mars 1953, si «ish pasues i ideve të Fulcit dhe për agjitacion e propagandë kundër Pushtetit Popullor» dhe u dënua me pesë vjet heqje liri.

H. Gonxhja, I. Gogaj, Sh. Bumçi, *Ndihmesa e ish nxënësve dhe mësuesve të Shkollës Teknike të Tiranës për zhvillimin e vendit dhe luftën për çlirim e demokraci*, Tiranë, 2006, VII, 2, f. 253.

BRAHIMAJ Sinan

Lindi më 28 shtator të vitit 1907, në fshatin Lepenicë të Vlorës. U burgos si «kriminel luftime». Më 23 qershor 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Kotës vendosi konfiksimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 67, 1 nëntor 1945, f. 4.

BRAHIMI Hetem

Lindi më 10 prill të vitit 1938, në fshatin Dragom të Çamërisë. Më 11 shkurt 1957, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie, konfiksimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Tetë muaj më vonë, më

27 nëntor të po atij viti, dënimi iu zbrit në 17 vjet, 10 muaj e 27 ditë burg.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 158.

BRAHIMI Omer

U vra në përpjekje me forcat partizane, më 7 shkurt të vitit 1945, në fshatin Brojë të Kelmendit.

Dr. Luigj Martini, *Prek Cali, Kelmendi dhe kelmendasit*, Shkodër, 2005, f. 248.

BRAHJA Hoxhë Selim

Klerik musliman.

Lindi në vitin 1890, në fshatin Sauk të Tiranës. U diplomua për teologji në Turqi. Në vitin 1916, pas përpjekjesh të mëdha, bashkë me Mehmet Efendi Saukun, arritën të hapin shkollën e parë shqipe në fshat. Mori pjesë aktive në lëvizjen fanoliste të vitit 1924. Në mars të vitit 1940 u arrestua nga italianët dhe u dënua me katër muaj burg. U vra nga partizanët më 31 gusht të vitit 1943, përpara xhamisë së fshatit Sauk.

BRAHJA Veli

Lindi në fshatin Ndroq të Tiranës. U deklarua «armik i popullit». Më 31 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Shijakut vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 34, 18 prill 1947, f. 2.

BRAHOLLARI Razmi

Lindi më 15 maj të vitit 1926, në fshatin Neviçisht të Korçës. Më 29 nëntor 1947, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi «armik i popullit» dhe e dënoi me 10 vjet privim lirie me punë të detyruar.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 385.

BRAJOVIÇ (FEREZAJ) Vuko

Lindi më 24 nëntor të vitit 1963, në Shkodër. Më 3 shtator 1982, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor «për tradhëti ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit të mbetur në tentativë», dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 402.

BRAKA Hakim

Lindi në fshatin Gerkovinë. Më 15 qeshor 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Topallti urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 116, 26 dhjetor 1946, f. 7.

BRAKA Sefer


Lindi më 1 maj të vitit 1951, në fshatin Tartaj të Dibrës. Më 19 janar 1976, Gjykata e Dibrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 84.

BRANICA Halil

Pjesëtar i Gardës Mbretërore të Zogut I.

Më 28 prill të vitit 1952, së bashku me Hamit Matjanin [*shih*], Zenel Shehun [*shih*], Haxhi Gjylen [*shih*], radioperatorin e grupit Tahir Prençi [*shih*] dhe udhërrëfyesin Xhelo Tresova [*shih*], kaluan kufirin greko-shqiptar në këmbë. Por shumë shpejt Branica u sëmur dhe u kthye në Greqi. Të tjerët vazhduan drejt një baze në Veri, ku ata u bashkuan me luftëtarët antikomunistë, që Matjani i kishte rekrutuar qysh më parë. Shehu dhe Prençi ndenjën me ta, kurse Matjani, Gjylja dhe Tresova u kthyen në Greqi. Disa muaj më vonë, më 4 gusht 1952, pasi ishte mëkëmbur nga sëmundja, Halil Branica u parashutua në vendin që i kishte caktuar radioperatori Prençi, në malet e Martaneshit. Më 1 janar 1954, Radio Tirana dha lajmin e bujshëm se Hamit Matjani, Zenel Shehu, Halil Branica, Naum Sula [*shih*], Gani Malushi [*shih*] dhe disa luftëtarë të tjerë lokalë ishin kapur nga Sigurimi i Shtetit. Në gjyqin që u zhvillua më prill 1954 u kuptua se Zenel Shehu ishte kapur sapo kishte mbërritur në bazë dhe se radiomesazhet i kishte dërguar Sigurimi shqiptar, duke i futur në



Lekë Previzi, Prerje tërthore e kaponit të kampit të Tepelenës (skicë)

kurth të gjithë të parashutuarit. Dhe më 12 prill 1954, Halil Branica u dënua me vdekje me pushkatim, bashkë me Shehun, Sulën e Malushin, kurse Hamit Matjani me varje. Me gjithë premtimin e dhënë se do t'u falej jeta po të bashkëpunonin me Sigurimin, u ekzekutuan të gjithë në afërsi të Urës së Beshirit.

Curtis Peebles, *Twilight Warriors: Covert Air Operations Against the USSR*, Naval Institute Press, Annapolis, 2005, I, 2, f. 51-53.

BRANKOVIQ Pero

Shtetas jugosllav. Ndërkohë që kryente shërbimin ushtarak në kufi, bashkë me Bogdan Lesoskin [*shih*] kaluan në Shqipëri. U dërguan në kampin e Llakatundit në Vlorë. Më vonë u arrestua si spiun jugosllavë. Si pasojë e torturave, ia prenë këmbën.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 57.

BREGASI Mete

Lindi në fshatin Kocul të Vlorës. U

deklarua «kriminellufte». Përkëtë arsye, më 6 dhjetor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Topalltis urdhëroi sekuestrimin e gjysmës së pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 8, 4 shkurt 1947, f. 8.

BREGASI Viliam

Lindi në vitin 1935 në Korçë. Më 14 dhjetor 1950, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor si «pjesëtar të një grupi antipushtet» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie. U lirua për plotësim afati, më 8 nëntor 1958. U arrestua sërish më 1979, dhe më 25 shtator të po atij viti u dënua me 10 vjet heqje lirie, 5 vjet internim dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «agjitacion e propagandë», (dënim i kombinuar).

AISKK, F.1, V.2012,D.1, Fl. 250.

BREGU Abdyl

Lindi më 5 janar të vitit 1930, në fshatin Taç i Poshtëm të Kolonjës. Më 16 prill 1958, Gjykata e Qarkut të Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e pro-

pagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie. Një muaj më vonë, më 19 maj të po atij viti, Gjykata e Lartë hodhi poshtë vendimin e Gjykatës së Qarkut të Korçës dhe urdhëroi lirimimin e tij nga burgu.

AISKK, F.1, V. 2012, D. 1, Fl. 360.

BREGU Pjerin

Lindi më 4 maj të vitit 1962, në Shkodër. Më 7 korrik 1981, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 259.

BREGU Riza

Lindi më 18 korrik të vitit 1952, në Tiranë. Më 7 dhjetor 1979, Gjykata e Tiranës e dënoi me 5 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 257.

BRESHANI Kacandon

Banues në fshatin Vajzë të Vlorës. U burgos si «kriminel luftë». Më 23 qershor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Kotës vendosi konfiskimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 70, 8 nëntor 1945, f. 7.

BRESHO Nuredin

Lindi më 10 janar të vitit 1930, në fshatin Voshtinë (sot Pogoniani brenda kufirit të Greqisë), në krahinën e Çamërisë. Më 21 korrik 1950, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «tentativë kalim kufiri pa pasaportë» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 184.

BRIGO Spiro

Lindi më 2 tetor të vitit 1949, në Himarë. Më 29 dhjetor 1967, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie.



Arben Broci

AISKK, F. 1, V. 212, D. 1, Fl. 421.

BROCI Arben

Student në vitin e fundit të Inxhinierisë Mekanike pranë Universitetit të Tiranës. Një nga nismëtarët e Lëvizjes Studentore dhe një prej 300 firmëtarëve të parë për krijimin e Partisë Demokratike. Pas ngjarjeve të dhjetorit, u caktua si i deleguari i Grupit Nismëtar për të krijuar Degën e PD-së në Shkodër, si dhe për të përhapur programin fillestar të PD-së në këtë rreth. Fill pas fitores së Partisë së Punës në zgjedhjet e 31 marsit të vitit 1991, më 2 prillit të po atij viti, në Shkodër filloi një demonstratë masive, që përfundoi me vrasjen me armë të katër personave: Arben Broci, Bujar Bishanaku, Besnik Cekës dhe Nazmi Kryeziut. Pak kohë pas ngjarjes, të katër u nderuan me medaljen «Dëshmorë të Demokracisë», ndërsa me një vendim të Këshillit Bashkiak të qytetit, 2 prilli u shpall dita e «Dëshmorëve të Shkodrës».

BROJA (CIU) Selfixhe

Shkrimtare.

Lindi në vitin 1918, në qytetin e Gjiro-

kastrës. Pasi kreu shkollën unike, vazhdoi mësimet për dy vjet në Liceun e Gjirokastrës. Pas mbylljes së liceut, mesimet e mesme i përfundoi në Gjimnazin e Tiranës. Që në gjimnaz (1935) botoi poezitë dhe tregimet e para në shtypin e kohës me pseudonimin «Kolombia». Gjatë kësaj periudhe u njoh dhe përqafoi idetë komuniste, nëpërmjet mikut të saj Zef Malës [shih], kryetarit të Grupit Komunist të Shkodrës, dhe u pranua si anëtare e këtij grupi. Pas mbarimit të shkollës së mesme në vitin 1938, fitoi një të drejtë studimi për në fakultetin e Letërsisë në Universitetin e Firences. Në prill të vitit 1939, pas pushimit të Shqipërisë nga Italia fashiste, së bashku me disa studentë të tjerë shqiptarë, i braktisi studimet në mënyrë demonstrative. Dhe kështu, aty nga fillimi i vitit 1940, u kthye në Shqipëri, ku u rilidh me grupet komuniste. Më 23 mars të vitit 1946, bashkë me të shoqin, u përjashtuan nga partia si «elementë antiparti». Të mbikqyrur vazhdimisht, ata u vetëizoluan. Më 17 janar 1947 u internuan në Gusmar të Kurveleshit. Pas prishjes me jugosllavët (1949), iu hoq masa e internimit. I dërguan fillimisht në Elbasan dhe më pas në Tiranë. Prej këtu i qarkulluan në Kuçovë. U internuan sërish më 1966, bashkë me të bijat, Sashenkën (lindur më 1944) dhe Merin (lindur më 1951), në Gradishtë të Lushnjës. Po atë vit u përjashtuan edhe nga Lidhja e Shkrimtarëve. U rikthyen në Tiranë në vitin 1971 dhe në atë kohë Selfixheja u mbyll në shtëpi, kurse Xhemali punoi për disa kohë në Kinostudjo si administrator. Më vonë u hoq që andej dhe u dërgua në Fermën Bujqësore «Gjergj Dimitrov». Vdiq në gusht të vitit 2003.

Vepra: «Tallazet e jetës: Kujtime, poezi, publicistikë» (1998).

Dashnor Kaloçi, *Si u persekutuan intelektualët, Xhemal e Selfixhe Broja*, në «Gazeta shqiptare», 26 shkurt 2002.

BROJA Xhemal

Dramaturg, pedagog, drejtor i Teatrit Popullor.

Lindi më 24 mars të vitit 1918, në Shkodër, ku ndoqi gjimnazin françeskan. Studimet e larta për drejtësi i filloi në Grenobël të Francës. Aty ndoqi njëherësh kursin e letërsisë dhe të dramaturgjisë. Në këtë periudhë u aktivizua në lëvizjen komuniste franceze. Për arsye financiare i ndërpreu studimet në Grenobël, për t'i vazhduar në Itali përkrah së fejuarës, Selfixhe Brojës [shih]. I ndërpreu studimet dhe, bashkë me të shoqen, u kthyen në Shkodër, ku hapën një librari. Më vonë u zgjodh anëtar i Kryesisë së Këshillit Nacional Çlirimtar të qarkut të Shkodrës. Pas luftës u thirr në kryeqytet për të organizuar Teatrin Popullor, ku punoi për 20 vjet si drejtor e dramaturg. Më 23 mars të vitit 1946, bashkë me të shoqen u përjashtuan nga partia si «elementë antiparti». Më 17 janar 1947 u internuan në Gusmar të Kurveleshit. Pas prishjes me jugosllavët më 1949, iu hoq masa e internimit. I çuan fillimisht në Elbasan dhe më pas në Tiranë. Prej këtu i qarkulluan në Kuçovë. Më 1966 i internuan sërish, bashkë me të bijat, Sashenkën (lindur më 1944) dhe Merin (lindur më 1951). Po atë vit u përjashtuan dhe nga Lidhja e Shkrimtarëve. U rikthyen në Tiranë në vitin 1971 dhe në atë kohë Selfixheja u mbyll në shtëpi, kurse Xhemali punoi për disa kohë në Kinostudjo si administrator. Më vonë u hoq që andej dhe u dërgua në Fermën Bujqësore «Gjergj Dimitrov». Duke qenë të survejuar nga Sigurimi, u mbyllën në shtëpi. Vdiq në vitin 1976 në Tiranë.

Vepra: «Nën okupacion» (dramë), «Përleshja» (dramë), «Dragoi i Dragobisë» (dramë), «Majlinda» (dramë) etj. *Përkthime:* Jean Baptiste Poquelin Molier, «Shkolla e grave» (komedi); Teodor Mushatesku, «Vlasi i Titanikut»; Lope de Vega, «Qeni i kopsharit» etj.

Dashnor Kaloçi, *Si u persekutuan intelektualët, Xhemal e Selfixhe Broja*, në «Gazeta shqiptare», 26 shkurt 2002.

BRUÇAJ Ejëll

Lindi më 16 tetor të vitit 1948, në Kop-



Gjergj (Jorgji) Bubani

lik. Më 19 janar 1989, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor «për agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor», dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 401.

BRUNGAJ Zef

Lindi më 18 tetor të vitit 1923, në Obot të Shkodrës. Më 19 mars 1964, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e dënoi për «agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit popullor» me 7 vjet heqje lirie. Me vendim të Gjykatës së Lartë, më 8 shtator 1967 iu fal dënimi i mbetur.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 30.

BRUSHTULLA (RRASHTULLA) Tomë

Lindi më 12 dhjetor të vitit 1936, në Theth. Më 13 shkurt 1961, Gjykata Ushtarakë e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut», dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë dhe konfiskimin e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 366.

BRUZI Ylli

Lindi më 23 janar të vitit 1950, në Tiranë. Më 13 nëntor 1969, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 187.

BUALI Hafiz Xhefer

Klerik i lartë musliman, kryemyfti i qarkut të Korçës (?-1946).

Lindi në lagjen «Kasaba» të qytetit të Korçës, më 4 janar të vitit 1885. Mësimet e mesme i filloi në medresenë e Korçës dhe i përfundoi në atë të Tiranës. Në vitet '30 u caktua kryemyfti i qarkut të Korçës. Në vitin 1946 u arrestua si antikomunist. Vdiq katër vjet më vonë, më 1950, në kampin e kënetës së Maliqit.

100 personalitete shqiptare të kulturës islame: shekulli XIX-XX, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë, 2012, f. 281.

BUBANI Gjergj (Jorgji)

Publicist, shkrimtar, botues.

Lindi më 15 mars të vitit 1900, në fshatin Boboshticë të Korçës. Studimet e larta i kreu në Akademinë Industriale të Athinës. U shpërngul në Rumani, ku punoi për të përjavshmen kombëtare shqiptare «Shqipëri' e re», të botuar prej studijuesit Ilo Mitkë Qafëzezi (1889-1964). Në janar të vitit 1922 nxorri një periodik me titullin «Dodona», ndërsa në mars 1926 revistën «Zëri shqipëtar», që pati jetë të shkurtër. Punoi edhe si sekretar i kosullatës shqiptare në Konstancë e Sofje. Në Shqipëri u kthye më 1944. U arrestua më 13 nëntor 1944. Ashtu si shumë intelektualë të tjerë, u gjyquan dhe u dënuan në gjyqin e «kriminelëve të luftës», në prill të vitit 1945, pa një mandat arresti. Në aktakuzën e formuluar më 12 shkurt 1945, ai u akuzua «Se asht bërë vegël e propagandës armike (si agjikator, propagandist, dhe publicist) me anë të radios dhe fletoreve. Ka shkruar artikuj për okupatorin dhe kontra luftës së popullit. (Drejtor i Radioemisionit, Drejtor i Radios, redaktor i gazetës «Bashkimi i

Kombit».)» Ndonëse nuk e pranoi akuzën, dhe megjithëse tre dëshmitarët dëshmuar se Gjergj Bubanin e njihnin si simpatizant të lëvizjes qysh në fillimet e saj, ai u dënua me pesëmbëdhjetë vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë së luajtshme e të paluajtshme dhe humbjen e të drejtave civile e politike. Kështu, më 20 nëntor 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tiranës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij të luajtshme. Një tjetër urdhër sekuestrimi u dha edhe gjashtë muaj më vonë, më 8 maj 1946, kësaj radhe nga Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Korçë. Vdiq në burg, më 1954.

Robert Elsie, *Histori e letërsisë shqiptare*, Tiranë-Pejë, 1997, 10.6, f. 325; *Gazeta Zyrtare*, nr. 60, 6 korrik 1946, fq. 8; *Gazeta Zyrtare*, nr. 3, 7 kallnor 1946, f. 13.

BUBEQI Edmond

Lindi më 13 shkurt të vitit 1960, në Durrës. Më 1 dhjetor 1977, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 29.

BUCI Hajredin

Lindi në fshatin Arrëmollë të Lurës. U dënua si «armik i popullit dhe kriminel lufte», i akuzuar se «ka strehue vazhdimisht kriminelat, ka lehtësue punën e tyne, ka sabotue, punët e Pushtetit dhe janë munduar të ngjallin pa kënaqësina». Për këtë aryse, më 13 maj 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Prefekturës së Peshkopisë urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij të patundshme. Gjashtë muaj më vonë, më 1 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Shumbatit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 112, 14 dhjetor 1946, f. 3; *Gazeta Zyrtare*, nr. 13, 18 shkurt 1947, f. 8.

BUCI Sulë

Lindi në fshatin Arrëmollë të Lurës.

U dënua si «armik i popullit (kriminel lufte)», i akuzuar se «ka strehue vazhdimisht kriminelat, ka lehtësue punën e tyne, ka sabotue, punët e Pushtetit dhe janë munduar të ngjallin pa kënaqësina». Për këtë aryse, më 1 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Shumbatit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 13, 18 shkurt 1947, f. 8.

BUÇPAPAJ Ali Ibish

Lindi më 13 gusht të vitit 1932, në fshatin Tpla të Tropojës. Më 21 tetor 1953, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie dhe humbjen e të drejtave për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 115.

BUÇPAPAJ Rexhep

Lindi më 15 maj të vitit 1938, në fshatin Bujan të Tropojës. Më 25 qershor 1963, në bazë të neneve 80/1 dhe 34, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e dënoi me 18 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1979 dhe më 24 gusht të po atij viti, Gjykata e Qarkut të Beratit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 28.

BUDINI Dem

Lindi në fshatin Selishtë të Burrelit. U dënua si «kriminel lufte e armik i popullit». Më 21 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Burrelit urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 19, 27 shkurt 1947, f. 5.

BUDINI Ibrahim

Lindi më 7 shtator të vitit 1928, në Gramsh. Më 18 shkurt 1954, Gjykata Ushta-

rake e Korçës e deklaroi fajtor për «dhënie ndihme të gjithanshme diversantëve» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 430.

BUDO Ihsan

Lindi më 10 dhjetor të vitit 1920, në Gjirokastrë. Më 12 dhjetor 1977, Gjykata e Rrethit të Mirditës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 145.

BUDO Jorgji

U ekzekutua më 30 janar të vitit 1961.

Lista e personave të ekzekutuar për vitin 1961-1962, hartuar nga Dega e Hetuesisë së Drejtorisë së Policisë, Tiranë.

BUHARAJA Vexhi

Shkrimtar, përkthyes, historian, «Mësues i Popullit».

Lindi më 12 maj të vitit 1920, në lagjen «Murat Çelepi» të Beratit. Mësimet fillore i kreu në vendlindje. Vijoi studimet në Medresën e Përgjithshme në Tiranë, ku u diplomua në vitin 1940. Fill pas diplomimit, në moshën 20 vjeçare, u punësua në redaksinë e revistës «Kultura Islame» në Tiranë. Në vitin 1944 u largua nga Tirana, për shkak të rrethanave të vështira të luftës dhe qëndroi në familjen e tij në Berat. Me ardhjen e komunistëve në pushtet, në nëntor 1944, për pak kohë punoi në Berat si referent në Shtëpinë e Kulturës. Në vitin 1946 u burgos, me akuzën e propagandës kundër qeverisë komuniste të Shqipërisë. Pasi doli nga burgu, për të mbijetuar u detyrua të bëjë punë të rënda fizike. Në vitin 1965 u pranua në Sektorin e Historisë së Mesjetës, pranë Institutit të Historisë në Tiranë, ku mbledhi, përktheu në shqip e transkriptoi rreth treqind mbishkrime turko-osmano-arabe. Duke u mbështetur në këtë material, ai shkroi studimin



Vexhi Buharaja

«Mbishkrimet turko-arabe në vendin tonë si dëshmi historike». Ka përkthyer një varg materialesh të periudhës së Rilindjes Kombëtare Shqiptare, siç janë aktet dhe memorandumet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, manifestin «Ujanallem» («Të zgjohemi», 1899), hartuar nga Dervish Hima, letërkëmbimin e tij me dr. Ibrahim Temon (*64 letra*), që përfshihet në vëllimin e tretë (1900-1908) të «Rilindja Kombëtare Shqiptare». Përveç dokumenteve historike, përktheu nga gjuha turke e perse edhe vepra të tjera shkencore dhe letrare, si veprat shkencore të Hoxhë Hasan Tahsinit, dramën «Besa» të Sami Frashërit, «Shahnamenë» e Firdeusit («*Naimi*», Tiranë, 2010), përmbledhjen poetike «Tahajjulat/Ëndërrimet» (Prishtinë, 1972; Tiranë, 2007, 2012) dhe «Katër stinët» (Tiranë, 1995, 2007) të Naim Frashërit, «Gjylistani dhe Bostani» të Saadi Shirazi (Tiranë, 1960; Prishtinë, 1974; Tiranë, 1988, 2003, 2007, 2008). Në vitin 1975 u dëbua edhe nga Instituti i Historisë. Vdiq në Berat, më 5 korrik 1987, në moshën 67 vjeçare.

Më 20 dhjetor 1993 iu dha titulli «Mësues i Popullit» (pas vdekjes), kurse më 6 Korrik 1994 biblioteka e qytetit të Beratit u pagëzua Biblioteka «Vexhi Buharaja». Emrin e tij e mban sot edhe medreseja e qytetit.

100 personalitete shqiptare të kulturës islame: shekulli XIX-XX, Komiteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë, 2012, f. 273-275.

BUHELLI Qamil

Lindi në Elbasan. U deklarua «armik i popullit». Më 16 mars të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Elbasanit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 38, 8 prill 1948, f. 2.

BUHELLI Sabri

Lindi në Elbasan. U deklarua «armik i popullit». Më 31 mars të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Elbasanit vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 43, 26 prill 1948, f. 8.

BUJAJ Gjokë

Lindi më 5 maj të vitit 1944, në fshatin Selcë të Shkodrës. Më 30 mars 1976, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 27.

BUJARI Mehmet

Më 19 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës Qendër Korçë, vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 38, 15 maj 1946, f. 7.

BUJARI Sali

Lindi më 18 dhjetor të vitit 1935, në fshatin Zemblak të Korçës. Më 10 nëntor 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kolonjës urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij. Disa vite më vonë, më 17 nëntor 1955, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «krimet: agjitacion e propagandë dhe pjesëmarrje në organizata antipushtet» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

Gazeta Zyrtare, nr. 120, 31 dhjetor 1946, f. 5; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 181; AISKK, F. 1,

V. 2012, D. 1, Fl. 241.

BUJARI Xhevat

Lindi në vitin 1924, në Korçë. Mbaroi Shkollën Normale të Elbasanit. U arrestua në vitin 1950 dhe u dënua me 15 vjet burg për «agjitacion e propagandë». U lirua në vitin 1958.

BUKA (MIRDITA) Zef

Veprimtar politik, pjesëtar i Rinisë nacionaliste të Ballit Kombëtar, më vonë sekretar i Veprimit Katolik dhe një nga themeluesit e organizatës «Bashkimi Shqiptar».

Lindi në Shkodër, më 1927. Në fillim të qershorit të vitit 1945 u thirr të paraqitet në Degën e Punëve të Brendshme të Shkodrës, ku u porosit të mos përzihej me veprimtari kundër pushtetit popullor. U arrestua në Fushë Arrëz më 12 gusht 1945. Pas dy ditësh në Degën e Pukës, u përçoll për në Shkodër, në burgun e togës. U lirua më 15 gusht, por me detyrim që të paraqitej çdo ditë në orën 12^{oo} para Zoi Themelit. U arrestua sërish mbrëmjen e 25 nëntorit 1945 dhe u dërgua te shtëpia e Çurçisë, ku ishte vendosur Dega e Sigurimit të Shtetit në Shkodër. Më 22 shkurt 1946, Gjykata e Qarkut të Shkodrës e dënoi me burgim të përjetshëm.

Bashkimi Shqiptar!, në «Nji Seminar Papnor në vorbull të përndjekjes komuniste: Shkodër 1945-1946», Shkodër, 2008, f. 86-103; Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë, 2009, I, III, f. 47.



Zef Buka (Mirdita), në gjyq

BUKMISHI Shyqyri

Lindi më 4 shkurt të vitit 1929, në fshatin Sukth të Shijakut. Më 28 maj 1946, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «pjesëmarrje në organizime antipushtet me bashkëpunim» dhe «dhënie ndihmë të arratisurve» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbje të së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 26.

BUKOSHI Hysen

Mësues.

Lindi më 1 janar të vitit 1941, në fshatin Bukosh të Therandës në Kosovë. U arrestua në Prizren, pas arrestimit të Adem Demaçit dhe të disa anëtarëve të organizatës Lëvizja Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve. Dënimin e vuajti në burgun e Nishit. Pas lirimit, më 1969 u arratis në Shqipëri, bashkë me Ali Boletinin, nipin e Isa Boletinit. U emërua mësues në Berat, ku shumë shpejt fitoi prestigj si mësues e nacionalist. Për këtë arsye, u arrestua më 1975 dhe më 27 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Beratit e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë për «agjitacion e propagandë». Një pjesë të dënimit e vuajti në burgun e Ballshit.

Myrteza Bajraktari, *Një vështrim tjetër i historisë*, Tiranë, 2011, III, f. 218; Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 105-106; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 201.

BULÇARI Albert

Lindi më 4 maj të vitit 1948, në Elbasan. Më 27 nëntor 1964, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «tëntativë arratisjeje» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie. U lirua me kusht, më 27 qershor të vitit 1967.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 364.

BULÇARI Hamid

Më 18 shkurt të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Qendres Elbasan, urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 32, 16 prill 1947, f. 5.

BULEJ (BULIQI) Jonuz

Personalitet i shquar i komunitetit musliman shqiptar, pedagog, Drejtor i Përgjithshëm i Medresesë së Tiranës, teolog e përkthyes.

Lindi më 15 mars të vitit 1892, në qytetin e Shkodrës. Studimet teologjike i kreu në Stamboll. Në vitin 1929 u emërua drejtor administrativ në Medresenë e Përgjithshme dhe profesor i saj. Është një nga dy hartuesit e projektstatutit të Komunitetit Musliman Shqiptar, ngarkuar me dekret mëkëmbësor datë 9 qershor 1942. Por ky statut nuk u mor asnjëherë në shqyrtim nga qeveria e kohës dhe kështu Komuniteti Musliman punoi pa statut deri në vitin 1945. Pas luftës punoi si profesor i Medresesë së Përgjithshme të Tiranës, drejtor i brendshëm dhe, pas arrestimit të Hafiz Ismet Dibrës [*shih*], edhe drejtor i përgjithshëm i saj. Kundërshtoi hapur krijimin e organizatës së rinisë popullore në Medresenë e Përgjithshme. U arrestua nga Sigurimi i Shtetit më 19 prill të vitit 1947, së bashku me profesorë të tjerë të kësaj medreseje. Për këtë arsye, Kryesia e Këshillit të Përhershëm të Komunitetit Musliman e pezulloi nga të gjitha detyrat. Mes viteve 1955-1963 vazhdoi veprimtarinë pedagogjike, si mësues në shkollat e ciklit 7 vjeçar. Vdiq në maj të vitit 1966.

AQSh, *Komuniteti Mysliman*, F. 482, D. 3, viti 1945; Po aty, D. 6, viti 1947; Po aty, D. 2, viti 1949; *Dhe mban emrin shkollë...*, në gazetën «17 Nandori», dt. 23. 12. 1946; *100 personalitete shqiptare të kulturës islame: shekulli XIX-XX*, Tiranë, 2012, f. 117-119.

BULGARECI Bexhet

U kap, bashkë me të vëllanë, Xhevdetin, nga çeta komuniste e kryesuar nga Agush Gjergjevica, i cili u preu hundët, veshët e organet gjenitale, u nxorri sytë dhe u theu krahet.

BULGARECI Motër Gjerogjina

Jorgjie Bulgareci lindi më 22 prill të vitit 1928, në një familje ortodokse nga Ko-

rça. Që e vogël mbeti jetime, ndaj motra e madhe e dërgoi në Shkollën e Stigmatineve në Shkodër. Aty, e frymëzuar nga shebulli i Motrës Muzhani, u regjistrua në Urdhërin Rregulltar të Motrave Stigmatine. Kur u mbyll shkolla dhe u shpërnda kuvendi i murgeshave, në mars 1946, ajo u kthye në Korçë, po pa kaluar shumë kohë u arrestua dhe u dënua me pesë vjet heqje lirie «për agjitacion e propagandë». Pas lirimit, u strehua në Kishën Françeskane të Tiranës, ku u shërbeu deri në vdekje shumë fretërve pleq edhe pas mbylljes së kishave më 1967.

At Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue: Robnia e gjatë*, Pjesa e tretë: 1967-1989, Tiranë, 2000, f. 354-355; .

BULKU Ali

Lindi më 8 qeshor të vitit 1947, në Tiranë. U arrestua më 23 qershor 1977 dhe pesë muaj më vonë, më 24 nëntor të po atij viti, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie. U lirua më 15 nëntor 1982.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 331.

BULKU Haki

Lindi më 15 janar të vitit 1942, në Tiranë. Më 8 janar 1963, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 12 vjet e 6 muaj heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 24.

BULKU Rexhep

Lindi më 30 tetor të vitit 1928, në Peshkopi. Më 10 shtator 1951, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «krime kundër shtetit» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 266.

BULLMO (BULLMA) Spiro

Lindi më 10 nëntor të vitit 1931, në



Imzot Luigj Bumçi

fshatin Mursi të Sarandës. Më 2 korrik 1960, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «krimet e agjitacionit e propagandës dhe për tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 17 vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë. U lirua më 29 korrik 1972 për plotësim afati.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 260.

BUMBLI Sotiraq

Lindi më 1 prill të vitit 1931, në Berat. Më 22 nëntor 1955, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «tentativë për kalim kufiri në mënyrë të paligjshme», dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie. U lirua me amnisti, më 27 nëntor 1957.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 398.

BUMÇI Imzot Luigj

Klerik i lartë katolik, Ipeshkëv i Dioqezës së Lezhës, kryetar i komisionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris, kryetar i Këshillit të Lartë të dalë nga Kongresi i Lushnjës, nip i Pashko Vasës.

Lindi në Shkodër, më 6 nëntor të vitit 1872. Mësimet e para i mori në shkollën e jezuitëve. Kreu Seminarin Papnor në Shkodër. Mësimet e larta i kreu në Itali, ku më 3 maj 1903 u shugurua meshtar. Më 18 shtator 1911 u zgjodh Ipeshkëv i Dioqezës

së Lezhës: u shugurua më 10 dhjetor të të njëjtit vit nga Imzot Jak Serreqi në Katedralen e Shkodrës. Ishte pjesëtar, dhe më vonë kryetar i delegacionit shqiptar në Konferencën e Paqes në Paris. Në kthim, Imzot Bumçi dhe sekretari i tij, Atë Gjegj Fishta, u ndalën në Romë, ku takuan Atin e Shenjtë, Papa Benediktin XV, i cili u premtoi se do të ndërmjetësonte pranë bashkësisë ndërkombëtare për fatet e Shqipërisë. Në Kongresin e Lushnjës u zgjodh në krye të Këshillit të Lartë. Më 1921 u urdhërua nga Vatikani që të mos merrej me politikë, por vetëm me baritjen e Dioqezës së tij. Por në dhjetor të po këtij viti, ai mori pjesë, bashkë me Aqif Pashë Elbasanin, në grushtin e shtetit kundër Kryeministrit Pandeli Vangjeli. Për këtë arsye, Parlamenti e shkarkoi nga posti i kryetarit të Këshillit të Lartë dhe mes viteve 1922-1924 u dëbua. Pas shumë lajmërimesh nga ana e Delegatit Apostolik, më 1944 iu hoq detyra e Ipeshkvit. Që në muajt e fundit të vitit 1944 iu nënshtrua pyetjeve dhe hetimit. I dërmuar nga seancat hetimore, vdiq më 1 mars të vitit 1945 në selinë e ipeshkvisë së tij, në Kallmet të Lezhës.

Dr. Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë, 2007, vol. I, II, f. 366-367; Markus W. E. Peters, *Përballjet e historisë së Kishës Katolike në Shqipëri 1919-1996*, Shkodër, 2010, 5, f. 281.

BUMÇI Stefan

Ushtarak, veprimtar politik.

Lindi në Shkodër, në vitin 1913. Kreu Akademinë Ushtarake në Itali. Deri në vitin 1944 shërbeu në rradhët e Ushtrisë Kombëtare. U arrestua në fillim të vitit 1946 si anëtar i opozitës së parë, «Bashkimit Demokrat», dhe u dënua me 20 vjet heqje lirie. U lirua më 1962.

BUMÇI Shkëlqim

Inxhinier ndërtimi.

Lindi më 7 dhjetor të vitit 1934, në Tiranë. Më 1950 u diplomua gjeometër në Politeknikumin «7 Nëntori». Mes viteve 1950-1954 kreu Fakultetin e Inxhinierisë së Ndërtimit. Në vitet 1963-1966 kreu

funksionet e kryeinxhinierit në Ndërmarrjen e Ndërtimeve Industriale në Laç. Dy vitet në vazhdim punoi si kryeinxhinier në Ndërmarrjen e Ndërtimit të Hekurudhës Rrogozhinë-Fier, kurse nga 1968 deri më 1971 si drejtor i Ndërmarrjes së Ndërtimit të Hekurudhës Elbasan-Përrenjas. Në vitet 1971-1975 u caktua kryeinxhinier në Drejtorinë e Përgjithshme të Ndërtim-Montimit në Kombinatin Metalurgjik në Elbasan. Në dhjetor 1975 u shkarkua nga të gjitha funksionet dhe u arrestua «për veprimtari armiqësore për krimin e sabotimit». U dënua me 20 vjet heqje lirie, por u lirua pas dhjetë vjetësh me dekret të Presidiumit Popullor. Pas liritimit dhe deri në vitin 1991 punoi në Ndërmarrjen e Ndërtimit «21 Dhjetori».

H. Gonxhja, I. Gogaj, Sh. Bumçi, *Ndihmesa e ish nxënësve dhe mësuesve të Shkollës Teknike të Tiranës për zhvillimin e vendit dhe luftën për çlirim e demokraci*, Tiranë, 2006, VI, f. 237-238.

BUNAJ Gjin

Lindi në fshatin Prosek të Mirditës. U deklarua «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 20 shtator të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Mirditës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 104, 16 dhjetor 1947, fq. 6.

BUNAJ Pal

Lindi më 18 nëntor të vitit 1928, në fshatin Ujë të Mirditës. U arrestua më 10 gusht 1949, por më 12 shtator 1955, Gjykata e Lartë Ushtarake e shpalli të pafajshëm për mungesë provash ligjore bindëse dhe urdhëroi lirim të menjëhershëm të tij «në mos qoftë i penguar për ndonjë çështje tjetër».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 447.

BUNATI Abdulla

Lindi në Peqin. Më 5 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Peqinit urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 55, 24 qeshor 1946, fq. 6.

BUNGO Makensen

Lindi më 14 prill të vitit 1926, në Elbasan. Kreu shkollën Normale të këtij qyteti dhe Institutin e Lartë Pedagogjik, Fakultetin Gjuhë-Letërsi. U arrestua në vitin 1946 dhe më 12 tetor të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor për «krime kundër shtetit» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie, humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë dhe konfiskimin e pasurisë. Dhe më 26 shkurt të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Qendrës Elbasan urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. U lirua në vitin 1950.

Vepra: «Këneta e vdekjes» (roman, 1996), «Abaz Kupi» (monografi, 2001), «Nëna Kosovare» (poemë, 2003), «Gruaja me të zeza» (tregime, 2008); «Rrugëtim me psherëtim» (roman, 2009).

Gazeta Zyrtare, nr. 28, 29 mars 1947, f. 8; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 228.

BUNGURI Dali

Lindi më 17 gusht të vitit 1918, në fshatin Grevë të Peshkopisë. U dënua nga Gjykata Ushtarake si «sabotator i Pushtetit». Në bazë të këtij vendimi, më 19 dhjetor 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Qendrës Peshkopi urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 22, 8 mars 1947, f. 5; *Gazeta Zyrtare*, nr. 25, 18 mars 1947, f. 2.

BURGAJ Ahmet

Lindi më 10 maj të vitit 1930, fshatin Kurtaj të Koplikut. Më 27 nëntor 1953, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë. U lirua më 10 mars 1961.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 245.

BURGAJ Islam

Lindi më 1 janar të vitit 1925, në fsha-

tin Kurtaj të Shkodrës. Më 18 korrik 1953, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje dhe bashkëpunim me diversantët», dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 5 gusht të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 405.

BURIMI Lako

Lindi në fshatin Psar i Zi të Kolonjës. U dënua me vdekje nga Gjykata Ushtarake si një prej organizatorëve kryesorë të Ballit Kombëtar në Kolonjë. Më 5 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Kolonjës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 21, 29 mars 1946, f. 6.

BURIMI Luan

Lindi më 28 prill të vitit 1937, në fshatin Psar i Zi të Kolonjës. Më 2 qershor 1969, Gjykata e Fierit e dënoi me 12 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë». Gjatë revoltës së të burgosurve të Spaçit (21-23 maj 1973), ngriti flamurin kombëtar pa yllin komunist. Një ditë pas shtypjes së revoltës, më 24 maj 1973, Gjykata e Lartë e dënoi edhe me 25 vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë si «pjesëmarrës në organizatë kundër pushtetit popullor» dhe «agjitacion e propagandë».

Vepra: «Mallkuar qofshin të liqtë» (poezi, poemë, tregim; Tiranë, 1996), «Përtëritje» (poezi; Tiranë, 1994), «Klithma shpirti», (poezi, tregime dhe novela; Tiranë, 2010).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 292.

BURIMI Qemal

Veprimtar politik.

Lindi në fshatin Psar i Zi të Kolonjës. U dënua me vdekje nga Gjykata Ushtarake si një prej organizatorëve kryesorë të Ballit Kombëtar në Kolonjë. Më 5 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç.



Ahmet Bushati

të Nënprefekturës së Kolonjës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 21, 29 mars 1946, f. 6.

BUSHAJ Bejto

Lindi në vitin 1927, në Smokthinë. Më 2 maj 1947, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor se «ka strehuar dhe furnizuar të arratisurit, kriminela lufte dhe armiq të popullit» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie, punë të detyrueshme dhe humbjen e të drejtave qytetare e civile për 1 vit kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 435.

BUSHATI Ahmet

Lindi në Shkodër, më 25 mars të vitit 1929. Ishte anëtar i organizatës antikomuniste të studentëve shkodranë «Përpyjekja Shqiptare». U arrestua më 20 janar të vitit 1948, një ditë pasi e kishin përjashtuar nga «Organizata e Rinisë». Më 24 qershor 1949, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 7 vjet heqje lirie, punë të detyruar dhe heqjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë për «krime kundër shtetit». U lirua më 23 shtator 1954 për plotësim afati. Pas burgut punoi si punëtor krahu dhe më vonë si teknik në Krujë. Kreu me korrespondencë fakultetin në degën Gjuhë-Letërsi. Në vi-

tin 1991 u kthye në Shkodër. Nga viti 1992 deri më 1996 ishte kryetar i Këshillit Bashkiak të Shkodrës.

Vepra: «Në gjurmët e një ditari: Shkodra në tri vitet e saj të parë nën komunizëm: Në Sigurim ndër burgje e kampe» (kujtime, 2001; ribotimi i plotësuar «Në gjurmët e një ditari: Shkodra në vitet e para nën komunizëm», doli më 2007).

Ahmet Bushati, *Në gjurmët e një ditari: Shkodra në vitet e para nën komunizëm*, Shkodër, 2007; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 218.

BUSHATI Haki

Lindi më 8 tetor të vitit 1898, në Shkodër. Shkollën e mesme e kreu në Stamboll. Më 1945 i pushkatuan të vëllanë, Maliq Bushatin [*shih*]. Po këtë vit u arrestua dhe ai. Më 30 qeshor 1945, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit të Prefekturës së Shkodrës, urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij të patundshme. U lirua më 1946, por pesë vjet më vonë, më 1951, u arrestua sërish. U lirua më 1960.

Gazeta Zyrtare, nr. 106, 21 nëntor 1946, f. 5.

BUSHATI Hamdi

Historian, etnograf, personalitet i shquar i arsimit shqiptar.

Lindi në vitin 1896, në qytetin e Shkodrës. Mbaroi shkollën ushtarake të qytetit



Hamdi Bushati



Gjyqi kundër Lef Nosit, At Anton Harapit dhe Maliq Bushatit (i treti nga e majta)

(Mejtepin Ruzhdije Asqerie). U regjistrua në gjimnazin civil, por me të shpërthyer Luftërat Ballkanike, i ndërpreu mësimet. Gjatë viteve 1914-16 ndoqi një kurs të hapur nga Italia. Vazhdoi shkollën tregtare derisa u mbyll e më pas Kolegjin Saverian. Në vitin 1917 ndoqi kursin e shkurtër pedagogjik për përgatitjen e mësuesve, që drejtohej nga Gaspër Beltoja. Dhe kështu, në moshën 21 vjeçare filloi karrierën e mësuesisë. Në vitet 1920-1921 doli vullnetar në Luftën e Koplikut, ku shërbeu si sekretar i dytë pranë shtabit kryesor. Në vitin shkollor 1926-1927 u emërua drejtor i shkollës së Perashit. Tre vjet më vonë dha dorëheqjen dhe, deri më 1945, iu rikthye mësimdhënies. U burgos më 1945, por shumë shpejt u la i lirë si i pafajshëm. Më 1950 u largua nga arsimit dhe u shtrëngua të punojë si punëtor krahu. Vitete 1954-1960 i kaloi në internim. Vdiq në Shkodër më 1983. Ka dhënë një kontribut të shquar si mësues, historian, etnograf e përkthyes. Në organet e shtypit të kohës botoi artikuj e studime të rëndësishme, si «Gjenealogjia e Bushatllinjve», «Lufta e Miletit» etj., që

u përfshinë më pas në kryeveprën e tij, «Shkodra dhe motet». Si përkthyes, përveç dokumenteve të shumta në turqisht dhe mbishkrimeve të ndryshme mbi objektet e kultit, përktheu dhe: «Fjalorin historik» dhe «Fjalorin etnografik» nga «Enciklopedia» e Sami Frashërit, «Psikologjinë» e Hasan Tahsinit, «Xhibali» të J. Davvenportit, «Mbrojta e Shkodrës» të Nazif-Karamentinit etj.

Dr. Njazi Kazazi, Mentor Quku, *Dy fjalë*, në «Shkodra dhe motet», Shkodër, 1998.

BUSHATI Dom Jak

Klerik katolik.

Lindi në Shkodër, më 8 gusht të vitit 1890. Mësimet e para i mori në shkollën françeskane, kurse të mesmet në Seminarin Papnor të Shkodrës. U shugurua meshtar më 30 maj 1915 në Kishën e Seminarit. Për 26 vjet shërbeu si meshtar në Abacinë e Mirditës. Më 1946 u transferua në Kallmet të Zadrimës. U arrestua në prill të vitit 1949, me akuzën se «Në kishën e tij është organizuar mbledhja e organizatorëve të revoltës së Kallmetit, me synim

rrëzimin e Pushtetit Popullor». Pas shumë torturash, vdiq në hetuesinë e Lezhës, më 12 shtator 1949, para se të dilte në gjyq. Trupi i tij i pajetë u hodh në një kënetë në afërsi të qytetit të Lezhës.

Dr. Pjetër Pepa, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri*, Tiranë, 2007, Vol. II, f. 179-181; Pjetër Pepa, *Të mbyturit ndër tortura*, në «55», 27 dhjetor 2005, f. 6; Stephen Schwartz, *Broken Promises*, në «First Things», The Institute on Religion and Public Life, New York, April 2006.

BUSHATI Atë Luigj

Klerik katolik, Guardijan i Kuvendit të Rubigut (1906), firmëtar i Memorandumit të Kuvendit të Greçes.


Kreu Kolegjin e Fretërve Observantë në Bajzë të Kastratit (1883-1887). Novicijatin e filloi në Itali më 23 gusht të vitit 1886. U kthye në atdhe më 1892. Pas dekretit të 6 majit të vitit 1906 të Gjeneralit të Françeskanëve, të Përndertit At Dionis Schuler, që e shndërroi Misionin Françeskan të Shqipërisë në Provincë Misionare, u caktua Guardijan në Kuvend të Rubigut. Gjatë kohës që shërbente si famullitar në fshatin Traboin të Malësisë së Madhe (1910-1911), u vu në krye të kryengritjes antiosmane. Emri i tij është ndër 34 firmëtarët e Memorandumit të Kuvendit të Greçes (10-23 qershor 1911). U pushkatua.

P. Donat Kurti, *Provinca Françeskane Shqiptare (E ripërtrime në vj. 1906)*, Shkodër, III, VIII, X, XI, XVI; Imzot Zef Simoni, *Persekutimi i Kishës Katolike në Shqipëri nga 1944-1990*, në «Krishtërimi ndër shqiptarë», Shkodër, 2000.

BUSHATI Maliq

Veprimtar politik, deputet (1921-1923; 1925-1936), Ministër i Punëve të Brendshme (prill 1939), Kryeministër i Shqipërisë (12 shkurt-12 maj 1943).

Lindi në Shkodër, më 8 shkurt të vitit 1890. Shkollën fillore e kreu në vendlindjen. Më 1910 filloi studimet në kolegjin e Stambollit. U kthye në Shkodër në fund të vitit 1911, ku së bashku me Riza Danin [shih] u përpoq për bashkimin e rrymave të ndryshme fetare. Në periudhën 1916-



Atë Luigj Bushati

1918 ishte anëtar i këshillit bashkiak të Shkodrës. Gjatë kësaj kohe botoi gazetën «Populli». Në vitin 1920 u mobilizua vullnetarisht në njësitë e drejtuara nga Sylço beg Bushati [shih] për mbrojtjen e Koplikut nga forcat ushtarake serbe. Në periudhën 1921-1923 u zgjodh deputet i Shkodrës. U rizgjodh sërish më 1925 e që prej këtij viti do të rizgjidhej në çdo legjislaturë, deri në vitin 1936. Në prill të vitit 1939, në qeverinë «Vërlaci-2», u caktua në postin e Ministrit të Brendshëm. Kabineti qeveritar i kryesuar prej tij u dekretua më 12 shkurt të vitit 1943. Më 12 maj 1943 paraqiti dorëheqjen nga detyra e kryetarit të Këshillit të Ministrave. Më 30 qeshor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit të Prefekturës së Shkodrës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij. U arrestua pak muaj më vonë, më 3 dhjetor 1945, nga të ashtuquajturat forca të «Mbrojtjes së Popullit». U gjykua bashkë me Lef Nosin [shih] dhe At Anton Harapin [shih]. Në krye të njëzetënjë ditëve, më 12 shkurt 1946, Gjykata e Lartë Ushtarake vendosi: «Ndëshkimin e fajtorëve me vdekje, humbjen e të drejtave të tyre qytetare e politike dhe konfiskimin e pasurisë të luajtshme e të paluajtshme». U pushkatua më 20 shkurt 1946. Ende sa pa mbaruar gjyqi, më 15 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Durrësit urdhëroi sekuestrimin e



Qazim Bushati

gjithë pasurisë së tij.

Hilë Lushaku, *Ministrat e Brendshëm 1912-2007*, vol. 1, Tiranë, 2009, vol. 1, 24, f. 364-391; *Gazeta Zyrtare*, nr. 30, 26 prill 1946, f. 2; *Gazeta Zyrtare*, nr. 106, 21 nëntor 1946, f. 5.

BUSHATI Myfid Myrto

Jurist, veprimtar politik.

Lindi më 1 tetor të vitit 1920, në Shkodër. Studimet e larta për Drejtësi i kreu në Bolonjë. Mori pjesë në organizatën Balli Kombëtar. U arrestua në vitin 1945 dhe u dënua me 30 vjet burg si «Armik i Popullit». U lirua më 1954.

BUSHATI Myfit Qamil

Lindi më 29 shkurt të vitit 1928, në Shkodër. Ishte anëtar i organizatës antikomuniste të rinisë studentore shkodrane «Bashkimi Shqiptar». U arrestua në vitin 1946. Më 22 shkurt të të njëjtit vit, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Shkodrës e dënoi për «krime kundër shtetit» me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. U lirua në vitin 1953.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 23.

BUSHATI Qazim

Lindi në Shkodër. Më 25 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit N. Ç. të Nënprefekturës së Malësisë së Madhe vendosi sekuestrimin e gjithë pasurisë së

tij, të luajtshme dhe të paluajtshme. Katër muaj më vonë, më 19 shtator 1946, po ky Komitet urdhëroi edhe një herë sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 63, 15 korrik 1946, fq. 6; *Gazeta Zyrtare*, nr. 116, 26 dhjetor 1946, f. 5.

BUSHATI Sylço beg

Veprimtar politik, anëtar i komisionit administrativ të Shkodrës (1914-1915), zv. prefekt i saj.

Lindi në Shkodër. Në vitin 1913 kun-dërshtoi Esat Pashë Toptnin për dorëzimin e Shkodrës. Në vite 1914-1915 u zgjodh anëtar i komisionit administrativ të Shkodrës. Gjatë kohës së Mbretërisë shërbeu si zëvendësprefekt dhe si drejtues i xhandarmërisë. Mori pjesë si drejtues në Luftën Koplikut. Pas dështimit të konferencës së Mukjes, u rreshtua në radhët e Bllokut Independent. Me largimin e gjermanëve u fsheh dhe refuzoi të largohet nga Shqipëria. Duke e ditur se komunistët do të ndëshkonin këdo që do ta strehonte, Sylço Begu u largua drejt rrënojave të ish shtëpisë së vëllait së tij, ku nuk shkelte më njeri. Aty u kap nga komunistët. U pushkatua bashkë me Dom Lazër Shantojën [shih], më 21 shkurt të vitit 1945 në Tiranë.



Sylço beg Bushati (me kostum kombëtar) dhe Maliq Bushati



Burgu i Vlorës, 1993

Më 25 prill 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit N. Ç. të Nënprefekturës së Malësisë së Madhe vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij të paluajtshme. Një vit e gjysmë më vonë, më 11 korrik të vitit 1946, po ky Komitet përsëriti urdhërin për sekuestrimin e pasurisë së tij, por tashmë edhe asaj të luajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 94, 7 tetor 1946, f. 2; *Gazeta Zyrtare*, nr. 63, 15 korrik 1946, fq. 7.

BUSHGJOKA Lulash

Lindi më 11 maj të vitit 1958, në Tropojë. Më 10 prill 1979, Gjykata e Qarkut të Kukësit e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar) dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 22.

BUSHGJOKA Zef

Lindi më 1 mars të vitit 1953, në fshatin Betoshe të Tropojës. Më 10 prill 1979, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Kukësit e

deklaroi fajtor për «krimin e arratisjes nge-lur në tentativë» dhe e dënoi me 13 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 346.

BUSHGJOKAJ Lush

Lindi më 20 tetor të vitit 1955, në fshatin Betosh të Tropojës. Më 10 prill 1979, Gjykata e Rrethit të Kukësit e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut, nge-lur në fazën e përgatitjes», dhe e dënoi me 11 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 365.

BUSHI Sedih

Lindi në fshatin Gjaçej të Mirditës. U deklarua «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 20 shtator 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Mirditës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 105, 18 dhjetor 1947, fq. 7.

BUSHI Stavro

Lindi më 11 prill të vitit 1932, në Sarandë. Më 21 gusht 1976, Gjykata e Rrethit të Sarandës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut me anë spiunazhi» dhe e dënoi me 13 vjet heqje lirie dhe me humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 350.

BUSHI Thoma

Lindi më 19 prill të vitit 1933, në Berat. Më 13 shkurt 1965, Gjykata e Qarkut Vlorë-Berat e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 146.

BUTKA Fetah

Nacionalist, biri i atdhetarit Selman Butka.

Lindi më 10 mars të vitit 1903 në fshatin Butkë të Kolonjës. Fillimisht zjarrist, tok me Anastas Lulën [*shih*] dhe Andrea Varfin [*shih*], mandej ballist, komandant kompanie i batalianit «Safet Butka». U arrestua në fund të vitit 1944 dhe më 19 nëntor 1945 Gjykata Ushtarake e Kolonjës e dënoi me vdekje, që iu kthye më burgim të përjetshëm e, përfundimisht me 20 vjet heqje lirie, me akuzën «Ka bërë krime kundër Luftës NÇ». Më 4 shtator 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Kolonjës vendosi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. Dënimin e kreu në burgun e Burrelit e atë të Tiranës. Në vitin 1956 u lirua, po menjëherë u internua në Kuç të Vlorës. Familja e tij ishte internuar që më parë në disa kampe internimi.

Arkivi i MB, Gjykata Ushtarake e Kolonjës, vendimi nr. 6, dt. 19. 11. 1945; Ministria e Drejtësisë, Regjistri i Gjendjes Gjyqësore, v. 1945; *Gazeta Zyrtare*, nr. 3, 5 janar 1948, f. 2.

BUTKA Ibrahim

Lindi në fshatin Butkë të Kolonjës, në

vitin 1878. U arrestua më 13 gusht 1946 dhe u dënua me 7 vjet burg, punë të detyruar, konfiskim të pasurisë së tundshme e të patundshme dhe humbjen e të drejtave civile, me akuzën: «Ka inspiruar dhe ndihmuar bijtë e tij për t'u arratisur; ka pasur lidhje me elementë të pakënaqur dhe reaksionarë, ka ushqyer dhe përhapur parulla të reaksionit në dëm të popullit dhe të pushtetit». Dënimin e kreu në kampin e përqëndrimit në Vloçisht, ku, për shkak të moshës dhe torurave, e lanë fuqitë dhe gardianët urdhëruan që mbi të kalonte karroca me dhé, kështu që Ibrahim përfundoi në barkun e kënetës. Bijtë e tij, Sami Butka dhe Petrit Butka, u arratisën për motive politike në vitin 1945. Petriti zbriti dy herë në Kolonjë dhe Shkodër si desant nga Malta, për të rrëzuar pushtetin komunist. Djali tjetër, Xhaferr Butka [*shih*], u arrestua dhe u dënua me vdekje, që iu kthye në dënim të përjetshëm. Familja e Ibrahim Butkës u internua në Krujë dhe kampe të tjerë internimi.

Ministria e Rendit, Dega e Arkivit, nr. 2590/1; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nr. 404.

BUTKA Safet

I biri i atdhetarit Sali Butka, profesor, nationalist, kundërshtar i komunizmit.

Lindi në Butkë të Kolonjës, më 10



Safet Butka



Kampi i internimit në Plug të Lushnjës (foto: Lekë Previzi)

gusht të vitit 1901. Studimet e mesme dhe ato universitare i kreu në Linz e Graz të Austrisë, ku u diplomua për filozofi (1928). Atje botoi studimin e tij të parë «Naim Frashëri, jeta dhe veprat», 1925. Pas kthimit në atdhe, u caktua profesor në Liceun e Korçës, shkollën Tregtare të Vlorës, drejtor i shkollës Normale të Gjirokastrës, inspektor në Ministrinë e Arsimit dhe drejtor i Liceut shtetëror të Tiranës (1929-1939). Udhëhoqi demonstratat e para antifashiste të studentëve dhe qytetarëve të Tiranës (3-6 prill 1939). Nuk pranoi të nderonte alla-fashiste dhe, si drejtor i Liceut, frymëzoi edhe pedagogët e nxënësit të mos nderonin pushtuesit. U burgos dhe u internua nga italianët në ishullin Ventotene (1939-1942). Nacionalist, luftëtar i lirisë dhe i çlirimit kombëtar, komandant i çetave të Ballit Kombëtar në qarkun e Korçës (1942-1943). Zhvilloi disa beteja kundër pushtuesve italianë: në Floq, janar 1943; Poceshtë, shtator 1943 etj., dhe kundër gjermanëve: Barmash, gusht 1943, në bashkëpunim me Misionin Britanik në Shqipëri. Nismëtar dhe veprimtar i bashkimit të të gjithë shqiptarëve në luftë për një shqipëri të

lirë, etnike dhe demokratike. Pas prishjes së Marrëveshjes së Mukjes, menjëherë sa kishte përfunduar një betejë kundër italianëve në Poceshtë, u rrethua nga forcat komuniste në Melçan dhe, për të mos shkaktuar luftën vëllavrasëse, por edhe për të mos rënë në duar të tyre, u vëtëflijua më 19 shtator 1943.

Është dekoruar me medaljen «Martir i Demokracisë» dhe titullin më të lartë «Urdhëri i Flamurit Kombëtar».

AQSH, Fondi «Safet Butka»; Iljaz Gogaj, «Punëtorë të shquar të shkollës shqiptare», «Euro-rilindja» dhe «Shtëpia e Librit», Tiranë, 2001; Uran Butka (Përg. e red.), «Safet Butka», «Maluka», Tiranë, 2003.

BUTKA Xhaferr

Nacionalist, komisar i një kompanie të Ballit Kombëtar në Kolonjë.

Lindi më 5 tetor të vitit 1918, në fshatin Butkë të Kolonjës. U arrestua më 26 shtator 1944 dhe më 1945, Gjykata Ushtarake e Kolonjës e dënoi me vdekje, me akuzën «kriminel luftime» dhe «armik i pushtetit popullor», dënim që iu kthye në burgim të përjetshëm. Dënimin e kreu në burgun e

Burrelit, ku u shqua si një nga qëndrestarët e pathyeshëm të këtij burgu famëkeq. Pas lirit, u arratis në Greqi, ku u burgos për disa vjet. Më vonë emigroi në SHBA.

AQSH, F. 14/AP, D. 620, fl. 22, V. 1949; Ministria e Drejtësisë, Regjistri i Gjendjes Gjyqësore, nr. 11080.

BUZI Hekuran

Lindi në fshatin Kallm Maliq të Lushnjës. U pushkatua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 21 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Lushnjës vendosi sekuestrimin e pasurisë së tij të luajtshme. Të njëjtin vendim mori më 2 tetor të po atij viti edhe Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Beratit.

Gazeta Zyrtare, nr. 14, 20 shkurt 1947, f. 7-8; *Gazeta Zyrtare*, nr. 108, 24 dhjetor 1947, fq. 8.

BUZO Ridvan

Lindi më 10 qeshor të vitit 1939, në Berat. Më 12 nëntor të vitit 1973, Gjykata e Qarkut të Beratit e deklaroi fajtor për «kriminelin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 21.

BUZOPULLO Odhisea

Lindi më 17 qershor të vitit 1959, në Kriomes të Greqisë. Më 17 nëntor 1979, Gjykata e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «kriminelin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 251.

BUZUQI Thoma

Lindi më 7 mars të vitit 1907, fshatin Mursi të Konispolit. Më 16 korrik të vitit 1946, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e dënoi si «armik të popullit dhe sabotator të pushtetit». Më 30 dhjetor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Konispolit urdhëroi

sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme dhe të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 8, 4 shkurt 1947, f. 6.

BUZUKA Panajot

Lindi më 5 gusht të vitit 1932, në fshatin Velahovë të Delvinës. Më 26 maj 1958, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe «përhapje të sekretit shtetror» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 438.

BYBERI (ZYBERI) Idriz

Lindi më 1 prill të vitit 1958, në fshatin Shoshan të Tropojës. Më 10 qershor 1979, Gjykata e Qarkut të Kukësit e deklaroi fajtor për «kriminelin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 20.

BYKETA Pajtim

Lindi më 1 qeshor të vitit 1972, në Lezhë. U arrestua më 2 tetor 1990, dhe më 9 nëntor të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Shkëmborës e deklaroi fajtor «për kalim të paligjshëm kufiri mbetur në tentativë dhe të kryer në bashkëpunim» dhe e dënoi me 10 muaj heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 449.

BYLO Idris

Lindi në Fier. U dënua si «kriminel lufte». Më 14 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Fierit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 51, 12 qeshor 1946, fq. 4.

BYLYKBASHI Gëzim

Lindi më 20 tetor të vitit 1940, në fshatin Pilur të Devollit. Më 10 shkurt 1959, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «kriminelin e tentativës për arratisje



Burgu i Qafë Barit

jashtë shtetit për në Greqi» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, me konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 12 mars të vitit 1959.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 362.

BYLYKBASHI Medi

Lindi më 2 tetor të vitit 1935, në fshatin Pilur të Devollit. Më 26 gusht 1954, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «pjesëmarrje në grup me qëllim arratisjeje» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë. U lirua më 15 tetor 1961. U arrestua sërish më 1980, dhe më 24 mars të po atij viti, Gjykata e Rrethit të

Lushnjës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër shtetit dhe R.P.S. të Shqipërisë» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe 5 vjet internim. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 19 prill 1980.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 431.

BYLYKBASHI Njazi

Lindi më 9 gusht të vitit 1933, në fshatin Pilur të Devollit. Më 17 shtator 1952, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1972, dhe më 12 prill të po atij viti, Gjykata e Lushnjës e dënoi me 10 vjet heqje

lirie për «agjitacion e propagandë». Mori pjesë në revoltën e Spaçit të 21-23 majit të vitit 1973, ndaj dhe më 13 korrik të po atij viti, Gjykata e Mirditës e ridënoi me 13 vjet burg, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë, si pjesëmarrës në «organizatë kundër pushtetit popullor për të kryer krimin e sabotimit ekonomik, krimin e agjitacionit dhe propagandës dhe krimin e terrorit».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 222; *Dokumenti i Sigurimit: Si e shtypëm revoltën e Qafëbarit*, në Gazetën «Panorama», 5 tetor 2009.

BYLYKBASHI Ramazan

U dënua si «armik i popullit». Për këtë arsye, më 4 tetor të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nën-prefekturës së Qendrës Elbasan urdhëroi sekuestrimin e ¼ -tës së pasurisë së tij të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 42, 8 maj 1947, f. 1.

BYLYKU Agim

Lindi më 2 qeshor të vitit 1937, në Tiranë. Më 15 maj 1982, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie, humbjen e së drejtës elektorale dhe heqjen e medaljeve të punës dhe të shërbimit ushtarak.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 368.

BYLYKU Daut

Lindi më 3 nëntor të vitit 1930, në Tiranë. Më 7 gusht 1952, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «tentativë arratisje» dhe e dënoi me 5 vjet burg. U arrestua sërish më 1958, dhe më 19 korrik të po atij viti, Gjykata e Qarkut të Tiranës e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 1 vit kohë. Vdiq në vitin 2012.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 19.

CACA Mark

Anëtar i organizatës studentore anti-komuniste «Përpjekja Shqiptare», që u krijua në Gjimnazin e Shkodrës në tetor të vitit 1947. U vra në gusht të vitit 1948, bashkë me Bardhosh Danin [*shih*], kreun e organizatës, dhe Brahim Dërgutin [*shih*], kur po përpiqeshin të kalonin kufirin.

Ahmet Bushati, *Në gjurmët e nji ditari: Shkodra në vitet e para nën komunizëm*, Shkodër, 2007, f. 227.

CACO Irfan

Lindi më 3 tetor të vitit 1893, në fshatin Psar të Kolonjës. U dënua nga Gjykata Ushtarake. Për këtë arsye, më 29 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 46, 19 maj 1947, f. 5.

CACO Teki

Lindi në fshatin Psar të Kolonjës. Më 13 maj të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Kolonjës urdhëroi konfiskimin e pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 54, 20 qeshor 1946, fq. 1.

CAFI Manush

Një ndër prijësit e Kryengritjes së Postribës (9 shtator 1946). Lindi në fshatin Mes. Ishte një nga krerët që u priu postribasve në luftën e Koplikut (1920) dhe gjatë rezistencës antifashiste më 1939.

Gazeta «Shekulli», qershor 2007.

CAKA Andrea

Lindi më 23 janar të vitit 1932, në fshatin Leshnicë të Sarandës. Më 23 qershor 1969, Gjykata e Sarandës e dënoi me 5 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 166.

CAKANI Safije

Lindi në fshatin Borizanë të Krujës. U dënua me vdekje me vendim të Gjykatës së Prefekturës së Tiranës, më 21 dhjetor të vitit 1949. Por më 7 shkurt 1947, Kryesia e Presidiumit të Kuvendit Popullor të Republikës Popullore të Shqipërisë, dekretoi faljen e këtij dënimi dhe kthimin e tij në privim lirie dhe punë të detyruar.

Gazeta Zyrtare, nr. 1, 18 janar 1950, f. 2.

CAKO Ali

Lindi në fshatin Progonat të Kurveleshit. U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Për këtë arsye, më 7 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Kurveleshit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 36, 23 prill 1947, f. 7.

CAKO Alisan

Mësues.

Lindi në qytetin e Gostivarit në Maqedoni. Së bashku me Hadi Gashin [*shih*] u arratis në Shqipëri, ku dy dekadat e fundit të jetës i kaloi në internim.

Myrteza Bajraktari, *Një vështrim tjetër i historisë*, Tiranë, 2011, III, f. 213.

CAKO Zyhdi

Lindi më 9 tetor të vitit 1946, në Berat. Më 13 tetor 1983, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Beratit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me dhjetë vjet heqje lirie.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

CAKRANI Bektash bej

Veprimtar i lëvizjes kombëtare shqiptare, një nga anëtarët kryesorë të komisionit për përgatitjen e kuvendit të pavarësisë së Shqipërisë, drejtor i thesarit në qeverinë e parë shqiptare, iniciator dhe organizator i Kongresit të Lushnjës.

Lindi në vitin 1871, në Cakran të Mallakastrës, në një familje aristokrate atdhetare. Shkollën fillore dhe atë qytetëse (ruzhdie) i kreu në Berat. Shkollën e mesme për Ekonomi Agrare e përfundoi në Kajro, ndërsa shkollën e lartë juridike në Stamboll e, më vonë, në Sorbonë (Paris). Në gusht 1912 është një nga organizatorët e mbledhjes së Fierit. Është një nga anëtarët kryesorë të komisionit për përgatitjen e kuvendit të pavarësisë së Shqipërisë dhe një nga njerëzit më të besuar të Ismail Qemalit. Në qeverinë e Vlorës u emërua drejtor thesari. Në qeverinë e princ Vidit luftoi me forcat e veta luftarake kundër kryengritjes së Haxhi Qamilit, në Durrës, Myzeqe, Ballsh dhe Berat. Është iniciator dhe organizator i Kongresit të Lushnjës, ku propozoi dhe vetë kabinetin. Udhëhoqi forcat e Mallakastrës në Luftën e Vlorës dhe ishte deputet i grupit independent deri në fund të vitit 1923. Pas grushtit të shtetit, që solli në fuqi qeverinë e Fan Nolit, e kritikoi atë me anë të një letre. Megjithëse me pikpamje republikane, nuk përkrahu republikën e Ahmet Zogut. Më 1935 është një nga krerët mbështetës të Kryengritjes së Fierit. Për këtë arsye, Mbreti Zog e dënoi me vdekje, por falë reputacionit të madh, përfundimisht u dënua me burg. Me pushtimin italian të Shqipërisë, në krye të një delegacioni të parisë së Mallakastrës, i paraqiti forcave



Bektash bej Cakrani

italiane kërkesën për të mos kryer operatione ushtarake në Mallakastër. Për veprimtarinë e tij atdhetare e antifashiste, italianët e arrestuan dhe e burgosën. U lirua vetëm pas kapitullimit të Italisë. U caktua në një komision ekonomik shtetëror, ku pas dy muajsh, për shkak të moshës së thyer dhe sëmundjes, dha dorëheqjen. Më 1945, pas një gjyqi farsë, u ekzekutua me urdhër të vetë Mehmet Shehut.

Asqeri Llanaj, *Bektash Bej Cakrani: Historia flet vetë*, Vlorë, 2010.

CAKRANI Beniamin

Lindi më 1 gusht të vitit 1935, në fshatin Cakran të Mallakastrës. Më 20 nëntor 1976, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1982, dhe më 25 gusht të po atij viti, Gjykata e Fierit e dënoi me 10 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D .1, Fl. 204.

CAKRANI Hajdar

Lindi në vitin 1910, në Petoshaj të Libofshës. Pas mbarimit të shkollës fillore dhe asaj qytetëse, kreu në Grac të Austrisë shkollën e lartë ushtarake. Me fillimin

e luftës kundër italianëve, ngriti çetën e parë nacionaliste në Myzeqe dhe u përfshi në shumë beteja. Me mbarimin e luftës u arrestua si kundërshtar dhe, pas një gjyqi special, u ekzekutua në Fier, më 1945. Për këtë arsye, më 7 qeshor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Fierit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Asqeri Llanaj, *Bektash Bej Cakrani: Historia flet vetë*, Vlorë, 2010; *Gazeta Zyrtare*, nr. 75, 8 gusht 1946, f. 8.

CAKRANI Hysenj

Lindi në vitin 1914, në Petoshaj të Libofshës. Pas mbarimit të shkollës fillore e të mesme në Shqipëri, kreu universitetin e Bolonjës, dega Ekonomi Agrare. U arrestua më 1946. Pak pas lirimit, më 1949-1952 u burgos sërish. Më 7 qeshor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Fierit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme. Pas lirimit u internua dhe përfundoi në azilin e pleqve në Fier, ku dhe vdiq më 1989.

Asqeri Llanaj, *Bektash Bej Cakrani: Historia flet vetë*, Vlorë, 2010; *Gazeta Zyrtare*, nr. 75, 8 gusht 1946, f. 8.

CAKRANI Iliaz

Veprimtar politik, Ministër i Bujqësisë në qeverinë e Ibrahim bej Biçakut (5 shtator 1944-25 tetor 1944).

Lindi në vitin 1914, në fshatin Cakran të Mallakastrës. Pas mbarimit të shkollës fillore e të mesme në Shqipëri, kreu studimet e larta për Ekonomi Agrare. Me kapitullimin e Italisë, u zgjodh anëtar i Komitetit Kombëtar (14 shtator 1943), që deklaroi rishpalljen e pavarësisë së Shqipërisë. Në fund të luftës, u zgjodh Ministër i Bujqësisë në Qeverinë e Ibrahim bej Biçakut [*shih*]. Pas lufte u arrestua dhe u burgos. Më vonë u internua në fshatin Novoselë të Vlorë. Vdiq në vitin 1994.

Asqeri Llanaj, *Bektash Bej Cakrani: Historia flet vetë*, Vlorë, 2010; *Gazeta «Kombi»*, Tiranë, 19 shtator 1943.

CAKRANI Qani

Lindi më 10 maj të vitit 1917, në Cakran të Mallakastrës. Kreu Universitetin Mbretëror të Budapestit, në degën e shkencave politike. Fill pas përfundimit të luftës u arrestua dhe u burgos disa herë. Vdiq në Vlorë, në vitin 2006.

Asqeri Llanaj, *Bektash Bej Cakrani: Historia flet vetë*, Vlorë, 2010.

CAKRANI Vasfi

Lindi në vitin 1912, në Petoshaj të Libofshës. Pasi kreu shkollën fillore dhe atë qytetëse, filloi studimet në Sorbonë (Paris), ku u lauria me rezultate të shkëlqyera për Diplomaci. U arrestua më 1946. Më 19 shkurt të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Fierit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. Pak mbas lirimit, më 1949-1952 u burgos sërish. Më vonë u internua dhe vdiq në një gjendje të mjeruar në azilin e pleqve të qytetit të Fierit, më 1983.

Asqeri Llanaj, *Bektash Bej Cakrani: Historia flet vetë*, Vlorë, 2010; Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 79; *Gazeta Zyrtare*, nr. 25, 18 mars 1947, f. 5.

CAKU (UJKAJ) Kolë

Lindi në Triepsh të Malësisë së Madhe. Mori pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe, që shpërtheu në janar të vitit 1945. U arrestua në Selishtë, në shkurt të po atij viti, nga forcat jugosllave të udhëhequra nga Petro Bullatoviqi, dhe u pushkatua pa gjyq te kisha e Grudës, bashkë me Luc Prekën [*shih*], Dodë Lulgjurajn [*shih*], Gjergj Lulgjurajn [*shih*], Zef Miliqin [*shih*] dhe Gjelosh Gjokë Lacajn [*shih*].

Franz-Llesh Grishaj, *Shkreli dhe roli i tij në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945*, Simpoziumi shkencor me rastin e 60 vjetorit të Rezistencës dhe Kryengritjes Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945, mbajtur në Sallen «At Gjergj Fishta» në Kishën Katolike Shqiptare të Shën Palit në Rochester Hills, Michigan, më 6 shkurt 2005.

CALA Hysen

Lindi në Vlorë. Me shkresën e Prokurorisë Ushtarake të Vlorës, datë 27 nëntor të vitit 1945, u deklarua i ekzekutuar si «kriminel luftë». Për këtë arsye, më 20 dhjetor 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nën-prefekturës Topallti urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij të patundshme. Urdhëri u përsërit dy muaj më vonë, më 18 shkurt 1946, nga po ky Komitet, kësaj radhe për sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 44, 18 shkurt 1946, fq. 3; *Gazeta Zyrtare*, nr. 77, 24 gusht 1946, f. 3.

CALA Rukie

Lindi më 20 janar të vitit 1949, në Dibër. Më 21 tetor 1969, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 288.

CALAJ Liço

Lindi më 13 dhjetor të vitit 1938, në Fier. Më 22 qershor 1965, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 183; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 230.

CALI Prekë

Veprimtar i lëvizjes kombëtare shqiptare.

Lindi më 29 korrik të vitit 1878, në Malin e Jushit (Rranzat e Bushatit). Udhëhoqi luftërat antiosmane të kemendasve në vitet 1908-1911 e 1912. Më 1914 mbështeti qeverinë e princit Vid. Pas vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913), udhëhoqi luftërat për mbrojtjen e kufijve veriorë të Shqipërisë. Në gusht të vitit 1920, në krye të një çete malësorësh, mori pjesë në Luftën e Koplikut në cilësinë e komandantit, krahas Hamit Gjylbegut, Dedë Nikollës, Smail Osmanit, Hamza Kuçit etj. Gjatë Revolucionit të Qershorit të



Prekë Cali

vitit 1924 u radhit në krahun e Fan Nolit. Në krye të luftëtarëve të Kelmendit, ai hyri në Tiranë më 11 qershor 1924. Gjatë qeverisjes jetëshkurtër të Nolit, shërbeu si komandant i forcave të Malësisë së Madhe. Pas kthimit të Ahmet Zogut dhe zgjedhjes së tij president, Prekë Cali u internua për rreth tri vjet në qytetin e Gjirokastrës. U lirua me ndërhyrjen e At Anton Harapit. Pas shpalljes së Mbretërisë (1928), u gradua kapiten rezervist dhe për shumë vjet kreu detyrën e sigurimit të qetësisë publike dhe ruajtjes së kufijve të Kelmendit. Më vonë u zgjodh komandant i xhandarmërisë për Malësinë e Madhe. Mori pjesë në Kuvendin e Brojës, që u mblodh më 13 janar 1945, për të organizuar rezistencën antikomuniste. Udhëhoqi Kryengritjen e Kelmendit, që u zhvillua më 12 dhe 13 janar të vitit 1945. Pas dështimit të saj, më 17 shkurt iu dorëzua Batalionit IV të Brigadës XXIII. Gjyqi kundër Prekë Calit filloi më 28 shkurt 1945. U akuzua se «në bashkëpunim me gjeneral Parianin dhe Melonin, ka vënë në rrezik shtetin shqiptar, duke përgatitur pushtimin e vendit nga Italia fashiste, se ka bashkëpunuar me regjimet e kaluara, se ka qenë armik i përbetuar i lëvizjes Nacionalçlirimtare» etj. U pushkatua mëngjesin e 25 marsit të po atij viti pas murit të varrezave të Rrëmajit në Shkodër,

bashkë me tremëdhjetë burra të tjerë. Më 15 gusht të po atij viti, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Malësisë së Madhe, urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij. Ky urdhër u përsërit nga po ky komitet edhe më 25 prill 1946.

Më 25 qershor 1993, Presidenti i Republikës i akordoi medaljen «Martir i Demokracisë».

Dr. Luigj Martini, *Prek Cali, Kelmendi dhe kelmendasit*, Shkodër, 2005; Fritz Radovani – de Angeliis, *Një monument nën dhé*, Melbourne, 2004, I, f. 53; *Gazeta Zyrtare*, nr. 63, 15 korrik 1946, fq. 6; *Gazeta Zyrtare*, nr. 106, 21 nëntor 1946, f. 5.

CAMAJ Pjetër

Mori pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe, që shpërtheu në janar të vitit 1945. U arrestua nga forcat jugosllave në Traboin, në shkurt të po atij viti, dhe u pushkatua pa gjyq, bashkë me At Leonard Tagajn [*shih*] dhe vojvodën e Vuksanajve, Vasel Mirash Camajn [*shih*].

Franz-Llesh Grishaj, *Shkreli dhe roli i tij në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945*, Simpoziumi shkencor me rastin e 60 vjetorit të Rezistencës dhe Kryengritjes Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945, mbajtur në Sallen «At Gjergj Fishta» në Kishën Katolike Shqiptare të Shën Palit në Rochester Hills, Michigan, më 6 shkurt 2005.

CAMAJ Vasel

Vojvodë i Vuksanajve. Mori pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe, që shpërtheu në janar të vitit 1945. U arrestua nga forcat jugosllave në Traboin, në shkurt të po atij viti, dhe u pushkatua pa gjyq, bashkë me At Leonard Tagajn [*shih*] dhe Pjetër Zekun Camajn [*shih*].

Franz-Llesh Grishaj, *Shkreli dhe roli i tij në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945*, Simpoziumi shkencor me rastin e 60 vjetorit të Rezistencës dhe Kryengritjes Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945, mbajtur në Sallen «At Gjergj Fishta» në Kishën Katolike Shqiptare të Shën Palit në Rochester Hills, Michigan, më 6 shkurt 2005.

CAMBRI Dhimitër

Lindi më 1925 në fshatin Muzinë të Gjirokastrës. Më 18 prill 1947, Gjykata e Rrethit të Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «krimin e pjesëmarrjes në një grup armiqësor kundër pushtetit» dhe e dënoi me një vit heqje lirie dhe punë të detyruar.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 108.

CAMI (CANI) Ajet

Lindi më 5 korrik të vitit 1970 në Dibër. Më 11 korrik 1989, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit e të spiunazhit» dhe e dënoi me 17 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 376.

CAMI Dik

Ushtarak, veprimtar i nacionalizmit shqiptar.

Lindi në Dibër, në vitin 1905. Gjimnazin e kreu në Shkodër, kurse Akademinë Ushtarake në Modena të Italisë. U kthye në Shqipëri, ku iu përkushtua organizimit të ushtrisë shqiptare, veçanërisht shkollave ushtarake. U arrestua në dhjetor të vitit 1944 dhe, pas torturash çnjerëzore,



Dik Cami

u pushkatua më 14 prill 1945. Para pushkatimit deklaroi: «Mbrapsht nuk kthehem se jam ushtarak! Vdes si shqiptar, se gjithë jetën ia kam dedikue Shqipërisë dhe organizimit të ushtrisë shqiptare! Rroftë Shqipëria etnike!».

Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë, 2009, I, f. 30.

CAMI Fitim

Lindi më 2 qeshor të vitit 1951, në qytetin e Peshkopisë. Më 24 maj 1985, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Me dekret nr. 7227 të Presidiumit të Kuvendit Popullor, iu fal dënimi i mbetur.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

CAMI Përparim

Lindi më 6 maj të vitit 1949, në Peqin. Më 25 janar 1986, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 61.

CAMI Zenel

Lindi në fshatin Zerqan të Dibrës. U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Për këtë arsye, më 25 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Zerqanit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 16, 24 shkurt 1947, f. 2.

CANAJ Muharrem

Lindi më 23 maj të vitit 1932, në Filat të Çamërisë. Më 27 tetor 1956, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «mbledhje informatash sekrete» dhe «agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 285.

CANAJ Mustafa Mislli

Lindi më 2 janar të vitit 1909, në fshatin Dukat të Vlorës. Më 5 shkurt 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Vlorë urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 48, 30 maj 1946, fq. 8.

CANAJ Sazan

Lindi më 10 korrik të vitit 1962, në Patos të Fierit. Më 17 mars 1987, Gjykata e Rrethit të Lushnjës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 175.

CANAMETAJ Baba Sh.

Klerik i lartë bektashian.

Lindi në vitin 1895, në fshatin Zhapokikë të Tepelenës. Me mbylljen e teqeve në vitin 1967, u internua në disa fshatra të Jugut, deri në vitin 1990.

CANE Fahri

Lindi në fshatin Bilisht të Devollit. U deklarua «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 19 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Devollit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 119, 30 dhjetor 1946, f. 6.

CANE Mustafa

Lindi në vitin 1927 në Fier. Më 8 mars 1969, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie. U lirua më 9 tetor 1972 për plotësim afati.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 284; F. 1, V. 2012, Fl. 355.

CANI Abdurrahim

Lindi më 14 korrik të vitit 1914, në Peqin. U shpall «kriminel lufte». Për këtë arsye, më 24 maj të vitit 1947, Komiteti



At Çiril Cani O.F.M.

Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nën-prefekturës së Peqinit urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 56, 20 qershor 1947, f. 4.

CANI Avdi

Lindi më 25 prill të vitit 1962, në Kodër-Kamëz të Tiranës. Më 4 maj 1989, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 417.

CANI O.F.M. At Çiril

Klerik katolik, veprimtar i lëvizjes kombëtare shiptare.

Lindi në Shkodër, më 3 qershor të vitit 1875. Kreu Kolegjin e Fretërve Observantë, në Kuvendin e Gjuhadorit në Shkodër. Më 1890 u nis për në Kërshivë të Bosnjës, ku mbaroi studimet për filozofi e teologji. U shugurua më 10 gusht 1894. Në vitin 1895 u dërgua famullitar në Prevezë. Pas kthimit, në vitet 1900-1912 shërbeu në Dukagjin. Në vitin 1913 mobilizoi popullsinë e Dukagjinit në luftë kundër Malit të Zi. Bënte pjesë në delegacionin shqiptar

pranë komisionit të caktimit të kufijve. Me ardhjen e Zogut në fuqi, u caktua zëvendëskomandant i forcave të Shkodrës. U arrestua më 21 shtator të vitit 1946 në famullinë e tij në Bajzë të Kastratit, «për veprimtari kundra Pushtetit Popullor». Më 4 janar 1948, Këshilli i Gjykatës Ushtarake të Shkodrës e dënoi me «5 vjet privim lirie si dhe humbjen e të drejtave civile për 5 vjet kohë..., me konfiskim të pasurisë së luajtshme e të paluajtshme». U lirua tre vjet më vonë, më 29 nëntor 1949. Vdiq në Shkodër, më 27 shtator të vitit 1967.

P. Donat Kurti, *Provinca Françeskane Shqiptare (E ripërtrime në vj. 1906)*, I, XXVII, XXXI, f. 37, 44; II, XI, f. 68; Dr. Pjetër Pepa, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri*, Tiranë, 2007, Vol. II, f. 6-7, 30, 39.

CANI Diell

Lindi më 15 shkurt të vitit 1920 në Peqin. Dënimin e vuajti në burgun e Elbasanit. Më 5 shkurt 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Peqinit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 55, 24 qeshor 1946, fq. 7.

CANI Qamil

Lindi në Peqin. Më 5 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Peqinit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 55, 24 qeshor 1946, fq. 7.

CANI Sait

Lindi më në fshatin Trush të Shkodrës. U dënua si «kriminel lufte». Më 27 korrik të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Prefekturës së Shkodrës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të pa-tundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 87, 17 gusht 1946, f. 2.

CANI Shaqir

Lindi në fshatin Sofroçan të Dibrës. U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Për këtë arsye, më 20 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës

së Zerqanit urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 17, 25 shkurt 1947, f. 8.

CANKA Teki

Lindi më 10 tetor të vitit 1910, në fshatin Miçan të Përmetit. Gjatë luftës u rreshtua në radhët e Ballit Kombëtar. U arrestua më 27 tetor 1966 «për agjitacion e propagandë kundër Pushtetit Popullor». Më 29 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Qarkut të Gjirokastrës e deklaroi fajtor dhe e dënoi me dhjetë vjet heqje lirie dhe me humbje e të drejtës elektorale për pesë vjet kohë. Këtë vendim e la në fuqi edhe Gjykata e Lartë më 18 shkurt të vitit 1967.

Republika Popullore e Shqipërisë, Gjykata e Qarkut Gjirokastrë, no. 25 aktivi, no. 25 vendimi.

CANKJA Agron

Lindi më 16 qershor të vitit 1945, në Elbasan. U arrestua më 9 qershor 1982. Më 1 shkurt 1984, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër shtetit» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar). Por më 17 maj të po atij viti, po kjo gjykatë e deklaroi të pafajshmë për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër shtetit», dhe urdhëroi pushimin e çështjes në ngarkim të tij. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 12 qershor 1984.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 377.

CANKO Mehdi

Lindi më 2 korrik të vitit 1929, në fshatin Taç Lartë të Ersekës. Më 26 dhjetor 1964, Gjykata e Kolonjës e deklaroi fajtor për «tentativë arratisjeje» dhe e dënoi me 4 muaj burg. U arrestua sërish më 1965, dhe më 12 mars të po atij viti, Gjykata e Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 232.

CANOSINAJ Sulo

Lindi në fshatin Dhëmbllan të Tepelenës. Më 8 dhjetor të vitit 1945, Komiteti

Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tepelenës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 40, 20 maj 1946, f. 4.

CAPA Hasije

Lindi më 7 korrik të vitit 1947, në fshatin Pshinar të Peshkopisë. Më 5 maj 1969, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, F. 62.

CAPA Mehmet

Lindi në fshatin Bllatë e Poshtme të rrethit të Dibrës. U dënua nga Gjykata Ushtarake si «sabotator i pushtetit». Më 26 qeshor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Peshkopi urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tij të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 118, 28 dhjetor 1946, f. 4.

CAPA Mexhit

Lindi më 16 maj të vitit 1939, në Matjare të Dibrës. Më 5 maj 1969, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 63.

CAPA Naile

Lindi më 1 shkurt të vitit 1942, në Hoteshtë të Dibrës. Më 5 maj 1969, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 64.

CAPO Idajet

Lindi më 1930 në Dukat, Vlorë. Më 20 mars 1957, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 65.



Ethem Cara

CARA Bardhi

Lindi më 20 janar të vitit 1937, në Kavajë. Më 12 qershor 1967, Gjykata e Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës dhe tradhëtisë kundër shtetit» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 244.

CARA Emin

Lindi më 21 mars të vitit 1928 në Kavajë. Më 3 qershor 1966, Gjykata e Qarkut të Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 66.

CARA Ethem

Ekonomist, veprimtar politik, Ministër i Financave (7 shtator 1944-25 tetor 1944).

Lindi më 4 maj të vitit 1905, në Kavajë. Mësimet e para i mori në vendlindje, kurse studimet e larta për financë në Universitetin e Vjenës, ku mbrojti dhe titullin Doktor i Shkencave Ekonomike. Më 1928 u kthye në Shqipëri. Punoi për disa vite në Ministrinë e Arsimit. Në qeverinë e krijuar prej

Ibrahim Biçakut [shih] (7 shtator 1944-25 tetor 1944) u zgjodh Ministër i Financave. Aty nga fundi i vitit 1944 u arrestua nga Sigurimi i Shtetit me akuzën: «element i rrezikshëm për diktaturën e proletariatit, me ide perëndimore antikomuniste...». Gjyqi Special, i zhvilluar në muajt mars-prill të vitit 1945, e dënoi me 101 vjet heqje lirie. Ende sa pa u shpallur vendimi i gjykatës, më 6 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tiranës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme. U lirua në vitin 1970.

Gazeta Zyrtare, nr. 20, 23 mars 1946, f. 7.

CARA Ibrahim

Lindi më 15 korrik të vitit 1944, në Kavajë. Më 21 shtator 1962, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e tentativës së arratisjes» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 437.

CARA Rustem

Lindi në fshatin Zajs të Mirditës. U shpall «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 20 shtator të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Mirditës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 105, 18 dhjetor 1947, fq. 5.

CARA Sabri

Lindi më 2 maj të vitit 1935 në Kavajë. Më 29 mars 1972, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 286.

CAKU Martin

Lindi në Mirditë. U dënua me dhjetë vjet heqje lirie «për agjitacion e propagandë».

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver*

Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980, Berat, 1995, f. 84.

CAUSHAJ Xhafer

Lindi më 7 korrik të vitit 1900, në fshatin Gorrish të Vlorës. U dënua si «kriminel luftime». Më 16 dhjetor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Topalltis urdhëroi sekuestrimin e gjysmën e pasurisë së tij të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 8, 4 shkurt 1947, f. 8.

CECO Veiz

Lindi më 10 maj të vitit 1945, në Gramsh. Më 17 prill 1965, Gjykata e Rrethit të Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e arratisjes jashtë atdheut mbetur në fazën e përgatitjes» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1968, dhe më 20 qershor të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e dënoi me 20 vjet heqje lirie, sepse «në marrëveshje dhe në bashkëpunim është arratisur jashtë shtetit». Më 5 shkurt 1979, Gjykata e Rrethit të Mirditës e ridënoi më 25 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për pesë vjet kohë për «agjitacion e propagnadë kundër shtetit».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 345.

CEKA Adem

Më 7 qeshor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Fierit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 75, 8 gusht 1946, f. 8.

CEKA Selim

Përkthyes.

Lindi më 9 janar të vitit 1905 në Elbasan. Kreu Shkollën Teknike «Harry Fultz» në Tiranë. Pas luftës punoi si përkthyes i UNRRA-s. U arrestua si pjesëtar i një grupi armiqësor. Pas vendimit me burg, u dërgua në kampin e Maliqit. *Përkthime: Thomas B. Saunders, «Ndriçime të Schopenhauer-it. Libri I-rë. Ditunija e jetës» (Tiranë, Shtypëshkronja "Mbrothësija",*

1944); Thomas B. Saunders, Ndriçime të Schopenhauer-it. Libri II-të. Udhëzime dhe mendime të vërteta (Tiranë, Shtypëshkronja "Mbrothësija", 1944).

Bardha Nergjoni, *Familja Çiftja, shkëlqimi dhe rënia e një familjeje patriote*, në «Shekulli», 1 mars 2010; Maksim Gjinaj, Margarita Mele, Myrvete Elmazi, *Bibliografia e librit shqip në fondet e Bibliotekës Kombëtare (1913-1944)*, Biblioteka Kombëtare, Tiranë, 2010, f. 33.

CEKA Zef

Lindi në fshatin Bzhetë të Shkrelit. Mori pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe. U vra në Bajzë të Kastratit, më 23 janar të vitit 1945, gjatë përpjekjes për marrjen e Postkomandës.

Franz-Llesh Grishaj, *Shkreli dhe roli i tij në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945.*

CEKAJ Gjokë

Lindi më 3 maj të vitit 1904 në fshatin Bzhetë të Shkrelit. Mori pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe, që shpërtheu në janar të vitit 1945. Pas shtypjes së kryengritjes u arrestua dhe u dënua me 15 vjet heqje lirie.

Franz-Llesh Grishaj, *Shkreli dhe roli i tij në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945.*

CEKAJ Marash

Vëllai i Gjokë Cekajt [*shih*]. Lindi në fshatin Bzhetë të Shkrelit. Mori pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe, që shpërtheu në janar të vitit 1945. Pas shtypjes së kryengritjes u arrestua dhe u dënua me 10 vjet heqje lirie.

Franz-Llesh Grishaj, *Shkreli dhe roli i tij në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945.*

CELA Meto

Lindi në fshatin Sevaster të Vlorës. Më 5 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kotës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 41, 21 maj 1946, f. 6.

CENKO Jahja

U dënua nga Gjykata Ushtarake, dhe më 4 shtator të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Kolonjës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 3, 5 janar 1948, f. 2.

CENJA Sylejman

U ekzekutua si «armik i popullit». Më 18 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Topalltis, Llakatund, urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 44, 25 maj 1946, fq. 3.

CEPALE Tefik

Lindi në Roskovec. U deklarua «kriminel luftime dhe armik i popullit». Më 16 janar të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të qytetit të Fierit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 18, 4 shkurt 1948, f. 6.

CEPO Remzi

Lindi në fshatin Borsh të Sarndës. U ekzekutua si «armik i popullit». Më 9 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Sarandës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 48, 30 maj 1946, fq. 5-6.

CERCIZI Skënder

Lindi në fshatin Vranisht të Vlorës. Më 15 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kotës urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 38, 15 maj 1946, f. 5.

CERVENKO Jovica

Malazias. Fillimisht major i UDB-së, më vonë informbyroist, domethënë pro-stalinist. Për këtë arsye u arratis në Shqi-

përi, ku u dënua me 15 vjet heqje lirie si spiun jugosllav.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 58; Uran Kalakulla, *21 vjet burg komunist*, Tiranë, 2008.

CIBANI Sadik

Lindi në fshatin Vajzë të Vlorës. Më 23 qershor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kotës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 30, 26 prill 1946, f. 3-4.

CILA Kurt

Lindi në fshatin Topojan të Kukësit. U dënua si «kriminel luftime dhe armik i popullit». Për këtë arsye, më 25 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Zerqanit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 16, 24 shkurt 1947, f. 2.

CIRRAGA Ibrahim

Lindi në qytetin e Elbasanit. U deklarua «armik i popullit». Më 9 mars të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Elbasanit urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 38, 8 prill 1948, f. 1.

COKU Dedë

Veprimtar i nacionalizmit shqiptar.

Lindi në fshatin Shënkoll të Lezhës. U padit për «kolaboracionizëm» me gjermanët. Para vendimit të gjyqit, që u zhvillua në korrik të vitit 1945 në kino-teatrin «Rozafa», tha: «Kam luftue kundra turqve për pavarësinë e Shqipnisë, jam varrue dy herë, dhe kam humbë një vëllá n'atë luftë, kam pësue shembejn e shtëpisë: e kam dashtë gjithmonë atdheun tim, jam përpjekë gjithmonë t'i shërbej: nuk do ta kisha pritë kurr të trajtohesha në këtë mënyrë prej bashkatdhetareve të mij. Zoti e shpëtoftë Shqipninë». Në vendin e ekzekutimit

u ul në gjuhë dhe bëri Shënjen e Kryqit: e qëlluan, por jo për vdekje; pastaj e qëlluan me revolver, por prapë nuk vdiq: ra, u çua, bëri përsëri Shënjen e Kryqit dhe vetëm në të shtirën e tretë ra i vdekur. Një muaj më vonë, më 15 gusht 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Malësisë së Madhe urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij. Një vendim të tillë mori më 18 janar të vitit 1947 edhe Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Lezhës.

Shënime të Atit Luigi Rosa, S. J., në «Nji Seminar Papnor në vorbull të përndjekjes komuniste: Shkodër 1945-1946», Shkodër, 2008, f. 67; Gazeta Zyrtare, nr. 106, 21 nëntor 1946, f. 5; Gazeta Zyrtare, nr. 16, 24 shkurt 1947, f. 5.

coku Vasil

Lindi më 15 janar të vitit 1929, në fshatin Shënkoll të Lezhës. Më 24 shkurt 1982, Gjykata e Rrethit të Krugës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, internim dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 1.

COLAJ Kolë Nikë

Lindi më 19 shtator të vitit 1915, në fshatin Zagore të Shkrelit. Mori pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe, që shpërtheu në janar të vitit 1945. Pas shtypjes së kryengritjes, u dënua me 10 vjet heqje lirie.

Franz-Llesh Grishaj, *Shkreli dhe roli i tij në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945.*

COLAJ (STOLAJ) Ukë

Lindi më 8 maj të vitit 1923 në Shkodër. Më 8 maj 1965, Gjykata e Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 174.

como Kolo

Lindi në fshatin Mbrazhdan të Përmetit.

U dënua si «kriminel lufte dhe armik i popullit» nga Gjykata Ushtarake. Më 24 shkurt të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të qytetit të Përmetit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 32, 25 mars 1948, f. 5.

cova Rustem

Lindi në fshatin Zajs të Mirditës. U deklarua «kriminel lufte dhe armik i popullit». Më 20 shtator të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Mirditës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 106, 19 dhjetor 1947, fq. 3.

CUFI Dul

Lindi më 25 shkurt të vitit 1936, në fshatin Bërdicë të Shkodrës. Më 6 nëntor 1964, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie dhe me konfiskimin e pasurisë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 132.

CUFI Mark

Një pjesë të dënimit e vuajti në «Repartin 307», kamp-burgun që ndodhej pranë lumit të Lanës në Tiranë. Që këtu u transferua në kamp-burgun e Laçit. Në vitin 1965 u arratis nga kampi dhe u vra nga policia në urën e Baçallëkut në Shkodër.

CUKA Ganimet

Lindi në Tiranë, ku kreu dhe Institutin Femëror «Nana Mbretneshë». U arrestua më 1945 si agjente të zbulimeve të huaja. Pas shumë muajsh hetuesie dhe refuzimit të saj për të pranuar akuzat, e lanë të lirë. Më 29 shtator të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Prefekturës së Tiranës urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së tundshme të saj. Në tetor të vitit 1967, bashkë me të ëmën, i internuan në Grabjan të Lushnjës, ku i vunë për të banuar në një kthinë të stallës së derrave. Aty u vetëvarën të dyja.

Kufomat e tyre i hodhën në një gropë buzë kanalit, që kalonte pranë stallës.

Agim Musta, *Kampet e internimit dhe trimat e dëshpërimit*, Tiranë, 2012, f. 38-39; *Gazeta Zrytare*, nr. 102, 9 dhjetor 1947, fq. 1.

CUKA Mustafa

Lindi më 5 tetor të vitit 1920, në fshatin Macukull të Matit. U arrestua më 18 qershor 1945, dhe më 2 korrik të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Beratit e deklaroi fajtor «se ka dezertuar nga ushtria», dhe e dënoi «me 20 vjet burg, me punë të detyruar, humbjen e nderit ushtarak dhe të drejtave civile, baraz me kohën e ndëshkimit».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 388.

CUKA Xhuljeta

Lindi në vitin 1968, në Tiranë. Më 11 gusht 1989, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtorë për «krimet: agjitacion e propagandë kundër shtetit dhe tradhëti ndaj atdheut mbetur në përgatitje» dhe e dënoi me 13 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 652.

CUKALI Jorgji

Lindi më 15 mars të vitit 1914, në Kohnispol. U ekzekutua më 12 nëntor të vitit 1962 «për kryengritje të armatosur, spiunazh, sabotim», dhe si bashkëpunëtor i kryetarëve të të ashtuquajturit «grupi i Teme Sejkos dhe Tahir Demit», bashkë me Beqo Plakun [shih], Ilia Gjyzelin [shih], Nikolla Goçin [shih] dhe Theodhori Veton [shih].

Lista e personave të ekzekutuar për vitin 1961-1962, hartuar nga Dega e Hetuesisë së Drejtorisë së Policisë, Tiranë.

CULAJ (HYSAJ) Caf

Lindi më 25 maj të vitit 1928, në Reç të Malësisë së Madhe. Deri në vitin 1946 drejtoi Rininë Antifashiste të Malësisë së Madhe. Në vitin 1954 u dënua me njëzet vjet heqje lirie me akuzën «Tradhëti ndaj atdheut dhe agjitacion e propagandë». U lirua në vitin 1967 dhe deri më 1970 punoi

si punëtor krahu në Ndërmarrjen e Ndërtimit në Shkodër. Po këtë vit u dënua sërish me akuzën «agjitacion e propagandë» me nënëtë vjet burg, të cilat i vuajti tërësisht.

Vepra: «Krushqit e lirisë».

Agim Musta, Visar Zhiti, Enver Lepenica, Tanush Mulleti, *Antologjia e plagëve nën terrorin komunist*, 2004, f. 472.

CULAJ Ndoc Ndrekë

Lindi më 5 tetor të vitit 1948, në fshatin Zagorë të Shkrelit. Më 6 shtator të vitit 1966, mbështetur në nenet 64, 14 dhe 46 të Kodit Penal, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e dënoi me 3 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 5.

CULAJ Ndrekë Pjetër Zef

Lindi në fshatin Zagorë të Shkrelit. Mori pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe, që shpërtheu në janar të vitit 1945. Pas shtypjes së kryengritjes, u pushkatua pa gjyq.

Franz-Llesh Grishaj, *Shkreli dhe roli i tij në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945*.

CUNGU Ali

Pedagog, një nga përkthyesit më të njohur nga gjuha shqipe në anglisht.

Lindi më 2 gusht të vitit 1898, në Elbasan, në familjen e një qiraxhiu karvanesh. U shkollua në Robert Kolegj të Stambollit. Pas diplomimit, punoi për ca kohë si mësues në Elbasan dhe, më 1921, filloi punë në Shkollën Teknike «Harry Fultz» në Tiranë. Në verën e vitit 1931, mbajti dy Konferenca të rëndësishme për problemin shqiptar në Institutin e Studimeve në Gjenevë. Pas shtetëzimit të shkollave të huaja dhe private (1933), filloi punë në Institutin Shqiptaro-Amerikan të Kavajës, të quajtur simbolikisht katundi «Përparimi». Pa kaluar shumë kohë, u emërua nëndrejtor i tij. Me largimin e amerikanëve më 1939, u zgjodh drejtor i Institutit. Pas pushimit italian, u transferua, fillimisht si rektor i konviktit të Gjinnazit të Tiranës, dhe më vonë si drejtor i Shkollës së Punës në



Kampi i Spaçit, fjetorja

Elbasan. Me mbarimin e luftës, si shumë intelektualë të tjerë të përmasave të tij, u burgos, dhe pa kurrfarë procedure juridike e me dëshmitarë të rremë, u dënua me shtatë vjet heqje lirie. Pas lirimit nga burgu, deri në vitin 1958, u dërgua në internim. Vdiq në moshën 87-vjeçare. Sot emrin e tij dhe të të vëllait, Mahmud Cungut, e mban Shkolla e Mesme Profesionale e Gjuhëve të Huaja në qytetin e Elbasanit.

Përkthime: Gavril Dara, «The Last Lay of Bala» (*Tiranë, 1967*); Naim Frashëri, «Frasheri's Song of Albania» (*përkthyer bashkë me të vëllanë, Mahmud Cungun, New York, 1981*); Naim Frashëri «Skanderbeg's Return and Other Poems» (*Tiranë, 1970*); Migjeni, «Selected Albanian songs and

sketches» (*Tiranë, 1962*); Ismail Kadare, «The Wedding» (*Tiranë, 1968*) etj.

Iljaz Gogaj, *Ali Cungu, personalitet i shquar i arsimit dhe kulturës*, në «Perla», Tiranë, 2007, nr. 2, fq. 46-56; Robert Elsie, *Albanian Literature In The English-Speaking World*, në «Translation Review», nr. Seventy-six, 2008, f. 2; H. Gonxhja, I. Gogaj, Sh. Bumçi, *Ndihmesa e ish nxënësve dhe mësuesve të Shkollës Teknike të Tiranës...*, Tiranë, 2006, VII. 2, f. 252.

CUNGU Haxhi

Klerik musliman.

Lindi më 19 janar të vitit 1918, në Shkodër. Bëri plot 24 vjet burg. Është ndër aktivistët e parë që ndihmuan për rimëkëmbjen e besimit në Myftininë e Shkodrës. Më 16 nëntor 1990, në mbled-

hjen e organizuar në Xhaminë e Plumbit në Shkodër, ku u vendos krijimi i «Bashkësisë Islamike Shqiptare», – që i parapriu Komunitetit Musliman Shqiptar, – ai u zgjodh anëtar i kryesisë së saj. Më vonë shërbeu për shumë vite si imam dhe kujdestar i xhamisë Rus. Me rastin e 20 vjetorit të rilejimit me ligj të lirisë fetare, me propozim të Myftinisë së Shkodër, Këshillit Bashkiak i qytetit e nderoi me titullin «Mirënjohja e qytetit».

CURAJ Pashko

Lindi më 15 janar të vitit 1956, në Bajzë të Kastratit. Më 31 maj 1978, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit popullor në bashkëpunim» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie. U lirua me dekret nr. 6656, datë 28 tetor 1982.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 351.

CURANAJ (ULDEDAJ) Lulash

Lindi në fshatin Bajzë të Kastratit. Mori pjesë në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe. U vra në fshatin e tij të lindjes, më 23 janar të vitit 1945, gjatë përpjekjes për të marrë Postkomandën.

Franz-Llesh Grishaj, *Shkreli dhe roli i tij në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945*, Simpoziumi shkencor me rastin e 60 vjetorit të Rezistencës dhe Kryengritjes Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945,

mbajtur në Sallen «At Gjergj Fishta» në Kishën Katolike Shqiptare të Shën Palit në Rochester Hills, Michigan, më 6 shkurt 2005.

CURAJ Muho

Lindi më 20 maj të vitit 1929 në Leporash të Shkodrës. Më 30 tetor 1961, Gjykatata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për krimin e «agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet burg.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 68.

CURRI Dashamir

Lindi më 23 mars të vitit 1954, në Kavajë. Më 2 prill 1976, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie dhe me humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë (dënim i kombinuar). Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë, më 21 prill 1976. U lirua për plotësim afati, në tetor të vitit 1982.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 338.

CURRI Lulash Cuk

Luftëtar antikomunist.

Lindi në fshatin Jeran të Bajzës së Kastratit. U vra më 21 janar të vitit 1945 në Bajzë, në përpjekje me forcat partizane.

Dr. Luigi Martini, *Prek Cali, Kelmendi dhe kelmendasit*, Shkodër, 2005, f. 241.



ÇAÇANI Vasil

Lindi më 14 tetor të vitit 1921, në fshatin Mazi në veriperëndim të Peloponezit. Më 26 dhjetor 1967, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie. U arrestua sërish më 1978, dhe më 27 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Fierit e dënoi me 10 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 67.

ÇAÇI Artan

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1968, në Vlorë. Më 20 qershor 1986, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 9.

ÇAÇI Ilia

Lindi më 6 prill të vitit 1943, në Himarë të Vlorës. Më 24 tetor 1960, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 213.

ÇAKAJ Spiro

Lindi më 14 shkurt të vitit 1963, në fshatin Vagalat të Sarandës. Më 21 prill 1988, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Sarandës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes ngelur në tentativë dhe për agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 337.

ÇAKO Ethem

Lindi më 1 mars të vitit 1908, në fshatin Progonat të Kurveleshit. Në moshën njëzet vjeçare u gradua rreshter i xhanadarmërisë mbretërore. Në nëntor të vitit 1942 u fut në radhët e Ballit Kombëtar. Në mars të vitit pasues u emërua anëtar i nënkomitetit të Ballit Kombëtar për Delvinën e, në fund, anëtar i komitetit rajonal të Ballit për Gjirokastrën. Shërbeu si komandant i policisë së Delvinës nga janari deri më 5 korrik të vitit 1944, ku u arrestua nga gjermanët, sepse liroi të burgosurit që kishte në ngarkim. U internua në Gjermani. Pas kapitullimit të Gjermanisë, në korrik të vitit 1945 kaloi në Itali. Me riorganizimin e Ballit Kombëtar (tetor 1945), u zgjodh anëtar kandidat i Komitetit Qëndror të tij. Natën e 8 korrikut 1949, skuadra e drejtuar prej tij, dhe e përbërë nga Kasem Zhupa [*shih*], Zyber Lika [*shih*] dhe Llukman Lutfiu [*shih*], u parashutua në zonën e Kurveleshit, midis fshatrave Progonat dhe Lekdush. Të nesërmen në mesditë ranë në përpjekje me forcat e Sigurimit. Zyber Lika u vra gjatë përpjekjes, kurse Ethem Çakoja, Llukman Lutfiu dhe Kasem Zhupa u arrestuan. Më 24 maj të vitit 1950, në sallën e kinema «17 Nëntorit», Gjykata e Lartë Ushtarake hapi seancën e parë publike të procesit kundër anëtarëve të këtij grupi. Ethem Çakoja u akuzua: «për krime të shumta lufte..., në cilësinë e drejtuesit të formacioneve ... të Ballit Kombëtar...; për pjesëmarrje në organizata antikombëtare, të krijuara jashtë...; për vënien në shërbim të spiunazhit të huaj...; për drejtim të bandës së armatosur



Grupi i Ethem Çakos

të parashutuar mbi territorin shqiptar...» etj. Më 5 qershor të po atij viti, në pretencën e tij, prokurori ushtarak, kolonel Siri Çarçani, kërkoi «një dënim të vetëm për të tre: dënim me vdekje me pushkatim». Një ditë më vonë, Gjykata e Lartë Ushtarake miratoi «njëzëri pretencën e Prokurorit të Ushtrisë Popullore», dhe e dënoi me vdekje, pushkatim, me humbjen e përhershme të të drejtave civile dhe me konfiskim të pasurisë. Më vonë dënimi iu kthye në 25 vjet heqje lirie.

Il processo di Tirana, "Edizioni di Cultura Sociale", Roma, 1950.

ÇAKO Hito

Ushtarak i lartë, Zëvendësministër i Mbrojtjes (20 korrik-25 nëntor 1974).

Lindi më 2 mars të vitit 1923, në Progonat të Kurveleshit. Arsimin fillor e kreu në vendlindje (1931-1933). U lidh me LANÇ-in që në fillim. Më 7 mars 1946 u emërua Shef i Sigurimit të Shtetit, fillimisht në Vlorë dhe, më 7 qershor të po atij viti, në Peshkopi. Nga marsi i vitit 1961 deri në fillim të dhjetorit, pra, në periudhën më të acaruar të marrëdhënieve me sovjetikët, kreu funksionet e komandantit

të Flotës Luftarake Detare në Pashaliman, në ishullin e Sazanit. Më 20 korrik 1974 u emërua Zëvendësministër i Mbrojtjes, së bashku me Petrit Dumen [shih], por pak muaj më vonë, më 25 nëntor të po atij viti, u pezullua nga detyra dhe u la në «dispozicion». Më 12 dhjetor 1974 u përjashtua nga ushtria dhe brenda në sallën e punimeve të Pleniumit të KQ të PPSH-së u arrestua së bashku me Petrit Dumen dhe Rrahman Përlakun [shih]. Pas një hetimi intensiv gati njëvjeçar, në fund të vitit 1975 u pushkatuan që të tre «Për tradhti të lartë ndaj atdheut».

Dr. Gjergj P. Titani, Prof.dr. Proletar Hasani, *Personalitete ushtarake shqiptare në vite: 1912-dhjetor 1997*, Vëll. I, f. 181-187.

ÇALA Gani

Lindi më 5 shtator të vitit 1912, në fshatin Murat Bejas të Elbasanit. Më 21 maj të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Gostimes urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 48, 30 maj 1946, fq. 11.

ÇALA Kasëm

Lindi më 29 maj të vitit 1949, në fshatin

Luar të Fierit. Më 20 shkurt 1981, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 278.

ÇALA Tasim

Lindi më 20 gusht të vitit 1940, në fshatin Ploshtan të Kalasë së Dodës, në Dibër. Më 21 tetor 1969, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 69.

ÇALI Ali

Lindi më 20 mars të vitit 1934, në Tiranë. Më 30 korrik 1951, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 172.

ÇAMI Elena

Lindi më 22 qershor të vitit 1932, në Moskë, Rusi. Më 21 janar 1976, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 98.

ÇAMI Jani

Lindi në fshatin Koshovicë të Gjirokastrës. U deklarua «armik i popullit». Më 15 korrik të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Gjirokastrës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 82, 3 gusht 1948, fq. 3.

ÇAMI Minella

Lindi më 3 qeshor të vitit 1929, në Korçë. Më 11 maj 1972, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «krimin e agji-

tacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 85.

ÇAMI Nevzat

Lindi në Gjirokastrë. Më 14 maj të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Qendrës Korçë urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të lujatshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 53, 3 qershor 1947, f. 7.

ÇAMI Spiro

Lindi më 30 janar të vitit 1950, në Sarandë. Më 20 janar 1977, Gjykata e Rrethit të Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundra pushtetit popullor dhe për largim pa leje nga reparti» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 408.

ÇAMI Syrja

Lindi më 18 gusht të vitit 1915, në Gjirokastrë. Më 14 maj të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Qendrës Korçë urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të lujatshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 53, 3 qershor 1947, f. 7.

ÇAMI Shahin

Lindi në Dibër. U dënua nga Gjyqi Ushtarak i Qarkut të Peshkopisë. Më 20 nëntor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tiranës urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij të luajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 2, 5 kallnor 1946, f. 5.

ÇANAJ Halo

Lindi më 12 prill të vitit 1927, në fshatin Dukat të Vlorës. Më 11 dhjetor 1951, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «pjesëmarrje në grup kundër shtetit» dhe e dënoi me 13 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 4 vjet kohë (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D.1, Fl. 154.

ÇANGOLLI Jani

Lindi më 14 shtator të vitit 1936, në fshatin Peshtan të Tepelenës. Më 11 nëntor 1960, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 18 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 4 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 149.

ÇANGU Adem

Lindi më 15 gusht të vitit 1932, në fshatin Verjon të Krujës. Më 2 tetor 1964, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «agjitacion dhe propagandë» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie. Por meqë me dekret i zbritet $\frac{1}{4}$ e dënimit, vuajti 4 vjet e 6 muaj burg.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 375.

ÇANO Besnik

Një nga përfaqësuesit kryesorë të rinisë nacionaliste të Ballit Kombëtar, drejtues i shquar i rezistencës antikomuniste.

Lindi në Libohovë, më 1921. Përfaqësoi rininë nacionaliste në Konferencën e Mukjes (1-3 gusht 1943). Në tetor të vitit 1943 u kap pabesisht në Kavajë bashkë me Qeramudin Sulon [*shih*], tek po shkonin në Jug për të përcjellë mesazhin e kësaj marëveshjeje. Prej këtu u dërguan në Pezë, ku pasi u torturuan për vdekje nga komunistët, u pushkatuan më 29 tetor 1943. Më vonë me emrin e tij u pagëzua Batalioni i Rinisë së Ballit Kombëtar, që mori pjesë në luftime deri në Kosovës (qershor 1944).

ÇAPAJ Idai

Lindi më 10 janar të vitit 1930, në fshatin Dukat të Vlorës. U arrestua në vitin 1957 dhe u dënua me 10 vjet heqje lirie për «agjitacion e propogandë». U lirua në vitin 1963.

ÇAPAJ Eqerem

Lindi më 8 janar të vitit 1936, në fshatin Dukat të Vlorës. U arrestua më 1955



Eqerem Çapaj

dhe më 5 nëntor 1955, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër pushtetit popullor (si pjesmarrës në organizatën «Besa e shqiponjës»)» dhe e dënoi me 25 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë (dënim i kombinuar). U aksidentua në kampin e Laçit dhe humbi këmbën e majtë. U lirua në vitin 1966. Që nga ky vit e deri më 1990 u internua në Savër të Lushnjës.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 70.

ÇAPAJ Neço

Lindi më 13 mars të vitit 1928, në fshatin Dukat të Vlorës. Më 29 dhjetor 1960, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut, në formën e tentativës së arratisjejes» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë. U lirua më 1968, dhe u internua familjarisht deri në vitin 1990.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 121.

ÇAPAJ Veledin

Lindi më 5 janar të vitit 1903, në fshatin Dukat të Vlorës. U dënua si «sabotator i pushtetit dhe armik i popullit». Më

24 gusht të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Vlorë urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 87, 17 shtator 1946, f. 6.

ÇAPOLLARI Gjergji

Lindi më 22 shtator të vitit 1951, në Korçë. Më 31 maj 1976, Gjykata e Rrethit të Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënnoi me 7 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë. Një pjesë të dënimit e vuajti në kampin e Spaçit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 2.

ÇARÇANI Daut

Ushtarak i lartë, prefekt i Gjirokastrës dhe më vonë i Shkodrës (1940-1942).

Lindi në vitin 1890, në Gjirokastrë. Kreu Kolegjin e Shën Adrianit në Shën Mitër Koronë të Kalabrisë e më pas Akademinë Ushtarake në Napoli. Mes viteve 1924-1939 punoi si qark-komandant në Korçë, Berat e Shkodër. Pushtimi italian e gjeti në Shkodër, prej ku, pas një rezistence të shkurtër, bashkë me shumë oficerë të rrethit, kaloi kufirin jugosllav. Pas amnistisë, në vitet 1940-1942 shërbeu si prefekt në Gjirokastrë dhe Shkodër. Gjatë pushtimit gjerman u transferua në Ministrinë e Punëve të Brendshme në Tiranë, por pa kaluar shumë kohë dha dorëheqjen. U arrestua në nëntor të vitit 1944 dhe u dënua me vdekje, pushkatim. Vendimi u ekzekutua më 14 prill 1945. Më 20 nëntor të po këtij viti, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tiranës urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë, 2009, I, f. 31; *Gazeta Zyrtare*, nr. 3, 7 kallnor 1946, f. 9.

ÇARÇANI Elmas

Lindi më 20 gusht të vitit 1914, në fshatin Brataj të Vlorës. Më 23 qershor 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kotës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pa-

surisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 30, 26 prill 1946, f. 4.

ÇARÇANI Hamdi

Lindi në fshatin Brataj të Vlorës. Më 23 qershor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kotës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 30, 26 prill 1946, f. 4.

ÇARÇANI Myslim

Lindi në fshatin Fush-Bardhë të Gjirokastrës. Më 9 mars të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Delvinës urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 79, 29 gusht 1946, f. 12.

ÇAUSHAJ Ali

Lindi në fshatin Dhëmban të Tepele-nës. Më 3 nëntor të vitit 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tepelenës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 40, 20 maj 1946, f. 3.

ÇAUSHAJ (GUNAJ) Ceno (Cane)

Lindi më 7 shtator të vitit 1920, në



Daut Çarçani

fshatin Hekal të Fierit. Më 30 tetor 1947, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor për «krime lufte» dhe e dënoi me 3 vjet e gjysmë burg. U arrestua sërish më 1952, dhe më 18 shtator të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Durrësit e dënoi me 6 vjet heqje lirie për «tentativë arratisje jashtë shtetit». U arrestua për të tretën herë më 1980, dhe më 25 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 303.

ÇAUSHAJ Faik

Lindi në vitin 1939, në fshatin Drizar të Fierit. Më 6 tetor 1979, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 269.

ÇAUSHAJ Hekuran

Lindi më 16 janar të vitit 1925, në Vlorë. Më 11 korrik 1978, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet burg dhe heqjen e dekoratave.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 226.

ÇAUSHAJ Hulusi

Lindi më 10 maj të vitit 1935, në fshatin Dhëmban të Tepelenës. Më 4 shtator 1959, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e përgatitjes së arratisjes» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, sekuestrimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë (dënim i kombinuar). Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Ushtark i Gjykatës së Lartë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 367.

ÇAUSHAJ Iljas

Lindi në fshatin Dhëmban të Tepelenës. Më 3 nëntor të vitit 1945, Komiteti

Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tepelenës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 40, 20 maj 1946, f. 3.

ÇAUSHAJ Refat

Lindi më 5 qeshor të vitit 1901, në fshatin Dhëmban të Tepelenës. Më 3 nëntor 1945, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës së Tepelenës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 40, 20 maj 1946, f. 3.

ÇAUSHAJ Skënder

Lindi në fshatin Plashnik të Beratit. Më 19 gusht të vitit 1945, Gjykata Ushtarake e Beratit e dënoi me vdekje. Këtë vendim e aprovoi më 3 shtator të po atij viti edhe Gjykata e Lartë Ushtarake në Tiranë. U ekzekutua më 31 shtator të vitit 1945.

Fritz Radovani – de Angeliis, *Një monument nën dhé*, Melbourne, 2004, I, f. 58.

ÇAUSHI Kastriot

Lindi më 26 shtator të vitit 1953, në Elbasan. Më 8 dhjetor 1979, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut, të mbetur në fazën e përgatitjes», dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 27 dhjetor të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 397.

ÇAUSHI Latif

Lindi më 5 qeshor të vitit 1909, në Dibër. Më 15 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Elbasanit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 54, 20 qeshor 1946, fq. 8.

ÇAUSHI Qerim

Lindi më 29 prill të vitit 1934, në Tiranë. Kur po kryente dënimin në kamp-burgun e Laçit, nga dëshpërimi u hodh me kokë nga tarraca e banesës ku banonin të burgosurit, drejt e në tokën e fortë të obo-

rrit, dhe mbeti i vdekur në vend.

Uran Kalakulla, *21 vjet burg komunist*, Tiranë, 2008, f. 102.

ÇAUSHI Skënder

Lindi më 1943, në fshatin Hekal të Fier. Më 3 prill 1980, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 130.

ÇAVIDHI Spiro

Lindi më 13 mars të vitit 1951, në Sarandë. Më 29 dhjetor 1987, Gjykata e Rrethit të Sarandës e deklaroi fajtor për «krimet e agjitacionit e propagandës dhe tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 13 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 283.

ÇEÇI Aleks

Lindi në Gjirokastrë. Më 27 mars të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës Qendër Gjirokastrë udhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 89, 23 shtator 1946, f. 7.

ÇEFA Andon

Lindi më 27 nëntor të vitit 1942, në Tiranë. Më 5 prill 1976, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 76.

ÇEFA Karlo

Lindi më 1 mars të vitit 1938, në Shkodër. Më 6 gusht 1957, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «përgatitje për t'u arratisur në një shtet të huaj dhe agjitacion e propagandë», dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe me humbjen e së drejtës elek-

torale për 3 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, në gusht të po atij viti. U lirua më 8 janar 1964 për plotësim afati.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 396.

ÇEFA Matish

Lindi më 15 maj të vitit 1926, në një familje qytetare shkodrane. Pa kryer gjimnazin, u arrestua. Qëndroi 2-3 javë në burg. U lirua, por pas dy ditësh u arrestua sërish, bashkë me disa shkodranë të tjerë, për t'i hapur rrugën brigadës sulmuese partizane që shkoi në Vishegrad të Jugosllavisë. E rigjistruan gabimisht, jo në datën e arritjes në Vishegrad, por në një datë tjetër, ndaj pas disa kohësh u konsiderua si vullnetar. I propozuan të vazhdonte shkollën për të marrë maturën e për t'u bërë mësues. U kthye në Shkodër dhe hyri në organizatën «Bashkimi kombëtar», e cila e dërgoi që të punonte në favor të saj në gjimnazin e Tiranës. U emërua mësues në Jug. Më 1950 u arrestua dhe u dënua me 20 vjet burg. Pasi doli nga burgu, punoi në NSHN. Vdiq më 1992.

Më 1995 iu dha medalja «Per veprimtari patriotike» me motivacionin: «I shquar për veprimtari patriotike gjatë gjithë jetës, kundërshtar i vendosur i diktaturës komuniste».

ÇEJKU Ali

Lindi në vitin 1923 në Kukës. U ekzekutua pa gjyq më datë 10 shkurt të vitit 1945.

Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Arkivit, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 10/5.

ÇEKA Selim

U dënua si «armik i popullit dhe sabotator i Pushtetit». Për këtë arsye, më 3 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Qendrës Elbasan urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 32, 16 prill 1947, f. 6.

ÇEKAJ Fran

Lindi në fshatin Vukël të Kelmendit. Më 25 prill të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit N.Ç. të Nënprefekturës së Malësisë së Madhe urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 63, 15 korrik 1946, fq. 6.

ÇEKANI Agim

Lindi më 6 dhjetor të vitit 1944, në Tiranë. Më 5 nëntor 1988, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimet e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes dhe agjitacionit e propagandë» dhe e dënoi me 18 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 163.

ÇEKIÇI Feriz

Lindi më 31 korrik të vitit 1939, në fshatin Starovë të Pogradecit. Më 16 janar 1959, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «përgatitje për t'u arratisur jashtë shtetit», dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë. Më 15 nëntor 1965 iu fal, me dekret, pjesa e mbetur e dënimit.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 406.

ÇEKIÇI Hasan


Lindi më 15 nëntor të vitit 1935, në fshatin Sllatinë të Dibrës. Më 30 janar 1980, Gjykata e Rrethit të Dibrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 272.

ÇEKINI Riza

Lindi në vitin 1917 në Korçë. Më 11 nëntor 1952, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e organizimit të një grupi kundërshtar» dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për një vit kohë. U lirua më 28 mars të vitit 1961.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 263.



Beqir Çela

ÇEKREZI Anton

Lindi më 30 korrik të vitit 1968, në fshatin Pjetërshan të Kelmendit. Më 9 dhjetor 1986, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 352.

ÇEKREZI Jonus

Lindi në Gramsh. Më 29 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Gramshit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 32, 16 prill 1947.

ÇELA Bajram

Lindi në fshatin Çerem të Tropojës. U internua me gjithë familjen në kampin e Çermës në Lushnjë.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 92.

ÇELA Beqir

Lindi në Durrës, në vitin 1918. Pasi kreu shkollën pedagogjike në Elbasan, punoi si mësues. U akuzua si pjesëmarrës në grupin e deputetëve. Dhe më 10 tetor 1947, u dënua me vdekje, pushkatim.

ÇELA Enver

Lindi më 27 janar të vitit 1903, në Progradec. U ekzekutua më 28 mars të vitit 1961.

Lista e personave të ekzekutuar për vitin 1961-1962, hartuar nga Dega e Hetuesisë së Drejtorisë së Policisë, Tiranë.

ÇELA Ferit

Lindi më 3 dhjetor të vitit 1936, në Burrel. Më 6 gusht 1957, Gjykata Ushtarake e deklaroi fajtor për «krimet: tentativë arratisjeje dhe agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Iu fal $\frac{1}{4}$ e dënimit të mbetur.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 233.

ÇELA Gëzim

Lindi më 23 maj 1935, në Lushnjë. Pas largimit të gjermanëve, në fund të vitit 1944 i ati, Mahmut Çela, në atë kohë ende prefekt i Durrësit, i sistemoi bashkë me të shoqen te disa të afërm në Ulqin. Të ndodhur në vështirësi, ata u kthyen në Tiranë, po nuk u lejuan të qëndronin, sepse tashmë u kishin konfiskuar shtëpinë. I ati, që nuk arriti të kthehej, më vonë u vendos në SHBA. Shkollën e mesme e kreu në Durrës, më 1956. U arrestua pak pas mbarimit të shkollës dhe pas 7 muajsh hetuesie në Dëgën e Punëve të Brendshme të Shkodrës, më 27 dhjetor 1957, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 12 vjet heqje lirie, konfiskim të pasurisë dhe heqjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «tradhëti ndaj atdheut». Më 6 prill 1964 iu fal mbetja e dënimit. U arrestua sërish më 1971 dhe më 12 korrik të po atij viti, Gjykata e Durrësit e dënoi me 8 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë». Pas Revoltës së Spaçit (21-23 maj 1973) u ridënua edhe me 15 vjet burg.

Vepra: «Klithma e një nëne: tregime të jetuara» (Tiranë, 2006), «Nga burgu i Spaçit drejt lirisë: tregime të jetuara dhe shqetësimet e tranzicionit» (Durrës, 2010).

Gëzim Kabashi, *Gëzim Çela, liria e çmuar e një durrsaku*, në «Gazeta e Durrësit», nr. 151, 12 prill 2012, f. 12-13; Gëzim Çela, *Klithma e një nëne: Tregime të jetuara*, Tiranë, 2006, f. 15, 19-21, 39-40, 65; AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 209.

ÇELA Hysen

Lindi në Vlorë. U ekzekutua si «kriminel luftime». Më 3 qeshor 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës Qendër Vlorë urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 78, 26 gusht 1946, f. 2.

ÇELA Hysen Sulejman

Lindi më 26 janar të vitit 1952, në fshatin Zabërzan të Skraparit. Më 1 shkurt 1980, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës dhe tentativës për t'u arratisur» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 177.

ÇELA Ilirjan

Lindi më 16 prill të vitit 1961, në Shkodër. Më 2 dhjetor 1985, Gjykata e Rrethit të Shkodrës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 436.

ÇELA Irfan

Lindi më 11 korrik të vitit 1919, në fshatin Selcë e Poshtme të Pogradecit. U dënua si «kriminel luftime». Më 4 qeshor 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Pogradecit urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së luajtshme të tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 69, 30 qeshor 1948, fq. 1.

ÇELA Jaho

Lindi në vitin 1900, në fshatin Murras të Elbasanit. Më 24 maj 1947, Gjykata Ushtarake e Elbasanit e deklaroi fajtor se «ka strehuar dhe furnizuar kriminelë», dhe e dënoi me një vit heqje lirie dhe punë të detyruar.



Pamje nga një seancë gjyqësore

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 411.

ÇELA Man

Lindi në vitin 1880, në fshatin Kovaç të Tropojës. Më 19 maj 1955, Gjykata Ushtarake e Shkodrës e deklaroi fajtor për «strehim e furnizim diversantësh» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 339.

ÇELA Mehmet

Anëtar i Ballit Kombëtar. Mori pjesë në luftime me çetën e Ali Zenelit nga Arانيتasi i rrethit të Fierit. U vra në fshatin Allambrez të Beratit, më 30 nëntor të vitit 1943, në përpjekje me «forcat partizane të komanduara nga Neshat Hysi».

ÇELA Meto

Lindi në fshatin Sevaster të Vlorës. Më 15 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kotës urdhëroi sekue-

strimin e gjithë pasurisë së tij, të luajshme e të paluajshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 26, 13 prill 1946, f. 7.

ÇELA Nustret

Lindi më 16 janar të vitit 1959, në Tiranë. Më 4 gusht 1976, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe dënoi me 8 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar). Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 25 gusht 1976. Po atë vit u arratis nga burgu, por u kap. Ndaj më 18 dhjetor 1976, Gjykata e Rrethit të Lezhës e deklaroi fajtor për «arratisje nga vendi i vuajtjes së dënimit» dhe dënoi me 1 vit e 6 muaj heqje lirie. Duke bërë bashkimin e dënimeve, përfundimisht u dënua me 8 vjet e 11 muaj heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 443.

ÇELA Rexhep

Lindi në vitin 1900, në Fier. U ekzekutua më 25 qershor të vitit 1945. Më 12 shtator të po atij viti, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Fierit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 70, 30 korrik 1946, f. 3.

ÇELA Sabri

Lindi në vitin 1907. U ekzekutua si antikomunist, më 30 dhjetor të vitit 1952.

ÇELA Sali

Lindi në vitin 1917, në fshatin Allambrez të Beratit. Gjatë luftës u rreshtua në radhët e Ballit Kombëtar. Mori pjesë në luftime me çetën e Ali Zenelit nga Arانيتasi i rrethit të Fierit. U vra në në fshatin e tij të lindjes, më 30 nëntor të vitit 1943, në përpjekje me «forcat partizane të komanduara nga Neshat Hysi».

ÇELA Selami

Lindi në vitin 1903 në Fier. U ekzekutua më 31 dhjetor të vitit 1943.

ÇELA Shefki

Lindi më 5 shtator të vitit 1939, në fshatin Kolonjë të Lushnjës. Më 12 shtator 1978, Gjykata e Rrethit të Kavajës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 217.

ÇELAJ Besnik

Lindi më 12 nëntor të vitit 1956, në Vlorë. Më 15 mars 1972, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «përgatitje për t'u arratisur jashtë shtetit» dhe dënoi me 3 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 3 prill të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 442.

ÇELAJ Fejzi

Lindi më 20 janar të vitit 1934, në fshatin Hormovë të Tepelenë. Më 12 gusht 1967, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 4 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 96.

ÇELAJ Iljas (Laze)

Lindi më 21 janar të vitit 1910, në Ballsh të Fierit. Më 15 qershor 1949, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «krimin e pjesëmarrjes aktive në bandë kriminale kundër pushtetit dhe për agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie e punë të detyruar.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 123.

ÇELAJ Muço

Lindi më 11 korrik të vitit 1894, në fshatin Gjorm të Vlorës. Më 1 tetor 1945, Gjykata Ushtarake e Vlorës e deklaroi «kriminel luftime» dhe e dënoi me 101 vjet burg dhe konfiskimin e pasurisë. Në bazë të ndryshimit të vendimit në *Gazetën zyrtare*, dënimi iu kthye në 30 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 90.

ÇELAJ Shpend

Lindi në vitin 1947, në fshatin Babinë të Tropojës. Më 14 korrik 1980, Gjykata e Rrethit të Tropojës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie dhe humbje të së drejtës elektorale për 3 vjet kohë (dënim i kombinuar). U arrestua sërish më 1985, dhe më 9 tetor të po atij viti, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut në formën e kryerjes së detyruar të agjenturës së huaj, tentativës së arratisjes dhe agjitacionit e propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 383.

ÇELIKU Kadri

Lindi më 13 prill të vitit 1931, në fshatin Breçaj të Devollit. Më 7 mars 1986, Gjykata e Rrethit të Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e agjenturës dhe pjesëmarrjes në organizata kriminale kundër pushtetit popullor» dhe për «agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 221.

ÇELIKU Musa

Një nga të dënuarit e të ashtuquajturit «Grupi i Zëmbllakut», që u akuzua se do të hidhte në erë kooperativën. U arrestua më 1959, së bashku me anëtarët e tjerë të këtij «grupi», dhe u dënua me 25 vjet heqje lirie.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 53.

ÇELIRAMA Etëhem

Lindi më 18 qeshor të vitit 1911, në Elbasan. U deklarua «armik i popullit». Më 9 Mars 1948, Komiteti Ekzekutiv i Rrethit të Elbasanit urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së të tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 38, 8 prill 1948, f. 1.

ÇELKUPA Shefqet

Lindi më 4 qeshor të vitit 1899, në Durrës. U dënua nga Këshilli Gjyqësor i Qarkut të Durrësit me vendim nr. 108, datë 24 nëntor 1945. Për këtë arsye, më 22 janar 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nën-prefekturës së Durrësit urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së paluajtshme të tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 30, 26 prill 1946, f. 2-3.

ÇELO Kajtaz

Lindi më 20 maj të vitit 1911, në fshatin Tatzat të Sarandës. Më 1945, Gjykata Ushtarake e Delvinës e dënoi me vdekje. Ky dënim iu kthye në 101 vjet burg, më vonë iu zbrit në 30 vjet dhe kur u lirua, me amnist, kishte vuajtur gjithsej 11 vjet burg.

ÇELO Kristo (Kiço)

Lindi më 10 maj të vitit 1888, në fshatin Mbrehzhdan të Përmetit. U dënua si «armik i popullit» dhe «sabotator». Më 16 gusht 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nën-prefekturës së Sarandës urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 108, 24 dhjetor 1947, fq. 4.

ÇELO Remzi

Diplomat.

Lindi në vitin 1904 në Leskovik. Studimet i kreu në Selanik. Punoi në shërbimin diplomatik nga viti 1933 e deri më 1939. Në vitet 1934-1939 shërbeu si konsull në Selanik, Greqi. Si dhëndër i Mehdi Frashërit, i internua me gjithë familjen, fillimisht në Kuç të Vlorës, e më vonë në fshatin Gradiisht të Lushnjës, ku dhe vdiq në vitin 1980.

Enver Memisha, *Masakra komuniste: arrestime, burgime, ekzekutime e internime mbi inteligjencien shqiptare*, në «55», 25 shkurt 2009, f. 17; Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, Tiranë, 2007, XXV, f. 319-320.

ÇELOALIAJ Dilaver

Lindi më 10 mars të vitit 1950, në fshatin Dukat të Vlorës. Më 7 korrik 1978, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 74.

ÇELOALIAJ Mislli

Lindi më 15 qeshor të vitit 1952, në fshatin Dukat të Vlorës. Më 7 korrik 1978, Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 71.

ÇELOALIAJ Nuri

Lindi më 14 korrik të vitit 1943, në fshatin Dukat të Vlorës. Më 14 korrik 1977,

Gjykata e Rrethit të Vlorës e deklaroi fajtor për «krimin e agitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 9 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 8.

ÇEMI Aleks

Lindi më 20 dhjetor të vitit 1938, në fshatin Malëshovë të Përmetit. Më 13 qershor 1960, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për akuzën «tradhëti ndaj atdheut».

Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1.

ÇEPALE Refik

Lindi më 3 janar të vitit 1920, në fshatin Jogodinë të Roskovecit. U deklarua «armik i popullit». Më 18 maj 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Fierit urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 61, 26 maj 1948, fq. 5.

ÇEPELI Bashkim

Lindi në Tiranë, më 5 prill të vitit 1954. Më 25 korrik 1986, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes jashtë shtetit» dhe e dënoi me 17 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 131.

ÇEPRATI Hamdi

Lindi në fshatin Çeprat të Vlorës. U ekzekutua si «kriminel lufte». Më 5 shkurt të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i K.N.Ç. të Nënprefekturës Qendër Vlorë urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 48, 30 maj 1946, fq. 7.

ÇEPRATI Tefik

Lindi në fshatin Çeprat të Vlorës. Më 27 shtator të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Topalltisë urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të tundshme e të patundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 116, 26 dhjetor 1946, f. 8.

ÇERÇISI Bexhet

Lindi në fshatin Starje të Kolonjës. U dënuar nga Gjykata Ushtarake «për faje kriminale». Më 22 nëntor të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kolonjës udhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 120, 31 dhjetor 1946, f. 5.

ÇERÇIZI Bedulla

Lindi në fshatin Çarshovë të Përmetit. U dënua si «kriminel lufte». Më 4 qershor të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Pogradecit urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së luajtshme të tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 69, 30 qershor 1948, fq. 1.

ÇERÇIZI Skënder

Lindi në fshatin Vranishtë të Vlorës. Më 15 janar të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Kotës urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 26, 13 prill 1946, f. 8.

ÇEREPI Ilirjan

Lindi më 29 janar të vitit 1961, në Tiranë. Më 10 qershor 1988, Gjykata e Rrethit të Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e agitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 302.

ÇERLOJ Hiqmet

Lindi më 1 prill të vitit 1923, në Durrës. Më 23 nëntor 1946, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi «sabotator dhe armik i popullit në bashkëveprim» dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 416.

ÇETRI Minella

Lindi më 15 prill të vitit 1942, në fshatin Lukovë të Sarandës. Më 22 qershor 1960, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e dekla-

roi fajtor për «krimin e stradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 4 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 151.

ÇETA Agron

Nga Kosova. U arrestua në vitin 1976 në Durrës.

Myrteza Bajraktari, *Një vështrim tjetër i historisë*, Tiranë, 2011, III, f. 218.

ÇETA Beniamin

Lindi në vitin 1937 në Tiranë. Më 8 mars 1982, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 247.

ÇIÇI Xhavit

Lindi më 31 dhjetor të vitit 1951, në qytetin e Tetovës, në Maqedoni. Më 29 gusht 1977, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës» dhe dënoi me 8 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 75.

ÇIFLIKU Ramadan

Lindi më 14 shkurt të vitit 1952, në fshatin Lapardha të Beratit. U arrestua më 12 shtator 1980. Më 19 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Beratit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie. Vendimi u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 14 janar 1981.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 403.

ÇIFTJA Ali

Ushtarak.

Lindi më 10 gusht të vitit 1910, në Peqin. Një pjesë të dënimit e vuajti në kampin e Urës së Bonos.

Ahmet Bushati, *Në gjurmët e nji ditari: Shkodra*

në vitet e para nën komunizëm, «Camaj-Pipa», Shkodër, 2007, III, f. 388.

ÇIFTJA Tahsim

U arrestua si pjesëtar i një grupi armiqësor. Pas vendimit me burg, u dërgua në kampin e Maliqit. Më 1 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Qendrës Elbasan urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 32, 16 prill 1947, f. 5; Bardha Nergjoni, *Familja Çiftja, shkëlqimi dhe rënia e një familjeje patriote*, në «Shekulli», 1 mars 2010.

ÇIKA Ali

Lindi më 5 shkurt të vitit 1929, në fshatin Kolonjë të Gjirokastrës. Më 8 shtator 1950, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor si «pjesëmarrës aktiv të një grupi të organizuar anti-pushtet» dhe dënoi me 15 vjet heqje lirie me punë të detyruar, konfiskim e pasurisë së luajtshme e të paluajtshme dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë Ushtarake, më 29 mars 1951. U lirua me kusht më 27 shtator të vitit 1960.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 426.

ÇIKA (MARTINELI) Elsa

Arbëreshe e Italisë, e ardhur në Shqipëri në vitet '30-të, pasi ishte martuar me publicistin e njohur të kësaj kohe, Nebil Çikën [shih]. Një zonjë e arsimuar dhe me kulturë të lartë, me një kontribut të spikatur në emancipimin e gruas shqiptare. U shpall kriminele lufte dhe armike e popullit. U riatdhesua në vitin 1946 si shtetase italiane. Më 29 shtator të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të qytetit të Tiranës urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së luajtshme të saj.

Gazeta Zyrtare, nr. 99, 15 nëntor 1948, fq. 8.

ÇIKA Nebil

Një nga publicistët e mendimtarët më të njohur shqiptarë të viteve '30-të.

Lindi në fshatin Borsh të Sarandës, më

1893. Mbaroi studimet në kolegjin francez të Korfuzit dhe studimet e larta në Stamboll. Atje, bashkë me Baha Tefikun, botoi një revistë satirike, e cila pas një viti u ndalua nga autoritetet. Botoi artikuj në gazetat dhe revistat me më zë të Stambollit dhe njihet si një nga përkthyesit e parë të Niçes në Turqisht. Qe redaktor dhe kryeredaktor i mjaft organeve të shtypit shqiptar të atyre viteve, si «Revista Pedagogjike», «Reforma», «Java», «Arbëria», «Miku i Popullit», «Minerva», «Bota e Re» etj. U pushkatua pa gjyq, më 12 nëntor të vitit 1944. Dy vjet më vonë, më 1946, e shoqja, Elsa Martineli [shih], me origjinë nga arbëreshët e Italisë, u largua nga Shqipëria. Më 29 shtator 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të qytetit të Tiranës urdhëroi sekuestrimin e pasurisë së luajtshme të tij.

Në dhjetor të vitit 2009, Presidenti i Republikës e dekoroi me Urdhërin «Nderi i Kombit», bashkë me 36 intelektualë të tjerë të Tiranës të vrarë nga komunistët në periudhën 28 tetor-16 nëntor 1944, me motivacionin: «Të martirizuar nga terrori komunist për shkak të besimit në idetë demokratike perëndimore të zhvillimit të Shqipërisë pas Luftës II Botërore».

Vepra: «Njimendësija shqiptare: Studim politik e psikologjik» (Tiranë, 1943).

Mitrush Kuteli, *Shënime letrare*, Tiranë, 1944; *Gazeta Zyrtare*, nr. 99, 15 nëntor 1948, fq. 8; Arshi Pipa, *Communism and Albanian Writers*, 1959; Maksim Husi, *Dy fjalë për lexuesin*, në «Njimendësia shqiptare», Tiranë, pa datë, f. 129; gazeta «Mapo», nëntor 2012.

ÇIKA Sorkadh

Lindi në vitin 1928, në fshatin Borsh të Sarandës, në një familje të njohur nacionaliste. Që fëmijë mori pjesë në rezistencën kundër pushtuesve. U arrestua në vitin 1949 bashkë me një grup të konsiderueshëm intelektualësh nga i grithë rrethi i Sarandës, kur punonte si mësues në zonën e Konispolit. Ishte pjesëtar i një grupi intelektualësh antikomunistë të rrethit të Sarandës e më gjerë. U izolua dhe u torturua në mënyrë çnjerëzore për më

shumë se një vit në bodrumet e Kalasë së Gjirokastrës. U dënua nga Gjykata Ushtarake Gjirokastrë me 16 vjet heqje lirie me akuzën: «përpjekje e organizuar (në grup) për përmbysjen e pushtetit popullor». Vdiq në Tiranë, më 25 dhjetor të vitit 2005.

ÇIKOLLA Niko

Lindi në fshatin Dhuvjan të Gjirokastrës. U dënua nga Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës si «kriminel lufte dhe armik i popullit». Veç ndëshkimit penal, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës Qendër të Gjirokastrës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 1, 2 kallnor 1947, f. 7.

ÇINIU Meshan

Lindi më 15 korrik të vitit 1928, në Delvinë. Kur u arrestua më 1952, ishte ende gjimnaziste. Më 30 mars 1953, Gjykata Ushtarake e Durrësit e deklaroi fajtorë për «krimet: tradhëti ndaj atdheut; agjitacion e propagandë dhe moskallëzim të krimit të tradhëtisë», dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë, si dhe humbjen e të drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Më 3 shtator 1962 iu falën 2 vjet nga dënimi.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 384; Tomor Aliko, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, Tiranë, 2007, f. 264.

ÇIPA Andrea

Lindi më 4 prill të vitit 1921, në fshatin Pilur të Vlorës. Më 17 qershor 1947, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «përgatitje për t'u arratisur jashtë shtetit» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie dhe punë të detyrueshme. U lirua me dekret të Presidiumit të Kuvendit Popullor të 27 prillit të vitit 1949.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 446.

ÇIPI Lavdim

Lindi më 20 gusht të vitit 1960, në fshatin Arzë të Devollit. Më 31 mars 1980, Gjykata e Qarkut të Korçës e deklaroi faj-

tor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor, të kryer në bashkëveprim» dhe e dënoi me 3 vjet heqje lirie. U lirua më 8 gusht 1982.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 389.

ÇIPI Vasil

Lindi më 19 dhjetor të vitit 1933, në Durrës. U arrestua më 1961 dhe më 15 shtator të po atij viti, Gjykata Ushtarake e Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës dhe për arratisje jashtë shtetit, të mbetur në tentativë» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për një vit kohë. U lirua me amnisti më 1963.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 129.

ÇIPLLAKA Agron

Lindi më 24 nëntor të vitit 1963, në Fier. Më 4 qeshor 1980, Gjykata e Rrethit të Fierit e deklaroi fajtor për «krimet e agjitacionit e propagandës dhe tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 11 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 118.

ÇIRA Xheladin

Lindi më 12 maj të vitit 1935, në qytetin e Tetovës, në Maqedoni. Më 2 gusht 1968, Gjykata e Rrethit të Durrësit e deklaroi fajtor për «krimet: tradhëti ndaj atdheut, tentativë arratisjeje dhe ndihmë për arratisje» dhe e dënoi me 15 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 275.

ÇIRRAGA Selman

Lindi në Elbasan. U dënua si «armik i popullit». Për këtë arsye, më 6 gusht të vitit 1946, Komiteti Ekzekutiv i Nënprefekturës së Qendrës Elbasan urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 28, 29 mars 1947, f. 6.

ÇITAKU Alush

Kushëri i Ramadan Çitakut [*shih*]. Lindi në Drenicë të Kosovës. U burgos në

Goli Otok, por meqenëse kishte shtetësi shqiptare, u riadhesua bashkë me gruan e fëmijët. U internua në kampin e Çermës në Lushnjë.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 90.

ÇITAKU Zyhdi

Funksionar i lartë i Kundërzbulimit Shqiptar, nip i Ramadan Çitakut.

Lindi më 28 qeshor të vitit 1934, në Durrës. Më 1945 u dërgua në Beograd, ku kreu shkollën e spiunazhit. Për gati tri-dhjetë vjet punoi në kundërspiunazh, si në Austri, Çeki, Gjermaninë Perëndimore, Francë, Belgjikë e Itali: në vitet e fundit të aktivitetit të tij kishte në komandë mbi 60 oficerë shqiptarë të Sigurimit, që ishin hedhur në Perëndim. Pas kthimit në Shqipëri, u caktua të organizonte diversionin në Jugosllavi, por që të mos dilte sekreti, u emërua llogaritar në fermën e Roshnikut në Berat. Pas shtatë vjetësh u thirr të paraqitej në Ministrinë e Brendshme, por sapo doli nga shtëpia u arrestua prej vetë kryetarit të Degës së Beratit. Bëri dy vjet hetuesi në birucat e burgut të Tiranës: u akuzua se, në emër të Sigurimit të Shtetit, kishte vepruar kundër shtetit, atdheut dhe popullit shqiptar dhe se kishte organizuar vrasjen e 14 bashkëpunëtorëve të Sigurimit në emigracion. Në gjyqin e fshehtë që u organizua në Tiranë u dënua me vdekje. Pas dy muajsh, Presidiumi i Kuvendit Popullor ia uli dënimin në 25 vjet heqje lirie.

At Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue: Robnia e gjatë*, Pjesa e tretë: 1967-1989, Tiranë, 2000, f. 326-330.

ÇITOZI Bardhyl

Lindi më 11 mars të vitit 1957, në Krujë. Më 17 qershor 1976, Gjykata e Rrethit të Krujës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut të kryer në formën e arratisjes mbetur në fazën e përgatitjes» dhe dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë (dënim i kombinuar). Gjatë kohës

së burgut u ridënua sërish: më 11 shtator 1980, Gjykata e Rrethit të Mirditës e deklaroi fajtor për «agjitacion dhe propagandë», dhe e dënoi me 12 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 441.

ÇITOZI Gëzim

Lindi më 14 maj të vitit 1957, në Krujë. Më 8 janar 1981, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë edeklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 13 vjet burg (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 77.

ÇIZMJA Dëshir


Lindi më 11 shkurt të vitit 1951, në Shijak. Më 23 qershor 1976, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e përgatitjes për arratisje jashtë shtetit» dhe e dënoi me 18 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar). Ky vendim u la në fuqi edhe nga Gjykata e Lartë, më 14 korrik të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 391.

ÇOBA Ejëll

Një nga djemtë e regjentit të Shqipërisë, Gjon Çobës, veprimtar politik, sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, ndihmësministër.

Lindi 12 mars të vitit 1908, në Shkodër. Arsimin fillor e kreu në qytetin e lindjes e më pas, për 13 vite me rradhë, studijoi në Itali, studime të cilat i përmbylli me gradën Doktor në Jurisprudencë në Universitetin «La Sapienza» të Romës, më 1932. U kthye në vendlindje, ku ndoqi karrierën profesionale e politike. Mes viteve 1935-1944 mbajti poste e detyra të rëndësishme politike e shoqërore: avokat, gjyqtar, sekretar i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave dhe ndihmësministër. Në krye të dy viteve arrati, u arrestua më 2 nëntor të vitit 1946. Pas katër muajsh tortura nga më çnjerëzoret, më 20 maj 1947 Gjykata Ushtarake e Garnizonit Tiranë, e formuar prej major Gjon Banushit (kryetar), nëntoger Vasil Karajanit dhe aspirant Xhevdet Fishkut (anëtarë)



Ejëll Çoba

dhe me praninë e prokurorit kapiten Petrit Hakani, filloi procesin gjyqësor kundër tij. Tetë ditë më vonë, më 28 maj të po atij viti, u shpall fajtor për disa akuza dhe, në bazë të nenit 16 të ligjit nr. 372, datë 12. 12. 1946 dhe nenit 15 të ligjit nr. 373, datë 12. 12. 1946, u dënua me vdekje. Më 16 qershor 1947, ky vendim iu përcoll për gjykim përfundimtar Gjykatës së Lartë Ushtarake, e cila vendosi kthimin e dënimit nga me vdekje në burgim të përjetshëm. Dënimin e vuajti në disa burgje të vendit, si në atë të Bedenit në Kavajë, Orman-Pojanit në Korçë, në burgun e Tiranës, si dhe në burgun famëkeq të Burrelit. U lirua më 8 prill 1970 «për plotësim afati». Pas daljes nga burgu, mes viteve 1973-1978, shkroi librin me kujtime «Jetë e humbun». Vdiq në vitin 1979.

Ejëll Çoba, *Jetë e humbun*, Tiranë, 2010.

ÇOBA Imzot Ernest M.

Klerik i lartë katolik, Provikar i Arki-dioqezës së Shkodrës (1946-1952), Ispeshkëv titullar i Midaeum-it (21 janar 1952), Sekretari i Përgjithshëm i «Kryesisë së Kishës Katolike të Shqipërisë» (1952-1956), Kryetar i «Kishës Katolike të Shqipërisë» (9 nëntor 1956-21 mars 1957).



Imzot Ernest M. Çoba

Lindi më 16 shkurt të vitit 1913, në Laç të Vaut të Dejës, ku familja e tij, një prej më të vjetrave të Shkodrës, ishte vendosur në kohën e rrethimit të qytetit nga malazezët. Mësimet fillore e të mesme i kreu në Kolegjin Saverian e në Seminarin Papnor në Shkodër. Kreu studimet e larta për teologji e filozofi. Më 9 shkurt të vitit 1936 u shugurua meshtar nga delegati apostolik dhe administratori i Arkidioqezës së Shkodrës, Imzot Giovanni della Pietra S. J., dhe pas dy ditësh çoi meshën e parë. Shërbeu në detyra të ndryshme pranë Seminarit Papnor e si mësues i besimit ndër shkolla të qytetit (1938-1946). Më 19 mars 1936 u zgjodh ndihmës famullitar i Shkodrës. Në vitet '46-'52 është provikar i Arkidioqezës së Shkodrës dhe famullitar i qytetit. Pas vdekjes së Imzot Gaspër Thaçit, arrestimit të Dom Mikel Koliqit [shih] dhe vdekjes së Dom Tomë Lacës [shih], i ngarkohen të gjitha detyrat e shërbimit në Kishën Katedrale të Shkodrës. Më 21 janar 1952 u emërua Ipeshkëv titullar i Midaeum-it: u shugurua më 20 prill të po atij viti nga Ipeshkvi i Pultit dhe «Kryetari i Kishës Katolike të Shqipërisë», Imzot Bernardin Shllaku O.F.M. [shih]. Që prej kësaj kohe e deri më 9 nëntor 1956,

kur vdiq Imzot Shllaku, kreu detyrën e Sekretarit të Përgjithshëm të «Kryesisë së Kishës Katolike të Shqipërisë», kurse nga 9 nëntori 1956 deri më 21 mars 1957 atë të «Kryetarit» të saj. Gjatë kësaj kohe, me ndihmën e të motrës, mbajti marrëdhënie të fshehta me Selinë e Shenjtë nëpërmjet Legatës italiane në Tiranë. Sa herë që e motra shkonte në Legatë për të marrë pensionin e të shoqit italian, dorëzonte edhe materialet e Imzotit të shkruara në letra cigaresh. Për këtë arsye u arrestua më 29 prill të vitit 1976. Plot një vit më vonë, më 29 prill 1977, Gjykata e Rrethit të Shkodrës, me akuzën «tradhëti ndaj atdheut dhe agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor», e dënoi «me 25 vjet të heqjes së lirisë, konfiskimin e pasurisë dhe heqjen e të drejtës elektorale për 5 vjet.» Dënimin e vuajti në burgun e Tiranës, ku vdiq në mënyrë të mistershme, pas një injeksioni që iu bë në spitalin e burgut më 8 janar të vitit 1980. Me rënien e Komunizmit, eshtrat e tij u rivarrosën në Katedralen e Shkodrës, me ç'rast u celebrua dhe një meshë nga Nunci Apostolik, Imzot Ivan Diazi dhe Imzot Zef Simoni [shih].

Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë, 2009, II, f. 458-462; АМРВ, D. 3359; *Persekutimi i Kishës Katolike në Shqipëri nga 1944-1990*, në *Krishtërimi ndër shqiptarë*, Shkodër, 2000, f. 376; Dr. Pjetër Pepa, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri*, Tiranë, 2007, Vol. II, f. 498-503; Markus W. E. Peters, *Përballjet e historisë së Kishës Katolike në Shqipëri 1919-1996*, Shkodër, 2010, 5, f. 281-283.

ÇOBA Mikel (Kel)

Një nga djemtë e regjentit të Shqipërisë, Gjon Çobës, diplomat.

Lindi më 10 shkurt të vitit 1910, në Shkodër. Studimet e larta i kreu në Universitetin e Torinos. Më 1936 u punësua në Ministrinë e Punëve të Jashtme, ku punoi në shërbimin diplomatik deri më 1944. Bashkëpunëtor i Riza Danit [shih]. U arrestua më 1946 pse kishte strehuar të vëllain, Ejëll Çobën [shih], dhe u dënua me 25 vjet heqje lirie. Vdiq në Shkodër, më 1969.

Agim Musta, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, Ti-



Ndoc Çoba

ranë, 2007, XXV, f. 320; Ejëll Çoba, *Jetë e humbun*, Tiranë, 2010.

ÇOBA Ndoc

Veprimtar politik, Ministër i Financave (1920), kryetar i bashkisë së Shkodrës (27 gusht 1937-24 qershor 1939), një nga organizatorët e Konferencës së Pezës, botues.

Lindi më 1870 në Shkodër, ku përfundoi dhe Kolegjën Saveriane. Studimet e larta për ekonomi i kreu në Venedik. Në vitin 1908 u zgjodh kryetar i klubit «Gjuha Shqipe. Në vitet 1909-1910 u caktua drejtor i përgjithshëm i doganave shqiptare. Mori pjesë në Kuvendin Kombëtar të Vlorës e, më pas, më 1918, në Kongresin e Durrësit. Dy vjet më vonë, më 1920, përfaqësoi Shkodrën në Kongresin e Lushnjës. Në qeverinë që doli nga ky kongres iu ngarkua detyra e Ministrit të Financave. Botoi gazetën «Ora e Maleve». Në vitet 1928-1936 u zgjodh kryetar i asamblesë bashkiake të Shkodrës, kurse nga 27 gushti i vitit 1937 e deri më 24 qershor 1939 kryetar i bashkisë së qytetit. Nuk u pajtua asnjëherë me pushtimin fashist të Shqipërisë, ndaj dhe më 16 shtator të vitit 1942, së bashku me figura të njohura të kohës, si Ymer Dishnica, Mus-

tafa Gjinishi etj., organizoi Konferencën e Pezës, që synonte bashkimin e të gjithë forcave antifashiste. Në nëntor 1942 u internua në Ventotene, në afërsi të Bergamos në Itali. Pas kapitullimit të Italisë u kthye në atdhe, ku mori pjesë aktive në Lëvizjen e Legalitetit (1943-1945). Me mbarimin e luftës, edhe pse në moshë të thyer, në janar 1945 u arrestua nga komunistët si bashkëpunëtor i gjermanëve dhe pas tre muaj torturash në hetuesi, vdiq në burg në mars të po atij viti.

Vladimir Misja, Fatmira Rama, *ÇOBA Ndoc*, në «Fjalor Enciklopedik Shqiptar», 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 399.

ÇOBA Rruzhdii

Lindi në Shkodër. Studimet e larta për financë dhe ekonomi i kreu në Bolonjë. U arrestua aty nga fundi i vitit 1944, i akuzuar se kinse donte të themelonte një parti politike me emrin «Demokracia islamike». Pas burgut të gjatë, u lejua të punonte si berber. Por pak para se të dilte në pension, u arrestua sërish dhe u dënua me dhjetë vjet heqje lirie «për agjitacion e propagandë».

At Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue: Robnia e gjatë*, Pjesa e tretë: 1967-1989, Tiranë, 2000, f. 335-336.

ÇOBA Shaqe (Marie)

Një nga intelektualet e para shkodrane, themeluese e Komitetit «Gruaja Shqiptare», veprimtare e lëvizjes për lirinë kombëtare dhe emacipimin e gruas.

Lindi në vitin 1875, në Shkodër, ku mori dhe mësimet e para. Të mesmen e kreu në shkollën e një kuvendi austriak në Kroaci, kurse studimet e larta për shkenca politike në Firence. Më 3 gusht 1920 themeloi në Shkodër Komitetin «Gruaja Shqiptare». Ky komitet u krijua kryesisht për të grumbulluar ndihma për forcat shqiptare që luftonin për mbrojtjen e Shkodrës nga agresioni jugosllav (Lufta e Koplikut). Për të informuar publikun lidhur me punën e bërë nga «Gruaja Shqiptare», nga nëntori i vitit 1920 deri në korrik 1921 Komiteti



Shaqe (Marie) Çoba

botoi dhe revistën «Gruaja shqyptare». Në vitet 1925-1939 ishte nënkryetare e degës së Shoqërisë «Gruaja Shqyptare» për Shkodrën. Mori pjesë në luftë bashkë me të shoqin, Ndoc Çobën [shih]. Pas luftës u dënua për qëndrim kundër pushtetit komunist. Në vitin 2002, me rastin e nëntëdhjetë vjetorit të Pavarësisë, Presidenti i Republikës i akordoi Urdhërin «Naim Frashëri» (pas vdekjes), për pjesëmarrjen e saj në lëvizjen kombëtare të vitit 1920, si luftëtare «kundër ndarjes së Shqipërisë dhe për emancipimin e gruas shqiptare».

Zenepe Dibra, *ÇOBA Shaqe (Marie)*, në Francisca de Haan, Krassimira Daskalova and Anna Loutfi (Edited and with an introduction by), «A Biographical Dictionary of Women's Movements and Feminisms: Central, Eastern, and South Eastern Europe», CEU Press, Budapest, 2006, f. 99-101; Fatmira Musaj, *ÇOBA Marie*, në «Fjalor Enciklopedik Shqiptar», 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008, f. 399.

ÇOBAJ Rait

Lindi më 28 tetor të vitit 1936, në fshatin Matogjin të Vlorës. Në korrik 1966 u dënua me 5 vjet e 6 muaj heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 381.

ÇOBO Esat

Lindi në vitin 1935, në fshatin Trev-

llazën të Vlorës. Më 27 nëntor 1956, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «veprën përgatitore të tradhëtisë» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe konfiskimin e pasurisë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 186.

ÇOBO Muço

Lindi më 6 shkurt të vitit 1922, në fshatin Poshnjë të Beratit. Më 16 dhjetor 1976, Gjykata e Beratit e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë për «agjitacion e propagandë» (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 242.

ÇOBO Ushtar

Lindi më 19 gusht të vitit 1949, në fshatin Polizhan të Beratit. Më 7 janar 1978, Gjykata Ushtarake e Rrethit të Beratit e dënoi me 25 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «arratisje jashtë shtetit».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 6.

ÇOÇA Shyqyri

Lindi në fshatin Çoçaj të Tiranës. U deklarua «armik i popullit». Për këtë arsye, më 31 janar të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës së Shijakut urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 28, 29 mars 1947, f. 5.

ÇOÇKA Hazis

Lindi më 10 korrik të vitit 1943, në fshatin Podgorie të Korçës. Më 14 gusht 1961, Gjykata Ushtarake e Gjirokastrës e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie. Ky vendim u la në fuqi edhe nga Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Lartë, më 30 shtator të po atij viti.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 429.

ÇOÇOLI Hysen

Lindi më 4 qeshor të vitit 1908, në Gjiro-kastër. U dënua si «armik i popullit». Më 6 shtator 1946, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nënprefekturës Qendër Gjirokastrë udhëroi sekuestrimin e 2/3 të pasurisë së tij. Dy muaj më vonë, më 7 nëntor 1946, edhe Komiteti Ekzekutiv i Nën-prefekturës Qendër Korçë urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij të tundshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 33, 3 maj 1946, f.3; *Gazeta Zyrtare*, nr. 96, 18 tetor 1946, f. 3.

ÇOKA Kostandina

Lindi në Tiranë. U akuzua si «kriminele lufte dhe armike e popullit». Më 4 qeshor të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Tiranës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së saj.

Gazeta Zyrtare, nr. 65, 14 qeshor 1948, fq. 8.

ÇOKA Profi

Tregtar.

Lindi më 10 mars të vitit 1910, në Tiranë. Të mesmen ekonomike e kreu në Rumanë. Anëtar i grupit të rezistencës «Bashkimi Demokrat Shqiptar». U arrestua më 2 shkurt të vitit 1946 dhe u dënua me vdekje, me pushkatim. Më vonë dënimi iu kthye në burgim të përjetshëm e pastaj në



Profi Çoka

101 vjet heqje lirie. Vdiq në vitin 1979, në moshën 70 vjeçare, në fshatin e Rozares, ku gjendej i internuar me gjithë familjen.

Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, «Kumi», Tiranë, 2009, I, III, f. 82.

ÇOKA Sabri

Lindi më 4 nëntor të vitit 1959, në fshatin Arrën të Kukësit. Më 2 qeshor 1979, Gjykata e Kukësit e dënoi me 16 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë, për «tradhëti ndaj atdheut» (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 173.

ÇOKA Theodhor (Todi)

Vëllai i Profi Çokës [*shih*]. Lindi në Tiranë. U shpall «kriminel lufte» dhe «armik i popullit» dhe u pushkatua pa gjyq. Më 4 qeshor të vitit 1948, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të rrethit të Tiranës urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 65, 14 qeshor 1948, fq. 8.

ÇOKU Aleksandër

Lindi më 5 dhjetor të vitit 1931, në Tiranë. Më 1 gusht 1952, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë e deklaroi fajtor për «zhvillimin e aktit të armiqësisë» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 7.

ÇOKU Bedri

Lindi më 16 janar të vitit 1949, në Lushnjë. Më 27 gusht 1969, Gjykata e Gjirokastrës e dënoi me 7 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë». Së bashku me vëllezërit e tij, Esatin [*shih*] dhe Çaushin [*shih*], si dhe me babanë e tyre, Azem Çokun [*shih*], kanë bërë gati një shekull burg, në Burrel e Spaç, në Qafë-Bari e nëpër kampet të ndryshme të punës të shpërndara nëpër të gjithë territorin e Shqipërisë. Në vitin 1973, gjatë revoltës së të burgosurve të Spaçit, ngriti flamurin kombëtar pa yllin komunist. U ridënua më 30 qeshor 1973 nga Gjykata e Mirditës për «sabotim» dhe «agjitacion e propagandë»



Bedri Çoku

me 23 vjet të tjera, konfiskim të pasurisë dhe heqjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë. Vazhdoi kalvarin e vuajtjeve deri në ditët e fundit të regjimit. Mbas rënies së diktaturës, kreu Fakultetin Juridik.

Vepra: «Dy vëllezër në një prangë» (poezi dhe tregime, bashkë me Çaush Çokun; Tiranë, 1995); «Burri që qan» (novela, tregime dhe ese; Tiranë, 2009).

Agim Musta, Visar Zhiti, Enver Lepenica, Tanush Mulleti, *Antologjia e plagëve nën terrorin komunist*, Tiranë, 2004, f. 115; AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 254.

ÇOKU ÇAUŠ

Lindi më 16 janar të vitit 1949, në fshatin Muçias të Lushnjës. Më 27 gusht 1969, Gjykata e Rrethit të Gjirokastrës e dënoi me 10 vjet heqje lirie për «agjitacion dhe propagandë kundër pushtetit popullor». U arrestua sërish më 1973 dhe më 21 korrik të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Mirditës e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë për «sabotim».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 72.

ÇOKU ESAT

Lindi më 5 korrik të vitit 1944, në Lushnjë. Më 14 janar 1980, Gjykata e Rrethit të Lushnjës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 427.

ÇOKU HAMIT

Lindi në fshatin Mbreshtan të Leskovikut. U deklarua «kriminel lufte». Për këtë arsye, më 21 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nën-prefekturës së Leskovikut urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 42, 8 maj 1947, f. 7.

ÇOKU NEIM

Lindi në fshatin Mbreshtan të Leskovikut. U deklarua «kriminel lufte». Për këtë arsye, më 21 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nën-prefekturës së Leskovikut urdhëroi sekuestrimin e të gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 42, 8 maj 1947, f. 6.

ÇOKU SYRJA

Lindi në fshatin Mbreshtan të Leskovikut. U deklarua «kriminel lufte». Për këtë arsye, më 21 mars të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i Këshillit Popullor të Nën-prefekturës së Leskovikut urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij, të luajtshme e të paluajtshme.

Gazeta Zyrtare, nr. 42, 8 maj 1947, f. 6.

ÇOLLAKU ABIT

Lindi në fshatin Zym të Prizrenit. Provoi shumë burgje dhe kampe të Jugosllavisë e Shqipërisë: Goli Otokun, Nishin, Tiranën, Prishtinën, Çermën.

Nazmi Berisha – Dyzi, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, Berat, 1995, f. 92.

ÇOLLAKU Gëzim

Lindi më 21 prill të vitit 1950, në fshatin Rakickë të Devollit. Më 24 maj 1967, Gjykata e Rrethit Gjyqësor të Korçës e deklaroi fajtor për «krimin tradhëti ndaj atdheut» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 387.

ÇOLLAKU Hamit

Lindi më 20 shtator të vitit 1943, në fshatin Kërçishtë të Dibrës. Më 8 shtator 1981, Gjykata e Qarkut të Dibrës e deklaroi fajtor «për krimet e tradhëtisë ndaj atdheut në formën e arratisjes të mbetur në fazën e përgatitjes dhe për agjitacion e propagandë kundër pushtetit», dhe e dënoi me 12 vjet e 4 muaj heqje lirie dhe me humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 359.

ÇOLLAKU Ilmi

Lindi më 25 korrik të vitit 1957, në fshatin Shuëc të Devollit. Më 13 shtator 1977, Gjykata e Korçës e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 7 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 167.

ÇOLLAKU Kristo

Lindi më 19 korrik të vitit 1958, në Delvinë. Më 1 qershor 1985, Gjykata e Sarandës e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 86.

ÇOLLAKU Lin

Kapterr në seksionin e Sigurimit të Shtetit në Shkodër, hetues, anëtar partie.

U arrestua në moshën 23 vjeçare, më 28 korrik të vitit 1948, bashkë me katër persona të tjerë, si anëtarë të një grupi që, sipas Prokurorisë Ushtarake të Tiranës me funksion në Shkodër, jo vetëm që kanë «bërë agjitacion dhe propagandë me gojë e



Drita Çomo

me shtyp», por për më tepër, kanë dashur «të kryejnë atentate kundër funksionarëve të partisë e të pushtetit». Është një nga hetuesit që u pushkatuan për të mos dalë e vërteta e futjes së armëve në kishë nga Sigurimi në nëntor të vitit 1946.

ÇOMI Thoma

Lindi më 8 shkurt të vitit 1938, në fshatin Tërbuq (Odrë) të Gjirokastrës. Më 22 shkurt 1963, Gjykata Ushtarake e Tiranës e dënoi me 10 vjet heqje lirie për «tradhëti ndaj atdheut». U arrestua sërish më 1975 dhe më 31 dhjetor të po atij viti, Gjykata e Rrethit të Gjirokastrës e dënoi me 10 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 3 vjet kohë për «agjitacion dhe propagandë».

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 73.

ÇOMO Drita

Shkrimtare.

Lindi në Tiranë, në vitin 1958. Në nëntor 1960, në moshën dy-vjeçare, u internua, për shkak të dënimit politik të nënës së saj, Liri Belishovës [shih]. I ati, Maqo Çomoja [shih], u dënua dhe u ridënua. Një pjesë të fëmijërisë dhe të adoleshencës e kaloi

e internuar në Kuç të Vlorës e më pas në Progonat të Kurveleshit. Së fundi u internua në Cërrik, ku dhe mbaroi shkollën e mesme, por për shkak të sëmundjes së rëndë dhe të keqdashjes, nuk arriti të kryente maturën. Vdiq fill e vetme në moshë fare të re, më 19 shkurt 1981, në Spitalin Onkologjik të Tiranës: as në grahmat e fundit nuk iu lejua që të kishte pranë të ëmën. Që nga 9 prilli i vitit 2012 shkolla 9-vjeçare e qytezës së Cërrikut mban emrin «Drita Çomo».

Vepra: «Dritë që vjen nga humnera» (di-tar, 1997).

ÇOMO Maqo

Lindi më 14 mars të vitit 1922, në Korçë. Në krye të 16 viteve internim u arrestua dhe, pas afër një viti hetuesie, u dënua me 10 vjet heqje lirie për «agjitacion e propagandë».

Agim Musta, Visar Zhiti, Enver Lepenica, Tanush Mulleti, *Antologjia e plagëve nën terrorin komunist*, Tiranë, 2004, f. 113.

ÇONIKU Fatbardh

Lindi më 1 janar të vitit 1954, në Skënderbegas të Gramshit. Më 3 prill 1980, Gjykata e Rrethit të Gramshit e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 6 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 135.

ÇONIKU Spartak

Lindi më 20 maj të vitit 1956, në Skënderbegas të Gramshit. Më 9 janar 1987, Gjykata e Gramshit e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 249.

ÇOTA Martin

Luftëtar antikomunist.

Lindi në fshatin Nikç të Kelmendit. U vra në përpjekje me forcat partizane më 7 shkurt të vitit 1945 në fshatin Rahovicë të Kelmendit.

Dr. Luigj Martini, *Prek Cali, Kelmendi dhe kelmendasit*, Shkodër, 2005, f. 246.

ÇUKA Bajram

Ushtarak me gradën kapiten, «Nderi i Kombit».

U pushkatuan pa gjyq në Sharrë të Tiranës, në nëntor të vitit 1944, bashkë me katër viktime të tjera: Selim Kelmendin [shih] nga Vuthajt e Gucisë, Ndue Palin [shih], Minella Toçin [shih] dhe Selaudin Korçën [shih], të birin e Hafëz Ali Korçës [shih], që vazhdonte studimet e larta në Itali. Kufomat e tyre u hodhën mbi njëri-tjetrin në një përrua.

Në dhjetor të vitit 2009, Presidenti i Republikës e dekoroi me Urdhërin «Nderi i Kombit», bashkë me 36 intelektualë të tjerë të Tiranës të vrarë nga komunistët në periudhën 28 tetor-16 nëntor 1944, me motivacionin: «Të martirizuar nga terrori komunist për shkak të besimit në idetë demokratike perëndimore të zhvillimit të Shqipërisë pas Luftës II Botërore».

ÇUKA Banush

Lindi më 2 shkurt të vitit 1959, në fshatin Çervenakë të Pogradecit. Më 2 shkurt 1980, Gjykata Ushtarake e Korçës e deklaroi fajtor për «agjitacion e propagandë» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 101.

ÇUKA Çelnik

Lindi më 15 maj të vitit 1944 në Korçë. Më 7 shkurt 1980, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e deklaroi fajtor për «tradhëti ndaj atdheut» dhe si «pjesëmarrës në një organizatë tradhëtare antisocialiste» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 293.

ÇUKA Stavri

Lindi më 15 shtator të vitit 1939, në Fier. Më 11 maj 1959, Gjykata Ushtarake e Tiranës e deklaroi fajtor për «krimin e përgatitjes së arratisjejes» dhe e dënoi me 2 vjet heqje lirie, humbjen e së drejtës elektorale për 2 vjet kohë dhe konfiskimin e pasurisë.

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 248.

ÇUKU Shaban

Lindi më 29 janar të vitit 1932, në Rrajcë të Librazhdit. Më 26 korrik 1963, mbështetur në nenin 73/1 të Kodit Penal, Gjykata e Rrethit të Elbasanit e dënoi me 5 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 102.

ÇULE Themistokli

Lindi më 27 maj të vitit 1926, në Voskopojë. Më 15 maj 1982, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Qarkut të Kukësit e deklaroi fajtor «se ka agjituuar e propaganduar kundër pushtetit popullor». Por meqenëse u deklarua i papërgjegjshëm, u vendos mbyllja e tij në spitalin psikiatrik të Elbasanit. Prej këtu u nxorr si i shëruar më 13 maj 1979.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 369.

ÇUNAJ Abedin

Lindi më 6 prill të vitit 1947, në fshatin Letaj të Hasit. Më 9 prill 1981, Gjykata e Rrethit të Kukësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacionit dhe propagandës kundër shtetit» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 4.

ÇUNI o.f.m. At Alfons

Klerik katolik.

Lindi në fshatin Bushat të Shkodrës, më 6 dhjetor të vitit 1900. Shkollën fillore dhe plotore e kreu në Kolegjin «Illyricum» dhe Seminarin Papnor në Shkodër. Në vitin 1917 nisi studimet e larta për teologji dhe filozofi në Grac të Austrisë, së bashku me At Çiprian Nikën [shih]. Për arsye shëndetësore i ndërpreu studimet në Grac dhe i përfundoi në Sangiano të Lombardisë. U shugurua meshtar në Romë, më 28 korrik 1924. Nga viti 1935 e deri kur u arrestua, shërbeu në shumë famulli të Veriut, si në Toplanë, Bizë, Theth, Hot, Plan dhe në Curraj të Epërm. U arrestua më 4 dhjetor të vitit 1946, sepse i gjetën një armë në murin e kishës, vendosur nga vetë

Sigurimi. U lirua dy vjet e gjysëm më vonë dhe iu kthye sërish shërbimit, fillimisht në Troshan, pak kohë në Bushat dhe vitet e fundit të jetës në Theth. Është një nga firmëtarët e Statutit të Kishës Katolike Shqiptare të vitit 1951. Pas ndalimit të fesë, u tërhoq tek te afërmit në Bushat. Vdiq më 6 dhjetor të vitit 1976.

P. Donat Kurti, *Provinca Françeskane Shqiptare (E ripertrime në vj. 1906)*, I, XXXI, f. 41; Dr. Pjetër Pepa, *Tragedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri*, Tiranë, 2007, vol. I, II, f. 696-697.

ÇUNI Gac

Mësues, kompozitor.

Lindi në vitin 1926, në Shkodër. Kreu Seminarin Jezuit dhe Liceun e Shtetit në Shkodër. Pas diplomimit punoi si mësues në Bajzë të Kastratit, ku dhe u arrestua me akuzën se kishte takuar të vëllanë e arratisur. Vdiq në burgun e Burreli pa i mbushur të tridhjetat. Në mars 1956, pak muaj para se të lirohej, pati një sulm apendiciti. Drejtori i burgut e la të vdiste pa e shtruar në spital. Kur vdiq, Arshi Pipa [shih], që e kishte patur nxënës, po dhe bashkëvuajtës në kampin e Bedenit në Kavajë, shkroi «Elegji për Gac Çunin».

Është dekoruar me urdhërin «Martir i Demokracisë» dhe «Qytetar Nderi i Shkodrës».

At Zef Pllumi, *Rrno vetëm për me tregue*, I, Tiranë, 1995, f. 155.

ÇUNI Ibrahim

Lindi më 23 nëntor të vitit 1959, në fshatin Letaj të Kukësit. Më 14 prill 1981, Kolegji Ushtarak i Gjykatës së Durrësit e deklaroi fajtor për «krimin e agjitacion e propagandës kundër pushtetit popullor» dhe e dënoi me 10 vjet heqje lirie (dënim i kombinuar).

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 142.

ÇUNI Mark

Seminarist, themelues i organizatës «Bashkimi Shqiptar».

Lindi në fshatin Rranxë të Bushatit (Shkodër), më 30 shtator të vitit 1919. Pas

shkollës fillore, kryer në fshatin e lindjes, përfundoi shkollën e mesme në Shkodër dhe, tetëmbëdhjetëvjeçar, filloi studimet në Seminarin Papnor të qytetit. Që në moshë të re botoi në revistat «Kumbona e së Djelës» dhe «Aurora Consurgens» shumë artikuj, poezi e përkthime. Luajti në dramën «Flije Atdheut», vepër me temë nga Lufta e Spanjës. Qe themelues i organizatës politike «Bashkimi Shqiptar» brenda seminarit. Kur organizata u zbulua, mbrëmjen e 7 dhjetorit 1945 Sigurimi arrestoi Mark Çunin, kurse më 31 dhjetor Atë Giovanni Faustin [shih] dhe Atë Daniel Dajanin [shih], si eprorë dhe përgjegjës të Seminarit. Në gjyqin që filloi më 31 janar të vitit 1946, ai mori mbi vete të gjithë përgjegjësinë për organizimin e «Bashkimit Shqiptar», duke shfajësuar kësisoj At Faustin dhe At Dajanin. Më 22 shkurt të të njëjtit vit, Gjykata e Qarkut të Shkodrës urdhëroi dënimin e tij me vdekje-me pushkatim, bashkë me pesë të arrestuar të tjerë: At Faustin, At Dajanin, At Gjon Shllakun [shih], Qerim Sadik Myftarin [shih] dhe Gjelosh Lulash Bajraktarin [shih]. Më 2 mars mbërriti miratimi për ekzekutimin e tyre, firmosur nga vetë Enver Hoxha. U ekzekutuan më 4 mars 1946, në varrezën e Rrmajit në Shkodër.

Pjetër Pepa, *Dosja e diktaturës*, Tiranë, 2009, I, III, 4, f. 46; VI, f. 62-63; *Shënime të Atit Luigi Rosa, S. J.*, në «Nji Seminar Papnor në vorbull të përndjekjes komuniste: Shkodër 1945-1946», Shkodër, 2008, f. 77.

ÇUNI Dom Mëhill

Klerik katolik.

Lindi në vitin 1871, në fshatin Rranxë të Bushatit (Shkodër). Studimet e mesme i kreu në Seminarin Papnor të Shkodrës, kurse të lartat në Itali, ku mori dhe shqurimin meshtarak. Meshën e parë e tha më 15 gusht 1893. Shërbeu si famullitar në fshatra të ndryshme të Pukës e Zadrimës, si në Shllak, Hajmel, Naraç, Pistull, Gjadër, Blinisht, Kryezi dhe Kçirë. U arrestua dhe bëri disa vite burg. Vdiq në vitin 1965, në moshën 94 vjeçare.



Mark Çuni

Dr. Pjetër Pepa, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri*, Tiranë, 2007, Vol. II, f. 343-344.

ÇUNI Tom

Më 26 dhjetor 1948, trupin e tij të vdekur e hodhën, bashkë me atë të Dom Zef Sirdanit [shih], Dom Pjetër Çunit [shih] dhe Nikë Markut [shih], në një gropë septike të Degës së Sigurimit në Koplik.

ÇUNI Dom Pjetër

Klerik katolik.

Lindi në Shkodër, më 9 korrik të vitit 1914. Shkollën fillore dhe liceun e kreu në Seminarin Papnor të Shkodrës, kurse teologjinë në Kongregatën Propaganda Fide në Romë. U shugurua meshtar më 23 mars 1940 në Bazilikën e Shën Pjetrit. Pasi u kthye në Shqipëri, shërbeu në famullitë e maleve përreth Shkodrës: Reç, Lohe (Shkrel) e Rrjoll. Dha një ndihmesë të vyer për revistën dioqezane «Kumbona e së Djeles». U arrestua pa motiv në Rrjoll më 27 korrik 1948, prej nga u dërgua i lidhur në Koplik. Këtu, së bashku me Dom Lekë (Aleksandër) Sirdanin [shih], i lidhën dhe i hipën mbi gomerë. I shëtitën kështu nëpër të gjithë qytetin, ndërsa i fyenin dhe aku-

zonin pareshtur. Në fund, më 26 dhjetor 1948, i hodhën të dy në një gropë septike dhe aty i mbytën duke i shtyrë me cfurk.

ÇUPI Edmond

Lindi më 18 maj të vitit 1959, në Shkodër. Më 12 shkurt 1987, Gjykata e Rrethit të Kukësit e deklaroi fajtor për «krimin e tradhëtisë ndaj atdheut» dhe e dënoi me 8 vjet heqje lirie.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 3.

ÇUPI Ndreç

Lindi më 17 prill të vitit 1921, në fshatin Kaçinar të Mirditës. Më 2 shtator 1952, Gjykata e Lartë e deklaroi fajtor si «bashkëpuntor e furnizues të diversantëve» dhe e dënoi me 20 vjet heqje lirie, konfiskimin e pasurisë dhe humbjen e së drejtës elektorale për 5 vjet kohë.

AISKK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 206.

ÇUPI Ndue

Lindi në fshatin Bisakë të Mirditës. U deklarua «kriminel lufte dhe armik



Dom Pjetër Çuni

i popullit». Më 20 shtator të vitit 1947, Komiteti Ekzekutiv i K.P. të Nënprefekturës së Mirditës urdhëroi sekuestrimin e gjithë pasurisë së tij.

Gazeta Zyrtare, nr. 105, 18 dhjetor 1947, fq. 2.

BIBLIOGRAFIA

BURIME ARKIVORE:

AQSh, F. 165, viti 1941, D. 11.
AQSh, F. 482, viti 1945, D. 3.
AQSh, F. 482, viti 1947, D. 3.
AQSh, F. 482, viti 1947, D. 6.
AQSh, F. 482, viti 1949, D. 2.
AQSH, Fondi «Safet Butka».

DËSHMI PENALITETI:

AISSK, F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 397; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 10; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 11; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 12; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 16; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 17; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 18; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 57; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 36; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 35; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 58; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 56; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 55; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 48; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 54; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 53; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 52; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 51; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 50; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 49; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 47; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 46; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 45; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 44; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 43; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 42; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 41; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 40; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 39; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 38; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 37; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 34; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 33; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 32; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 31; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 30; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 29; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 28; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 27; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 26; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 24; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 23; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 22; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 21; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 20; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 19; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 61; F. 1, V. 2012, D. 1, F. 62; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 63; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 64; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 65; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 66; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 68; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 67; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 9; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 69; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 70; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 2; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 76; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 74; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 8; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 71; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 75; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 77; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 6; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 73; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 7; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 72; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 1; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 114; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 5; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 4; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 3; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 104; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 105; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 107; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 109; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 108; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 110; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 111; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 112; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 113; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 115; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 116; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 117; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 118; F. 1, V. 2012, D. 1, Fl. 119; F. 1, V.

- D. 2, FL. 131; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 132; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 133; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 134; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 136; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 137; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 138; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 139; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 140; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 141; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 142; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 143; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 144; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 145; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 146; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 147; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 148; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 149; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 150; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 151; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 152; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 153; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 154; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 155; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 156; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 157; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 158; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 159; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 160; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 161; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 162; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 163; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 164; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 165; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 166; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 167; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 168; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 169; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 170; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 171; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 172; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 173; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 174; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 175; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 176; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 177; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 178; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 179; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 180; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 181; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 182; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 183; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 184; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 185; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 186; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 187; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 188; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 189; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 190; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 191; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 192; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 193; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 194; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 195; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 196; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 197; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 198; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 199; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 200; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 201; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 202; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 203; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 204; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 205; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 206; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 207; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 208; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 209; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 210; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 211; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 212; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 213; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 214; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 215; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 216; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 217; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 218; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 219; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 220; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 221; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 222; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 223; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 224; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 225; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 226; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 227; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 228; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 229; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 230; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 231; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 232; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 233; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 234; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 235; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 236; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 237; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 238; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 239; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 240; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 241; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 242; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 243; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 244; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 245; F. 1, V. 2012, D. 2, FL. 246.
- A.SH. Berat, Nr. Prot. 72, më 21. 12. 1993.
 - Lista nr. 1 (VKM 1699, datë 29. 12. 2008).
 - Dega e Hetuesisë së Drejtorisë së Policisë (hartuar nga), Tiranë, Lista e personave të ekzekutuar për vitin 1961-1962.
 - Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Drejtoria e Arkivit, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 10/5.
 - Republika Popullore Socialiste e Shqipërisë, Gjykata e Lartë, Regjistri i Gjendjes Gjyqësore, Tiranë, 2. 4. 1992, *Dëshmi*.
 - Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Administratës së Burgjeve, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, 19. 01. 1993.
 - Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Regjistri i Gjendjes Gjyqësore, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, Tiranë, 8. 10. 1992.

- Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Sektori i Arkivit Shtetëror të Sistemit, Vërtetim i gjendjes gjyqësore, nr. prot. 1529/1.
- Republika Popullore e Shqipërisë, Gjykata e Qarkut Gjirokastrë, no. 25 aktivi, no. 25 vendimi.
- Republika Popullore e Shqipërisë, Gjykata e Lartë, «Kolegji Ushtarak», nr. 71 i Radhorit themeltar, Vendimi nr. 2.
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Administratës së Burgjeve, Vërtetim nr. 65/4991.
- Republika e Shqipërisë, Spitali Psikiatrik «Dr. Filip Papajani», Elbasan, Vërtetim nr. 1113 regj.
- Republika e Shqipërisë, Gjykata e Rrethit Berat, Vendim nr. 1391.
- Republika e Shqipërisë, Qarku Berat, Rrethi Berat, Zyra e Gjendjes Civile, Çertifikatë vdekjeje, nr. 001 010066.
- Republika Popullore e Shqipërisë, Gjykata e Lartë, «Kolegji Penal», nr. 160 Regj. Themeltar, nr. 150 i vendimit.
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Rendit Publik, Dega e Arkivit, nr. 1161/1 Prot.
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Rendit Publik, Drejtoria e Administratës së Burgjeve, Vërtetim nr. 2265.
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Zyra e Gjendjes Gjyqësore, Vërtetim Gjyqësor, nr. 4218 i Prot.
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, Drejtoria e Çështjeve Ligjore dhe Problemeve Shqoqërore, Vërtetim, nr. Extra i Prot.
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Drejtësisë, Zyra e Gjendjes Gjyqësore, Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore Nr. 4218 i Prot.
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Sektori i Arkivit Shtetëror të Sistemit, Vërtetim, Nr. 1717/1 i Prot.
- Ministria e Rendit, Dega e Arkivit, nr. 2590/1; Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, nr. 404.
- AQSH, F. 14/AP, D. 620, fl. 22, V. 1949; Ministria e Drejtësisë, Regjistri i Gjendjes Gjyqësore, nr. 11080.
- Arkivi i MB, Gjykata Ushtarake e Kolonjës, vendimi nr. 6, dt. 19. 11. 1945; Ministria e Drejtësisë, Regjistri i Gjendjes Gjyqësore, v. 1945.
- Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 784, datë 01. 07. 2009: Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish-të përndjekurit politikë të regjimit komunist.
- Republika e Shqipërisë, Ministria e Brendshme, Sektori i Arkivit Shtetëror të Sistemit, Vërtetim, Nr. 1510/8 Prot.

PERIODIKË:

Fletorja Zyrtare e Mbretnisë Shqiptare

Fletorja Zyrtare e Mbretnisë Shqiptare, nr. 38, 24 qersher 1939; *Fletorja Zyrtare e Mbretnisë Shqiptare*, nr. 61, 17 prill 1940.

*Gazeta Zyrtare***1945**

Gazeta Zyrtare, nr. 47, 29 shtator 1945; *Gazeta Zyrtare*, nr. 52, 21 shtator 1945; *Gazeta Zyrtare*, nr. 67, 1 nëntor 1945; *Gazeta Zyrtare*, nr. 70, 8 nëntor 1945.

1946

Gazeta Zyrtare, nr. 2, 5 kallnor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 3, 7 kallnor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 7, 24 kallnor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 9, 31 kallnor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 14, 25 shkurt 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 20, 23 mars 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 21, 29 mars 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 26, 13 prill 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 30, 26 prill 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 33, 3 maj 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 34, 4 maj 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 35, 9 maj 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 38, 15 maj 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 40, 20 maj 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 41, 21 maj 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 42, 22 maj 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 44, 18 shkurt 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 44, 25 maj 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 47, 29 maj 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 48, 30 maj 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 49, 31 maj 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 50, 4 qeshor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 51, 12 qeshor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 52, 15 qeshor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 54, 20 qeshor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 55, 20 qeshor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 55, 24 qeshor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 57, 27 qeshor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 59, 5 korrik 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 60, 6 korrik 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 62, 12 korrik 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 63, 15 korrik 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 64, 16 korrik 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 67, 22 korrik 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 70, 30 korrik 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 72, 5 gusht 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 73, 6 gusht 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 75, 8 gusht 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 77, 24 gusht 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 79, 29 gusht 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 82, 3 shtator 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 87, 17 gusht 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 87-bis, 17 shtator 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 89, 23 shtator 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 94, 7 tetor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 96, 18 tetor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 106, 21 nëntor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 112, 14 dhjetor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 116, 26 dhjetor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 117, 27 dhjetor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 118, 28 dhjetor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 119, 30 dhjetor 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 120, 31 dhjetor 1946.

1947

Gazeta Zyrtare, nr. 1, 2 kallnor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 5, 22 kallnor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 7, 31 kallnor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 8, 4 shkurt 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 10, 11 shkurt 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 11, 13 shkurt 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 13, 18 shkurt 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 14, 20 shkurt 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 15, 22 shkurt 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 16, 24 shkurt 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 17, 25 shkurt 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 18, 26 shkurt 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 19, 27 shkurt 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 21, 4 mars 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 22, 8 mars 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 25, 18 mars 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 28, 29 mars 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 32, 16 prill 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 34, 18 prill 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 36, 23 prill 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 37, 26 prill

1947, f. 7; *Gazeta Zyrtare*, nr. 40, 5 maj 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 41, 7 maj 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 42, 8 maj 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 43, 10 maj 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 44, 14 maj 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 46, 19 maj 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 48, 26 maj 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 51, 29 maj 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 52, 3 qershor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 53, 3 qershor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 54, 6 qershor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 56, 20 qershor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 57 bis., 21 qershor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 58, 25 qershor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 62, 8 korrik 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 63, 15 korrik 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 76, 23 gusht 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 78, 26 gusht 1946; *Gazeta Zyrtare*, nr. 96, 31 tetor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 102, 9 dhjetor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 104, 16 dhjetor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 105, 18 dhjetor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 106, 19 dhjetor 1947; *Gazeta Zyrtare*, nr. 108, 24 dhjetor 1947.

1948

Gazeta Zyrtare, nr. 1, 2 janar 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 3, 5 janar 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 12, 20 janar 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 18, 4 shkurt 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 32, 25 mars 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 36, 3 prill 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 37, 7 prill 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 38, 8 prill 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 43, 26 prill 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 45, 29 prill 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 51, 8 maj 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 54, 15 maj 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 54, 8 maj 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 57, 19 maj 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 61, 26 maj 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 64, 11 qershor 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 65, 14 qershor 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 69, 30 qershor 1948; *Gazeta zyrtare*, nr. 81, 3 gusht 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 82, 3 gusht 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 89, 15 shtator 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 99, 15 nëntor 1948; *Gazeta Zyrtare*, nr. 102, 9 dhjetor 1948.

1950

Gazeta Zyrtare, nr. 1, 18 janar 1950.

Gazeta dhe revista

- *Gazeta «Besa»*, 6 prill 1932; 2 gusht 1937.
- *Revista «Jeta Kristiane»*, nr. 12, Tiranë, shkurt 1942.
- *Gazeta «Kombi»*, Tiranë, 19 shtator 1943.
- *Gazeta «17 Nandori»*, Tiranë, 23 dhjetor 1946.
- «*Gazeta Shqiptare»*, Tiranë, 26 shkurt 2002.
- «*Gazeta Shqiptare»*, Tiranë, 7 shtator 2002.
- «*Gazeta Shqiptare»*, Tiranë, 8 shtator 2002.
- *Gazeta «Panorama»*, Tiranë, 5 tetor 2009
- *Gazeta «Panorama»*, Tiranë, 2 maj 2011.
- *Gazeta «Mapo»*, Tiranë, 31 gusht 2011.
- *Gazeta «55»*, Tiranë, 27 dhjetor 2005.
- *Gazeta «55»*, Tiranë, 25 shkurt 2009.
- *Gazeta «55»*, Tiranë, 24 maj 2010.
- *Gazeta «55»*, Tiranë, 30 dhjetor 2010.
- *Gazeta «Ngjallja»*, nr. 12 (179), Tiranë, dhjetor 2007.
- «*Translation Review»*, The University of Texas at Dallas, nr. Seventy-six, 2008.
- *Revista «Perla»*, Fondacioni Kulturor «Saadi Shirazi», Tiranë, Viti XII, 2007, nr. 2 (45).
- *Gazeta «Shekulli»*, Tiranë, 1 mars 2010.

- Gazeta «Metropol», Tiranë, 29 dhjetor, 2009.
- Gazeta «Metropol», Tiranë, 10 qershor 2012.
- Gazeta «Atdheu», 26 mars-2 prill 2006.
- «Gazeta e Durrësit», nr. 151, 12 prill 2012.
- Gazeta «Dielli», 31 maj 2011.

BOTIME:

- AGAJ, RESHAT, *Vëllai i pengut: ditari i mbajtur në Amerikë*, «Europrint», Vlorë, 2009.
- AHMATAJ, KUJTIM, *Shenjti këmbëzbathur: Dede Ahmet Myftar Ahmataj (22 shkurt 1916-10 korrik 1980)*, Tiranë, pa datë.
- AHMATAJ, KUJTIM, *Loti i orarë*, «Adelprint», Tiranë, 2012.
- ALIKO, TOMOR, *Genocidi mbi elitën intelektuale të kombit shqiptar nën terrorin komunist*, «Maluka», Tiranë, 2007.
- BAJRAKTARI, MYRTEZA, *Një vështrim tjetër i historisë*, «West Print», Tiranë, 2011.
- BASHA, ALI M., *Rrugëtimi i fesë Islame në Shqipëri (1912-1967)*, Tiranë, 2011.
- BEDULI, DHIMITËR, *Kisha Orthodhokse Autoqefale e Shqipërisë deri në vitin 1944, në Kishë dhe Kulturë*, «Instituti i Dialogut dhe Komunikimit», Tiranë, 2006.
- BEDULI, KRISTOFOR, *Episkop Irine Banushi: martir i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë*, Botim i Kishës Orthodhokse Autoqefale të Shqipërisë; Tiranë, 2000.
- BERISHA – DYZI, NAZMI, *20 vjet në burgjet e Enver Hoxhës: Dëshmi për periudhën prej 1959-1980*, «UEGEN», Berat, 1995.
- BLOSHMI, BEDRI, *Rrëfime nga ferri komunist*, «Almera», Tiranë, 2011.
- BUSHATI, AHMET, *Në gjurmët e një ditari: Shkodra në vitet e para nën komunizëm*, «Camaj-Pipa», Shkodër, 2007.
- BUTKA, URAN, *Kryengritja e Postribës*, në «Almanak 1», botim i Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit, Tiranë, 2011, f. 61-71.
- BUTKA, URAN (Përg. e red.), *Safet Butka*, «Maluka», Tiranë, 2003.
- ÇELA, GËZIM, *Klithma e një nëne: Tregime të jetuara*, Globus R., Tiranë, 2006.
- ÇELO, KAJTAZ, *Kujtime: kalvari i jetës*, «Milosao», 2012.
- ÇOBA, EJËLL, *Jetë e humbun: Kujtimet e një të dënuemi me vdekje nga diktatura*, Tiranë, 2010.
- DEDEJ, GJYSH QAZIM, *Fillimet e Bektashizmit në Shqipëri dhe në Elbasan*, «Egnatia», Elbasan, 1997, f. 107.
- DERVISHI, KASTRIOT, *Revolta e Spaçit 21 – 23 maj 1973: Si u ngrit flamuri në kamp*, në «55», Nr. 140 (4205), E hënë, 24 maj 2010, f. 16-17.
- ELSIE, ROBERT, *Histori e letërsisë shqiptare*, «Dukagjini», Tiranë-Pejë, 1997.
- ELSIE, ROBERT, *Albanian Literature in the English-Speaking World*, në «Translation

- Review», The University of Texas at Dallas, nr. Seventy-six, 2008, f. 1-10.
- «Fjalor Enciklopedik Shqiptar», 1, Akademia e Shkencave e Shqipërisë, Tiranë, 2008.
 - GOGAJ, ILJAZ, *Ali Cungu, personalitet i shquar i arsimit dhe kulturës*, në «Perla», Fondacioni Kulturor “Saadi Shirazi”, Tiranë, Viti XII, 2007, nr. 2 (45), fq. 46-56.
 - GOGAJ, ILJAZ, *Punëtorë të shquar të shkollës shqiptare*, «Eurorilindja» dhe «Shtëpia e Librit», Tiranë, 2001.
 - GONXHJA, H.; GOGAJ, I.; BUMÇI, SH., *Ndihmesa e ish nxënësve dhe mësuesve të Shkollës Teknike të Tiranës për zhvillimin e vendit dhe luftën për çlirim e demokraci*, «Geer», Tiranë, 2006.
 - GRADICA, XHEVAHIR, *Si i dogjën e i vranë Allamanët e Matit*, në gazetën «Metropol», E martë, 29 dhjetor, 2009.
 - GRISHAJ, FRANZ-LLESH, *Shkreli dhe roli i tij në Kryengritjen Antikomuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945*, Simpoziumi shkencor me rastin e 60 vjetorit të Rezistencës dhe Kryengritjes Anti-Komuniste të Malësisë së Madhe të vitit 1945, mbajtur në Sallen «At Gjergj Fishta» në Kishën Katolike Shqiptare të Shën Palit në Rochester Hills, Michigan, U.S.A., më 6 shkurt 2005.
 - GJINAJ, MAKS; MELE, MARGARITA; ELMAZI, MYRVETE, *Bibliografi e librit shqip në fondet e Bibliotekës Kombëtare (1913-1944)*, Biblioteka Kombëtare, Tiranë, 2010.
 - DE HAAN, FRANCISCA; DASKALOVA, KRASSIMIRA and LOUTFI, ANNA (Edited and with an introduction by), «A Biographical Dictionary of Women’s Movements and Feminisms: Central, Eastern, and South Eastern Europe», CEU Press, Budapest, 2006.
 - HUSI, MAKSIM, *Dy fjalë për lexuesin*, në «Njimendësia shqiptare», «Kumi», Tiranë, pa datë.
 - *Il processo di Tirana*, “Edizioni di Cultura Sociale”, Roma, 1950.
 - KABASHI, GËZIM, *Gëzim Çela, liria e çmuar e një durrsaku*, në «Gazeta e Durrësit», nr. 151, 12 prill 2012, f. 12-13.
 - KALAKULLA, URAN, *21 vjet burg komunist*, IKK & Botimet «Fjala», Tiranë, 2008.
 - KALOÇI, DASHNOR, *Si u persekutuan intelektualët, Xhemal e Selfixhe Broja*, në «Gazeta shqiptare», 26 shkurt 2002.
 - KOLI, SHPËTIM, *Grupi i «sabotatorëve» të naftës*, në gazetën «Mapo», Tiranë, 31 gusht 2011, f. 18-19.
 - KORÇA, MËRGIM, *Histori të pashkruara*, «Media Enter», Tiranë, 2005.
 - KORDILEVA, ATË VASIL, *Papa Jorgji Kosta Bezhani*, në gazetën «Ngjallja», nr. 12 (179), Tiranë, dhejtor 2007, f. 9-10.
 - KURTI, P. DONAT, *Provinca Françeskane Shqiptare (E ripërtrime në vj. 1906)*, Shkodër, pa datë.
 - KUTELI, MITRUSH, *Shënime letrare*, Tiranë, 1944.
 - LOKA, ASLLAN, *Shqipëria, Dibra, Aliajt dhe Halil Alia*, «Dita 2000», Tiranë, 2008.

- LUBONJA, FATOS, *Ridënimi*, IKK & Botimet «Fjala», Tiranë, 2007.
- LUSHAKU, HILË, *Ministrat e Brendshëm 1912-2007*, vol. 1, Tiranë, 2009.
- LLANAJ, ASQERI, *Bektash Bej Cakrani: Historia flet vetë*, «Triptik», Vlorë, 2010.
- LLUKANI, ANDREA, *Kisha në diktaturë*, Botimet «Trifon Xhagjika», Tiranë, 2012.
- MARKO, PETRO, *Intervistë me vetveten (Retë dhe gurët)*, «OSMCA», Tiranë, 2000.
- MARTINI, DR. LUIGJ, *Prek Cali, Kelmendi dhe kelmendasit*, «Camaj-Pipa», Shkodër, 2005.
- *Martirizimi i Kishës Katolike Shqiptare 1944-1990*, Shkodër, 1993.
- MEMISHA, ENVER, *Masakra komuniste: arrestime, burgime, ekzekutime e internime mbi inteligjencien shqiptare*, në Gazeta «55», E mërkurë, 25 shkurt 2009, f. 16-17.
- MUSTA, AGIM, *Libri i zi i komunizmit shqiptar*, «Naim Frashëri», Tiranë, 2007.
- MUSTA, AGIM, *Kampet e internimit dhe trimat e dëshpërimit*, «Marin Barleti», Tiranë, 2012.
- MUSTA, AGIM; LEPENICA, ENVER, *Antologjia e krimit komunist*, «Geer», Tiranë, 2006.
- MUSTA, AGIM; ZHITI, VISAR; LEPENICA, ENVER; MULLETI, TANUSH, *Antologjia e plagëve nën terrorin komunist*, Qendra Shqiptare e Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës, Tiranë, 2004.
- NERGJONI, BARDHA, *Familja Çiftja, shkëlqimi dhe rënia e një familjeje patriote*, në Gazeta «Shekulli», 1 mars 2010.
- *100 personalitete shqiptare të kulturës islame: shekulli XIX-XX*, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, Tiranë, 2012.
- *Nji Seminar Papnor në vorbull të përndjekjes komuniste: Shkodër 1945-1946*, Qendra Botuese Shoqata Jezuite «Ylber», Shkodër, 2008.
- PEEBLES, CURTIS, *Twilight Warriors: Covert Air Operations Against the USSR*, Naval Institute Press, Annapolis, 2005.
- PEPA, DR. PJETËR, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri*, Vol. I, Shtëpia Botuese «55», Tiranë, 2007.
- PEPA, DR. PJETËR, *Tragjedia dhe lavdia e klerit katolik në Shqipëri*, Vol. II, Shtëpia Botuese «55», Tiranë, 2007.
- PEPA, PJETËR, *Dosja e diktaturës*, Botimet «Kumi», Tiranë, 2009.
- PEPA, SIMON, *Gjurmë kulturore: studime, artikuj, kumtesa*, «Camaj-Pipa», Shkodër, 2000.
- PETERS, MARKUS W. E., *Përballjet e historisë së Kishës Katolike në Shqipëri 1919-1996*, Qendra Botuese Shoqata Jezuite «Ylber», Shkodër, 2010.
- PLLUMI, AT ZEF, *Rrno vetëm për me tregue: Libri i kujtimeve*, Pjesa e parë: 1944-1951, «Hylli i Dritës», Tiranë, 1995.
- PLLUMI, AT ZEF, *Rrno vetëm për me tregue: Liria mes dy burgimeve*, Pjesa e dytë: 1950-1967, «Hylli i Dritës», Tiranë, 1997.
- PLLUMI, AT ZEF, *Rrno vetëm për me tregue: Robnia e gjatë*, Pjesa e tretë: 1967-1989, «Hylli i Dritës», Tiranë, 2000.

- RADOVANI (-DE ANGELIIS), FRITZ, *Një monument nën dhé*, Melbourne, 2004.
- SIMONI IPESHKËV, ZEF, *Dritat në errësinë: Persekutimi i Kishës në Shqipëri, Shtypshkronja e Kishës Françeskane*, Tiranë, 1994.
- SIMONI IPESHKËV, ZEF, *Ngjarje në tokë*, Shtëpia Botuese «At Gjergj Fishta», Shkodër, 1998.
- SIMONI, IMZOT ZEF, *Persekutimi i Kishës Katolike në Shqipëri nga 1944-1990*, në «Krishtërimi ndër shqiptarë», Simpozium Ndërkombëtar, Tiranë, 16-19 nëntor 1999, Konferenca Ipeshkvnore e Shqipërisë, Shkodër, 2000.
- *Shkrimtarët Shqiptarë, Pjesa I (1462-1878)*, Mbledhë e punue nën kujdesin e Ernest Koliqit, nga Namik Ressuli, Botim i Ministrisë s' Arsimit, Tiranë, 1941.
- *70 vjet të Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare*, Simpozium (Tiranë, 19 shtator 1992), Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë, 1993.
- SCHWARTZ, STEPHEN, *Broken Promises*, në «First Things», The Institute on Religion and Public Life, New York, April 2006.
- TAYLOR, STEPHEN, *Who's Who in East and Central Europe*, «Central European Times Pub. Co.», Zurich, 1937.
- TUFA, AGRON, *ADN-ja kulturore e atdhedashurisë së Mitat Aranitit*, në gazetën «Start», 14 prill 2012.
- UKCAMA, NDUE, *Zgjimi i dragojve*, Tiranë, 2005.
- ZANE, HYQMET, *50 vjet nga ekzekutimi i grupit të Teme Sejkos dhe Tahir Demit*, në Gazeta «Dielli», 31 maj 2011.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

NË MUNGESË TË NJË TRIBUNALI	5
Një inventar për viktimat e terrorit komunist	5
Nazizmi <i>versus</i> Komunizmi	6
Mitologjia komuniste mbi Kohën dhe Historinë	7
Krimet kundër njerëzimit: a ka ushtruar gjenocid komunizmi?	10
Komunizmi - çarja më e madhe në historinë tonë kombëtare	11
Masakra komuniste e Tivarit - një krim i përbashkët i PKSH dhe PKJ	18
Hekatombat e para të masakrës komuniste	21
Kryengritja e Postribës	24
Postriba, harta memece e historisë sonë	25
Tragedia e opozitës socialdemokrate	28
Terrori komunist mbi klerin katolik	29
Gjyqi mbi inxhinierët “sabotatorë” të Kënetës së Maliqit	31
Festë vdekjeje në mesnatë për nder të Stalinit	35
Përvoja e vyer e “Terrorit të madh stalinist”	35
Listat e vdekjes - e vetmja kronikë e pushtetit komunist	37
“Kolonja ndëshkimore” e kampeve të internimit	41
Kampet e internimeve - kampe të shfarosjes	43
Kur Themida ka vetëm njërin sy të mbyllur... si piratët	50
Kontrata jonë me Djallin	52
Heshtja e errët e Lustracionit	54
Kuja e Mnemozinës	56
Çdo viktimë e terrorit komunist akuzon	59
KRITERET E HARTIMIT	61
FALENDERIMET E VEÇANTA TË “INSTITUTIT TË STUDIMEVE PËR KRIMET DHE PASOJAT E KOMUNIZMIT” (ISKK)	62
A	65
B	137
C	222
Ç	237
BIBLIOGRAFIA	264

